

ENVER HOXHA

DITAR

1964

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANE KQ TE PPSH

ANËNË

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1989



ENVER HOXHA

E MËRKURË
1 JANAR 1964*

Dje pritëm në aeroport delegacionin qeveritar të RP të Kinës, të kryesuar nga Çu En Lai, në të cilin bën pjesë edhe Çen Jia. Në aeroport, ku ishin gati tre mijë veta, ishte rreshtuar roja e nderit. Çu En Lai, i qeshur, zbriti nga avioni dhe u përçafua me ne i gëzuar. Me automobil të hapët kaluam nëpër rrugët e Tiranës, të mbushura plot me popull, i cili ishte gjithë entuziazëm, me flamuj e me lule në duar.

Pasdreke Çu En Lai na bëri vizitën e zakonshme, kurse në mbrëmje vajtëm në klubin e kombinatit të tekstileve «Stalin», në mes të punëtorëve, pastaj në Shtëpinë Qendrore të Ushtrisë dhe në Klubin e Shkrimtarëve e të Artistëve, ku të gjithë festonin Vitin e Ri. Kudo pritja ka qenë entuziaste në kulm. Miqtë mbetën shumë të kënaqur.

Mbrëmjen e Vitit të Ri e kaluam shumë mirë në Pallatin e Brigadave me të gjithë shokët. Në darkë folëm unë dhe Çu En Lai.

Sonte në mbrëmje vajtëm në Teatrin e Operës dhe të Baletit dhe pamë një koncert të bukur, që u pëlqeu shumë miqve. Brohoritjet e spektatorëve për miqësinë shqiptaro-kineze ishin të përzemërta dhe të zjarrrta.

E ENJTE
2 JANAR 1964

Në sallën e Kryeministrisë filluan që në mëngjes bisedimet me delegacionin kinez. Vazhduan edhe pasdreke. Paradite dhe pasdite fola unë. Stenogramet e bisedës sime ndodhen në Arkivin Qendror të Partisë, prandaj nuk po shënoj përmbajtjen e saj në këtë Ditar. Mund të shtoj vetëm që miqtë dëgjonin me shumë vëmendje dhe të gjithë mbanin shënime. Çu En Lai, përveç shënimeve që mbante, nënvizonte dhe nxirrte shënime edhe në marzhin e letrës. Përkthyesi kinez Fan nuk përkthente keq, sido që pasdreke i duhej të ndihmohej nga shoku i tij Zhang. Edhe përkthyesi ynë e di jo keq kinezçen. Mendoj se shokët kinezë u interesuan shumë dhe këtë e shprehën përpara nesh duke thënë se ekspozeja jonë ishte shumë e mirë. Bile Çu En Lai përdori termin frëngjisht *excellent*¹, gjuhë të cilën e flet fare pak. Çu En Lai na tha: «Ju jeni përgatitur mirë për bisedime».

Nesër do të flasë Çu En Lai. Pas takimit ata shkuan të çlodhen.

1. E shkëlqyeshme.

E PREMTE
3 JANAR 1964

Sot vazhduan bisedimet me kinezët. Miqtë, megjithëse mbrëmë kanë punuar vonë, janë të çlodhur. Sot foli Çu En Lai. Ai kishte përpara mjaft fletë të shkruara, por nuk i përdori. Parashtroi dhe sqaroi probleme të vijës së Partisë Komuniste të Kinës e të politikës së tyre të jashtme. Në ekspozenë e tij problemet shtroheshin pak në përgjithësi dhe ca të theksuara me teoritë që shoqërojnë gjithë artikujt e kohëve të fundit të shokëve kinezë. Edhe mendimet lidhur me taktikën që duhet të përdoret në luftën kundër revizionizmit ishin ca të tjerrura, me fraza që të linin të mendoje se ishte fjala për diçka që Çuja s'na e thoshte hapur.

Ekspozeja e bisedës së Çu En Lait, që vazhdoi në mëngjes dhe pasdreke e që u mbajt me stenogram, ndodhet në Arkivin Qendror të Partisë.

Në mbrëmje shkuaam pamë baletin «Halili dhe Hajria». Miqve u pëlqeu shumë si muzika dhe ekzekutimi, ashtu edhe vënia në skenë. Çen Jia, që është më ekspansiv, u tha shokëve tanë: «Këto që po shoh të ju, as nuk mund t'i imagjinonim. Ne duhet të mësojmë shumë nga ju».

E SHTUNE
4 JANAR 1964

Çu En Lai shkoi sot në Shkodër, kurse Çen Jia në Korçë. Të dyve iu bë pritje e ngrohtë. Vajtja e tyre në këto dy qytete ka, gjithashtu, rëndësi politike në lëmin ndërkombëtar. Ajo forcon pozitat tona të drejta dhe të forta ndaj revizionistëve jugosllavë dhe monarko-fashistëve grekë. Veçanërisht jugosllavët tregohen shumë nervozë. Çu En Lai i sulmoi hapur dhe bëri shumë mirë. Ne nuk i sulmuam hapur, përndryshe duhet të përmendnim hapur edhe hrushovianët. Dhe për këtë taktikë, si të kinezëve dhe tonën, ne as biseduam dhe as ramë dakord. Por qëndrimi i të dyja palëve ishte i njëjtë dhe, kur sulmonim revizionistët modernë, kuptohet fare qartë për kë flisnim.

E DIEL
5 JANAR 1964

Sot në drekë u kthyen shokët kinezë nga Shkodra dhe nga Korça.

Pasdreke në orën 17 filluam përsëri bisedimet. Fola unë. Ekspozeja ime e stenografuar ndodhet në Arkin Qendror të Partisë. Çu En Lai dhe Çen Jia dëgjuan me vëmendje, morën boll shënime dhe, pasi mbarova, Çu En Lai tha: «Unë do t'i transmetoj sa më parë këto në Pekin, pse kanë rëndësi parimore, kurse disa çështjeve do t'u përgjigjem vetë radhën tjetër».

Koha po bën e mrekullueshme, sikur ta kishim porositur.

E HËNE
6 JANAR 1964

U nisa për në Vlorë tok me miqtë kinezë. Gjithë rrugës populli manifestonte i gëzuar. Herë zbrisnim nga automobili, herë hipnim në automobil të hapët që populli të shikonte miqtë. Në Vlorë kishte një entuziazëm të madh. Pasi bëmë pak pushim në komitetin ekzekutiv, shkua në Sheshin e Flamurit, ku u bë mitingu. Folën Hysniu dhe Çu En Lai. Fjalimet e tyre u dëgjuan me shumë vëmendje dhe u brohoritën. Nga mitingu shkua në shtëpitë e pushimit në Ujë të Ftohtë.

Në mbrëmje vizitua Muzeun e Pavarësisë. Gjatë kësaj kohe u kthye edhe Çen Jia nga Berati e Qyteti Stalin. Darka shkoi për mrekulli, kishte dhe një program me këngë. Foli Çu En Lai, fola dhe unë. Rap-sodë popullorë, si xha Selimi, Mustafa Luçi e Xhebro Gjika improvizuan vjersha që u pëlqyen miqve.

Pritja qe entuziaste. Të pranishmit përcollën miqtë deri te makina.

E MARTE
7 JANAR 1964

Para se të largoheshim nga Vlora për në Tiranë vizituam Fabrikën e Çimentos, ku Çu En Lait i bëri përshlypje të madhe pastërtia dhe për këtë i përgëzoi punëtorët. Vizituam edhe ndërtime të qe po bëhen në fabrikën e eternitit.

Rrugës për në Tiranë u ndalëm në kooperativën bujqësore të Novoselës, ku kryetari u foli miqve mbi gjendjen e saj. Ata u kënaqën shumë nga përparimet e kësaj kooperative.

Pasdreke, gjatë vazhdimit të bisedimeve, Çu En Lait foli mbi taktikën dhe luftën kundër revizionizmit modern. Ekspozesë së tij iu përgjigja edhe unë. (Stenogramet e bisedave të të dyja palëve janë në Arkivin Qendror të Partisë.) Shokët kinezë mbetën shumë të kënaqur nga bisedimet dhe këtë e shprehën hapur. Në sër Çu En Lait do të përfundojë bisedën e tij, pastaj do t'i përgjigjem unë.

Në mbrëmje në Pallatin e Brigadave ne dhamë darkën e madhe zyrtare. Folëm unë dhe Çu En Lait. Çdo gjë shkoi shumë mirë.

E MËRKURË
8 JANAR 1964

Në mëngjes, pasi Çu En Lait bëri një vizitë në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe Çen Jia në Universitet, rifilluan bisedimet, të cilat mbaruan me sukses.

Pasdreke u bë një miting i madh në pallatin e sportit «Partizani». Fjala e Çu En Lait u duartrokit shpeshherë. Ai tha fjalë shumë të mira për Partinë dhe për popullin tonë.

Në mbrëmje Çu En Lait dha darkë në Pallatin e Brigadave, ku ka rezidencën. Darka kaloi shumë ngrohtë, me këngë e valle. U larguam në orët e vona.

E ENJTE
9 JANAR 1964

Çu En Lai, Çen Jia dhe shokët e tyre u larguan sot nga vendi ynë.

Aerodromi i Rinasit ishte plot me njerëz. Pasi u zhvilluan ceremonitë e zakonshme, të emocionuar që të dyja palët, u përqaftuam. Avioni u ngrit nga aerodromi në orën 10. Miqtë morën me vete shumë përshtypje të mira nga populli ynë, nga Partia, nga atdheu ynë.

*Ardhja e Çu En Lait te ne ka shkaktuar një interesim të madh brenda vendit dhe në arenën ndërkombëtare. Populli ynë e priti me dashuri përfaqësuesin e popullit kinez dhe të Partisë Komuniste të Kinës, për arsye se ne jemi lidhur me ta me një miqësi të singertë, në bazë të marksizëm-leninizmit.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli ynë janë të vendosur në luftën kundër imperializmit botëror, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me grupin tradhtar të Hrushovit dhe atë të Titos. Lufta e përbashkët, sidomos në momentet ak-

tuale, e ka forcuar dhe e ka kalitur miqësinë tonë të madhe.

Dihet rëndësia e madhe e Kinës në arenën ndërkombëtare, prandaj opinionimi botëror po e ndjek me interesim udhëtimin e Çu En Lait dhe lidhur me këtë gazetat janë plot lajme. Natyrisht, imperialistët dhe reaksionarët e ndryshëm, nga vizita e Çu En Lait te ne, presin se si do të qëndrojë Kina përpara propozimeve absurde dhe dredharake të Hrushovit për ndalimin e polemikës. Atyre u interesojnë të dyja anët e medaljes. Edhe sikur të pushojë polemika me revizionistët, ata fitojnë, se renegati Hrushov mund ta vazhdojë në qetësi tradhtinë e tij. Nga ana jonë ndalimi i polemikës nuk do të ngjasë kurrë, por edhe kinezët, nga ana e tyre, konfirmuan se nuk do ta pushojnë.

Imperialistëve, nga ana tjetër, u intereson që polemika të vazhdojë për ta tërhequr edhe më tej grupin e Hrushovit në kthetrat e tyre. Ne as që e duam këtë tradhtar në radhët tona dhe do të bëjmë ç'është e mundur që ta izolojmë nga populli, nga komunistët sovjetikë dhe nga komunizmi ndërkombëtar.

Ardhja e Çu En Lait te ne ka një rëndësi të madhe, se, kur i shikon gjërat me sy, është shumë më ndryshe sesa kur i lexon në raportet e Lo Shi Gaos, ambasadorit kinez në Tiranë. Çu En Lai dhe Çen Jia i panë me sy forcën e Partisë sonë, lidhjet e saj të forta me masat e gjera të popullit, panë unitetin e çeliktë të popullit, të Partisë dhe të udhëheqjes; ata panë dhe ndjenë fuqimisht besimin dhe entuziazmin e masave në ndërtimin e socializmit, panë sigurinë dhe guximin e popullit, të Partisë dhe të ushtrisë në mbroj-

tjen e vendit, të pavarësisë dhe të sovranitetit të atdheut tonë. Kudo që shkuan, ata vunë re lulëzimin e bujqësisë, të industrisë, të arsimit dhe të kulturës.

Kjo është një fitore e madhe për Shqipërinë, sepse kështu shokët kinezë, populli dhe partia e tyre, rritin besimin dhe dashurinë për popullin dhe për Partinë tonë. Një miqësi e tillë i duhet Shqipërisë, e cila ka nevojë jo për miqësi platonike, idealiste, po reale, të bazuar në marksizëm-leninizmin.

Bisedimet, mendoj unë, shkuan shumë mirë. Ne i kuptuam miqtë dhe ata na kuptuan ne. Për sa na përket neve, në ekspozetë që bëra dhe në mbylljen e bashkëbisedimeve, u shprehëm hapur, pa asnjë rezervë, mbi të gjitha problemet, mbi strategjinë dhe mbi taktikën.

Ne e kuptojmë rolin e madh të Kinës, kuptojmë situatat e veçanta dhe përgjegjësinë e madhe që ka çdo fjalë, çdo veprim dhe akt i udhëheqësve të saj. Gjithashtu shokët kinezë e kuptojnë situatën tonë, pozitat e fituara dhe të avancuara të Partisë sonë kundër revizionizmit modern dhe këto pozita tonat ata i gjetën të drejta, marksiste-leniniste. Taktika e luftës që po përdorim dhe do të përdorim ne, ka edhe ajo bazën e saj teorike, ajo s'harron strategjinë.

Lidhur me çështjen se si e kuptojmë ne unitetin, nga ana jonë u theksua nevoja për t'u konsultuar më shpesh me njëri-tjetrin.

Por rëndësi të madhe ka, dhe kjo doli edhe nga bisedimet zyrtare dhe jøzyrtare, se tani shokët kinezë s'kanë iluzione për Hrushovin, se atë e konsiderojnë, si edhe ne, një tradhtar me damkë. Megjithatë ekspozita

zeja e Çu En Lait në lidhje me taktikën që duhet të përdorim në luftë kundër revizionizmit, ishte ca e tjerërrur gjatë. Ajo të linte të mendoje se Çuja bënte shumë fraza për të na bindur mbi diçka që s'mund ta thoshte hapur, sepse mund të gjente kundërshtimin tonë. Ne ia kishim frikën vetëm shtrimit të kësaj çështjeje nga ana e tyre: A mundet dhe a duhet, në raste të posaçme, të bënim kompromis me grupin e Hrushovit, kundër imperializmit? Ne ia shprehëm hapur Çu En Lait mendimin tonë, duke theksuar se ndaj Hrushovit nuk do të bëjmë asnjë lëshim, me të nuk do të bëjmë asnjë kompromis, se ai është tradhtar. Çdo orvatje për afrim nga ana e tij do të jetë demagogji dhe gënjeshtër për të fituar kohë, për të dalë nga situatat e vështira. Çu En Lai nuk u shpreh shumë qartë për këtë çështje, siç bëmë ne, por ai na aprovoi. Për Hrushovin pohonte po ato mendime që kishim shprehur ne dhe, në fund, me pretekstin se gjoja përkthyesi mund të mos e kishte përkthyer mirë, nuk mungoi të shtonte se, kur ka folur për ndonjë kompromis (dhe këtë jo në çështjen e kompromisit me Hrushovin), kishte ndër mend një kompromis marksist-leninist.

Me një fjalë, ashtu si i paraqiti Çu En Lai problemet, në çështjet e taktikës, në vija të përgjithshme, ne s'kishim pse të mos ishim dakord. Në disa raste dhe në disa rrethana të veçanta, që lidhen edhe me pozitat tona të avancuara, ne do të veprojmë në bazë të vijës sonë, natyrisht kurdoherë me kujdes, por duke pasur parasysh në çdo moment interesin e madh të përbashkët.

Ne mendojmë se koha do të bëjë që shokët kinezë

të avancojnë më shpejt nga sa thonë. Ata janë të mendimit se kështu i shohin problemet gjerë, dhe kjo është punë e tyre, vetëm se çështjet duhen ndjekur në kohë dhe duhet reaguar për to me tempin që e kërkojnë situatat. Kjo s'do të thotë aspak se të gjitha parashikimet ose konkluzionet që nxjerrim ne, janë të pagabueshme dhe të gjitha të drejta e ekzakte. Prandaj është shumë i domosdoshëm shkëmbimi, sa më shpesh, i mendimeve. Shokët kinezë mund të kenë më shumë të dhëna, i përpunojnë këto dhe nxjerrin, natyrisht, edhe konkluzione. Ne mund t'i shohim çështjet nga disa anë të tjera, prandaj, po të shkëmbejmë bashkërisht mendime, mund të dalë një konkluzion më i plotë.

Çu En Lai i priti në mënyrë të favorshme mendimet tona për planin perspektiv të pesëvjeçarit të ardhshëm. Ai i gjeti me vend dhe premtoi se Kina do të na ndihmojë për përpunimin e naftës, të kromit, të bakrit, të hekur-nikelit etj. Me një fjalë, problemet ekonomike që i shtruam, ai i gjeti me vend dhe tash, kur të kemi gati projektplanin pesëvjeçar, ata do t'i studiojnë konkretisht kërkesat tona. Çu En Lai u interesua për problemin e fuqisë punëtore, që ne na ka preokupuar dhe na preokupon vazhdimisht. Ai e gjeti të drejtë kujdesin e madh që ne bëjmë për të mos i boshatisur fshatrat, por të përdorim sa më shumë fuqinë punëtore të qyteteve. Natyrisht çështja e bukës na preokupoi të dyja palët. Ky problem kyç te ne sigurisht do të ecë drejt zgjidhjes, sidomos kur të kemi plehurat kimike. Çu En Lai e gjeti interesant orientimin tonë për zhvillimin e mëtejshëm të kulturave të dri-

thit në vendet malore, edhe për rastin e ndonjë situatë luftar.

Përfundimet e arritura në bisedime mund t'i vlerësojmë të kënaqshme, si për ne, ashtu edhe për ata, si nga ana politike, ashtu edhe nga ana ekonomike. Kjo do ta forcojë akoma më shumë miqësinë tonë, do të ndihmojë në forcimin e gjendjes politike dhe ekonomike të vendit tonë, do të forcojë akoma më shumë pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë.

E PREMTE
10 JANAR 1964

Shkuam me fëmijët në Dajt për të kaluar fundin e javës.

Të gjithë revizionistëve modernë ardhja e Çu En Lait në Shqipëri u dogji. Hrushovianët dhe shokët e tyre shtreshin sikur ky udhëtim dhe rezultatet e bisedimeve me ne nuk u interesonin. Kjo në sipërfaqe, pse brenda zienin, u vinte inat, donin të dinin dhe bënëin ç'bënin, përpiqeshin ta ulnin vlerën e udhëtimit të delegacionit kinez te ne dhe në Afrikë. Titistët flisnin më hapur, ishin në pararojë të revizionistëve modernë, përgjonin për të filluar zhurmën. Dhe revizionistët, pas fjalimit që mbajti Çu En Lai në Shkodër, ku i përmendi me emër titistët, ngritën boritë e tyre të çjerra.

Jugosllavët flisnin çdo natë në radiot e tyre në emër të të gjithë revizionistëve, organizuan konferenca shtypi, të gjitha gazetat e tyre shkruan. E çfarë thoshin? Sikur Çu En Lai nuk është për bashkekzistencën paqësore! Sepse për revizionistët modernë bashk-

ekzistencë paqësore do të thotë të pushosh demaskimin politik dhe ideologjik të imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe të revizionizmit modern. Titistët vetë as kishin ndonjë iluzion se nuk do të flitej kundër tyre, por u prekën që Çu En Lai atakoi vetëm ata, dhe donin të atakoheshin tok me shokët e tyre. Titistët ishin të bindur që ne nuk do të rrinim pa folur si kundër Hrushovit, ashtu edhe kundër tyre. Ata e prisnin një sulm të këtillë. Por edhe këtu mbetën me gisht në gojë. Prandaj për ne ngritën tezën e tyre bajate se Shqipëria është e izoluar. Këtë tezë të rreme ata përpiqeshin ta paraqitnin të vërtetë, në një kohë kur vetë ardhja e Çu En Lait te ne vërteton më së miri se vendi ynë nuk është aspak i izoluar.

Por titistëve u duhej të grinin, pse ardhja e Çu En Lait te ne vërtetoi pikërisht të kundërtën e propagandës së tyre kundër vendit tonë dhe izoloi në sytë e popujve klikat revizioniste në fuqi në Evropë. Ardhja e Çu En Lait ishte një grusht për ta dhe një inkurajim për revolucionarët dhe për popujt e vendeve ku sundojnë revizionistët.

Ftesa që i bëhet Kastros për në Moskë dhe vajtja e Toliatit në Beograd nuk mund të mos jenë si dy kundërpesha të revizionistëve modernë për suksesin e udhëtimit të Çu En Lait te ne e në Afrikë. Hrushovi bëri shumë përpjekje dhe presione në vendet e Afrikës për ta errësuar këtë sukses, por më kot. Ai u demaskua edhe më shumë në sytë e udhëheqësve nacionalistë të popujve të këtyre vendeve. Tash, për të ku-

ndërbalancuar suksesin e Partisë Komuniste të Kinës, Hrushovi po përdor presionet dhe shantazhet edhe kundër kubanëve, për t'u shkukur ndonjë koncesion politik që të bëjë ca bujë. Por të shohim ç'do të ngjasë.

Vajtja e Toliatit në Beograd është një kapitull i ri i avancuar i tradhtarëve të marksizëm-leninizmit. Grupi i Toliatit është nga grupet revizioniste më të rrezikshme e më të avancuara në Perëndim. Revizionistët italianë kanë një platformë krejt të hapët dhe të koordinuar me titistët, me të cilët janë në unitet të plotë dhe, pa u gabuar, mund të themi se merren vesh më mirë me Titon sesa me Hrushovin. Toliati e Titoja ua kanë frikën revolucionarëve në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të demokracisë popullore, prandaj në planet e përbashkëta kanë edhe planet e tyre të veçanta. Është e qartë se Titos i intereson shumë që toliatistët të arrijnë të marrin pjesë në pushtet në Itali. Toliati e di këtë dhe punon t'ia arrijë këtij qëllimi, duke u përpjekur të krijojë unitet me Partinë Socialiste Italiane. Por, që t'ia arrijë kësaj, që të fitojë besimin e borgjezisë, duhet që Partia Komuniste Italiane të shkojë nga e djathta, bile shumë më nga e djathta se Partia Socialiste Italiane. Për këtë qëllim, toliatistët do të ndërrojnë edhe strukturën organizative të partisë së tyre.

Natyrisht, për të zbatuar vijën e tyre revizioniste, toliatistët nuk mund të mbështeten në një parti me forma organizimi dhe disiplinë leniniste. Titoja, që e ka likuiduar një parti të tillë në Jugosllavi, u jep eksperiencë. Si Titoja dhe Toliati, si revizionistë që janë, punojnë për unitetin e krerëve të socialdemokracisë

dhe të revizionizmit modern, për unitetin e aristokracisë punëtore. Edhe Hrushovi, me anë të Titos, Toliatit e të tradhtarëve të tjerë, i është futur një rrugë të tillë, punon në këtë drejtim. Prandaj partitë e vërteta marksiste-leniniste duhet t'i dërrmojnë këto plane, t'i demaskojnë, t'i luftojnë pa mëshirë.

Pra Toliati në Jugosllavi po bën një punë të rrezikshme, po komploton kundër marksizëm-leninizmit, kundër nesh. Komunistët italianë duhet të veprojnë, ndryshe jo vetëm s'janë revolucionarë, por kanë edhe përgjegjësi.

**DAJT, E SHTUNË
11 JANAR 1964**

Jemi në Dajt. Koha është e mrekullueshme, dielli shullen. Televizori merr mirë. Bëmë shëtitje dhe djemtë vazhdojnë të ngasin makinën në luginë.

**E DIEL
12 JANAR 1964**

Dje garën në qitje e fitoi Iliri, kurse sot Sokoli. Në drekë zbritëm në Tiranë. Koha ka qenë e mrekullueshme dhe e ngrohtë.

E HËNË
13 JANAR 1964

Biseduam me Hysniun për planin e punës.

Nisemi për në Vlorë për të bërë 15 ditë pushim.

Fidel Kastroja arriti në Moskë. Ai udhëtoi në të njëjtin avion me emisarët e Hrushovit, Podgornin dhe Pasionaren, që ishin dërguar prej tij në Havanë. Pritja në aerodrom nuk ishte si e para. Tash për tash s'dimë gjë pse ka vajtur ai në Moskë. Të shohim, por punët, mendoj, nuk do të jenë të ngrohta. Do të shohim nëse Kastroja ka nxjerrë mësim nga gabimet e tij të para.

Nga eksperiencia jonë me Hrushovin mund të bëjmë një parashikim. Hrushovi e ka ftuar Kastron, ashtu siç na ftoi edhe ne, që, duke marrë shkas nga marrëdhëniet ekonomike që ai vetë i ka acaruar me qëllim, t'i bëjë presione të shumanshme. S'ka asnjë dyshim se Podgorni dhe Pasionarja kishin shkuar në Kubë që të bënin presion mbi Fidel Kastron, që ky të mbajë hapur qëndrim pro sovjetikëve si në çështjet ideologjike, ashtu

edhe në ato politike dhe veçanërisht në lidhje me Traktatin e Moskës, domethënë të zbutë politikën me imperializmin amerikan, të hyjë në tratativa me të, të mos nxitë revolucione në vendet e Amerikës Latine, të rakorodojë vijën me revizionistët e Amerikës Latine dhe të spastrojë partinë dhe udhëheqjen nga «dogmatikët». Siç duket, emisarët e Hrushovit s'patën sukses, pse nga shtypi sovjetik del qartë se pritja e këtyre dy kalanderëve në Kubë qe e ftohtë, nuk pati dandanara. Gjatë ditëve të qëndrimit në Havanë, Podgorni dhe Ibarruri a e përmendën apo jo një a dy herë emrin e Kastros. Por edhe ky as që i shoqëroi fare ose shoqëroi vetëm një herë dhe pak Podgornin. Atëherë, përpara kësaj disfate, Hrushovi i nxjerr pengesa ekonomike Kubës dhe, për t'i bërë shantazhe të mëtejshme, siç u përpoq të na i bënte edhe neve, e ftoi Kastron «të merren vesh» në Moskë. Ne s'vajtëm, Kastroja shkoi. Tash çështja qëndron nëse ky do t'i nënshtrohet Hrushovit si herën e parë¹ apo jo? Kastroja, po të jetë i qëndrueshëm dhe po ta ketë kuptuar gabimin e madh që bëri herën e parë, ia vë këmbët në një këpucë Hrushovit dhe, pa bërë as më të voglin lëshim, e detyron që ndihmat jo vetëm të mos ia presë, por këto t'i venë Kubës si sahat.

Arsyeja që dha Hrushovi për vajtjen e Kastros në Bashkimin Sovjetik, gjoja për të parë dimrin rus dhe për të gjuajtur derra në borë, është aq absurde sa edhe qesharake. Vetë Kastroja e përgënjeshtroi këtë akro-

1. Gjatë vizitës së tij në Bashkimin Sovjetik në prill-maj 1963.

baci të Hrushovit, duke deklaruar se do të rrijë shumë pak, mbasi në Kubë e pret korrja e kallamsheqerit.

Të gjitha këto konkluzione, natyrisht, i nxjerr nga të dhënat e jashtme dhe po të ndjekim këtë logjikë e në rast se Kastroja tregohet i vendosur, atëherë do të grinden në Kremlin, s'do të merren vesh ose më mirë Kastroja do të marrë vesh më mirë me ç'tradhtar të rrezikshëm ka të bëjë. Mund të mos i presin urat, se Hrushovi e di çfarë humbje kolosale do të jetë kjo për të, ai u dogj fort me ne, prandaj lidhjet do t'i mbajnë hiq e mos e këput, për të shpëtuar faqen. Kjo ka më shumë mundësi të ngjasë, por varet nga Kastroja. Çdo gjë mund të ngjasë, kur digjesh nga qulli i fryn edhe kosit.

Ngjarjet e mëvonshme do të përcaktojnë rrjedhën e gjërave.

VLORE, E MËRKURE

15 JANAR 1964*

Çu En Lai na tha¹ se gjatë udhëtimit të tij në Afrikë mund të lëshohej një komunikatë për të shpallur se Republika Franceze e njihte Republikën Popullore të Kinës. Ky akt është rezultat i bisedimeve të Edgar Forit, të dërguarit gjysmëzyrtar të Dë Golit në Kinë, me udhëheqësit kinezë.

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike në mes Kinës dhe Francës, duke pranuar Franca kushtet e Kinës, domethënë prerjen e marrëdhënieve diplomatike me Taipahun dhe mosnjohjen e politikës amerikane të «dy Kinave», do të ketë rëndësi të madhe ndërkombëtare dhe rrjedhime të thella në politikën botërore. Ky akt izolon politikën aventureske dhe grabitqare të imperialistëve amerikanë, është me të vërtetë një grusht i rëndë që i jepet politikës hegjemoniste amerikane.

Pa dyshim kjo ngjarje do të thellojë akoma më shumë të çarën serioze që ekziston në mes Francës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Koniunkturat ak-

1. Në vitën që bëri në Shqipëri në fillim të janarit të vitit 1964.

tuale bënë që, me gjithë presionet e forta e të shumanshme të imperialistëve amerikanë, anglezë, dhe deri në njëfarë shkalle të Gjermanisë së Bonit ndaj Francës, borgjezia franceze dhe presidenti i saj të mos i nënshtrohen diktatit të tyre. Franca po revoltohet si kundër vijës ushtarake të NATO-s, ashtu edhe kundër politikës ekonomike të SHBA-së. Përpara një situatë të tillë, imperializmi amerikan dhe ai anglez, të ndihmuar në këtë drejtim nga grupi revizionist i Hrushovit, po përpiqen ta izolojnë Francën, ta gjunjëzojnë dhe ta bëjnë një shtet të bindur. Mirëpo borgjezia imperialiste franceze është duke bërë një kthesë në politikën e saj drejt lidhjeve diplomatike me Kinën.

Sigurisht Franca në këto kushte do të mund ta zhvillojë më lirisht tregtinë me Kinën dhe me shumë vende të tjera të Lindjes së Largët, kështu që deri diku ajo i shpëton bojkotimit të tregjeve të saj që po ia përulan imperializmi amerikan, gjë që është jetike për të. Kjo s'ka si të mos ketë rrjedhime politike të thella në NATO, se presionet ekonomike në mes imperialistëve janë nga mjetet kryesore të luftës.

Dë Goli, duke njohur Republikën Popullore të Kinës, u tregua një borgjez i zgjuar. Kjo ngjarje do të shkaktojë me siguri një reaksion zinxhir në NATO, në lidhjet e ndryshme reciproke në mes vendeve që bëjnë pjesë në këtë organizatë, në qëndrimet ndërkombëtare përpara problemeve të rëndësishme me karakter botëror. Autoriteti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës pësoi një disfatë të dukshme në drejtimin e plotfuqishmërisë së tyre. Qëndrimin e Francës ndaj Kinës, shpejt ose vonë, do ta ndjekin edhe shtete të tjera, si,

për shembull, Japonia, në radhë të parë, e cila përpiqet të shpëtojë nga zgjedha amerikane dhe ka interesa të mëdhenj tregtarë dhe politikë nga vendosja e marrëdhënieve me Republikën Popullore të Kinës. Pozitat amerikane në OKB, në mbrojtjen e kufomës Çan Kai Shi, bëhen, gjithashtu, të vështira.

Gjithë kjo situatë e krijuar nga lidhja e marrëdhënieve diplomatike në mes Francës e RP të Kinës, vë në pozita të vështira tregtinë botërore amerikane, diskrediton dhe minon politikën agresive të Shteteve të Bashkuara në Vietnam, në Kore e gjetkë, ku Franca do të përpiqet të rifitojë disa pozita të zbehta, por që janë më mirë se hiç. Komonuelthi Britanik, duke parë këto situata, do të përshkohet edhe ai nga ethet kundër presionit amerikan.

Për ne kanë rëndësi ashpërsimi i kontradiktave në mes vendeve imperialiste, çarja e tyre, dobësimi dhe izolimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe fitorja e socializmit dhe e popujve që luftojnë për liri.

Nga ana tjetër, politika «botërore» e Hrushovit, politikë aventureske dhe krejt antimarksiste, po pëson një disfatë kolosale. Aleati i tij, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilin ra në kompromis tradhtie, po humbet në lojën e tij të shahut. Për t'u lidhur dhe për të fituar besimin e amerikanëve tradhtari Hrushov e hoqi maskën, sulmoi marksizëm-leninizmin, socializmin e vendin tonë.

Tradhtari Hrushov mendoi se arriti qiellin me dorë dhe se tok me imperializmin amerikan do të sundonin botën. Mirëpo planet e tyre po dështojnë. Në këto koniunktura, ashtu si po zhvillohen ato, ai v'ihet në

pozita çdo ditë e më shumë të vështira. Ç'do të bëjë tradhtari? Ai do të shkojë më tej në demaskimin e tij të plotë, derisa të futet në varr. Popujt dhe komunistët e botës çdo ditë e më qartë po shohin tradhtinë e Hrushovit dhe të revizionistëve modernë si agjenturë e borgjezisë dhe në aleancë me xhandarin botëror, imperializmin amerikan. Veçanërisht pasi të lidhen marrëdhëniet diplomatike në mes Kinës dhe Francës, Partia Komuniste Franceze vihet në pozita shumë të vështira nga politika tradhtare e udhëheqjes së saj revizioniste. Kjo udhëheqje tradhtare është afishuar, përveç të tjerave, edhe kundër Republikës Popullore të Kinës. Tash, kur gjithë populli francez dhe komunistët revolucionarë francezë do ta aprovojnë aktin e drejtë të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me RP të Kinës, revizionistët francezë, pa marrë parasysh akrobacitë demagogjike që do të bëjnë, do të demaskohen edhe më shumë, do të izoloohen akoma më tej nga masat. Ata, në fakt, do të mbeten shërbëtorë të Hrushovit kundër socializmit dhe interesave të vendit dhe të popullit të tyre. Në Partinë Komuniste Franceze pa dyshim do të ngjasin gjëra në të ardhmen.

VLORË, E ENJTE

16 JANAR 1964

Koha është shumë e bukur. Vizitova dy vilat që janë ndreçur. Bëra një orë shëtitje me këmbë.

VLORE, E PREMTE
17 JANAR 1964

Koha është shumë e bukur, por e ftohtë dhe me erë. I bëmë vizitë Ramizit që erdhi dje për pushime.

Në mbrëmje erdhën shokët, biseduam dhe luajtëm kupat.

VLORE, E DIEL
19 JANAR 1964

Koha shumë e bukur, shëtitëm në bregdet.

Në mbrëmje erdhi Hysniu. Nesër ai me të bijën, Verën, do të shkojnë në Tërbaç, se është festa e 20-vjetorit të themelimit të Brigadës së 5-të, në të cilën Hysniu ka qenë komisar politik. Brigada e 5-të ishte një brigadë heroike, ajo është dalluar shumë në luftime, ka pasur mbi 250 dëshmorë dhe me qindra të plagosur. Disa luftëtarë të saj janë shpallur Heronj të Popullit. Meritat e Hysniut janë shumë të mëdha; ai ka qenë një trim i shquar në luftë, ashtu siç është edhe sot i shquar në punë, i vendosur, i zgjuar, i mprehtë dhe i dashur, punëtor partie me të vërtetë shembullor.

VLORE, E HËNË

20 JANAR 1964

Koha e bukur dhe jo e ftohtë. Vajtëm vizituam Ritën, që erdhi për pushime.

Pamë me Ramizin një projektartikull për demaskimin e revizionistëve jugosllavë. Nuk ishte punuar aq mirë. E kthyem të punohet më mirë.

«Trojka trojane» Hrushov-Tito-Toliati po kristalizojn gjithnjë e më hapur punën e vet intensive revizioniste për të degjeneruar partitë komuniste, sidomos ato të vendeve kapitaliste. Bisedime të vazhdueshme janë bërë më parë dhe vazhdojnë të bëhen me krerët e socialdemokracisë evropiane dhe me partitë socialiste, si nga Kardeli me Vendet Skandinave, ashtu dhe nga Titoja e Hrushovi, pa folur për takimet, bisedimet dhe ujditë e përjavshme që bëjnë Torezi me shokë dhe klika revizioniste italiane e Toliatit. Këto bisedime dhe takime kanë qëllime të shumta, ideologjike, politike, organizative; ato shërbejnë, gjithashtu, për t'u lidhur me

borgjezinë reaksionare të vendeve ku kjo është në fuqi, për të lehtësuar kontaktet, për të tatuar pulset e shoqi-shoqit. Kontaktet e tradhtarëve të rinj me tradhtarët e vjetër të marksizëm-leninizmit bëhen në kushte të favorshme për socialdemokratët. Këta mbajnë, natyrisht, qëndrime arrogante dhe përbuzëse ndaj revizionistëve modernë dhe sidomos të vendeve të tyre. Tendencat e tyre janë të bien në ujdi me «dirigjentin» dhe ky të lozë shkopin për të vënë në lëvizje violinat e mësuara dhe të përgatitura për këtë punë në orkestrën e tij.

Marksi, Engelsi dhe Lenini bënë një luftë të ashpër kundër oportunistëve të çdo kallëpi, i demaskuan ata katërcipërisht dhe marksistët u shkëputën e formuan partitë marksiste-leniniste. Stalini më vonë i goditi të gjitha rrymat antimarksiste dhe grupimet e trockisto-revizionistëve të çdo kallëpi. Dihen sukseset kolosale të marksizëm-leninizmit, dihen proceset e lavdishme që u zhvilluan në rrugën e triumfit të socializmit në shumë vende të Evropës dhe të Azisë, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore. Lufta kundër imperializmit fashist u bë me sukses, se me sukses ishte bërë dhe u bë edhe lufta kundër oportunitizmit, trockizmit etj.

Përpara këtij hovi të pandalshëm të socializmit, imperializmi, duke mëkëmbur pas luftës agjenturën e vet, revizionizmin, e hodhi këtë në luftë kundër marksizëm-leninizmit, kundër kampit të socializmit. Revizionistët modernë dhe «trojka trojane», së cilës po i çirret çdo ditë e më shumë maska, përpiqen të gënjejnë, të forcojnë pozitën e tyre në shtet dhe në partitë e tjera komuniste dhe punëtore. Por, natyrisht, pozitën e tyre

nuk mund të shkojnë duke u forcuar, por duke u dobësuar dhe në këtë rrugë ata bëjnë përpjekje të dëshpëruara për t'u afruar me socialdemokracinë, veçanërisht me atë evropiane, duke u orvatur, sa të jetë e mundur, të ruajnë disa veçori false. Kurse, nga ana e saj, socialdemokracia i pret këta në qoshe të rrugës, kërkon t'u heqë çdo maskë, kërkon t'u heqë çdo tipar dhe t'i shkrijë në veten e saj. Kjo është rruga që po ndiqet nga tradhtarët e rinj dhe të vjetër. Ne, me luftën tonë të drejtë marksiste-leniniste, duhet të sqarojmë sa më shumë komunistë, të izolojmë dhe të demaskojmë pa mëshirë «trojkën trojane» dhe pasuesit e saj.

Mendoj se vajtja e Toliatit në Beograd dhe përpjekjet për të organizuar një mbledhje të partive «komuniste» të vendeve kapitaliste të Evropës, kanë për qëllim përgatitjen e një platforme të përbashkët revizioniste për bashkëpunim të hapët me partitë socialiste dhe ato «demokrate», kanë për qëllim t'i bëhen lëshime të mëtejshme imperializmit nga ana e revizionistëve modernë për të forcuar kampin revizionist dhe luftën kundër socializmit.

A do t'ia arrijnë toliatistët t'i bëjnë titistët të marrin pjesë në këtë mbledhje? Për titistët kjo pjesëmarrje, sigurisht, është e dëshirueshme për shumë arsye, sidomos se këta për herë të parë do të hynin zyrtarisht në një mbledhje të partive të tjera «komuniste». Por vetëm duhet që këto parti ta pranojnë plotësisht një pjesëmarrje të tillë. Për këtë punë merren me zell Toliati dhe Hrushovi. Ky i fundit, sido që është dakord, nuk do të dëshironte që shumë udhëheqës revizionistë,

që sot i drejton ai, të këmbëjnë dorë e të drejtohen nga Titoja ose Toliati. Por Hrushovi nuk mund t'i shpëtojë këtij procesi. Uniteti i plotë i revizionistëve nuk mund të arrihet, ata do të kenë grindje e kontradikta të shumta, të cilat çdo ditë e më shumë do të shtohen dhe do të thellohen.

Udhëheqësit e Partisë Komuniste Italiane, me Toliatin në krye, kanë një mendim të madh për veten e tyre. Ata mendojnë se janë dhe duhet të bëhen një qendër tjetër e madhe në Evropë e marksizëm-leninizmit të tipit të tyre, domethënë e revizionizmit modern. Këta, duke e ruajtur për formë lidhjen dhe respektin për hrushovianët, në një mënyrë ose në një tjetër, dëshirojnë t'ua heqin ndikimin që ushtrojnë në sajë të prestigjit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që të ruajnë kështu imperializmin dhe borgjezinë ndërkombëtare nga një e papritur nga ana e komunistëve të vërtetë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik; ata duan t'ia ngushtojnë Bashkimit Sovjetik sferën e ndikimit, për ta kontrolluar më mirë dhe për ta çuar më shpejt në rrugën e kapitullimit.

Udhëheqja revizioniste italiane këtë rol dëshiron ta luajë vetë, mirëpo Titoja është në mes, dhe është me influencë, kështu që hëpërhë Toliati nuk mund të bëjë dot pa të, prandaj bashkëpunon ngushtësisht me mikun e tij të Beogradit. Por revizionistët italianë s'vënë njeri mbi vete. E tillë është morga¹ dhe megalomania e tyre.

Kombinacionet parlamentare, diskutimet pa fund

1. Nga frëngjishtja — arogancë.

dhe intrigat në korridoret e parlamentit italian, polemikat që rrjedhin prej këtyre llogjeve e prapaskenave konsiderohen prej udhëheqjes revizioniste të Partisë Komuniste Italiane si kyçi i zgjidhjes së problemeve kapitale, i «marrjes» së pushtetit nga klasa punëtore dhe i «vendosjes së socializmit» në rrugë paqësore, evolucioniste, në rrugën specifike italiane. Sa më tepër të stërholluara të jenë këto diskutime në parlament, aq më tepër udhëheqjes revizioniste të Partisë Komuniste Italiane i mbushet mendja se po i bind të tjerët për të ecur në aleancë me të drejt «socializmit».

Revizionistët toliatistë kanë arritur deri në atë pikë sa të besojnë se platforma e tyre në parlament është e vetmja dialektikë «marksiste» e përsosur. Kur vjen çështja të hedhin poshtë me «fakte» tezat tona të drejta, në gojë dhe në majë të penës ata kanë vetëm shprehjet: «ju s'e njihni gjendjen reale në Itali dhe në botë», «ju s'kuptoni asgjë nga marksizmi». Të hedhësh poshtë parimet bazë të marksizëm-leninizmit e të fillosh të bësh kiakiere¹, siç po bën udhëheqja revizioniste e Partisë Komuniste Italiane, është një gjë, dhe të bësh bisedime e diskutime të frytshme, duke u udhëhequr dhe duke ruajtur parimet marksiste-leniniste, është një gjë tjetër. Të parën udhëheqja e Partisë Komuniste Italiane e ka përqafuar dhe e mban fort, e shtjellon, kurse të dytën e ka tradhtuar me ndërjegje, e ka flakur, e ka shkëlmuar definitivisht.

Vihet pyetja: Ç'kanë fituar deri tash udhëheqësit revizionistë të Partisë Komuniste Italiane me pallavrat

1. Nga italishtja — llafe.

e tyre? Asgjë, fare asgjë! Borgjezia italiane vazhdon punën e saj, klasa punëtore italiane shtypet, fshatarësia shfrytëzohet, bile në Italinë e Jugut, me format mesjetare, Vatikani helmon shpirtrat. Borgjezia italiane sikur u thotë revizionistëve italianë: vazhdoni me këto përralla, se ato na shërbejnë edhe neve, edhe juve, vazhdoni të gënjeni klasën punëtore dhe fshatarësinë italiane dhe proletariati italian e ka «eksperiencën» të marrë pushtetin. . . në kalendat greke. Borgjezia italiane nuk i trembet as strategjisë, as taktikës «specifike italiane» të revizionistëve italianë, por ajo trembet e tmerrohet nga marksizëm-leninizmi revolucionar, nga klasa punëtore, nga kthimi në pozitë të vërteta marksiste-leniniste të Partisë Komuniste Italiane, në pozitë të luftës revolucionare.

Prandaj borgjezia italiane ka gjetur te revizionistët italianë një kalë që i përshtatet vetes së saj dhe po e tërheq nga kapistra për të degjeneruar sa më shumë e sa më shpejt Partinë Komuniste Italiane dhe të largojë kështu lëvizjen punëtore nga rruga e drejtë. Borgjezia italiane, me fjalë të tjera, u thotë udhëheqësve të Partisë Komuniste Italiane: «S'kam akoma besim të plotë te ju, jepni akoma prova nënshtrimi ndaj meje në planin kombëtar, pastaj t'ju hedh disa thërri-me». Partia Komuniste Italiane është angazhuar në këtë qorrrokak edhe kjo për shkak të tradhtisë së udhëheqjes së saj, me Toliatin në krye. Komunistët e vërtetë revolucionarë italianë nuk duhet të lejojnë për shumë kohë një gjendje të tillë dhe duhet të ngrihen kundër saj. Kësaj furtune të pashmangshme i tremben edhe udhëheqja revizioniste e Partisë Komuniste Italia-

ne, edhe borgjezia italiane. Prandaj që të dy palët po bëjnë përpjekje të ecin drejt një aleance të shenjtë, për t'i bërë ballë rrebeshit të ardhshëm.

Përrallisjet e Toliatit nuk e mbajtën dot afër socialistin Neni, i cili, duke u futur në aleancë dhe në kthetrat e demokristianëve, shkaktoi përçarjen e partisë së tij. Partia e re socialiste e Unitetit Proletar, mund të jetë më e majtë se Partia Komuniste Italiane. Mundet që udhëheqjes së Partisë Komuniste Italiane s'i ka ardhur hiç mirë për atë që i ngjau partisë së Nenit, pse është një paralajmërim se një gjë e tillë do t'i ngjasë sot ose nesër edhe Partisë Komuniste Italiane. Në një rast të tillë vërtet do të krijohen mundësi më të mëdha për grupin e Toliatit që të konsumojë plotësisht tradhtinë, po në të njëjtën kohë krijohen edhe mundësi të mëdha për një luftë revolucionare kundër revizionistëve dhe borgjezisë imperialiste italiane, luftë e cila duhet të udhëhiqet nga një parti e vërtetë marksiste-leniniste italiane. Kur të krijohet kjo parti, atëherë hapen perspektiva të ndritura për unitetin e veprimit të klasës punëtore italiane, për zgjerimin e luftës dhe për izolimin e revizionistëve dhe të socialistëve të djathtë.

Revizionistët e udhëheqjes italiane e kanë zili aleancën e Nenit me demokristianët, ata do të dëshironin të shkonin tok me Nenin në këtë aleancë. Neni ua ngatërroi ca marshrutin e tyre, por Toliati nuk i ka humbur shpresat për ndonjë kockë dhe punon për këtë i udhëhequr nga «parimet e demokracisë italiane të shkruara në kushtetutë». Ja ylli ndriçues i rrugës së karvanit toliatist drejt «socializmit specifik italian»!

Udhëheqësit revizionistë të Partisë Komuniste Italiane, sigurisht, pretendojnë se partia e tyre është një «parti e madhe», «e fuqishme», «e masave». Por ata nuk i bëjnë vetes pyetjen: Pse borgjezia italiane sillet ndaj tyre në mënyrë kaq dashamirëse? Pse borgjezia italiane nuk ka marrë dhe nuk po merr ndaj tyre po ato masa dhe ligje drakoniane e mashtruese në zgjedhjet parlamentare, siç ka bërë borgjezia franceze kundër Partisë Komuniste Franceze, të cilën gati po e eliminon nga parlamenti? Sigurisht pse nuk ka frikë prej «madhësisë» së saj (megjithëse Partia Komuniste Franceze nuk është një parti e vogël në numër). Borgjezia franceze në të vërtetë ia ka pasur dhe ia ka akoma frikën Partisë Komuniste Franceze edhe pse në udhëheqje ekziston një grup i fortë revizionistësh me Moris Torezin në krye.

Revizionistët e udhëheqjes së Partisë Komuniste Italiane thonë se partia e tyre është një parti me një politikë «të gjerë, marksiste». E gjerë aq sa s'bie erë marksiste. Kjo parti jo vetëm që është e kalbur për shkak të vijës së saj politiko-ideologjike, por, me këtë gjendje që është, në grushtin e parë që do t'i japë reaksioni, do të shpartallohet dhe do të katandiset kokoshi një thelë. Revizionistët italianë përpiqen që partisë së tyre t'i japin përmasa aq të gjera, sa të katandiset në një front akoma më keq se ç'është. Ata synojnë që edhe Partinë Komuniste Franceze, një nga më të mëdhatë në vendet kapitaliste dhe me tradita revolucionare, ta sjellin plotësisht në rrugën e tyre. Këtu synojnë Hrushovi, Toliati, Titoja. Ata kanë me vete, por jo plotësisht, grupin revizionist të Torezit, i cili, sipas

mendimit tim, mund edhe të gabohem, duhet të ketë me ta divergjenca të brendshme që për interesin e përgjithshëm nuk i shprehin haptazi. Por, në udhëheqjen e Partisë Komuniste Franceze duhet të ketë një korrent të fortë revizionist që lufton ta çojë Partinë Komuniste Franceze në gjurmët e Partisë Komuniste Italiane, të partive të Titos dhe të Hrushovit, ta çojë në kohën e para kongresit të Turit, ku u bë ndarja me socialistët e Blumit dhe bashkimi me Internacionalen e Tretë. Për zhvillimin e mëtejshëm të punëve në partitë e tyre, rol vendimtar dhe përgjegjësi të madhe kanë komunistët e vërtetë francezë dhe italianë. A do të luftojnë ata? Sigurisht që po, në mos sot, nesër. Unë kam shpresa. Në këtë drejtim Partia jonë do t'i mbështetë.

Tradhtari i marksizëm-leninizmit, Toliati, ia dha dëftesën e «marksistit të shquar, heroit, njeriut që hapi rrugën e vërtetë të ndërtimit të socializmit», tradhtarit tjetër të marksizëm-leninizmit, shokut të tij Tito.

Ç'biseduan këta të dy në Beograd? Ç'do të bisedonin tjetër veç për punë tradhtie?! Por Toliati, përveç xhevahireve të tjera të tradhtisë, duke thënë për titistët: «Ne e dinim edhe më parë se ju ndërtonit socializmin dhe ishit në rrugë të drejtë marksiste-leniniste» etj., afirmoi edhe një herë tjetër se për të Deklaratat e Moskës të viteve 1957 dhe 1960 janë copa leckash. Atëherë këtij tradhtari mjafton t'i thuhet vetëm kjo: «Kur e dije këtë, pse e firmose Deklaratën?». Po a mund të ketë turp tradhtari? Jo, ai është antimarksist, që tregton pa turp me parimet.

VLORE, E MARTË

21 JANAR 1964

Hysniu kishte kaluar mirë në festën e Brigadës së 5-të. Sot ai u kthye në Tiranë.

Qëndrimi që po mban Kastroja përballë bandës së Kremlinit është shumë i mirë për Hrushovin dhe shumë i keq për çështjen e marksizëm-leninizmit. Në fakt ai po vazhdon rrugën dhe qëndrimin që mbajti gjatë vizitës së tij të parë në Bashkimin Sovjetik¹. Kastroja edhe këtë herë po e lavdëron publikisht Hrushovin. Si duket Fidel Kastroja as herën e parë dhe as herën e dytë jo se u gënjye nga Hrushovi, por ka qenë dakord me të dhe «njohja e gabimeve të tij», «autokritika» etj., janë përralla. Këtyre as që mund t'u zihet besë.

Mua më duket se s'ka gjë për t'u çuditur në këtë qëndrim të Kastros. Ai u vetëquajt marksist, dhe ne dëshiroam që të ishte i tillë për të mirën e Kubës dhe të revolucionit në Amerikën Latine. Kastroja është një intelektual demokrat-revolucionar me shumë tipa-

¹ Prill-maj 1963.

re të një luftëtari borgjez. Nën sqetullën e Hrushovit ai do të ecë më tej në këtë rrugë. Por vallë Kastroja vepron sipas kokës së vet? Më duket se jo. Ai duhet të ketë mbështetje te shumë shokë të tij. Kjo s'do të thotë se në udhëheqjen kubane s'ka njerëz që mendojnë në mënyrë revolucionare. Grindjet me Blas Rokën dhe me Eskalanten qenë më tepër çështje pushteti dhe prestigji. Në qoftë se Kastroja nuk bën kthesë, këto grindje do të venë duke u zhdukur.

Sigurisht kjo gjendje në udhëheqjen e Kubës nuk është e mirë, megjithatë revolucionet në vendet e Amerikës Latine do të ecin në rrugën e tyre. Ato kanë shkatërruar pengesa të tjera edhe më të mëdha. Koha do të na tregojë më mirë se si do të venë punët në Kubë. Ne duhet të vazhdojmë të kemi durim, pse durimi i bazuar në ideologjinë marksiste të çon në vendime të drejta, të matura dhe në interes të revolucionit botëror. Sidoqoftë hidhur na vjen që Kastroja po merr një rrugë të tillë. Megjithatë, jam i bindur se Hrushovi do t'i bëjë Kubës aq poshtërsi, sa që Kastroja, do s'do, shpejt ose vonë, do ta kuptojë me kë ka të bëjë.

VLORE, E MËRKURE

22 JANAR 1964

I bëme vizitë në shtëpi Mihallaq Gjnikasit¹.

Agjencitë e lajmeve dhe radiot e huaja po bëjnë shumë zhurmë për mundësitë e njohjes së Kinës nga Franca. Shumë mirë.

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Vlorës.

VLORE, E ENJTE
23 JANAR 1964

Koha shumë e bukur. Shëtitje e zakonshme me Ramizin. Paspdreke u bëmë një vizitë shokëve në vilën nr. 5.

I shkuam vizitë në shtëpi shokut Petrit Hakani.

VLORE, E PREMTE
24 JANAR 1964

Edhe sot koha është shumë e bukur. Shëtitje e zakonshme.

U botua komunikata ruso-kubane. Ajo është për faqe të zezë.

VLORE, E SHTUNE
25 JANAR 1964

Pamë udhëtimin tim në Sarandë të filmuar nga Sulo Gradeci. Ishte realizuar mirë.

VLORE, E HENE
27 JANAR 1964

Agjencitë e lajmeve njoftuan se Franca e njohu Republikën Popullore të Kinës. Kjo gjë shkaktoi jehonë të madhe në botë. Uashingtoni është zemëruar; Londra thotë se kjo është punë e qeverisë franceze; Boni pretendon se, si aleatë, «duhet të ishim konsultuar»; Italia hesht dhe qëndron si zakonisht në bisht, ndërsa Hrushovi dhe Titoja pëlcasin, po s'kanë ç'bëjnë, duan s'duan, e pranojnë. Dë Goli s'çan kokën fare nga këto. Kjo është një punë e mirë. Kontradiktat e imperialistëve po thellohen.

VLORE, E MARTË
28 JANAR 1964

Shkuam shëtitje me shokët në Kuzbaba¹. Koha shumë e mirë.

1. Sot parku «Liria».

VLORE, E MËRKURË
29 JANAR 1964

Kohë e vrenjtur. Natën ka rënë shi. Bëmë shëtitjen e zakonshme me Ramizin.

Qeveria kineze botoi dje një komunikatë, ku vë pikat mbi i për sa i përket çështjes së «dy Kinave» dhe i jep kështu fund spekulimeve që bëhen në lidhje me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Francën.

I bëmë një vizitë në shtëpi shokut Myzafer [Trebe-shina]¹.

Koha është me re. Bëmë shëtitje me Ramizin dhe me Ritën.

1. Në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Vlorës.

Është kohë me shi. Në mbrëmje kemi thirrur, për ta kaluar kohën së bashku, shokët drejtues të Vlorës, se nesër mbarojmë pushimet dhe do të kthehemi në Tiranë.

JANAR 1964

Takime dhe biseda pune me shokët

— Bisedë me shokun Hysni për propozimin e bërë nga Ministria e Mbrojtjes për mbrojtjen e kufirit, për planet e punës së Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ.

— Takim me Siri Çarçanin, ambasador në Kore.

— Bisedë me shokë për përmbytjet që kanë ndodhur në Shkodër, Lezhë etj.

— Bisedë pune me shokun Rita për zgjedhjet në Parti, për ceremoninë në Akademinë Ushtarake etj.

— Bisedë me shokët e rretheve Shkodër e Lezhë për masat që duhen marrë kundër përmbytjeve.

— Bisedë pune me Ramizin, me Ritën për ndihmën dhe përkrahjen që u duhet dhënë artistëve.

— Bisedë me Hakiun për mineralet e rralla në rërëra (titan etj.) dhe shfrytëzimin e tyre që sivjet, si dhe për planin e ndërtimeve të reja në Gjirokastrë.

— Takim me Ramizin për Kongresin e PSB të Gjermanisë dhe komunikatën eventuale që mund të nxjerrim, për fjalimet në këtë kongres dhe taktikën

tonë, për përgjigjen e fjalimit të N. Hrushovit në Berlin.

— Takim me shokun Rita për disa çështje organizative të Partisë.

— Takim me shokun Ramiz për çështjen e artikullit që po përgatisim kundër revizionistëve.

— Bisedë me shokun Haki për punimet e rezolucionit të Plenumit të Komitetit Qendror dhe për pusin e naftës në Divjakë.

— Urova shokun Manush për 45-vjetorin e lindjes.

*Gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare në Greqi, Sofokli Venizellosi, disa herë me radhë e në mënyrë provokuese, ka ngritur të ashtuquajturin problem të Vorio-Epirit. Më 17 dhjetor 1963, në një intervistë që i dha korrespondentit të gazetës «To Vima», ai përsëri paraqiti kërkesa për koncesione territoriale e politike nga vendi ynë, duke thënë: «Ne do të merrshim vesh lehtë me Shqipërinë, në qoftë se ky vend do të pranonte t'i jepte autonomi administrative pakicës greke në Shqipërinë e Jugut».

Deklaratat dhe qëndrimet antishqiptare të këtij monarko-fashisti të tërbuar kanë gjetur mbështetje te revizionistët e ndryshëm. Dihet biseda që ai ka bërë, për minoritetin grek në Shqipëri, me revizionistin Hrushov dhe sigurimi që ky i dha për t'ua transmetuar «shokëve shqiptarë» mendimet e pretendimet e tij shoviniste nga pozitat e «megaliidhesë». Kohët e fundit

në shtypin sovjetik nuk kanë munguar përshëndetjet drejtuar «aleatëve» grekë.

Edhe organet zyrtare të propagandës të revizionistëve jugosllavë nuk kanë mbetur pas në këtë punë. Kështu, për shembull, agjencia TANJUG jo vetëm ritransmetoi intervistën e Sofokli Venizellosit me korrespondentin e gazetës «To Vima», por shkoi edhe më tutje. Kërkesës së tij «për autonomi administrative pakicës greke në Shqipërinë e Jugut» ajo i shtoi frazën «nën varësinë e Greqisë». Kjo nuk është e rastit dhe me këtë jugosllavët vërtetuan edhe një herë se janë për copëtimin e Shqipërisë. Me këtë ata iu drejtuan edhe vetë Venizellosit (i cili nuk e shfaqti plotësisht ujdinë dhe aleancën e fshehtë në mes titistëve dhe reaktionit monarko-fashist grek për copëtimin e Shqipërisë) dhe i tërhoqën vërejtjen për këtë çështje duke e vënë qartë pikën mbi i.

Për ne, qëndrimi i titistëve ka qenë i qartë me kohë, por ata e pohuan këtë edhe një herë me gojën e tyre.

Në këtë çështje e tha fjalën e vet edhe shtypi bullgar. Por opinioni i organeve të shtypit bullgar, natyrisht, nuk përfaqëson opinionin as të komunistëve bullgarë, as të popullit vëlla bullgar. Ai përfaqëson, siç është bërë zakon atje, opinionin e dirigjentit. Sigurisht, shtypi i Hrushovit nuk mund të fliste vetë për këtë çështje, prandaj, kësaj radhe për të foli shtypi bullgar. Ky u përpoq të korrigjonte TANJUG-un dhe të shprehte «korrektesën» e zotit Venizellos. Por edhe shtypi bullgar, në përpjekjet e tij që ta vinte «drejt» qëndrimin e Hrushovit e marrëveshjen e tij me Veni-

zellosin dhe të kënaqte njëkohësisht edhe titistët, me «një zgjuarsi të rrallë» shtoi diçka nga vetja e tij. Ai s'tha as më shumë e as më pak, veçse t'i jepet autonomi Shqipërisë së Jugut, ashtu siç kanë bërë jugosllavët për shqiptarët e Kosovës.

Por, shtypi bullgar harron krejt se në mes dy popujve e dy vendeve tona, ka një traktat aleance dhe dihet përse është nënshkruar ky traktat, kurse ai e gjen shumë normal e të drejtë pretendimin e Venizellosit. Përveç kësaj, shtypi bullgar i jep Shqipërisë edhe këshillën si duhet ta zgjidhë kjo një «çështje» të saj të brendshme, që s'është aspak çështje, por të tillë e bëjnë imperialistët dhe revizionistët grabitqarë. Me këtë rast, shtypit bullgar dhe gjithë atyre që e kanë shtyrë atë ta japë këtë mendim, ne u kujtojmë sa vijon:

1. Jugosllavia çështjen e shqiptarëve të Jugosllavisë «e ka zgjidhur» me vrasje, me gjenocid, me shpërngulje, me dëbime etj.

2. Ne as jemi përzier dhe as përzihe mi në punët e brendshme të Bullgarisë, por detyrohemi të vëmë pyetjen para revizionistëve bullgarë e shtypit të tyre: Më parë se të na jepnit neve këshilla e këtë mendim tuajin «të shkëlqyer», të bazuar edhe në «eksperiencën jugosllave», pse nuk kërkonti të vihet në zbatim për minoritetin turk në Bullgari? Ju që nuk munguat të vinit në dukje me të shpejtë «idenë» e Venizellosit dhe propozimin e tij «të zgjuar», a do ta vinit pikëpamjen tonë në faqet e gazetave tuaja që ta mësojë atë opinionin i popullit vëlla bullgar?

Ne nuk kemi shpresa për një gjë të tillë, pse ky shtyp dhe këta njerëz në Bullgari, që mbështetën de-

klaratat antishqiptare të Venizellosit e që kanë bërë edhe gjëra të tjera në drejtim të vendit tonë, kanë vetëm emrin bullgar dhe asgjë të përbashkët me popullin trim, besnik e aleat bullgar.

Sulmeve reaksionare antishqiptare të Sofokli Venizellosit për çështjen e Vorio-Epirit u duhet dhënë një goditje publike diplomatike e vendosur. Njëkohësisht, ajo duhet të jetë therëse për reaksionin grek, për hrushovianët, për titistët dhe për shtypin bullgar.

Të theksohet në të se, pa u tharë mirë boja e shkriemeve të tyre, Venizellosi theu qafën tok me qeverinë e tij.

Nga ana jonë, në trajtimin e kësaj çështjeje, të tregojmë gjakftohtësi dhe përbuzje për pretendimet e Venizellosit, i cili as nuk na ka trembur dhe as do të na trembë kurrë.

E SHTUNE 1 SHKURT 1964

Nisemi për në Tiranë. Koha është me diell. Mbaruam pushimet dhe do të fillojmë nga puna me forca të reja.

Sot u njoftua një ngjarje me rëndësi të madhe për lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe veçanërisht për vendet e Amerikës Latine: Partia Komuniste e Perusë botoi një komunikatë, sipas së cilës bëhet e ditur se konferenca e partisë spastroi udhëheqjen e saj nga elementët revizionistë. Midis revizionistëve që u spastruan ndodhet edhe sekretari i përgjithshëm i Komitetit Qendror¹, i cili në Mbledhjen e Moskës të vitit 1960 na sulmoi paturpësisht. Konferenca, përveç të tjerave, aprovoi edhe një rezolutë të veçantë në përkrahje të hapët dhe solidariteti për Partinë tonë dhe për Stalinin. Ky është një grusht për revizionistët, për intrigat e tyre në Amerikën Latine.

1. Raul Akostas.

klaratat antishqiptare të Venizellosit e që kanë bërë edhe gjëra të tjera në drejtim të vendit tonë, kanë vetëm emrin bullgar dhe asgjë të përbashkët me popullin trim, besnik e aleat bullgar.

Sulmeve reaksionare antishqiptare të Sofokli Venizellosit për çështjen e Vorio-Epirit u duhet dhënë një goditje publike diplomatike e vendosur. Njëkohësisht, ajo duhet të jetë therëse për reaksionin grek, për hrushovianët, për titistët dhe për shtypin bullgar.

Të theksohet në të se, pa u tharë mirë boja e shkriemeve të tyre, Venizellosi theu qafën tok me qeverinë e tij.

Nga ana jonë, në trajtimin e kësaj çështjeje, të tregojmë gjakftohtësi dhe përbuzje për pretendimet e Venizellosit, i cili as nuk na ka trembur dhe as do të na trembë kurrë.

E SHTUNE
1 SHKURT 1964

Nisemi për në Tiranë. Koha është me diell. Mbaruam pushimet dhe do të fillojmë nga puna me forca të reja.

Sot u njoftua një ngjarje me rëndësi të madhe për lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe veçanërisht për vendet e Amerikës Latine: Partia Komuniste e Perusë botoi një komunikatë, sipas së cilës bëhet e ditur se konferenca e partisë spastroi udhëheqjen e saj nga elementët revizionistë. Midis revizionistëve që u spastruan ndodhet edhe sekretari i përgjithshëm i Komitetit Qendror¹, i cili në Mbledhjen e Moskës të vitit 1960 na sulmoi paturpësisht. Konferenca, përveç të tjerave, aprovoi edhe një rezolutë të veçantë në përkrahje të hapët dhe solidariteti për Partinë tonë dhe për Stalinin. Ky është një grusht për revizionistët, për intrigat e tyre në Amerikën Latine.

1. Raul Akostas.

Kjo ngjarje do të bëjë shumë efekt në partitë e tjera të këtij kontinenti. Tash në pozita të mira dhe të hapëta ndodhen Partia Komuniste e Brazilit, Partia Komuniste e Perusë, Partia Komuniste e Venezuelës.

E DIEL
2 SHKURT 1964

Kohë e bukur me diell. Bëmë shëtitje në rrugët rreth e rrotull shtëpisë.

E HËNE

3 SHKURT 1964

Kinezët botuan një artikull të gjatë, të shtatin, me titull «Udhëheqësit sovjetikë — përçarësit më të mëdhenj të botës». Artikulli është i mirë, i fortë, parimor, demaskues, ashtu sikur ta kishim bërë ne. Na vjen mirë, se kjo ka rëndësi për Kinën vetë dhe për forcat revolucionare në botë.

E PRËMTE

7 SHKURT 1964

Në mbledhjen e Byrosë Politike, sot, përveç të tjerave, morëm në studim dhe vendosëm problemin e ekonomizimit të bukës. Në diskutimin¹ tim për këtë problem, theksova se kjo masë nuk është aspak restriktive, shtrënguese. Ajo do të bëjë që të realizojmë kursime në bukë si në fshat, ashtu edhe në qytet. Do të evitohet shpërdorimi, sido që i paktë; do të evitojmë deri në njëfarë shkalle tregtimin e drithërave të bukës, pra shitjen e tepricave me çmime të larta, sido që një gjë e tillë nuk është alarmante dhe e konsiderueshme; do të zhdukim në fshat psikozën «se mos mbetemi pa bukë»; do të krijojmë traditën e gatuarjes dhe të pjekjes kolektive të bukës në furra publike dhe do të kemi këndeje edhe përfitim nga ngritja e rrezes së bukës, edhe kursim dhe ekonomizim ditë-punësh, që do të shkojnë në dobi të punës së përbashkët. Jam i bindur se fshatarët do ta presin mirë këtë masë.

Detyrë e ngutshme është ngritja e furrave në ato kooperativa që i kanë shtëpitë të mbledhura, si dhe

1. Shënimet e mbajtura nga ky diskutim gjenden në AQP.

ndihma nga ana e shtetit, me kredi me afate të shkurtëra, që të rregullojnë paradhëniet çdo muaj, derisa kooperativa të krijojë fondin qarkullues të saj në sasi të mjaftueshme.

Në diskutimin tim¹ për problemin e sigurimit, sistemit dhe përdorimit të fuqisë punëtore theksova se është e rëndësishme që këto probleme t'i shohim në dinamikën e tyre që në të ardhmen të mos vihemi në vështirësi, sepse edhe popullsia rritet po edhe industria (megjithëse jo me të njëjtin ritëm) rritet, edhe bujqësia kërkon vazhdimisht fuqi punëtore, krahas së cilës shtojmë edhe mekanizimin. Natyrisht ky problem nuk zgjidhet në një ditë dhe me dekrete. Kujdes i veçantë duhet treguar për pasaportizimin dhe lëvizjen e fuqisë punëtore sepse nuk ka arsye që qytetari të rrijë pa punë në shtëpi e të mos shkojë për të punuar në kooperativë apo në ndërmarrje bujqësore, në një kohë që në shumë fronte ka nevojë për forca pune.

E SHTUNË
8 SHKURT 1964

Sot në mbledhjen e Byrosë Politike u diskutua për disa detyra që i dalin Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë si dhe për zhvillimin e punës kërkimore-shkencore në shkencat ekonomike dhe juridike.

Theksova në diskutimin tim¹ përpjekjet që kanë bërë kuadrot e universitetit në fushën e shkencës. Ne kemi shkencëtarë të aftë e të pasionuar në shkencat filologjike dhe historike. Ndër të tjera theksova se unë, personalisht, nuk e kuptoj pse shkencëtarët tanë të këtyre fushave nuk janë të dispozuar të merren me problemin e ekzistencës së pellazgëve. Është i vështirë, mungojnë dokumentet. Dakord, por është shumë interesant për prejardhjen shumë të lashtë të popullit tonë.

Akoma na duhen më shumë kuadro të lartë, prandaj Ministrisë së Arsimit i del detyrë të punojë më tepër për këtë çështje. Gjithashtu, del nevoja që edhe universiteti ta organizojë më mirë punën studimore-shkencore. Natyrisht, të gjitha këto kërkojnë kohë,

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 45.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 56.

por zbatimi i masave të nevojshme ka rëndësi sepse nëpërmjet kësaj rruge do të përgatiten kushtet për krijimin, në të ardhmen, të Akademisë së Shkencave¹.

E DIEL
9 SHKURT 1964

Koha shumë e bukur. S'kemi parë kohë të tillë të thatë dimërore. Kjo mund të na shkaktojë edhe mungesë uji në verë, sidomos në Tiranë.

Në Romë një shoku ynë u takua me një shok komunist italian. Mendoj se ai ka një fond të mirë, e do dhe ka respekt për Partinë tonë, është dakord me ne, dhe, atje ku s'është dakord, s'është në gjendje të arsyetojë, prandaj me një bisedim të vogël çarmatoset. Ai hapur thotë se Partia Komuniste Italiane është në shturje, udhëheqja e saj ka tradhtuar dhe asgjë s'e lidh me të. Ky shok qëndron në parti, pse i vjen keq të largohet ose ta përjashtojnë. Ai ka humbur perspektivën në forcat e shëndosha, nuk shikon ç'bën baza dhe, dashje pa dashje, i frenon njerëzit e mirë të bazës ku ka influencë. Kërkoj ndihmën tonë morale, politike, ideologjike. Me një fjalë shoku italian dëshiron që ta ndihmojmë, duke biseduar me të më shumë.

1. Akademia e Shkencave u krijua më 10 tetor 1972.

E HËNE

10 SHKURT 1964

Bisedë me shokun Seit Bushati për disa probleme pune që ngriti.

E MARTE

11 SHKURT 1964

Sot u hap mbledhja e Plenumit të Komitetit Qendror. Në rendin e ditës është realizimi i planit dhe i buxhetit të shtetit për vitin 1963 dhe detyrat për vitin 1964. Mbasi u mbajt raporti i Byrosë Politike, filluan diskutimet që ishin të mira, por mund të bëheshin edhe më të mira.

Shokët duhen orientuar që në diskutime të mos përhapen në të gjitha problemet, por të kapin ato që janë kyç, t'i zhvillojnë dhe të bëjnë analizë kritike rreth tyre. Gjithashtu, nuk është e udhës që për çdo problem të bëjmë kurdoherë plenumë të zgjeruara, ku të marrin pjesë pothuaj dyfishi i plenumit, se kjo, ka të mirat e saj, por ka edhe minuset, mbasi kritika s'bëhet aq e hapur sa duhet dhe njerëzit nuk vihen përpara përgjegjësisë, propozimet e ndryshme nuk shqyrtohen shpejt dhe të merret vendim, por lejohet deri diku formalizëm, të cilin duhet ta luftojmë vazhdimisht e ta zhdukim.

E MËRKURË
12 SHKURT 1964

Vazhduan diskutimet në Plenumin e Komitetit Qendror. Padsreke fola unë¹ për disa çështje që na preokupojnë, si për ekonomizimin dhe administrimin më të mirë të drithit, për lëvizjen e fuqisë punëtore nga fshati në qytet dhe frenimin e kësaj lëvizjeje. Theksin e vura në punën e madhe politike që duhet të bëjë Partia për forcimin e disiplinës në punë si dhe me ata njerëz, të cilët nuk kanë arsye pse të rrinë e të kërkojnë punë të lehtë në qytete, por të shkojnë e të sistemohen në fshat.

Fola gjithashtu edhe për bisedimet dhe rezultatet e tyre me Çu En Lain, për disa probleme të situatës ndërkombëtare dhe të luftës së PPSH kundër revizionizmit modern, si dhe për nevojën që njerëzit tanë të jetojnë më mirë me situatat.

Sot morën fund punimet e Plenumit të 12-të të KQ të Partisë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 63.

E PREMTE
14 SHKURT 1964

U bë mbledhja e Sekretariatit të Komitetit Qendror, ku morëm një varg vendimesh të rëndësishme.

Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit mbi luftën kundër paragjytimeve fetare. Në diskutimin tim për këtë problem¹, pas një ekspozije të shkurtër për gjendjen e feve në vendin tonë, theksova punën e gjallë që duhet bërë me njerëzit, duke pasur parasysh moshën, formimin dhe psikologjinë e tyre. Lufta kundër fesë të jetë e vazhdueshme, në ngjitje por, megjithatë, duhet bërë kujdes, sepse lidhet me ndër-gjegjen e njerëzve.

Një rol të madh luan këtu vetë jeta jonë socialiste, puna, veprimtaria e përditshme e gjallë e njerëzve. Në këtë luftë kanë e duhet të lozin rolin e tyre edhe letërsia dhe artet.

Diskutova², gjithashtu, edhe për ngritjen e nivelit të edukatës shëndetësore të vetë punonjësit e shëndetësisë, për rëndësinë që kanë analizat mjekësore në

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 89.

2. Po aty, f. 99.

depistimin e sëmundjeve. Të kuptohet nevoja e analizave nga mjekët dhe të propagandohet edhe në popullin dhe siguria që japin ato në përcaktimin e sëmundjeve. Të përgatishim krahas infermierëve edhe laborantët e nevojshëm.

E HËNË
17 SHKURT 1964

Vajta urova shokun Rita për 44-vjetorin e lindjes.

Pata një bisedë me shokun Ramiz Xhabia, për probleme në punën e tij.

Po shkruaj tezat për një artikull të gjatë¹, me të cilin të vërtetojmë se revizionistët modernë po identifikohen dhe po bashkohen me socialdemokratët dhe me socialshovinistët. Mendoj se një artikull i tillë është i kohës dhe sidomos orientues për partitë komuniste të vendeve kapitaliste dhe, në radhë të parë, për Partinë Komuniste Franceze dhe Partinë Komuniste Italiane që udhëhiqen nga grupet revizioniste Torez-Toliat.

1. «Revizionistët modernë në rrugën e degjenerimit socialdemokrat e të shkrirjes me socialdemokracinë», botuar në gazetën «Zëri i popullit» më 7 prill 1964. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 237.

**E MËRKURË
19 SHKURT 1964**

Kohë e vrenjtur e me shi. Bën shumë mirë ky shi.

Kinezët na vunë në dijeni për përçapjen që kanë bërë rumunët dhe polakët për pushimin e polemikës.

**E ENJTE
20 SHKURT 1964**

Rumunët i drejtuan një letër edhe Komitetit Qendror të Partisë sonë, me të cilën na vënë në dijeni për përçapjet që kanë bërë pranë sovjetikëve e kinezëve për të pushuar polemikën. Na ftojnë edhe ne, si dhe të gjitha partitë e tjera, që ta bëjmë një gjë të tillë. Kjo është letra e parë që na drejtojnë rumunët. Ajo na jep neve rastin t'u përgjigjemi. Do të përgatis përgjigjen, do ta shtroj në Byronë Politike, pastaj do t'ua dërgojmë.

Renegatët e Moskës, në plenumin e fundit të Komitetit të tyre Qendror, që bënë disa ditë më parë gjoja për të mëkëmbur bujqësinë sovjetike që po shkon keq e më keq, u detyruan të shtrojnë edhe një herë çështjen e polemikës me Partinë Komuniste të Kinës, me Partinë e Punës të Shqipërisë dhe me partitë e tjera që qëndrojnë në pozita të drejta. Ata morën aprovimin e plenumit për «rifillimin» e polemikës me ne, të cilën në fakt nuk e kishin pushuar asnjëherë. Renegatët e Moskës morën gjithashtu aprovimin e plenu-

mit që materialet për këtë çështje t'i botojnë në organet e tyre qendrore. Zaten s'kishte rrugë tjetër për ta. Ata vetë e shpërthyen polemikën, por u përvëluan nga zjarri ynë, pastaj u përpoqën me hipokrizi të na gënjenin që ta pushonim atë, por s'u doli në kut kjo manovër e qepur me pe të bardhë dhe atëherë, për arsye se po u del keq boja, vendosën të mbrohen. Tani ata janë shumë të tronditur dhe të frikësuar.

Shkopi i dirigjentit nga Moskë, si dhe herët e tjera, gjoja i bindi satelitët që ta përkrahnin për «pushimin» e polemikës, e cila nuk kishte pushuar as nga ana e orkestrantëve. Sidoqoftë këta u përpoqën të gjenin nga një *modus vivendi*, pse edhe gjendja e tyre e brendshme në parti dhe ajo ekonomike ishte shumë alarmante, ishin keq për bukë, blenë drithëra nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në politikën botërore po pësonin disfata.

Tash tradhtarët e Moskës duhej të rimerrnin gjoja aprovimin e përkrahësve të tyre për fillimin rishtas të polemikës. Për këtë disa prej tyre i thirrën në Moskë «për t'i sqaruar» e «për t'i bindur», ndërsa të gjitha partive të tjera (me përjashtim të Partisë Komuniste të Kinës, Partisë së Punës të Shqipërisë, mundet edhe të Partisë së Punës të Koresë e Partisë së Punonjësve të Vietnamit) u dërguan një letër sekrete ku, pasi na shajnë ne, u thonë se do të «rifillojnë polemikën».

Mirëpo orkestra nuk ecën plotësisht si më parë sipas shkopit të dirigjentit. Shumë ujë ka kaluar nën urë dhe miu i ka shkuar disa herë në mjekër dirigjentit të orkestrës. Të çarat e tanishme nuk janë ideologjike. Ato janë taktike. Por është fakt se ky veprim

i grupit të Hrushovit ka shqetësuar veçanërisht grupin e Gomulkës dhe atë të Dezhit.

Grupi tradhtar i Gomulkës në Poloni qëndron si mbi gozhdë, si fakirët e Indisë. Ai s'di nga t'ia mbajë, pozitat i ka kaotike. Ky grup e mbështet Hrushovin, por edhe e kundërshton në disa taktika, bën kompromis me klerin, merr kredi nga amerikanët, sulmon komunistët dhe, duke qenë kundërshtari ynë nga më të rreptët, përpiqet të shuajë polemikën, që të konsumojë më mirë e më shpejt tradhtinë e tij. Prandaj Gomulka reagoi me ethe dhe iu drejtua Hrushovit që të mos botonin materiale kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe kinezëve. Nga ana tjetër, në mënyrë arrogante u tha të ndërpresin polemikën. Kampioni revizionist, Gomulka, mori tash rolin e arbitrit. Kinezët nuk i janë përgjigjur deri tash kërkesës së këtij prifti.

Edhe grupi rumun i Dezhit reagoi dhe u shqetësua shumë, jo për marksizmin, por për veten e tij, për pozitën centrliste-revizioniste që ka adoptuar në gjirin e revizionistëve të tjerë.

Cila është pozita e grupit të Dezhit? Kjo është një pozitë diçka më e majtë në gjirin e revizionizmit modern, është, si të thuash, fillimi i një vije të nuancuar revizioniste. Siç dihet, përpara presionit të Hrushovit, Ulbrihtit, Novotnit etj., grupi i Dezhit reagoi disi. Edhe Hrushovi u tërhoq disi nga pozitat e tij arrogante dhe imperialiste, nga frika se mos e shtynte Dezhin drejt pozitave tona. Kjo ishte një manovër e përkohshme e Hrushovit, për të mos i ikur zogu nga dora. Grupi i Dezhit mendoi se me këtë fitoi qiejt dhe ndërtoi një pozitë të re, të cilën e quan qëndrim të tij «heroik» dhe

njëkohësisht shumë të zgjuar, në rrugën «më të drejtë marksiste-leniniste».

Grupi i Dezhit arsyeton dhe thotë: shqiptarët dhe kinezët gabuan, u rrëmbyen. Megjithëse vonë, ne rumunët kuptuam se edhe Nikita Hrushovi ka gabuar. Pra, ne ishim gjakftohtë, të duruar, i atakuam kinezët dhe shqiptarët në fillim, pse ata gabuan, por më vonë kritikua edhe Hrushovin. Ne rumunët e ndërpreme polemikën edhe me Hrushovin, i zgjidhëm mosmarrëveshjet brendapërbrenda dhe këto i zgjidhëm drejt, në favorin tonë. Kurse shqiptarët, kinezët dhe sovjetikët janë fajtorë që mosmarrëveshjet i nxorën jashtë. Prandaj fajtorët duhet ta shuajnë polemikën dhe divergjencat t'i zgjidhim ne rumunët. E vetmja rrugë, thotë grupi i Dezhit, është rruga jonë, prandaj ne duhet të luajmë rolin e arbitrit për të pajtuar «vëllezërit» armiq e të verbuar.

Pra, Dezhi i kërkoi Hrushovit të mos i publikojë materialet e plenumit kundër Partisë Komuniste të Kinës, pse do të dërgojë një delegacion në Pekin që të merret vesh për pushimin e polemikës. Hrushovi, natyrisht, e pranoi propozimin rumun sepse, për këtë s'ka asnjë dyshim, kjo përçapje ishte e koordinuar në mes tyre. Dezhi kërkoi kështu nga kinezët që ta ndërpresin polemikën dhe të pranojnë delegacionin rumun. Kinezët e pranuan dërgimin e delegacionit dhe ftuan Dezhin, por rumunët dërguan Maurerin. Për këtë veprim të tyre rumunët vunë në korent edhe partitë e tjera. Na bënë edhe neve një letër, me të cilën me paturpësi na kërkojnë të pushojmë polemikën.

Natyrisht, ne do t'u përgjigjemi dhe do t'i vëmë

në vend ata. Në letrën tonë duhet t'u themi rumunëve që polemika nuk pushohet, se atë s'e filluam ne, por Hrushovi, duke përfshirë dhe ata vetë me shokët e tyre, se polemika është një gjë e mirë, e domosdoshme, shpëtimtare për marksizëm-leninizmin dhe shkatërrimtare për revizionistët. Polemika, edhe sikur Nikita Hrushovi të njohë gabimet dhe krimet e tij hapur dhe botërisht, prapë nuk do të pushojë, pse duhet të vazhdohet puna për demaskimin e rrymave revizioniste. Armiku Nikita Hrushov as i njeh gabimet, as i merr mbrapsht, prandaj polemika do të vazhdojë deri në shpartallimin e plotë të tij, të ideve revizioniste të tij, të Titos dhe të shokëve të tij.

Duhet t'u vëmë në dukje rumunëve në letër që të mos harrojnë se ata vetë kanë bërë gabime të rënda, se janë akoma në gabime dhe orvatja e tyre bie shumë erë revizioniste, se Partia jonë s'i ka asnjë borxh partisë rumune, përkundrazi, kjo i ka borxh Partisë sonë. Për sa i përket kundërshtimit që kjo i bën Hrushovit, ky është vetëm një fillim, megjithëse jo ndonjë gjë e madhe, prandaj i duhet të ecë përpara dhe e ka kot që orvatet të na tërheqë ne pas në pozitat e saj centriste. Të tilla manovra ne nuk i hamë.

T'ua themi rumunëve hapur të katër të vërtetat, në formë të drejtë, shoqërore, por të vendosur, që të mbledhin mendjen, që të mos kenë iluzione dhe në fund t'ua mbyllim letrën me një kokërr sheqerkë që të mos hidhërohen nga të vërtetat, përkundrazi të mësojnë nga to, të njohin thellë gabimet e tyre dhe, po qe se kanë një fije ndershmërie, të hyjnë në binarët e marksizëm-leninizmit.

E PREMTE
21 SHKURT 1964

Koha u gdhi me diell. Kështu bëhet mirë për bujqësinë: shi-borë-diell.

Kopja e origjinalit të letrës së KQ të Partisë Komuniste të Kinës dërguar Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku denoncohet komploti i revizionistëve sovjetikë prapa shpinës së Partisë Komuniste të Kinës në lidhje me shuarjen e polemikës, do të na jepet sot. Sipas kësaj letre, për të cilën jemi vënë në dijeni verbalisht, kinezët i kapin mirë momentet që ngrenë revizionistët, të cilët janë në konfuzion të madh. Letra e kinezëve demaskon edhe duaxhinjtë e Hrushovit, që janë bërë maska e tij.

Po përgatitim letërpërgjigjen për Partinë Punëtore Rumune

E DIEL
23 SHKURT 1964

Përfunduar letrën që do t'i dërgojmë KQ të Partisë Punëtore Rumune. Tekstin e saj do ta shohim përfundimisht me shokët e Byrosë Politike.

E HËNË
24 SHKURT 1964

Dje dhe sot Tirana dhe Durrësi s'kanë pasur ujë të pijshëm se është çarë një tubacion nga ana e Qafë-mollës. Janë marrë të gjitha masat që defekti të riparohet sa më shpejt.

Bisedova me shokun Ramiz për dorëzimin e letër-përgjigjes rumunëve.

E MARTË
25 SHKURT 1964

Bisedë pune me shokun Ramiz.
Në Elbasan e Peqin ra dy herë tërmet, por i lehtë.
Defekti në tubacionin e ujit u rregullua. Tirana e Durrësi po marrin ujë si zakonisht.

U tërhoqa vërejtjen Fadil Paçramit dhe Todi Lubonjës, se kanë pesë ditë që po ndryshojnë faqosjen e «Zërit të popullit», të cilën për nga forma po e kthejnë në një gazetë joserioze, plot fantazira të çuditshme.

U nisa për në Korçë. Ndalova në Elbasan dhe bisedova me shokët e byrosë së komitetit të Partisë të këtij rrethi. Tani atje u zgjodh sekretar i parë, shoku Jashar Menzelxhiu, kurse shoku Seit Bushati, që ishte në Elbasan u zgjodh sekretar i parë në Lezhë.

Fjeta në Elbasan.

Duke udhëtuar për në Korçë, u ndala në Librazhd, ku bisedova për punët me shokët e byrosë së rrethit.

Qëndrova për drekë në Pogradec dhe bisedova me shokët drejtues të këtij rrethi.

Në mbrëmje arrita në Korçë.

Pasdreke filloi konferenca e Partisë e rrethit. Raportin e mbajti shoku Leka Shkurti, se shoku Pirro Kondi¹ është i sëmurë e shtruar në spital. Raporti ishte përgatitur mirë dhe u dëgjua me vëmendje të madhe.

Pas raportit u dha një koncert ku merrnin pjesë një masë e madhe diletantësh. Interpretuan mirë, por mund dhe duhet t'i organizojnë edhe më mirë.

Shoku Ramiz erdhi këtu dhe më informoi për përgjigjen që kinezët duan t'u dërgojnë sovjetikëve në lidhje me letrën që këta u kanë dërguar këtu e tre muaj më parë.

Pjesa e parë e letrës është e mirë, e fortë. Në pjesën e dytë kinezët u propozojnë sovjetikëve që në tetor të vazhdohen në Pekin bisedimet kino-sovjetike që u filluan në Moskë dhe mbasandaj të punohet për një mbledhje të 17 partive për të përgatitur konferencën

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës.

ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore. Për këtë ata kërkojnë mendimin tonë.

Porosita Ramizin t'u thotë shokëve kinezë me gojë se mendimin tonë s'ua japim dot brenda 24 orëve, për arsye se këtë gjë (sidomos pjesën e propozimeve) duhet ta vendosë Byroja Politike. I theksova t'u sugjerojë idenë se është vallë e domosdoshme një përgjigje e shpejtë, sidomos tash që po shkon në Pekin delegacioni rumun? Apo të lihet kjo çështje pas përfundimit të bisedimeve me rumunët, pse qëllimi i të gjitha këtyre manovrave të revizionistëve është që të pushojnë polemikën, gjë që ne s'duhet në asnjë mënyrë ta pranojmë.

KORÇË, E SHTUNË

29 SHKURT 1964

Filluan dhe vazhduan gjithë ditën diskutimet në konferencën e Partisë të rrethit. Ato ishin të mira, konstruktive, me kritikë dhe autokritikë.

KORÇË, E DIEL

1 MARS 1964

Shënime gjatë diskutimeve në konferencën e Partisë të rrethit të Korçës.

1. — **Ilo Prifti**, drejtor i Ndërmarrjes Bujqësore të Maliqit, tha se panxharin e vlerësuan më shumë, kurse drithërave nuk u vunë rëndësinë e duhur. Mirë kanë vepruar për panxharin, por drithërat nuk duhej t'i nënvleftësonin.

Kujdes kishin treguar në rezervimin e tokës më shumë nga ç'duhej për panxharin, për patatet etj., kurse për bukën jo.

Rezultatet e tyre në përgjithësi janë të kënaqshme, vetëm në drithërat pati mosrealizime, gjë që ngjau nga mungesa e kujdesit të duhur.

Iloja kritikoi shokët drejtues të Korçës për deficitet e krijuara. Bëri, gjithashtu, autokritikë serioze dhe u angazhua që deficitin e misrit ta plotësojnë si pesëvjeçar. Tha se gruri i sivjetshëm paraqitet shumë i mirë dhe plani do të tejkalohet. Për misrin do të bëjnë shumë kujdes, kanë marrë të gjitha masat.

Iloja është shok shumë i mirë, i zoti, energjik, e kemi Hero të Punës Socialiste.

2. — **Vasil Tilka** (kryetar i kooperativës bujqësore të Rëmbecit).

S'kanë realizuar as panxharin, as drithërat, bile kanë pasur goxha deficite. Këta kanë pasur përmbytje nga ujërat, por nuk kishin parashikuar të papriturat.

Organizata e Partisë është e fortë dhe kryetari po ashtu është shok i mirë.

Foli për leverdinë e madhe që ka shitja e bukës në furra, gjë që e kanë pritur mirë fshatarët sepse kështu kanë ekonomi të madhe të drithit, po ekonomizojnë edhe fuqinë punëtore. Kooperativistët e konsiderojnë dënim në rast se nga kooperativa do t'u thuhet: «Meqenëse nuk përmbush minimumin e ditë-punëve, do të të japim drithë, por jo bukë në furrë».

Foli për shtimin e fondit tranzitor. Dënoi largimin e njerëzve nga fshati. Tha se panxharsheqeri sivjet do të realizohet mbi planin.

3. — **Petraç Kacori** (përgjegjës i SMT-së (oficinë), sekretar i organizatës-bazë).

Foli për punën politike që bëhet çdo javë me punëtorët.

Mori angazhime.

4. — **Myzafer Sulejmani** (drejtor i trikotazhit).

Tha se ndërmarrja ka një kolektiv të fortë, të shëndoshë dhe planin e realizojnë. Vuri në dukje se kanë dobësi në shfrytëzimin e makinerive; u mungon filli për çorape dhe llastiku dhe prandaj dalin deficit. Kanë marrë mjaft iniciativa për përparimin dhe shtimin e prodhimeve.

Kritikon disa drejtues ndërmarrjeje që nënvlerësojnë punën e «brigadave socialiste». Ata jo vetëm nuk

përkrahin, por as marrin mundimin të krijojnë të tilla brigada.

Diskutim i mirë.

5. — **Irfan Spaho** (kryetar i kooperativës bujqësore të Vishocicës).

Foli për situatën politike në botë dhe për punën e Partisë në demaskimin e revizionizmit modern.

Tregoi se si zbatojnë në praktikë kodin agroteknik, si i përdorin plehrat organike.

Siguruan numrin e krerëve në bagëti. Prodhimin blegtoral e tejkaluan. Ushqimin e bagëtisë e realizuan. Panxharsheqerin e realizuan vetëm 75 për qind. Pra planin e panxharit dhe të drithërave s'e kanë realizuar. Gruri paraqitet mirë dhe planin e mbjelljes e kanë tejkaluar.

Bën thirrje për garë dhe jep shifra për realizimet që janë objekt garash.

6. — **Myftar Grabocka** (kryetar i komitetit ekzekutiv të kp të rrethit).

Tërhoqi vëmendjen se për deficitet e krijuara shkaqet duhen kërkuar në dobësi të drejtimit të punës.

U gjetën të papërgatitur përpara shirave të mëdha të vitit të kaluar. U vonuan në mbjellje, pasi kanalizimet nuk u bën dot ballë vërshimit të ujërave. Plehu, gjithashtu, nuk u transportua në kohë.

Puna jo e plotë me njerëzit bëhet pengesë. Mungesat në disiplinë sjellin humbje të mëdha në numrin e ditë-punëve. Kritikon punën burokratike të aparatit të komitetit ekzekutiv. Bën edhe autokritikë.

Detyrat që vë konsistojnë në plotësimin e deficitit të bukës, në përparimin e blegtorisë dhe në shtimin e

prodhimit të panxharit. Kritikon tendencën e gabuar që lejon nënvlerësimin e panxharit, të drithërave ose të kullotave të caktuara për to.

Vuri detyrë evitimin e gabimeve të vitit të kaluar, shfrytëzimin e kohës së pranverës dhe parapërgatitjen për kushte thatësire.

7. — **Sterjo Male** (kryetar i komitetit ekzekutiv të lokalitetit të Pustecit).

Foli për përmirësimin e jetesës në fshat. Fshatrat e këtij lokaliteti ku banon minoriteti maqedonas më parë kanë pasur një nivel shumë të ulët të jetesës, kurse tani çdo gjë ka ndryshuar. Nuk ka më sëmundje si tuberkulozi etj., përkundrazi ka mjekë, farmaci e maternitet. Pra mënyra e jetesës është përmirësuar dhe në të gjitha fshatrat e lokalitetit ka përparime të mira. Dhe njerëzit që banojnë atje janë të mirë, përparimtarë dhe shumë të lidhur me Partinë.

Tha se planin do ta realizojnë.

8. — **Fatmir Pavliqoti** (sekretar i organizatës-bazë në Progër).

Foli për ndërtimet në fshat dhe për përmirësimin e jetesës. Tha se tri herë në javë japin film, (me aparat e tyre). Foli mirë dhe paraqiti rezultate konkrete për kulturën në kooperativë.

9. — **Dhora Konomi** (përgjegjëse e gruas).

Përmendi shumë organizata partie të kooperativave ku gratë punojnë mirë. Por sidoqoftë, vuri në dukje se në përgjithësi bëhet një punë e sipërfaqshme me masat e grave.

Pjesëmarrja e gruas në punë në kooperativë dhe

numri i ditëve të saj të punës është akoma i ulët (160 ditë-punë është mesatarja).

Kritikon ata kryetarë kooperativash që nuk nxjerrin gratë në punë dhe hedh mendimin të caktotet minimumi real i ditë-punëve për gratë, se disa herë kjo bëhet pa kritere të drejta. Vuri në dukje se ka të vajzat shfaqje të tendencës për t'u larguar nga fshati, prandaj del detyrë intensifikimi i punës bindëse me to.

Sigurimi i fronteve të punës së përshtatshme për gratë nuk bëhet seriozisht.

Ngritja e çerdheve, e kopshteve, e furrave. Autokritikë.

10. — **Koço Lako** (kryetar i komitetit ekzekutiv të qytetit).

Foli për zgjidhjen e ankesave dhe të kërkesave të qytetarëve, për probleme të strehimit, të zënies me punë dhe të pasaportizimit.

Ngriti problemin që ndërmarrjet të interesohen vetë për strehimin e punëtorëve dhe të mos presin që kërkesat për strehim t'u plotësohen të tëra nga komiteti ekzekutiv i qytetit. Komisionet, gjithashtu, t'i shpërndajnë drejt banesat për strehim. Të ketë lidhje të ngushta të komitetit ekzekutiv me ndërmarrjet dhe kontroll të rreptë nga i pari të dytëve sepse, ka raste që ndërmarrjet bëjnë lëshime.

Martetat e djemve të fshatit me qytetare, për të ardhur në qytet, bëhen shqetësuese (afro 300 martesa). Të bëhet punë politike individuale.

11. — **Bexhet Zagorçani** (sekretar i komitetit të Partisë).

Në fillim vlerësoi gjendjen politike dhe ideologjike,

si brenda dhe jashtë vendit. Foli për forcimin e Partisë në fshat dhe për rëndësinë e punës së Partisë në brigada, për shpërndarjen e komunistëve në frontin e punës prodhuese.

Foli për furrat e bukës dhe eksperiencën e mirë të Rëmbecit dhe për prapambetjen në këtë drejtim të Zemblakut.

12. — **Abdyl Bizhga** (delegat i kufitarëve).

Solli përshëndetjet e kufitarëve. Arsyetoi në mënyrë marksiste unitetin e popullit dhe të Partisë me kufitarët. Tregoi për vigjilencën dhe heroizmat e kufitarëve dhe të njerëzve të popullit për ruajtjen e kufirit, për kapjen e shkelësve të kufirit. Foli për marrëdhëniet midis kufitarëve e kooperativistëve dhe ndihmën që i japin njëri-tjetrit. Rregulloret të mos shkelen as nga kufitarët, as nga civilët.

13. — **Marko Xega** (sekretar i komitetit të Partisë për probleme të ekonomisë).

Foli për NTLAP-in, për raste të thyerjes së disiplinës, për faktin që ka komunistë të cilët nuk ngarkohen me detyra apo që ka edhe grindje midis tyre.

Organizatata-bazë të jenë më luftarake. Kritikoi shfaqje të burokratizmit në aparatit e komitetit ekzekutiv. Foli, gjithashtu, për aktivizimin më të madh të shokëve të plenumëve.

14. — **Rexhep Saraçi** (drejtor i Uzinës Mekanike).

Foli si ka punuar uzina dhe organizata e Partisë. Si kanë punuar me kooperativën bujqësore të Vashtëmisë që e kanë në patronazh.

Planin e kanë realizuar.

Kanë prodhuar makineri që janë vënë në punë në rreth, duke kursyer materiale të importit.

I kanë ardhur në ndihmë fshatit, duke rregulluar vegla të punës, kamionin për transportimin e prodhimeve etj. Kjo ndihmë nuk u ka kushtuar gjë, por fitimet kanë qenë të mëdha. Foli për konfeksionet e brendshme. Kritikoi kooperativën e Vashtëmisë që nuk realizoi planin dhe rendimentet.

15. — **Petraq Veshi** (sekretar i komitetit të Partisë në Fabrikën e Sheqerit).

Foli për punën e komunistëve në organizatë, për përparimet që janë bërë, për unitetin dhe për jetën e brendshme të organizatës. Ka edhe disa njerëz që merren me cikërrima, por organizata është në pozita të shëndosha.

Fabrika dhe çdo repart veç e veç e kanë realizuar planin.

16. — **Dituri Lalollari** (mësuese në Dobërçan).

Flet për luftën kundër prapambetjes dhe zako-neve të këqija. Moshat e reja janë çliruar nga besimet e kota. Flet për ndryshimet në fshat, për përparimet në mënyrën e jetesës.

17. — **Misto Nuke** (mjek kardilog, zëvendësdrejtor i spitalit).

Flet për çështje administrative që lidhen me mjekësinë. për luftën kundër tuberkulozit, për depistimet që janë shtuar dhe për kontrollin që u bëhet nxënësve dhe punëtorëve në qendrat e punës, për kërkesat kryesore që i kanë bërë komitetit ekzekutiv etj.

Sistemi i ngrohjes.

Sistemi i shërbimit autopsik.

Meremetimi i spitalit.

Röntgen më të fuqishëm, operator tjetër.

18. — **Skënder Stefanllari** (drejtor i shkollës pedagogjike).

Foli për reformën e shkollës. Mendimi i pavarur pedagogjik po forcohet dhe cilësia e mësimit është ngritur.

Shkolla pedagogjike e Korçës gjatë 16 vjetëve ka nxjerrë 1100 nxënës.

19. — **Palo Themeli** (nënkryetar i komitetit ekzekutiv).

I njuh problemet.

20. — **Koço Lekbello**, (konsumi i rrethit).

21. — **Vasilika Kallanxhi** (nëndrejto e NTLAP-it).

Foli për punën e kolektivit dhe të organizatës së Partisë në ndërmarrjen e saj.

22. — **Jani Polena** (sekretar i parë i komitetit të rinisë).

Foli për edukimin e rinisë. U bëri kritikë mbeturinave të këqija.

23. — **Hamide Pashollari** (brigadiere në Ndërmarrjen Bujqësore të Maliqit).

E re. Diskutoi shumë mirë.

24. — **Jani Naska** (në Degën e Punëve të Brendshme).

E paraqiti shumë të rëndë punën e armikut. Më duket se e absolutizon që në çdo gjë, në çdo pakujdesi, sheh gishtin e armikut.

Si anëtar i byrosë, mund dhe duhej të fliste edhe për punën armiqësore, por me folë në të tërë diskutimin për këtë, nuk është me vend. Mund të ketë njerëz

që të mendojnë se na mbuloi puna e armikut, prandaj çdo gjë duhet thënë me masë. Të flasësh për punën e armikut, dhe për mungesën e vigjilencës nga disa komunistë, nuk do të thotë të mos japësh dhe shembuj pozitivë nga komunistë që janë vigjilentë.

25. — **Nasi Mosku** (në Bashkimet Profesionale të rrethit).

26. — **Thoma Samara** (drejtor në Ndërmarrjen e Ndërtimit).

Diskutimet mbaruan.

Konferenca e Partisë e rrethit vazhdon punimet. Mendimi im është se ajo po zhvillohet në nivel të lartë. Diskutimet ishin objektive dhe me frymë kritike. Organizata e Partisë e rrethit të Korçës është e mirë, një organizatë me formim të shëndoshë marksist-leninist, e pjekur e me eksperiencë të madhe; çdo vit organizata rritet dhe përtërihet. Në Korçë mund e duhet të ketë shumë rezultate të mira si në bujqësi, në industri, ashtu edhe në arsim e kulturë.

Në fjalën që mbajta¹ bëra sugjerime dhe shtrova disa probleme që punët të ecin gjithmonë e më mirë.

Vizitova familjet e shokëve Pirro Kondi dhe Myftar Grabocka.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 102.

Sot në gazetën «Zëri i popullit» u botua artikulli me titullin: «N. Hrushovi shtrembëron idetë e Leninit për t'i hapur rrugë kursit të vet proimperialist»¹.

Vajtëm në teatër, pamë dramën «Rrethimi i bardhë». Është e palejueshme të vihet në skenë ose të botohet një pjesë e tillë.

Subjekti i kësaj pjese teatrale s'i përgjigjet fare realitetit tonë, dhe ka, me tërë kuptimin e fjalës, përmbajtje demoralizuese dhe disfatiste.

Në dramë bëhet fjalë për një grup të degjeneruarish, imagjinuar diku në Alpe dhe këta qenkan bërë «bërthama proletare» për ndërtimin e një fabrike. Kjo «bërthamë proletare» përbëhet nga një kuzhinier pijanec, një punëtor dembel dhe budalla, një magazinier kusar dhe dezertor, një përgjegjës nga më të poshtrit, një doktoreshë e re që mendon vetëm për dashuri etj. Të tillë janë personazhet e kësaj pjese. Atëherë ç'pret nga morali i pjesës?!

S'ka pse të vihen në skenat tona pjesë të tilla!

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 159.

KORÇE, E HENE

2 MARS 1964

Vizitova Fabrikën e Trikotazhit, e cila është bërë një fabrikë moderne me salla të mëdha plot dritë e diell, të pastra, me llamba neon dhe me makineri krejt të reja. Punëtorët, pse shumica dërrmuese atje janë gra, punojnë në kushte mjaft të mira dhe prodhojnë trikotazhe të bukura, të forta dhe të lira. Populli është i kënaqur nga prodhimet e kësaj ndërmarrjeje. Atje më thanë se kishin disa mungesa të vogla të parëndësishme, që do t'u plotësohen.

Pasdreke shkova në shtëpinë e kulturës dhe u dorëzova disa shokëve tjerat e reja të Partisë. Ishin çaste emocionuese dhe nder e kënaqësi e madhe për mua.

Në mbrëmje më erdhi profesor Konda (107 vjeç, siç thotë ai). Natyrisht, biseda jonë e gjatë u bë rreth pellazgjishtes, rreth Dodonës, rreth Olimpët dhe Homerit.

KORÇE, E MARTË

3 MARS 1964

Vajta pashë si punojnë punëtorët e qilimave e të sixhadeve. Atje të gjitha janë gra dhe punojnë mirë. Vetëm se nuk i kemi stabilizuar si duhet tregjet e jashtme për shitjen e qilimave e të sixhadeve. Për këtë shumë herë jemi detyruar t'u ndryshojmë planin dhe t'i vëmë kështu në vështirësi. Në të dalë të fabrikës u bë një miting ku u fola punëtorëve.

Vizitova uzinën mekanike, e cila do të zgjerohet akoma. Më pëlqeu puna që bëjnë punëtorët atje. Organizimi dhe planet perspektive të kësaj qendre pune janë kurajoze. Përveç veglave të ndërrimit, në këtë uzinë bëjnë pompa për ujitje dhe makina. Sa mundësi kemi! Këtë çështje do ta shtroj me forcë në Byronë Politike dhe do të propozoj të merren masa të tjera.

Më bëri vizitë shoku Kristo Kono. Biseduam për muzikën shqiptare dhe të ardhmen e saj. I sugjerova atij të mendojë për të përgatitur një balet shqiptar (ndonjë legjendë nga më të bukurat e vendit). Më premtoi se do të përpiqet.

E MËRKURË

4 MARS 1964

U ktheva në Tiranë. Shkova urova shokun Hysni për datëlindjen, mbushi 49 vjeç.

E PREMTE

6 MARS 1964*

Kinezët na kanë komunikuar përgjigjen e një le-tre të tyre dorëzuar më 1 mars sovjetikëve, lidhur me një dokument që këta u kanë dërguar, pas mbledhjes së plenumit të tyre të fundit, gjithë partive komuniste e punëtore, me përjashtim të Partisë Komuniste të Ki-nës dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë. Letra e so-vjetikëve është shumë e ndyrë, ajo e sulmon si vaga-bonde dhe njëkohësisht e kërcënon Partinë Komuniste të Kinës. Kjo e fundit u është përgjigjur sovjetikëve flakë për flakë dhe na e dërgon edhe neve përgjigjen që u bën atyre.

Të shohim se si do të reagojnë sovjetikët lidhur me propozimet për mbledhje, por mendoj se ata do ta kapin këtë çështje, sidomos tash që do të venë rumu-nët në Pekin, për të ndikuar me çdo kusht që të pu-shohet polemika, qoftë edhe për një kohë të shkurtër. Armiku kërkon të të kapë qoftë edhe majën e gishtit dhe pastaj të të rrëmbejë dorën, krahun e më në fund kokën. Në asnjë mënyrë nuk duhet pushuar polemika! **Zjarr deri në fund kundër revizionistëve sovjetikë!**

E MARTE

10 MARS 1964

Në Qipro vazhdojnë trazirat, ndërsa populli, qoftë ai grek, qoftë ai turk, vuan. Imperializmi anglez, ame-rikan, reaksioni grek, turk, Hrushovi, Titoja e të tjerë intrigojnë, spekulojnë mbi këtë çështje.

Sot në orën 16.30' patëm mbledhjen e organizatës-
-bazë.

Kinezët ritransmetuan në radio artikullin e tyre të
fundit, ku Hrushovin e trajtojnë si përçarësin më të
madh. Kjo u tregon sovjetikëve se polemika vazhdon
edhe pas vajtjes së rumunëve në Pekin.

E HËNE
16 MARS 1964

Sovjetikët u kanë dërguar një tjetër letër të poshtëre kinezëve, ku, pasi i shajnë, kapen nga propozimi i vetë kinezëve dhe u thonë jo vetëm «t'i bëjmë» mbledhjet, por edhe «t'i bëjmë» sa më shpejt. Ata afrojnë datat dhe propozojnë që gjatë kësaj kohe të pushojë polemika. Nuk e parashikuam keq.

Rumunët, më në fund, pasi ikën nga Pekini, na lajmërojnë të njëjtën gjë, ndërsa kinezët akoma s'na kanë vënë në korent për bisedimet që bëjnë me ta. Me sa duket, rumunët dështuan në planet e tyre.

E MARTË
17 MARS 1964

Partia Komuniste e Zelandës së Re doli hapur kundër Hrushovit. Komunistët e Zelandës së Re po bëhen shembull për partitë komuniste e punëtore të vendeve kapitaliste në atë zonë.

E MËRKURE
18 MARS 1964

Mora një letër nga Riza Kodheli. Me sa duket, në këtë moshë të shtyrë, nuk është mirë me shëndet dhe me gjithë dëshirën që ka nuk vjen dot të më takojë. Përveç kësaj ka edhe hallin e djalit që prej 6-7 vjetësh punon larg familjes. Lashë shënimin që t'i jepet përgjigje shpejt plakut për këtë problem.

E ENJTE
19 MARS 1964

Në numrin 3 të revistës «Nëntori» lexova poemën e Ismail Kadaresë «Përse mendohen këto male». Më pëlqeu shumë dhe e përgëzova autorin me telefon.

E PREMTE
20 MARS 1964

Kinezët po na e vonojnë informacionin për bisedimet me rumunët.

E SHTUNË
21 MARS 1964

Sot në mbledhjen e Sekretariatit u diskutua për gjendjen e kuadrit në aparatet e KQ, në aparatet e komiteteve të Partisë në rrethe, në dikasteret qendrore etj.

Në diskutimin tim¹ u ndala në metodën tonë të punës. Fola², gjithashtu, për punën e Partisë në lagje, për dashurinë dhe kujdesin që duhet të kenë njerëzit ndaj lagjes dhe rrugës ku banojnë.

Kinezët na vunë në dijeni për bisedimet që zhvilluan me rumunët. Siç del nga njoftimi i kinezëve, rumunët dështuan në orvatjet e tyre të koordinuara me Hrushovin për pushimin e polemikës. Megjithatë, rumunëve do t'u bëjë mirë vajtja në Pekin, do të reflektojnë, mund të mbajnë për një kohë pozita centriste, por nga kjo ne s'humbasim gjë. Më mirë të qëndrojnë gjoja neutralë, sesa të jenë hapur kundër nesh, pse di-

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 175.

2. Po aty, f. 172

het që pozitativ centriste nuk mund të durojnë për shumë kohë, sidomos kur zien lufta në mes marksistëve dhe revizionistëve. Kinezët kanë mbajtur qëndrime të mira.

E MARTË
24 MARS 1964

Prita shokë nga Venezuela. Njëri është anëtar i Komitetit Qendror. Na folën për punën e partisë së tyre, e cila ka suksese, por ka edhe vështirësi.

E MËRKURË

25 MARS 1964

Në mbledhjen e sotme të Byrosë Politike diskutuam për përgatitjen luftarako-politike të ushtrisë për vitin 1963¹, rreth orientimit të përgjithshëm për hartimin e projektplanit të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës popullore për pesëvjeçarin e katërt², si dhe rreth disa çështjeve të tjera.

Në ushtri krahas sukseseve, ka edhe dobësi. Sidoqoftë në përgjithësi ushtrinë e kemi në gatishmëri. Për përgatitjen ushtarake dhe për forcimin e ndërgjegjes së njerëzve rol vendimtar luan puna politike e Partisë. Kam përshtypjen sikur puna e Partisë në ushtri nuk ecën me atë vrull që ecën ana teknike. Por si puna e Partisë, ashtu edhe puna ushtarake janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën, ndikojnë njëra-tjetrën, prandaj të dyja këto drejtime duhet të jenë të harmonizuara. Veçse këtu rolin kryesor, vendimtar, e luan puna e Partisë. Organizata e Partisë në ushtri duhet të jetë

e gjallë, luftarake dhe t'u qëndrojë pranë njerëzve.

Na duhet të marrim masa për kualifikimin e kadrove të ushtrisë, për rishikimin e programeve të akademisë e të shkollave të tjera ushtarake.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 181.

2. Po aty, f. 185.

E SHTUNË
28 MARS 1964

U takova me një shok nga Kili. U njohëm me gjendjen në parti të tyre, në të cilën sundojnë revizionistët. Na tha se ka një grup të mirë jashtë partisë që punon aktivisht. Ne i folëm për eksperiencën tonë. Kërkoji që të dërgojnë në Shqipëri njerëz për të mësuar.

E HËNË
30 MARS 1964

Isha në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik. Shoku Gogo Nushi mbajti raportin për fushatën e zgjedhjeve për këshillat e gjykatat popullore dhe për detyrat që i dalin organizatës së frontit gjatë kësaj fushate.

Në këtë mbledhje u aprovua Thirrja e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik për fushatën e këtyre zgjedhjeve. Në mbyllje mora fjalën¹, ku theksova rëndësinë politike, organizative dhe ekonomike të fushatës së zgjedhjeve për këshillat dhe gjykatat popullore.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 196.

E MËRKURE
1 PRILL 1964

Prej disa ditësh vazhdon të bjerë shi jo i madh, por sidoqoftë i mjaftë për të penguar traktorët që të punojnë në fusha. Me punimet e tokave jemi shumë më përpara se vjet. Gruri deri tash është shumë i mirë.

Viti bujqësor nuk paraqitet keq. Edhe ullinjtë japin shpresa për një prodhim të mirë në sezonin e ardhshëm, sido që është shumë shpejt të flitet që tani.

E ENJTE
2 PRILL 1964

Siç njofton agjencia TANJUG, në Jugosllavi do të shkojë Spaku¹ i Partisë Socialdemokrate Belgjiane. Rreth qëllimit të udhëtimit të krerëve të socialdemokracisë evropiane në Beograd.

(Shënime)

— Po mbyllet cikli i bisedimeve dhe përgatitja e planeve djallëzore kundër komunizmit nga revizionistët modernë dhe krerët e socialdemokracisë evropiane.

— Qëllimet e vajtjes së Spakut në Beograd. Lidhur me vajtjen e Gi Molesë dhe udhëtimet e të dyve në Moskë dhe bisedimet Spak-Hrushov.

— Ç'ka menduar Spaku dhe partia e tij socialiste për Titon.

1. Pol Anri Spak, udhëheqës socialist belgjian. Në vitet 1957-1961 ka qenë sekretar i përgjithshëm i NATO-s. Shumë herë ministër i Punëve të Jashtme dhe kryeministër i Belgjikës.

Ç'ka menduar Spaku për Hrushovin dhe rekomandimet e tij për këtë njeri.

Historiku i Partisë Socialiste Belgjiane në shërbim të reaksionit belg, të kolonializmit belg dhe të kapitalizmit ndërkombëtar.

Si e ka luftuar Lenini vijën renegate të socialistëve belgë me në krye Vanderveldin.

— Partia Socialiste Belgjiane dhe udhëheqësi i saj Spak vazhdojnë rrugën e vjetër tradicionale të tradhtisë, në shërbim të borgjezisë belge dhe të imperializmit amerikan. Veçanërisht Spaku, shërbëtor i imperializmit amerikan.

— Grupi hrushovian i Brunelit, që hiqet sikur ka një parti komuniste, është bërë shërbëtor i Partisë Socialiste Belgjiane.

— Spaku, socialdemokrat, mesagjer i imperializmit amerikan, mik e bashkëpunëtor i Titos dhe shambellan¹ i amerikanëve për paraqitjen e Hrushovit në Shtëpinë e Bardhë.

— Titoja është diskredituar për punën e tij sabotuese në Afrikë, në Azi dhe në Amerikën Latine.

— Titizmi, pasi tërhoqi në orbitën e tij Hrushovin dhe lakenjtë që i venë pas, është caktuar nga imperializmi amerikan të lidhë fijet e këputura në mes socialdemokracisë dhe revizionistëve modernë.

— Që ta kryejë me sukses këtë punë, përveç qindra milionë dollarëve që i jep imperializmi amerikan klikës së Titos, është e qartë tash për të gjithë pse Hrushovi dhe gjithë klikat revizioniste po reklamojnë

¹ Nga frëngjishtja — fisnik i oborrit; i ngarkuar për t'i shërbyer sovranit.

me të madhe se gjoja në Jugosllavi po ndërtohet socializmi, se titistët kanë në deje gjak të «kulluar marksist-leninist». Të gjithë revizionistët modernë, që dikur të maskuar dhe të shtrënguar nga rrethanat e kritikuan këtë antimarksist, tash po i lëpijnë paturpësisht ato që kishin thënë. Revizionistët modernë, që pësojnë kudo disfata në teoritë e tyre të kalbura revizioniste, kërkojnë me çdo ekspedient¹, me çdo manovër, të bëjnë diçka për të mbajtur gjallë frymën e tyre dhe për të dhënë iluzionin e ndonjë suksezi.

— Të sjellim si shembull çështjen e marrjes së pushtetit me rrugë paqësore, me rrugë parlamentare. Këtë falsitet të madh hrushovianët dhe revizionistët francezë duan ta realizojnë nëpërmjet një aleance me krerët e socialdemokracisë, duke e ditur se është po kjo socialdemokraci, po këta njerëz që vazhdimisht e kanë tradhtuar kauzën e një bashkëpunimi me Partinë Komuniste Franceze, që kurdoherë kanë luajtur kartën e borgjezisë franceze e të reaksionit imperialist.

— Pikërisht, kur Partia Komuniste Franceze luftonte në rrugën e drejtë marksiste-leniniste dhe kishte numrin më të madh të deputetëve në parlament, pikërisht në ato kohë asnjëherë krerët e socialdemokracisë nuk dëgjuan të ndiqnin një rrugë lufte me Partinë Komuniste Franceze për probleme të caktuara, por përkundrazi ata u lidhën dhe më fort me partitë borgjeze. Vetëm në ato kohë, kur vija e Partisë Komuniste Franceze ishte e drejtë, prestigji i saj ishte i mirë në masat socialiste.

¹ Nga frëngjishtja — mjet të rastit (marifet).

— Tash revizionistët francezë mund të fitojnë vetëm atë që të bëhen një apendiks i partisë socialiste, një dele e tufës socialdemokrate, një armë «e maskuar» e borgjezisë reaksionare franceze dhe ndërkombëtare kundër socialistëve, komunistëve, klasës punëtore dhe popullit francez.

— Partia Komuniste Franceze përpara kongresit të saj të 17-të është më tepër se kurrë në rrugëkryq: a do të vazhdojë t'i bindet ajo verbërisht shkopit të dirigjentit dhe ta lërë veten që grupi revizionist në udhëheqje ta hedhë atë përfundimisht në rrugën e tradhtisë, apo do ta thyejë shkopin e dirigjentit, do të korrigjojë gabimet e saj dhe do të kthehet në rrugën heroike dhe revolucionare të marksizëm-leninizmit?

— Shumë udhëheqës të Partisë Komuniste Franceze e kanë sharë, e kanë sulmuar në mënyrë të turpshme Partinë e Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjen e saj. Këto ne nuk i harrojmë. Do të vijë koha, në mos sot nesër, dhe çdo gjë do të vihet në vendin e saj, në mënyrë marksiste-leniniste. Ne jemi të bindur se atyre që kanë vepruar kështu, nesër do t'u skuqet fytyra nga turpi... Ne s'i kemi ndonjë borxh Partisë Komuniste Franceze, udhëheqësit e saj i kanë borxh Partisë së Punës të Shqipërisë. Por megjithatë ne i bëjmë sinqerisht thirrje Partisë Komuniste Franceze të kthehet, sa s'është vonë, në rrugën e revolucionit, në rrugën e vërtetë marksiste-leniniste, në interes të popullit francez, të proletariatit francez dhe të proletariatit ndërkombëtar. Në këtë rrugë e ka vendin ajo. Ata që ndreqin

gabimet, ngjallin respekt te të tjerët dhe kanë përkrashjen e komunistëve dhe të të gjitha masave përparimtare të botës, kurse tradhtarët s'i do njeri, ata i përbuzin dhe i luftojnë pa mëshirë, siç po bëjnë kundër klikës së Hrushovit, Titos, Toliatit dhe shokëve të tyre besnikë — gjithë revizionistëve modernë.

E PREMTE
3 PRILL 1964

Revizionistët sovjetikë shpërthyen sulmin e tyre të ndyrë kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Ata filluan sot të botojnë raportin e Suslovit, mbajtur në plenumin e fundit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Përmbledhja e raportit që dha agjencia TASS është plot shpifje, trillime, gënjeshtra, demagogji, kërcënime dhe shantazhe nga më të ndyrat.

Në këtë përmbledhje ata na cilësojnë ne një klikë që i bindet kinezëve, që merr udhëzime prej tyre e që është në aleancë me ta që nga Kongresi i 20-të i revizionistëve sovjetikë. Në fund revizionistët sovjetikë thonë se duan mbledhje të partive dhe se mund ta bëjnë atë edhe pa ne. Kjo do të jetë shumë mirë. Siç duket dhe siç e shprehin, mbledhjen renegatët e konsiderojnë si një gjyq, për të na gjykuar dhe, natyrisht, për të na dënuar ne. Por kjo manovër nuk do t'u ecë dhe ata do të shkojnë më tej, se nuk kanë ç'të bëjnë, mirëpo pas kësaj do të demaskohen, natyrisht, më shumë. Studimi i plotë i raportit do të na sqarojë më mirë për manovrat e revizionistëve modernë.

E SHTUNE
4 PRILL 1964

Ramë dakord me Ramizin për përgatitjen e një artikulli të ri teorik: «Për çfarë mbledhje të partive komuniste e punëtore të botës po bëhet fjalë». Ky artikull, që duhet të botohet në rast se do të mbahet mbledhja¹, duhet të shërbejë për të demaskuar orvatjet e revizionistëve modernë për thirrjen në mbledhje të klivake revizioniste të partive komuniste dhe punëtore në krizë.

1. Mbledhja nuk u bë, u shty dy herë për shkak të kontradiktave në gjirin e partive revizioniste.

E DIEL
5 PRILL 1964

Revizionistët modernë, me hrushovianët në krye, dëshirojnë të thërresin një mbledhje të partive komuniste e punëtore të botës. Më të zjarrtët për këtë problem paraqiten, sipas të dhënave, francezët dhe hrushovianët, i ndjekin edhe bullgarët, gjermanët dhe çekët. Por, siç duket, italianët vazhdojnë të ngulin këmbë në mendimin e tyre se një mbledhje e tillë aktualisht nuk është oportune. Këtë qëndrim mbajnë edhe polakët e norvegjezët. Duhet të ketë patjetër edhe parti të tjera të grupit hrushovian që i tremben një mbledhjeje të tillë.

S'ka dyshim se kjo i ka vënë në pozita të vështira sovjetikët dhe lë të duket çarje në mes tyre. Kjo i tmerron, pse nuk mjafton çështja rumune, që i ka sëkëlldisur mjaft, por ka rrezik që të manifestohen edhe divergjenca të tjera. Italianët dhe polakët kundërshtojnë nga pozitat e «pavarësisë» së tyre, ata duan të përfitojnë nga dobësimi i pozitave të hrushovianëve në lëvizjen komuniste për të krijuar dhe për të thelluar anarkinë e policentrizmin, dhe këndeje e nga këto pozita të minojnë marksizëm-leninizimin.

Nga natyra e tyre revizionistët nuk mund të veprojnë të orkestruar, siç do Hrushovi. Ata janë dakord që të sulmohemi ne, kinezët e të tjerë, janë dakord të zbatojnë vijën e tyre kapitulluese ndaj imperializmit, por jo nën drejtimin e Moskës. Ata duan të udhëheqin aleanca nacionale me borgjezinë e vendeve të tyre, të zbatojnë forma bashkëpunimi që u pëlqejnë, dhe jo t'ua imponojë këto Hrushovi. Me këto qëndrime ata duan njëkohësisht të gënjejnë partitë e tyre, duke u përpjekur të lënë përshtypjen se gjoja janë të pavarur, dhe, në mos më shumë se Hrushovi, janë shumë të pjekur për të gjykuar se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë vendimesh të marrin. Hrushovi do të tërhiqet hëpërhë nga një mbledhje e shpejtuar, pse një mbledhje e tillë pa ne, do t'i demaskojë më tej, do t'i detyrojë ata të marrin vendim kundër nesh unanimisht ose edhe të përçahen zyrtarisht në mes tyre, gjë që s'u leverdis, se jo vetëm që marrin përsipër përçarjen me ne, por, sigurisht, do të jenë në dizakord edhe në mes tyre, pse do të ketë nga ata, që, nga pozitat revizioniste, do të hedhin disa vicka, qofshin këto edhe të vogla.

E gjithë kjo e ashtuquajtur fushatë dërrmuese kundër nesh dhe këto propozime, që «i merr era», i demaskojnë ata ca më shumë dhe tregojnë kalbëzimin revizionist, degjenerimin dhe thellimin e tij të mëtejshëm në rrethin e tyre.

E HËNË
6 PRILL 1964

Vajta në mbledhjen e organizuar në universitet, ku u dorëzova taserat e reja të Partisë disa komunistëve nga organizatat e Partisë të kryeqytetit. Mbledhja ishte emocionuese, revolucionare, e zjarrtë. Shokët që morën taserat shprehën ndjenjat më të pastra e më të zjarrta të besnikërisë ndaj Partisë, vendosmërinë e tyre për mbrojtjen e fitoreve të marksizëm-leninizmit dhe të atdheut.

Në mbledhje merrnin pjesë komunistë nga gjithë sektorët, punëtorë, mjeshtër, inxhinierë, kuadro partie dhe pushteti, pedagogë, mësues, artistë, shkrimtarë të rinj dhe nga të gardës së vjetër (anëtarë partie të vitit 1941).

Mora fjalën¹ dhe fola për rëndësinë dhe përmbajtjen e madhe të taserës, për rrugën e lavdishme që ajo simbolizon, duke e lidhur me luftën e Partisë në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen. Mbledhjen e mbyllëm duke kënduar Internacionalen.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 204.

Presidiumi i Kuvendit Popullor në mbledhjen e tij të sotme mori në shqyrtim një numër projektdekretesh si atë mbi vetëtatimin e popullsisë fshatare, mbi disa ndryshime në ndarjen administrative tokësore, mbi aprovimin e modelit të urdhrimit dhe të medaljes «Për veprimtari patriotike» si dhe disa propozime për dekorime, një projektvendim mbi motivacionet e patriotëve para dhe pas Çlirimit e të tjera.

Lidhur me propozimet për dekorime diskutova¹ dhe vura në dukje rëndësinë e madhe që kanë ato. Në dhënien dhe në motivimin e dekorimit duhet bërë kujdes. Këtu kemi të bëjmë me një çështje delikate. Për secilin rast duhen parë mirë rrethanat dhe kushtet konkrete. Nuk duhet të nisemi nga fakti që kjo brigadë apo ky repart të dekorohet me iks urdhër ashtu si brigada apo reparti tjetër. Po të veprohet në këtë mënyrë, mund edhe të gabohet.

Dhashë mendimin që për këtë punë të krijohet një komision.

1. Shënimet e mbajtura nga ky diskutim gjenden në AQP.

**Ë MARTË
7 PRILL 1964**

Sot në gazetën «Zëri i popullit» u botua artikulli «Revizionistët modernë në rrugën e degjenerimit socialdemokrat e të shkrirjes me socialdemokracinë»¹.

Sot prita delegacionin e Bashkimeve Profesionale të RD të Vietnamit që po viziton vendin tonë. Shokët vietnamezë duken njerëz të mirë, por të heshtur; nuk shprehen për problemet ideologjike që preokupojnë komunizmin ndërkombëtar. Unë u fola haptas².

1. Shih në këtë vëllim, f. 73.

2. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 227.

**Ë MËRKURË
8 PRILL 1964**

Ra shi i mirë në mbrëmje, kurse natën pati furtunë.

E ENJTE
9 PRILL 1964

Mbrëmë natën paskësh rënë ca borë në majë të Dajtit. Koha sot është e hapët dhe e freskët.

E PREMTE
10 PRILL 1964

Bëmë mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë. Çështjet që kishim në rendin e ditës u trajtuan drejt.

E DIEL
12 PRILL 1964

Sekretari i parë i KQ të Partisë së Punonjësve të Vietnamit, Le Zuan, në raportin që mbajti në plenumin e fundit të KQ përpiqet të bëjë një analizë revolucionare të gjendjes, por nuk demaskon antileninistët dhe kundërrevolucionarët hrushovianë.

E MARTË
14 PRILL 1964

Bisedova me Ramizin për dy artikuj. Në njërin të demaskojmë qëllimet e vajtjes së udhëheqësit të Partisë Socialiste Franceze, Gi Molesë, në Beograd¹, në tjetrin të shkruajmë kundër raportit të Suslovit mbajtur në plenumin e KQ të PK të BS². Për të dy këta artikuj kam shkruar një numër tezash, të cilat ia dhashë Ramizit.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 322.

2. «Veprimtaria përçarëse e revizionistëve hrushovianë në dritën e raportit të M. Suslovit», botuar në gazetën «Zëri i popullit», më 17 maj 1964.

Një ndër çështjet që diskutuam sot në mbledhjen e Byrosë Politike ishte ajo për zhvillimin e industrisë elektrike gjatë pesëvjeçarit të katërt dhe në perspektivë.

Studimi që na paraqitën specialistët, të kryesuar në këtë punë nga inxhinieri me talent Petrit Radovicka, ishte i mirë, i vlefshëm, me propozime interesante e të mundshme për t'u realizuar. Tani shtrohet çështja e hartimit të një plani perspektiv 15-20-vjeçar për elektrifikimin e vendit dhe ky studim është një mbështetje e mirë për hartimin e këtij plani.

Dhashë mendime¹ për këtë problem kyç për ndërtimin e socializmit e të komunizmit në vendin tonë.

Në diskutimin¹ që bëra sot në mbledhjen e Sekretariatit bëra vërejtje për raportin e paraqitur: «Mbi zhvillimin e zgjedhjeve në Parti», i cili në vend që të pasqyronte eksperiencën e punës së Partisë për këtë problem ishte mbushur me konstatime.

Mendoj se në përgatitjen e raporteve që i jepen udhëheqjes duhet të marrin pjesë edhe instruktorët e Komitetit Qendror sepse ata njohin edhe udhëzimet e Sekretariatit por edhe problemet që ka baza.

I rëndësishëm është, gjithashtu, aktivizimi i anëtarëve të plenumit të komiteteve të Partisë në rrethe.

Fola² gjithashtu edhe për gjendjen dhe masat që duhen marrë për përmirësimin dhe forcimin e punës ideoartistike në estradat profesioniste.

Me gjithë përparimet që ka bërë teatri i estradës prapë nuk është në nivelin e duhur. Ka shfaqje të nënvlerësimit të estradës, gjë që e tregon edhe fakti që shkrimtarët tanë nuk shkruajnë pjesë me humor për estradat, përmbajtjes dhe ngritjes së nivelit artistik të të cilave duhet t'u kushtohet rëndësi.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 290.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 298.

2. Po aty, f. 305.

E PREMTE
17 PRILL 1964

*Në Moskë dje dhe sot lakenjtë e Hrushovit, me rastin e ditëlindjes, i çuan këtij dekorata, që nga «Ylli i Artë» e deri tek «Urdhri i Luanit». Kjo i përngjet historisë së Biblës, ku tregohet se si mbretërit magë i çuan dhurata Krishtit. Lakenjtë përpiqen t'i mbajnë ngritur prestigjin të falimentuarit.

Telegrame hosana i venë Hrushovit nga të katër anët, por nga më të papëlqyerit dhe krejtësisht të gabuarit është ai i shokëve kinezë. Telegrami i urimit i kinezëve është telegram i shkruar me këmbë dhe jo me kokë. Çfarëdo arsytimi që do të përpiqen të japin shokët kinezë, asnjë nuk qëndron në këmbë. Telegrami i tyre është një gabim klasor, politik dhe ideologjik. Ne s'jemi kurrsesi dakord me këtë akt të tyre dhe do të gjejmë rastin patjetër t'ua themi, në mos drejtpërdrejt, tërthorazi medoemos. Ne sot do t'ia heqim Hrushovit titullin e «Qytetarit të nderit» të qytetit të Tiranës me motivacionin që meriton një tradhtar si ai. Kështu që ky akt i rëndësishëm politik do të jetë «dekorata» jonë për revizionistin, njëkohësisht një përgjigje tele-

grameve që i dërguan kinezët, koreanët, vietnamezët e të tjerë.

Tradhtarit Hrushov i hoqëm sot titullin «Qytetar nderi» i qytetit të Tiranës. Vendimi u mor nga këshilli popullor i qytetit.

... 1964 ...

**E SHTUNE
18 PRILL 1964**

Sot u hap Konferenca e 4-t e Bashkimit të Gazetarëve të Shqipërisë. Me një letër përshëndetjeje¹ u urova gazetarëve suksese në punimet e konferencës dhe në punën e tyre të vështirë por edhe fisnike.

... 1964 ...

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 313, gjyko tele-

... 1964 ...

**E MARTE
21 PRILL 1964**

Hrushovi, në marrëveshje me Xhonsonin, president i SHBA-së, bënë sot një bluf të ri, gjoja për mbrojtjen e paqes. Ata njoftuan se pas bisedimesh sekrete, së bashku me Britaninë e Madhe, kishin arritur në marrëveshje për pakësimin, nga të tri fuqitë, të prodhimit të lëndëve fisile për armët bërthamore (të uraniumit e të plutoniumit). Por këtë ata e bënë pasi i kanë mbushur depot e tyre plot me lëndë të tilla.

... 1964 ...

... 1964 ...

Ë MËRKURË
22 PRILL 1964

Rumunët shpallën se do t'i botojnë vendimet e plenumit të KQ të partisë së tyre, i cili mbaroi sot. Ai kishte të bënte me divergjencat në lëvizjen komuniste. T'i shohim këto vendime dhe pastaj do të gjykojmë.

E ENJTE
23 PRILL 1964

Lexova një informacion mbi punën për zbatimin e vendimit të Byrosë Politike, për çështjet e sigurimit, të sistemimit dhe të përdorimit të fuqisë punëtore, ku flitet për shkurtime që duhet të bëhen në aparatet dhe dikasteret në qendër e në rrethe dhe lashë shënimin se nuk duhet të kënaqemi vetëm me leksionet dhe me «shtruarjen» e problemit, me «konferenca» dhe me: «Jemi dakord, është vendim i drejtë» sepse këto mund të mbeten zjarr kashte.

Largojnë 100 veta dhe kujtojnë se e «zbatuan vendimin», kurse nga penxherja hyjnë 500 veta të tjerë.

Revizionistët dhe imperialistët po bëjnë zhurmë të madhe propagandistike rreth traktatit sovjeto-amerikano-anglez për ndalimin e provave të armëve bërthamore¹. Ky është një bluf i tyre i ri.

— Ndërsa imperializmi amerikan vazhdon luftën e

1. Traktati u ratifikua në Moskë më 5 gusht 1963.

tij grabitqare dhe shtypëse, grupi tradhtar i Nikita Hrushovit vazhdon ta zbukurojë atë.

— Revizionistët vazhdojnë të thonë se imperialistët amerikanë janë paqësorë.

— Vazhdojnë kapitullimet e Nikita Hrushovit përpara amerikanëve.

— Tërheqja nga Kuba.

— Traktati famëkeq i Moskës (traktati mbi ndalimin e provave të armëve bërthamore) u diktua nga amerikanët dhe u pranua nga hrushovianët. Propagandimi i këtij traktati u shërben amerikanëve për t'u paqatur si paqësorë.

— Marrëveshja për kufizimin e prodhimit të lëndëve fisile u diktua nga Xhonsoni, u pranua nga Hrushovi. Ajo nuk përfaqëson asgjë, por propagandohet në favor të amerikanëve.

— Priten blofe në seri, për shembull, heqja nga shërbimi i avionëve të vjetër ushtarakë. Edhe për këtë me siguri do të bëhet shumë propagandë.

— Problemi gjerman ka rënë në gjumë, ose më mirë të thuhet diplomacia sekrete po punon të përgatitë kapitullimin hrushovian.

— Çarmatimi i përgjithshëm ka mbetur në vend numëro. Po mbahen fjalime, po merren poza, shpesh pushime të gjata, herë pas here rrëzohet nga një avion dhe lirohen e shkëmbehen spiunët e burgosur etj.

— Gjatë gjithë kësaj kohe, kur kori i bashkuar imperialisto-revizionist po trumbeton me të madhe diskut demagogjik për paqen, kur revizionizmi modern me Hrushovin në krye po sulmon me të gjitha forcat kampin e socializmit, marksizëm-leninizmin, partitë që

qëndrojnë në pozita të shëndosha etj., imperialistët amerikanë vazhdojnë të armatosen, të grumbullojnë stoqe armësh, t'u shpërndajnë armë aleatëve, t'i perfeksionojnë këto për luftën e ardhshme. Vazhdojnë përgatitjet e tyre për luftëra grabitqare imperialiste. Shembuj:

— Vietnami

— Laosi (grushti i shtetit)

— Tajvani (pushtim)

— Brazili (grushti i shtetit)

— Kuba.

E SHTUNE

25 PRILL 1964

Skemë e shënime për artikull¹

*Po bëhet nevojë urgjente demaskimi i veprimtarisë revizioniste në Evropë.

— Traditat revolucionare në Evropë: kundër kapitalit monopolist, kundër imperializmit, kundër fashizmit italo-gjerman, kundër tradhtarëve oportunistë, socialshovinistëve dhe rrymave të tjera antimarksiste — trockistëve, menshevikëve, buharinistëve e të tjerë shërbëtorë të borgjezisë.

- a) lufta ideologjike;
- b) lufta politike;
- c) lufta ekonomike;
- d) lufta e armatosur.

(Që nga periudha e Marksit deri te shembja e nazifashizmit dhe forcimi i demokracisë popullore në vendet e Evropës.)

1. Këto shënime janë përdorur në artikullin me titull «Marksizëm-leninizmi revolucionar do të triumfojë në Evropën e mbarë me revizionizëm», botuar në gazetën «Zëri i popullit» më 6 janar 1965. Shik: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 353.

Pas Luftës së Dytë Botërore.

Pozitat ekonomike, politike dhe ushtarake të borgjezisë kapitaliste në Evropë. Aleanca me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndihma amerikane, qëllimet e saj. Synimet e planeve të ndryshme të kësaj borgjezie imperialiste në Evropë për riafirmimin e forcimit të pushtetit të kapitalit monopolist e të pozitave të tij politike, për përgatitjet ushtarake, për luftën kundër komunizmit, kundër partive komuniste e punëtorë, kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore.

Lufta e socialdemokracisë si shërbëtorë e imperializmit.

— Pozitat e forcave revolucionare në Evropën e pasluftës së Dytë Botërore.

- pozitat politiko-ideologjike;
- pozitat luftarake;
- pozitat e partive komuniste e punëtorë në vendet kapitaliste të Evropës ndaj lëvizjes revolucionare në këto vende. Koherenca e vijës së tyre revolucionare, kompaktësia e revolucionit e çimentuar nga teoria revolucionare, marksizëm-leninizmi.

Forca e Bashkimit Sovjetik në kohën e Lenin-Stalinit.

- Epiqendra e revolucionit.
- Vendi ku triumfoi revolucioni.
- Atdheu i proletariatit botëror.
- Ndërtimi me sukses i socializmit.
- Ideologjia marksiste-leniniste në veprim e në rrugë të drejtë.

- Politika e jashtme e drejtë, parimore.
- Bashkimi Sovjetik, ndihmës i fuqishëm i luftërave revolucionare të popujve.

- Pas fitores mbi fashizmin u krijuan vendet e tjera socialiste të Evropës dhe të Azisë, nën udhëheqjen e partive komuniste e punëtore.

— Sukseset e kampit socialist pas luftës deri në vdekjen e Stalinit.

— Pas vdekjes së Stalinit Evropa filloi të mbarset me revizionizëm.

— Imperializmi botëror, me atë amerikan në krye, vazhdon të armatohet me shpejtësi, të konsolidojë forcat e veta nëpërmjet skllavërimit financiar, nëpërmjet aleancave ushtarake, nëpërmjet zaptimit të tregjeve koloniale, nëpërmjet luftërave grabitqare, agresioneve të ndryshme, nëpërmjet shantazheve e mbi të gjitha atij atomik.

Propaganda antikomuniste rritet në kulm, masa rrezikshme kundër komunistëve dhe partive komuniste e punëtore në vendet kapitaliste etj.

Revizionizmi titist.

Ç'përfaqëson ai. Sinjali i parë i rrezikut revizionist. Lufta për demaskimin e tij. Unanimiteti i partive komuniste e punëtore në luftimin e tij.

Pas vdekjes së Stalinit: revizionizmi hrushovian.

Ç'përfaqëson ai, qëllimet e tij, taktikat që ai përdori për të marrë fuqinë në Bashkimin Sovjetik dhe për të përgatitur komplete revizioniste në partitë komuniste e punëtore në Evropë.

Aleanca e revizionistëve hrushovianë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe demaskimi i tyre në botë nga ne, marksistë-leninistët.

- Kapitullim në të gjitha problemet politiko-ushtarake.

- Kërkesa, ndihma në kredi dhe në eksperiencë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

- Organizimi i luftës kundër marksizëm-leninizmit në shkallë botërore, në aleancë me kapitalizmin botëror dhe socialdemokracinë.

- Qëllimet e tyre: Marrja e pushtetit nga revizionistët modernë; degjenerimi i marksizëm-leninizmit dhe i partive marksiste-leniniste; degjenerimi i socializmit në pushtet borgjez (degjenerimi moralo-politik, degjenerimi i aparatit shtetëror dhe atij ekonomik, dështime në industri, bujqësi etj.); vënia nën thundër, nga grupi i Hrushovit, i vendeve të ish-demokracisë popullore në Evropë në të gjitha drejtimet: politike, ekonomike, ushtarake (KNER-i, Traktati i Varshavës).

Plani imperialisto-revizionist botëror.

- Sundimi i botës nga imperializmi amerikan, me violinë të parë Bashkimin Sovjetik (të transformuar gradualisht nga grupi i Hrushovit në shtet të një tipi të veçantë borgjez kapitalist).

- Luftë të ftohtë dhe të nxehtë kundër komunizmit, kundër ndërtimit të socializmit, kundër lirisë së popujve, kundër luftërave revolucionare, nacionalçlirimtare. Dy armë kryesore, nga njëra anë, demagogjia e gënjeshtra dhe, nga ana tjetër, atomi.

- Të dyja këto armë janë në duar të amerikano-hrushovianëve.

- Arma tjetër, forca ekonomike e këtyre dy partnerëve, mjet për skllavërimin e popujve, për rehabilitimin dhe për zgjatjen e jetës së kapitalizmit, për degjenerimin e njerëzve.

Fushat e betejës.

- Atje ku hallkat e zinxhirit kapitalist janë më të dobëta, atje zhvillohen dhe do të zhvillohen luftërat e nxehta — Azi, Afrikë, Amerikë Latine.

- Bashkërisht me amerikanët N. Hrushovi punon në Azi dhe në Afrikë kundër komunizmit, komploton kundër popujve, kontribuon me anë të OKB-së (Kongo) për të shtypur revolucionin, jep kredi për forcimin e klikave reaksionare etj. Në Amerikën Latine N. Hrushovi s'fut dot hundët, SHBA e mbajnë jashtë; sot për sot ato mendojnë se janë në gjendje vetë të shtypin revolucionin e luftën nacionalçlirimtare në çdo vend të këtij kontinenti. Revizionistëve modernë, veçanërisht, u është ngarkuar detyra të mbarsin Evropën me revizionizëm.

Qëllimi.

- Të shuajnë në Evropë çdo tentativë revolucionari, të degjenerojnë marksizëm-leninizmin në revizionizëm, partitë komuniste e punëtore të Evropës në parti borgjeze, socialdemokrate, vendet socialiste në vende kapitaliste, borgjezo-revizioniste dhe ta bëjnë Evropën platformë të sigurt të reaksionit për të sulmuar kudo në botë socializmin dhe komunizmin.

- Pra kapitalizmi botëror dhe shërbëtorët e tij përpiqen që para përgatitjes së një lufte bërthamore, Evropën ta kenë mënjanuar nga revolucionin, pra të ke-

në vendosur kudo në Evropë diktaturën e kapitalit.

- Këtë plan po e vënë në zbatim dhe revizionistët hrushovianë dhe, bashkë me ata që i pasojnë, përdorin demagogjinë duke thënë:

Marksizmi i vërtetë, sipas Leninit dhe Marksit, lulëzon vetëm në Evropë dhe qendra, feneri ndriçues është grupi i Hrushovit.

Kudo gjetkë, marksizëm-leninizmi, sipas revizionistëve, ka degjeneruar, ka rënë në dogmatizëm, në nacionalizëm borgjez, neotrockizëm etj.

Prandaj, sipas tyre, duhet të çohet kudo drita hrushoviane.

Detyra e madhe e shenjtë, urgjente e të gjithë komunistëve të Evropës dhe të botës është: të ngrihen dhe të luftojnë me heroizëm kundër kësaj tradhtie të madhe.

— Të luftohet brenda dhe jashtë partive komuniste e punëtore në të gjithë botën, dhe veçanërisht në Evropë, kundër këtij plani djallëzor të Nikita Hrushovit dhe bandës së tij, t'u hiqet atyre fuqia nga duart, të demaskohen, të shpëtohen partitë nga kjo sëmundje e rëndë. Të krijohet uniteti i komunistëve në botë, e veçanërisht në Evropë, dhe në çdo parti, në luftë për pastërtinë e marksizëm-leninizmit, në luftë kundër klikave revizioniste, në luftë kundër bandës revizioniste hrushoviane.

— Këtë e lyp e sotmja dhe e ardhmja e socializmit dhe e komunizmit, këtë e lyp klasa punëtore e të gjithë botës, ajo klasë heroike punëtore, të cilën grupi

i Hrushovit përpiqet ta përçajë, ta ndajë në kontinente, duke shpifur paturpësisht sikur ata që Hrushovi i quan dogmatikë s'kanë besim në hovin revolucionar të klasës punëtore të vendeve kapitaliste të Evropës, ose të vendeve socialiste të Evropës. Komunistët kudo në Evropë, brenda partive komuniste e punëtore dhe jashtë tyre kur përjashtohen nga revizionistët, duhet të organizohen, për të demaskuar tezat tradhtarë të bashkekzistencës paqësore hrushoviane, që s'kanë asgjë të përbashkët me tezat e bashkekzistencës leniniste, për të demaskuar luftën për paqe hrushoviane, që s'ka të bëjë fare me luftën për paqe në rrugën leniniste, për të demaskuar demagogjinë hrushoviane të çarmatimit, që s'është veçse një perde tymi e kapitullim përpara imperializmit amerikan të armatosur për luftë, që s'është veçse një veprim për shuarjen dhe për shpartallimin e revolucioneve dhe të luftërave nacionalçlirimtare. Të bashkohen, për të demaskuar përçarësit e vërtetë të komunizmit, që maskohen me parulla demagogjike të «unitetit», për të demaskuar gjithçka që është hrushoviane në ndihmë të imperializmit, përçarjen që ky reneгат provokoi në kampin e në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Forcat revolucionare në Evropë nuk janë shuar, ato janë të gjalla dhe luftojnë dhe lufta po ngjitet, ajo do të bëhet e tmerrshme për revizionistët. Lufta e revolucionarëve dhe e komunistëve militantë të Evropës është e lidhur me luftën e gjithë komunistëve të botës. Komunistët në Evropë kanë një përgjegjësi të madhe botërore, ata janë brenda në kështjellën e revizionizmit dhe kjo kështjellë duhet hedhur në erë, duhet bërë pluhur e hi.

Komunistët evropianë duhet të ngrenë lart flamurin e revolucionit, të përqafojnë traditat më të mira të revolucionarëve, të ngrenë lart dhe të ruajnë pastërtinë e marksizëm-leninizmit dhe kjo bëhet në luftë kundër kapitalit dhe shërbëtorëve të tij, revizionistëve modernë.

— Lufta lyp përppjekje, sakrifica. A i kanë kursyer ndonjëherë komunistët këto, për çështjen e madhe? Jo. A kanë pasur frikë ndonjëherë komunistët në luftë me reaksionin më të zi, me fashistët, me Gestapon? Jo. Atëherë ka ardhur koha që komunistët të ngrenë krye kundër tradhtisë, të mposhtin revizionistët modernë, të krijojnë unitetin e mëparshëm marksist-leninist-stalinian të komunistëve të botës, që i solli kaq fitore proletariatit, që forcoi pozitat e socializmit dhe të komunizmit në botë, që i dha grushte të njëpasnjëshme reaksionit, kapitalit, imperializmit në të gjithë botën.

— Uniteti i çeliktë marksist-leninist në luftë kundër revizionizmit modern, në luftë kundër imperializmit përbën forcën tonë, sigurinë në fitoren e pashmangshme të socializmit e të komunizmit.

E DIEI

26 PRILL 1964

Dje mbrëma ra përsëri pak borë në majën e Dajtit. Në Tiranë bie shi. Kjo i bën mirë bujqësisë, por në qoftë se nuk do të vazhdojë gjatë. Sidoqoftë, gruri është i mbarë.

E HËNË
27 PRILL 1964

Kinezët botuan raportin e Suslovit, mbajtur në plenumin e Komitetit Qendror të PK të BS, me një hyrje të rreptë të tyre.

2000 3
1964 J. 1127 75

E MARTË
28 PRILL 1964

Bëmë mbledhjen e Byrosë Politike, në të cilën diskutova¹ për probleme të pagës mesatare dhe të zbatimit të disiplinës në punë, për punën që duhet të bëjnë organizatat-bazë të Partisë, për edukimin e punëtorëve në këtë drejtim dhe për realizimin e normave.

U diskutua, gjithashtu, për punën e komiteteve të Partisë të Tepelenës, të Përmetit, të Beratit dhe të Pogradecit.

1. Shënimet e mbajtura nga ky diskutim gjenden në AQP.

2000 3
1964 J. 1127 75

E MËRKURË
29 PRILL 1964

Gazetat sovjetike kanë filluar një fushatë të dendur antikineze, sulmojnë me fyerje të rënda Maon dhe udhëheqësit e tjerë kinezë. Godasin të gjitha aspektet e jetës në Kinë. Normat e PKK i quajnë diktatoriale, kapitalisto-mikroborgjeze e trockiste.

E PREMTE

1 MAJ 1964

Manifestimi popullor i 1 Majit ishte i shkëlqyer dhe i organizuar më mirë se çdo herë tjetër. Populli ishte shumë entuziast, i gëzuar, i qeshur, optimist, i veshur shumë mirë. Dashuria e tij për Partinë që në kulm. Kjo është një garanci e madhe për ecjen përpara.

Miqtë që asistonin në tribunë, ishin shumë të kënaqur dhe të entuziazmuar; kurse diplomatët e shteteve që mbajnë qëndrim armiqësor ndaj nesh, përkundrazi, ishin të vrenjtur dhe të trishtuar.

Edhe koha na buzëqeshi.

E DIEL

3 MAJ 1964

I nisa një letër¹ profesorit të shkencave matematike Kristaq Fundos në përgjigje të letrës së ngrohtë që më dërgoi dhe të veprës së tij të çmuar «Studimi i evolutive dhe i evolventeve të kurbave të hapësirës».

E përgëzova për punën e pasionuar që bën në shkencën e bukur por të vështirë të matematikës dhe kontributin e tij në edukimin shkencor të brezit të ri.

Takim me shokun belg Masoz², me shokët anglezë Mak Kreri e Artur Meixher³, me shokët japonezë Akiko Nose e Shigeaki Hirata⁴, që kanë ardhur në vendin tonë me rastin e festës së 1 Majit.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 348.

2. Moris Masoz, në atë kohë anëtar i byrosë politike të KQ të PK të Belgjikës.

3. Në atë kohë sekretarë të komitetit të luftës kundër revizionizmit dhe për unitetin komunist me qendër respektivisht në Londër dhe në Mançester. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 336.

4. Akiko Nose, në atë kohë korrespondente e organit të PK të Japonisë, «Akahata», Shigeaki Hirata, docent i universitetit «Hosei» të Tokios.

1964 LAJMI

E MARTË
5 MAJ 1964

U takova me ambasadorin e Vietnamit në Bashkimin Sovjetik, i akredituar edhe në vendin tonë, i cili transferohet.

E ENJTE
7 MAJ 1964

Takim me delegacionin e Federatës së Bashkimeve Profesionale të RDP të Koresë¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 354.

Kinezët iu përgjigjën mirë letrës së marsit të sovjetikëve¹.

1. Është fjala për letrën e KQ të PK të BS të 7 marsit 1964, në të cilën revizionistët sovjetikë gjoja shprehin gatishmërinë e tyre për «zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ekzistuese», «ndalimin e polemikës» dhe «forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste e punëtoresh ndërkombëtare».

Vizitova Fabrikën e Tullave në Vorë. U takova dhe bisedova me punëtorët.

Takim me miq francezë¹.

Dje kinezët botuan një sërë letrash që i kanë dërguar KQ të PK të BS në përgjigje të letrave të tij. Demaskim i mirë².

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 360.

2. Është fjala për një numër letrash të dërguara në datat 20, 27 dhe 29 shkurt të vitit 1964. Botimi i tyre publik u vendos të bëhej për të hedhur poshtë akuzat e bëra nga KQ i PK të BS se KQ i PK të Kinës ka shtrembëruar përmbajtjen e korrespondencës së zhvilluar midis dy komiteteve qendrore.

E HËNË
11 MAJ 1964

U takova me një shok të Partisë Komuniste të Cejlonit¹.

1. Hasen Muhiden në atë kohë kryeredaktor i së përjavshmes «Uorker», organ i KQ të PK të Cejlonit. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 371.

E MARTE
12 MAJ 1964

U takova me delegacionin e Bashkimeve Profesionale dhe me atë të Ministrisë së Komunikacioneve të RP të Kinës¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 389.

1964.05.13

E MËRKURE
13 MAJ 1964

Bisedë me shokët Hysni dhe Ramiz për përmirësimin e metodës së punës.

E SHTUNË
16 MAJ 1964*

Hrushovi, gjatë vizitës së tij në Egjipt, po lidhet haptazi me antikomunistë të tërbuar arabë, si Arefi i Irakut¹ me shokë, me të cilët u takua gjatë një shëtitjeje me anije në Detin e Kuq.

1. Koloneli Aref, president i Republikës së Irakut deri në vitin 1966.

Në mbledhjen e Sekretariatit të KQ shqyrtuam punën e komiteteve të Partisë të rretheve Dibër e Tropojë dhe të organizatave-bazë të kooperativave të konsumit për zbatimin e detyrave për fshatin.

Dibra dhe Tropoja janë kryesisht rrethe bujqësore, prandaj theksova në diskutimin tim¹ që problemet e fshatit të zënë një vend të rëndësishëm në punën e Partisë dhe të pushtetit në këto rrethe. Krahas punës politike, ideologjike që bën Partia për zbatimin e direktivave të KQ të Partisë dhe të Qeverisë, organet shtetërore nga ana e tyre duhet të marrin masat e nevojshme. Kujdesi për grumbullimin e prodhimeve në fshat, edhe për një organizim më të mirë të furnizimit të dyqaneve të fshatit me artikuj të ndryshëm, sidomos me materiale ndërtimi, të jetë në qendër të vëmendjes.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 398.

Në mbledhjen e Byrosë Politike shoku Haki Toska i ngriti shumë drejt problemet e naftës. Në diskutimin tim¹ theksova se aftësitë e specialistëve të naftës sot, duke pasur parasysh eksperiencën e grumbulluar, duhet të përqendrohen në studime, në konkluzione për të zbuluar vendburimet e naftës. Për naftën duhet të mendojmë jo vetëm për pesëvjeçarin e ardhshëm, por për perspektivën.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 413.

QYTETI STALIN, E PREMTE

22 MAJ 1964

Jemi të gëzuar që do të shkojmë në festën e 20-vjetorit të Kongresit të Përmetit. U nisëm me Nexhmijen për në Qytetin Stalin, ku do të pushojmë sonte dhe nesër në mëngjes do të nisemi për në Përmet. Në Qytetin Stalin erdhën edhe shokët e tjerë. Koha ishte e mirë, shpresojmë se do të na mbajë për festë.

Ditën e kaluam bukur, se edhe Qyteti Stalin është i bukur, plot gjelbërim dhe lule. Nga tarracat e kopsh-tit shihet një fushë e bukur me kulla pusesh, përballë duket rafineria dhe më tej fusha e gjelbër e pjellore dhe kodrinat e buta të Beratit të mbjella me pemë të reja frutore. Pasdreke vajtëm të shihnim ndërtimet në Kombinatin e Tekstileve të Beratit. Punimet atje shkojnë normalisht, s'ka asnjë pengesë.

Mbrëmjen e kaluam mirë me biseda e me shaka, bëmë edhe një lojë kupash me shokët e komitetit të Partisë të qytetit.

Presim me padurim ditën e nesërme.

PËRMET, E SHTUNE

23 MAJ 1964

U nisëm për në Përmet. Berati i vjetër, me kalanë e lashtë mbi kokë dhe Osumin në këmbët e tij, duket madhështor e i bukur nën rrezet e arta të diellit të mëngjesit. Kodrat mbi qytet, nga e djathta dhe nga e majta, mbi rrugë dhe nën rrugë, janë krejtësisht të mbjella me fiq, ullinj e pemë të tjera frutore. Është një mrekulli që ka bërë Partia dhe që rrallë e gjen gjetkë.

Po i afrohemi Sukës, ku është rreshtuar Brigada e 12-të Sulmuese partizane. I gjithë efektivit i saj, që doli nga lufta, ishte atje, oficerë aktivë e në pension, zyrtarë të lartë e punëtorë, kooperativistë dhe gra, që të gjithë me shamitë e kuqe dhe me dekoratat në gjoks.

Momente prekëse! Më ranë lotët mbi faqe, kur shtabi i vjetër i brigadës më paraqiti forcën dhe lexoi emrat e heronjve të brigadës, që ranë në luftë. Kalova në paradë dhe përshëndeta shokët e mi të dashur të luftës dhe të ndërtimit të socializmit. Filloi parakalimi madhështor. Folën Shefqet Peçi dhe shokë të tjerë; përqafova me mall shokët e vjetër të asaj kohe, mëmat e dëshmorëve, pastaj u nisëm për në Përmet, ku na pret populli. Ndalëm automobilat tek ura.

Si mizë lisi duket moria e njerëzve të mbledhur në Përmet, varg i pambaruar, ardhur nga të katër anët e atdheut. Kopsht i lulëzuar është bërë Përmeti, me njerëz të qeshur e të gëzuar si rrezet e diellit dhe si ditët më të bukura të majit. Njerëzit brohorasin dhe këndojnë në qytetin e bukur historik që Partia e ndërtoi të ri. Kalojmë në mes një populli të dendur nga të dyja anët e bulevardit të ri, anash të cilit janë ndërtuar apartamente të reja, një hotel madhështor, shtëpi kulturore moderne, trotuare të shtruara bukur dhe kudo flamuj. Monumenti i ri i partizanit qëndron aty si një nuse mbuluar me duvak dhe pret në qetësi çastin e zbulimit, të inaugurimit.

Shqipëri o mëma ime, më e shtrenjta, më e shenjtja, më e dashur se jeta ime! Sa jam i gëzuar që të nxori Partia në dritë, të hoqi vuajtjet e mjerimet, të bëri të bukur, të fuqishme! O nënë plakë, Partia të bëri nuse të re, të bëri të fuqishme dhe tash balli yt shkëlqen! Të rrosh në shekuj e lumtur, e fortë, e ndritur, e mësuar! Tërë jetën time unë do ta shkrij për ty!

U çlodhëm në apartamentin e ri, hëngrëm bukë të kënaqur dhe përgatitemi për pasdreke.

Sot pasdreke, të shoqëruar nga një turmë e madhe e popullit, vajtëm vumë kurora dhe nderuam shokët tanë të rënë në luftë. Varrezat e dëshmorëve në Përmet janë rregulluar mirë; atje janë mbjellë plot lule dhe në krye është vendosur një monument i ri i skulptorit të njohur Odise Paskali, monument i bukur plot harmoni, që të ngjall ndjenja dhembshurie, krenarie

dhe heroizmi. Në varrezat u përqafova me nënën e një shoku të vranë në luftë, me një nga nënat trimëresha shqiptare, që rrinte në krye të varrit të djalit të saj. Iu afrova, i putha dorën, e pushtova, po ndërsa unë qava, ajo i mbajti lotët, më fërkoj ballin dhe më tha: «Mos qaj, biri im! Do të vriteshin një pjesë, ndryshe s'mund të kishte Shqipëri të lirë socialiste!»

E tillë je dhe ti, mëmë Shqipëri, zemërluane, e dashur me bijtë e tu!

Në mbrëmje asistua në një shfaqje folklorike, e vënë në skenë shumë bukur nga grupi amator i shtëpisë së kulturës të Përmetit. Rapsodi që nga koha e luftës e deri te festimi i 20-vjetorit. U kënaqëm.

PERMET, E DIEL

21 MAJ 1964

Filloi mitingu i madh. Sheshi është mbushur plot me popull dhe me flamurët që valëviten. Dielli shkëlqen, shkëlqejnë fytyrat e njerëzve të lumtur e të gëzuar. Shoku Haxhi Lleshi foli për rëndësinë e kësaj date të shënuar, pastaj filloi parakalimi. Në krye të repartit udhëheq ish-shtabi i brigadës, pastaj parakalon flamuri dhe një repart i Brigadës së 12-të të Ushtrisë Popullore; pas tyre parakalojnë veteranët e Brigadës së 12-të Sulmuese partizane dhe në fund reparte artilerie të garnizonit. Një gjë shumë e bukur, prekëse, madhështore. Populli është në kulmin e gëzimit.

Pas paradës, të gjithë ish-delegatët e kongresit historik shkuan në sallën muze, ku u mbajt kongresi. Ishin momente prekëse për të gjithë, veçanërisht për mua. Isha i emocionuar, se më është dashur ta mbroj me gjoks Partinë e dashur, veprën e saj të pavdekshme dhe veçanërisht mbajtjen e Kongresit të Përmetit. Armiqtë e fshehtë nuk donin që të mbahej ky kongres; këta ishin agjenti i Intelixhens Servisit, Mustafa Gjinishi dhe padronët e tij, misionarët ushtarakë anglezë, që ishin në atë kohë në vendin tonë. Një nënkolonel

anglez zbriti atëherë me parashutë apostafat që të merrte kontakt me krerët e Ballit dhe me Mustafa Gjinishin. Ky agjent erdhi gjoja që të na hidhte armë, por e diktova qëllimin e tij që në takimin e parë. Ai kishte dijeni se ne do të mbanim kongresin (pra anglezi kishte një informator në radhët tona, që e dija me kohë se ishte Mustafa Gjinishi, se e kishim zbuluar më parë punën e tij) dhe donte të merrte takim me ballistët. E bllokova që ditën e parë, duke i thënë se në rast se do të kalosh kufirin e partizanëve, në zonat tona nuk kalon dot më. Pikërisht rrugës kur po shkonim nga Helmësi në Përmet e kapëm Mustafa Gjinishin me letër në dorë, të dërguar në mënyrë misterioze me një korrrier anglez. Mustafai s'pranoi të ma dorëzonte letrën, prandaj e cilësova menjëherë ashtu siç ishte.

Pra, në Përmet u ashpërsua lufta jonë me Mustafa Gjinishin. Ai përpiqej të sabotonte mbledhjen, të luftonte projektet e punës, të bënte njerëz të pakënaqur. Por unë s'e lija, këmba-këmbës ndiqja çdo veprim të tij. Shkova natën të Myslimi dhe i tregova çdo gjë, i thashë se po të vazhdojë Mustafai në veprimtarinë e tij të ndyrë, do ta arrestojmë dhe do t'ia kalojmë gjyqit ushtarak. Myslimi dhe Spiro Moisiu ishin plotësisht dakord me mua. Medari, Esati, ashtu siç i udhëzova, filluan ta luftonin Gjinishin dhe shokët e tjerë i vunë dërmën. Më në fund e thirra përsëri vetë dhe i thashë: «Është e fundit herë që po të paralajmëroj, mos saboto punën, se do të jap urdhër të të arrestojnë dhe të të nxjerrin në gjyq». Atij i hyri frika në palcë.

Të gjitha këto e plot ngjarje të tjera më kujtoheshin kur ecja sot për në sallën muze. Më kujtoheshin

shokët e vrrarë me emrin e Partisë në gojë, fshatrat e djegura etj. Dhe ja, sot, në këtë ditë të lumtur, përpara sallës së kongresit historik, zemra më shtrëngon nga emocioni. Zëmë vendet që kishim 20 vjet më parë. Heshtje; më duhet të flas po s'flas dot, sytë i kam me lot, gryka më është zënë nga emocioni. Fola¹ më së fundi, por pashë se edhe shokët që kisha përpara, i kishin sytë gjithashtu me lot. Pasi vizituam sallën muze e dolëm edhe në fotografi së toku, u kthyem në shtëpi.

Pasdreke asistuaam në manifestimin fizkulturor të nxënësve. Ishte përgatitur shumë mirë dhe pati shumë sukses.

Në mbrëmje, në darkën e organizuar, fola unë² dhe doktor Musa Ohri, patriot nga Përmeti, partizan tok me ne. Në darkë kishte edhe miq të huaj.

E HENE
25 MAJ 1964

U nisëm për në Vlorë të gëzuar e plot kujtime të paharruara nga Përmeti historik. U ndalëm në Tepelenë, biseduam me shokët dhe vizituam shtëpinë e kulturës, që Nexhmija s'e kishte parë. I pëlqeu.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 416.

2. Po aty, f. 419.

E ENJTE

23 MAJ 1964

Mora letër nga një i njohur, i cili kërkon që djali që i mbaron studimet e larta sivjet, për arsye ekonomike, të emërohet në Korçë, pranë tij. Unë mendoj se arsyeja e vërtetë nuk është ngushtica ekonomike po thjesht dëshira për ta pasur djalin pranë, prandaj lashë shënimin se më parë nga këto duhen parë interesat e shtetit.

E PREMTE

29 MAJ 1964

Prita delegacionin e Vietnamit të Jugut të kryesuar nga Nguyen Van Hieu, anëtar i KQ të Frontit të Çlirimit të Vietnamit të Jugut. Kryetari i delegacionit foli për taktikën e luftës së tyre dhe për atë të amerikanëve. Foli edhe për perspektivën e luftës, për ndihmat që u japin miqtë, për vështirësitë që hasin në sigurimin e armatimeve etj.

Me rastin e 20-vjetorit të krijimit të Teatrit Popullor u nisa një letër përshëndetje¹ punonjësve të këtij kolektivi, me të cilën i urova për punën e tyre të palodhur në përparimin e artit skenik shqiptar, i cili si të gjitha artet në Shqipëri pasqyron jetën tonë socialiste në zhvillimin e saj revolucionar.

Punonjësit e kësaj sfere duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rolin e teatrit tonë si kultivues i ndërgjegjes revolucionare të masave, për misionin e rëndësishëm në formimin dhe forcimin e kësaj ndërgjegjeje, që teatri ynë të jetë gjithnjë i kuptueshëm për popullin, një armë e fuqishme për të ecur përpara drejt një jete më të lumtur.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 26, f. 448.

Votuar me Nexhmijen për zgjedhjen e këshilltarëve dhe të gjyqtarëve popullorë. Ditë me shi, megjithatë populli shkoi i gjithë në votime, bile që herët. Patriotizëm i pashoq në popullin tonë, dashuri dhe besnikëri e madhe ndaj Partisë.

E PREMTE
5 QERSHOR 1964

Prita kryetarin e delegacionit të Konfederatës së Përgjithshme të Punës të Kongos, që ndodhet për vizitë në vendin tonë.

Prita delegacionin e dramaturgëve kinezë¹ dhe një shkrimtar kinez.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 6.

E HËNE
8 QERSHOR 1964

Për zhvillimin e punës kërkimore-shkencore.

Sistemi i Universitetit.

Sistemi i instituteve kërkimore të prodhimit.

Këshilli shkencor.

Ky këshill të drejtojë edhe bërthamat kërkimore-shkencore në sistemin e Universitetit

a) Ç'institute do të vëmë në varësi të këtij këshilli?

b) Ç'bërthama të reja do të krijojmë?

Për kushtet tona reale sot si edhe për perspektivën të përcaktojmë më mirë planin e problemeve për punën shkencore. Të ruajmë përpjesëtimet dhe prioritetin në dobi të problemeve më të rëndësishme.

Të bëhet një studim i imët për kuadrin e lartë ekzistues. Të caktojmë përpjesëtime të reja aktuale dhe për perspektivën e punës së tyre në prodhim, në Universitet, në institutet kërkimore-shkencore dhe në shkollat e mesme.

Në klasat e larta të japin mësim kuadro me arsim të lartë.

Duhet të rishikojmë punën shkencore që bëjnë institutet dhe laboratorët e ministrive të ndryshme.

Kuadri dhe tematika e punës shkencore në këto.

Të mendojmë për personelin ndihmës që është i nevojshëm në bërthamat e punës shkencore.

Shkollat e mesme profesionale të përgatitin laborantë dhe teknikë për eksperimentet shkencore.

Aktiviteti shkencor sot te ne mund të orientohet nga studimi me karakter teorik, por për ato probleme që i interesojnë zhvillimit të vendit dhe që gjejnë zbatim praktik.

Të përcaktojmë kritere të reja për orët e mësimin, për futjen e kuadrove të rinj nën drejtimin e punonjësve shkencorë me eksperiencë.

Të synohet në rritjen e numrit të aspirantëve, të mos lakmohet sasia në dëm të cilësisë. Të caktohen kushte të reja për mbrojtjen e aspiranturës.

Sistemi i ri arsimor

Ç'po bëhet? Kur do të përfundojë studimi?

Të supozojmë se do të pranojmë arsimin e mesëm 11-vjeçar, atëherë duhet të studiojmë që të shtojmë fakultetet nga një vit.

Çështja e kulturës së përgjithshme të përshtatshme për kushtet dhe nevojat e domosdoshme të vendit tonë kërkon thjeshtim të mirë të lëndëve në disa drejtime.

Zgjerimi dhe natyra e rrjetit shkollor

- a) Përcaktimi i numrit të gjimnazeve;
- b) i shkollave të mesme teknike ose politeknike;
- c) çështja e shkollave të rezervave të punës;
- d) arsimi i përgjithshëm 8-vjeçar dhe çështja e rezervave të punës për krijimin e kuadrove të mesëm për gjithë sektorët.

Orientimet për pesëvjeçarin e ardhshëm për këto probleme t'i kemi të qarta dhe të ecim me një plan të studiuar më mirë shkencërisht, të zbatueshëm, konkret dhe rentabël.

Për këto probleme pata një bisedë me Ramizin, Manushin dhe Kahreman Yllin.

E ENJTE

11 QERSHOR 1964

Gazeta «Zëri i popullit» botoi sot artikullin me titull: «Revizionistët hrushovianë janë për izolimin e popujve të Azisë e të Afrikës»¹.

E HËNE

15 QERSHOR 1964

Në mbledhjen e Sekretariatit të KQ diskutuam për zhvillimin e seminareve me sekretarët e organizatave-bazë të Partisë¹ dhe për disa çështje të tjera.

Seminaret që zhvillohen me sekretarët e organizatave-bazë janë shumë të nevojshme, ato do t'i ndihmojnë që të udhëheqin sa më mirë organizatën në zgjidhjen e problemeve.

Komitetet e Partisë duhet ta shohin më seriozisht përgatitjen e këtyre seminareve.

Njohja mirë e nivelit politik dhe kulturor të sekretarëve të organizatave-bazë nga komitetet e Partisë ndihmon në përcaktimin e drejtë të temave që do të zhvillohen me ta.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 14.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 28.

E MARTE
16 QERSHOR 1964

Mbledhja e Byrosë Politike që u zhvillua sot trajtoi probleme të punës kërkimore-shkencore gjatë planit të katërt pesëvjeçar në fushën e shkencave natyrore, bujqësore dhe teknike, probleme të punës e të jetës së plumeve e të byrove të komiteteve të Partisë në rrethe, si dhe për çmimin e blerjes dhe të shitjes së farnave të drithërave, të bimëve industriale etj.

SHKODËR, E ENJTE
18 QERSHOR 1964

U nisa për në Shkodër për të marrë takim me shokët drejtues të rrethit e me punonjësit. Pata një bisedë të përzemërt me anëtarët e byrosë së komitetit të Partisë të rrethit. Shokët folën për rezultatet e arritura në realizimin e planit, për punën që bën Partia në të gjithë sektorët e m'u përgjigjën për një varg problemesh, rreth të cilave u bëra pyetje. Situata politike në Shkodër është shumë e mirë.

Partia, u thashë të pranishmëve në këtë bisedë, të ketë vazhdimisht në qendër të vëmendjes edukimin e komunistëve në të gjitha drejtimet që ata të jenë agjitorë të punës së Partisë. Kështu dhe do të gjenden rrugët, metodat më të drejta, më të efektshme për zgjidhjen e problemeve të ndryshme¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 36.

SHKODËR, E PREMTE
19 QERSHOR 1964

Vizitua vepra të reja industriale që po ndërtohen në qytetin e Shkodrës; uzinën e telave elektrike, fabrikën e letrës për thasë çimentoje dhe fabrikën e pllakave prej fibre. Të tria këto vepra janë mjaft përpara. Shkodra është bërë një qendër shumë e mirë industriale.

Më pas vizitova ndërmarrjen bujqësore «Perlat Rexhepi». Kudo, nga të dyja anët e rrugës për në këtë ndërmarrje shihje vreshta të mëdha. Vreshta e Shtojit është me të vërtetë vepër shumë e bukur e mjeshtërve të talentuar të kultivimit të llojeve të shumta të rrushit. Dikur, kur isha djalë, në këtë fushë erdhëm për të marrë eshtrat e Çerçiz Topullit e të Muço Qullit dhe i çuam në Gjirokastër. Kur e vizitoi këtë vreshtë Nikita renegati, si «parashikues i madh» që ishte, tha: «Këtu s'keni për të marrë fare rrush». Por rrushi bëhet në Shtoj për bukuri. Bisedova gjatë me drejtorin dhe me punëtorët¹. Todo Gjermani, që e ngriti këtë ndërmarrje dhe që ka punuar e punon shumë mirë, më

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 46.

tha: «Kur të vdes, dua të më varrosin këtu, në vreshtë».

Pasdreke vizitova Stacionin Qendror të Zooteknisë dhe Teknikumin Veterinar. Pashë stallat e lopëve e u interesova për prodhimin. Bashkëpunëtorët shkencorë të stacionit ishin të preokupuar që me punën e tyre ta çonin prodhimin përpara. Edhe në teknikum bëhej një punë e mirë për përgatitjen e nxënësve. Pas vizitës bisedova me mësuesit dhe me bashkëpunëtorët shkencorë të stacionit¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 50.

SHKODËR, E SHTUNË

20 QERSHOR 1964

Shkova në kooperativën e Bërdicës, ku më pritën me dashuri. Kjo kooperativë është mirë me prodhime, fshatarët kanë bërë shtëpi të reja; do t'u japim edhe energji elektrike.

I përgëzoja kooperativistët për sukseset e arritura. Fola për punën që duhet të bëjë organizata e Partisë për forcimin e ndërgjegjes socialiste të njerëzve, për edukimin e tyre me frymën e kolektivizmit. Kooperativistët duhet të bëjnë përpjekje për ngritjen e nivelit të tyre kulturor. Bashkëpunimi midis kooperativistëve, shkëmbimi i eksperiencës ndikojnë pozitivisht në realizimin e detyrave të caktuara¹.

Sot paradite vizitova edhe një pikë hapjeje; bisedova me ushtarët dhe me oficerët. Shumë mirë! Pastaj pata një bisedë me drejtues të këtij nënreparti². Bisedova me ta për probleme të ngritjes së nivelit politik, ideologjik, arsimor e kulturor, për stërvitjen ushtarake etj. U fola edhe për detyrat që u dalin oficerëve tanë

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 62.

2. Po aty, f. 57.

për të njohur armët që disponon armiku imperialist, teoritë e ndryshme lidhur me çështjen e luftës e të tjera, me qëllim që të jemi të përgatitur për t'i bërë ballë, po të jetë nevoja, çdo sulmi nga ana e tij.

Pasdreke shkova në fabrikën e cigareve «Vasil Shanto». U shpërndava teserat e reja të Partisë disa komunistëve të Fabrikës së Cigareve, të SMT-së dhe të Fabrikës së Tisazhit, që ndodheshin në këtë takim, të cilëve u fola për rëndësinë e saj dhe për situatën¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 71.

SHKODËR, E DIEL
21 QERSHOR 1964

Sot bëra një diskutim¹ në byronë e komitetit të Partisë të rrethit për ngritjen e nivelit të punës së drejtuesve të Partisë në rreth.

Shkodra është një qendër e rëndësishme industriale e bujqësore. Sektori i industrisë është zgjeruar, në atë të bujqësisë gjithashtu janë bërë përparime. Në këta sektorë, si dhe gjetkë, punojnë kadro me nivel të ngritur, të aftë për t'i kryer me sukses detyrat që u ngarkohen. Pra, situata ka ndryshuar në qytet e në fshat dhe këtë ndryshim duhet, në radhë të parë, ta kuptojnë drejtuesit e Partisë në rreth, ndaj të cilëve kërkohet medoemos të ndryshojnë stilin e punës që ai t'i përgjigjet situatës, nivelit të kuadrove. Përmirësimi i metodës së punës të organeve të Partisë do të ndikojë edhe në përmirësimin e punës së organeve të pushtetit. Kështu edhe ndihma që këto organe i japin bazës do të jetë më efektive.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 85.

Për drekë isha në familjen e shokut Sulë Baholli¹.
Pasdreke u nisa për në Tiranë.

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës.

E HËNË
22 QERSHOR 1964

Takim me ambasadorin kinez Lo Shi Gao, me rastin e largimit.

U takova me shokët indonezianë që ndodhen këtu për vizitë e për pushime.

E ENJTE
25 QERSHOR 1964

Kërkova nga ndihmësit e mi të më bëhet një listë me datat e ardhjes dhe të nisjes së miqve të huaj, që do të pres në takim. Shënova që muajt të më jepen me shkronja dhe jo me shifra, se e kam shumë zët pse duhet t'i numëroj me gishta.

Në mbledhjen e Sekretariatit që zhvilluam sot u diskutua për eksperiencën e përparuar në bujqësi dhe në blegtori dhe për punën e organizatave të Partisë dhe të rinisë për këtë problem. Shokët që diskutuan folën mirë por tërhoqa vëmendjen¹ se nga mbledhja e Sekretariatit duhet të dalim me konkluzione, një prej të cilëve mund të jetë edhe ky që çdo formë që krijojmë, siç janë edhe skuadrat eksperimentale të bujqësisë në disa rrethe, nuk i krijojmë si qëllim në vetvete por që gjithë bujqësia jonë të ngrihet në nivelin e bujqësisë së zhvilluar socialiste.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 98.

Në mbledhjen e Byrosë Politike sot, ndër të tjera, u diskutua rreth shpenzimeve të buxhetit për masat socialkulturore dhe mundësitë për kursime në këtë sektor.

Të ruajmë nivelin e jetesës së popullit. Shkurtime në shpenzime të bëjmë, po jo vend e pa vend, veçse atje ku duhet.

Si për çdo gjë, theksova¹, edhe për këtë çështje kërkohet të veprohet me kujdes, në mënyrë të matur duke pasur parasysh kurdoherë situatën politike në të cilën jetojmë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 104.

E HËNË
6 KORRIK 1964

Prita delegacionin e Shoqatës së Miqësisë Belgjikë-Shqipëri që ka ardhur për të vizituar vendin tonë¹.

Hrushovi deklaroi se pranon propozimin amerikan për krijimin e forcave të përhershme të OKB-së. Ç'tradhti!!

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 108.

E MARTË
7 KORRIK 1964

Sot filloi punimet Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë¹. Raportin e Byrosë Politike «Mbi forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve», e mbajti shoku Ramiz Alia. Të gjithë e dëgjuan me vëmendje raportin që jepte orientime e shtronte detyra për një punë akoma më të mirë në drejtim të edukimit komunist të punonjësve.

Filluan diskutimet.

1. Plenumi i 13-të i KQ të PPSH, që u zhvillua nga data 7-9 korrik 1964.

Vazhduan diskutimet në Plenum, të cilat ishin konstruktive dhe u përshkuan nga fryma e kritikës dhe e autokritikës.

Në mbyllje të punimeve të Plenumit në fjalën që mbajta¹ midis të tjerash theksova rëndësinë e madhe të punës dhe qëndrimin ndaj saj dhe se ky problem nuk duhet shkëputur kurrë nga formimi i njeriut të ri. Fola, gjithashtu, për rëndësinë e lidhjes sa më të ngushtë të punës mendore me atë fizike, për kuptimin e vlerës së kohës dhe për përdorimin e drejtë të saj, për kuptimin e drejtë të kritikës dhe të autokritikës dhe për përdorimin e tyre me vend e me efekt, si dhe për vijën marksiste-leniniste të Partisë sonë e për situatën ndërkombëtare.

Pas përfundimit të punimeve të Plenumit u bë një mbledhje, ku u ndava taserat e reja të Partisë shokëve të KQ dhe sekretarëve të parë të komiteteve të Partisë të rretheve.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 118.

Prita delegacionin e qytetit Guançou të RP të Kinës, i cili ndodhet këtu për vizitë.

-12 Bashkë me Hysniun pritëm anëtarin e PK marksisiste-leniniste të Australisë, Florence Rusell. Ajo ka ardhur në Shqipëri për të kaluar pushimet¹.

Prita ambasadorin e ri të jashtëzakonshëm e fuqiplotë të RD të Vietnamit në RP të Shqipërisë, Nguyen Ngoc Son².

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 179.

2. Po aty, f. 192.

Shënim për shokun Haxhi¹:

Doktorët sulmojnë duhanin tim, unë i kundërsulmoj me filtrat «denikotea». Në rast se ti nuk m'i dërgon ato, atëherë luftën e humba me ta, se m'u mbaruan «fishekët».

Dezhi priti ambasadorin tonë në Rumani² dhe pati një bisedë të gjatë me të.

1. Haxhi Kroi.

2. Rrapi Gjermani.

**E SHTUNË
25 KORRIK 1964**

Ushtria jonë është e popullit dhe e Partisë, është ushtri e revolucionit. Ajo nuk është ushtri e kazermave dhe e kastave, siç janë ushtritë borgjeze.

Në punën e Partisë për edukimin politik dhe ideologjik të ushtrisë sonë ne duhet të synojmë që kurdoherë t'ia ruajmë kësaj të fundit këtë karakter. Por ky karakter popullor mund të ruhet vetëm atëherë kur ushtrinë e komandon Partia dhe jo kur ndodh e kundërta. Vetëm mësimet dhe udhëheqja e Partisë e ruajnë thjeshtësinë proletare të ushtrisë dhe e bëjnë këtë armë të diktaturës së proletariatit.

Po shkau ushtria nga rruga e Partisë, kjo do të thotë që ajo nuk është më ushtri e popullit, por e kastave që orvaten kurdoherë të marrin fuqinë dhe të vendosin pushtetin e tyre. Ç'pushtet mund të ishte ky? Sigurisht do të ishte pushteti i atyre që duan të sundojnë mbi popullin, jashtë ligjeve dhe interesave të diktaturës së proletariatit. Njerëzit e kastave ushtarake janë antiproletarë, antiparti, ata janë bejlerë ushtarakë, janë bashagatë e jeniçerëve të dikurshëm. Ushtria jonë nuk është dhe nuk do të jetë ushtri e mareshalëve, e

gjeneralëve dhe e kolonelëve, ushtri e puçistëve. Puçë po bëjnë njerëzit me grada në ushtritë borgjeze dhe revizioniste, të cilët janë në shërbim të klikave reacionare në fuqi.

Më shqetëson ekzistenca e gradave në ushtrinë tonë, se ishin pikërisht kuadrot me grada në Bashkimin Sovjetik ata që filluan të mendojnë: «Ne jemi dhe s'ka njeri», dhe duke shkelur ligjet e rregullat e Partisë futën në udhëheqje tradhtinë. Po përse e bënë ata këtë? Që të sundojnë mbi vendin, mbi Partinë, mbi popullin, që të kenë privilegje e të bëjnë një jetë të rehatshme. Një situatë të tillë ne nuk do ta lejojmë kurrë. Kuadrot tanë nuk janë të tillë, por mund të bëhen në rast se Partia nuk i edukon vazhdimisht. Partia duhet t'i edukojë kuadrot e ushtrisë që të mos u rritet mendja nga gradat.

Ne e dimë dhe ua mësojmë çdo ditë kuadrove se djemtë e popullit, djemtë e punëtorëve e të fshatarëve, të barinjve, të malësorëve, nuk dolën në male dhe nuk luftuan për të fituar grada e ofiqe, por për të çliruar atdheun dhe për të bërë revolucionin, siç e bënë. Pra, luftën ne e bëmë jo që të marrim rroga të majme, të zëmë kolltukë e të fitojmë grada. Jo. Ne e bëmë dhe vazhdojmë ta çojmë përpara revolucionin për ndërtimin e socializmit që të krijojmë një jetë të lumtur për gjithë popullin dhe jo vetëm për vetë. Ne duhet të jemi të thjeshtë në punë e në jetë e ta kemi mirë të qartë se këto vende ku na ka vënë Partia, nuk janë privilegje, por na ngarkojnë me përgjegjësi dhe na vënë përpara detyra që ne duhet t'i kryejmë me besnikëri për të mirën e popullit.

Shumë djem të popullit, pas luftës, qëndruan në ushtri dhe u bënë oficerë. Ata nuk e bënë këtë gjë për grada, po për të edukuar dhe për të kalitur ushtrinë e popullit, që kjo të jetë gati kurdoherë për të mbrojtur popullin, revolucionin, socializmin. Prandaj ne vazhdimisht duhet t'ua ngulim në kokë këto koncepte të drejta oficerëve tanë, si atyre të ushtrisë, ashtu edhe atyre të Organeve të Punëve të Brendshme.

Rendja pas rehatisë është e dëmshme për komunistët dhe për kuadrot. Në radhë të parë nuk mund të ketë rehati për oficerët, të cilët duhet t'u mësojnë artin ushtarak ushtarëve. Mirëpo këtë art ata nuk mund t'ua mësojnë vetëm në kazerma, por më shumë në terren, se në kohë lufte kjo punë nuk mund të bëhet as me lule dhe as me referate në një ambient të ngrohtë, por në terren të hapët, në fusha e në male, në shi e në borë dhe me stërvitje si nën breshërinë e plumbave e të gjyleve të armikut.

Këto i them se konstatoj disa shenja që janë shqetësuese. Shoh një takëm oficerësh që rrinë larg ushtarëve dhe hiqen fodullë, tunden sikur kushedi ç'janë. Këto nuk janë sjellje e qëndrime të pëlqyera. Me sa shoh, Beqiri nuk po i kushton vëmendje kësaj çështjeje dhe nuk po merr masa në këtë drejtim. Nuk e kam fjalën aspak për dënimet që jepen si pa të keq, por për të marrë masa partie, masa për edukimin e të tillë njerëzve me frymën e Partisë. Tjetër gjë nuk i sjell në vete këta «kapedanë» që e mbajnë hundën në qiell dhe mendojnë se dynjaja është nën këmbët e tyre.

Kam përshtypjen se organizatat e Partisë në ushtri bëjnë një punë rutinë për edukimin e këtyre nje-

rëzve, gjë që është e dëmshme. Me ta duhet bërë një punë revolucionare dhe jo shkel e shko. Të kuptohet thellë rëndësia e këtij problemi.

Prita një shok iranian, ish-anëtar të byrosë politike të Partisë Komuniste të Iranit, tani i përjashtuar nga revizionistët iranianë për qëndrimin e tij marksist-leninist. Ky është një personalitet, komunist i vjetër dhe i dëgjuar në Iran. Me profesion është doktor dhe punon profesor në universitetin e një vendi arab. Erdhi ilegalisht te ne. Shokët tanë u takuan dhe biseduan gjatë me të. Qëndrimi i tij dukej i mirë. Ai shprehu idenë e tij mbi thirrjen e një kongresi të Partisë Komuniste të Iranit, për të krijuar udhëheqjen e re marksiste-leniniste në kundërshtim me udhëheqjen aktuale revizioniste. Ai tha se gjysma e udhëheqjes aktuale është e mirë, gjysma tjetër është shërbëtore e paguar e Hrushovit. Partia në Iran është shpartalluar dhe ka mbetur pa asnjë lidhje me udhëheqjen. Ai dukej i vendosur për të punuar, të shohim. Ai mendon që, pasi të bëjnë kongresin, të krijojnë lidhjet dhe të mëkëmbin partinë brenda në Iran dhe ka besim se do ta realizojë këtë gjë.

E PREMTE
31 KORRIK 1964

Lexova nga agjencia HSINHUA përgjigjen që kinezët i dhanë letrës së KQ të PK të BS të datës 15 qershor 1964, lidhur me çështjen e mbledhjes ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore. Në përgjigjen e tyre kinezët i akuzojnë revizionistët sovjetikë se po përgatiten të thërresin në mënyrë arbitrare, të njëanshme e të paligjshme një mbledhje për të shkaktuar përçarje të hapët në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

DURRES, E SHTUNE
1 GUSHT 1964

Prita sot këtu shkrimtarin dhe gazetarin francez Pier Paraf me bashkëshorten e tij, edhe ajo gjithashtu shkrimtare, që kanë ardhur këtu për pushime. Parafi është një mik i vendit tonë, e do Shqipërinë dhe ka shkruar disa artikuj të mirë. Është në udhëheqje të Shoqatës Francë-Shqipëri. Ai ka mundësi ta zhvillojë aktivitetin në favor të Shqipërisë, pse ka shumë të njohur në rrethe të ndryshme. Biseduam për letërsi dhe politikë. Dukej njeri i mirë. Më foli me shumë entuziazëm për vendin tonë, për përparimet dhe premtoi se do të punojë shumë për ta bërë më mirë të njohur Shqipërinë në Francë. Krijova përshtypjen se do të aktivizohet. E inkurajova në këtë drejtim, duke i thënë se deri tash në Francë nuk është përkthyer dhe as botuar ndonjë roman shqiptar, kurse në vendin tonë janë botuar me dhjetëra autorë klasikë francezë etj. Parafi i aprovoi vërejtjet e mia dhe premtoi se do të luftojë që të ngjallë interes në shtëpitë botuese franceze për botimet tona etj. Mbeti i kënaqur nga takimi.

Bashkë me shokët Hysni e Ramiz u takuam me Zhak Gripën dhe me disa anëtarë të tjerë të Byrosë Politike të Partisë Komuniste të Belgjikës, të cilët kanë ardhur për pushime te ne. Hëngrëm edhe drekë me ta.

Bisedimet vazhduan disa orë, ato ishin shumë miqësore dhe për të gjitha çështjet mbetëm dakord.

Gripa na vuri në dijeni për zhvillimin dhe forcimin e partisë së tyre, për punën me masat, që po zgjerohet, për punën e gazetës së tyre dhe në përgjithësi për punën ideologjike me kuadrot. Natyrisht, kjo punë ka të metat e saj dhe kërkuan të ndihmohen, të njohin përvojën tonë. Shokët belgë s'kanë kuadro për të dhënë mësim, megjithatë do të hapin një kurs nga vjeshta që do ta quajnë «shkollë të lartë», por në fakt ajo do të jetë diçka shumë e thjeshtë.

Në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit, mbi taktikat që duhet të përdorim, ata ishin dakord me ne.

Parashtruan mendime për ndihmën që duhet t'u japim grupeve marksiste antirevizioniste në vendet kapitaliste. I këshilloam, dhe ata ishin dakord, që me

këto grupe duhet punuar me durim për krijimin e partive komuniste të reja, por me baza të sigurta, që të bëhen me të vërtetë bërthama marksiste-leniniste rreth të cilave të grumbullohen komunistët dhe të luftohet revizionizmi modern. Folëm me shokët belgë për nevojën që partitë komuniste të reja ta kenë bazën në klasën punëtore, të pranojnë njerëz të rinj në parti, të punojnë brenda në partitë e vjetra komuniste, të përpiqen që, përveç militantëve të shkëputur, të bëjnë organizata të tëra në anën e tyre.

Ne mendojmë se shokët e grupeve marksiste-leniniste duhet të punojnë edhe jashtë partisë së vjetër, por edhe brenda saj dhe, duke ruajtur vijën e drejtë dhe parimet, të mos tregohen sektarë ndaj atyre shokëve komunistë, që e kuptojnë me vonesë çështjen e drejtë. Rëndësi ka që shokët e grupeve ose partitë e reja komuniste të ruhen nga provokatorët, të cilët do të jenë të shumtë dhe do të orvaten të hyjnë në radhët e tyre.

U thamë shokëve belgë, dhe këta ishin dakord, që shokëve të grupeve marksiste në vendet kapitaliste duhet t'u mësojmë konceptet e vërteta të organizimit, të demokracisë, të disiplinës dhe të punës së një partie leniniste, pse ata janë mësuar me koncepte organizative dhe pune në partitë e vjetra, që jo vetëm kanë qenë të shthurura, por që nuk i përgjigjen aspak luftës që po bëjnë dhe do të bëjnë kundër imperializmit dhe revizionistëve në vendet e tyre. Ne u bëmë të ditur shokëve belgë se organizimi i partive të reja në vendet kapitaliste është një çështje jetike dhe shumë serioze, kjo s'është çështje diletante, por prej militanti,

një çështje lufte, çështje sakrifice kolosale. Shokët e rinj në vendet kapitaliste duhet të mësojnë si të mendojnë, si të gjykojnë, si të veprojnë dhe si të luftojnë e të sakrifikojnë. Rrugën e luftës ata nuk e kanë pa gjemba dhe shkurre.

E MARTË
4 GUSHT 1964

Sot paradite prita¹ delegacionin e punonjësve të shëndetësisë të RP të Kinës të kryesuar nga prof. Jeng Çia Tun. Në pritje ndodhej edhe shoku Hysni.

Pasdreke do të nisem për pushime në Pogradec. Sonte do të qëndroj në Elbasan dhe do të bisedoj me shokët drejtues për punët e këtij rrethi.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 224.

**POGRADEC, E MËRKURË
5 GUSHT 1964**

Arrita në Pogradec për të vazhduar pushimet në këtë qytet të vogël, por të bukur.

**POGRADEC, E ENJTE
6 GUSHT 1964***

Ambasadori ynë na lajmëroi nga Pekini se gjatë bisedës me Çu En Lain, kur i parashtrroi atij projektin e përçapjes sonë pranë rumunëve, Çuja la të kuptohej se kjo sikur nuk u pëlqen, sikur të lihet për më vonë, sikur t'i koordinojmë këto veprime në tetor, me rastin e festës së Kinës, ku do të vejë edhe delegacioni ynë.

Këtu diçka fshihet. Kjo s'është e qartë për ne, pse, nga ana tjetër, Çu En Lai i gjeti të drejta tezat që ne do t'u shtrojmë rumunëve. Çu En Lai tha se këto janë mendime personale, por do të vërë në dijeni udhëheqjen. Pastaj, me këtë rast, tha se do të na dërgojë procesverbalet e bisedimeve që kanë bërë ata me rumunët dhe që ne s'i dinim. Çuja, gjithashtu, tha se kishte qenë *incognito* në Kore e në Vietnam, se kishte biseduar me udhëheqjet e këtyre vendeve për këto gjëra dhe shprehur keqardhjen që ne jemi larg dhe s'mund të veprojmë dot kështu edhe me ne. Mjaft e çuditshme! Të shohim! Çdo gjë sqarohet shpejt ose vonë.

POGRADEC, E ENJTE

13 GUSHT 1964

Rumunët na kanë ftuar të dërgojmë një delegacion të Partisë e të Qeverisë për të marrë pjesë në festimet e 20-vjetorit të çlirimit të vendit të tyre. I njoftuam sot për përbërjen e delegacionit tonë. Atë do ta kryesojë shoku Manush.

«Në Bukuresht filloi përçarja, në Bukuresht filloi ngjitja», thonë revizionistët rumunë. Po ne s'e hamë këtë. Delegacioni ynë që do të marrë pjesë në festën e 20-vjetorit të çlirimit të Rumanisë, në fjalimin që do të mbajë nuk do të ngrejë çështje polemike, siç luten rumunët, por ai do t'i injorojë krejtësisht delegacionet revizioniste, me atë sovjetik në krye. As do të ngrihet në këmbë dhe as do të duartrokasë, kur ata të flasin në mbledhje solemne. Kurse për fjalën e të zotit të shtëpisë do të ngrihet dhe do të duartrokasë, ashtu siç do të bëjë salla.

Kështu salla do të shohë se pajtim me revizionistët nuk ka dhe se divergjencat janë të pakapërcyeshme. Revizionistëve kjo nuk do t'u vijë mirë, por do t'u vijë mirë komunistëve dhe popullit dhe për ne ky është qëndrimi më i drejtë: respektojmë të zotin e shtëpisë, po

jo armiqtë, respektojmë rregullat që vuri i zoti i shtëpisë, po jo qëllimet që ai kërkon të arrijë. Pas manifestimeve shoku Manush do t'i komunikojë udhëheqjes rumune edhe atë që kemi përgatitur për t'ia thënë, kështu që bëhet komplet kjo çështje. Ne përfitojmë nga ky rast dhe i vëmë çështjet drejt, në rrugën marksiste-leniniste. Këtë taktikë do t'ua komunikojmë edhe kinvezëve, por mendoj se ata do të përdorin një taktikë tjetër, të butë, oportuniste. Por keq është për ta, ne kemi taktikën tonë dhe e kemi më të drejtë.

Erdhi për t'u takuar me mua këtu Eduard Hilli, kryetar i Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) të Australisë¹. Shoqërohej nga gruaja e tij. Biseduam gjatë. Ai tha se «Partia e Punës e Shqipërisë tregoi pjekuri dhe heroizëm të madh. Ajo ishte e para që filloi me guxim dhe drejt luftën kundër revizionizmit modern dhe u bë shembull e mësim për partitë e tjera marksiste». Pastaj Hilli tregoi se si u zhvillua lufta në partinë e tyre kundër revizionistëve, të kryesuar nga Sharki dhe Diksoni. Unë e vura në korent mbi situatën në Parti dhe në vendin tonë, e njoha me momentet kryesore të luftës sonë të gjatë kundër revizionistëve modernë, i thashë edhe mendimin për mbledhjen që po përgatit Hrushovi për në dhjetorin e këtij viti. Në konkluzion, ai ishte plotësisht dakord me ne për të gjitha çështjet.

Komunikatë na u lut të mos bënim, për arsye se

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 229.

kishte ardhur ilegalisht dhe dëshironte të evitonte masat e mundshme që mund të merrte qeveria australiane kundër tyre. Hilli e paraqiti shumë optimiste punën e partisë së tij, kurse partia e Sharkit është në rrugën e shpartallimit.

Hëngrëm drekë tok dhe pasdreke miqtë bashkëshortë shkuan të vizitojnë Korçën.

POGRADEC, E MARTE

18 GUSHT 1964*

Udhëheqja kineze, duke marrë shkas nga taktika që do të mbajmë ne në festën e rumunëve, na njoftoi edhe ajo taktikën e saj. Delegacioni kinez do të ngrihet në këmbë për revizionistët, por nuk do të duartrokasë, dhe, në qoftë se atakojnë me emër Kinën, nuk do të dalë nga salla. Pra këtu disakordi do të duket botërisht. S'ka gjë, kjo bën mirë. Mirë do të ishte që kinezët të mbanin qëndrim të njëjtë me ne, por s'ke ç'bën, ne s'mund të mbajmë qëndrimin e tyre, sepse do të ishte gabim parimor.

Tok me këtë ata na thonë se udhëheqja kineze e kupton çështjen që Rumania po merr kredi nga imperialistët dhe bën një politikë pajtuese me titistët, po s'ka ç'bën, se ndryshe Rumania do të shkatërrohej. Kjo pikëpamje e shokëve kinezë është krejt revizioniste. Me fjalë të tjera, kinezët janë pro marrjes së kredive nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pro pikëpamjes se socializmi mund të ndihmohet nga imperializmi. Kinezët s'janë fare në të! Lëre pastaj për çështjen titiste! Kinezët harrojnë ç'kanë thënë dhe ç'kanë shkruar më parë. Kësaj i thonë ta vërtitësh nga fryn

era. Jo! Ne s'do të jemi kurrë dakord me këto pikëpamje oportuniste të shokëve kinezë! Ku është teza se «socializmi duhet ndërtuar me forcat e veta», kur, sipas tyre, mund të merret kredi edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës?

Kinezët do të shkaktojnë dëme të mëdha në qoftë se do të kalojnë në këto qorrsoqaqe. Pse do të shkatërron Rumania? Po ne, që s'morëm kredi nga imperia-listët, pse nuk u shkatërruam? Apo vallë me këtë që na thonë, kinezët duan njëkohësisht të na lënë të kuptojmë se ne shpëtuam nga disa kredi që na dhanë ata, përndryshe do të ishim shkatërruar?! Ky do të ishte kulmi i poshtërsisë! Ata as janë në të fare dhe as që e kanë kuptuar vijën tonë marksiste-leniniste të patundur e të drejtë. Është vetëm vija e drejtë e një partie ajo në bazë të së cilës ndërtohet socializmi. Kreditë dhe ndihmat nga miqtë janë të dorës së dytë dhe pasojë e kësaj vije të drejtë.

Kinezët po gabojnë rëndë në këtë çështje. Si kanë arritur ata në këtë gabim? Mos vallë në bisedime me rumunët, përmbajtjen e të cilave ne nuk e dimë, ata janë angazhuar së bashku në këto ujëra? Në këtë komunikim udhëheqja kineze konfirmon se është dakord me mendimet e Çu En Lait për sa i përket përçapjes që do të bëjmë ne pranë rumunëve. Me fjalë të tjera, udhëheqja kineze është e mendimit se gjoja ato që do t'u themi ne rumunëve, janë të drejta, po duan sikur të mos u thuhet tash, por të lihen për më vonë, dhe t'u thuhet nga një person i rëndësishëm, se mundet që Dezhi të mos i marrë mirë, se Titoja s'është armik kryesor e i rrezikshëm, e të tjera ide të tilla të turbullta,

të lëkundshme, të pakuptueshme për ne. Çfarë fshihet prapa gjithë këtyre? Një gjë është interesante: kur ne u komunikua shokëve kinezë çështjen se rumunëve do t'u shtrojmë disa gjëra parimore, ata përnjëherë na folën për bisedimet që kishin bërë fshehtëzi me Dezhin që më 5 qershor dhe na premtuan se do të na jepnin procesverbalet. Si duket këtu duhet të flejë lepuri. Kur të na japin këto procesverbale, do t'i shohim më qartë qëndrimet e kinezëve ndaj vijës oportuniste të rumunëve dhe këto lodra joshoqërore që na bëjnë neve.

Ne jemi të sigurtë me shokët kinezë dhe kështu do të vazhdojmë të jemi. Ne nuk lëvizim nga vija jonë, pse ajo është e drejtë, dhe të gjithëve do t'u themi haptazi çfarë mendojmë për çdo gjë.

E ENJTE
20 GUSHT 1964

Sot delegacioni ynë i kryesuar nga shoku Manush u nis për në Bukuresht, ku do të marrë pjesë në festimet e 20-vjetorit të çlirimit të Rumanisë.

POGRADEC, E PREMTE

21 GUSHT 1964*

Morëm procesverbalet nga Pekini: takimi «i përzemërt» i ambasadorit kinez me Dezhin (5 orë dhe drekë familjare), biseda e Bodnarashit me ambasadorin kinez (7 orë mbledhje sekrete buzë një liqeni, që zgjati deri në 3 të natës) dhe biseda e Çu En Lait me ambasadorin rumun në Pekin.

Del qartë se kinezët u ndodhën ngushtë ndaj nesh, prandaj na vunë në korent të këtyre bisedimeve dhe kontakteve, pse kishte mundësi që të na i mbanin të fshehta. **Qëndrimi i kinezëve përballë pikëpamjeve centriste e nacionaliste të rumunëve nuk është i drejtë, por i gabuar dhe oportunist.**

Rumunët, duke e vënë kinezët në korent për mosmarrëveshjet me Hrushovin, po tregohen si matamorë, «trima të tërbuar» kundër sovjetikëve, fodullë për «këtë trimëri» dhe kryelartë për «zgjuarsinë e tyre» dhe për këtë «zbulim sensacional» të një «vije të re» e «të drejtë». Është e vërtetë se me marifet rumunët po u bëjnë qejfin kinezëve, po luajnë telin që u pëlqen këtyre dhe bëjnë orvatje t'i tërheqin në disa veprime pajtimi me revizionistët e tjerë. I tillë është sugjerimi që u kanë

bërë, sipas të cilit, kur të shkojë Çu En Lai në Rumani, është mirë që të vejë më parë në Poloni dhe në Hungari. Përveç kësaj, në bisedën e Bodnarashit me ambasadorin kinez ne gjejmë «arsyen» përse kinezët e nënvleftësojnë tash rrezikshmërinë e Titos, pse Bodnarashi e paraqet Titon «kundërshtar të Hrushovit», sepse: «Titoja kundërshtoi Hrushovin për mbledhjen dhe për përjashtimin e Partisë Komuniste të Kinës nga kampi socialist e nga komunizmi ndërkombëtar», se «Titoja përkrah me dashamirësi Rumaninë» e të tjera profka dhe taktika djallëzore të Titos.

Siç duket, kinezëve u pëlqejnë këto koniunktura, ata u besojnë lehtë këtyre manovrave. Në bisedën e Dëzhit me ambasadorin kinez Titoja nuk zihet fare në gojë (s'është çudi të na e kenë hequr fare nga procesverbali këtë pjesë).

Qëndrimi i rumunëve është i qartë, por interesant është qëndrimi i Çu En Lait në bisedën me ambasadorin rumun, një bisedë në rrugë krejt të gabuar dhe nga pozita nacionaliste ndaj Bashkimit Sovjetik. Çu En Lai ngre përpara rumunëve rivendikime tokësore ndaj Bashkimit Sovjetik. Ai e akuzon Bashkimin Sovjetik (Leninin dhe Stalinin, pse në kohën e tyre janë bërë këto «grabitje», sipas Çu En Lait), se ka grabitur tokat kineze, japoneze, polake, gjermane, çeke, rumune, finlandeze etj. Nga ana tjetër, Çu En Lai u thotë rumunëve se bëjnë mirë të rivendikojnë tokat që u ka rrëmbyer Bashkimi Sovjetik.

Këto s'janë pozita marksiste-leniniste, po nacional-shoviniste. Pavarësisht se mund të jenë bërë gabime, por të ngrihen tash këto gjëra, kur përpara, në radhë të

parë, është lufta ideologjike kundër revizionizmit modern, do të thotë të mos e luftosh Hrushovin, përkundrazi ta ndihmosh këtë në rrugën e tij shoviniste. Hajde ç'vijë kanë këta kinezët! Nga një anë mbrojnë Stalinin, nga ana tjetër e bëjnë grabitqar. Nga një anë i thonë Hrushovit i dashuri «shok», dhe gjoja këtë e bëjnë për popujt sovjetikë, nga ana tjetër kërkojnë të copëtojnë Bashkimin Sovjetik. Ata harrojnë se të ngresh në këtë kohë rivendikime tokësore (goftë edhe sikur arsyet të jenë të plota, siç është çështja e Kosovës për ne), do të thotë të krijosh gjendje konflikti ushtarak.

Ne jemi kundër pikëpamjes së tradhtarit Hrushov për çështjen e kufijve, por dhe kështu si e shtron Çu En Lai, është krejt gabim. Ne nuk mund të pajtohemi me këto pikëpamje të shokëve kinezë, se janë antimarksiste.

Jo vetëm kaq, por kinezët, përveç kësaj, bëjnë edhe një gabim taktik të madh, që këto pikëpamje ua thonë rumunëve, i nxitin këta në rrugë të keqe dhe përpiqen t'i afrojnë me parime dhe me taktika të gabuara.

Tash kuptohet pse kinezët nuk duan që ne ta bëjmë bisedën që kemi vendosur me rumunët, pse ajo është në kundërshtim flagrant me pikëpamjet e kinezëve. Rumunët ne nuk i nxitim dhe nuk duam t'i afrojmë duke u bërë lajka ose duke u treguar oportunistë ndaj tyre, por duke ua thënë troç të vërtetën, parimet, rrugën e drejtë, politikën e drejtë, mbrojtjen e drejtë dhe të vendosur të marksizëm-leninizmit.

Rumunët në bisedat me kinezët as i ngrenë fare këto dhe s'kanë pse i ngrenë, se ideologjikisht janë në pozita revizioniste, titiste.

Kinezët gabojnë rëndë, ne duhet t'i ndihmojmë.

POGRADEC, E SHTUNË

22 GUSHT 1964

Sot vajtëm me shokët në rezervatin e gjahut të Maliqit. Atje qëndruam edhe për drekë.

Pasdreke shkuam në Korçë¹.

1. Po në këtë datë, autori ka hedhur në Ditar refleksione të cilat janë botuar në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 76, me titullin: «Lufta kundër hrushovizmit nuk duhet hallakatur në rivendikime territoriale».

KORÇË, E DIEL

23 GUSHT 1964

Ishim për piknik në Brozdovec. Në mbrëmje shëtitëm në kodra dhe në qytet.

POGRADEC, E HËNË

24 GUSHT 1964

U kthyem në Pogradec.

Shoku Manush, që kryeson delegacionin tonë në festimin e 20-vjetorit të çlirimit të Rumanisë, më njofton se u takua me G.G. Dezhin.

POGRADEC, E MARTE

25 GUSHT 1964

Takimin e Manushit me Dezhin mund ta konsiderojmë pozitiv. Rëndësi ka që ne i parashtruam atij pikëpamjen tonë. Ai nuk e priti atë keq dhe u tregua i kënaqur që ia thamë hapur. Ato që i thamë ai i konsideroi gjëra konkrete, që «shprehen miqësisht e jo prapa shpine». Dezhi ka thënë se mund të merremi vesh për shumë gjëra. U prek kur iu fol për sakrificën që mund të bëjmë ne, mjaft që ata të mos marrin kredi nga amerikanët.

Mendojmë se Dezhi do të na japë përgjigje mbi të gjitha çështjet, qoftë duke thirrur përsëri Manushin, qoftë më vonë me anë të ambasadorit, pse ato që i tha Manushit ishin pak dhe një përgjigje paraprake.

POGRADEC, E PREMTE

28 GUSHT 1964

Erdhi Manushi nga Bukureshti dhe më bisedoi se si shkuan punët në festën e rumunëve (20-vjetori i çlirimit). Çdo gjë e rregulluar në mënyrë që të binte zilja revizioniste. Pajtim dhe asnjë shenjë gjallërie. Dezhi e priti dy herë. Herën e parë për vizitë protokollare dhe herën e dytë për komunikimin që i bëmë. Këtë e dëgjuan me vëmendje ai dhe Bodnarashi dhe u detyruan ta dëgjonin bile deri në fund, saqë vajtën me 5 minuta vonesë në manifestim. Dezhi i tha se «është mirë që na flisni hapur dhe kështu duhet» dhe se «do të kemi rastin të bisedojmë». Por më s'u bisedua asgjë. Ceremonitë u zhvilluan ashtu si i parashikuam. Kinezi takohej me dashamirësi të madhe me rumunët, sikur s'kishte ngjarë gjë me ta. Paraqitje krejt revizioniste e çështjeve nga ana e gjeneral Salazhanit¹.

1. Leontin Salazhan, në atë kohë ministër i Mbrotjtjes i Rumanisë.

POGRADEC, E DIEL

30 GUSHT 1964

Vajtëm në Mokër për festë tok me djemtë. Që në kohën e luftës s'kisha qenë në këtë krahinë me tradita luftarake, prandaj ndjeva një kënaqësi të madhe sot, se u takova me shumë shokë të luftës, me popullin heroik, bujar dhe besnik të Mokrës. Pashë përsëri i mallëngjyer fshatrat, malet, grykat, rrugët e monopatet nëpër të cilat kisha kaluar në kohën e luftës. Isha i emocionuar, por edhe kurioz, që të provoja forcën e kujtesës sime për vendet e ndryshme: a do t'i gjeja ato përsëri ashtu si i kisha fotografuar në kujtesën time 20 vjet më parë? Sigurisht malet, gërxhet, pyjet ishin po ato, por në fshatra e kisha të zorshme të gjeja shtëpitë ku isha strehuar, sheshet ku u flisja popullit dhe partizanëve, se gjatë këtyre 20 vjetëve ishin ndërtuar shtëpi të reja, shumë shtëpi ishin mbuluar nga pemët, nga pjergullat, të tjera ishin meremetuar e lyer, sheshet ishin zënë me ndërtesa ose ishin bërë kopshte. Por zemra e popullit dhe imja s'kishin ndryshuar, kujtimet më vlonin në kokë me vrull, kur shikoja fshatrat, veshët më buçisnin nga kujtimi i jehonës së këngëve të dikurshme partizane. Ja, si tani më kujtohet takimi

në Sllatinë me Reshitin, Heroin e Popullit, biseda e përzemërt me të, pranimi i menjëhershëm prej tij i direktivave që i dhashë për të forcuar batalionin dhe për të shpeshuar aksionet. Ishte shok i zgjuar, i hedhur dhe i vendosur deri në fund për çështjen e popullit. Ndjeva përsëri hidhërimin e atyre çasteve kur mora vesh vdekjen e Reshitit dhe shkova në Mokër për zëvendësimin e tij me Ethem Haxhiun, fshatar trim nga Çezma. M'u kujtua pjekja dhe biseda me këtë luftëtar e patriot të thjeshtë, që me modesti e me besim, pranoi komandën e forcave të Mokrës si zëvendëskomandant i batalionit, deri në emërimin e Suat Leskovikut. Por edhe Ethemi na u vra në luftë.

Pas vrasjes së Muharrem Çollakut, përsëri u ktheva në Mokër për t'u pjekur me shokun Zyko Kalivaçi, të cilit i besova komandën e batalionit. Besimi im ishte i plotë për Zykon, që ai do ta kryente me nder detyrën e ngarkuar. Dhe kështu ngjau. Zykoja e meritoi besimin e dhënë. Ai luftoi heroikisht deri në fund dhe tash në pension është një nga njerëzit e mirë të Partisë.

Të gjitha këto, e shumë kujtime të tjera, më mbushnin zemrën dhe mendjen time, derisa arrita te çezma ku piva ujë dhe freskova fytyrën si atëherë kur isha partizan me fytyrën tërë djersë e pluhur dhe me këmbët e lodhura nga rrugët e mbirrugët, nga udhëtimet, ditën dhe natën. Po sa momente madhështore.

Në Pleshisht ishin mbledhur populli, luftëtarët e vjetër plot dekorata e plagë në trup nga plumbat. Momente prekëse. Fola në mitingun e organizuar me rastin e përvjetorit të 20-të të çlirimit të rrethit të Pogra-

decit¹. Të gjithë, të gëzuar më dëgjuan me vëmendje. Në drekë sollëm ndër mend kujtimet e luftës, thamë anekdota dhe kujtuam episodet e asaj kohe heroike. Ishte një kënaqësi e madhe për të gjithë. Kënduam këngë mokratçe për luftën, për heroizmat e popullit, për trimat që ranë, për Partinë, për jetën e re e për të ardhmen. U hodhën valle si në kohën e luftës. Dielli përvëlonte, por as që donim t'ia dinim, i tillë ishte gëzimi në këtë ditë feste. Dolëm në fotografi e në film dhe u ndamë me shokët e Mokrës, duke marrë me vete kujtime të shumta, të paharruara.

Njerëzit në këtë krahinë malore punojnë e luftojnë për rezultate sa më të mira. Kjo krahinë ka bërë shumë përparime ekonomike dhe kulturore. Akoma më shumë do të bëjmë për krahinën heroike të Mokrës.

Rrugës për në Pogradec u ndala në spitalin e Trebinjës. Bisedova me mjekun e me maminë, me infermieret e me të sëmuret.

E ndiej veten shumë të gëzuar, se populli është i lumtur dhe e do me gjithë shpirt Partinë tonë heroike.

Lexova fjalimin e plotë që mbajti Dezhi në mbledhjen solemne, me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të Rumanisë. Fjalim i shkurtër, i shpëlarë, rreshtim i një historiku, pa brendi, pa ngjyrë, pa zjarr. Krejt e kundërta e një fjalimj revolucionar. Nuk kishte në atë fjalim asnjë ide kardinale ku mund të qëndroje dhe të reflekteje. I tëri ishte hartuar me kujdesin maksimal

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 246.

që gjithçka të qe me të vërtetë asnjëherë, bajate, pa qëndrim, ose më drejt, me një qëndrim krejt oportunisto-revizionist.

Fjalimi i Dezhit pasqyrore qederin e udhëheqjes rumune që edhe manifestimet të zhvilloheshin si sahat, edhe qetësia e ujit të ndenjtur në moçal të mos prishej. Siç më bisedoi Manushi, edhe pritjet e të gjitha delegacioneve ishin organizuar njëjloj: të njëjtët njerëz në pritjet, të njëjtët flamurë, të njëjtat parulla, të njëjtët terma të komunikatave të ndryshme.

Me qëllim që të mos «u shkaktosheshin kontradikta» gjatë përshëndetjeve dhe duartrokitjeve, çështja paska shkuar deri atje sa rumunët e kishin rregulluar sallën në mënyrë që njerëzit nuk u ngritën në këmbë as për Dezhin, kur ky shkoi në tribunë të fliste. Kështu që «problemi u zgjidh» edhe për delegacionet e huaja. Nuk u ngrit e s'mund të ngrihej dot askush në këmbë. Kjo, natyrisht, ishte edhe ofezë për delegacionet e ftuara, por rumunët preferuan më mirë këtë sesa të prishnin qetësinë e batakut.

Në fjalimin e tij bajat Dezhi nuk përmendi asnjëherë as imperializmin amerikan. Del, pra, se qederin e rumunëve është që jo vetëm të mos ngrihen kontradiktat që ekzistojnë në mes nesh dhe revizionistëve modernë, por, po të jetë e mundur, të shuhen edhe kontradiktat tona me imperializmin amerikan. Vetë Dezhi, këto kontradikta «i shoi». Paqe me të gjithë, grurë me të gjithë. Kjo është shumë e keqe, është shenjë që tregon se do ta kemi të vështirë punën bindëse me ta.

Nga shkëmbimi i disa fjalëve në mes Manushit dhe Salazhanit (ministri rumun i Mbrojtjes), vërtetohet që-

ndrimi «pacifist», neutral i udhëheqjes rumune. Salazhani i tha Manushit se Hrushovi s'është tradhtar dhe se në Jugosllavi ndërtohet socializmi! Kur Manushi nisi t'i shfaqte mendimin e tij të kundërt, ministri rumun e ndërpreu: «Më mirë hajde të fillojmë të hamë sesa të vazhdojmë, sepse s'jemi në një mendje».

Natyrisht, ky Salazhan, kështu si mendon e vepron, është një patëllxhan, por sidoqoftë, është anëtar i komitetit ekzekutiv të partisë rumune dhe ministër i Mbrojtjes i Rumanisë. Si i tillë, ato çka ai tha, janë, pa dyshim, edhe mendimet e udhëheqësve të tjerë, ose në të kundërt, në udhëheqjen rumune ç'mendon njëri, s'mendon tjetri.

Sidoqoftë, vija e rumunëve është e djathtë. Kjo vijë është kundër Hrushovit nga pozita jomarksiste-leniniste dhe, si e tillë, ka tendencë të kristalizohet në një korrent krejtësisht revizionist, që të jetë edhe në aleancë me revizionistët sovjetikë, por njëkohësisht edhe «e pavarur» prej tyre. Ky korrent, mendoj unë, përmbledh Titon, rumunët, polakët dhe hungarezët. Titoja manovron me kujdes në këto ujëra me qëllime centrifugale dhe egocentrike. Natyrisht blloku revizionist, si një i tërë, do të ekzistojë, por me kontradikta të theksuara.

Kampi revizionist ka hyrë, pra, në momentin e timit të pulseve, të baticave dhe të zaticave, të përparimit dhe të tërheqjeve. Po çahen rrugë «të reja» dhe po ndërtohen taktika «të reja». Prandaj edhe qëndrimi i Dezhit ndaj ekspozesë që i bëri Manushi mbi qëndrimet tona principiale ishte korrekt, i rezervuar dhe të për i kujdesshëm. Ai nuk u prononcua për asnjë pro-

blem (mundet që s'kishte edhe kohë), por fakti është se Manushi u largua nga Bukureshti pa marrë ndonjë përgjigje.

Vetëm duhet të themi se mendimet tona ata i vlerësuan, kuptohet, pa i aprovuar, i konsideruan ato konkrete dhe premtuan se do të diskutojnë me ne. Kjo është pozitive, prandaj ne bëmë mirë dhe vepruam drejt që ua thamë hapur mendimet tona.

Mendoj se nga pikëpamja marksiste, taktika që ndjekin kinezët për të afruar rumunët, nuk është fare e drejtë dhe kam bindjen se, kështu siç po vepronë, nuk do të kenë sukses. Natyrisht, me atë taktikë në diçka edhe mund të arrihet, por kjo do të ndodhë në rast se vetë kinezët do të ndjekin rrugën e rumunëve. Por besoj se këtë kinezët nuk do ta bëjnë, prandaj, shpejt ose vonë, ata do të ndërrojnë mendimin që shfaqën se ne (shqiptarët) po shpejtohemi dhe mund të zemërojmë rumunët.

Në festën e Rumanisë edhe delegati i Kinës, Li Hsien Nieni, na e theksoi se kontradikta në mes nesh qëndron në taktikën e veprimit, kurse qëndrimet tona, në thelb, i quajti të drejta.

Kështu qoftë! Por ne jemi të bindur se, fakti që ua thamë hapur rumunëve ç'mendonim, është një veprim i mirë, i nevojshëm dhe plotësisht i drejtë.

Mendoj se rumunët e kishin të vështirë të angazhoheshin me ne për të na dhënë një përgjigje të shpejtë dhe të parratur mirë nga ana e tyre. Kjo neve na pëlqeu, pse, thjesht shtruarja e pikëpamjeve tona për çështje më kardinale ideologjike në udhëheqjen e tyre

është një sukses, pa marrë parasysh se çfarë do të mendojnë dhe si do të na përgjigjen.

Tash të ndjekim me kujdes zhvillimin që do të ketë ky problem si nga ana e kinezëve, ashtu edhe nga ana e rumunëve.

E HËNE
31 GUSHT 1964

U ktheva në Tiranë nga Pogradeci. Mbaruam pushimet.

POGRADEÇ
GUSHT 1964

Revizionistët sovjetikë janë angazhuar botërisht për mbledhjen përgatitore të partive revizioniste në dhjetorin e ardhshëm. Është angazhuar pra botërisht prestigji i tyre. Partitë që i pasojnë, për të tretën a për të katërtën herë, po angazhohen dhe po bëjnë deklarata të veçanta për këtë mbledhje.

Por është e qartë se për këtë mbledhje nuk ka unanimitet në mes revizionistëve. Sovjetikët iu futën një aventure që është në favorin tonë dhe në disfavorin e tyre.

Neve na intereson shumë që ata ta bëjnë mbledhjen pa ne, kurse atyre nuk u intereson, ca më shumë nuk u intereson që të bëjnë një mbledhje pa ne dhe pa pjesëmarrjen e disa partive revizioniste.

Titistët, për arsytet e tyre, janë kundër mbledhjes. Rumunët deri tash kanë deklaruar se nuk do të venë në një mbledhje të tillë, ku të mos jemi edhe ne. Italianët, po ashtu, deri tani kanë deklaruar se janë kundër mbledhjes, kurse polakët hezitojnë. Pra krizë për këtë mbledhje. Në rast se kjo krizë thellohet, atëherë revizionistëve sovjetikë u mbeten dy rrugë: ose të vazhdoj-

në të punojnë për ta realizuar mbledhjen, gjë që do të jetë vetëvrasje për ta, ose të heqin dorë duke e shtyrë. Prapë edhe kjo do të jetë vetëvrasje, dhe njëkohësisht turp për ta. Por nga halli ata e hanë turpin me bukë. Veçse prestigji i tyre është përtokë. Nëse partitë që përmenda më lart nuk do të shkojnë në mbledhje, mendoj se sovjetikët nuk do ta bëjnë, por do të përgatitin ndonjë manovër tërheqjeje.

Rumunët mund ta udhëheqin këtë manovër tërheqjeje, duke sugjeruar «miqësinë» me kinezët dhe me ne, fillimin e marrëdhënieve «të mira» dhe, në këtë pikë, duhet të «vazhdojnë» të punojnë në drejtimin tonë për zbutje. Duke vënë përpara këtë argument, ata do të kërkojnë që sovjetikët të mos ngulin këmbë për mbledhje. Në këtë manovër ata do të mbështeten nga Titoja dhe nga Gomulka. Sigurisht, rumunët do të sugjerojnë që Mikoja të shkojë në festën e kinezëve në tetor, ku të flasë si në Rumani, dhe kinezët, nga ana e tyre, mundësisht të mos ngrenë divergjencat.

Mund të kërkojnë të përcaktohet edhe data e një bashkëbisedimi në mes kinezëve dhe sovjetikëve, këtë ta konsiderojnë si një sukses dhe të mbështetin tërheqjen nga mbledhja që kanë projektuar.

Deklarata e Partisë Komuniste të Zelandës së Re që thotë në substancë se në rast se sovjetikët do ta bëjnë mbledhjen, atëherë edhe partitë tona duhet të mbli-dhen, megjithëse si propozim është i drejtë, më duket s'ishte me vend të bëhej, për arsye se sovjetikët apo revizionistët që s'duan të venë në mbledhjen e dhjetorit, do ta përdorin atë si shantazh e kërcënim kundër Hrushovit, që ta shtyjë mbledhjen. Dhe në fakt, në

njëfarë mënyre, deklarata e zelandezëve është një shantazh për mbledhjen.

Sigurisht që ne do të kemi rast të bëjmë mbledhje, ata e dinë një gjë të tillë, por ne pse ta themi, pse t'i ndihmojmë që të tërhiqen? Ne duhet t'i shtyjme ata që ta bëjnë mbledhjen e tradhtisë, të përçarjes, pse ata e filluan, e vazhduan dhe tash ta konsumojnë plotësisht atë. Të demaskohen plotësisht tradhtarët. Ky do të jetë një shërbim i madh për lëvizjen komuniste botërore. Prandaj ne duhet të jemi vigjilentë dhe të bëjmë që kjo manovër e revizionistëve të dështojë.

POGRADEC
[GUSHT 1964]

Hrushovianët po përpiqen të bëjnë mbledhje të partive

(Shënime)

I. Qëllimi i fushatës së grupit hrushovian për të angazhuar një numër partish komuniste dhe punëtorë të botës për bërjen e një mbledhjeje të tyre, nën udhëheqjen e grupit hrushovian dhe me një rend dite të caktuar nga ky grup.

a) Të çirren zyrtarisht Deklaratat e Moskës të viteve 1957 dhe 1960 dhe të hartohet një kartë e re, revizioniste.

b) «Të përjashtohen» nga lëvizja komuniste ndërkombëtare «dogmatikët» dhe «trockistët» e rinj për të qëndruar brenda oportunistët dhe trockistët e vjetër, të gjallë dhe të vdekur.

c) Të futen në lëvizjen komuniste ndërkombëtare tradhtarët titistë dhe të gjithë ata që vetëquhen socialistë.

ç) Të likuidohet kampi i socializmit si «ndodhi sek-

tare» që nuk u përgjigjet momenteve dhe pikëpamjeve të tyre revizioniste, për arsye se socializmi, sipas tyre, është bërë ide e masave dhe e shteteve borgjeze kapitaliste dhe në këtë drejtim të shturim marksizëm-leninizmin dhe principet e tij bazë të palëvizshme.

d) Të shkelmohen të gjitha parimet e marrëveshjeve dhe të aleancave që bënin forcën e kampit tonë socialist, në të gjitha fushat dhe të krijojnë aleanca të reja, antisocialiste në formë dhe në esencë, për të zhvilluar më me lehtësi integrimin botëror të socializmit në kapitalizëm, për të degjeneruar më shpejt shtetet socialiste në shtete borgjeze.

dh) Të forcohet dhe të përjetësohet në një fuzion parimesh aleanca dhe shkrirja e revizionistëve modernë me socialdemokracinë botërore, për të krijuar një bllok të ri në botë, të ashtuquajtur socialist të unitetit të klasës punëtorë botërore, për përjetësimin e «bashkekzistencës» të borgjezëve me njëri-tjetrin në kurriz të punëtorëve dhe të popujve të shtypur.

e) Të krijohet kështu një aleancë e shenjtë e borgjezisë kundër marksizëm-leninizmit, kundër komunizmit ndërkombëtar, kundër partive komuniste e punëtorë të botës dhe vendeve socialiste që i qëndrojnë besnike marksizëm-leninizmit.

II. Për t'i arritur këta objektiva dhe të tjerë të kësaj lloji revizionistët modernë, me në krye grupin e Hrushovit:

a) Zhvilluan në ethe një propagandë shpifëse dhe mashtruese kundër marksizëm-leninizmit dhe vendeve që qëndronin në pozita të drejta.

b) Vepruan intensivisht dhe çanë kampin e socializmit.

c) Angazhuan dhe komprometuan shumë udhëheqës të partive komuniste e punëtore të botës në rrugën e tyre tradhtarë.

c) Diktaturën e proletariatit dhe armët e saj i kthyen në armë terrori dhe shtypjeje për marksistë-leninistët dhe për popullin.

d) Grupi i Hrushovit dha sinjalet dhe realizoi aleancat me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në shembullin e tij dhe sipas direktivës së Kenedit, shumë vende të demokracisë popullore të Evropës kanë kthyer kursin e tyre ekonomik-politik drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe perëndimorëve. Pikëpamjet e tyre revizioniste s'kanë ku i çojnë gjatë.

Ky komplot i madh në shkallë botërore që po zhvillojnë imperialistët, socialdemokracia dhe revizionistët modernë me në krye Hrushovin, etapë pas etape, duhet të sanksionohet me veprime të reja, me demagogji të mëtejshme.

Mbledhjen në fjalë të grupeve revizioniste në botë, tash që Nikita Hrushovi i angazhoi zyrtarisht, do ta thërresin në pragun e një tradhtie të re që po përgatitet dhe që i duhet Hrushovit ta trumbetojë si një sukses të ri. Borizanët revizionistë po mbushin gjokset me frymë, për të ekzekutuar himnin e tradhtisë, kur të urdhërojnë shkopi i dirigjentit.

— Detyrat e marksistë-leninistëve përpara këtyre evenimenteve.

— Metodrat e luftës së tyre. Unitet veprimi kundër këtij koalicioni, armik i paqes dhe i socializmit,

Lufta jonë kundër revizionizmit modern do të përfshijë aspekte nga më të ndryshmet dhe kjo do të varet nga format që do t'i veshë vetes vetë revizionizmi, nga taktikat e ndryshme që ai do të përdorë në momente të caktuara, në kohë dhe në vende të ndryshme.

Çështja vendimtare këtu është që, si Partia jonë, ashtu dhe çdo parti tjetër marksiste-leniniste, të mbrojnë me vendosmëri parimet e marksizëm-leninizmit, të mos mashtrohen e të mos zihen kurrë në befasi. Që të bëhet kjo, duhet që këto parime të kuptohen nga të gjithë dhe të rrënjosen thellë, në mënyrë që ideologjia jonë udhëheqëse të jetë për këdo një busull e pagabueshme, në çdo situatë e në çdo rrethanë, për problemet e brendshme kombëtare dhe për ato ndërkombëtare.

Në këtë drejtim edukimi ideologjik i shokëve tanë është një problem kapital e i vazhdueshëm, i cili kurrësi nuk duhet të bëhet në mënyrë skolare e në forma të ngushta recetash, por i lidhur me ngjarjet e jetës, me transformimet që ndodhin, me procesin dinamik, materialist të zhvillimit të shoqërisë.

Ky edukim i shëndoshë do të bëjë që, qëndrimet parimore të Partisë sonë në luftën për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të mos jenë asnjëherë stanjante, por, ashtu si gjer më sot, të jenë qëndrime të zhdërvjellëta e revolucionare, që nuk u adaptohen e nuk u nënshtrohen situatave dhe qëndrimeve që shfaqin armiqtë tanë, por i parashikojnë me largpamësi manovrat dhe taktikat e armiqve dhe u dalin atyre përpara me një taktikë të vërtetë luftarake.

Ne nuk duhet të lejojmë kurrë që Partia jonë të sakrifikojë për «hijen», domethënë që, për një manovër

ose taktikë djallëzore të revizionistëve, në dukje «simpatike», të mashtrohet e të bjerë në gjumë, ose të jetojë me shpresa «të zvarura». Jo, partia duhet të jetë kurdoherë vigjilente e të gjejë mënyrën më të përshtatshme për të vepruar drejt, shpejt dhe në mënyrë të matur e të peshuar në çdo situatë e para çdo problemi. Aksioni i partisë duhet të jetë kurdoherë i efektshëm, goftë tani, goftë në të ardhmen.

Është fakt se udhëheqja rumune aktualisht po mban një qëndrim anti-Hrushov. Natyrisht ne duhet të punojmë në drejtim që, kjo «grindje» në mes revizionistëve, të thellohet dhe kështu të demaskohen veprimet e hrushovianëve. Por të mashtroresh nga kjo «grindje» dhe, për hir të saj, të harrosh qëndrimet e tjera jo të drejta të rumunëve, të heshtësh për to për shumë kohë ose për një kohë relativisht të gjatë, kjo është fund e krye gabim.

Në mënyrë të organizuar ose jo, revizionistët do të përpiqen të gjejnë forma të ndryshme e të krijojnë lloj-lloj grupimesh e sektesh, ndaj të cilëve ne, për arsye taktike, në momente të caktuara për njërin ose për tjetrin, mund edhe të heshtim. Por një gjë duhet ta kemi kurdoherë të qartë: kontradiktat në mes revizionistëve do të acarohen, do të marrin forma nga më të ndryshmet, veçse te të gjithë esenca mbetet e do të mbetet po ajo — lufta kundër marksizëm-leninizmit. Revizionizmi lindi policentrizmin dhe ky do të zhvillohet në mënyrë të natyrshme në vendet ku revizionistët janë në fuqi. Nesër, kështu si sot rumunët, por për «arsye të tjera» dhe në forma joanaloge, mund të dalin edhe revizionistët polakë, pasnesër revizionistët hunga-

rezë, e kështu me radhë. Natyrisht, ne duhet të përfitojmë nga këto kontradikta midis tyre, do të ndjekim taktika të shkathëta e largpamëse, por jo të harrojmë luftën tonë parimore kundër të gjitha formave të revizionizmit.

Kush më shpejt, kush më vonë, revizionistët modernë do të fitojnë pavarësinë nga grupi hrushovian dhe, si revizionistë që janë, do të mbajnë edhe qëndrime të përbashkëta, por edhe të veçanta. Këto qëndrime të veçanta të revizionistëve nuk duhet kurrsesi të na mashtrojnë dhe të mendojmë se në ta është arritur diçka pozitive. Jo, «të veçantat» në stanin revizionist janë shprehje e procesit të plotë të dezintegritimit, të shpartallimit të kampit socialist nga ana e revizionistëve modernë.

Prandaj kurrë nuk duhet të ekzistojë besimi i verbër ndaj revizionistëve që gjoja bëjnë «kthesa». Çdo gjë duhet të gjykohet me gjakftohtësi, në bazë të analizës leniniste të gjendjes, pa marrë zjarr të pamotivuar optimizmi. Duhet të ecet me shumë kujdes, në rrugë të drejtë; të ndihmohen për t'u ndrequr ata që mund të ndreqen dhe të luftohen pa mëshirë të pandreqshmit. Të mësohemi të dallojmë mirë ata që bëjnë kthesë të sinqertë, që vijnë me të vërtetë në rrugë të drejtë gradualisht, nga ata që në «kthesat» e tyre s'kanë asgjë marksiste. Naiviteti në mbrojtjen e parimeve është i dëmshëm. Verbëria dhe zvarritja në mbajtjen e qëndrimeve të drejta ndaj vickave të revizionistëve janë të dëmshme, lejojnë qëndrime oportuniste, lënë të trashet rreziku, të bëjnë të veprosh me hope, sipas rrethanave që të imponon armiku.

E MERKURE

2 SHTATOR 1964

Shkruam në pritjen e dhënë nga ambasada vietnameze për festën e 19-vjetorit të themelimit të Republikës Demokratike të Vietnamit. Ambasadori ka ardhur i ri dhe duket i ri. Foli mirë. Mundet që këto janë diskutimet e tij të para, të përgatitura për rrethanat e paraqitjes, pse ai foli edhe kundër Hrushovit. Mirë, po pastaj u mbyllet goja.

E PREMTE

4 SHTATOR 1964

Mbledhja e organizatës-bazë. Shokët vijnë të përgatitur mirë në mbledhje. Kjo duket qartë në diskutimet e tyre.

* U dhamë kinezëve përgjigjen¹ lidhur me çështjen e ftesave për festën e 15-vjetorit të themelimit të republikës së tyre. Në përgjigje i kritikonim rëndë, por drejt, pse po bëjnë gabime trashanike dhe të palejueshme.

... U shkruam se ne nuk e gjejmë të drejtë vendimin që në festën e madhe të 15-vjetorit të themelimit të Republikës Popullore të Kinës, ku do të marrin pjesë miq të shumtë të Kinës, të përjashtohen përfaqësuesit zyrtarë të popujve më besnikë të popullit kinez, përfaqësuesit zyrtarë të partive komuniste e punëtoresh që qëndrojnë në pozita revolucionare marksiste-leniniste dhe që luftojnë kundër armiqve më të egër, impe-

1. Shih shënimin e plotë të kësaj date, botuar në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 79.

rializmit botëror dhe agjentëve të tyre, revizionistëve modernë. Ky është një veprim që në këto momente asnjë rrethanë taktike, dhe sidomos taktike e brendshme në mes partive tona, nuk mund ta justifikojë. Këtë gjë nuk do ta kuptojnë as populli, as Partia jonë. Por edhe në rastin ekstrem, në qoftë se ne do t'u themi «arsyet» që ju ju shtypnë të merrni këtë vendim, ju sigurojmë se ata prapë nuk do t'i kuptojnë.

Ne mendojmë, se edhe popullit vëlla kinez, edhe komunistëve kinezë, nuk do t'u vijë mirë kur të shohin se miqtë e tyre më të ngushtë nuk ndodhen në festën e tyre të madhe.

Ne mendojmë, nga ana tjetër, se për opinionin botëror kjo do të jetë një gjë e habitshme, e pakuptueshme dhe do të interpretohet sipas qejfit në shumë mënyra...

Mund që udhëheqësve kinezë nuk do t'u pëlqejë aspak kritika jonë, por neve aq na bën, pse, e përsëris, është gabim që në festën e tyre të ftohet vetëm Rumania. Kjo do të thotë të zësh botërisht një pozitë centriste.

Të thërresësh në festën kombëtare shtete dhe parti është një çështje politike dhe jo çështje private, sikur Maoja të ftonte një person, pse, fjala vjen, marton djalin. Ky veprim i shokëve kinezë nuk duket i rastit dhe i pamenduar, dardha e ka bishtin prapa. Të presim dhe të shikojmë.

E MARTE

8 SHTATOR 1964

Teza për një artikull¹

I. Platforma e luftës e udhëheqjes së Partisë Komuniste Italiane, e bazuar në policentrizmin e Toliatit.

II. Platforma e luftës egocentriste, dogmatike, diktatoriale e grupit të Nikita Hrushovit dhe e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

— Në fakt në «testamentin»² e tij të Jaltës, Palmiro Toliati vazhdon të mbrojë planin e tij të rrëzuar nga plani i luftës hrushoviane, vazhdon të mbështetë atë

1. Këto teza janë përdorur nga autori për artikullin e tij ««Testamenti» i P. Toliatit, kriza e revizionizmit modern dhe lufta e marksistë-leninistëve», botuar në gazetën «Zëri i popullit» më 13 nëntor 1964. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 114.

2. Në gusht të vitit 1964 P. Toliati shkroi promemorjen «Mbi çështjet e lëvizjes punëtore ndërkombëtare e të unitetit të saj» e cila u cilësua nga shtypi perëndimor si «testamenti» i tij. Ky «testament» përshkohet fund e krye nga shtrembërimi i marksizëm-leninizmit dhe pasqyron vijën e «socializmit italian» dhe teorinë e «policentrizmit italian».

dhe ta lërë si «vasijet» për Partinë Komuniste Italiane, e cila e adoptoi si të vetmen rrugë veprimi në të ardhmen. Gjithashtu, Toliati në «testamentin» e tij predikon se taktika italiane e luftës kundër marksizëm-leninizmit është më e mira dhe pra i gjithë ky «testament» nuk është veçse një kritikë e ashpër dhe e gjithanshme e taktikës së luftës së adoptuar nga Hrushovi kundër marksizëm-leninizmit dhe të gjitha partive marksiste-leniniste që qëndrojnë në pozita të drejta.

— Nën këtë prizëm ne duhet të shikojmë disfatën e luftës së revizionistëve, disfatën hrushoviane, disfatën e taktikës së Toliatit, dhe të çdo taktike të re revizioniste të shartuar.

— Taktika dogmatike-revizioniste e grupit të Hrushovit ka në vetvete farën e përçarjes së frontit revizionist, që do të sjellë, dhe bile ka sjellë, izolimin e këtij grupi nga grupimet e tjera revizioniste.

— **Taktika policentriste-revizioniste e Toliatit predikon shpartallimin e «komandës unike» në luftën kundër marksizëm-leninizmit revolucionar, gjë që përmban farën e përçarjes të grupimeve revizioniste dhe pra të shpartallimit të tyre.**

— Taktika e luftës e grupit të Hrushovit është politika e «grushtit mbi bankë» ndaj revizionistëve të tjerë, e bindjes pa kondita të këtyre të fundit ndaj tij dhe e pranimit, e aprovimit në gjuhë të politikës *en bloc* të një shteti të fuqishëm shovinist dhe të një «partie të madhe mëmë», pra të një politike paternaliste.

— Taktika policentriste e Toliatit është shprehja tipike liberale, oportuniste, antimarksiste, socialdemokrate, e një politike që do të heqë qafe çdo imponim

revizionist nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe grupi i Hrushovit dhe jo vetëm për Partinë Komuniste Italiane, por për të gjitha partitë komuniste e punëtoresh të tjera.

— Për Toliatin, Moska nuk mund dhe nuk është më në gjendje të drejtojë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

— Hrushovi nuk mund ta pranojë këtë disfatë.

— Toliati propozon disa qendra udhëheqëse: Partinë Komuniste Italiane, Partinë Komuniste Franceze, Partinë Komuniste të Spanjës dhe Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Do s'do, ai pranon se ekziston dhe udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës.

— Toliati nuk u lë «privilegjin» Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe qeverisë sovjetike që këta të jenë të vetmit të autorizuar të mbajnë lidhje me partitë komuniste e punëtoresh të vogla dhe të bëjnë mbledhje e të japin direktiva *ex cathedra*, bile nuk u lë privilegjin që vetëm këta të kenë lidhje, të bëjnë politikë me elementët jokomunistë, nacionalistë, qeveritarë, progresistë.

— Hrushovi natyrisht i shkelmon këto pretendime të italianëve.

— Toliati e bën përgjegjës grupin e Hrushovit që shkakton lindjen e frymës nacionaliste në vendet ish-socialiste të Evropës dhe bën sikur u lë njëfarë autonomie veprimi këtyre vendeve. Në fakt, edhe Toliati e di që Hrushovi e ka humbur autoritetin këtu.

— Toliati pohon me plot gojën se lufta «parimore» e revizionistëve në të gjithë frontin ka pësuar disfatë, prandaj duhet të spostohet kjo luftë nga mbrojtja e

parimeve, në luftën e vogël të përditshme, konfuze, joparimore, të pakontrollueshme.

— Hrushovi, përkundrazi, mendon se degjenerimi duhet të vazhdojë, por i maskuar, me demagogji dhe nën formulimet e përgjithshme teorike revizioniste.

— Toliati e tmerron lufta e madhe parimore që bëjnë Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë e vërteta komuniste. Ai ka frikë nga uniteti parimor i marksistë-leninistëve në të gjithë botën (dhe ai e quan këtë një internacionale të re). Ai ka shumë frikë nga krijimi i partive komuniste të reja (dhe ai i quan këto seksione të kësaj internacionaleje të re).

— Hrushovi, po ashtu, është tmerrësisht i frikësuar nga ky koncentrim i forcave marksiste-leniniste.

— Toliati propozon forma të reja lufte për ta ndaluar ose për ta dobësuar këtë koncentrim, por në fakt, në vetvete, këto forma përmbajnë farën e dobësimit të punës revizioniste dhe ndihmojnë koncentrimin dhe shndërrimin e forcave revolucionare nga kuantiteti në kualitet.

— Hrushovi vazhdon metodën e vjetër të komandimit, të kërcënimit, të shantazhit, të korrupsionit të krerëve të partive revizioniste. Ai vazhdon të luajë «me numrin» e partive që hiqen me të, vazhdon të numërojë «deklaratat e solidaritetit të tyre», pa marrë parasysh se ato janë si kufoma të gjalla që nesër do të vdesin.

— Toliati mendon të vazhdohet polemika gjoja korrekte dhe jo brutale, kuptohet jorevolucionare, ose «parlamentare», siç e bëjnë ata me kundërshtarët në Itali dhe megjithëkëtë farë polemike të mos priten

urat me kinezët, për «kohët e këqija», për kohët e acarimit të situatave ndërkombëtare nga ana e «të tërbuarve» që ai i ka frikë. Këto ura duhet t'i ruajmë, thotë Toliati, se mund të «ndërrojmë këmishë» dhe «aleanca», taktikë kjo tipike e borgjezisë italiane, e cila në momentet decizive ka ndërruar aleancat si «mbreti gratë».

— Kurse Hrushovi kërkon të dominojë absolutisht, ai kërkon t'i presë të gjitha urat me Kinën, ai është i sigurt për aleancën që po ndërton me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ai s'ka frikë nga amerikanët, por në rast se këta shkojnë në aventura, Nikita do të shohë me siguri fundin e karrierës së tij. Limoni shtrydhet dhe flaket.

— Toliati kërkon liri për çdo parti dhe brenda-përbrenda partive, domethënë partitë të kthehen në parti socialdemokrate, ashtu siç është në fakt vija e tyre revizioniste-liberale. Këtu ai është konsekuent.

— Kurse Nikita Hrushovi, revizionist me damkë, s'do liri në parti, por bindje të verbër, diktaturë të sigurimit dhe të policisë, ai do degjenerimin e partisë në një armë policie. Kjo formë partie do të ketë sukses në vendet e ish-demokracisë popullore, ku janë në fuqi revizionistët, por s'mund të aplikohet dhe të zbatohet në partitë revizioniste të vendeve kapitaliste. Prandaj dy metoda ndërtimi dhe funksionimi të partive revizioniste, pse ka dy situata të ndryshme.

— Toliati, është e kuptueshme, s'është për mbledhje të partive, pse një mbledhje e tillë bie në kundërshtim me vijën e tij revizioniste, pse Hrushovi do të

ketë shumicën numerike dhe do të vendosë si do vetë, pra në kundërshtim me policentrizmin.

— Toliati s'do që të ketë përsëri, qoftë edhe një qendër formale — Moska.

— Hrushovi e do këtë dhe lufton ta mbajë gjallë.

— Toliati s'do të përjashtohen Kina dhe Shqipëria për arsyet që thamë.

— Hrushovi nxiton ta bëjë këtë për arsyet që thamë.

— Hrushovi do të vendosë një kartë të re të revizionizmit modern dhe t'i angazhojë të gjithë.

— Toliati nuk e do një kartë të tillë të formuluar sipas qejfit të Hrushovit dhe të «numrit». Tendenca e tij është të mos ecë pas një karte, qoftë ajo revizioniste.

— Toliati dëshiron që Hrushovi të bëjë disa autokritika, edhe për ta diskredituar për qëllimet e triumfit të vijës së tij, edhe për «leshkot» që mund të ekzistojnë në anën tonë, të cilët do ta quajnë Toliatin «realist».

— Mirëpo Hrushovi s'bën asnjë autokritikë, pse atëherë e mori lumi, u demaskua me gojën e tij.

— Toliati vazhdon tezën e tij që «sistemi sovjetik» lind kultin e personit dhe përpiket që këtë tezë ta pranojë Hrushovi dhe gjithë revizionistët e tjerë.

— Hrushovi publikisht nuk mund ta pranojë këtë tezë, pse atëherë mbaroi, ai e kundërshton në dukje, por në praktikë sistemin sovjetik e lufton, e zëvendëson, e shkatërron.

— Toliati kërkon haptazi që në vendet e demokra-

cisë popullore dhe në Bashkimin Sovjetik, në radhë të parë, të ketë në të gjitha fushat liberalizëm.

— Hrushovi është dakord dhe e bën këtë në praktikë në të gjitha lëmet e aktivitetit, por nuk mund ta pohojë dhe ta ngrejë hapur e në teori, pse do të gjejë kundërshtime brenda. Po e njëjta situatë është dhe në vendet e tjera «socialiste» ku janë në fuqi revizionistët.

— Toliati dëshiron që Bashkimi Sovjetik të thotë të vërtetën mbi realitetin ekonomik dhe të mos blofojë dhe këtë ai e lyp, jo për të qenë realist, por për ta diskredituar Bashkimin Sovjetik, sistemin sovjetik.

— Hrushovi s'mund ta bëjë këtë, megjithëse faktet flasin ndryshe. Ai rron me blofe, gjithë punën e bazon në blofe, ai erdhi në fuqi me blofe. Ai është personifikimi i blofizmit.

— Platforma politike dhe ideologjike e Toliatit ekzistonte edhe më parë, por kjo doli tash në plan të parë, për arsye se në mes revizionistëve u acaruan situatat në lidhje me mbledhjen që propozon Hrushovi.

— Për të mos folur për mbledhjen e përgjithshme të partive, për mbledhjen përgatitore, Nikita Hrushovi po pëson disfata dhe ka krijuar vështirësi:

1) Mosvajtja e partive tona marksiste-leniniste është një disfatë e madhe për ta.

2) Rumunët qosheve thonë se nuk do të venë, pa vajtur ne. Të shohim, se ka mundësi të adoptojnë taktikën italiane.

3) Titoja le që s'vete, por paraqitet kundër; ai do që rumunët të venë dhe të veprojnë si italianët, me të cilët duhet të jenë dakord.

4) Polakët, gjoja të zjarrrtë për mbledhjen, tash

s'po ndihen, ka mundësi më shumë të venë dhe atje të adoptojnë qëndrime centriste.

5) Italianët do të venë, por do të venë për të rishtruar platformën e Toliatit.

6) Numri i partive të tjera do të lëkundet si fletët e pemëve në erën e vjeshtës.

— Kështu që mbledhja përgatitore, nën frymën e dënimit të partive tona, do të bëhet një arenë debatesh, rivalitetesh të brendshme në mes revizionistëve dhe, për t'i fshehur këto rivalitete, për të shpëtuar situatën, atje mund të adoptohet propozimi italian, që mbledhja të pezullohet, të vejë një «komision partie në Kinë», të bisedojë me kinezët, mundësisht dhe me koreanët dhe me indonezianët; bisedime pas bisedimesh, hiq e mos e këput, jo dhe aq për të sheshuar divergjencat me ne, se ato nuk sheshohen, por më shumë për të maskuar divergjencat në mes tyre. Ose ka mundësi varianti tjetër, «grushti mbi bankë» i sovjetikëve; presionet, shantazhi dhe kavaleria sulmuese e rublave të hyjnë në veprim dhe të dalin me ato vendime që duan sovjetikët. Të na dënojnë ne kryesisht, pastaj «shkoni në shtëpi dhe bëni si të doni, të gjithë në një rrugë jemi, duke ndjekur gjithsecili nga një monopati të veçantë revizionist, piqemi në qafë me kapitalistët e me imperialistët amerikanë dhe me të tjerë si këta».

— Duhet që ne të luftojmë, që ana jonë të luftojë e vendosur për parimet, të mbajë pozitat e drejta të fituara dhe të sulmojë më tej me vull revizionizmin modern, që ka hyrë në rrugën e madhe të shkatërrimit. Të «butët» e anës sonë duhen forcuar, se mund t'u vijë për hosh taktika e djallëzuar e revizionistëve italianë

ose e centristëve revizionistë rumunë, që po luajnë si me thënë rolin e atij që «mban një dorë në bakllava dhe tjetrën në revani». Me të vërtetë komedi si në një panair. Por Partia jonë është dhe do të jetë shumë vigjilente dhe me qëndrimet e saj parimore marksiste-leniniste, burrërore, s'do të lërë asgjë të kalojë në thikën me dy presa, që më në fund të kthehet në thikë me një presë për të na goditur në befasi dhe prapa shpine ne dhe marksizëm-leninizmin.

— Më në fund, në «testament» shprehet urrejtja borgjeze nacionaliste italiane e Toliatit kundër Shqipërisë.

E MËRKURE
9 SHTATOR 1964

Ambasada koreane dha sonte një pritje për 16-vje-torin e shpalljes së RPD të Koresë. Shokët që morën pjesë në të më njoftuan se ndodhi i njëjti avaz, fjalë të mira nga ana e ambasadorit, por si kurdoherë të përgjithshme.

Të tërë evitojnë të flasin kundër Hrushovit, se sigurisht s'u vjen mirë. Megjithatë, le t'i regjistrojnë pikëpamjet tona, le t'ua raportojnë udhëheqjeve të tyre. Do të vijë dita që çdo gjë që kemi mbrojtur ne, do të vërtetohet. Revizionizmi dhe Hrushovi janë armiq të egër. Mjerë ata që nuk duan ose nuk guxojnë t'i luftojnë hapur!

E ENJTE
10 SHTATOR 1964

U bë mbledhja e Byrosë Politike, e cila vendosi që t'i dërgohet një letër KQ të PK të Kinës, në lidhje me deklaratën e Maos mbi kufijtë e shteteve¹.

1. Është fjala për mosmarrëveshjet kufitare kino-sovjetike. (Rreth tyre Mao Ce Duni kishte folur në një takim me socialistë japonezë.)

Letra e Komitetit tonë Qendror (10 shtator 1964) shpjegon qëndrimin parimor të PPSH lidhur me çështjen e kufijve ekzistues midis shteteve, si dhe mendimet e saj mbi pozitën e PK të Kinës për çështjen e kufirit kino-sovjetik.

1) Të sistemohen dokumentet që ekzistojnë në Ministrinë e Jashtme dhe në Arkivin e Shtetit.

Për këtë duhet të vendoset një plan shkencor (jo literaturë), domethënë të bëhet jo vetëm përcaktimi i një sistemi, por njëkohësisht edhe studimi i dokumenteve një nga një, duke i inkuadruar të sistemuara dhe me referenca e lidhje për çdo problem të veçantë, që studimeve në fjalë t'u referohesh lehtë.

Për çdo periudhë dokumenteve duhet t'u caktohen një sërë titujsh e nëntitujsh që të klasifikojnë problemet e periudhës (pavarësisht se për ndonjë titull, ose shumë tituj nuk ka dokumente të shumta, ose s'ka fare, këto do të plotësohen më vonë me dokumente që ndodhen jashtë Ministrisë së Jashtme dhe Arkivit të Shtetit).

Prandaj duhet të bëhet një punë e menduar dhe e organizuar mirë, e jo siç shtrohet në relacionin e Ministrisë së Jashtme. Duhet të hedhim bazat e një pune shkencore për sistemimin e dokumenteve, pa këtë nuk mund t'i hyhet punës për botime dokumentesh ose studime.

2) Dokumente ka kudo, por unë mendoj që Ministria e Jashtme nuk duhet t'i zgjatë krahët aq sa t'i këputen kyçet. Ajo duhet, në radhë të parë, të interesohej për dokumentet që ka brenda në ministri dhe për ato që ka Arkivi i Shtetit (është fjala për dokumente që lidhen me politikën diplomatike të shtetit shqiptar, kryesisht para Çlirimit).

Dokumentacionin që i përket politikës diplomatike të RPSH dhe që ndodhet në Ministrinë e Jashtme vetë kjo ministri duhet ta sistemojë, ta përgatitë dhe ta vërë në rregull.

Të gjithë këtë punë Ministria e Jashtme duhet ta bëjë me kuadrot e vet; edhe Arkivi i Shtetit me ata kuadro që ka ta bëjë (por këtyre duhet t'u jepen udhëzime të veçanta pune).

Gjatë kësaj pune përgatitore të domosdoshme, shkencore, do të dalin më drejt problemet dhe studimet që duhet të bëhen, ose të plotësohen ato që janë bërë, të shtypen të reja, ose të rishtypen të plotësuara ato që janë shtypur një herë.

Mund të përcaktohen edhe tema në skemën e «problemeve diplomatike», por ato mund të jenë si një objektiv i mëvonshëm, mund të shërbejnë si orientim në sistemin e klasifikimit të dokumenteve, ose mund t'i kenë parasysh ata që do të punojnë për këtë sistem apo klasifikim.

Instituti i Historisë së Partisë ose Universiteti kanë punën e tyre, planin e tyre dhe të mos konfondohet kjo punë me atë që duhet të bëjë Ministria e Jashtme, as me studimet e saj, të cilat duhet të kenë një karakter special. Këto studime, këto monografi dhe sido-

mos dokumente, do t'u shërbejnë shumë edhe universitetit, edhe Institutit të Historisë së Partisë ose çdo instituti tjetër të interesuar për këto probleme.

Duhet të evitohet çdo punë paralele, siç mund të ngjasë me mënyrën që propozon Ministria e Jashtme, e cila në studimet eventuale për problemet e diplomacisë të evitojë sidomos frazat boshe, propagandistike. Çdo gjë duhet të dalë koncize në bazë të dokumenteve.

Prandaj shokët e Ministrisë së Jashtme duhet ta rishqyrtojnë prapë këtë plan që kanë bërë, të caktojnë sa më parë detyra dhe të fillohet nga puna menjëherë.

Atyre t'u theksohet se Ministria e Jashtme duhet të mendojë seriozisht për këtë problem, se ajo ka përgjegjësi të madhe jo vetëm për dokumentet e kohës së paraçlirimit, por sidomos për ato të pasçlirimit. Pra çdo gjë duhet të jetë në rregull, e sistemuar, e studiuar etj., etj.

E MARTË

15 SHTATOR 1964

Bëmë mbledhjen e Sekretariatit. Shqyrtuam një numër problemesh:

1) **Përbërja e Partisë, pranimet dhe masat ndëshkimore.** (Na raportuan shokët e rretheve Durrës dhe Burrel).

Forcimin organizativ të Partisë e kemi pasur kurdoherë në qendër të vëmendjes. Shokët e Partisë në qendër e në bazë kanë zbatuar e po zbatojnë drejt vendimet e marra nga Byroja Politike dhe Sekretariati për këtë problem. Por si për çështjen e pranimeve në Parti e të shtrirjes së tyre, të masave ndëshkimore edhe për të gjitha çështjet e tjera organizative duhet reflektuar më shumë e më thellë. Tërhoqa vëmendjen¹, se me gjithë përmirësimet që janë vënë re, ndihet nevoja për një metodë pune sa më të zhdërvjellët e frytdhënëse nga ana e Drejtorisë së Organizimit pranë Komitetit Qendror dhe seksionet e organizimit në komitetet e Partisë.

2) **Puna mësimore-edukative me studentët.** (Ra-

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 257.

porti u paraqit nga Komiteti i Partisë i Universitetit të Tiranës).

Njerëzit e Partisë dhe rininë në universitet i kemi shumë të mirë. Megjithatë përsa i përket edukimit ka vend për një punë më të madhe me të rinjtë studentë dhe me pedagogët.

Edukimi i rinisë studenteske me dashuri të madhe për mësimin dhe për punën ka rëndësi të veçantë. Për këtë arsye nga organizata-bazë e Partisë dhe ajo e rinisë kërkohet një punë më e mirë.

Duke diskutuar¹ për këtë problem u ndala pak më gjatë në luftën e vazhdueshme që duhet bërë kundër disa shfaqjeve intelektualiste që vihen re.

Në këtë mbledhje u diskutua edhe për disa çështje të tjera, si për punën e komiteteve të Partisë në ndërmarje e kooperativa bujqësore², për problemin e madh të sigurimit të ujit³ si dhe për shtimin dhe për administrimin e drithërave të bukës⁴.

Lidhur me parullën vepruese të shokëve kinezë në luftën kundër revizionistëve modernë: «Hapin e parë ata, hapin e dytë ne», kam arritur në përfundimin se ajo nuk është e drejtë për të gjitha kohët, ashtu siç dëshirojnë ta zbatojnë ata në luftën kundër revizionistëve modernë. Prej disa ditësh po hedh në letër me-

ndimet e mia mbi këtë çështje. Sot përfundova një pjesë¹.

* Kjo parullë veprimi e shokëve kinezë kundër revizionistëve modernë jo vetëm **nuk është e drejtë për të gjitha kohët**, por, sipas mendimit tim, **s'ka asgjë revolucionare**. Ajo është një parullë pritjeje, frenuese dhe «ndërtim i veprimeve revolucionare e luftarake» sipas çapit të kundërshtarit. Me fjalë të tjera, duhet të numërosh në vend derisa kundërshtari të hedhë çapin e tij dhe ti ta rregullosh çapin, natyrisht me një vonesë dëshpëruese (siç veprojnë shokët kinezë), sipas daullës së armikut. Në qoftë se daullja e armikut bie fort, taktika e kinezëve është që daullja e tyre të bjerë më pak, në qoftë se ajo bie në sordinë, daullja e tyre pushon fare...².

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 265.

2. Po aty, f. 275.

3. Po aty, f. 278.

4. Po aty, f. 281.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 285.

2. Shih vazhdimin e këtyre shënimeve në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 85.

E MËRKURE
16 SHTATOR 1964

Mbledhja e Byrosë Politike sot analizoi punën e Partisë për zbatimin e vendimit të Plenumit të tetorit 1962 për intensifikimin e bujqësisë dhe përcaktoi detyrat për të ardhmen.

Pa një organizim të mirë të punës si kudo edhe në bujqësi nuk mund të ecim përpara. Tani kooperativat bujqësore janë bërë qendra të mëdha ekonomike, prandaj që të ndiqen me përgjegjësi problemet e shumta që dalin në to është e domosdoshme përsosja e metodës së drejtimit dhe e ndarjes së punës në kryesitë e tyre. Në mbledhjen e Byrosë ngrita edhe çështjen¹ që për ndjekjen konkrete të problemeve të caktuara të krijohen disa grupe të përbëra prej kooperativistësh, që të përgjigjen përpara kryesisë së kooperativës për një problem, bie fjala për ujitjen. Një formë e tillë organizimi mendoj se do të ndikojë pozitivisht për intensifikimin e bujqësisë dhe për zbatimin e agroteknikës.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 304.

E PREMTE
18 SHTATOR 1964

Sot prita ambasadorin e ri të jashtëzakonshëm e fuqiptotë të RP të Kinës në RP të Shqipërisë. Pasi i urova mirëseardhjen, i shpreha, midis të tjerave, edhe mendimet tona për disa probleme aktuale të jetës ndërkombëtare e për luftën kundër revizionizmit modern¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 308.

Gazeta «Zëri i popullit» boton sot artikullin «Afrimi i N. Hrushovit me Bonin inkurajon synimet agresive të militarizmit gjerman»¹. Artikulli ka të bëjë me çështjen që Traktati i paqes me Gjermaninë, edhe pse kanë kaluar 20 vjet nga mbarimi i luftës kundër nazizmit gjerman, akoma nuk është nënshkruar.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 330.

Teza shtesë për artikullin¹ që ishte menduar të botohet në «Zërin e popullit» dhe që e lexova sot

1) Për arsye politike

- a) Të influencojnë më mirë në BS e në vendet anëtare të KNER-it.
- b) Të forcojnë pozitën amerikane.
- c) Të forcojnë pozitën e miqve të tyre në KNER.
- ç) Të forcojnë pozitën e «të paangazhuarve».
- d) Të forcojnë dhe të ngrenë autoritetin e tyre.

2) Për arsye ideologjike

- a) Afirmimi i pikëpamjeve të tyre në kamp.
- b) Influencimi në të tjerët për krijimin e një blloku kundërbalancimi në bllok.
- c) Kontrollimi dhe influencimi për veprimet ideologjike sipas pikëpamjeve të titistëve.
- ç) Dezagregim i influencës hrushoviane si në politikë, ashtu dhe në ideologji.

1. «Futja e klikës së Titos në KNER dhe planet revizioniste», botuar në gazetën «Zëri i popullit», më 18 nëntor 1964.

d) Forcimi i pozitave të tyre politike dhe ideologjike dhe i pozitave të të tjerëve ndaj hrushovianëve etj.

3) Për arsye ekonomike

a) Të marrin ndihma nga të gjithë se në Jugosllavi, me gjithë ndihmat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka krizë të madhe.

b) Të forcojnë pozitën ekonomike të të tjerëve ndaj hrushovianëve, që të rrjepin sa më shumë Bashkimin Sovjetik.

c) Të dobësojnë në përgjithësi Bashkimin Sovjetik ekonomikisht dhe ta bëjnë sa më të varur nga kapitalizmi botëror që sulmon në vendet revizioniste për të vendosur kapitalet e veta.

c) Të degjenerohet krejtësisht KNER-i dhe të kandidate t'hesht në një treg të përbashkët (mundet në perspektivë si ndihmës i fuqishëm i aleancave të reja amerikane, si bllok kundër Tregut të Përbashkët).

4) Për arsye spiunazhi ushtarak dhe ekonomik në favor të imperialistëve etj.

a) Futja e titistëve ka aprovimin e amerikanëve.

b) Hrushovi është futur në rrugën e tradhtisë dhe koniunkturave të krijuara politike, ekonomike, ideologjike e detyrojnë t'u nënshtrohet situatave, por kjo s'është thotë se ai do të dorëzohet plotësisht para vullnetit të titistëve. Ai do të luftojë të ruajë epërsinë mbi këta, ai do të përpiqet t'i urdhërojë, t'i drejtojë, me një fjalë të bëjë ligjin dhe të drejtojë në të gjitha çështjet.

Por forca e kontradiktave, e grindjeve, e përçarjeve është brenda dhe vepron.

Në goftë se duam një artikull që të shoqërojë notën¹, duhet të trajtojmë këto aspekte, mendoj unë, dhe jo të tjerim formula dhe fraza.

Të gjitha arsyet e faqes së parë të artikullit janë pa asnjë vlerë reale. Ai që ka shkruar këtë artikull, më duket mua, s'ka marrë as mundimin të lexojë statutet dhe vendimet e KNER-it. E vetmja arsye e vlefshme është fakti që Hrushovi dhe anëtarët e tjerë të KNER-it nuk kanë marrë mendimin dhe pëlqimin tonë si anëtarë të kësaj organizate.

Edhe një gjë tjetër.

Për KNER-in ideja duhet të dalë e qartë që qëllimet e krijimit të tij kanë degjeneruar në qëllime antimarksiste, antisocialiste. Kjo u provua me çështjen tonë, që na bënë presione ekonomike, që shkelën tratatet ekonomike e të kredisë, ndaluan tregtinë etj. Këtë e provojnë çështja e Rumanisë, çështja e tarifave hekurudhore etj.

1. Notë proteste e Qeverisë së RP të Shqipërisë mbi pjesëmarrjen e Jugosllavisë në punët e disa organeve të Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke (KNER-it). Shih: «Zëri i popullit», 18 nëntor 1964.

E MARTË
29 SHTATOR 1964

Lexova një relacion të ardhur nga Presidiumi i Kuvendit Popullor për ndryshimet në dekoratat ekzistuese si dhe për krijimin e disa dekoratave të reja dhe lashë një shënim për shokun Rita, që për këtë çështje para se të vendoset në Presidium të merret edhe mendimi i Byrosë Politike dhe i Qeverisë.

E MËRKURË
30 SHTATOR 1964

Shkuam në darkën e dhënë nga ambasada kineze për 15-vjetorin e krijimit të RP të Kinës. Ambasadori¹ na priti i gëzuar. Duket ca më i shkathët se i pari, po ka mundësi që të jenë ditët e para të veprimtarisë së tij të re.

Flet diçka më shumë se Lo Shi Gaoja, por, kur vjen puna për të dhënë mendime për çështje të ndryshme, mban të njëjtin qëndrim si ai. Formulat i vazhdojnë dhe pasi i mbarojnë ato, atëherë bëhen mumje. Ne duam që me kinezët të jemi kurdoherë të hapët, të shkëmbejmë mendime, se me formula të sklerozuara nuk shkohet larg.

1. Shy Gjien Guo.

[SHTATOR 1964]

Grupi revizionist sovjetik, me në krye Nikita Hrushovin, po bëhet i rrezikshëm për Bashkimin Sovjetik, për kampin e socializmit, për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe për çështjen e paqes botërore. Ai bëhet akoma më i rrezikshëm nga çdo grup tjetër revizionist pse është në krye të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, pse fshihet pas prestigjit dhe autoritetit të tyre të madh dhe ka në dorë mjete të fuqishme materiale dhe propagandistike. Ky grup filloi të shfaqet¹ pas vdekjes së shokut Stalin dhe shkoi duke intensifikuar veprimtarinë e tij të fshehtë, në mënyrë intrigante, të mbuluar me demagogji deri në Kongresin e 20-të. Që nga ky kongres ai doli më hapur, veproi më lirisht dhe më me guxim, derisa arriti në kohën e sotme, ku veprimtaria e tij antimarksiste është zbuluar pothuajse krejtësisht dhe vepron hapur, pa përfillur kërkënd, pa përfillur as normat leniniste dhe teorinë marksiste-leniniste, dhe një nga një flak dhe maskat. Qëllimi i fundit i grupit revizionist të

1. Në shtator të vitit 1953 Hrushov i u caktua sekretar i parë i KQ të PK të BS.

Hrushovit është shkatërrimi i kampit të socializmit, degjenerimi i tij, degjenerimi i doktrinës marksiste-leniniste dhe integrimi i plotë i kapitalizmit në socializëm. Pra kthimi i rrotës së historisë prapa. Siç duket qartë ky është një plan i madh, që grupi i Moskës kërkon të vërë në zbatim.

Grupi i Nikita Hrushovit e di se përpara ka gjetur dhe do të gjejë pengesa shumë serioze, ai e di se do të ndeshet me botën komuniste, me klasën punëtore ndërkombëtare, me të gjitha masat përparimtare dhe popujt e botës.

Ai në këtë luftë ka aleatë imperialistët, dhe në radhë të parë imperializmin amerikan, ka kapitalistët e botës, forcat kundërrevolucionare dhe revizionistët modernë, e sidomos revizionistët jugosllavë.

Grupi tradhtar i Nikita Hrushovit para së gjithash duhet të sigurojë prapavijat e tij në Bashkimin Sovjetik, domethënë të krijojë mbështetjen kryesore kombëtare, për të përforcuar veprimet ndërkombëtare. Kësaj veprimtarie ai i është futur me ethe, por nuk po ia arrin qëllimit. Në fillim ai, me intriga, me shpifje, me kurthe të përgatitura, eliminoi elementin marksist-leninist të shëndoshë të udhëheqjes sovjetike dhe nisi fushatën më të madhe diskriminuese kundër tyre. Propagandoi me marifet se ndërtimi i socializmit në Bashkimin Sovjetik kishte ngelur prapa dhe vuri në dukje sidomos të ashtuquajturat vështirësi të mëdha në bujqësinë sovjetike. Propaganda e grupit revizionist gjatë kësaj fushate shpalli të ashtuquajturat talente gjeniale të Hrushovit në bujqësi, e paraqiti këtë si doktorin e vetëm që do të «shëronte» bujqësinë sovjetike, do të

krijonte bollëkun, do t'ua kalonte Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mishi do të qelbej dyqaneve dhe qumështi do të rridhte si lumë. Asgjë nuk ekzagjerohet këtu, këto janë thënë në vetë fjalimet e atij sharlatanit. Pra faji, sipas këtij grupi tradhtar, bie mbi Stalinin, mbi udhëheqësit e tjerë, të cilët «të gjithë s'kishin haber as nga drejtimi i bujqësisë, as nga drejtimi i industrisë dhe as nga ai i ekonomisë në përgjithësi».

Çështja tjetër që propagandonte grupi trockist i Hrushovit ishte «çlirimi i partisë» nga «sektarizmi» stalinian, «lidhja e gjerë» me masat dhe këtë propaganda e grupit e vinte në dukje, me shëtitjet e organizuara të Hrushovit nëpër kolkoze e ferma, me pritjet në ambasada të ndryshme në Moskë, të vendeve të demokracisë e të vendeve kapitaliste, për të dhënë përshtypjen se ky farë burri nuk ndien lodhje, është një fenomen i gjuhës, i udhëtimeve, i politikës, i ideologjisë dhe i çfarëdo gjëje dhe, nga ana tjetër, propaganda s'mungonte të vinte në dukje që Stalini s'dinte ç'bëhej në Bashkimin Sovjetik pale në botë, se ai «rrinte» në Kremlin e «shikonte filma e pinte vodka» dhe të tjera shpifje të tilla.

Për grupin tradhtar, që lëshoi klithma gjoja parimore kundër «kultit të Stalinit», qëllimi ishte gjetiu, të ngrinte kultin e Hrushovit, ku do të bazoheshin të gjitha veprimtaritë antiparti dhe antimarksiste të këtij grupi të poshtër revizionist me në krye Hrushovin, të errësonte veprën gjeniale të Leninit, të Stalinit dhe të bolshevikëve, të diskreditonte Bashkimin Sovjetik nëpërmjet shpifjeve kundër Stalinit dhe shokëve të tij dhe të paraqiste ardhjen e këtij grupi tradhtarësh në

fuqi si «një eveniment historik me karakter ndërkom-bëtar, si një epokë e re, epoka e ndërtimit të komunizmit». Prandaj, ky grup, duke menduar se ia kishte arritur qëllimit, në Kongresin e 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u dha ideve të tij revizioniste dorën e fundit, u vuri vulën në dy drejtime kryesore, në shkurorëzimin e leninizmit dhe në frenimin e revolucionit në botë.

Ne shqiptarët akuzohemi nga Nikita Hrushovi si luftënxitës, si ata që dëshirojnë dhe luftojnë të hedhin në zjarrin e luftës atomike Bashkimin Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ne të bëjmë sehir e të hamë gështenjat që do të na i nxjerrin të tjerët nga zjarri! Për pak sa nuk na akuzojnë se ne shqiptarët luftojmë për të sunduar botën dhe të vendosim hegjemoninë botërore shqiptare!

Po pse grupi i Nikita Hrushovit ka arritur deri në absurditete të tilla? Kjo është e qartë për të gjithë, ata kanë humbur çdo masë, çdo gjykim, vetëm pse Partia e Punës e Shqipërisë u zbuloi tradhtinë e tyre dhe lufton pa u përkulur kundër tradhtisë së madhe që bënë në kurriz të socializmit e të paqes botërore dhe në favor të imperializmit e të luftës atomike.

Lufta parimore marksiste-leniniste e Partisë së Punës të Shqipërisë nuk nxit luftën atomike, por synon ta pengojë luftën atomike.

Mund të thuash shumë fjalë për «paqen» sa për të gënjyer naivët, dhe t'i bësh lëshime vdekjeprurëse imperializmit. Kjo e shpejton luftën dhe nuk e pengon. Popujt dhe marksistë-leninistët nuk mund t'i nënshtrohen ligjit imperialist dhe kapitalist. S'i janë nënshtroar

as në të kaluarën dhe as në të ardhmen nuk do t'i nënshtrohen.

Grupi i Nikita Hrushovit, me politikën e tij tradhtarë, përpiqet të gënjejë popujt dhe komunistët, me njëfarë arritje të «uljes së tensionit», që, në fund të fundit, është provizore dhe përgatitore për ndërmarrje më të egra nga ana e imperializmit kundër komunizmit, kundër vendeve të socializmit dhe popujve të botës. Politika e grupit tradhtar të Hrushovit synon që njerëzit dhe popujt të preokupohen për njëfarë kompromisi bile dhe të turpshëm momentan dhe të mos gjejnë për rrjedhimet katastrofike të së nesërme.

Kurse Partia jonë lufton për të mbrojtur të sotmen, që të sigurojmë të nesërmen. Duhet të jemi vigjilentë sot që të mos vuajmë nesër. E sotmja e fituar duhet të ruhet fort, që të fitohet e nesërmja.

E PREMTE
2 TETOR 1964

Sot në mbledhjen e Byrosë Politike diskutuam për disa probleme të vëllimit të dytë të «Historisë së Shqipërisë». Dhashë edhe unë disa mendime¹ për trajtimin e çështjeve të veçanta që përfshihen në këtë vëllim.

Ngjarjet në tekstin e «Historisë së Shqipërisë» duhet të shkruhen ashtu siç janë zhvilluar në të vërtetë. Historia si shkencë kërkon kurdoherë pasqyrimin e drejtë të ngjarjeve.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 349.

E HËNË
5 TETOR 1964

I dërguam redaksisë së gazetës «Zëri i popullit» letrën e hapur drejtuar anëtarëve të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik¹. Do të botohet në shtyp nesër.

1. N. Hrushovi në një letër të dërguar më 30 korrik 1964 të gjitha partive, midis tyre edhe Partisë së Punës të Shqipërisë, njoftonte se kishte vendosur të thërriste më 15 dhjetor të po atij viti mbledhjen e komisionit të redaktimit dhe nga mesi i vitit të ardhshëm mbledhjen ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore. Në letrën e tij Hrushovi ftonte Partinë tonë që të dërgonte në Moskë delegacionin e saj për të marrë pjesë në punimet e komisionit të redaktimit dhe i kërkonte asaj të njoftonte sa më parë përbërjen e delegacionit.

KQ i PPSH, duke pasur parasysh se grupi i Hrushovit kishte tradhtuar përfundimisht çështjen e marksizëm-leninizmit dhe se me këtë grup renegat ajo nuk kishte të bënte më, vendosi të mos i përgjigjet letrës së tij, por t'i drejtohet me këtë rast me një letër të hapur anëtarëve të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 353.)

E MARTE
6 TETOR 1964*

Disa qëndrime joparimore të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës, të shfaqura sidomos kohët e fundit, nuk mund të mos na shkaktojnë shqetësime.

Çështja e kufijve kino-sovjetikë, kino-mongolë dhe e kufijve të vendeve të demokracisë popullore të Evropës, të caktuar pas Luftës së Dytë Botërore. (Të gjitha shprehur nga Maoja socialistëve japonezë.)

Ne u shkruam letër shokëve kinezë për problemin e kufijve... Ata nuk shohin dhe nuk duan të shohin haptazi rrezikshmërinë dhe padrejtësinë e kësaj çështjeje. Shokët kinezë e shohin këtë si një veprim të drejtë ideologjik, që dëmton Hrushovin dhe nuk e ndihmon atë për ta përdorur kundër tyre. Kjo është serioze... Ata janë në pozita të vështira, hezituese, s'kanë vendosur akoma çfarë të bëjnë dhe kështu lejojnë të spekulojnë armiqtë rreth këtij qëndrimi...¹

1. Shih vazhdimin e këtyre shënimeve në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 95.

E SHTUNE
10 TETOR 1964

Sot paradite prita delegacionin e grave kineze. Bisedova gjatë me to për luftën dhe përparimin e gruas në RPSH, si dhe për forcimin e miqësisë sonë me Kinën¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 27, f. 392.

E MARTË
13 TETOR 1964*

Shoku Mao fjalëve të shokëve të delegacionit tonë të Partisë e të Qeverisë «Besojmë se do të na jepni përgjigjen e letrës sonë në lidhje me kufijtë e Bashkimit Sovjetik» iu përgjigj: «E ardhmja do ta vërtetojë nëse kjo është e gabuar ose jo. Ne nuk do t'ju përgjigjemi, se, po t'ju përgjigjeshim, do t'jua hidhnim poshtë, ashtu sikurse na i hodhët edhe ju, dhe kështu do të lindë polemika. Pra, le të presim, ndoshta pas shumë vjetësh, do t'ju përgjigjemi, por jo tani»¹.

Kjo përgjigje nuk është e drejtë, është një qëndrim joparimor, jokorrekt, përbuzës dhe aspak shoqëror ndaj Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Nga ana tjetër, kjo përgjigje tregon se shokut Mao nuk i pëlqejnë kritikrat shoqërore dhe ne duhet të dalim me disa konkluzione:

Shokët kinezë jo vetëm që konfirmojnë përsëri se shoku Mao i ka thënë ato që kanë deklaruar socialistët japonezë, por për këto probleme, qëndrojnë ndaj nesh,

1. Nga procesverbali i bisedës me delegacionin e Partisë e të Qeverisë Shqiptare, më 9.10.1964. Arkivi Qendror i Partisë.

në pozitë e mëparshme dhe këto pozita i quajnë të drejta. Nga ana tjetër, fakt është se qëndrimet e tyre për këto probleme nuk janë aq të vendosura siç duan të tregohen përpara vërejtjeve tona. Ambasadorët kinezë në vendet e ndryshme të Evropës kanë marrë udhëzime se çfarë qëndrimi të mbajnë ndaj këtij problemi.

Ambasadori kinez në Poloni kërkon të takohet me Gomulkën (sigurisht për t'i arsyetuar intervistën e Maos me socialistët japonezë), Gomulka refuzon ta presë dhe ia rekomandon pritjen një anëtari të Byrosë Politike. Ambasadori kinez shkon në takim dhe polaku jo vetëm që i qëndron ftohtë, por i hedh poshtë thëniet e Maos dhe u kërkon kinezëve që të bëjnë deklaratë për të njohur kufijtë Oder-Najse. Ambasadori kinez përpiqet të shfaqësojë Maon, pranon të bëjë deklaratë dhe e bën këtë deklaratë nga Radio Varshava me rastin e festës së 15-vjetorit të themelimit të Republikës Popullore të Kinës. Kurse çështja e «territorit polak të rrëmbyer nga Bashkimi Sovjetik» mbetet «ashtu si ka qenë» (sic e ka thënë Maoja). Kjo u intereson nacionalistëve polakë dhe njëkohësisht u shërben edhe kinezëve për luftën kundër Hrushovit dhe për afrimin me polakët. Taktikë «e zgjuar», «nacionaliste» nga ana e kinezëve!! Dhe «për ta ndrequr» këtë situatë, këtë xhevahir të Maos, kinezët po shtojnë lajkat ndaj polakëve, me pretekstin se «polakët kanë kontradikta me Hrushovin dhe duhet përfutuar nga këto kontradikta».

Përse lindin tash këto kontradikta të polakëve me sovjetikët?! Dhe çfarë kontradiktash janë këto? Nuk e njohin shokët kinezë natyrën e këtyre kontradiktave?

Sigurisht e njohin dhe pikërisht për këtë arsye ata i nxitin polakët në rrugën nacionaliste. Kësaj i thonë, nga njëra anë, të ndjekësh ato rrugë dhe atë taktikë që përdor imperializmi për të nxitur popujt dhe shtetet në mes njëri-tjetrit dhe, nga ana tjetër, të bësh përpjekje t'i quash këto «taktika socialiste». Jo, këto veprime s'janë të drejta, s'janë marksiste.

Shokët kinezë, për të fshehur këtë gabim të shokut Mao, kanë hedhur idenë se gjoja «ky i tha këto për historinë». Por, derisa flitet për «historinë», atëherë pse nuk u shkoi ai deri në fund këtyre çështjeve? Për «historinë» nuk mund të kufizohesh të flasësh vetëm për Bashkimin Sovjetik, përveçse po të kesh qëllime të caktuara. Dhe cilat mund të jenë këto qëllime të caktuara? Këto mund të jenë: Të godasësh dhe të diskreditosh Stalinin si grabitës e imperialist dhe Bashkimin Sovjetik kur udhëhiqte ai dhe të nxitësh ndjenjat shoviniste, antimarksiste të atyre revizionistëve që kanë kontradikta me revizionistin Hrushov.

Meqenëse Maoja foli për «historinë», përse nuk foli edhe për Transilvaninë, që «është tokë hungareze», por foli vetëm për Besarabinë dhe Moldavinë, që «janë toka rumune»? Meqenëse Maoja ka dalë të rregullojë «për historinë» kufijtë e vendeve, përse nuk foli edhe për Kosovën e kështu me radhë?

Jo, këto arsyeime nuk qëndrojnë në këmbë dhe shokët kinezë e shohin vetë se këto janë si rroba e zezë e qepur me pe të bardhë. Nga njëra anë ata «flasin për historinë», por, nga ana tjetër, mbrojnë tezën se «asnjë kufi i caktuar nuk duhet të lëvizë». Vihet pyetja: Kur historikisht ti i shtron drejt çështjet dhe thua se

kufijtë s'duhet të lëvizin, atëherë përse i ngre këto probleme në këto momente? Kujt i shërbejnë këto? Maoja u tha shokëve tanë se «qëllojmë me artileri pa predha», gjë që do të thotë «për të bërë vetëm zhurmë». Zhurmë e bukur!!

Maoja tha gjithashtu se «zhurmën» e Hrushovit për «zhurmën që bën Maoja» nuk e dëgjon njeri. Domethënë Maon e dëgjojnë. Hrushovin s'e beson njeri, ose me fjalë të tjera: Sovjetikët e dëgjokan, e kuptokan, e duartrokitchkan Maon, kur ai u thotë atyre: «Ktheni tokat polake, rumune, çeke, kineze, japoneze» etj., ndërsa, kur Hrushovi u thotë sovjetikëve se Maoja kërkon të shpartallojë Bashkimin Sovjetik, atë sovjetikët jo vetëm nuk e dëgjokan, po e urrekan që nuk i kthen këto toka! Logjikë e çuditshme!

Udhëheqja rumune ka filluar ta mburrë Maon brenda në Rumani, ta cilësojë ideolog, politikan të madh, që jo vetëm sulmon Hrushovin, por kritikon edhe Stalinin. Ajo thotë se Maoja «foli shumë drejt për Besarabinë që na e kanë grabitur sovjetikët, por këtë çështje ne nuk e ngremë tash për tash, pse kemi hallin e Transilvanisë».

Rumunët janë «në pararojë» për të reklamuar kinezët, «pjekurinë» e tyre dhe «kokëfortësinë» tonë. Morëm vesh nga burime të besueshme se rumunët, me rastin e festës së tyre, kishin në plan që të na afronin në me sovjetikët, si dhe kinezët me sovjetikët. Por me ne dështuan, se «shqiptarët tregohen kokëfortë e sektarë», kurse Mikoiani, sipas rumunëve, «u tregua i arsyeshëm dhe diplomat i mirë me kinezët».

Shokët kinezë, nga ana e tyre, kanë filluar një fushatë afrimi me revizionistët e Evropës që janë në fuqi

(me përjashtim të sovjetikëve). Nga pozitat negative që donin të mbanin me rastin e 15-vjetorit të festës kombëtare të Kinës duke mos ftuar jo vetëm revizionistët, por as edhe ne, tash shkojnë në festat e revizionistëve, flasin ëmbël, me entuziazëm, me zjarr «për miqësinë e popujve» etj. Neve ata na thonë: «Duhet të punojmë mirë me ta, se do të përfitojmë nga kontradiktat që kanë me Hrushovin». Por hovi kinez është i tillë sa «mund të shuajë edhe kontradiktat» që kanë vetë kinezët me këta revizionistë, në favorin e këtyre të fundit ose të një kompromisi pa parim. E gjithë kjo punë tregon diçka jo të shëndoshë, jomarksiste.

Në goftë se kinezët kanë një «plan ofensiv» në Evropë, kanë «një taktikë të re dhe origjinale» për të përfitur nga kontradiktat ndërrevizioniste dhe «për të luftuar Hrushovin», këtë duhet ta shtronin e ta diskutonin së toku dhe me të tjerët. Këtë gjë as e bënë dhe as që kanë ndër mend ta bëjnë. Ata veprojnë vetë dhe janë vetëm fjalë të gjitha ato që thonë.

Në praktikë çështja nga shokët kinezë shtrohet kështu: «Ne veprojmë; po të doni, na ndiqni; po të mos doni, ne në polemikë me ju s'futemi; le t'i lëmë t'i gjykojë historia ato për të cilat ne s'jemi dakord». Kjo s'është e drejtë, s'është marksiste. Historia shkruhet çdo ditë.

Çdo veprim, i mirë ose i keq, i partive tona regjistrohet, lidhet me veprimet e mëparshme dhe të pas-tajme dhe, kur veprimet janë të pamatura, ato kanë pasoja të këqija. Ne mendojmë se duhen evituar veprimet e pamatura dhe të tilla mund të ketë edhe nga ne, por edhe nga ata, edhe nga partitë e vogla, po edhe nga

partitë e mëdha. Prandaj duhen konsultime. Fakt është se shokët kinezë i evitojnë konsultimet dypalëshe me ne dhe ato shumëpalëshe.

Pala jonë ka qenë ajo që kurdoherë ka kërkuar të shkëmbejë mendime për probleme të ndryshme me shokët kinezë. Ne kemi vepruar kurdoherë me iniciativë. Ata nuk kanë shtruar probleme nga ana e tyre, por kanë biseduar për problemet që kemi shtruar ne.

Ne do ta vazhdojmë këtë metodë pune të drejtë dhe marksiste, do t'ua themi kurdoherë pikëpamjen tonë shokëve kinezë, qoftë kjo e rëndë për ne ose e hidhur për ta. Dhe ne do të kërkojmë prej tyre që të diskutohet mbi pikëpamjet dhe jo «të mos diskutohet», nga frika se «kështu do të polemizohet». Ne nuk kemi frikë të diskutojmë më parë se të polemizojmë, dhe nuk ka përse të arrijmë deri në polemikë, kur kemi mundësi të diskutojmë si marksistë dhe të bindim shoqi-shoqin me argumente dhe fakte.

Asgjë nuk duhet «t'i lëmë historisë ta zgjidhë». Ne duhet t'i zgjidhim ato që na takojnë dhe t'i zgjidhim drejt, kurse historia le të japë më vonë gjykimin mbi zgjidhjet që u japin problemeve partitë tona.

Ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë e të luftojmë ngushtë me njëri-tjetrin në rrugën marksiste-leniniste. Ne kemi besim se këto çështje do t'i sqarojmë dhe do t'i ndreqim drejt, në interesin e madh të Partisë dhe të forcimit të doktrinës sonë, marksizëm-leninizmit, që po sulmohet nga revizionistët modernë të çdo ngjyre dhe nga imperializmi botëror.

E ENJTE

15 TETOR 1964*

Shokët kinezë, veçanërisht Liu Shao Çia, në qoftë se nuk gabohej, në një bisedë me një delegacion tonin që kishte shkuar në Pekin, kishin hedhur idenë se, për të luftuar imperializmin dhe veçanërisht imperializmin amerikan, duhet të punojmë për të krijuar një front të gjerë antiimperialist edhe me revizionistët modernë. Një ide të tillë, kalimthi, e shtroi edhe Çu En Lai gati një vit më parë, kur ishte te ne. Ne ia kundërshtuam idenë për të bashkëpunuar për një gjë të tillë me revizionistët modernë, por, për krijimin e një fronti antiimperialist, ne natyrisht jemi dakord dhe punojmë. Megjithatë, Çu En Lai as u tërhoq dhe as e zhvilloi këtë ide, por e la në heshtje, hodhi gurin dhe e la përtokë.

Kjo çështje kaq e rëndësishme shtrohej në disa momente të caktuara, si të thuash, aspak të përshtatshme. Kjo ide hidhej kur lufta jonë ideologjike dhe politike me revizionistët modernë ishte acaruar në kulm dhe veçanërisht kur grupi i Hrushovit ishte futur thellë në bashkëpunim konkret, serioz me imperialistët amerikanë. Ai po vinte në zbatim, pa asnjë ngurrim, gjithë politikën e tij antileniniste të bashkekzistencës hru-

shoviane, i bënte lëshime politikës agresive amerikane, zbukuronte imperializmin amerikan, dobësonte luftën çlirimtare të popujve dhe aktivizonte e ashpërsonte luftën kundër marksizëm-leninizmit, kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë.

Kur grupi i Nikita Hrushovit në krye të revizionistëve modernë po dobësonte luftën kundër imperializmit, shokët kinezë hodhën idenë e krijimit të frontit antiimperialist edhe me revizionistët modernë. E çuditshme!!

Megjithatë ne nuk shihnim ndonjë veprim konkret në këtë drejtim nga ana e shokëve kinezë, me përjashtim të faktit që propaganda e tyre kundër hrushovianëve nuk zhvillohej me ritmet e duhura siç e kërkonin momentet, sido që nuk dukeshin shenja zbutjeje në polemikën e tyre antihrushoviane. Mendonim se kjo ide e hedhur nga kinezët ishte, si shumë ide të tyre, e papjekur mirë, por se më vonë, me kalimin e kohës, ata i rikthehen, e rimendojnë etj. Sidoqoftë, për një kohë të gjatë nuk u fol më për këtë çështje.

Por dy-tri ditë më parë kjo ide e kinezëve doli haptazi, botërisht, në kryeartikullin e organit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Japonisë, ku, duke dënuar mbledhjen e dhjetorit të ardhshëm të propozuar nga Hrushovi, propozohet një mbledhje e 81 partive komuniste dhe punëtore për të diskutuar e për të vendosur për krijimin e një «fronti antiimperialist».

Siç shihet, idenë e tyre kinezët e kanë përpunuar me partitë komuniste të Azisë dhe kanë ardhur në konkluzionin që kjo ide të bëhet publike dhe të diskutohet në opinionin botëror dhe në atë të komunizmit ndër-

kombëtar. Në qoftë se del «djalë», atëherë bëhet i njohur i ati, në qoftë se s'bëhet gjë, atëherë mbetet «qëllimi i mirë», «i këndshëm», sepse fronti ka pasur për titull fjalën «antiimperialist».

Kjo s'është një çështje e vogël, por nga më të rëndësishmet. Kjo është hedhja në tryezë për diskutim e një kthese revizioniste në politikë dhe në ideologji, parvarësisht se i është veshur petku «fronti antiimperialist»...¹

1. Shih vazhdimin e këtyre shënimeve në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 113.

**E PREMTE
16 TETOR 1964**

Prita shokët që më uruan për datëlindjen. Vitet po ikin njëri pas tjetrit e bashkë me to edhe moshja; flokët po na zbardhen, por zemrën e kemi çelik.

Sihariq dhe gëzim i madh për ne dhe për të gjithë marksistët e botës. Mbrëmë vonë Moska dha lajmin se Nikita Hrushovi u përjashtua nga Presidiumi i KQ të PK të BS dhe u shkarkua nga funksionet e sekretarit të parë të KQ dhe të kryetarit të Këshillit të Ministrave të BRSS. Por të tjerët, shokët e tij, kanë mbetur në fuqi. Ata e rrëzuan, prandaj ky është një puç po e po, por mund të jetë fjala edhe për ndonjë manovër. Megjithatë kjo është një fitore e madhe për ne. Ndërkaq lufta jonë kundër revizionizmit modern vazhdon. Të gjithë tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, herët a vonë, do t'u vijë fundi.

**E SHTUNË
17 TETOR 1964***

Dita e djeshme ishte me të vërtetë një ditë gëzimi të madh për të gjithë marksistë-leninistët e botës dhe veçanërisht për Partinë e Punës të Shqipërisë dhe popullin shqiptar. Partia jonë heroike ka të drejtën legjitime të gëzohet dhe të ndiejë një kënaqësi të madhe, pse ajo luftoi me heroizëm, me pjekuri të madhe marksiste-leniniste kundër revizionizmit modern në përgjithësi dhe kundër hrushovizmit dhe titizmit në veçanti. Kundër Partisë së Punës të Shqipërisë u hap zjarri i parë hrushovian, ky zjarr u bë i përgjithshëm nga i gjithë revizionizmi modern, mori një gjerësi dhe një thellësi të paparë asnjëherë, u shndërrua në një kryqëzatë të tërbuar ideologjike, politike, ekonomike, diplomatike, ushtarake kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, popullit shqiptar dhe Republikës Popullore të Shqipërisë. Partia jonë iu përgjigj zjarrit që i hapën, i qëndroi këtij zjarri si trimëreshë e pjekur marksiste-leniniste dhe jo vetëm që nuk u gjunjëzua, por luftoi kryelartë në radhën e parë dhe u bë shenabull e flamur. Me këtë ajo fitoi besimin, admirimin, respektin dhe përkrahjen e të gjitha partive marksiste-leniniste që qënd-

ronin në pozita të drejta dhe të të gjithë marksistë-leninistëve e revolucionarëve të botës. Lufta jonë heroike e drejtë, e papërkulur vazhdoi vite me radhë dhe çdo vit është mbushur me fitore për Partinë tonë. Këto fitore zbukurojnë gjoksin e saj të çeliktë si medalje të ndritshme që kurrë s'do të errësohen. Këmba-këmbës ndoqëm, demaskuam, luftuam pa mëshirë revizionizmin modern, grupin tradhtar të Hrushovit, grupin tradhtar të Titos dhe të gjitha grupimet e tjera revizioniste. Kontribuam fuqimisht në demaskimin e tradhtisë së tyre të gjithanshme.

Ne kishim besim të patundur se tradhtari do të pësonte disfatë dhe mënyra si u bë eliminimi i tij, nuk është për t'u çuditur, por shkarkimi i tradhtarit nga postet e tij kaq shpejt, dhe sidomos nga shokët e tij, ishte i papritur për ne. Ky është një puç pallati. Ashtu si N. Hrushovi organizoi puçin e tij kur eliminoi nga udhëheqja Molotovin, Kaganoviçin, Malenkovin, ashtu si gjykoi dhe ekzekutoi Berian, ashtu si eliminoi Zhukovin, ashtu shokët e tij eliminuan dhe vetë Hrushovin. Organizimi i puçit, siç duket nga të dhënat e para, është bërë në mënyrë konspirative dhe tradhtari e besnikët më të afërt të tij s'kanë ditur gjë, ose janë vënë në atë gjendje që të mos kishin kohë as të lajmëronin, as të merrnin masa. Më vonë, me kohë, faktet do të na sqarojnë për gjithçka...¹

1. Refleksionet e plota lidhur me këtë ngjarje janë botuar në librin: Enver Hoxha, «Superfuqitë», f. 112.

E MARTE
20 TETOR 1964

Shënime për fjalimin që do të mbaj në Shkollën e Partisë

Përsëritet nga ana e Komitetit Qendror dhe nga ana ime.

Rëndësia e shkollës dhe rezultatet e mëdha të saj (kanë dalë 4 000 kuadro).

Detyrë themelore është përgatitja e kuadrove të Partisë me teorinë marksiste-leniniste.

Ndërtimi i socializmit, nën udhëheqjen e Partisë, është një luftë madhështore, e lavdishme, e koklavitur, dhe jo pa pengesa të shumta që duhen kapërcyer.

Lidhja e teorisë me praktikën.

Roli i pedagogëve për të mësuar nxënësit duke lidhur diturinë dhe eksperiencën e tyre me metodën leniniste.

Horizont i gjerë. Të parashikohet dhe të përcaktohet perspektiva e zhvillimit.

Largimi nga mësimi formal. Zhvillimi i problemeve kryesore aktuale dhe të perspektivës. Forcimi i lidhje-

ve midis asaj që mësohet në shkollë dhe asaj që nxënësi do të bëjë në jetë. Të mësojë nga jeta dhe nga librat. Të armatoset që të analizojë ngjarjet.

Kriza e kapitalizmit botëror nxiti ringjalljen e revizionizmit modern, në modelin titist.

Qëllimi kryesor i tij ishte goditja e kokës së kampit të socializmit, Bashkimit Sovjetik, që përbënte rrezikun kryesor të imperializmit botëror dhe të lidërshiptit të tij, imperializmit amerikan.

Nikita Hrushovi dhe grupi i tij hyri në shërbim të ideologjisë borgjeze, braktisi rrugën marksiste-leniniste, e tradhtoi atë dhe i hapi luftë në atë drejtim që dëshironin strategjia dhe taktika amerikane.

Si e zhvilluan revizionistët punën e tyre minuese? Kongresi i 20-të, i 21-të, i 22-të.

Teoritë mbi bashkekzistencën, çarmatimin, paqen. Zbukurimi i imperializmit.

Lëshimet ndaj imperializmit.

Lufta kundër marksizëm-leninizmit.

Lufta kundër marksizëm-leninizmit brenda në vendet dhe partitë e tyre dhe krijimi i koalicionit revizionist në komunistin botëror.

Disfatat e njëpasnjëshme në lëmin ndërkombëtar, në lëmin e brendshëm dhe në frontin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Kriza në gjirin e revizionizmit modern. Si paraqitet kjo krizë. Mbledhja që propozonte Hrushovi.

Rrëzimi i tij, motivacionet.

Kriza vazhdon të thellohet dhe do të thellohet. Taktikat e tyre të mundshme.

Detyrat e marksistë-leninistëve dhe lufta e Partisë sonë në të ardhmen.

Sot isha shumë i gëzuar, se shkova në Shkollën e Partisë, për të festuar 15-vjetorin e krijimit të saj¹. Ç'ndryshime kolosale që kishte nga dita e parë e inaugurimit të kursit të parë të Partisë pas Çlirimit! Sukseset të mëdha ka arritur kjo shkollë. Me qindra shokë që e kanë mbaruar, janë armatosur me teorinë marksiste-leniniste dhe me punën e tyre kanë fuqizuar Partinë. Fola gjatë përpara studentëve dhe pedagogëve për rëndësinë e madhe të shkollës, për detyrat e shokëve që mësojnë dhe të pedagogëve. Fola, gjithashtu, edhe për problemet aktuale ideologjike dhe politike².

Kur dolëm nga mbledhja, binte shumë shi dhe frynte erë dhe, duke qenë i djersitur, besoj se u ftoha ca, se në mbrëmje më zuri kolla dhe filloi të më dhembë pak këmba. Reumatizëm!

1. Në atë kohë si vit i krijimit të shkollës merrej viti 1940, kurse më vonë është marrë si bazë viti 1945, kur u hap kursi i parë i Partisë, pas Çlirimit.

2. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 1.

QYTETI STALIN, E MËRKURË

21 TETOR 1964

U nisa për në Berat për festë. Sonte qëndrova në Qytetin Stalin, ku erdhën edhe shokët e tjerë. Biseduam.

Koha është e veshur, por shokët e Beratit kanë dhënë «urdhër» që nesër të mos bjerë shi. Të shohira, a do t'i dëgjojë «baba Ali Tomori»?

BERAT, E ENJTE

22 TETOR 1964

U mbledhëm në Berat për të festuar 20-vjetorin e krijimit të Qeverisë Demokratike. Momente prekëse për mua dhe për të gjithë, se na kujtohen vitet heroike të luftës.

Vendosëm kurora në varrezat e shokëve të rënë. U bë miting i madh, ku foli shoku Spiro Koleka. Në drekën e shtruar me këtë rast fola unë¹.

Pasdreke u ktheva në Tiranë, kurse shokët e tjerë qëndruan në Berat.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 25.

E SHTUNË
24 TETOR 1964

Prita sot sekretarin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Indonezisë, shokun Peris Pardede. Biseduam dhe shkëmbyem mendime për problemet e rëndësishme që na preokupojnë të gjithë. Ishim dakord për çdo gjë¹.

E PREMTE
30 TETOR 1964

Sot u zhvillua mbledhja e Sekretariatit të Komitetit Qendror. Fola edhe për situatën e re të krijuar pas rrëzimit të Hrushovit. Partia jonë, si parti marksiste-leniniste, ka qenë në ballë të luftës kundër revizionizmit modern, prandaj edhe lufta e saj parimore ka ndihmuar shumë për rrëzimin e Hrushovit.

Në luftën me armiqtë ne kemi një eksperiencë të madhe, nuk jemi dehur kurrë nga sukseset, nuk gënjehemi as shpejtohemi në qëndrimet tona. Ajo i mat mirë fjalët dhe veprimet e saj, ecën përpara me kujdes.

Rrëzimi i Hrushovit është një fitore e madhe që u arrit me luftë, por lufta duhet të vazhdohet pa ndërprerje në rrugën marksiste-leniniste. Partia jonë do të ndjekë këtë rrugë pa asnjë lëkundje. Ne kurrë nuk jemi pajtuar e nuk do të pajtohemi me revizionistët, nga parimet nuk do të lëvizim.

Rrëzimi i tradhtarit N. Hrushov është një sukses i madh i marksizëm-leninizmit dhe i Partisë sonë. Por, sikurse na lajmëroi me radiogram ambasada jonë në

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 42.

Pekin, për fat të keq, pas kësaj ngjarjeje, ne patëm një të keqe jo të vogël me qëndrimin e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës¹. Natyrisht, kjo i bën më pak optimiste mendimet tona në lidhje me zhvillimin e ngjarjeve pas rënies së Hrushovit. Në rast se Partia Komuniste e Kinës do të qëndronte në pozita të forta marksiste-leniniste dhe së bashku me Partinë tonë do të ndiqte të njëjtën rrugë, ose të paktën në vijat kryesore do të luftonte nga pozita të drejta, atëherë mund të thuhej se situatat ishin optimiste.

Është fakt se me qëndrimin që ka vendosur të mbajë Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës, sikurse na thotë Çu En Lai, perspektiva e fitores së shpejtë mbi revizionizmin modern nuk mund të jetë optimiste. Kështu, mendoj unë, duhet gënjyuar kjo çështje, sepse Partia Komuniste e Kinës në luftën kundër revizionizmit modern ka një potencial dhe influencë të madhe në lëvizjen komuniste dhe në arenën ndërkombe-tare. Do të ishte gabim i madh të mos e çmonim

1. Më 29 tetor 1964, Ministria e Punëve të Jashtme e Kinës kishte ftuar në një takim ambasadorët e RP të Shqipërisë, të RD të Vietnamit, të Rumanisë, të Kubës dhe të ngarkuarin me punë të Koresë, në të cilin vetë Çu En Lai, në emër të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, u komunikoi pikëpamjet e Partisë Komuniste të Kinës për situatën pozitive që, sipas tyre, ishte krijuar në PK të Bashkimit Sovjetik dhe në udhëheqjen e saj pas rrëzimit të Hrushovit. Në të njëjtën kohë ai u njoftoi se Komiteti Qendror i PK të Kinës kishte vendosur t'i propozonte KQ të PK të Bashkimit Sovjetik që të ftonte në Moskë për të marrë pjesë në festimet e 47-vjetorit të Revolucionit të Tetorit delegacione nga të 12 vendet socialiste.

këtë forcë të madhe të Partisë Komuniste të Kinës.

Nuk ka asnjë parti tjetër që të ketë ndjekur dhe të njohë në vazhdim hezitimet, lëkundjet, bile edhe kundërshtimet që ka pasur Partia Komuniste e Kinës me Partinë tonë për sa i përket luftës kundër revizionizmit modern. Në fakt edhe në sipërfaqe po ta shohim çështjen e Partisë Komuniste të Kinës, e cila u sulmua nga revizionistët dhe pretendoi se e pa rrezikun e tyre, kur hrushovianët filluan luftën e hapët kundër marksizëm-leninizmit, Partia Komuniste e Kinës, për një kohë të gjatë, prej më shumë se një viti pas sulmit të hapët të Hrushovit kundër Partisë sonë, nuk ka qenë në sulm, por në mbrojtje dhe mbrojtja e saj konsistonte në uljen e polemikës.

Në momentet e kontradiktave kryesore me sovjetikët, kur ata po na luftonin ne ashpërsisht dhe ne rezistonim, në këtë moment krize të madhe, Partia Komuniste e Kinës qëndronte në pozitën e shuarjes së polemikës.

Partia Komuniste e Kinës mendonte se ndihmonte luftën kundër revizionizmit modern me autoritetin e saj të madh dhe duke botuar në gazetën e veta artikujt tanë. Kjo ishte një gjë shumë e mirë, mbasi me botimin dhe propagandimin e tyre përfituam ne dhe marksizëm-leninizmi. Më vonë ata kaluan në pozitën që dimë.

Ne duhet të nxjerrim konkluzione se, siç duket më vonë shokëve kinezë pozitën e «luftës» që morën, nuk u kanë pëlqyer. Në fakt ata nuk ishin për një luftë të hapët parimore kundër revizionizmit modern dhe mund të themi se, gjer në njëfarë shkalle, ata janë

penduar, për arsye se duhet të kenë pikëpamje jo të drejta marksiste-leniniste për shumë çështje dhe për vetë kuptimin e polemikës. Kjo rrjedh nga butësia dhe oportunitizmi në vijën e tyre, si dhe nga megalomania «e partisë dhe e shtetit të madh». Ata kanë menduar se në këtë polemikë kanë dalë të njollosur, se autoriteti i madh i partisë së tyre pësoi disfatë, për arsye të sulmeve që i janë bërë, se partia e tyre e madhe «nuk e meritonte» që të hidheshin në sulm kundër tyre Partia Komuniste Franceze etj., e të lëshonin për Maon plot sulme e shprehje të tilla si «galloshja e vjetër» etj., etj. Në sedrën e tyre mikroborgjeze kjo i ka rënduar ata. Prandaj, duke u nisur nga këto konsiderata dhe për arsye të tjera, ata prisnin me padurim të krijohej një situatë si kjo e kohëve të fundit. Gjykojmë kështu se shohim që polemika e tyre me shtyp ka ecur me një javashllëk të çuditshëm që nuk e lejonte momenti.

Kjo tregon se shokët kinezë nuk ishin të vendosur për luftën parimore gjer në fund kundër revizionizmit modern, me shpirt ata ishin për njëfarë kompromisi. Prandaj rrëzimi i Hrushovit për ta ishte kulmi, fitorja më e madhe dhe i vetmi qëllim i tyre, kurse me të tjerët mund të merren vesh fare lehtë. Ky është një gjykim antimarksist i çështjes nga ana e tyre, se ne nuk mund të mendojmë që revizionizmi përfshihet vetëm te hrushovizmi.

Kur flasim për Stalinin, te ne nuk ka kontradikta se ne e identifikojmë atë me gjithë vijën. Edhe ata, në qoftë se janë marksistë, Stalinin duhet ta identifikojnë me tërë vijën, po këtë nuk e bëjnë. Ata thonë se

këto gjëra do të rregullohen me largimin e Hrushovit, domethënë janë subjektivistë.

E para, udhëheqësit kinezë thonë: «Ne do të pajtohemi» dhe pajtimi bëhet pa dinjitet, pa pasur një koncept të drejtë për ndershmërinë ideologjike të një shteti dhe partie të pavarur, që në rrugën marksiste kanë autoritetin e tyre. Këtu e ka burimin zelli i udhëheqësve kinezë për ta kapur shpejt këtë ngjarje.

E dyta, ata thonë: «Të vemi në BRSS sa më parë», se vajtja jonë atje, «argumentojnë» ata, do të jetë «sukses i madh», bota do të thonë që «shkuam si triumfatorë» dhe «ne bashkë me rumunët, jemi ata që e rrëzuan Hrushovin».

E treta, shkëputja menjëherë nga shqiptarët do të thotë që ata t'u japin sovjetikëve dhe të gjithë revizionistëve të tjerë të kuptojnë se nuk janë solidarë me vijën e Partisë së Punës të Shqipërisë.

Në këtë vijë që përgatitën, dhe ata ishin përgatitur më përpara për këtë, Partia jonë nuk u ndodh në befasi, ajo i ka ndjekur me vëmendje qëndrimet e udhëheqësve kinezë gjatë zhvillimit të ngjarjeve, sidomos marrëdhëniet e tyre me Rumaninë. Me rumunët kinezët kanë vepruar prapa krahëve tanë. Duke parë se ata patën disa kundërshtime ekonomiko-shtetërore me Hrushovin, kinezët hynë në bisedime të fshehta nga ne me rumunët, këta pastaj me sovjetikët dhe me të tjerët dhe sa për me titistët po e po. Kjo vërtetohet edhe nga ngjarjet e mëvonshme, këtë e vërteton në një shkallë të mirë edhe hipokrizia e kinezëve ndaj tyre dhe ndaj nesh. Si arriti Çu En Lai t'u thotë ambasadorëve që kishte ftuar në takim se është Shqipëria ajo

që hapi rrugën e unitetit? Kjo është një hipokrizi e madhe dhe e poshtër kundër nesh. Është pandershmëri e madhe, është antimarksiste kur Çu En Lai thotë se Partia e Punës e Shqipërisë propozoi të vinin në festën tonë (të kinezëve) përfaqësuesit e të 12 vendeve socialiste. Ai me këtë qëndrim bëhet një mashtrues antimarksisist. Në qoftë se ai donte t'ua thoshte mendimin e Partisë së Punës të Shqipërisë ambasadorëve, atë duhet ta thoshte të plotë, ashtu siç është pikëpamja jonë për këtë çështje, se, siç e tha Çu En Lai, del sikur Shqipëria është për pajtim me revizionistët. Kjo nuk është pikëpamja jonë, përkundrazi letra jonë dënon qëndrimin e gabuar të Partisë Komuniste të Kinës për çështjen e festës së 15-vjetorit të themelimit të Republikës Popullore të Kinës. Në qoftë se ata do të ishin marksistë duhet t'u kishin thënë ndershmërisht ambasadorëve që «ne (kinezët) kemi bërë një gabim të madh, kemi hedhur poshtë miqtë tanë dhe ftuam në festë vetëm rumunët. Për këtë shqiptarët na bënë letrën», dhe në të njëjtën kohë t'u parashtronin ambasadorëve pikëpamjen e Partisë sonë. Kjo që bëri Çu En Lai është mashtruese, e bërë me qëllim të keq, antimarksist, është armiqësore.

Nga kjo ngjarje ne duhet të gjykojmë se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës ka vendosur të ecë pa asnjë kusht drejt pajtimit të plotë me udhëheqjen revizioniste sovjetike, të shuajë polemikën me ta. Kjo do të thotë që për një kohë pak a shumë të gjatë nuk do të ketë më kontradikta në mes revizionistëve sovjetikë dhe kinezëve, sepse edhe në rast se sovjetikët do të qëndrojnë në pozitat e tyre, kinezët do t'u adaptohen këtyre pozitave. Revizionistët sovjetikë mund të

lustrosin disa gjëra dhe kinezët këto do t'i quajnë «të mjaftueshme» dhe «një provë të madhe» që këta «shokë» kanë njohur gabimet e tyre dhe tani po vijnë në rrugën tonë.

Rruga e kinezëve duket qartë, të mos kemi iluzione.

Kinezët e shuan tani polemikën, nga ana e tyre nuk do të botohen më artikuj kundër revizionistëve sovjetikë dhe ca më pak kundër revizionistëve të tjerë, do të shtohen midis tyre marrëdhëniet miqësore e tregtare, do të hartohen bashkërisht edhe disa qëndrime kundër imperializmit etj. Sa për jugosllavët ata mund të mos i zënë në gojë fare.

Përpara kësaj situate, e para, ne duhet të përcaktojmë në mënyrë më të shtrenguar taktikat tona.

Unë mendoj se ky është hapi i parë i kinezëve kundër Partisë sonë. Në të ardhmen marrëdhëniet ndërmjet nesh do të acarohen, do të shtohen. Ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet për të mos dalë haptazi kundër Partisë Komuniste të Kinës. Këtë duhet ta evitojmë sa të jetë e mundur. Prandaj, në qoftë se gjer tani me ta kemi qenë gjakftohtë, në të ardhmen duhet të jemi edhe më gjakftohtë. Kjo nuk do të thotë që ne të ndryshojmë qëndrimet tona parimore, sidomos tani që ata po ecin në një rrugë me të cilën ne nuk jemi dakord me ta. Në çdo moment ne duhet të mbajmë qëndrimet tona parimore të drejta, të gjykojmë se këto janë kontradiktat tona me Partinë Komuniste të Kinës dhe këto gradualisht do të duken. Por, që të marrim ne iniciativën dhe ta godasim me emër Partinë Komuniste të Kinës, këtë nuk duhet dhe nuk do ta bëjmë.

E dyta, në marrëdhëniet tona me Kinën, **pikëpam-**

jet tona, sikurse ua kemi thënë, t'ua themi haptazi edhe paskëtaj, t'u themi se ku nuk jemi dakord me ta. Për luftën kundër imperializmit, natyrisht, ne do të jemi dakord me ta, kurse për unitetin, ndërsa ata do ta zbutin qëndrimin e tyre, ne do ta vazhdojmë propagandën tonë pa u lëkundur në luftën kundër revizionizmit modern.

Marrëdhëniet shtetërore me Republikën Popullore të Kinës ne do t'i ruajmë, po pa bërë lëshime parimore. Do t'u lëmë të kuptojnë se kreditë nuk na i japin për lëmoshë dhe me to nuk na blejnë dot. Por, meqenëse hiqen si një parti internacionaliste, sado që kemi pikëpamje të kundërta për tri të katërtat e çështjeve, duke marrë parasysh se ne jemi në situata të vështira ekonomike, do t'u kërkojmë kredi, por pa kondita. Ne kundër revizionizmit modern do të flasim, ata po të duan le të na i presin kreditë, nga parimet ne nuk do të lëshojmë.

Prëzimi i Hrushovit do të ketë pasoja në vijën dhe në qëndrimet e revizionistëve modernë. Edhe 29 pikat, me të cilat thuhet se akuzojnë Hrushovin, janë një demaskim i vijës së revizionistëve sovjetikë, se atje ka gjëra që janë tonat, si, për shembull, çështja e Kubës, e tokave të reja etj., etj. Prandaj nuk është e vërtetë ajo që thotë Çu En Lai. Ky e gjykon çështjen nga pozitat e tij revizioniste oportuniste kur thotë që do të ketë njerëz që të deklarojnë se këto qëndrime të sovjetikëve (të udhëheqjes së re revizioniste të BS) janë false. Çu En Lai i konsideron të mira ato qëndrime, kurse ne nuk i konsiderojmë të mjaftueshme. Këtu qëndron diferenca ndërmjet nesh. Çu En Lai tha se «ne

(kinezët) kemi besim tek ata», kurse ne shqiptarët nuk kemi. Akuzat që udhëheqja aktuale revizioniste sovjetike bën kundër Hrushovit ne nuk mund t'i marrim si të vendosura dhe të realizuara. Vetëm kur të shohim, për shembull, që në lidhje me kultin e Hrushovit do të veprojnë hapur për ta dënuar, atëherë ne do të themi se këta po e demaskojnë Hrushovin. Pa bërë gjëra të tilla, pa i parë në qëndrimet dhe në veprimet e tyre konkrete si mund të gënjëhemi ne e të themi se revizionistët sovjetikë ndryshuan drejt «së mirës» dhe të kemi besim tek ata?

Për sa i përket akuzës që i bëhet Hrushovit se partinë e ndau më dysh, sovjetikët duhet të dalin publikisht për ta demaskuar këtë vepër likuidatore të Hrushovit si revizionist, atëherë ne do të themi se udhëheqësit aktualë sovjetikë po bëjnë një hap përpara. Kështu do të themi po të veprohet edhe për aleancat antiimperialiste etj. Ç'kuptim ka aleanca antiimperialiste me revizionistët? Kjo është një pikëpamje antimarksiste. Pikërisht se janë revizionistë udhëheqësit sovjetikë, ju kinezët keni tre-katër vjet të tërë që flitni kundër tyre. Prandaj sovjetikët të rrëzojnë një herë të gjitha ato që kanë thënë e bërë më parë, pastaj të mendojnë për aleancat.

Kështu qëndrojnë çështjet. Me kinezët shihet se politikisht dhe ideologjikisht urat po priten. Ata këtë e bënë në mënyrë brutale; «mendimi» i tyre, për të cilin thonë se na e shfaqën, është një bluf, pse ata vërtet na e shfaqën atë po edhe vepruan pa pyetur njeri. Kështu çështja e marrëveshjeve, e bisedimeve, e konsultimeve paraprake të përbashkëta, e partive të bara-

barta, të gjitha këto që janë trumbetuar më të madhe nga ana e tyre, duket qartë se kanë qenë dhe janë vetëm llafe. Me këtë që bënë ata i vunë pikat mbi i. Sido të qëndrojnë në të ardhmen karshi nesh, do të shohim, ne do të kemi durim dhe do t'u përgjigjemi.

Tani ç'duhet të bëjmë ne përpara kësaj situatë të re? Unë mendoj se edhe ne duhet t'u japim një përgjigje në bazë të konkluzioneve që do të dalin nga diskutimi që do të bëjmë mbi këtë problem në Byronë Politike. Ne mund t'u përgjigjemi edhe me gojë, sikurse vepruan ata, por, do të ishte më mirë që përgjigjen tonë, po të arrijmë, ta formulojmë në një letër që ta kenë të shkruar.

E treta, është çështja e festës së **Revolucionit të Tetorit dhe e 8 Nëntorit, përvjetorit të themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë**. Më parë ishte menduar të bëhej një mbrëmje solemne, por kam menduar dhe do t'i propozoj Byrosë që të mos e bëjmë mbrëmjen, se së afërmi do të kemi festën e 20-vjetorit të Çlirimit, në të cilën do të flasim gjerë dhe do të mbajmë një qëndrim të plotë mbi këto probleme. Prandaj mendoj të mos e copëtojmë fjalimin. Po mbledhje në qendrat e punës jo vetëm të bëhen, po ne duhet të japim edhe një direktivë të caktuar për trajtimin si duhet të situatës aktuale. Domethënë të bëhen kudo mbledhje, në të gjitha qendrat e punës dhe në fshatra, ku të flitet në mënyrë më të zgjeruar nga sa foli Spiro Koleka në festën e Beratit më 22 tetor, të demaskohet revizionizmi sovjetik, të demaskohen shokët e Hrushovit etj. Partia duhet ta vazhdojë pa u përkulur luftën kundër kësaj tradhtie.

Çështja tjetër është që mbi bazën e atyre që tha Spiroja në Berat është përgatitur një artikull, të cilin duhet të vendosim nëse duhet ta botojmë apo jo. Kisha menduar sikur të prisnim sa të merreshim vesh edhe me kinezët mbi këto çështje, po tani kjo ra. Kinezët nesër do të venë në Moskë, kurse ne nuk do të vemi. Kjo, domethënë vajtja e kinezëve dhe mosvajtja jonë, do të bëjë përshtypje në botë, do të bëjë bujë, prandaj tani është e nevojshme që për opinionin botëror dhe për Partinë tonë të dihet qëndrimi i Partisë së Punës të Shqipërisë mbi këto ngjarje.

Mendoj se është koha ta «përsëhendetim» gjer në fund tradhtinë, indirekt edhe Kinën, të mësojnë njerëzit qëndrimin e Partisë së Punës të Shqipërisë. Artikullin mund ta rregullojmë në mënyrë që të mos i prekim ata, po ai është i domosdoshëm të botohet. Në momentin kur Partia Komuniste e Kinës vepron me *fait accompli* neve na duhet të shfaqim qëndrimin dhe pikëpamjet tona. Ky artikull¹ duhet të jetë orientim për mbledhjet në qendrat e punës dhe në fshatra për festat e 7 dhe 8 Nëntorit. Qëllimi kryesor për të cilin ne e botojmë artikullin është që të përgatitet Partia për rreziqet e ardhshme, prandaj Partia të jetë top.

Ftesat për festën e 20-vjetorit të Çlirimit t'i bëjmë ashtu si kemi vendosur. Në qoftë se kinezët do të na pyesin me letër mbi qëndrimin që do të mbajmë ne,

1. «Të ngremë lart flamurin fitimtar të ideve të Tetorit të Madh». Kryeartikull i gazetës «Zëri i popullit», më 7 nëntor 1964.

t'u përgjigjemi që do të flasim për ato që mendojmë dhe përbëjnë vijën tonë, domethënë do të flasim kundër Kongresit të 20-të dhe të 22-të. . .

Sot pasdite, në orën 18⁰⁰ bashkë me Nexhmijen shkuam në Teatrin e Operës e të Baletit për të parë shfaqjen e ansamblit të këngëve e të valleve të Phenianit. Ansambli ishte shumë i mirë. Vallet ishin të bukura, por edhe këngët nuk mbeteshin pas. Solistët këndonin veçanërisht shumë bukur këngët tona popullore, këndonin me delikatesë dhe ëmbëlsi.

E SHITUNE
31 TETOR 1964

Iu dërgua sot gazetës «Zëri i popullit», për ta botuar në numrin e saj të nesërm, artikulli me titull «Me rënien e N. Hrushovit nuk është zhdukur revizionizmi hrushovian»¹.

Duke pasur parasysh iluzionet që po duken te disa parti, në artikull vëmë në dukje se likuidimi i personit të Hrushovit nuk do të thotë likuidim i kursit të tij politik, ideologjik, ekonomik e organizativ dhe theksojmë se Partia jonë, ashtu si gjithë marksistë-leninistët dhe revolucionarët e vërtetë, do të vazhdojë me vendosmëri luftën e saj të drejtë deri në shpartallimin përfundimtar të revizionizmit modern.

Sot u bë mbledhja e Byrosë Politike. Diskutuam gjerësisht për qëndrimin antimarksist të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës ndaj Partisë sonë pas rrëzimit të tradhtarit Nikita Hrushov².

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 93.

2. Po në këtë datë, autori ka hedhur në Ditar refleksione të cilat janë botuar në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 125, me titullin: «Nuk mund të pajtohemi në asnjë mënyrë me këto pikëpamje të Çu En Lait».

E MARTË
3 NËNTOR 1964

Nexhmija shkoi në Berat për të marrë pjesë në festën e 20-vjetorit të Kongresit të Parë të Bashkimit të Grave Antifashiste Shqiptare¹.

E MËRKURE
4 NËNTOR 1964*

Çen Jia, i cili këto ditë ndodhet për vizitë në disa shtete të Afrikës, u tregua shumë i sigurt se revizionist më i keq se Hrushovi s'mund të vijë më në Bashkimin Sovjetik dhe tha se tre-katër udhëheqësit kryesorë aktualë të Bashkimit Sovjetik s'janë të rëndësishëm. Sipas tij, këta, edhe sikur të duan të bëjnë një kthesë të menjëhershme, nuk janë në gjendje ta bëjnë. Kthesën që mund të bënin këta, vazhdoi Çen Jia, e pengon presioni i partizanëve të Hrushovit e revizionistët e vendeve socialiste dhe ata të vendeve kapitaliste. Ata mund ta hiqnin pa kongres Hrushovin, po ndërrimin e vijës duhet ta bëjë kongresi. Në qoftë se këta ndërrojnë vijën, kjo, sipas Çen Jisë, do të ketë reperkusione të mëdha në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste do të pëlcasë kundërrevolucionin. Prandaj, vazhdoi Çen Jia, udhëheqësit sovjetikë do të ecin me kujdes dhe ne duhet t'i ndihmojmë ata. Ne, tha ai, nuk duhet të shpejtohem në qëndrimin ndaj udhëheqjes sovjetike, ne duhet ta ndihmojmë dhe të presim; kështu s'ka rrezik që, duke ndihmuar atë, të mendohet se ne ndihmojmë revizionizmin. Çen Jia

1. Po në këtë datë, autori ka shkruar shënimin: «Kinezët kërkojnë të na imponojnë mendimet e tyre», që është botuar në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 136.

tha gjithashtu se «kjo mund të ndreqë disa gabime të partisë dhe ne duhet të kënaqemi me ndreqjen e disa gabimeve të vogla». Ai tha se për gabimet e udhëheqjes sovjetike nuk do të flitet publikisht, sepse do të përsëriteshin gabimet që u bënë ndaj Stalinit; ne duam t'i ndreqin gabimet gradualisht, duke i trajtuar këto në mënyrë shoqërore dhe këto gabime të mbeten brenda partive motra, të mos bëhen publike...¹.

1. Shih vazhdimin e këtyre shënimeve në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 145.

E ENJTE
5 NËNTOR 1964

*... Çu En Lai shkoi në Moskë i entuziazmuar shumë. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës veproi brutalisht në këtë çështje, duke hedhur poshtë edhe normat më të thjeshta të marrëdhënieve me njerëzit, për të mos folur për normat dhe parimet marksiste-leniniste që lidhin shokët dhe miqtë e luftës me njëri-tjetrin. Ndërkaq Kim Ir Seni nuk shkoi në Moskë për festë, siç dha urdhër Çu En Lai (Kim Ir Seni deri diku është për këtë vijë pajtuese); mosvajtja e tij në Moskë tregon të paktën njëfarë pavarësie, dinjiteti për Partinë e Punës të Koresë.

Edhe miqtë e rinj të kinezëve, rumunët, me sa dimë deri tash, nuk e pranuan gjithashtu diktatin e Çu En Lait që Dezhi të shkonte në Moskë, në një kohë kur atje po venë revizionistët e tjerë, si Gomulka, Kadari, Novotni, Ulbrihti, Zhivkovi...¹.

1. Shënimet e plota të mbajtura në këtë datë janë botuar në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 149.

U transmetuam kinezëve mendimin e Partisë sonë për rrëzimin e Hrushovit, për shokët e tij që mbetën në fuqi, për situatat e krijuara, ç'qëndrim duhet të mbajmë dhe si duhet të veprojmë më tej.

E SHTUNË
7 NENTOR 1964*

Fjalim kauçuk me rastin e 47-vjetorit të Revolucionit Socialist të Tetorit. Vetëm oportunistë dhe revizionistë të vendosur mund të shkruajnë një fjalim të tillë as mish, as peshk, një fjalim që përpiket t'i kënaqë të gjithë, por s'kënaq askënd dhe veçanërisht përpiket të gënjejë «marksistët» e lëkundshëm, e në radhë të parë shokët kinezë.

Ky fjalim pritej të sqaronte diçka, por ai nuk sqaroi asgjë ose, më mirë të thuash, i sqaroi të gjitha ato që ne, komunistët shqiptarë, i kishim menduar qysh më parë. Ky fjalim ishte pasqyra e gjendjes shpirtërore dhe e konfuzionit ideopolitik të revizionistëve sovjetikë dhe të shokëve të tyre, ai tregonte hutimin e tyre përpara katastrofës që pësuan, frikën që i ka mbërthyer për të ardhmen, mënyrat hezituese si ta ngadalësojnë, në mos e pengofshin dot katastrofën. Me këtë fjalim llastik, revizionistët sovjetikë, përpara vështirësive të mëdha që kanë krijuar, përpara zjarreve të shumanshme, në të cilat i ka futur politika e tyre tradhtare, përpara kontradiktave të panumërta ku janë kredhur, përpara frikës që kanë nga marksistë-leninistët dhe nga

popujt sovjetikë, me zemër të dridhur përpiqen të arnojnë situatën e nderë, përpiqen t'u vënë melhem plagëve, përpiqen t'u japin opium të tjerëve për të dalë hëpërhë nga ky kaos i rrezikshëm.

Objektivat kryesorë të fjalimit janë:

a) Të qetësojnë situatën brenda. Situatën revolucionare ta dobësojnë vetëm me faktin demonstrativ të heqjes së Hrushovit, duke lënë të kuptohet: Hrushovi kishte bërë gabime, këto jua thamë nëpër organizatat-bazë dhe me aluzionet që bëjnë nëpër gazeta. Ka edhe gabime të tjera të rënda, këto ju i merrni me mend vetë, por kini shpresë se javash-javash çdo gjë do të vihet në vend. Tash, për të ruajtur prestigjin e Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nuk mund të ecim më tej. Gradualisht duhet të ndreqim disa gabime flagrante ekonomike (këtu natyrisht duhet të punojmë, bile të shtrëngojmë rripin, se fajet i ka Hrushovi) dhe disa norma të partisë (për një kohë nuk do të ketë shumë fotografi të Brezhnjevitet të Kosiginit). Dhe ja prova e parë kundër kultit të personit: nuk i mban një njeri të dy postet kryesore, atë të partisë dhe atë të qeverisë etj., etj.

Kështu, me një qese plot me demagogji të tillë, do të përpiqen revizionistët të shuajnë pakënaqësitë brenda vendit.

Partizanët e Hrushovit dhe revizionistët brenda e kanë më lehtë, për arsye se, megjithëqë Hrushovi iku, hrushovianët mbetën në fuqi, vija mbeti e pandryshuar, «ndryshimet» që do të bëhen, do të realizohen nën drejtimin e tyre; prandaj atyre u lihet të kuptojnë që nostalgjinë dhe admirimin për Hrushovin ta ruajnë, por

të shtrëngojnë radhët rreth udhëheqjes së re hrushoviane, pse «përndryshe na piu e zeza, do të pëlcase revolucionin», dhe, kur pëlcet revolucionin, dihet mirë se kush fiton. Prandaj tërhiqet vëmendja: revolucionin duhet ta evitojmë, tek e fundit pak gjë humbasim në goftë se lëshojmë diçka dhe ia hedhim fajin Hrushovitet — «koka e turkut». Në këtë rrugë do të konsolidojë radhët e saj udhëheqja revizioniste.

Fjalimi i Brezhnjevitet u thoshte atyre se s'humbën gjë me rënien e Hrushovitet; vija e tij, vija e kongreseve të 20-të, të 21-të dhe të 22-të qëndron e palëvizshme. Kurse marksistëve dhe revolucionarëve sovjetikë fjalimi i Brezhnjevitet u hidhte me grushte të hanin formula parimore si «uniteti», «kritika-autokritika», «kolegjialiteti» etj.

b) Të qetësojnë klikat revizioniste jashtë Bashkimit Sovjetik. Sigurisht kontradiktat që kanë ekzistuar në mes tyre dhe Bashkimit Sovjetik, do të thellohen edhe më shumë. Me italianët dhe me rumunët kontradiktat dolën sheshit, por me të tjerët, pavarësisht se s'dolën sheshit, nuk ishin më pak të acaruar. Rrëzimi i Hrushovitet do t'i acarojë më tepër jo aq për arsyen se iu «dogj barku për Hrushovitet», po për vete, për stabilitetin e tyre.

Vetë fakti që klikat revizioniste humbën «Yllin e karvanit», pavarësisht se me të edhe ziheshin, edhe grindeshin, edhe i bindeshin, edhe i bënin presion, dhe kështu «Ylli» i tyre po errësohej, e se «Yll të karvanit» më nuk kanë, kjo ata edhe i kënaq, por edhe i frikëson. I kënaq se tash janë të lirë të mendojnë dhe të vendosin si të duan, mund të flenë me Shtetet e Bashkuara

të Amerikës, sikurse mund të flenë me Anglinë, por mundet edhe me të dyja së bashku; i frikëson se Hrushovi, ky tradhtar me damkë, s'është më për ta, jo pse këta që e zëvendësuan tradhtarin s'janë si ky, por janë të tillë tradhtarë që qëndrojnë mbi prushe zjarri. Pra nga kjo anë vdiq edhe ai gjoja unitet marksist-leninist.

Cilido nga këto grupime revizioniste, në fuqi ose jo, do të shpallet i pavarur me tërë kuptimin e fjalës. Këtë filloi ta shpallë udhëheqja çeke, franceze dhe nesër të tjerët me radhë. Ata dje betoheshin për kongreset e 20-të e të 22-të, sot flasin për to me zë të ulët, nesër do të heshtin fare dhe do të ruajnë gjoja frymën e këtyre kongreseve. Sovjetikët luftonin për hegjemoni, por u doli përpara policentrizmi. Tash do të zhvillohet plotësisht decentralizimi dhe anarkia nën parullat e flamurit të «marksizëm-leninizmit», të «unitetit proletar», të «unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare».

Grupet revizioniste po i dëgjojnë me difidencë «fjalët e bukura» të kinezëve, te të cilët nuk kanë as më të voglin besim, por vëzhgojnë gjithashtu me mosbesim edhe ndaj sovjetikëve, se deri ku këta do t'i hanë «këto ditirambe» kaq të papritura të shokëve kinezë. Do të bashkohen «të dy të mëdhenjtë», do të bëjnë ligjin dhe do të na vënë shpatën e Damokleut mbi kokë — mendojnë revizionistët. A do të rrimë ne me duar lidhur dhe me gojë hapur të presim shpëtimin nga qielli? — pyesin revizionistët «e vegjël». As te njëri, as tek tjetri ata s'kanë besim dhe mosbesimi do të shtohet; ata me doemos do të reagojnë. Jo vetëm revizionistët sovjetikë që nuk do t'u lëshojnë asgjë kinezëve, por edhe grupimet revizioniste do të bëjnë presion nga platforma e

pavarur, që të mos bëhet asnjë lëshim. Kinezët duhet të zbrapsen, të përulen, të çarmatosen dhe të ecin në rruqën e atyre. Revizionistët sovjetikë, pra, nuk e kanë të qetë situatën nga kjo anë dhe po bëjnë përpjekje ta qetësojnë.

Fjalimi i Brezhnjev-it e kishte kujdes këtë çështje, duke u thënë atyre: Asgjë s'ka ndryshuar, çdo gjë ecën si më parë; kongreset e 20-të, të 21-të dhe të 22-të janë në vend, aleancat janë në vend; frenat, dua s'dua, do t'jua lëshoj (derisa të forcoj pozitën dhe të rregullohen koniunkturat; pastaj, «dallëndyshe ktheje ndryshe»). Pra, në drejtim të kinezëve asnjë lëshim, le të kënaqen me faktin se hoqëm Hrushovin dhe le të rrojnë me shpresa si ajo dhelpra e përrallës, e cila ndiqte dashin që i vareshin topet, duke shpresuar se do t'i binin në ndonjë kthesë rruge.

c) Të qetësojnë kinezët, t'i gënjejnë që të shuajnë polemikën dhe javash-javash t'i futin në kllapa. Të dyja palët me këto parime ecin, kush do të gënjejë njëri-tjetrin dhe kush do t'i hedhë më parë kllapat. Parimet e luftës s'janë më revolucionare, nga sovjetikët jo e jo, por as nga kinezët. Nga të dyja palët po zbatohet taktika e luftës së miut me macen.

Megjithëse fjalimi i Brezhnjev-it nuk u bën asnjë koncesion parimor kinezëve, në format si është ndërtuar nga jashtë krijon disa iluzione, hedh disa pika «mjalti sintetik» për të kapur hundën e mizës. Por fakt është se kinezët, që mendonin, si Cezari në Romë, të dërgonin në Pekin telegramin *veni, vidi, vici!*, s'e arritën dot.

1. Latinisht — erdha, pashë, fitova.

Nga një anë, Brezhnjevi mbrojti regjimin dhe fitoren e Xhonsanit, nga ana tjetër mund të kënaqë shpresat e kinezëve me «kërcënimin e Malinovskit» që u bëri amerikanëve. Sikur të tilla gjëra, bile akoma më kërcënuese, nuk bëheshin edhe më parë nga Hrushovi, edhe nga po ky Malinovsk!

Me një fjalë, të dyja palët kanë të njëjtat taktika. Sovjetikët thonë: Të ecim me ngadalë, me kujdes, së përnjëherë kinezëve s'ua hedhim dot zinxhirët, por me durim, me ca mjaltë, me ca sheqer t'u futim pilulën e helmatisur, pastaj, pasi ta kenë pirë, puna ecën vetë. Çështja është t'i komprometojmë, t'i bëjmë edhe këta si veten ideologjikisht; pa kontradiktat në rrugën tonë as që do të shuhen. Qartë! Ai që ndan hesapet në këtë stan, është ligji i forcës, i xhunglës.

Kinezët, nga ana e tyre, ndjekin po të njëjtën taktikë: Të kemi durim, të mos i sulmojmë, t'u këndojmë këngë gjumi dhe javash-javash t'i futim në kllapa, nën drejtimin tonë. Zaten, thonë kinezët, kjo taktikë është e njohur te ne dhe ka dhënë fryte, kjo është si historia e gjeneralit Fu Ca Ji, gjeneral i Çan Kai Shisë, i cili u mund nga komunistët, u dorëzua dhe Maoja e bëri ministër të bonifikimeve e të energjetikës dhe zëvendëskryetar të komisionit ushtarak të Kinës. Kjo është autentike. Mbi këtë eksperiencë të sklerozuar po bazojnë shokët kinezë politikën e tyre aktuale me udhëheqjen e re sovjetike. Mund të merren me mend rezultatet e një politike të tillë.

c) Të qetësojnë imperialistët amerikanë. Fjalimi i Brezhnjevut në këtë drejtim u jep satisfaksion e siguri të plotë ish-aleatëve të Hrushovit dhe që mbetën prapë

aleatët e tyre. Brezhnjevi u thotë amerikanëve: «S'keni pse shqetësoheni, ne nuk e ndryshojmë kursin në marrëdhëniet me ju, bile ju duhet të jeni të kënaqur, pse nuk do t'ju themi: «Do t'ju futim në varr», siç i shkiste goja padashur Hrushovit. Me ne do të ecet «urtë e butë e plot tigani»». Për disa gjëra të vogla taktike Brezhnjevi u thotë amerikanëve: Ne do të merremi vesh që më parë me teletajpin e kuq që kemi vendosur në linjën Kremlin—Shtëpi e Bardhë.

d) Marksistë-leninistëve të vërtetë në botë Brezhnjevi s'ka ç'u jep. Ata janë armiq të vendosur të tij, që do t'u bëjnë varrin revizionistëve modernë, nën çdo maskë që të fshihen. Ata ua prishin gjumin të gjitha këtyre kategorive të revizionistëve, të cilët fjalimi i Brezhnjevut përpiqet t'i qetësojë. Këto kategori nuk kanë dhe s'do të kenë qetësi.

Prandaj fjalimi i Brezhnjevut nuk ka zgjidhur asgjë. Të gjitha huanatë e revizionistëve sovjetikë për «rrugën e ndritur», «për partinë e madhe» që e njolloshën, për rrugën «leniniste» që s'është tjetër veç tradhti, bien si një daulle e shpuar. Të gjitha këto bëjnë atë zhurmë që bën teneqja që i kanë varur një qeni në bisht.

Është tragjedi që në këto momente kaq të favorshme për lëvizjen komuniste ndërkombëtare të ndihmsh revizionistët e urryer, sikurse mendojnë të bëjnë kinezët, duke u bazuar në eksperiencën e gjeneralit çankaishist Fu Ca Ji dhe të hedhësh poshtë eksperiencën e mareshalëve marksistë botërorë: Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit.

E DIEL
8 NËNTOR 1964

Kur shkruaj në fletore këtë datë, shumë kujtime më ngjallen dhe ndiej krenari të ligjshme.

23 vjet që nga themelimi i Partisë sonë të shtrenjtë, 23 vjet luftë e fitore.

U takuan në Tepelenë nënat, baballarët, motrat dhe të afërmit e dëshmorëve dhe më bënë një letër të ngrohtë e plot dashuri për Partinë.

Edhe unë iu përgjigja sot me një letër¹.

*Artikuj dhe fjalime të çuditshme! Besoj se edhe në kohët e arta të miqësisë sovjeto-kineze pak herë kinezët mund të kenë shkruar artikuj kaq entuziastë për miqësinë kino-sovjetike si ky i gazetës «Zhenminzhibao» me rastin e 47-vjetorit të Revolucionit Socialist të Tetorit. Dhe këto janë shkruar disa javë pas rënies së Hrushovit dhe pas një polemike publike të pa-

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 103.

shembullt. Është arritur deri atje sa vetë ata të thonë në mes të tjerash: «Maoja i ka mësuar kinezët të ndjekin rusët» ose «ne, kinezët, jemi të mahnitur, të entuziazmuar nga sukseset madhështore që ka arritur Bashkimi Sovjetik brenda këtyre 47 vjetëve» etj. Dhe të gjitha këto shkruhen kur vetëm disa muaj më parë kinezët thoshin se sovjetikët vuanin për bukë dhe blinin nga amerikanët.

Me të vërtetë qëndrim skandaloz, pa dinjitet, çdo gjë false, çdo gjë e thënë me hipokrizi për të arritur disa qëllime në rrugë jo të ndershme. Po të gjitha këto «buketa me lule» ose këto «deklarata dashurie» apo «betime besnikërie të pafund» nuk i ha kush, dhe ca më pak revizionistët sovjetikë. Në fakt, këto janë mirëpritur nga sovjetikët, sepse pavarësisht që nuk gënjejnë njeri, por të paktën vënë mirë në dukje karakterin e komplikuar, *bizarre*¹, të lëkundshëm të udhëheqësve kinezë.

Natyrisht, kinezët mendojnë të vrasin disa zogj me një të shtënë, të gënjejnë udhëheqësit e rinj sovjetikë, t'i ndihmojnë ata në sytë e popujve sovjetikë në këto momente të vështira ku ndodhen, t'u japin një dorë «kundër presioneve të revizionistëve të huaj», «të intrigojnë dhe të trembin imperialistët», «të çelikosin miqësinë me popujt sovjetikë» etj., etj. Këtu mund të zgjatemi sa të duash. Taktikë gjeniale!!! Vetëm duhej menduar! Këtë taktikë e polli mendja femër e Çu En Lait. Sa për efektin e kundërt që mund të bëjë kjo taktikë, për këtë udhëheqjes kineze nuk i ka shkuar fare ndër mend.

1. Frëngjisht — të çuditshëm

I gjithë artikulli përshkohet fund e krye nga ky ton ekzaltues, por fjalimi i shokut kinez në mbrëmjen solemne ka shkuar deri atje sa të mos zërë në gojë, të paktën për formë, «luftën» kundër revizionizmit modern. Kurse në darkën që shtroi ambasadori sovjetik në Pekin me rastin e përvjetorit të Revolucionit të Tetorit, me përjashtim të Maos, kanë shkuar të gjithë, që nga Liu Shao Çia e deri tek i fundit. Por e bukura këtu është (dhe për këtë mbështetem tek të dhënat e HSINHUA-së) se ambasadori sovjetik tha vetëm disa fjalë mirësearchjeje dhe ngriti doli pa denjuar të përmendë as emrin e Maos dhe as atë të Liut që asistonte në festë. Kurse Çen Jia mbajti një fjalim të gjatë, nja pesë a gjashtë faqe (kurdoherë sipas HSINHUA-së) dhe çfarë fjalimi! Çfarë dollira! Të gjitha me adresë. Me të vërtetë e paimagjinueshme! E pakonceptueshme për ne! Edhe sikur Molotovi të kishte ardhur në krye të partisë, ne do të frenoheshim disi. Për kinezët s'kishte asnjë fre.

Me gjithë këto, për çdo eventualitet, e kjo edhe për të ruajtur fasadën, në kryeartikullin e tyre disa pozita sikur i ruajnë dhe këto janë: në një vend përmendin emrin e «kampit socialist», por kjo e futur brenda në ditirambet. Zihet në një vend emri «Lenin-Stalin» më shumë si formulë, zihet në gojë Hrushovi dhe cilësohet si tradhtar etj.

Pozitat e luftës kundër imperializmit, bashkekzistenca paqësore, qëndrojnë si përpara, por të gjitha këto të inkuadruara në artikull me një frymë dhe me një ton të tillë, dalin të zbehta, kashtë, ose sa për të kaluar radhën. Artikulli, në radhë të parë, do të thotë të pu-

themi, të puthemi, pa të tjerat i gjejmë më vonë, me ngadalë, hap pas hapi.

Të gjitha këto s'janë shenja të mira. Duhet të jemi vigjilentë. Interesat e atdheut, të Partisë, të marksizëm-leninizmit nuk na lejojnë kurrësi të shuajmë vigjilencën kundër kujtdo goftë, sikur të japë edhe shenjë më të vogël të lëkundjes. Ata që lëkunden e kemi për detyrë t'i këshillojmë, t'i ndihmojmë; në rast se na përbuzin ose sillen arrogantë, si zotërinj, t'u tregojmë vendin, duke ndjekur me vendosmëri, pa lëkundje, rrugën tonë të drejtë marksiste-leniniste.

E HËNË
9 NËNTOR 1964

Në mbledhjen e Byrosë Politike që u mbajt sot u diskutua rreth relacioneve mbi zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës popullore gjatë pesëvjeçarit të katërt, si dhe për disa çështje të tjera.

Në diskutimin tim¹ dhashë mendime dhe bëra disa vërejtje për projektplanin e këtij pesëvjeçari, në bazë të këtyre shënimeve që kisha përgatitur.

Në koniunkturatur aktuale, dhe në çfarëdo kohe, në hartimin e planit duhet të mbështetemi në forcat tona, në të ardhurat tona kombëtare, në akumulimin e brendshëm dhe zhvillimi i mëtejshëm i forcave prodhuese të mbështetet kryesisht në këto mundësi reale. Prandaj plani të jetë i shtrënguar dhe jo me supozime e duke shpresuar në kreditë që do të na japin miqtë. Ne, natyrisht do të kërkojmë kredi nga miqtë, por këtë do ta bëjmë pasi ta kemi studiuar çështjen dhe të kemi vendosur sa kredi do të kërkojmë dhe në ç'drejtim. Dhe, pasi t'i sigurojmë kreditë, dhe duke ditur edhe sa do të sigurojmë, atëherë i inkuadrojmë këto në planin

tonë, i cili mbasandaj merr formë të prerë dhe është real. Se, po të hartosh një plan ku të vetëpërcaktosh kufijtë e kredive që janë hipotetike, s'ka se si të mos largohesh nga realiteti, t'i konceptosh planet të fryra, të rritësh investimet jashtë masës, të mos planifikosh drejt shfrytëzimin e mundësive të brendshme. Me një fjalë, kësaj i thonë të rrosh për një kohë, derisa të të caktojë kreditë miku, në një ëndërr të kënaqshme për dëshira, por jo për gjëra reale.

Kredia, që ne duhet të kërkojmë nga miqtë, të jetë e arsyeshme, e argumentuar, as e paktë, por as edhe e shumtë.

Në këto koniunktura ekonomike dhe politike nuk mund të zhvillojmë më tej forcat prodhuese siç dëshirojmë dhe siç paraqiten në projektplanin bazë që na është paraqitur. Por unë mendoj se edhe sikur situatat të ishin normale, prapë në investime projektplanin paraqitet shumë i rëndë për supet tona. Ne duhet të investojmë në disa drejtime vendimtare, kyç për ekonominë tonë, si, për shembull, në metalurgjinë e hekur-nikelit, të bakrit, për sigurimin e energjisë së nevojshme elektrike, për çimenton, naftën etj. Për të tjerat, duhet t'i nderim këmbët aq sa kemi jorganin, se duhet të parashikojmë edhe kohë të vështira. Revizionistët sovjetikë na shkaktuan shumë dëme, duke ndikuar në ngadalësimin e ritmeve të zhvillimit të forcave prodhuese. Këto situata të mos i harrojmë dhe sidomos të mos ngarkohemi me investime të rënda në industri, ku kërkohen shumë shpenzime të brendshme, por ku edhe faktori i jashtëm luan rol të madh.

Me bujqësinë çështja qëndron ndryshe. Kjo sepse

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 106.

bujqësia paraqet për ne një fushë pa pengesa, pa rreziqe dhe sabotime eventuale nga jashtë. Prandaj varet nga ne dhe vetëm nga ne që bujqësia, ky sektor kolosal, vendimtar, sidomos në këto koniunktura të ecë përpara. Bujqësia ka rëndësi të dorës së parë, për të gjitha ato që dimë dhe që kemi thënë, por ky sektor merr rëndësi akoma më të madhe për arsye të situatave politike, për arsye të pamundësisë së zhvillimit të sektorit industrial me ato ritme që dëshirojmë.

Natyrisht, një plan i tillë, i ndërtuar në këtë prizëm, do të jetë më i drejtë, më real, më frytdhënës dhe do ta forcojë ekonominë tonë, do ta përmirësojë jetën e popullit. Niveli i jetesës do të ngrihet, mundet 10 për qind ose edhe 5 për qind por mund të qëndrojë edhe në këtë nivel që është sot, po për t'u ulur nuk do të ulet. Në këtë rast duhet t'ia shpjegojmë popullit dhe ky, me siguri, do ta kuptojë se ruajtja e nivelit të jetesës, në këto situata politike, është prapë një sukses i madh.

Të rishikohet dhe të përpunohet projektplan i pesëvjeçarit të katërt, duke pasur parasysh vërejtjet e vlefshme të shokut Hysni për bujqësinë dhe të shokut Haki për industrinë, si edhe vërejtjet e shokëve të tjerë.

- a) Të evitohet rëndimin e investimeve dhe të ndërtimeve.
- b) Të evitohet shtimin e panevojshëm të punëtorëve dhe për veprat e reja të merren kryesisht forca të lira nga qyteti.
- c) Të mos sjellim shumë makineri dhe, në rast se sjellim, të kalojnë në rezervë shtetërore.
- d) Shfrytëzimi i plotë i fabrikave dhe i makinerive ekzistuese. Ruajtja e tyre nga prishjet. Traktorët,

makineritë, veglat bujqësore etj., deri edhe veglat e ndërrimit të përdoren me ekonomi të madhe. Teprica në rezervë.

- e) Ngritja e rendimentit në rend të ditës.
- f) Vënia në shfrytëzim sa më parë e objekteve të reja. Të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë dhe rezervat duke ngritur rendimentin dhe duke vendosur punën me turne.
- g) Hidrocentralin e Vaut të Dejës ta ndërtojmë. Më shumë tani për tani nuk bëjmë dot. Në qoftë se nuk do të arrijmë këtë, atëherë të shtojmë kapacitetin e TEC-it të Fierit.

Për pemët frutore të zbatohet orientimi i përcaktuar, duke pasur parasysh cilësinë, specialistët, blloqet etj. Të mos harrojmë eksportin e frutave.

E MARTE
10 NENTOR 1964

T e z a

— **Ç'do të thotë internacionalizëm proletar.** Mbi ç'parime ideologjiko-politike bazohet dhe mbi ç'veprime konkrete zbatohet.

— **Ç'do të thotë kampi i socializmit** në teori dhe në praktikë. A e ka vërtetuar koha dhe a e kërkojnë situatat.

Çfarë i lidh vendet e socializmit në kamp. Ideologjia dhe politika, ekonomia dhe mbrojtja. Si duhet të jenë këto dhe si nuk duhet të jenë.

— **Çështja e unitetit ideologjik dhe politik të kampit të socializmit**, jo thjesht në formula, të cilat shkelen, shtrembërohen.

— **Rehabilitimi i plotë i Stalinit, ngritja e prestigjit dhe e autoritetit të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik**, dashuria e popujve dhe e partive marksiste-leniniste për ta.

— Lidhjet e popullit shqiptar me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe me popujt e vendeve të tjera socialiste.

— Lufta e paprerë dhe e vazhdueshme kundër revizionizmit modern e veçanërisht kundër hrushovizmit dhe titizmit.

— Tendencat e theksuara të dezagregimit të partive komuniste e punëtore nga revizionistët modernë, gjoja parti të pavarura, parti sovraane etj.

— **Unitetin në lëvizjen komuniste nuk mund ta vendosin më një ose dy parti, qofshin këto edhe të mëdha, qofshin këto edhe në rrugë të drejtë. Uniteti do të bëhet nën flamurin e marksizëm-leninizmit. Sigurimi i unitetit në lëvizjen komuniste botërore është uniteti i partive në vendet socialiste dhe ky unitet jo formal, jo me formula, jo me deklarata, por me vepra, me aksione, me lidhje të shumanshme të bëra drejt, të spastruara nga revizionizmi dhe nga çdo pikëpamje antimarksiste. Rreth një uniteti të tillë do të forcohet uniteti i lëvizjes komuniste ndërkombëtare.**

Asnjë mbledhje e komunizmit ndërkombëtar nuk mund të bëhet pa u bërë mbledhje të partive të vendeve të kampit të socializmit dhe që të bëhet një mbledhje e tillë duhen shumë mbledhje dypalëshe. Dhe që të bëhen këto mbledhje dypalëshe, duhet që revizionistët sovjetikë të njohin botërisht gabimet karshi Partisë së Punës të Shqipërisë e Qeverisë Shqiptare dhe në përgjithësi të japin prova konkrete të fillimit të njohjes së gabimeve kyç që ata kanë bërë.

Pa bërë këto, polemika s'mund të pushojë, mbledhje dypalëshe, shumëpalëshe ose mbledhje të përgjithshme s'mund të bëhen, ne do t'i kundërshtojmë, ne s'i pranojmë. Lëvizja revolucionare duhet ndihmuar, dhe ne do ta ndihmojmë atë me të gjitha forcat.

— **«Suivizmi» nuk mund të pranohet në mënyrë të**

verbër, suivizëm me tërë kuptimin e fjalës dhe në mënyrë besnike ka vetëm për marksizëm-leninizmin.

— «Dirizhizmi» nuk mund të pranohet, vetëm marksizëm-leninizmi na dirizhon, na drejton, atij i qëndrojmë kurdoherë besnikë, kurdoherë do t'u jemi besnikë, shokë dhe miq të gjithë atyre partive marksiste-leniniste dhe atyre shokëve që u qëndrojnë besnikë marksizëm-leninizmit, socializmit dhe komunizmit. Ato parti që devijojnë, ata njerëz që devijojnë, ne do t'i kritikojmë shoqërisht dhe brenda normave leniniste, në rast se ata do të tradhtojnë, ne do t'i luftojmë pa mëshirë, deri në fund dhe botërisht. Për ato parti dhe për ata njerëz që njohin gabimet, që i ndreqin, që japin prova, ne do të sillemi si leninistë.

— Çdo parti ka edhe ajo të drejtën e saj të veprojë karshi nesh lirisht, kur ajo mendon se Partia jonë gabon ose tradhton. Gjyqtari më i mirë në këto raste konfliktesh është koha, por jo koha plot «qetësi», plot «hesh-tje», por koha plot polemikë të bazuar me fakte, me dokumente, polemikë revolucionare leniniste dhe jo shpifje e gënjeshtër.

Nuk mund të pranohet «unitet kulisash» ose «unitet krerësh» që përpiqen të ruajnë të kaluarën. Vetëm unitet partish, unitet popujsh, është i vetmi unitet marksist-leninist. Më parë se të pihen «krerët» në kulisa, partitë duhet të informohen plotësisht, të vihen plotësisht në korent të kontradiktave ideologjike dhe jo të presin çdo t'u thotë dhe sa dëshiron t'u thotë «agjitor» i përgatitur, por çdo anëtar i partisë t'i vihen në dorë materialet bazë të partive të ndryshme, të caktuara nga vetë kjo parti. Kështu të gjykojë vetë partia,

të vendosë vetë partia dhe vetë partia t'i diktojë udhëheqjes ato që kjo duhet të bëjë. Këto janë momente serioze që po kalojmë dhe këto nuk mund të zgjidhen siç duan disa, por siç e lyp marksizëm-leninizmi.

Po flitet shumë për normat leniniste, si brenda partive, ashtu dhe në marrëdhëniet me partitë. Por si zbatohen këto norma, kjo është për të vënë duart në kokë. Revizionistët modernë që kanë frikë nga partia, i fshehin asaj çdo gjë dhe atë që ia thonë, ia shtrembërojnë, shpifin.

«Stalini ishte diktator i egër» etj., thonë revizionistët. Por në qoftë se ka një njeri që ka bërë një luftë të hapët, në bazë të normave leniniste, brenda dhe jashtë partisë kundër trockistëve, kundër buharinistëve, kundër zinovievistëve etj., dhe jo një muaj, po vite me radhë, ai ka qenë Stalini. Në qoftë se ndonjë ka urreyer metodat antileniniste të puçeve, ai ka qenë Stalini. Si veprouan dhe si veprojnë revizionistët? Kudo me metoda puçiste.

Kë vrau Stalini që revizionistët e quajnë terrorist, vrasës etj.? Armiqtë e revolucionit, tradhtarët, spiunët nuk i vrau Stalini, por revolucionit, i gjykuan gjyqet revolucionare dhe gjyqet u bënë hapur dhe debatet e vendimet janë të shtypura botërisht. Si veprojnë revizionistët? Fshehurazi, mbytazi, si kusarë. Ata rehabilitojnë tradhtarët nëpër zyra të errëta, kohë më kohë hartojnë dhe formulojnë komunikatat që i botojnë në gazeta, vendosin t'u ngrenë edhe monument këtyre tradhtarëve. Po kush i beson kuzhinës së tyre! Kurse veprat e Stalinit shkëlqejnë si diell. Kujt nuk i pëlqejnë këto vepra të Stalinit? Imperialistëve, kapitalistëve,

bjellogardistëve, trockistëve, revizionistëve, kundërrevolucionarëve, tradhtarëve.

Lufta kundër imperializmit botëror, me imperializmin amerikan në krye, duhet të vazhdojë e ashpër, e paprerë, dhëmb më dhëmb, deri në shkatërrimin e tij.

Duhet të luftojmë gjer në fund kolonializmin dhe kapitalizmin shtypës, gjer në fund dhe nën çdo maskë që të fshihen.

Duhet të ndihmojmë ndershmërisht, bujarisht, pa pushim, me çdo mjet, popujt që luftojnë për çlirimin e tyre.

Këta popuj duhet të ndihmohen sinqerisht, drejtësisht, pa kursyer, në mënyrë vëllazërore, pa interesa të ndyrë politikë dhe të demaskohen ata që duan t'i shkëputin nga një shfrytëzues për t'i lidhur me një tjetër, që maskohet me formula bombastike. Duhet miqësi e sinqertë me popujt e Afrikës dhe të kontinenteve të tjera. Atë duan ata dhe jo fjalë. Ndihma atyre të mos u jepet si lëmoshë dhe kur t'ua dojë qejfi t'u bëhen presione, t'u priten ndihmat, t'u grabiten deri te bananet për të ushqyer aristokracinë e metropoleve, që s'rron dot pa banane, dhe më së fundi të organizohen edhe komplete për të rrëzuar udhëheqjet e tyre se nuk i pëlqejnë ndokujt. Jo, kjo s'është marksiste, kjo s'është internacionaliste. Këto metoda u përkasin imperialistëve dhe kapitalistëve, të cilët u kishin hipur në kurriz shekuj me radhë popujve heroikë të Afrikës dhe të kontinenteve të tjera.

Në shekullin e leninizmit të veprohet me pikëpamjet e shovinizmit të shtetit të madh, të mendohet se me para dhe me kërcënime do të mund të dominohet, të

bëhet presion mbi popujt e vegjël, të mashtrohen këta, të ngatërrohen, të shtypen, kështu nuk i arrihet dot qëllimit. Marksizmi, leninizmi, drejtësia, forca e madhe e popujve të vegjël, nuk do të lënë asnjë forcë të veprojnë për shumë kohë si t'ia dojë qejfi asaj, qoftë ajo imperialiste, kapitaliste, borgjeze apo revizioniste. Historia e popujve ka dhënë dhe po jep çdo ditë prova të mëdha në këtë drejtim.

— Marksizëm-leninizmi është një e vërtetë e madhe, universale. Ai s'është dogmë; të vërtetat e mëdha të marksizëm-leninizmit as që mund të shpërdorohen sipas qejfit të njërit ose të tjetrit, duke u fshehur pas parullës: «T'i aplikojmë sipas vendit dhe kohës».

— Marksizëm-leninizmi është busull veprimi e çdo partie. Çdo parti mundet dhe duhet ta aplikojë marksizëm-leninizmin në konditat dhe në rrethanat e vendit të saj, por busulla tregon pa u gabuar pikat kardinale dhe në rast se me forcë do të bëhen përpjekje që veriun ajo ta tregojë në jug dhe perëndimin në lindje, pavarësisht se mund të gërthitet se mbahet një busull në dorë, ajo mund të jetë çdo gjë, po jo busull. Kështu është edhe me zbatimin korrekt të ligjeve universale të marksizëm-leninizmit.

Një parti e madhe mund të gabojë, po aq sa mund të gabojë edhe një parti e vogël. Një parti e vogël mund të gabojë më shumë se një parti e madhe, ashtu siç mund të gabojë një parti e madhe më shumë se një parti e vogël, ose një parti e vogël mund të mos bëjë gabime, kurse një parti e madhe mund të bëjë dhe gabime të mëdha. Ajo parti që gabon, qoftë e madhe ose e vogël, duhet të kritikohet që të ndreqet. Vetëm kjo rrugë

është marksiste. Të mos i kritikosh as njërën, as tjetrën, kjo është oportunist dhe prish punë, nuk ndreq punë; të kritikosh të voglën dhe të harros të madhen, kjo është servilizëm dhe të fshehësh gabimet e partisë së madhe, të mos e kritikosh, kjo i ka të gjitha të këqijat brenda, kjo është të tradhtosh marksizëm-leninizmin, pse partia e madhe me një vijë të gabuar do të bëjë dëme kolosale.

— Marksizëm-leninizmi, mësimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit, të Stalinit s'mund të jenë monopoli i disa partive. Ato janë thesari i njerëzimit, i mbarë komunistëve të botës. Ato parti ose ata njerëz që mendojnë të spekulojnë dhe të nxjerrin përfitime antimarksiste nga ajo që Marksi dhe Engelsi ishin me kombësi gjermane, ose Lenini dhe Stalini ishin sovjetikë dhe anëtarë të Partisë Komuniste (b) të BRSS dhe, si rrjedhim, çdo gjë që thonë ato parti dhe udhëheqësit e atyre partive, janë ligj i së vërtetës marksiste, në një kohë kur ato janë revizioniste, antimarksiste, kjo duhet të shkelmohet, sepse është pikëpamje antimarksiste.

— Eksperienca e çdo partie, qoftë kjo e madhe ose e vogël, është një thesar i madh i të gjithëve, e cila duhet të shfrytëzohet nga të gjitha partitë. Kjo eksperiencë e arritur në zbatimin e drejtë të marksizëm-leninizmit, në konditat dhe në rrethanat e çdo partie e të çdo vendi, është një thesar i madh që i shtohet marksizëm-leninizmit. Kush nuk e përdor, kush nuk e shfrytëzon këtë eksperiencë, ai mbetet prapa, kush e përbuz, ai s'është marksist, ai është shovinist. Por, çdo eksperiencë duhet të shkojë në shoshën e logjikës dhe frymës marksiste-leniniste. Asnjë detyrim nuk mund

dhe nuk duhet të ushtrohet nga disa mbi disa të tjerë për t'u imponuar këtë ose atë eksperiencë. Kjo nuk ekskludon këshillat shoqërore, kjo nuk ekskludon as kritikën (por të gjitha këto brenda normave që rregullojnë marrëdhëniet në mes partive marksiste-leniniste), ndaj atij që bën eksperimente, që shkel parimet, por edhe ndaj atyre që tregohen shovinistë dhe shkelin prapë parimet.

E ENJTE
12 NËNTOR 1964

Ambasadori ynë në Romë, na njoftoi për bisedën që ka pasur me një komunist italian.

Ky shok është ai që dimë dhe s'mund të pritet më shumë prej tij. Zaten ato që kemi menduar ne për atë, ai, më duket mua, sinqerisht i pohon me gojën e tij. Atij i është fishkur shpirti revolucionar, është plakur, nuk e ndien më veten as për aksione revolucionare të theksuara, as të udhëheqë një lëvizje revolucionare, goftë brenda partisë, por sidomos jashtë partisë. Ai, pra, as shpirtërisht, as fizikisht nuk mund ta bëjë këtë. Këtë gjë ai e arsyeton sipas mënyrës dhe pikëpamjeve të tij, të frymës së përgjithshme të Partisë Komuniste Italiane.

Por megjithatë, ne mund të arrijmë në konkluzionin që ky shok është kundër udhëheqjes revizioniste italiane, nuk pajtohet me të dhe qëndron në opozitë, por nuk shkon më larg. Ai është për organizimin e një pune brenda partisë, në forma opozitare, diskutimesh, por kurdoherë jo të acaruar dhe që të mos çojnë në konflikte të brendshme, pa le të jashtme. Me një fjalë, kritikata e tij evitohet format militante dhe diskutimet e

organizuar, që të sjellin si rrjedhim një rrymë të shëndoshë marksiste, e cila të shkojë kreshendo dhe të pengojë hëpërhë seriozisht, në mos të shkatërrojë, revizionizmin në gjirin e udhëheqjes dhe të Partisë Komuniste Italiane.

Ai ka frikën e përjashtimit nga partia dhe këtë e quan një humbje për personalitetin e tij dhe këndej del në konkluzionin se kauza s'fiton gjë.

Shoku, luftën që bëjnë grupet revolucionare marksiste jashtë partisë nuk e kundërshton haptazi, por e quan atë të pashpresë e pa asnjë perspektivë dhe arrin deri atje, saqë predikon disfatën e tyre, si disfatën e Bordigës e të tjerëve buharinistë e titistë në kohën e tyre. Ky paralelizëm dhe ky konkluzion i tij është krejt i gabuar. Ai harron se disfata e këtyre antimarksistëve u shkaktua për arsye se Partia Komuniste Italiane në atë kohë ishte në pozita më të drejta marksiste-leniniste, kurse aktualisht është e kundërta: Partia Komuniste Italiane është në pozita antimarksiste dhe grupet revolucionare jashtë partisë në pozita marksiste-leniniste.

Shoku nuk ka pse të krahasojë forcën aktuale organizative, financiare dhe propagandistike të PK Italiane, natyrisht e fuqishme, me atë të grupeve revolucionare, por duhet në radhë të parë të shohë forcën ideologjike dhe politike marksiste-leniniste, forcë kolosale, që karakterizon grupet revolucionare jashtë partisë dhe brenda partisë dhe që mungon te revizionistët e udhëheqjes së Partisë Komuniste Italiane dhe tek ata që i pasojnë.

Këtë besim (se, unë jam i bindur që nga ana parimore shoku, si militant i vjetër dhe teoricien, e di, por

fishkja e frymës revolucionare e bën atë të mbrojtë gjithë gjëra që nuk i ndien dhe nuk i beson) ne, në mënyrë shoqërore, në mënyrë të thjeshtë, duhet t'ia forcojmë, që të gjallërohet. Shoku është komunist me një të kulluar të mirë, ai është antirevizionist, me të cilin ne mund të shkëmbejmë mendime, me fjalë të tjera ai ka anë pozitive, që mund t'i shërbejnë, aq sa mund t'i shërbejnë, Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste) dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Atij, gjithashtu, i është errësuar perspektiva e një uniteti të vërtetë marksist-leninist në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, dhe nuk sheh dot mënyrat se si marksistë-leninistët do t'ia arrijnë këtij uniteti, ai nuk imagjionon dot format revolucionare, pse vetë atij i ka ikur shpirti revolucionar. Ai mbivlerëson, dhe kjo e ka hutuar atë, revizionizmin modern, ai është dhe e ndien veten si një fletë peme në mes të një «furtune» të egër; forca e imperializmit, kapitalizmi në vendin e tij, partia e tij në duart e revizionistëve, Bashkimi Sovjetik në duart e hrushovianëve, titizmi nga një anë, përçarja nga ana tjetër, dhe nuk sheh forcën e madhe revolucionare të marksizëm-leninizmit. Ai është i frikësuar, i llahtaritur, ai arrin deri atje sa të thotë «i madhi e ha të voglin», ose «e ç'mund të bëjnë partitë tona të vogla» përpara të dyja partive të mëdha, Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës. Që kënde del në një konkluzion pasiv, fatalist, «të shohim ç'do të bëjnë këto dy parti», «ishallah merren vesh në disa çështje» dhe «atëherë ka mundësi që Partia Komuniste Italiane të ndryshojë diçka në formë, por jo në esencë».

Deri këtu ka ardhur dëshpërimi, hutimi, konfuzioni i tij. Ç'të bëjmë? Ta hedhim poshtë? Jo, ta ndihmojmë, ta sqarojmë me durim, me durim ta inkurajojmë, në mënyrë të sjellshme e shoqërore.

Është e qartë se shoku, siç e thotë edhe vetë, nuk do të dalë nga partia e revizionistëve. Sigurisht ai diçka bën në parti, diçka punon, diçka thotë. Ai ka lidhje me shokë që kanë mendime të përbashkëta. Ata thonë se nuk rrinë dhe nuk do të rrinë me duar kryq. Bile tha se do të bëjë edhe disa kritika në mbledhjen e ardhshme të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Italiane. Këtë nuk duhet ta nënvleftësojmë. Kjo farë pune e tij dhe e shokëve të tij (pse kaq ata janë të vendosur të bëjnë), lëvizjes sonë i intereson, se ata shtyhen përpara, marrin kurajë, përdorin format legale të luftës brenda partisë, ngjitin një nga një shkallët, dhe i pengojnë udhëheqësit revizionistë, aq sa mund t'i pengojnë. Në këtë drejtim ne duhet të punojmë me kujdes që t'i sqarojmë këta shokë në çështjet e mëdha parimore të lëvizjes komuniste, por duhet të jemi dhe në korent të gjendjes brenda në Partinë Komuniste Italiane dhe në Itali, që të mund t'u sugjerojmë disa qëndrime që mund të mbahen nga ai dhe nga shokët e tij (natyrisht aq revolucionare sa mbajnë supet e tyre dhe kur këto supe të forcohen, atëherë ecet edhe më tej).

Shoku tha, dhe kjo është e ndershme nga ana e tij, se duhen të rinj për këto punë. Ai ka të drejtë që mendon për të ardhmen e partisë, për grurin e ri që rritet, por edhe vetë duhet të punojë, në forma legale brenda në parti për të edukuar, për të formuar e për të kalitur njerëz të rinj, t'i frymëzojë ata, t'i udhëzojë

si të studiojnë teorinë marksiste-leniniste dhe sidomos çfarë duhet të studiojnë. Kjo është një punë e madhe që ai mund ta bëjë, edhe legalisht, edhe individualisht, edhe me grupe.

Shoku nuk i sulmoi grupet revolucionare jashtë partisë. Kjo prapë është pozitive. Ai i nënvleftësoi, ai është pesimist për punën e tyre. Ç'duhet bërë në këto situata? Të arrihet që ai dhe shokët e tij edhe në të ardhmen të mos i sulmojnë grupet revolucionare. Besimi ndaj tyre do të vijë më vonë, dhe kjo varet shumë nga puna dhe nga qëndrimet e drejta të grupeve. Por edhe këto duhet që disa persona të tillë si ai të mos i sulmojnë (pavarësisht se këta qëndrojnë brenda). Shokët e grupeve, mendoj unë, duhet të evitojnë të hyjnë në polemikë të hapët me të, dhe kjo të mos i ndalojë ata që me shokë të tjerë të rinj të sulmojnë udhëheqjen revizioniste. Ka shumë që duhen sulmuar në Partinë Komuniste Italiane. Komunistë si shoku në fjalë që janë brenda në parti, mund t'u bëjnë edhe disa kritika veprimeve ose qëndrimeve të grupeve, mund të japin edhe këshilla. Të gjitha këto mund të jenë të drejta ose të gabuara dhe s'është e domosdoshme që grupet t'i pranojnë në bllok, ose në bllok t'i hedhin poshtë. Grupet revolucionare me këta njerëz (kështu si janë, kaq sa mund të japin) duhet të bëjnë një punë, një punë që hyn në atë kategori dhe drejtim që ata kanë caktuar për të punuar në parti.

Shoku italian la, gjithashtu, të kuptojë se për disa nga këta shokë, që militojnë në grupet revolucionare, ai ka besim dhe i respekton. Kjo është një gjë shumë e mirë. Për të gjitha ato që thashë pak më lart, këta sho-

kë, duhet të hedhin urat e ndërlidhjes, të bashkëpunimit, të kritikave dhe të këshillimeve shoqërore në mes njëri-tjetrit. Për këto gjëra, të reflektojmë edhe vetë thellë, t'i përshtatim me situatat që krijohen në vend dhe të ndihmojmë me kujdes, me takt, me dashamirësi, si leninistë, shokët që s'mendojnë plotësisht si ne, por që ne e kemi për detyrë shoqërore të shkëmbejmë mendime me ta dhe t'i influencojmë për të mirë, por edhe të mësojmë shumë gjëra prej tyre.

E PREMTE
13 NËNTOR 1961

Në mbledhjen e sotme të Byrosë Politike si problem kryesor ishte diskutimi i projektplanit dhe i projektbuxhetit të vitit 1965 për zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit.

Vështirësitë për realizimin e planit pesëvjeçar, vura në dukje¹, janë objektive dhe subjektive, të brendshme e të jashtme. Në situatat e krijuara të përpiqemi të shtojmë rezervat dhe të mos kemi deficite. Detyrat e planit në industri dhe në bujqësi t'i realizojmë e t'i tejkalojmë që bilanci vaçutor të përmirësohet. Për këtë qëllim të marrim disa masa, por edhe të bëhen studime. Të gjithë duhet ta kuptojnë drejt dhe të reflektojnë për problemin e import-eksportit.

Sot në gazetën «Zëri i popullit» u botua artikulli im, që mban titullin: ««Testamenti» i P. Toliatit, kriza e revizionizmit modern dhe lufta e marksistë-leninis-

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 157.

tëve»¹, tezat e zgjeruara të të cilit i kisha shkruar që gjatë muajit shtator.

Po në këtë numër të gazetës «Zëri i popullit» është botuar edhe teksti i plotë i «testamentit» të Toliatit në Jaltë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 114.

E DIEL

15 NËNTOR 1964

*Asgjë nuk pipëtin. Kinezët përpara shokëve të tyre shqiptarë mbajnë heshtje prej varri. Natyrisht kjo nuk është as e rregullt, as miqësore, as shoqërore dhe as marksiste. Kurse revizionistët, nga ana e tyre, e kanë vënë në korent njëri-tjetrin, koordinojnë veprimet. Shokët kinezë as nuk morën mundimin të na vinin në korent, fundi i fundit edhe në mënyrë rezervate, mbi përmbajtjen e letrës që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës mori nga sovjetikët në lidhje me aktin e rrëzimit të Hrushovit. Kjo, natyrisht, tregon, dhe s'kemi si ta interpretojmë ndryshe, se shokët kinezë deri në këtë shkallë mbajnë rezerva me ne. Kurse mospërfillja e kinezëve për t'iu përgjigjur letrës sonë për çështjen e kufijve me Bashkimin Sovjetik, mosdenjimi për të na thënë nëse e tërhoqën para Çervonenkos gafën e madhe që bënë lidhur me ne dhe fakti që nuk japin as shenjën më të vogël mbi promemorian që u bëmë në lidhje me «gjendjen e krijuar pas rënies së Hrushovit», tregojnë hapur se udhëheqja kineze nuk është në rregull me ne, ajo është çakërdisur në rrugën qorre.

Entuziazmi i madh dhe euforia që u krijuan te kine-

zët me vajtjen e Çu En Lait në Moskë, po shfaqeshin ditët e para nga të gjithë ambasadorët e Kinës, në të gjitha vendet ku ne kemi ambasadorë. Bile kishte ambasadorë kinezë që filluan t'u qëndronin tanëve edhe ftohtë e me buzë të varura, kur këta shprehnin pikëpamjen e Partisë sonë.

Pas 7 nëntorit afshi i ambasadorëve kinezë filloi të bjerë gradualisht. Më parë thanë «të shohim», pastaj vazhduan «ne menduam t'i ndihmojmë, në qoftë se ata (sovjetikët) kthehen», pastaj «taktika jonë ka qenë bazuar në një entuziazëm të tepruar», derisa arritën të thonë që «këta janë revizionistë e nuk ndërrojnë dhe ne duhet të vazhdojmë polemikën» e, më në fund, «ne menduam se ata do të përfitonin nga rasti t'ia hidhnin të gjitha fajet Hrushovit, por edhe këtë s'e bënë».

Kjo e fundit është «buketa» më e bukur antimarksishte e ambasadorit kinez në Bukuresht. Domethënë, sipas këtij ambasadori, në qoftë se revizionistët sovjetikë ia hidhnin fajin Hrushovit, çdo gjë rregullohej, ne mund të putheshim me ta. Kjo i përngjet taktikës së vjetër kineze që, kur Hrushovi kritikoi Stalinin, ata e mbështetën Hrushovin dhe ishin të gëzuar se çdo gjë do të shkonte mirë. Po ç'dolën nga këto veprime, këto dihen. Kjo është njëra anë.

Ana tjetër, zgjatja kaq tepër e qëndrimit të Çu En Lait në Moskë, në bisedime, tregon se asgjë s'ka shkuar «mirë», sipas planeve dhe «taktikave gjeniale» të kinezëve. Gjatë gjithë kohës që Çu En Lai qëndroi në Moskë, shtypi kinez nuk shkroi asgjë, kurse shtypi sovjetik çdo ditë ka kryeartikuj ku konfirmon vijën e mëparshme në të gjitha drejtimet. Sovjetikët çdo ditë

thonë «për ne asgjë s'ka ndryshuar dhe çështja e Hrushovit është një çështje jona e brendshme». Pra, në goftë se kinezët kanë vendosur t'i ndihmojnë «shokët e dashur sovjetikë», sikundër na deklaroi zyrtarisht Çu En Lai, atëherë mund të themi me plot gojën se kjo qenka një tradhti e vërtetë.

Ç'ujdi janë kombinuar në Moskë? Ne ato s'i dimë. Por që mbledhja e 15 dhjetorit është shtyrë, kjo s'ka dyshim. Kinezët këtë do ta trumbetojnë si fitore të madhe të tyre. Sa qesharake do të jetë!!

Ata mund të kenë vendosur edhe ndonjë takim bilateral në Pekin për të vazhduar «bisedimet». Edhe kjo do të trumbetohet si një sukses i madh nga kinezët, se u ç'a akulli etj., etj.

Më në fund u arrit «një sukses i madh» për të dyja palët (pse kështu u bënë punët tash), pushimi i polemikës. Hëpërhë, do të thonë kinezët (derisa të bëhet mbledhja e caktuar); por kjo mund të vazhdojë edhe më tej, pse do të caktohet një mbledhje tjetër e një mbledhje tjetër, e kështu me radhë.

Por, me torbën e tij «të sukseseve» në Moskë, Çu En Lai nuk do të mungojë të sjellë në Pekin përshtypjet e veçanta të «vëzhgimeve të tij të thella», të «gjkimeve të tij gjeniale», nga «të shtrënguarit e duarve», nga «fjalët me dy kuptime», nga «të qeshurat mbi buzë e nën buzë», nga «qëllimet e afërta e të largëta», nga «shprehjet e hapëta e të maskuara të krerëve të ndryshëm revizionistë» që ai takoi dhe me të cilët bisedoi në Moskë. Dhe nga të gjitha këto do të dalë një vijë, një qëndrim «i pjekur, tej pamës, marksist-leninist kinez». Do ta shohim çfarë çorbe do të jetë, por fakt është

se largimin e Çu En Lait nga Moska e «përhëndetën» me katër «të shtëna topi», me predha plot dhe jo pa predha, siç thonë kinezët, me katër artikuj të fortë antikinezë të shkruar në revistën «Probleme të paqes e të socializmit» të muajit nëntor nga Dykloja, Longoja, Tim Baku dhe Fyrnbergu.

Ç'do të bëjnë kinezët përpara kësaj situatë, përpara këtij dështimi të tyre? Atë që kanë bërë edhe herët e tjera. «Dekalogu»¹ i tyre s'është mbaruar, ka edhe një artikull. (Të paktën Balli Kombëtar, para se të merrte fund, dekalogun e tij e botoi të plotë.) Ata fillojnë botimin në seri të artikujve të Ulbrihtit, Longos e të të tjerëve dhe vazhdojnë me artikujt tanë të «Zërit të popullit». Pra, për vete lidhin duart, mbrohen me artikujt tanë, hiqen në arenën ndërkombëtare sikur ne jemi të shtyrë nga ata dhe neve gjoja na japin «satisfaksion», që marrin mundimin e botojnë artikujt tanë, duke mos qenë dakord në realitet me pikëpamjet tona.

Kinezët, duke marrë mundimin të botojnë artikujt tanë, bëjnë sikur na thonë: «Ja, ne jemi me ju», por njëkohësisht janë edhe me revizionistët, se edhe artikujt e tyre i botojnë dhe bëjnë sikur na thonë neve «ja, duke botuar artikujt tuaj, ne bëjmë autokritikë dhe ju luftoni nga jashtë, kurse ne nga brenda».

1. Aludim ironik për «programin» prej 10 pikash që organizata tradhtare Balli Kombëtar shpalli në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit tonë. Edhe udhëheqja kineze kishte deklaruar se do të botonte 10 artikuj kundër revizionizmit hrushovian.

Jo! Të gjitha këto manovra e këto taktika nuk janë as të ndershme dhe as marksiste. Por s'ka gjë, ne bëjmë punën tonë. Bota di të gjykojë.

Ambasadori ynë në Algjeri na lajmëron se ka marrë vesh që një delegacion i PK të Kinës, nën maskën e një delegacioni qeveritar ose tregtar, ka shkuar në Itali, do të takohet me përfaqësues të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Italiane dhe do të bisedojë e do të shikojë se ku qëndrojnë kontradiktat në mes komunistëve italianë dhe udhëheqjes sovjetike. Sa keq që kinezët s'na vënë fare në korent për këto gjëra. Kjo nuk do t'u dalë në rrugë të drejtë. Ata mendojnë se ne jemi njerëz që s'kuptojmë asgjë, se vetëm ata i kuptojnë gjërat shumë mirë. Por ne themi që kinezët janë politikanë oportunistë dhe nuk udhëhiqen nga parime të shëndosha. Politika e tyre është një politikë bizantine, që jo vetëm s'u shkon te komunistët, por as imperialistët dhe as revizionistët s'e hanë. Do të presim dhe do të shohim.

E MARTE
17 NËNTOR 1964

Sovjetikët po bëjnë gjoja korigjime, pa zënë në gojë fare Hrushovin. Ata po e bashkojnë përsëri organizativisht partinë që e kishin ndarë më dysh: në «parti të industrisë» dhe në «parti të bujqësisë».

Kinezët, që «do t'i ndihmojnë shokët sovjetikë», s'po flasin në shtypin e tyre për këtë «performance»¹ të sovjetikëve. Siç duket janë në mbledhje dhe ka mundësi që mbledhja e tyre të vazhdojë disa javë, derisa të gjejnë fjalën dhe vijën.

1. Frëngjisht — arritje.

E MËRKURË
18 NËNTOR 1964*

... Megjithëse kontaktet me njerëzit tanë në Pekin janë të ftohta, po mësojmë se kinezët po flasin andej-këtej se ata «nuk lëvizin nga parimet marksiste-leniniste», se «nuk janë kallam që të lëkunden sa andej-këtej». Atë duam edhe ne, por veprimet e fundit nuk e provojnë këtë.

Nga burime të sigurta po marrim vesh se Çu En Lai, kur do të largohet nga Moska, do të kalonte në Bukuresht, sigurisht që të bënte bisedime «me shokun Dezh», të shkëmbejnë mendime, të përcaktonin një qëndrim. Por, siç duket, ky projekt u la, se qelbej shumë, dhe Çu En Lai u kthye nga Moska drejt e në Pekin. Koha do ta vërtetojë edhe këtë.

Një pjesë e delegacionit që ishte me Çen Jinë, nuk hipi në avion për t'u kthyer në Kinë, por, në formën e një «delegacioni qeveritar», shkoi në Romë, ku do të bjerë në kontakt me shokët italianë për të marrë vesh se ç'mendojnë këta për udhëheqësit e rinj sovjetikë.

Diplomaci «e bukur», «e zgjuar»! Ne s'jemi në kundërshtim që ata të venë andej-këtej, ajo është punë e tyre, por, derisa qëndrimet e të dyja partive tona ishin

të njëllojta edhe ndaj italianëve, të veprosh prapa kraheve tanë ose, të paktën, të mos bësh me ne një shkëmbim mendimesh, qoftë të shkurtër, për «italianët e kulluar», që i kemi mu në hundë, kjo jo vetëm nuk është marksiste, po as shoqërore dhe as diplomaci borgjeze, pa lëre proletare. Por edhe për këtë koha do ta vërtetojë se kush e ka drejt¹.

1. Shënimet e plota të mbajtura në këtë datë janë botuar në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 167, me titull: «Shtypi kinez hesht për artikujt tanë dhe boton fjali-
met e udhëheqësve sovjetikë». Po në këtë datë autori ka shkruar shënimin: «Ideja e Çu En Lait për të krijuar një OKB tjetër nuk do të ketë sukses». Po aty, f. 169.

E ENJTE
19 NËNTOR 1964

Këndova sot në «Humanité» *compte-rendu*¹-në e delegacionit të PK Franceze, që vajti në Moskë për të kërkuar sqarime. Sovjetikët s'kanë lëvizur asnjë presje nga vija e tyre ideologjike dhe politike dhe i kanë dhënë sigurime se do ta vazhdojnë atë pa lëkundje. Francezëve u kanë thënë se Hrushovi i ka bërë ato që janë shkruar në «Pravda», duke shtuar ndonjë gjë për bujqësinë.

Natyrisht këto dhe ca më pak, i kanë thënë ata edhe Çu En Lait. Kështu që ky duhet të ketë ikur shumë i pakënaqur.

1. Frëngjisht — raport.

E PREMTE
20 NËNTOR 1964

U bë mbledhja e Byrosë Politike për të diskutuar dhe për të aprovuar projektfaqimin që do të mbaj në mbledhjen solemne, më 23 Nëntor, me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit.

Fjalimi ka rëndësi si për brenda vendit, ashtu edhe për jashtë, sidomos, sepse në këtë situatë të re që është krijuar pas rënies së Hrushovit, qëndrimi i Partisë së Punës të Shqipërisë merr një rëndësi të veçantë. Jam përpjekur që pjesën ideopolitike dhe momentet më kryesore t'i formuloj me kujdes të veçantë, se ato përbëjnë përcaktimet bazë të vijës sonë aktuale dhe të veprimeve tona në të ardhmen. Sigurisht, disa «miq» tanët do të shtrembërojnë buzët, por kanë kohë të reflektojnë dhe, ata që janë marksistë-leninistë, do të na kuptojnë.

Pasdreke hapet sesioni i 5-të i legjislaturës së 5-të të Kuvendit Popullor. Sot do të zgjedhim kryetarin e ri të Kuvendit Popullor pas vdekjes së shokut Medar Shtylla.

Mora vesh se parada ushtarake për festat e nëntorit do të vazhdojë 1 orë e gjysmë. Kjo është shumë, prandaj porosita të merren masa që parada të mos zgjatë kaq shumë. Rëndësi ka që ajo të jetë e organizuar mirë. Neve na intereson të tregojmë cilësinë e ushtrisë sonë dhe jo sasinë, se kjo e fundit qoftë në njerëz, ashtu edhe në armatime rregullohet në bazë të disa normave, që tjetri, edhe në qoftë se nuk i di, është në gjendje t'i llogaritë afërsisht. Kurse rëndësi të madhe kanë gatishmëria, disiplina, rregulli, armët, cilësia dhe mirëmbajtja e tyre.

Parada duhet t'i entuziazmojë njerëzit tanë, t'i gëzojë, t'u ngjallë besimin në forcën e ushtrisë sonë dhe jo t'i mërzitë ata, duke parë tanke, tanke dhe tanke, me një fjalë të gjitha llojet e tankeve, të autobлиндave ose të topave të ushtrisë.

Koha e paradës ushtarake të jetë në përpjesëtim të drejtë me atë të manifestimit popullor. Politikisht manifestimi popullor ka rëndësi kolosale, edhe më të madhe se vetë parada e ushtrisë. Ai shpreh kulmin e gëzimit që populli ynë manifeston përpara Partisë. Po të ketë mundësi, gjithë Tirana le të marrë pjesë në manifestim, por kjo, natyrisht s'mund të bëhet. Sidoqoftë populli medoemos duhet të manifestojë në masë të konsiderueshme.

Jam i mendimit që në mbledhjen solemne, më 23 Nëntor, delegacionet mike që kanë ardhur për festë mund të mos flasin. Ka prej tyre që do t'u vijë mirë për këtë, se jo vetëm mund të mos jenë plotësisht dakord me disa nga pikëpamjet tona, por edhe mund të mos kenë

vendosur ç'qëndrime të reja do të mbajnë, kështu që nuk duan të shprehen që tani. Kjo rregullon të dyja palët.

E SHTUNË
21 NËNTOR 1964

Ka ndonjë shok që tregohet shumë i zellshëm në «zbatimin me shpejtësi» të vendimit të Byrosë Politike për ngritjen e kolektivave blegtoralë, duke harruar punën me bazën, veçanërisht me fshatarësinë, duke harruar se kolektivizimi i bujqësisë nuk u arrit as me një vit, as me pesë vjet, kurse Partisë i janë dashur vite me radhë për të bërë një punë sqaruese dhe bindëse me fshatarësinë, duke kapërcyer vështirësi të panumërta.

Askush nuk duhet të mendojë se me urdhër nga zyra, duke nënçmuar punën bindëse dhe duke nënvleftësuar rezistencën e blegtorëve, brenda një ose dy vjetësh mund të kolektivizohet bagëtia. Dikush mund të mos jetë i kënaqur që blegtorët tanë kanë filluar të zbatojnë format fillestare të kolektivizimit, mund të kërkojë që blegtori privat ta kuptojë «pa vonesë» udhëzimin e Partisë, mund të dojë, bile dhe t'i zhdukë me dekret mbeturinat mikroborgjeze të pronës private!

Kujtdo që mendon dhe vepron kështu i duhet tërhequr vëmendja që të ketë një zell më të përmbajtur, që të punojë dhe të bëjë më shumë punë bindëse e sqaruese në terren, me shokët dhe me fshatarët.

Nuk duhet të shpejtohemi! Ndonjë shok i tillë «i zellshëm» ka nxitur shokët e rretheve për kolektivizimin në fshatrat malore, ku u vërtetuan edhe fenomene të presionit, gjë që i detyroi fshatarët të na drejtoheshin neve me ankesa.

Ne morëm masa menjëherë për të ndrequr këtë shtrembërim të vijës së Partisë, por kur kërkuam fajtorin që kishte deformuar direktivën, faji u bë qyrk dhe asnjëri nuk pranoi ta vishte. Dhe këto gabime nuk ishin në një rreth, por në shumë rrethe; pra, dikush nga lart kishte dhënë udhëzime të gabuara, dikush që treguar «i zellshëm» në këtë shpejtim.

Fshatarësia ka hyrë në rrugë të drejtë, sepse e drejtë është vija e Partisë sonë në të gjitha drejtimet, veçanërisht për bujqësinë. Mirëpo kuadrot duhet të mos dehen nga sukseset dhe të mendojnë se në fshat janë zhdukur mbeturinat, se fshatarët janë të gatshëm për çdo gjë, se e kanë zhdukur ndjenjën e pronës private. Mjaft herë na duhet të merremi gjatë me disa fshatarë, të cilëve po t'u heqësh goftë edhe një të dhjetën e dynymit të oborrit, të drejtojnë gjithë ato kërkesa e lutje dhe megjithëse pranojnë, prapë nuk janë shumë të bindur.

Fshatari ynë e do kolektivizimin, e do Partinë me gjithë shpirt; ai është patriot dhe i gatshëm të japë edhe jetën në çdo moment që ta lypë atdheu, por ndjenjën e pronës private s'e ka zhdukur. Duhet ta kuptojmë se kjo psikologji mikroborgjeze e tij nuk zhduket ndryshe veçse me bindje, me edukim, me durim; ajo nuk zhduket as për një vit, as për 10 vjet. Brezat e rinj, të rritur në socializëm nga Partia, një ndjenjë të

tillë do ta kenë gjithnjë pak e më pak, derisa ta zhdukin.

Prandaj, të kemi kujdes në zbatimin e direktivave të drejta të Byrosë Politike në lidhje me kolektivizimin e blegtorisë. Të mos i nënçojmë format e para, t'i zgjerojmë ato se janë abëcëja dhe pa abëcënë s'mësohet shkrimi e këndimi. Të mbështetemi në këto forma të para dhe, me punë, me bindje të ngjitim shkallët një nga një, por edhe dy nga dy, atje ku janë pjekur kushtet, atje ku i kemi krijuar këto kushte. Parulla që përdorëm në fillim për kolektivizimin e bujqësisë «as të mos shpejtohem, por as të mos qëndrojmë në vend» të mos harrohet.

Lexova fjalimin që do të mbajë delegacioni ynë në sesionin e sivjetëm të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

S'kam vërejtje parimore për çështjet që ngrihen në të dhe për ato probleme që propozohen të ngrihen, po kam disa vërejtje të tjera që unë mendoj se kanë rëndësi.

1. — Forma se si ngrihen problemet dhe si trajtohen ato, për mendimin tim, dhe këtë vërejtje e kam bërë edhe herë të tjera, nuk është e mirë, nuk është tërheqëse, është pretencioze, por edhe këtij farë pretendimi është shumë larg t'i arrihet, për arsye se format janë shabllone, bajate, shumë herë të përsëritura. Nuk ka përpjekje sa duhet për të gjetur forma shtruarje të problemeve të çdo viti, të atilla që të tërheqin vëmendjen. Unë mendoj se këtu nuk është thjesht çështje stili, por ka diçka tjetër, për të cilën shokët që merren me

këto punë duhet të punojnë dhe ta lodhin mendjen shumë.

2. — E kam theksuar edhe herë tjetër, edhe tash së fundi kam tërhequr vëmendjen se deri ku është e leverdishme të flasim ne në Kombet e Bashkuara për çështjen e kufijve. Natyrisht që si shtet sovran ka rëndësi që ne të themi mendimin tonë për disa probleme të mëdha ndërkombëtare, por s'janë vetëm këto që ne duhet t'i themi dhe jo t'i themi në këto forma siç rreshtohen në fjalim, me pikëpyetje, me ironi, me sulme ku duhet dhe ku s'duhet.

Ne kemi interes të madh që, duke thënë pikëpamjen e Qeverisë sonë, të na dëgjojnë të gjithë me vëmendje, të interesohen dhe miqtë të na përgëzojnë. Ne nuk mund të flasim në OKB si në një organizatë-bazë partie.

OKB-ja është OKB. Atje ka turli shtetesh e turli njerëzish, armiq dhe miq, por edhe miqtë janë tanët deri në atë shkallë sa u intereson atyre, nëse ti u prek telin që u pëlqen dhe gjen mënyrën se si ua këndon këngën. Pikërisht ne kemi interes që t'ua prekim ata tela që na interesojnë edhe neve, por që u interesojnë edhe atyre, dhe t'ua këndojmë këngën pa shkelur parimet dhe vijën tonë, por që edhe atyre t'u pëlqejë.

3. — Interesi ynë në Kombet e Bashkuara është i madh, ne duhet të bëjmë që autoriteti i vendit tonë atje të ngrihet, të bëjmë shumë miq dhe t'i forcojmë lidhjet me ta për çështje të përbashkëta.

Ç'gjëra na lidhin ne me ta? Ka një mori problemesh në botë, të cilat duhet t'i kenë parasysh drejtuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe shokët e tjerë atje,

kur përgatiten për në OKB. Por kam përshtypjen se kjo përgatitje nga ana e tyre bëhet shumë formale, shumë shabllone. Kam përshtypjen se ata e nënvleftësojnë këtë punë të rëndësishme (jo për të zgjidhur çështjen e çarmatimit botëror), për ato që thashë më lart dhe që kanë rëndësi për ne.

Shokët e Ministrisë së Punëve të Jashtme thonë: «Ne do të shkojmë në OKB dhe do të përgatitim për atje dy-tri fjalime». Mirëpo edhe këtyre ata u vihen t'i shkruajnë muajin e fundit dhe, ashtu si i shkruajnë, na i paraqesin edhe neve si «simite». Duhet të braktiset ky sistem pune. Këta shokë rrojnë jashtë OKB-së, por për miqtë tanë atje ka shumë probleme, njëri e do kështu, tjetri ashtu, njërit i dhemb barku, tjetrit kurrizi, njëri kërkon këtë zgjidhje, tjetri një zgjidhje tjetër. Kjo është moria e problemeve që thashë, nga të cilat duhen zgjedhur ato më të mirat, më interesantet, për ne dhe për miqtë. Ato që shtrohen nga ne mund të mos jenë të gjitha probleme kapitale, por të hartuara në një fjalim joshabllon, ku të gërshetohen këto me probleme kyç ndërkombëtare, të radhitura e të shkruara me forma të bukura për një Asamble të tillë, siç është OKB-ja, fjalimi ynë bën përshtypje, bëhet interesant, pse ndihmon të demaskohen armiqtë, afron miqtë dhe na shton miq të rinj.

Natyrisht një gjëje të tillë, që duhet ta bëjnë vazhdimisht ministri i Jashtëm dhe shokët që ai merr nga pas, për sivjet i ka kaluar koha.

Në qoftë se do të arrijnë të rregullojnë paraqitjen, atëherë këtë le ta bëjnë dhe sa më parë, pse, për men-

dimin tim, kjo duhet përpunuar akoma nga stili, nga forma, nga shprehja dhe nga «të rrahurat».

Tjetër s'kam ç'të them. Le të dërsijnë edhe ca akoma mbi të.

*... Nga disa burime të sigurta po marrim vesh se çfarë ngjau në Moskë me delegacionet e Kinës, të Koresë dhe të Vietnamit, që kishin vajtur «të festonin me vëllezërit sovjetikë» festën e madhe të revolucionit e «të ndihmonin shokët sovjetikë». Thuhet se këto delegacione u poshtëruan nga revizionistët sovjetikë.

Delegacionin e Vietnamit mezi e priti vetëm fillikat Kosigini, duke lajmëruar që më parë se në dispozicion të tij nuk kishte veçse një orë. Kosigini i priti ftohtë dhe me përbuzje u numëroi ndihmat që u kanë dhënë, pastaj i kritikoi që në gazetatat e tyre botojnë materiale antisovjetike. Për sa i përket çështjes së Hrushovit, këtë sa ua përmendi dhe u tha se ata nuk lëvizin asnjë presje nga vija e tyre.

E njëjta sjellje arrogante dhe përbuzëse, edhe me delegacionin korean, bile me këta e shkurtoi kohën e takimit, për arsye se vietnamezët i hëngrën zotit Kosigin 15 minuta më shumë nga sa ai kishte denjuar t'u caktonte.

Kurse shokët kinezë bënë katër mbledhje me sovjetikët dhe ikën si rruar qethur. Sovjetikët i pritën shumë ftohtë, u thanë: «Mos mendoni se ne do të ndërrojmë vijën tonë, të cilën nuk e ka ndërtuar vetëm Hrushovi»; «ne do ta zbatojmë deri në fund, pa lëkundje, vijën tonë»; «qëndrimet ndaj jush ne nuk i ndry-

shojmë dhe këto s'janë vetëm të Hrushovit, por kjo është vija jonë e palëkundshme»; «ju kinezët duhet të ndreqni gabimet». Përveç kësaj, nga sa kemi marrë vesh, sovjetikët shkuan edhe më tej. **Malinovski i tha Çu En Lait: «Ne e rrëzuar Hrushovin, po ju ç'e mbani Mao Ce Dunin, atë galloshe të vjetër?»**. Çu En Lai nuk iu përgjigj, por më vonë ka ftuar në ziafet Brezhnjevin, Kosiginin dhe Mikojanin dhe u ka thënë: «Malinovski më provokoi, a mendoni edhe ju kështu?». Mikojani i qe përgjigjur Çusë se Malinovski ka gabuar. (Po kështu kishte thënë Mikojani edhe kur vietnamezët i kishin thënë se Malinovski ka folur kundër Shqipërisë.) Brezhnjevi i «shpjegoi» Çusë se Malinovski gjoja ka qenë i pirë dhe duhet të bëjë «autokritikë». Çu En Lai i ka njoftuar këta zotërinj se «këtë çështje do t'ia raportoj Mao Ce Dunit».

Sovjetikët i kanë kërkuar Çu En Lait që ata të pushojnë polemikën dhe ky nuk u ka premtuar gjë. Gjithashtu, Malinovski ka ofenduar mareshalin Ho Lun, duke i thënë: «Pse nuk ke ardhur me kostumin e vjetër, siç pretendon, po më ke veshur këtë kostum me këtë stof kaq të mirë?».

Turp i madh për kinezët!!! Të gjitha «grykimet e thella» të tyre, «vendimet e pjekura», «vija marksiste-leniniste, e studiuar imtësisht në Komitetin Qendror, pas rënies së Hrushovit», entuziazmi i tyre i papërshtetshëm, të gjitha pësuar fiasko, të gjitha dolën të gabuara, të padrejta, të gjitha mendime prej kalamanësh dhe oportuniste në kulm, por aq oportuniste, aq fodulle, saqë pa pikën e turpit ofenduan Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Shqipërinë.

Tash ç'do të bëjnë me Partinë e Punës të Shqipërisë? Do t'i njohin vallë gabimet e tmerrshme? Nuk denjuan të na jepnin asnjë përgjigje formale se e tërhoqën apo jo nga Çervonenkoja ftesën që bënë për Shqipërinë për të shkuar ne në Moskë, sipas urdhrin të Çu En Lait.

Asnjë fjalë nuk po i thonë kinezët ambasadorit tonë në Pekin për bisedimet që bënë në Moskë. Këtë ata e kanë për detyrë ta bëjnë. Po ç't'i thonë? Ata janë, me nder, të... Mundet që këtë detyrë «marksiste-leniniste» t'ia kenë ngarkuar delegacionit të tyre që mendohet të vijë për festën tonë, delegacion për të cilin akoma s'na kanë njoftuar, të paktën në mënyrë protokollare, se e pranojnë ftesën! Por këto janë punë kineze.

Dje filloi ose rifilloi taktika e vjetër. «Flamuri i kuq» botoi një artikull me titull «Pse u rrëzua Hrushovi?». Tezat e artikullit janë diametralisht të kundërta me ato që tha Çu En Lai para se të nisej për në Moskë. Por prapë subjektive. Sovjetikët i ofenduan kinezët, të cilët u zemëruan dhe çka vendosën 15 ditë më parë me aq bujë, derisa «hoqën nga qarkullimi të gjitha shkrimet e tyre që flisnin për Hrushovin», e prishën sot. Armëpushimi i trumbetuar nga Çu En Lai, siç duket, ishte vetëm për dy javë.

Por asgjë s'dihet nga kinezët, asgjë e sigurt nuk është. Ç'thonë sot, e ndërrojnë nesër. Vetëm se në të gjitha debatet aktuale të tyre, në të gjitha diskutimet e vendimet që marrin, qëndrimet e drejta të Partisë së Punës të Shqipërisë, që ata i përbuzën aq ndyrësisht, u rrinë si fantazma përpara grykimeve të tyre si

prej kauçuku. Ata do të hiqen sikur bëjnë autokritikë me ne. Artikulli për Hrushovin lë të kuptohet sikur «na bën qejfin neve», por ne do të jemi vigjilentë si leninistë. Do të gëzohemi dhe do të jetë një fitore për marksizëm-leninizmin, në qoftë se ata njohin gabimet, se gabimet u bëhen mësimë që të jenë të drejtë dhe të matur në të ardhmen. Do të shohim.

E HËNË
23 NËNTOR 1964*

Amerikanët barbarë dhe mercenarët e tyre belgë sulmuan sot me parashutistë qytetin Stanleivil, i cili gjendet në duart e kryengritësve kongolezë. Kjo është një ndërhyrje e egër e imperialistëve, miq të revizionistëve hrushovianë dhe titistë, të cilët së toku përpiqen me një mijë mënyra të shuajnë luftën nacionalçlirimtare të popujve. Spaku, miku i ngushtë dhe i përbashkët i Hrushovit dhe i Titos, është me amerikanët në krye të këtij operacioni banditesk¹.

1. Po në këtë datë, autori ka hedhur në Ditar shënimin: «Reagimi i Pekinit pas kthimit të Çu En Lait nga Moska», botuar në librin: «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 170.

E MARTE

24 NENTOR 1964

Prita sot në selinë e Komitetit Qendror delegacionin e Partisë Komuniste të Indonezisë, të Partisë Komuniste të Japonisë, të Partisë Komuniste të Belgjikës, të Partisë Komuniste të Zelandës së Re dhe të Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) të Australisë, që kanë ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në festën e 20-vjetorit të Çlirimit. Shokët ishin shumë të gëzuar dhe më shprehën urimet e zjarrta për festën tonë të 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe solidaritetin e plotë të partive të tyre me Partinë tonë.

*Ambasadori kinez në Tiranë me porosi të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, na komunikoi verbalisht mbi bisedimet e Çu En Lait në Moskë. Ato që dimë, por të radhitura me pika. Sovjetikët i kanë ofenduar keqas, s'kanë bërë as më të voglin lëshim. Kinezët janë fort të zemëruar dhe «shprehën deri në fund» kundër revizionistëve sovjetikë. Gati (në pikëpamjet e tyre) sa nuk i kanë kopjuar fjalë për fjalë mendimet tona të shprehura në komunikimin që u

bëmë se ç'mendon Komiteti ynë Qendror për situatën e krijuar pas rënies së Hrushovit. As shenjë më të vogël të autokritikës (por ata kanë menduar se ky komunikim që ishte një kthesë 180 gradëshe mund të konsiderohet si autokritikë).

Vajtjen në Moskë nuk mungojnë ta cilësojnë si «të domosdoshme» e «të nevojshme» dhe japin po ato arsye që kishim parashikuar ne. Nejse, shumë mirë kështu, vetëm të qëndrojnë në ato që thonë, të mos lëvizin nga parimet. Ne do të bëjmë detyrën tonë dhe do të përpiqemi të influencojmë për mirë.

Me një fjalë, ambasadori kinez ia lehtësoi ca punët Li Hsien Nienit, që do të vijë për festën e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut tonë.

E MËRKURË
25 NËNTOR 1964

Sot prita delegacionin e Partisë Komuniste të Kinës dhe të Qeverisë së RP të Kinës, që ka ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në festën e 20-vjetorit të Çlirimit. Takimi nga të dyja palët ishte shumë i ngrohtë, si shokë, si marksistë. Kryetari i delegacionit¹ foli shumë fjalë të mira, edhe ne gjithashtu. Ai theksoi dy herë se «Maoja dhe Liu Shao Çia i kishin ngarkuar si detyrë të vinte në Shqipëri për festë dhe të gëzonte tok me shokët shqiptarë këtë festë të madhe».

Me këtë shokët kinezë me siguri e kishin çështjen te propozimi që u bënim për të shkëmbyer mendime për situatat e reja të krijuara pas rënies së Hrushovit.

Pas delegacionit kinez prita delegacionin e Partisë së Punonjësve të Vietnamit dhe të Qeverisë së RD të Vietnamit. Pritja kaloi gjithashtu shumë ngrohtë. Vietnamezët më sollën edhe një fotografi të Ho Shi Minit me autografin e tij.

1. Li Hsien Nien.

E ENJTE
26 NËNTOR 1964

Prita delegacionin e PP të Koresë dhe të Qeverisë së RDP të Koresë. Takimi kaloi shumë ngrohtë.

Po sot pritëm edhe delegacionin e PP të Rumanisë e të Qeverisë së RP të Rumanisë. Në fillim biseda që bëmë shkoi mirë, u folën gjëra të përgjithshme miqësore, mbasandaj, në këmbë, kur do të ndaheshim, kryetari i delegacionit rumun filloi të na bënte moral se «duhej pushuar polemika», «me sharje nuk bën», «duhet unitet», «cilido mund të ndërtojë socializmin si të dojë» etj. Natyrisht, iu përgjigjëm të gjithave me fakte dhe me argumente. Rumuni mbeti me gisht në gojë, pse mbronte çështje që s'mbroheshin dot, mbasi për ato që na bënte moral neve, rumunët ishin treguar joparimorë, kurse ne ishim dhe jemi në rrugë të drejtë. Natyrisht, e uli tonin dhe u ndamë miqësisht.

Prita në mënyrë të ngrohtë edhe delegacionin e Partisë së Frontit Nacionalçlirimtar Algerian dhe të Qeverisë së Republikës Algjeriane Demokratike dhe Popullore.

E PREMTE
27 NËNTOR 1964

Çelëm ekspozitën e madhe «Shqipëria socialiste në 20-vjetorin e saj» në sallat e gjera të pallatit të madh të kulturës, që po ndërtohet.

Ishte organizuar shumë bukur, prodhimet ishin ekspozuar gjithashtu bukur, gjë që tregon zhvillimin e mirë ekonomik e kulturor të vendit. Të gjithë u gëzuam, se ekspozita na nderoi edhe në sytë e miqve të huaj, të cilët u habitën dhe u gëzuan për përparimet e vendit tonë.

Prita sot shkrimtaren Shirlei Graham Dy Bua, drejtore e Televizionit të Republikës së Ganës¹, që ka ardhur në vendin tonë me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit.

I shpreha gëzimin tim që takohesha me bashkëshorten e të nderuarit shokut Dy Bua, luftëtar i njohur për lirinë e popujve të shtypur, përkrahës i fuqishëm i lëvizjes përparimtare në botë dhe mbrojtës i

vendosur i çështjes së zezakëve dhe i të drejtave të tyre për punë e për bukë. I fola shkurtimisht edhe për kushtet shoqërore në të cilat filloi Lufta Nacional-çlirimtare në vendin tonë, për luftën që ka bërë Partia jonë kundër revizionizmit hrushovian, për luftën e popujve afrikanë, për unitetin e popujve në luftën e tyre për liri, pavarësi e përparim shoqëror etj.

Ajo foli për luftën e popullit ganez për përforcimin e pavarësisë së vet. Mikja nga Gana kishte përshypje shumë të mira nga vendi ynë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 163.

**E SHTUNË
28 NËNTOR 1964**

Në orën 10 mbajta fjalimin¹ në mbledhjen solemne organizuar me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut në sallën e madhe të pallatit të sportit «Partizani». Fjalimi zgjati 3 orë e ca, u dëgjua me vëmendje dhe u duartrokoi.

Në mbrëmje u dha koncert. Kishte pjesë të mira, këngë të reja, valle të bukura dhe pjesë baleti. Më pëlqeu.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 171.

**E DIEL
29 NËNTOR 1964**

Asistuaam në paradën ushtarake dhe në manifestimin e popullit. Çdo gjë e përgatitur mirë, e bukur, e gjallë, e disiplinuar dhe plot entuziazëm për Partinë tonë të lavdishme. Edhe koha ishte me popullin dhe me Partinë, dielli shkëlqente.

Miqtë e huaj na përgëzuan për ushtrinë tonë heroike dhe e vlerësuan paradën shumë lart. Kjo na gëzon dhe na inkurajon që në të ardhmen të përgatitemi edhe më mirë.

Fishekzjarre të shumta e të bukura mbi Tiranë dhe në qytetet kryesore të vendit. Tërë populli është jashtë në festë në një gëzim të papërshkruar.

Mbrëmja në Pallatin e Brigadave shkoi shumë mirë, e pasur, e gëzuar, optimiste. Entuziazmi i pjesëmarrësve ishte në kulm. Kishin ardhur përfaqësues nga të gjitha rrethet.

E HËNË
30 NËNTOR 1964

Sovjetikët dorëzuan një letër tjetër të Komitetit të tyre Qendror lidhur me shtyrjen e mbledhjes së partive komuniste e punëtore të 15 dhjetorit. Propozojnë që mbledhja të mbahet në mars.

E MARTE
1 DHJETOR 1964

Sonte natën ra borë në Dajt.

* Fitore e madhe për lëvizjen komuniste ndërkom-bëtare. Edhe nga gabimet e armiqve ne kemi shpre-suar që të ndreqen miqtë dhe të mos shkojnë larg. Re-vizionistët sovjetikë, me qëndrimet e tyre tradhtare, arrogante, fyese, na ndihmuan, ata bënë që shokët ki-nezë të humbisnin çdo shpresë dhe të rikthehen në rrugë të drejtë, t'i largohen rrezikut që sillte me vete një taktikë e gabuar, të cilën ata adoptuan, të entuziaz-muar pa arsye.

Artikulli i tyre «Pse u rrëzua Hrushovi?» i vuri çështjet në rrugë, pavarësisht se atje nuk përmendet udhëheqja e re sovjetike. Artikulli, sipas mendimit tim, ishte i mirë, i drejtë. Partia Komuniste e Kinës frenoi kështu çdo keqkuptim që kishte filluar të kri-johej në botë me vajtjen e delegacionit kinez në Mos-kë. Megjithëse ne vetë e dinim se ç'shpresa të kota i shtynë ata që vajtën në Moskë, prapëseprapë para ko-munistëve të botës u vu një pikëpyetje.

E HËNE
20 NËNTOR 1964

Sovjetikët dorëzuan një letër tjetër të Komitetit të tyre Qendror lidhur me shtyrjen e mbledhjes së partive komuniste e punëtore të 15 dhjetorit. Propozojnë që mbledhja të mbahet në mars.

E MARTE
1 DHJETOR 1964

Sonte natën ra borë në Dajt.

* Fitore e madhe për lëvizjen komuniste ndërkomëtare. Edhe nga gabimet e armiqve ne kemi shpresuar që të ndreqen miqtë dhe të mos shkojnë larg. Revizionistët sovjetikë, me qëndrimet e tyre tradhtare, arrogante, fyese, na ndihmuan, ata bënë që shokët kinezë të humbisnin çdo shpresë dhe të rikthehen në rrugë të drejtë, t'i largohen rrezikut që sillte me vete një taktikë e gabuar, të cilën ata adoptuan, të entuziazmuar pa arsye.

Artikulli i tyre «Pse u rrëzua Hrushovi?» i vuri çështjet në rrugë, pavarësisht se atje nuk përmendet udhëheqja e re sovjetike. Artikulli, sipas mendimit tim, ishte i mirë, i drejtë. Partia Komuniste e Kinës frenoi kështu çdo keqkuptim që kishte filluar të krijohet në botë me vajtjen e delegacionit kinez në Moskë. Megjithëse ne vetë e dinim se ç'shpresa të kota i shtynë ata që vajtën në Moskë, prapëseprapë para komunistëve të botës u vu një pikëpyetje.

Ishte e qartë se ne nuk ishim dakord që shokët kinezë të shkonin në Moskë për festën e Revolucionit të Tetorit. Ata ua kishin borxh sovjetikëve t'u dërgonin një «Grishin»¹ kinez, por edhe në këtë rast të pritnin t'i ftonin sovjetikët dhe jo të vetëftoheshin. Kurse ata jo vetëm dërguan Çu En Lain, por shkuan edhe më tej, sidomos me ne. Ne nuk e kundërshtuam, që shokët kinezë të tatonin pulsën e sovjetikëve, pas rënies së Hrushovit, por kjo punë duhej bërë me durim, me dinjitet dhe jo me aq «besim e entuziazëm», sikurse vepruan ata.

Sidoqoftë, edhe shokët kinezë e panë se ç'ishin udhëheqësit sovjetikë, gjykuan gjithashtu sa të matura ishin mendimet e Byrosë sonë Politike. Neve nuk na rritet dhe as që duhet të na rritet mendja për këtë gjë, se ndryshe ka rrezik të gabohemi. Ne duhet të sillemi kurdoherë si leninistë, të mos jemi as fodullë, as hakmarrës, as meskinë.

Shokët kinezë gjatë kësaj kohe bëjnë çmos të vënë në dukje vlerën e madhe të Partisë së Punës të Shqipërisë, heroizmin e popullit tonë, drejtësinë e vijës sonë, unitetin që lidh dy partitë dhe popujt tanë. Një gjë e tillë nga ana e tyre është e mirë dhe kjo, mendoj unë, bëhet nga pozita të drejta, për arsye se shokët kinezë panë edhe një herë se kritikën dhe vërejtjet që bëri Partia jonë ishin të frymëzuara nga një preokupim i drejtë dhe parimor.

1. V. V. Grishin, në atë kohë president i Këshillit të Përgjithshëm të Bashkimeve Profesionale të BS, që kryesoi delegacionin e PK të BS e të qeverisë sovjetike në festimet e 15-vjetorit të themelimit të RP të Kinës.

Në darkën që dha ambasadori ynë në Pekin shkuan të gjithë shokët e Byrosë Politike të Partisë Komuniste të Kinës, me përjashtim të Maos. Kjo ishte një shenjë dashurie e solidariteti të madh dhe i mbush zemrat tona me gëzim. Fjala e Çu En Lait ishte e mirë, e ngrohtë, miqësore. Fjala e Lu Din Isë po ashtu. Manifestimet në Pekin dhe në qytete të tjera të Kinës, me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit të vendit tonë, ishin të shumta, madhështore, të nxehta. Edhe Li Hsien Nieni tregohet te ne i dashur, i ngrohtë, i përzemërt, ai flet me entuziazëm për unitetin tonë. Kjo ka rëndësi të madhe për ne dhe për ata. Ky ka qenë preokupimi ynë më i madh këto kohë dhe jam shumë i gëzuar që çështjet hynë në rrugë të drejtë.

Na bie për detyrë dhe ne do të punojmë me të gjitha forcat që të gjitha punët, të gjitha çështjet të ecin në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, që uniteti i dy partive dhe i vendeve tona të kalitet vazhdimisht në rrugën marksiste-leniniste.

E MËRKURE
2 DHJETOR 1964

Sot prita delegacionin e Frontit Nacionalçlirimtar të Vietnamit të Jugut¹. Kryetari i delegacionit më vuri gjatë në dijeni për gjendjen në fushën e luftës dhe për politikën e brendshme e atë ndërkombëtare që ndjekin. Ai foli për sukseset dhe për situatën e vështirë në të cilën ndodhen forcat ushtarake amerikane. Foli, gjithashtu, për hrushovianët dhe për taktikat e tyre sabotuese. Situata është e mirë.

Çështjen e Stalinit duhet ta çojmë deri në fund, ta bëjmë çështje të madhe të komunizmit ndërkombëtar, derisa të rehabilitohen plotësisht figura dhe vepra e pavdekshme e këtij revolucionari të madh, e këtij klasiku të madh dhe udhëheqësi botëror të komunizmit ndërkombëtar.

Mendimi im është se për problemet bazë të çështjes së komunizmit ndërkombëtar që po diskutohen aktualisht, ne duhet të theksojmë ideologjikisht se vija

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 239.

e ndjekur nga Stalini dhe Partia Bolshevike ka qenë një vijë e drejtë leniniste, si në ndërtimin e partisë, të industrisë, të kolektivizimit të bujqësisë, të shtetit sovjetik, të mbrojtjes, të revolucionit botëror, të unitetit internacionalist të lëvizjes komuniste botërore, të unitetit të kampit të socializmit dhe në marrëdhëniet midis shteteve socialiste, të ndihmës së shteteve që luftonin për t'u mëkëmbur, të Luftës Nacionalçlirimtare, të qëndrimit ndaj imperializmit, carmatimit, bashkëzistencës paqësore, luftës dhe paqes. Të gjitha këto probleme kyç vërtetojnë qëllimet kriminale të revizionistëve modernë që sulmuan Stalinin dhe njëkohësisht tregojnë rrugën e vërtetë marksiste-leniniste që duhet të ndjekin komunistët në këto situata.

Ne vazhdimisht do të theksojmë domosdoshmërinë e rehabilitimit të plotë të Stalinit dhe të dënimit të pamëshirshëm të revizionistëve modernë që ndërmoren këtë akt kriminal kundër marksizëm-leninizmit.

Natyrisht ne do të akuzojmë përgjegjësit kryesorë të këtij krimi, revizionistët sovjetikë. Ne do të mbrojmë Partinë Bolshevike të Lenin-Stalinit dhe do t'u bëjmë thirrje komunistëve sovjetikë që të ndihmojnë fuqimisht në këtë çështje të madhe të përbashkët.

Çështja e Stalinit duhet të shikohet drejt, ai duhet të konsiderohet ashtu siç ka qenë — një udhëheqës i madh i komunizmit ndërkombëtar dhe në këtë drejtim ai nuk u përket vetëm sovjetikëve, por të gjithëve.

Revizionistët sovjetikë do të ngrenë çështjen se kjo është një punë e brendshme e partisë së tyre, se kjo është ndërhyrje në punët e brendshme të një partie etj.

Kjo është një mbrojtje false dhe e dobët e tyre dhe ne duhet t'ua rrëzojmë.

Ne duhet të theksojmë se në rast se revizionistët sovjetikë i shmangen një gjëje të tillë, në rast se nuk e pranojnë një gjë të tillë atëherë është e qartë se ata kanë frikë nga e vërteta, ata janë falsifikatorë. Dhe ne do ta vazhdojmë punën tonë.

Unë mendoj se këtë çështje duhet ta ndjekim si duhet deri në fund, pse është një nga detyrat më të lavdishme të Partisë sonë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe për shkatërrimin e revizionizmit modern.

E ENJTE

3 DHJETOR 1964

Sot pasdite në selinë e Komitetit Qendror prita delegacionin kinez. Takimi shkoi mirë, ngrohtë. Foli Li Hsien Nieni për vizitat që bëri në Jug, për vijën e drejtë të Partisë sonë etj. I fola edhe unë për partinë e tyre, i dhashë mendimin mbi pikëpamjet dhe qëndrimet e Partisë Komuniste të Kinës që na u komunikuan pas vizitës së Çu En Lait në Moskë.

Pas takimit, shkuam në Pallatin e Brigadave, ku hëngrëm darkë së bashku. Darka shkoi mirë. Pas buke pamë një film dhe u ndamë. Delegacioni ikën nesër.

Me delegacionin kinez ikën edhe delegacioni vietnamez.

Sot do të iknin mjaft delegacione nëpërmjet Italisë, por koha ishte shumë e keqe dhe s'u nisën dot.

Pjesëmarrja e miqve të huaj në festat tona, qoftë me delegacione, qoftë me telegrame nga të gjitha anët e botës, ka qenë me të vërtetë madhështore.

Kjo tregoi në mënyrë të shkëlqyer solidaritetin e madh të miqve të panumërt që ka atdheu ynë në të katër anët e botës. Tregoi se pozitat ndërkombëtare të Shqipërisë socialiste janë forcuar jashtëzakonisht shumë. Kjo gjë i detyrohet Partisë sonë të lavdishme, vijës së saj të drejtë, të urtë, largpamëse, të guximshme, kjo i detyrohet pjekurisë politike dhe heroizmit të popullit tonë. Luftës legjendare që bëri populli ynë për çlirim kundër fashistëve dhe nazistëve, iu shtua lufta heroike, plot suksese, plot heroizëm e ndërtimit të socializmit, lufta kundër vështirësive të brendshme dhe shkatërrimit njërin pas tjetrit të kompleteve të panumërta të imperialistëve të ndryshëm, të titistëve, të monarko-fashistëve grekë. Këtë prestigj ndërkombëtar të Partisë sonë dhe të popullit shqiptar e ngriti akoma më lart lufta heroike kundër revizionizmit modern, rrymës së saj hrushoviane në veçanti, luftë parimore, plot suksese.

Të gjitha këto bënë që Shqipërinë ta duan, ta njohin dhe ta përkrahin me qindra milionë njerëz në botë. Kjo është një fitore kolosale për popullin dhe për Partinë tonë. Shqipëria socialiste jo vetëm simpatizohet, por përmendet dhe merret si shembull nga shumë popuj të mëdhenj e të vegjël, për pjekurinë, për heroizmin dhe për mbrojtjen hapur, pa frikë të çështjeve të drejta të mëdha të kohës sonë. Këtë thesar të madh të fituar duhet ta konservojmë dhe ta shtojmë çdo ditë me qëndrimet tona të drejta, parimore, të urta dhe njëkohësisht të guximshme.

Delegacionet, partie dhe qeverie, të Kinës, të Koresë, të Vietnamit, me ardhjen e tyre i treguan botës

se sa ngushtë jemi lidhur me njëri-tjetrin, u treguan revizionistëve modernë forcën tonë të madhe marksiste-leniniste, që i dërrmoi dhe do t'i dërrmojë.

Delegacioni rumun, fakt është se u ndodh ngushtë, u përpoq të na shiste mend, por erdhi për lesh dhe iku i qethur. Megjithatë ai pa se Shqipëria është e çeliktë dhe aspak e izoluar. Le t'u bëjë mirë ky konstatim dhe t'u shërbejë për t'i inkurajuar për të ardhur në pozitat marksiste-leniniste.

Të gjitha partitë marksiste-leniniste që qëndrojnë në pozita të forta, dërguan delegacione, të gjitha komitetet qendrore të tyre dërguan telegrame urimi të gjata dhe të nxehta, kudo në vendet e tyre u bënë mitingje të panumërta. Kjo ishte një gjë e mrekullueshme për ne, kjo ishte një shprehje e madhe e solidaritetit ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, një gjë që ka rëndësi të madhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare është përfaqësimi komplet i partive të reja komuniste marksiste-leniniste dhe i të gjitha grupeve revolucionare marksiste-leniniste në Evropë e gjetkë. Kjo ngjet për herë të parë dhe në mënyrë zyrtare. Kjo është një fitore për Partinë tonë dhe një ndihmë e inkurajim kolosal për shokët që luftojnë heroikisht në mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Kjo që bëmë ne, tash do të krijojë një traditë, një vijë të re, të një qëndrimi marksist-leninist të hapët dhe të meritueshëm për partitë e reja marksiste-leniniste që janë formuar e që janë duke u formuar.

Telegramet e urimit që morëm nga shtetet me të cilat kemi marrëdhënie diplomatike, janë një gjë me

rëndësi, dhe telegramet e panumërta nga miq të ndryshëm nga të katër anët e botës ishin një përkrahje kolosale. Në ambasadat tona, ku u bënë pritje, vajtën miq me shumicë, të gëzuar dhe plot fjalë të mira për atdheun dhe për Partinë tonë. Në shumë vende u shthur filli i çorapes, si në Francë, për shembull, në mbrëmje vajtën një numër i madh anëtarësh të Partisë Komuniste Franceze, që vitet e tjera pengoheshin nga revizionistët. Ky është një sukses i vijës së drejtë të Partisë sonë.

Miqtë e mysafirët shëtitën vendin dhe mbetën shumë të kënaqur, të gëzuar nga çdo gjë, nga pritja e organizuar mirë, nga ngrohtësia dhe dashuria e popullit, nga vizitat e ndryshme në vend, nga kontaktet me popullin, me jetën, nga mbledhja solemne, nga raporti, nga parada ushtarake që i habiti dhe i entuziazmoi, nga entuziazmi i manifestimit popullor, nga darka solemne, nga lidhjet e çelikta të partisë me popullin.

Kjo është një fitore e madhe, fitore e shkëlqyer e Partisë sonë të lavdishme, e mëmës sonë të dashur Parti.

Revizionistët sovjetikë në mënyrë të paturpshme ripërsëritin kërkesën që mbledhja e komisionit redaktues të 16 partive, që duhet të përgatitë mbledhjen ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore të projektuar nga Hrushovi, të mbahet, por jo më 15 dhjetor 1964, siç kishin propozuar më përpara, por më 1 mars të vitit 1965. Pra asgjë s'ndryshojnë, veçse propozojnë

që në këtë «mbledhje komisioni partish» të marrin pjesë edhe parti të tjera që «kanë bërë lutje».

Revizionistët sovjetikë veprojnë plotësisht në vijën e Hrushovit dhe tregojnë qartë se skartimi i tij s'ka qenë veçse heqja e një «huri» nga gardhi revizionist, kështu gardhi ngeli si më parë. Ata pra janë të vendosur plotësisht në rrugën e tradhtisë si me Hrushovin, ashtu edhe pa të. Zaten ata po e thonë hapur, që ta dëgjojnë të gjithë, se Hrushovi u skartua gjoja për «çështje krejt të brendshme», dhe se po eot dhe do të ecet me vendosmëri në rrugën që kanë caktuar kongreset e 20-të, të 21-të e të 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Qëllimi i revizionistëve modernë, pra, nuk ndryshon. Me anë të kësaj farë mbledhjeje ata përpiqen të gënjejnë opinionin komunist botëror, duke përhapur mendimin se për çështjen e divergjencave kemi hyrë në bisedime për t'i sheshuar. Por këto «mbledhje» e «bisedime» mund të vazhdojnë me vite, dhe këtë gjë e lënë të kuptohet në letrën që kanë dërguar ku thonë se «mund të bëhen shumë mbledhje të komisionit përgatitor». Pra, revizionistët modernë kërkojnë të evitojnë mbledhjet dypalëshe, ku natyrisht nuk mund të arrihet në asnjë rezultat pa u dorëzuar krejtësisht sovjetikët, gjë kjo që s'ngjet. Ata, me këtë mbledhje përpiqen që të pushohet polemika qoftë edhe përkohësisht, pastaj do të kërkojnë ta zgjatin afatin, dhe në rast se polemika rifillon, atëherë të kenë gjoja një argument për të thënë se polemikën e rifilluam ne.

Revizionistët sovjetikë dëshirojnë të mos jenë ballë për ballë me ne dhe të detyrohen të na bëjnë lëshime,

ose mosarritjen e rezultateve të mos e marrin mbi vete, prandaj kërkojnë që debatin ta fillojnë me revizionistët e tjerë kundër nesh, bile të kenë shumicën, që kështu të paraqiten si një grup «i fortë», që bëri të gjitha përpjekjet për pajtim, por s'ia arriti dot qëllimit të «shenjtë» për fajin e «dogmatikëve»!

Më në fund, revizionistët sovjetikë, duke propozuar që në këtë mbledhje «komisioni përgatitor» të marrin pjesë dhe parti të tjera, kanë për qëllim që gradualisht, pas dy-tri mbledhjesh, pa kuptuar, ta kthejnë atë nga një mbledhje «të komisionit përgatitor» në një mbledhje të komurizmit ndërkombëtar.

Kështu revizionistët sovjetikë krijojnë njëfarë asambleje permanente të «komunizmit ndërkombëtar», si asambleja e Strasburgut që kanë krijuar kapitalistët, dhe në këtë farë asambleje debatet «janë të lira», mund të bëhen kritika sa të duash, mund të krijohen komisione e çfarë të duash dhe kështu revizionistët, gjoja nën parullën e forcimit të unitetit, t'ia arrijnë qëllimit, të vazhdojnë punën tradhtarë në rehati, pa polemikë, pa luftë.

E gjithë kjo duhet të shkëlmohet dhe do të demaskohet nga ana jonë. Ne do ta hedhim poshtë këtë manovër tradhtie, bajate dhe revizionistët sovjetikë në mars do të gjenden po në ato pozita që u gjend Hrushovi me projektin e mbledhjes së 15 dhjetorit. Ata ose do të pësojnë edhe një disfatë tjetër të bujshme, ose do ta bëjnë mbledhjen vetëm me revizionistët, mbledhje fraksioniste, pra *De profundis*-i i tyre.

Ne do të vazhdojmë të mos e njohim këtë udhëheqje tradhtarë të Bashkimit Sovjetik dhe do t'u drejto-

hemi drejtpërdrejt komunistëve sovjetikë. Përveç të tjerave, ne duhet të demaskojmë çështjen që për këtë mbledhje që propozohet as që është diskutuar me Partinë tonë. Pyesim, përse do të bëhet kjo mbledhje, ç'probleme konkrete do të diskutohen, kush i ka propozuar këto probleme, dhe në rast se s'kanë propozuar asgjë, si mund të shkohet në «një mbledhje përgatitore partish» pa ditur çfarë do të diskutohet dhe çfarë do të përgatitet? Apo këtë e di dirigjenti dhe ua servir të tjerëve në pjata?! Kjo tregon qartazi që mbledhja ka qëllime misterioze, mashtruese.

Lëvizja komuniste ndërkombëtare ka dokumentin marksist-leninist të Mbledhjes së Moskës të vitit 1960, ku janë përcaktuar drejt problemet dhe rrugët që duhet të ndiqen. Kush ka gabuar, të ndreqë gabimet e veta. Por fakt është se revizionistët tradhtarë nuk duan të njohin tradhtinë. Ata kanë frikë nga shpartallimi total i tyre, duan të shuajnë polemikën publike dhe ta kthejnë në një diskutim shterp të brendshëm, derisa të marrin veten nga grushtet e rënda që u japim, dhe të përgatiten për të na goditur më me forcë. Këtë manovër të tyre ne duhet ta demaskojmë katërcipërisht.

Pra, si konkluzion, s'ka pse të bëhet mbledhje me revizionistët, mbledhja të hidhet poshtë, të vazhdohet lufta për t'i demaskuar, t'i detyrojmë ata ose të hedhin armët, ose të bëjnë mbledhjen e tyre revizioniste.

Atëherë marksistë-leninistët duhet të bëjnë mbledhjen e tyre të vërtetë marksiste-leniniste.

Pozita jonë

1. — Të gjitha partitë duhet të marrin pjesë aktivisht dhe në mënyrë revolucionare në debat.

2. — Të zhvillohen bisedime në mes partive komuniste dhe punëtore, bisedime dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe bisedime të përbashkëta të partive komuniste e punëtore të kampit të socializmit. Për të zhvilluar të tilla bisedime në partitë komuniste e punëtore motra kërkohet më parë që:

a) Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik të njohë botërisht se ka gabuar rëndë dhe ka vepruar në mënyrë antimarksiste e armiqësore kundrejt Partisë së Punës të Shqipërisë dhe shtetit shqiptar në këto çështje (të numërohen ato).

b) Të gjitha partitë komuniste e punëtore të botës, dhe në radhë të parë ajo polake etj. (vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës), të njohin botërisht se kanë gabuar rëndë kundrejt Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, duke shkelur deklaratat e Moskës, marrëveshjet dhe aleancat, duke sulmuar Partinë e Punës të Shqipërisë në rrugën antimarksiste dhe pa tentuar as më të voglin sqarim me të, sipas rregullave të caktuara bashkërisht në Mbledhjen e Moskës, pa kontrolluar faktet, por duke iu bindur në mënyrë të verbër mendimit të falsifikuar të grupit revizionist të Nikita Hrushovit.

c) Të gjitha partitë komuniste e punëtore të kthehen në deklaratën e Moskës për sa i përket vlerësimit të tradhtisë së renegatëve titistë të Beogradit, të njohin gabimin e tyre tragjik dhe të ridënojnë klikën tradh-

tare të Titos, e cila është demaskuar botërisht dhe as që mund të bëhet fjalë që ajo të marrë pjesë, në çdo kohë dhe në çdo rrethanë, në ndonjë mbledhje ideologjike, politike të komunizmit ndërkombëtar.

3. — Komisioni përgatitor duhet të punojë për një kohë të gjatë, pa asnjë të drejtë vendimi, por me të drejtë studimi, konsultimi dhe masash përgatitore për mbledhjen e përgjithshme.

Komisioni duhet të pranojë dhe të studiojë të gjitha dokumentet që çdo parti e gjen të nevojshme t'i dërgojë dhe mbi këto baza të punojë.

Komisioni duhet t'i paraqesë mbledhjes rezultatet e punës së tij, pikëpamjet e ndryshme të çdo pale, partie ose grup partie, çështjet ku u arrit marrëveshja dhe ku jo, ku qëndrojnë divergjencat dhe fajet në bazë të fakteve.

Ky dokumentim duhet të përbëjë bazën e diskutimeve të mbledhjes, ku të marrin pjesë delegatë nga të gjitha partitë komuniste e punëtore të botës, si dhe të gjitha ato parti të reja që janë formuar rishtas. Pa pjesëmarrjen e tyre nuk mund të zhvillohet mbledhja e partive komuniste e punëtore të botës.

Për një diskutim të përgjithshëm në të gjitha partitë komuniste e punëtore të botës të divergjencave ideologjike

Pse është i nevojshëm një diskutim i tillë (në vija të përgjithshme):

— E vetmja rrugë leniniste për sqarim objektiv.

— E vetmja rrugë leniniste për spastrimin e gjithçkaje që është antileniniste në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

— E vetmja rrugë për ndarjen e shapit nga sheqeri, e sqarimit çka është e vërtetë dhe çka është e gënjeshtërt.

— E vetmja rrugë e krijimit të unitetit mbi baza marksiste-leniniste në partitë komuniste e punëtore në lëvizjen komuniste botërore.

— E vetmja rrugë e drejtë, e sigurt se çdo komunist merr përgjegjësi dhe flet e vendos me përgjegjësi të plotë për çështjen e madhe në diskutim; e vetmja rrugë që i siguron çdo parti, pas një diskutimi serioz, një vijë të drejtë marksiste revolucionare, bazuar në normat e vërteta leniniste dhe në bazë të parimeve të përgjithshme të statutit të vet, të centralizmit demokratik, në bazë të kritikës dhe të autokritikës.

— E vetmja rrugë e drejtë dhe me garanci që i jep delegacionit, që do të dërgohet nga çdo parti komuniste e punëtore në një mbledhje të përgjithshme të partive komuniste e punëtore të botës, të drejtën të flasë dhe të mbrojë vijën e partisë, vullnetin e partisë së tij dhe jo vullnetin e një klike e të një grupi.

Që të bëhet kjo duhet të merren këto masa organizative:

I. — Çdo parti të vendosë vetë cilat materiale nga të sajat dëshiron të botohen nga të gjitha partitë komuniste e punëtore të tjera të botës.

Çdo parti komuniste e punëtore të jetë e detyruar

t'i botojë këto materiale *in extenso*¹, në organet qendrore të partisë dhe në broshurë të veçantë, një për çdo tre komunistë.

II. — Për sa i përket Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ajo duhet më parë të njohë botërisht gabimet e saj të veçanta.

T'u bëhen të ditur të gjithëve gabimet tragjike dhe veprimet armiqësore që kanë bërë sovjetikët kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, Partisë Komuniste të Kinës, Partisë së Punës së Koresë, Partisë së Punojnësve të Vietnamit, kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, Republikës Popullore të Kinës.

Pa i njohur botërisht këto gabime, nuk mund të flitet për mbledhje të komunizmit ndërkombëtar.

III. — Në mbledhje do të thirren, me të gjitha të drejtat, partitë e reja marksiste-leniniste që janë formuar e që do të formohen gjatë kohës përgatitore.

Pa i thirrur këto parti, me të drejta të barabarta, nuk mund të flitet për mbledhje të komunizmit ndërkombëtar.

IV. — Pasi të plotësohen këto detyra e detyrime duhet të krijohet një komision i përbërë nga përfaqësuesit e një numri partish, i cili duhet të studiojë petitionet, rezolutat etj., që do t'i paraqiten dhe do të vendosë për thirrjen e mbledhjes, vendin dhe rendin e ditës.

Në mbledhje, çdo delegacion, ka të drejtë të thotë lirisht pikëpamjen e partisë së vet, të bëjë propozime.

Të bëhet bilanci i diskutimeve në komision, të shi-

1. Latinisht — të plota.

kohen pikat që na bashkojnë, të bëhet bilanci i gabimeve që janë vërtetuar, të dënohen rreptë këto dhe të përcaktohet vija e drejtë e përgjithshme.

V. — Çdo e drejtë e dhënë më parë Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për organizimin e mbledhjes, për caktimin e rendit të ditës, për caktimin e vendit, i hiqet për arsye se grupi renegat hrushovian s'e meriton këtë besim.

Po s'u bënë këto, Partia e Punës e Shqipërisë nuk do të marrë pjesë në asnjë mbledhje të partive komuniste e punëtore të botës, të thirrur nga klikat revizioniste, për qëllime të huaja dhe armiqësore për socializmin dhe komunizmin.

Ra borë në Dajt. Edhe në Tiranë ra, gjithashtu, një cipë bore e hollë.

Konstatohen disa të meta serioze në ndërtime, të cilat janë me pasoja të ndjeshme për ekonominë tonë.

1. — Studimi i objekteve që ndërtohen nuk bëhet i plotë, shpesh bëhen ndryshime dhe shumë herë janë të pastudiuara me fondet e caktuara. Vlera e projekteve të objekteve që ndërtohen asnjëherë nuk del më e paktë, por kurdoherë tejkalon preventivin dhe bile në mënyrë të konsiderueshme.

2. — Fillohen ndërtime pa bërë preventivin ose fillohen disa objekte që quhen jo shumë të rëndësishme, por kur mbarojnë kostoja e tyre kap 5-6 fishin e asaj «gjëje të vogël» që parashikohej në fillim.

3. — Ndërtohen objekte pa studiuar mirë leverdinë ekonomike, lëndën e parë dhe mundësinë e përdorimit të prodhimeve.

a) Sipas llogarive përfundimtare, në Fabrikën e Bukës në Tiranë, kostoja e bukës, në vend që të ulej,

në krahasim me furrat ekzistuese, ngrihet 55 milionë lekë në vit!

b) Përdorimi i majasë së bukës e ul rrezën e bukës 4 për qind, domethënë bukë me miell të rrezës 90 për qind do të kemi 3 000 tonë më pak në vit, që do të thotë 60 milionë lekë humbje.

4. — Ndërtohen karabinatë e fabrikave, si, për shembull, ajo e Fabrikës së Qumështit në Lushnjë, kurse makineria akoma nuk është porositur.

5. — Nuk vihet re një thjeshtim i numrit të objekteve që ndërtohen dhe si pasojë përdoret material jashtë masës dhe domosdoshmërisë. Në këto drejtime ka shumë shembuj dhe efektet ekonomike llogariten me qindra milionë lekë.

Duhet medoemos e sa më parë të marrim masa serioze dhe veçanërisht në hartimin e planit të ardhshëm pesëvjeçar. Pësimet të na bëhen mësim.

a) Të bëhet projekti për çdo objekt të ri që do të ndërtohet dhe veç kësaj të studiohen fill e për pe të gjitha të dhënat e nevojshme. Për sa i përket parashikimeve, të caktohet një marzh i vogël; më tej të mos lejohet të kapërcehen shpenzimet.

b) Organizimi i mirë i punimeve dhe vendosja e kohës së zbatimit të projektit. Futja në shfrytëzim e një objekti të caktuar në kohën e parashikuar të konsiderohet jo vetëm një detyrë, por një detyrim ligjor për investitorin dhe ndërtuesin.

c) Organet e planifikimit dhe organet e kontrollit financiar duhet të shkunden mirë, të heqin dorë nga puna rutinë; të mobilizohen, të parashikojnë e të marrin masa që më parë dhe jo të kënaqen me konstatime

dhe me raportime ndërsa e ka marrë ferra uratën, domethënë punimet kanë hyrë në një rrugë të shtrembër.

d) Kryesia e Këshillit të Ministrave të tregohet më shumë e interesuar për zbatimin e detyrave nga dikasteret në ndërtimin e objekteve të mëdha e të kushtueshme, punë që duhet ta bëjë konkretisht e jo në vija të përgjithshme duke ndihmuar e kontrolluar me organet përkatëse, që nga projekti dhe deri te përdorimi i drejtë i preventivave financiarë dhe materialë. Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Financave dhe Banka e Shtetit të bëhen syri i fuqishëm i Qeverisë në këto çështje të rëndësishme.

Për këtë mendoj se duhet të rishikohen më nga afër metoda e punës së tyre, mund të vihen detyra të reja më efikase për të zëvendësuar të vjetrat që ishin për një kohë tjetër, kur ndërtimet nuk kishin këtë zgjerim. Ndoshta mund të krijohen në këto hallka organizma të veçantë, që të ndihmojnë, por njëkohësisht të parashikojnë dhe të marrin masa me kohë për të mënjeluar pasojat negative në këtë fushë.

Ky është një problem që s'pret dhe që «gëlltit» me qindra milionë nga ekonomia jonë. Prandaj ta studiojmë seriozisht punën e ndërtimit dhe të marrim masa.

Sot u larguan delegacionet kineze, vietnameze etj. Iken të kënaqur.

Gazeta «Zhenminzhibao» botoi pjesën e dytë të fjalimit që mbajta me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit

të Atdheut, domethënë pjesën për politikën e jashtme dhe atë ideologjike, pra e dha të plotë¹.

1. Po në këtë datë autori ka hedhur në Ditar shënimin: «Të mbrojmë luftën heroike të popullit të Vietnamit të Jugut», botuar në librin: Enver Hoxha, «Superfuqitë», f. 130.

E DIEL 6 DHJETOR 1964

Sot ikën delegacioni belgjian dhe delegacionet e tjera. Të tërë u larguan të gëzuar, të kënaqur.

Kam filluar ta rralloj duhanin. Sot nga 37 shkova në 22 cigare.

Raporti i Gjykatës së Lartë që i paraqitej Presidiumit të Kuvendit Popullor jepte një pasqyrë të qartë për zgjidhjen e martesave. Gjatë studimit të tij shënova disa mendime:

Situata nuk është alarmante. Ka përparime në shumë drejtime. Gratë kanë kuptuar të drejtën e madhe që u njih ligji për zgjidhjen e martesës dhe numri i kërkesave të tyre në gjykatë paraqitet në përqindje të afërt me kërkesat e burrave. Pra tash s'është vetëm burri ai që kërkon zgjidhjen e martesës, por edhe gruaja. Rëndësi ka, gjithashtu, që përqindja e komunistëve (e oficerëve po ashtu) që kërkojnë zgjidhjen e martesës është shumë e ulët.

Në qytete ka më shumë divorce se në fshat, kjo, sigurisht ndodh, se atje shkaqet subjektive janë më të mundshme. Në fshat gruaja është më e prapambetur dhe ndjenja e patriarkalizmit më e fortë. Në disa fshatra divorcin e pengon deri diku edhe feja katolike.

Por megjithatë, duhet forcuar akoma më shumë puna edukative e Partisë, e organizatave të gruas e të rinisë, si dhe puna e vetë gjyqtarëve dhe prokurorëve.

1. — Në bazë të eksperiencës së fituar, të hartohen leksione me përmbajtje të lartë edukimi për moralin proletar, të zhvillohen kurse të veçanta me gjyqtarët dhe prokurorët, që ata të përgatiten për një punë më të mirë në drejtim të pajtimit të çifteve, të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, të forcimit të familjes, mbrojtjes së interesit të fëmijëve etj.

Këto materiale mund të përpunohen nën drejtimin e Partisë, nga gjykatat, prokuroritë, organizatat e gruas e të rinisë. Të krijohet një ambient i tillë i ngrohtë dhe i sigurt, që ata të cilët kanë mosmarrëveshje me gruan ose me burrin, të kërkojnë ndihmën e Partisë, të gjyqtarit e të prokurorit që si persona të formuar, të këshillojnë pajtimin paraprak, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që i çojnë çiftet në divorce e në shkatërrimin e familjeve.

2. — Të edukohet rinia dhe njerëzit në përgjithësi që t'i shikojnë drejt lidhjet shoqërore të të rinjve dhe të mos flasin andej-kënde, sapo shohin dy të rinj, që i lidh puna, mësimi, gjitonia etj., se këta janë të fejuar ose do të fejohen. Kjo krijon situata shumë të vështira për të rinjtë, hapen fjalë të kota dhe të rrezikshme për jetën e tyre, sidomos për vajzën. Kjo gjendje krijon, gjithashtu, mendimin se gjoja ekzistoka «licence» në rininë tonë. Kështu që vajza, për të mos u marrë kot nëpër gojë, detyrohet të izolohet, të bëjë një jetë të vetmuar, të ketë frikë të marrë pjesë në manifestimet e jetës.

Koncepte të tilla që shfaqen në një realitet të ndryshëm nga i vjetri, ku pranohet liria e të rinjve, që ata të venë në shkollë, të mësojnë bashkë, të qëndrojnë

bashkë, por, me kusht që medoemos të fejohen, se ndryshe «u del nami i keq», burojnë po nga pikëpamjet konservatore të disa njerëzve. Këtë nam të keq po këta e ushqejnë, e pëshpëritin për bijtë e bijat e të tjerëve, por që edhe të tjerët nuk mungojnë të flasin andej-kënde për fëmijët e atyre.

3. — Duhet sa më parë të korrigojohet interpretimi i gabuar, i bërë nga Ministria e Financave dhe nga Bashkimet Profesionale, për kompensimin e fëmijëve kur divorcojnë prindërit. Kur divorcojnë prindërit, kompensimi s'jepet për atë që është në marrëdhënie pune! Pse?! Vetëm për ngatërresa administrative! Kurse po këtij prindi, kur rimartohet dhe bën fëmijë, i fillon ndihma për fëmijë. Ky është diskriminim. Fëmijëve të pafajshëm të prindërve të divorcuar, në momentin më të vështirë të jetës së tyre materiale dhe shpirtërore, u pritët ndihma!

Të merren masa që kjo çështje të ndreqet menjëherë.

E MARTË
8 DHJETOR 1964

Mbledhja e organizatës-bazë.

Në Kongresin e 8-të të LKJ Titoja sulmoi fort Kl-nën. Të shohim si do të përgjigjen kinezët.

Vazhdoj të ruaj normën, 20-21 cigare në ditë.

Nga raportet që na jepen vëmë re se në kalamanët nga një deri në një vjeç e gjysmë kemi shumë vdekje dhe në përgjithësi shumica e këtyre rasteve ndodhin në fshat.

Me gjithë përparimet e mëdha që kemi bërë mendoj se këtë problem të madh duhet ta shikojmë më nga afër.

Shkaqet e vdekshmërisë së lartë në moshat e vogla mund të jenë shumë, por mendoj se kryesorja është mungesa e kulturës higjienike nga ana e mëmës dhe ngarkesa e kësaj me punë të tepërt ose të rëndë muajt e fundit të shtatzënësisë e sidomos pas lindjes. Ky fenomen ndodh më shumë në fshat, ku gruaja është e ngarkuar me shumë punë në arë dhe në shtëpi. Kështu që në shumicën e rasteve fëmijët që lindin para kohe janë në fshat dhe që pastaj nga pakujdesia vdesin më shumë.

Kurse grave të qytetit që janë në marrëdhënie

pune legjislacioni u ka siguruar gjatë periudhës së shtatzënësisë tre muaj leje të paguar, përveç kushteve të tjera më të mira, siç janë spitalet më të gjera e të pajisura më mirë, konsultoret etj.

Bisedova me shokët që ky problem të shqyrtohet në Kryesinë e Këshillit të Ministrave për të parë mundësinë e shtrirjes së legjislacionit edhe për gratë kooperativiste. Të studiohet formulimi i ndonjë ligji që gruaja në kooperativë të ketë leje lindjeje, me pagesë nga kooperativa në atë masë që do të shihet e arsyeshme. Dhe pas kësaj leje, për një kohë, sa të gjykohet, t'u jepet punë e lehtë.

Gjithashtu mendoj se duhet shtuar numri i shtretërve gratis në spitalet e qyteteve për fëmijët premturë që lindin në fshatra.

Dhe së fundi, nëpërmjet mjekëve, mamive e infermiereve në fshat të forcojmë edukimin e nënave, të zgjerojmë dhe të thellojmë kulturën e tyre për rritjen e fëmijëve, për higjienën e brendshme dhe të jashtme, për ushqimin e tyre etj.

Organizatrat e Partisë, gjithë komunistët, duhet të interesohen shumë, shumë më tepër për këtë problem të madh që ka të bëjë me jetën e njerëzve tanë, me ndjenjat e grave, të nënave shqiptare, me të ardhmen e popullit dhe të atdheut.

Për forcimin e mëtejshëm të ushtrisë

T e z a¹

1. Stërvitja ushtarake duhet intensifikuar, pse shoh boshllëqe si në anën teorike dhe në atë të praktikës ushtarake. Flitet mjaft për stërvitje ditën, për stërvitje natën, bëhen leksione etj. Të gjitha këto bëhen, po kryesorja është si bëhen. Më duket se programet nuk janë aq të qarta. Kam parë ndonjë demonstracion të organizuar, i cili ka qenë i kënaqshëm, por a bëhen kudo dhe kurdoherë kështu?

— Stërvitja ushtarake si në kondita lufte ka rëndësi vendimtare. Në gjumë nuk duhet të jemi për këtë problem. Na paraqitni kurdoherë organizime. Këto duhen, por mendoj që këto të bëhen të studiuara. Është

1. Në bazë të këtyre tezave shoku Enver Hoxha ka zhvilluar një bisedë me Beqir Ballukun, të cilit i ka tërhequr vëmendjen për disa dobësi e të meta serioze që ekzistojnë në ushtri dhe i ka dhënë detyra për forcimin e mëtejshëm të saj.

e domosdoshme që ushtrinë ta kemi kualitativisht të ngritur nga ana politike dhe ushtarake, por edhe zgjerimin e strukturave të saj duhet ta organizojmë. Më duket se ju, drejtuesit e Ministrisë nuk mendoni seriozisht për këtë. Ju mendoni vetëm për ushtrinë e kohës së paqes, por jo edhe për atë të kohës së luftës.

2. Vazhdojmë me SHNUM¹-in, si më parë. Ç'na jep ky organizim i vjetër? Gati asgjë. Na përgatit disa shoferë ose ata që i bien «çikalinos» së morsit. Pse me SHNUM-in do të vemi ne në luftë?!

— Ne duhet të organizojmë të gjithë popullin për kohë lufte. Ju mund të thoni: «Po ja, kemi rezervistët dhe këta e kanë bërë ushtrinë». Po, rezervistët e kanë bërë ushtrinë, por ka dhe nga ata që e kanë harruar. Dhe ata duhet jo të figurojnë vetëm si emra në zyrat ushtarake, por të jenë sidomos në fusha të stërvitjes. Rezervistëve duhet t'u përsërisim akoma më mirë ato që u kemi mësuar, sepse ose i kanë harruar, ose po i harrojnë. Prandaj duhen ndërtuar programe serioze për ta.

3. Rishikoni fund e krye stërvitjen ushtarake të studentëve dhe të paraushtarakëve, si në qytet dhe në fshat. Marrja seriozisht në dorë e kësaj detyre nga ushtria është urgjente dhe e domosdoshme.

Le të studiohet, por unë mendoj që në qytete stërvitja të fillojë që nga mosha 16 vjeç, me programe më

1. Shoqëri në Ndihmë të Ushtrisë e Mbrojtjes. U krijua më 13 gusht 1949 si shoqatë vullnetare masive dhe veproi deri në 1965-ën. Duke kaluar në sistemin e ri të armatosjes, të organizimit e të përgatitjes ushtarake të tërë popullit, në vitin 1965 SHNUM-i u shkri.

të zgjatura. Mendoj që programi hëpërhë të mos jetë i njëllotë për djem dhe për vajza. Në fshat për djemtë mund të jetë njësoj si ata të qytetit, në pikat e hapjes të ushtrisë; për vajzat dhe gratë deri në një farë moshe në formë vullnetare dhe brenda në kooperativën e fshatin e tyre. Program i diferencuar.

4. Buxheti i vitit 1965 duhet të jetë i shtrënguar, të bëhen shkurtime dhe kursime, pse kam përshtypjen se mendohet që «për ushtrinë arka e shtetit është e hapur, vetëm hap gojën dhe kërk». Jo, të luftohet ky koncept, në qoftë se ekziston. Të bëni shkurtime dhe kursime në çdo gjë, por veçanërisht në karburante, në dieta, në goma, në vegla ndërriimi. Të evitohen ndërtime të tepërta dhe të panevojshme. Jo me preventiva të fryrë dhe të pastudiuar mirë. Në ushtri ekziston një rrezik serioz në këto drejtime, prandaj ju them të bëni shumë kujdes, se ka rrezik abuzimi, vjedhje, kujdes të dobët në objekte etj. Duhet kontroll i madh financiar. Mos kujtoni se për financat e për çdo gjë Ministria e Mbrojtjes është jashtë kontrollit shtetëror.

5. Puna e Partisë në ushtri duhet forcuar. Unë mund të gabohem, por them se nuk e ndiej fort pulsën e organizatave-bazë të Partisë. Shoh një sërë shfaqjesh në njerëz dhe në veprime që ma krijojnë këtë përshtypje. Në tërësi, Partinë në ushtri e kemi të fortë, heroike, kuadrot i kemi të mirë, të luftës, por mendoj se organizimi i saj dhe i punës mund të shikohet, nëse mund të bëjmë ndonjë farë ndryshimi. Ne kemi aktualisht komandën unike dhe seksionet politike. Seksionet politike janë të emëruara dhe jo të zgjedhura. Prandaj mendoj, por kjo është një ide që më duhet ta blauj

dhe ta përpunoj në kokë, pastaj ta parashtroj¹, a duhet ne të vazhdojmë me këtë formë pune partie? Kjo më duket se nuk jep sa duhet dhe si duhet, nuk e përfaqëson plotësisht Partinë në komandën e ushtrisë.

Partia në ushtri duhet të jetë udhëheqëse, në teori dhe në praktikë. Komanda unike nuk e lejon një të vërtetë të tillë absolute. Në qoftë se heqim seksionet politike, atëherë duhet t'i zëvendësojmë. Me se? Me komitete partie të zgjedhura. Kjo e vë Partinë në udhëheqje, forcon demokracinë revolucionare. Komanda unike nuk mund të ketë nën urdhra Partinë, komitetin e Partisë. Komiteti i Partisë duhet të jetë në komandë, të komandojë komandën, pra komanda unike duhet të priset dhe të vijmë te komanda e kohës së luftës, komandant e komisar. Atëherë dhe teorikisht dhe praktikisht Partia komandon, krijohen komitetet dhe këto lidhen me Drejtorinë Politike dhe kjo është drejtori e Komitetit Qendror. Ne kemi krijuar komitete partie në shkolla ushtarake dhe ato ecin. Sidoqoftë unë do ta mendoj këtë çështje më thellë dhe duhet t'ia paraqes në kohën e duhur Byrosë Politike, se është në kompetencën e saj. Mendoni dhe ju, dhe më jepni mendimin tuaj.

6. Për përgatitjen operative të vendit. Të vazhdohen punimet xheniere, në drejtim të fortifikimeve, të brezave të mbrojtjes, në formë tuneli, në vendkomanda etj. Ky problem është kapital dhe duhet të largoheni

1. Këtyre ideve shoku Enver Hoxha iu kthye e iu rikthye përsëri. Këto pasqyrohen në Ditarin e tij e në diskutime që ka zhvilluar në Byrosë Politike, në Sekretariatën e KQ të Partisë dhe që u publikuan në Letrën e Hapur të KQ të 4 marsit 1966.

nga pikëpamjet subjektiviste. Punime të tilla duhet të ndjekin planin strategjik e taktik. Ky plan është i drejtë në vija të përgjithshme, por duhet herë pas here ta rishikojmë, ta korrigjojmë dhe ta plotësojmë. Duhet të njiheni mirë dhe vazhdimisht me përgatitjet luftarake të armiqve tanë. Dua t'ju them hapët, unë jam i pakënaqur nga informacionet që më jepni dhe kam arritur në konkluzionin se, ose ju nuk interesoheni, ose interesoheni, por nuk i përpunoni këto çështje. Duke mos i përpunuar, as juve s'ju hyjnë në punë dhe as neve nuk na vini në korent.

Nuk lejohet që punimet xheniere të caktohen dhe të ndërtohen si do njëri ose tjetri. Kjo është një detyrë e madhe e Shtatmadhorisë, e Drejtorisë operative dhe jo e një ose dy «kompetentëve ushtarakë». Këto probleme duhet të m'i paraqitni përfundimisht. Unë nuk do t'ju ndjek dot me këmbë mal më mal, por duhet të vini të m'i shpjegoni në kompleksin e tyre. Çdo gjë të bëhet në vendin e duhur, të betonohen mirë hyrjet dhe vendet që mund të shemben, tokat e qëndrueshme shkëmbore të lihen pa u betonuar. Të ushtrohet kontroll i fortë në këto punime.

Rrugët ushtarake të mos lihen pas dore siç kam parë disa. Disa pjesë të rrugës t'i bëjmë më mirë, të tjerat t'i mbushim, t'i mirëmbajmë, të bëjmë kanalizimet, që të mos na prishen dhe të kemi parasysht kthesat më të gjera dhe vende ku të kalojnë dy makina.

Duhet të vazhdojmë të ndërtojmë depo të mira për armatime dhe ushqime. Këto të bëhen me kritere të shëndosha, sa më afër reparteve, fronteve dhe sa më pak të prekshme dhe të diktueshme nga armiku. Të

gjitha këto të bëhen të planëzuara dhe në asnjë mënyrë në dëm të stërvitjes politiko-ushtarake të trupave. Nuk lejohet as anarki, as kaos, as konfuzion, por zbatim me përpikëri i çdo plani.

**E HENË
14 DHJETOR 1964**

Mbledhja e Këshillit të Mbrojtjes.

**E MARTË
15 DHJETOR 1964**

Titistët dhe miqtë e tyre u përpoqën t'i bënin shumë reklamë kongresit të tyre të 8-të revizionist, por nuk ia arritën dot qëllimit. Në paraqitjen e jashtme, revizionistët jugosllavë i dhanë formën që i përshtatej «socializmit specifik»: në këtë kongres tradhtarësh morën pjesë disa parti revizioniste, por edhe parti socialdemokrate dhe socialiste të Evropës e të vendeve të tjera kapitaliste. Këto të fundit e ndjenë veten si në shtëpinë e tyre. Revizionistët modernë që morën pjesë në këtë kongres, u treguan si «mbi gjemba» dhe të ndrydhur, jo pse nuk ishin solidarë me titistët, por se kishin frikën e komprometimit, të demaskimit të tyre dhe se atje ata e ndienin veten si nxënës përpara profesorëve, që zhvillojnë teoritë revizioniste, që japin vijën politike, ideologjike dhe organizative. Pra partitë revizioniste u drojtën të dërgonin atje personalitete «të shquara», gjë që nuk u ka pëlqyer titistëve. Nga ana tjetër, shumë parti revizioniste nuk dërguan delegacione dhe kjo, po ashtu, nuk u ka pëlqyer titistëve.

Fjalimet e Titos, të Kardelit, të Rankoviçit etj. kishin për qëllim kryesor të shtjellonin «formën e re»

të ndërtimit të «socializmit», vetadministrimin punëtor. Këtë formë «specifike» u përpoqën ta teorizojnë, ta stërhollojnë, gjoja ta plotësojnë, ta korrigjojnë me eksperiencën e fituar nga praktika.

Por ç'del nga e gjithë kjo? Një fiasko, një dështim i plotë e i natyrshëm. Një blufë i madh, i mbuluar me fraza bombastike, skolastike, të errëta me qëllim, të pakuptueshme dhe të pazbatueshme.

E gjithë kjo, për të gënjer, për të maskuar rrugën e tyre të kalimit nga «socializmi» (që në të vërtetë s'ka qenë ndërtuar kurrë në Jugosllavi) në kapitalizëm. Jugosllavia, në fakt, është një vend kapitalist. Vetadministrimi jugosllav është gjoja një fushë eksperimentimi, një metodë gjoja socialiste e vërtetë për të ndërtuar socializmin, për t'ua rekomanduar për përdorim revizionistëve të tjerë modernë, që i janë futur luftës për transformimin e socializmit në kapitalizëm në vendet e tyre.

Eksperimenti jugosllav synon jo vetëm transformimin e vendeve socialiste në vende kapitaliste, por synon gjithashtu që ky eksperiment të vlejë edhe për kapitalistët, në qoftë se gjenden të shtrënguar për të bërë disa reforma sa për sy e për faqe, sa për të gënjer klasën punëtore dhe popujt. S'është pa arsye dhe pa qëllime që imperialistët amerikanë, dhe bile personalitete të larta, e mburrin vijën jugosllave, bile thonë publikisht se ka disa gjëra që «ne duhet t'i studiojmë dhe t'i eksperimentojmë edhe në vendin tonë».

Gjendja në Jugosllavi shkon keq e më keq, po aq u bën titistëve, ata tash kryejnë *corvée*¹-në për ameri-

kanët dhe borgjezinë kapitaliste botërore në këto dy drejtime.

Në fjalimin e Titos dhe të të tjerëve s'ka asnjë fjalë polemike kundër imperializmit amerikan e të tjerëve. Kjo është e natyrshme dhe s'na çudit. Por Titoja, konkretisht dhe pa asnjë ekuivok, saboton luftën revolucionare të marksistëve dhe të popujve. Titoja, për t'ua dhënë disa atë shokëve të tij revizionistë, bën njëfarë autokritike të përgjithshme në fillim, me qëllim që shokët e tij ta përdorin për të gënjer dhe të thonë që «ja, Titoja diçka po korrigjon», kurse në fakt jo vetëm që ai nuk korrigjon asgjë, por forcon, afirmon, zhvillon vijën e tij tradhtarë revizioniste.

Nga fjalimet e krerëve revizionistë jugosllavë duket qartë kaosi i madh ideologjik, politik dhe ekonomik që mbretëron në Jugosllavi, duket pasiguria e tyre, vështirësitë kolosale që kanë krijuar në vend, ku imperialistët amerikanë jo vetëm po dominojnë, por e mbajnë ekonominë jugosllave në një kaos, të paramenduar për eksperimentet e tyre dhe për qëllimet e tyre kundër vendeve socialiste. Udhëheqësit tradhtarë jugosllavë notojnë në tradhti. Direktivat dhe dëshirat e imperializmit amerikan janë haptazi vija e politikës së tyre të jashtme. Titoja, në radhë të parë dhe posaçërisht, sulmoi Kinën dhe nëpërmjet saj të gjithë ne, bile ai dënoi dhe kërcënoi të gjithë ata që shpresojnë, ose bëjnë «kompromise» me ne.

Kjo tregon frikën kolosale që ata dhe padronët e tyre kanë nga marksizëm-leninizmi, nga e vërteta dhe nga disfata e tyre e sigurt. Duhet të forcojmë më tej luftën dhe demaskimin e tyre.

1. Frëngjisht — punë e detyruar e bujkrobrit ndaj të zotit.

E MËRKURE
16 DHJETOR 1964

Prita shqiptarët e mërguar që kishin ardhur me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut¹. Më thanë se ishin në rrethe të ndryshme të vendit, kishin vizituar fabrika, kooperativa, shkolla etj.

Ishin shumë të gëzuar, të kënaqur dhe të entuziazmuar.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 287.

E ENJTE
17 DHJETOR 1964

Në diskutimin tim¹ sot në mbledhjen e Sekretariatit duke folur për edukimin komunist të popullit dhe veçanërisht të anëtarëve të Partisë, theksova rëndësinë e një koncepti të drejtë për edukimin ideologjik, luftën si kundër optimizmit të tepruar dhe kundër pesimizmit, kundër qëndrimeve konservatore dhe atyre liberale.

Mbështetje rinisë, luftë kundër thashethemeve dhe kuptim të drejtë ndaj modës.

Fola² gjithashtu për përqendrimin në ndërtimet, për përcaktimin që duhet të bëjë Ministria e Ndërtimit se cilës vepër i duhet dhënë prioritet ndërtimi në raport me të tjerat që janë në plan.

I. Mbi punën e organizatave të Partisë në ndërmarjet industriale dhe ekonomike, të sektorit të grumbullimit, për forcimin e regjimit të kursimit, për përhapjen e eksperiencës së përparuar dhe rritjen e ndërgjegjes socialiste.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 309.

2. Po aty, f. 323.

1. — Përse kursimet të bëhen në formë fushate?
2. — Rezervat e brendshme.
3. — Si shkoka mirë puna kur në vend që të kishte 19,4 milionë lekë fitim pati 12,6 milionë humbje vetëm brenda 6 muajsh?
4. — Edukata dhe ndërgjegjja e disa njerëzve është akoma e dobët.

5. — Të qërohen sa më parë nga ndërmarrjet e grumbullimit njerëzit që kanë vjedhur.

Magazinerë të caktohen njerëz të rinj, të zotë e të gjallë dhe me ndërgjegje të lartë në punë. Magazinat nuk janë *refugium peccatorum*.

6. — Nga komitetet e Partisë të rishikohet nga të gjitha anët përbërja e tërë kuadrove punonjës në sektorin e grumbullimit.

Si interesohet, si i ndjek dhe si i zgjidh komiteti i Partisë dhe komiteti ekzekutiv i një rrethi problemet e grumbullimit dhe si punohet në këtë sektor me kuadrin, me përgatitjen profesionale, me organizimin, me ngritjen e ndërgjegjes së punonjësve.

Konkretisht dhe jo teorikisht.

II. Mbi përgatitjen e specialistëve dhe zgjerimin e aktiviteteve prodhuese dhe të shërbimeve të artizanatit në Tepelenë dhe në Kukës.

1. — S'është mirë që riparim-shërbimi në Tepelenë të realizohet 275 lekë në vit për frymë dhe aq më keq në Kukës ku është 75 lekë në vit.

Nuk vlerësohet aktiviteti i këtij sektori, nuk interesohen për shtimin dhe edukimin e kuadrit të ri.

Tepelena planin me zanatçinjtë e plotëson 76 për qind, Kukësi 43 për qind.

Si në Tepelenë, edhe në Kukës ka zanatçinjtë që punojnë edhe me leje, edhe që janë pa u kooperuar.

Kooperativat dërgojnë pak njerëz që të mësojnë zanat në qendrën e rrethit.

Nuk prodhohen gati fare prodhime lokale me lëndë të parë nga rrethi.

III. Mbi tematikat e byrove të komiteteve të Partisë, të plenumeve dhe të aktiveve të Partisë në rrethe.

1. — Bujqësia. Tematikë e gjerë, përveç të tjerave edhe në lidhje me kontrollin dhe ndihmën për zbatimin e kodit agroteknik.

2. — Informacionet duhen, por këto të mos ngatërrohen me analiza, studime dhe detyra të një periudhe të gjatë. Informacionet të shërbejnë për këto studime dhe për të marrë masa konkrete në vend.

Bashkë me shokë të udhëheqjes së Partisë vizituam Ekspozitën Kombëtare të Arteve Figurative që u hap me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit. Ishin ekspozuar vepra të piktorëve dhe të skulptorëve tanë të rinj e me perspektivë. Binin në sy përparime. S'kishte asgjë shqetësuese. Veprat e ekspozuara kishin përmbajtje të shëndoshë e të pastër, larg ndikimeve moderniste dhe rrymave dekadente.

Por nga artistët tanë duhen bërë akoma më shumë përpjekje për t'i çuar më përpara artet figurative. Shu-

më pak vepra kishte në këtë ekspozitë nga piktorët dhe skulptorët tanë të afirmuar.

Urova piktorët dhe skulptorët pjesëmarrës për arritjet në këtë ekspozitë dhe lashë një shënim në librin e përshtypjeve¹.

E PREMTE
18 DHJETOR 1964

Bëmë mbledhjen e Byrosë Politike, ku diskutuam dhe aprovuam, midis të tjerave, çështjen e thjeshtësimit të aparatit administrativ të qendrës dhe forcimin e komiteteve ekzekutive të rretheve.

Studimi që na u paraqit për këtë problem në përgjithësi ishte i mirë. Kemi të bëjmë me një problem të ndërlikuar e të rëndësishëm prandaj llogaritë për shkurtime në organika duhen bërë mirë, me saktësi. Në diskutimin tim¹ theksova se një nga çështjet kryesore është të vendosim parimisht a duken bërë ndryshime në strukturën e dikastereve dhe dhashë mendimin që kuadrot që shkurtohen nga aparatet e qendrës të kalojnë në rrethe.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 327.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 329.

E SHTUNE
19 DHJETOR 1964

U takova dhe pata një bisedë me sekretarin e përgjithshëm të Partisë Komuniste Peruane, Saturnino Paredes Macedo. Hëngrëm drekë me të.

E HËNE
21 DHJETOR 1964

Sot mbasdite u hap sesioni i 6-të i legjislaturës së 5-të të Kuvendit Popullor. Në rend të ditës kishim:

- 1) Projektligjin mbi buxhetin e shtetit për vitin 1965.
- 2) Projektligjin mbi krijimin e Ministrisë së Ekonomisë Komunale dhe çështje të tjera.

Kishim për drekë shokët Veiz dhe Sami Gjebero.

Prita shokët e delegacionit të PK të Zelandës së Re¹. Biseduam me ta për çështje të komunizmit ndërkombëtar.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 335.

E MARTË
22 DHJETOR 1964

Vazhdon punimet Kuvendi Popullor me diskutime. Buxheti u aprovua njëzëri, u aprovua gjithashtu krijimi i Ministrisë së Ekonomisë Komunale dhe ministër u caktua shoku Pjetër Kosta.

Kishim për drekë shokët Sulë Baholli dhe Bilal Parruca.

Në mbrëmje kishim për darkë shokët Pirro Kondi, Peti Shamblli dhe Myftar Grabocka.

E MËRKURË
23 DHJETOR 1964*

Taktika e udhëheqjes së re revizioniste sovjetike është, aktualisht, taktikë veprimi e heshtur, pa bujë e pa fjalime bombastike, «spektakulare». E kundërta e veprimeve të bujshme të Hrushovit. Dëshirojnë të fitojnë prestigjin e humbur nga veprimet «amerikandashëse» të Hrushovit dhe me këtë gjë të japin përshtypjen e dyfishtë që asgjë s'kanë ndërruar, por edhe veprojnë si «njerëz të pjekur» dhe jo si sharlatanë.

Në arenën ndërkombëtare, natyrisht, ata kanë pësuar fiasko.

Në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, taktika e tyre ka shumë synime. Në radhë të parë të rivendosin besimin e humbur ose të tronditur në gjirin e miqve të tyre revizionistë. Ata i sigurojnë miqtë se asgjë s'ka ndryshuar në vijën e tyre politike dhe ideologjike, por çështja qëndron në atë që revizionistët sovjetikë duhet të kërkojnë dhe të gjejnë rrugën mesatare demagogjike të një propagande as të bujshme, shkatërruese si të Hrushovit, as edhe krejtësisht të zbehtë, pse në të dyja rastet është një humbje për ta, por njëkohësisht edhe për revizionistët e tjerë, të cilët duan dhe

kërkojnë një mbështetje propagandistike nga revizionistët sovjetikë. Ata, natyrisht, nuk mund të jenë plotësisht dakord me atë që revizionistët sovjetikë të mos flasin fare për të mirë për Hrushovin, pse ky për ta ka qenë ideologu që i udhëhoqi për një dekadë. Kurse sovjetikët janë të detyruar, veçanërisht për opinionin e brendshëm, të mos flasin për Hrushovin, të flasin disi në «mënyrë kritike», por indirekt dhe të mos ekspozohen më në arenën politike dhe ideologjike në mënyrë e bujshme të Hrushovit.

Këto momente dhe koniunktura janë një *handicap*¹ i madh për udhëheqjen e re revizioniste sovjetike, pse ajo është akoma larg derisa të krijojë atë autoritet të duhur mbi aleatët e vet revizionistë, të cilët po forcojnë «independencën» dhe arrogancën e tyre. «Shkopi i dirigjentit», me qenien e Hrushovit në krye, u thye dhe vazhdon e do të vazhdojë të mos ngjitet. Ky është një minus i madh për ta dhe një plus për ne. Ata do të luftojnë kundër nesh, por jo në mënyrë të organizuar dhe monolite si më parë.

Vazhdon dhe do të vazhdojë për një kohë, sipas mendimit tim, të mos manifestohet personaliteti i gjithë udhëheqjes sovjetike, ose i disa udhëheqësve kryesorë, për arsye se ata krijuan përpara partisë së tyre dhe opinionit të tyre të brendshëm një situatë të ndërlikuar në lidhje me «personalitetet» e udhëheqjes. Qëndrimi i tyre antimarksist ndaj Stalinit, duke ngritur çështjen e të ashtuquajturit kult të individit, nuk shërben më për të maskuar komplotin e tyre kundër principeve të

marksizëm-leninizmit. I gjithë blofi u demaskua me rrëzimin e Hrushovit, i cili gjoja u hoq dhe dënohet për «kult të individit». Pra ai, që e dënoi «kultin e individit» të Stalinit, ngriti kultin e tij dhe ata, që në mënyrë të fshehtë punonin në kohën e Stalinit, për ta fryrë kultin e Stalinit, për ta dënuar atë, për të deklaruar se «ky kult u kapërcye», lanë më në fund të zhvillohej kult i Hrushovit. Tani ata s'i beson njeri, jo vetëm s'i beson por hapi më i parë që ata do të bëjnë për të vënë më në dukje personalitetin e një ose dy udhëheqësve, do t'i gjejë përpara kritikave se po ngrihet «kulti i individit» të një udhëheqësi të ri. Një koniunkturë e tillë është një *handicap* tjetër për udhëheqjen e re revizioniste sovjetike, pse jo vetëm ajo përbëhet prej njerëzish të diskredituar e pa personalitet, por edhe po të duan dhe do të tentojnë ta pompojnë, ky personalitet do të jetë një *homme de paille*¹ siç thotë francezi. Në këto situata të vështira për ta, revizionistët sovjetikë vijnë rrotull dhe për typen me parullat e «udhëheqjes kolektive», e të vendimeve «kolegjiale». Por kjo s'është do të qëndrojë për shumë kohë në këmbë, veçse «do të riparohet» me zor dhe në mënyrë të çalë e të vajtueshme. Në udhëheqjen e re revizioniste sovjetike do të shquhet një kalë dhe kjo është një humbje për ata dhe një fitore për ne. Ne shohim se fjalimet e udhëheqjes aktuale sovjetike, duke notuar në këto situata të vështira, janë të pakta, të zbehta, të përgjithshme, të tronditshme. Ata përpiqen të evitojnë fërkime të hapëta me ne, pse nga një goditje me ne, ata do të detyrohen të vijnë

1. Anglisht — pengesë.

1. Frëngjisht — njeri pa vlerë, vegël e një tjetri.

në pozitë e para. Atëherë «ku ishe? — asgjëkundi». Me taktikën e tyre revizionistët sovjetikë përpiqen që ta evitojnë këtë, kurse ne duhet t'ua shkatërrojmë këtë taktikë.

Përballë polemikës, qëndrimet e revizionistëve sovjetikë nuk para u pëlqejnë revizionistëve të tjerë, të cilët, sigurisht u bëjnë presion sovjetikëve, të forcojnë dozën në afirmimin e mbrojtjes së tezave tradhtarë hrushoviane, gjë që i çon të largohen nga goditja me ne. Këtë e tregon artikulli i botuar kohët e fundit në «Pravda»¹.

Revizionistët sovjetikë duhet të jenë në ujdi të plotë me imperialistët amerikanë për shumë çështje. Lidhjet e Hrushovit jo vetëm që u ruajtën, por po forcohen nëpërmjet një bashkëpunimi më pak të bujshëm, por më efikas. Bashkimi Sovjetik vazhdon të bëjë lëshime (siç janë kuotat për OKB-në) dhe imperialistët amerikanë të përfitojnë dhe të tregohen të qetë ndaj politikës së revizionistëve sovjetikë, pse ajo ecën kurdoherë në favorin e tyre.

Imperializmi po futet më thellë në vendet e ish-demokracisë popullore në Evropë dhe në Bashkimin Sovjetik. Ai në këto vende po fiton pozita ekonomike, politike dhe ideologjike.

Hrushovianët, herë pas here, në mënyrë demagogjike po flasin për Azinë, Afrikën, Amerikën Latine. Ata do të vënë forca dhe do të kujdesen për të ndihmuar imperializmin amerikan në ato zona ku ai ndodhet në vështirësi dhe në përleshje.

Ne shohim që revizionistët me bujë po ndihmojnë partinë revizioniste të Danges në Indi. Ata do të punojnë gjerësisht me reaksionin indian. Revizionistët sovjetikë do të ndihmojnë fuqimisht revizionistët japonezë dhe të tjerë, për të fituar pozitë e humbura dhe për t'u krijuar telashe ideologjike, politike dhe ekonomike vendeve socialiste të atij pellgu, si dhe partive marksiste-leniniste të Lindjes së Largme.

Nuk duhet në asnjë mënyrë të nënvleftësohen këto rreziqe. Ne duhet të demaskojmë fuqimisht veprimet armiqësore të revizionistëve modernë, t'i parashikojmë dhe t'i demaskojmë planet e tyre, të kemi edhe ne planet, taktikat tona dhe këto taktika jo vetëm të jenë të drejta, por të jenë të gjalla, revolucionare, të efektshme, të shumanshme dhe në shumë drejtime të koordinuara.

Plogështia, mykja, janë armiqtë tanë, prandaj t'i luftojmë ato që të mos kenë vend as në politikë, as në polemikë.

1. «Pravda», 6 dhjetor 1964: «Shteti i gjithë popullit».

Kohë shumë e keqe me shi dhe furtunë, por pa dëme, si në vendet e tjera të huaja.

Shokët iranianë (11 veta), që një javë më parë kishin ardhur këtu për të diskutuar mbi probleme që i preokupojnë, mbaruan punë dhe u nisën me avionin e sotëm për në vendet e veta të punës. Sipas bisedës së shkurtër që bënë me Ramizin, ata në përgjithësi kanë dalë të kënaqur, kanë qenë dakord për problemet që u diskutuan. Ata duan të forcojnë akoma më shumë pozitën në parti në emigracion. Pas 6-7 muajve parashikojnë të bëjnë një mbledhje tjetër të gjerë (me afro 40 veta) dhe atëherë do të flasin hapur dhe do të publikojnë dokumente. Ishin entuziastë nga pritja dhe trajtimi ynë. Ne nuk kërkuam asndonjë gjë nga puna e tyre, ata ç'dëshën bënë dhe sa deshën informuan. Kështu që me këtë sjellje shohin qëndrimin tonë internacionalist.

E MARTË
29 DHJETOR 1964

Në mbërmenjën e Vitit të Ri që u organizua në aparatet e Komitetit Qendror, vajtëm bashkë me Nexhmijen. Kaluam çaste të gëzuara me shokët.

E ENJTE
31 DHJETOR 1964

Mbrëmja e Vitit të Ri në Shtëpinë e Partisë.
Gëzuar Viti i Ri, me shumë të mira e gëzime për popullin dhe për Partinë tonë heroike!

Po formuloj disa teza për probleme që mendoj t'i trajtoj në fjalime dhe diskutime në mbledhje të ndryshme gjatë vitit 1965.

1) Problemi i edukatës në shkolla

- Ana pedagogjike;
- Edukata morale;
- Sjellja dhe edukimi i mësuesve;
- Ndikimi i punës së organizatës së rinisë dhe asaj të pionierit.

2) Problemet shoqërore të të rinjve dhe të rejave.

- Çfarë problemesh ka dhe si shfaqen në përgjithësi;
- Qëndrimi i të rinjve dhe i organizatës së tyre përpara këtyre problemeve;
- Masat që duhen marrë nga ana edukative dhe materiale.

3) Edukimi marksist-leninist i shkrimtarëve dhe i artistëve.

- Përbërja shoqërore e tyre në përgjithësi;

— Përbërja shoqërore e anëtarëve të Partisë në radhët e shkrimtarëve dhe artistëve dhe metodat e format edukative që përdoren;

— Shfaqjet e huaja, prejardhja, mënyrat e shfaqjes dhe lufta kundër tyre;

— Si ecën përtëritja e radhëve të shkrimtarëve dhe artistëve;

— Lidhjet e tyre me masat, me jetën, me punën krijuese;

— Puna ideopolitike me ta, format e tematika për edukimin e tyre komunist;

Ndihma që duhet t'u japim për forcimin e punës ideopolitike dhe edukimin moral të tyre.

4) Trajtimi i zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të jetës sonë socialiste nga:

- Prozatorët dhe poetët;
 - dramaturgët e komediografët;
 - kompozitorët, solistët dhe instrumentistët;
 - piktorët dhe skulptorët.
- I. — Brendia, idetë, realizimi, anët e mira dhe të këqija, realiteti dhe teprimet.
- II. — Profesionalizmi dhe diletantizmi.
- III. — Forma e paraqitjes, anët e mira dhe të këqija.
- IV. — Ndikimi, kopjimi, shabllonizmi, ndikimet e huaja, pozitive dhe negative.
- V. — Edukimi profesional, kritika dhe masat që duhet të marrim për përmirësimin e punës, që kjo të marrë një hov të ri.

5) **Problemet shoqërore në familje dhe forcimi i familjes me moralin proletar.**

Zhvillimi i familjes në vendin tonë dhe i marrëdhënieve shoqërore.

a) Anët pozitive dhe ato negative të saj të trashëguara nga e kaluara. Shfaqjet kryesore pozitive dhe negative. Prejardhja e tyre dhe shkaqet e zhvillimit.

b) Ndryshimet në botëkuptimin mbi marrëdhëniet shoqërore ndërmjet pjesëtarëve të familjes. Evolucioni i arritur dhe deri në ç'shkallë, në gjerësi dhe në thellësi, janë vënë në rrugë të drejtë këto marrëdhënie.

c) Në ç'gjendje, në ç'stad zhvillimi ndodhet aktualisht zhvillimi i familjes sonë në shtresat e ndryshme: punëtore, fshatare, intelektuale dhe ndikimi i një-rës shtresë mbi tjetrën në botëkuptimin e drejtë dhe të gabuar të marrëdhënieve në familje.

d) Zhvillimi i marrëdhënieve pleq e të rinj, burra e gra, të rinj e të reja, në të gjitha shfaqjet e jetës.

Ndikimet e fesë në jetën familjare dhe në marrëdhëniet midis pjesëtarëve të saj.

Ndikimi i arsimit dhe i kulturës sidomos te të rinjtë dhe të rejat në familje, në mënyrën e jetesës, në sjelljet, në gjykimet e problemeve të familjes.

e) Cilat janë ato zakone prapanike që na zënë këmbët dhe si t'u bëjmë një luftë ideologjike, politike, edukative dhe pedagogjike për t'i zhdukur ato.

ë) Çfarë duhet të bëjmë për t'i dhënë një hov të ri edukimit masiv të popullit në forcimin e familjes sonë me moralin e shëndoshë komunist.

6) **Qëndrimi komunist i të rinjve dhe i të rejave në jetë dhe marrëdhëniet në mes tyre.**

I. — Roli edukativ i prindërve në dhënien e një orientimi të drejtë fëmijëve të tyre për luftën në jetë. Prindërit duhet t'i kuptojnë ndryshimet shoqërore, të kuptojnë thellë thelbin e këtyre ndryshimeve dhe të udhëhiqen e të zbatojnë në mënyrë revolucionare parimet kryesore që kanë shkaktuar këto ndryshime.

II. — Roli i organizatës së rinisë për edukimin me moralin e lartë proletar dhe përgatitjen shpirtërore të rinisë për të luftuar në jetë, për të mbajtur kurdoherë dhe ndaj çdo gjëje qëndrim parimor.

Sa e luan organizata e rinisë këtë rol? Anët e mira dhe plogështia, rutina dhe mungesa e guximit në ngritjen dhe në shtruarjen drejt të këtyre problemeve.

III. — Qëndrimet e të rinjve ndaj disa problemeve kyç të tyre, që do t'u dalin meçomos përpara, pavarësisht nga format e shfaqjes.

a) Qëndrimet ndaj prindërve, ndaj këshillave e sjelljeve të tyre dhe roli edukativ që duhet të luajnë të rinjtë brenda formave të drejta edukative, pedagogjike e morale.

b) Qëndrimet në marrëdhëniet ndaj motrave dhe vëllezërve. Harmonia revolucionare.

c) Qëndrimi në mes shokëve: vajza dhe djem; kuptimi i drejtë i një shoqërimi të tillë, barazia, ndershmëria, morali i lartë proletar, dashuria e pastër për shokun, normat proletare të kësaj shoqërie në çdo situatë, në çdo rrethanë.

d) Qëndrimi serioz ndaj dashurisë dhe martesës, që është përfundimi logjik i ndjenjës së pastër të da-

shurisë dhe që ka një rëndësi të dorës së parë në jetë. Si duhet ta kuptojë rinia këtë, si duhet ta zhvillojë në rrugë të pastër, në liri, por edhe me seriozitetin më të madh.

e) Qëndrimi serioz ndaj mësimit, ndaj punës, ndaj pronës socialiste dhe ndaj të gjitha kërkesave të moralit proletar.

ë) Besnikëria dhe dashuria e madhe për atdheun dhe për Partinë, për veprën madhështore të Partisë, një nga të cilat është edukimi i rinisë me moralin proletar, armatosja e brezit të ri për të përballuar me sukses e me nder çdo situatë shpirtërore dhe materiale, objektive dhe subjektive.

Si këto ka edhe shumë probleme të tjera. Rëndësi ka që jo vetëm udhëheqja në qendër, por edhe kuadrot drejtues në bazë të thellohen më shumë në problemet që do të trajtojnë, t'u venë në fund gjërave dhe të përgjithësojnë në mënyrë shkencore eksperiencën e madhe të Partisë, konsekuencat e zbatimit të vijës së saj në praktikë për çdo problem që shtrohet dhe që kërkon zgjidhje.

Kjo në përgjithësi bëhet, po jo sa duhet dhe sidomos për problemet shoqërore që preokupojnë dhe do të preokupojnë vazhdimisht Partinë. Qëndrohet shumë në studime të cekëta e shabllone, në formula disa herë joreale, që u ka ikur koha; jeta ka ecur përpara kurse ka drejtues që nuk ecin tok me këto ndryshime ose u vënë rëndësi disa shfaqjeve duke neglizhuar disa të tjera. Ka probleme shoqërore të rëndësishme të cilat ata duhet t'i trajtojnë drejt, t'u zbulojnë anët e mira dhe të këqija dhe t'ia shtrojnë Partisë që kjo t'i kuptojë

si duhet në thellësinë dhe në gjerësinë e tyre. Harrohet nga disa drejtues që kanë mbetur pas, se masa e Partisë dhe populli kanë ecur përpara, se raportet shoqërore, mendore dhe intelektuale kanë ndryshuar, se janë krijuar raporte të reja, shije të reja, të cilat ndikojnë në gjithë zhvillimin e jetës në shoqërinë tonë.

Ky ndryshim raportesh nuk është bërë në mënyrë spontane, përkundrazi ai është rezultat i punës së madhe sistematike, të studiuar, të harmonishme të Partisë. Këto ndryshime janë të drejta në vijë dhe pozitive, por sidogoftë konkretizimi i tyre lyp një përpunim më serioz, më shkencor, që Partia, nëpërmjet problemeve të ndryshme që trajton, të armatohet edhe më mirë për konsolidimin e fitoreve dhe për të ecur më tej.

Partia duhet të njohë vazhdimisht terrenin ku do të hedhë farën e re, për të cilën ajo do të kujdeset dhe do të përqendrojë të gjitha forcat për një sukses efektiv, real.

Partia duhet ta njohë mirë terrenin dhe sidomos përbërjen, që të dijë ku t'i mbështetë mirë të dyja këmbët. Prandaj, është e domosdoshme që edhe ne shokët e udhëheqjes të shkundemi nga një punë e përsëritur e pa shumë frytë, se kështu do të shkundim edhe shokët e bazës që të punojnë me një hov më të gjallë, më të ri, më me perspektivë.

Të punojmë që Partia të edukohet dhe të nxjerrë mësim nga eksperiencia e mirë si dhe nga gabimet e anëtarëve të saj e të punonjësve. Por nuk është vetëm kjo anë, kjo formë e edukatës së saj dhe e komunistëve në veçanti. Më duket se disa kuadro drejtues në Partinë tonë e shohin këtë çështje ngushtë, në mënyrë

sektare, që kthehet në një formë burokratike e administrative të punës edukuese nga ana e Partisë. Mund të ruhen e të praktikohen format edukuese të Partisë ndaj një komunisti që ka bërë faj dhe kritikën ndaj atyre që bëjnë gabime të mbeten disa herë burokratike, të pathelluara dhe pa shumë efekt. Kjo ndodh se qëndrohet në fajin e dukshëm, kërkohet të zgjidhet vetëm ky, kurse fajet e tjera që nxiten nga botëkuptimet e vjetra, por që akoma s'kanë gjetur rastin dhe vendin të shfaqen me tërë forcën e tyre, mbeten pa kritikuar.

Kritika e drejtë për gabimin e një komunisti s'ka dyshim që do të bëjë efektin e vet edhe për ndreqjen e të metave të tjera të tij, që s'janë shfaqur akoma. Por në jetën e Partisë ka një mori rastesh, deri edhe tek ai komunisti i mirë, besnik e punëtor shembullor, që të ketë disa pikëpamje jo të drejta për çështje, të cilat për një periudhë, qoftë edhe relativisht të gjatë, të mos shfaqen, të mos bëhen pengesë. Jeta e Partisë do t'ia sqarojë. Pikërisht këtu e kam fjalën. Po si do t'ia sqarojë? Për këto mbeturina latente ai nuk mund të thirret e të kritikohet në komitet ose në byronë e organizatës-bazë. Edukimi i tij bëhet në organizatën-bazë, e cila do ta ndihmojë atë që të zhdukë shumë nga këto mbeturina.

Prandaj vij në çështjen që më shqetëson. T'i japim një gjallëri të re edukatës masive të komunistëve, duke ngritur probleme të thella shoqërore, të përgatitura mirë, në mënyrë shkencore dhe të ilustruara me shembuj të mirë dhe negativë nga jeta, nga qëndrimet individuale etj. Këto probleme rrahin të gjitha anët e çështjeve nga ana teorike dhe këtu gjen ushqimin e

shërimin jo vetëm ai që bën faje e gabime, por edhe ai që s'bën, por që ka dobësi në punë, në jetë, në mendime dhe ka nevojë, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, për një ndihmë konkrete morale, teorike, pedagogjike.

Një edukim i tillë i dyanshëm i komunistëve, i studiuar mirë në bazë të zhvillimit konkret të shoqërisë sonë në përgjithësi dhe në çdo rreth në veçanti, e armatos mirë Partinë për punën e saj të madhe edukative që duhet të bëjë në masat e gjera të popullit. Kështu çdo komunist do ta njohë mirë terrenin, brumin dhe farën e mirë që ka përgatitur për ta mbjellë, do të dijë ku ta mbjellë e si ta mbjellë, shërbimet që duhet t'i bëjë dhe rreziqet që duhet t'i evitohet, me qëllim që fara të japë një bimë të shëndetshme.

Prandaj duhet t'i vëmë rëndësi shumë të madhe punës sonë vitin e ardhshëm sidomos, edhe në këto drejtime kyç të punës së Partisë.

[1964]

Hrushovizmi — falsifikim i komunizmit, në përngjashmëri me modelet e pseudomarksistëve evropianë dhe me socialdemokracinë evropiane.

1) Falsifikimi i parimeve leniniste mbi partinë (parimet bazë organizative dhe ideologjike marksiste-leniniste, të ballafaquara teorikisht me deformimet e pseudomarksistëve evropianë mbi konceptet e organizimit të partisë, me deformimet trockiste, menshevikë, hrushoviane: partia e ndarë më dysh, bujqësi dhe industri, «partia e gjithë popullit» etj.).

2) Teoria e shtetit nga pikëpamja marksiste-leniniste e krahasuar me teorinë e pushtetit nga pikëpamja e antimarksistëve evropianë socialdemokratë, trockistëve e anarkistëve.

a) Marrja e pushtetit. Ballafaqimi me teoritë oportunisto-revizioniste. Deformimi hrushovian i problemit, «epërsia» e rrugës parlamentare e paqësore.

b) Parlamentarizmi nga pikëpamja marksiste-leniniste në ballafaqim me teoritë pseudomarksiste dhe hrushoviane.

1. Këto dorëshkrime që nuk kanë datë, janë ruajtur nga autori së bashku me Ditarin.

c) Diktatura e proletariatit. Teoria marksiste-leniniste për këtë problem, si dhe ajo reformiste, socialdemokrate e hrushoviane. «Shteti i të gjithë popullit», zhdukja e tij dhe e diktaturës së proletariatit. (Tezat marksiste-leniniste dhe hrushoviane.)

3) Lufta e klasave dhe zhdukja e saj (teoria marksiste-leniniste, ajo oportuniste dhe hrushoviane).

4) Ndërtimi i socializmit.

Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë nën drejtimin e klasës punëtore. Zhvillimi i industrisë dhe kolektivizimi. Ekonomia e planifikuar. (Teoria marksiste-leniniste, deformimet oportuniste, trockiste, titiste, hrushoviane.)

5) Internacionalizmi proletar.

Bashkëpunimi në mes vendeve socialiste (deformimi hrushovian).

Uniteti ideologjik e politik i klasës punëtore botërore. Lufta përçarëse hrushoviane.

6) Lufta dhe paqja (pikëpamjet leniniste dhe deformimet hrushoviane).

7) Kampi i socializmit dhe kampi i imperializmit.

8) Si e shikojnë marksistët imperializmin amerikan dhe si e shikon Hrushovi.

9) Lufta nacionalçlirimtare, si e shikojnë marksistët dhe si e shikon Hrushovi.

10) Bashkekzistenca leniniste dhe bashkekzistenca hrushoviane.

Lenini thoshte se revolucionarët është zor t'i nënshtrorsh me kërbac, por ata nganjëherë mund t'i bësh me vete me përkëdhelje. Këtë bëjnë imperialistët me tradhtarët hrushovianë.

Studimi i artit ushtarak — faktor i rëndësishëm.
Pushtet mikroborgjez do të thotë pushtet proimperialist.

Pra, partitë komuniste e punëtore në vendet kapitaliste duhet të luftojnë për vendosjen e një pushteti antiimperialist të drejtuar nga proletarët, ose njëherësh të vendosin diktaturën e proletariatit dhe kurrë s'duhet të bëjnë siç mendojnë dhe veprojnë aktualisht revizionistët modernë.

Lëvizja çlirimtare antiimperialiste është pjesë e revolucionit proletar botëror.

Krijimi i komiteteve fshatare, i komiteteve të zgjedhura, të cilat të jenë të afta të formulojnë kërkesat kryesore të fshatarësisë dhe të marrin masa për realizimin e këtyre kërkesave në mënyrë revolucionare. Boshfi i revolucionit në fshat. Formulimi i kërkesave jetike të fshatarësisë.

Revizionistët modernë në Evropë ruajnë centralizmin «demokratik» në parti, por partia dominohet nga revizionistët dhe oportunistët. Prandaj detyra e marksistëve është të ruajnë dhe të forcojnë kurdoherë centralizmin demokratik, ta përdorin atë për të hequr qafe sundimin e revizionistëve dhe të oportunistëve, për t'i likuiduar këta nga radhët e partisë.

Revizionizmi dhe socialshovinizmi kanë po të njëjtat qëllime dhe bazë politike: bashkëpunimin e klasave, mohimin e diktaturës së proletariatit, kundërshtimin e

aksioneve revolucionare, vënien në shërbim të borgjezisë për triumfin e qëllimeve të saj hegjemoniste dhe shfrytëzuese.

Oportunizmi, — thotë Lenini, — është politika punëtore e borgjezisë, politika e kësaj me një grusht të aristokracisë punëtore. Oportunizmi ka karakter jo vetëm thjesht «të brendshëm partie», por përfaqëson influencën e borgjezisë mbi proletariatin nëpërmjet një grushti njerëzish afër proletariatit.

[Faint, illegible text at the top of the left page]

[Faint, illegible text in the middle of the left page]

[Faint, illegible text in the lower middle of the left page]

[Faint, illegible text in the lower part of the left page]

[Faint, illegible text at the bottom of the left page]

TREKESIT

[Faint, illegible text above the title 'TREGUESIT']

TREGUESIT

[Faint, illegible text in the middle of the right page]

[Faint, illegible text in the lower middle of the right page]

[Faint, illegible text at the bottom of the right page]

TREGUESI I LËNDES

A

Aftësia prodhuese, shfrytëzimi i saj; ruajtja dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës — 336-337.

Ambasadat e RP të Kinës në shtete të ndryshme të botës — 225, 226, 288, 354-355.

Ambasadat e RP të Shqipërisë në shtete të ndryshme të botës — 54, 205, 346, 358, 373, 394.

Ambasadat e shteteve të ndryshme në Bashkimin Sovjetik dhe në RP të Kinës — 217, 225, 226, 280, 305-306, 310, 332, 387.

Ambasadat e shteteve të ndryshme në RP të Shqipërisë — 13, 160, 250, 262, 271, 277, 376, 377.

Arkivat, dokumentet arkivore — 264-266.

Armatimi, çarmatimi; demagogjia e fuqive të mëdha për

çarmatimin — 141, 143, 144, 148.

Armiqtë, veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre — 174-175, 305.

Arsimi në RPSH — sistemi arsimor; zhvillimi dhe masivizimi i tij; arsimi i mesëm — 184-185;

— metodat e mësimdhënies; mësuesit, pedagogët dhe studentët — 268, 299-300, 442.

Arti Ushtarak i Luftës Popullore — studimi dhe përvetësimi i tij — 192-193, 208, 418, 452.

Artizanati, shërbimet artizanale — 426-427.

B

Bashkimi Sovjetik (1917—1953), Partia Komuniste (bolshevikë) e Bashkimit Sovjetik — 147-148, 280, 300.

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik; Partia Komuniste (revizioniste) e BS — 34-35, 148, 401;

— gjendja e brendshme; degjenerimi i partisë, i pushtetit dhe i ekonomisë, likuidimi i diktaturës së proletariatit — 75, 76, 149, 207, 257, 258-259, 279-280;

— rrëzimi i Hrushovit, vija e PK të BS pas rrëzimit të Hrushovit — vazhdim i politikës së tij — 296, 298, 300, 305, 312, 317, 323-329, 355-356, 359, 362, 371, 395, 433-436;

— strategjia dhe taktikat; lufta e tij kundër socializmit, revolucionit dhe luftërave nacionalçlirimtare; lufta kundër Stalinit — 148-151, 244-246, 256, 257, 258-259, 278-281, 282, 293-295, 300, 389-390, 434-436;

— politika demagogjike; aleanca e bashkëpunimi me ShBA dhe kapitullimi para tyre; bashkëpunimi me kapitalizmin botëror dhe reaksionin; përkrahja për reaksionin grek — 55-56, 141, 143-144, 149, 167, 200, 246, 257, 279, 293-294, 328-329, 436;

— marrëdhëniet dhe kontradiktat me revizionistët e tjerë modernë; përpjekjet për hegjemoni mbledhjet e partisë dhe vendet e tjera revizioniste. Qëndrimi dhe propozimet e revizionistëve sovjetikë për mbledhjet e partive revizioniste — 19-20, 36-37, 76-77, 124, 125, 126-127, 241-242, 253, 254, 255, 256, 257-258, 325-326, 433-434, 437;

— Kongresi i 20-të, i 21-të, i 22-të dhe plenumet e KQ të PK të BS — 75, 278, 281, 325, 327, 395;

— roli sabotues i revizionistëve sovjetikë në lëvizjen komuniste punëtore e marksiste-leniniste, ndaj mbledhjeve dhe polemikës në lëvizjen komuniste si dhe qëndrimi ndaj partive të vërteta marksiste-leniniste — 75-76, 244-246, 384, 394-396, 434, 435, 436, 437;

— qëndrimi armiqësor kundër PPSH dhe RPSH — 55-56, 75, 76, 124, 281, 297, 307, 335, 398;

— qëndrimi ndaj Kinës dhe PK të Kinës — 19-20, 75, 76, 80, 102, 106, 124, 157, 257, 258, 327-328, 362, 371-

-372, 373, 376, 385;

— qëndrimi ndaj Kubës, Koresë dhe Vietnamit — 24-26, 371;

— tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit; shtrembërimi i teorisë m-l për partinë, për diktaturën e proletariatit, për luftën e klasave, për socializmin etj. — 29-30, 450-451.

Blegtoria — politika e Partisë për kolektivizimin e bagëtive; ngritja e kolektivave blegtoralë. *Specialistët e blegtorisë* — 191, 366-368.

Borgjezia në vendet kapitaliste — 28, 39, 40, 41, 257.

Bujqësia — ngritja në nivelin e bujqësisë së zhvilluar socialiste dhe rëndësia e saj; punët e stinës në bujqësi; dritërat, buka dhe ekonomizimi i saj. *Pemëtaria, ulliri dhe vreshtat* — 16-17, 63, 70, 118, 190, 198, 335-336, 337.

Bullgaria, revizionistët bullgarë; qëndrimi armiqësor ndaj Shqipërisë — 56-58.

Burokratizmi; lufta kundër shfaqjeve burokratike dhe thjeshtimi i aparateve shtetërore — 143, 429.

Buxheti i shtetit; shpenzimet, shkurtimi i tyre — 199, 416.

Dekorimet, kriteret e dekorimit — 129, 276.

Dëshmorët, heronjtë — 33, 171, 172-173.

E

Edukimi komunist — edukimi ideopolitik, moral dhe patriotik; bindja — metodë kryesore në fushën e edukimit — 111, 192, 201, 366, 367-368, 408-410, 425, 442-443, 444-446.

Engels, Fridrih — 35, 329, 344.

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 3-4, 6, 9, 18, 22, 23, 24, 31, 32, 33, 34, 46, 47, 48, 50, 51, 52, 53, 59, 61, 73, 85, 97, 99, 99, 100, 101, 108, 109, 140, 159, 163, 170, 171, 172-173, 174, 175-176, 177, 180, 181, 189, 190, 191, 192-193, 195, 205, 210-211, 215, 216, 219, 220, 228, 229, 230, 233-235, 240, 268-269, 276, 277, 296, 301, 302, 303, 316, 330, 352-353, 363, 380-381, 382, 391, 407, 412, 427, 428, 431, 432, 440.

F

Faktori i brendshëm dhe i jashtëm, mbështetja në forcat e veta — 334-336.

Familja, forcimi i saj; divorci — 408, 409, 410, 444, 445.
Feja — lufta kundër paragjy-
kimeve fetare — 71.
Fëmijët, kujdesi i Partisë për
mirërritjen e tyre — 410.
Financat — kontrolli financiar
— 404-405, 416.
Forcat prodhuese — 334-337.
Franca; marrëdhëniet e saj
me Kinën. Marrëdhëniet dhe
kontradiktat me ShBA — 27-
-29, 30, 45, 49;
— marrëdhëniet dhe qënd-
rimi i saj ndaj Shqipëri-
së — 211, 394.
**Fronti Demokratik i Shqipë-
risë** — 117.
Fshatarësia kooperativiste —
virtutet e saj moralopolitike;
politika e Partisë për fshata-
rësinë; edukimi ideopolitik
dhe ngritja e nivelit të saj
kulturor — 63, 192, 366-367.
Fshati socialist — përmirësi-
mi i vazhdueshëm i gjendjes
ekonomike e social-kulturore
të tij — 168, 192.
Fuqia punëtore — trajtimi i
saj, sistemimi dhe përdorimi
i fuqisë punëtore; lëvizja e
fuqisë punëtore qytet-fshat
— 16, 64, 70.

G

Gruaja, Bashkimi i Grave të
Shqipërisë — emancipimi dhe

roli i saj në ndërtimin e so-
cializmit; krijimi i kushteve
lehtësuese për gruan — 99,
100, 286, 318, 408, 412-413.
Grumbullimet; ndërmarrjet e
grumbullimit dhe punonjësit
e tyre — 426.

GJ

**Gjermania, pazarllëqet e su-
perfuqive për çështjen gjër-
mane** — 144.

H

Historia e Luftës Antifashiste
Nacionalçlirimtare — përvje-
torët e brigadave sulmuese të
Ushtrisë Nacionalçlirimtare
Shqiptare. Kujtimet mbi Luf-
tën Nacionalçlirimtare — 33,
171, 233-235.

Historia e Shqipërisë; teksti i
**historisë së Shqipërisë; objek-
tiviteti shkencor; prejardhja e**
popullit shqiptar, pellazgët —
65, 283, 292.

I

Imperializmi — strategjia dhe
taktikat; politika e tij e luf-
tës dhe e agresionit; kontra-
diktat; lufta e popujve të bo-
tës kundër imperializmit —

13, 27-29, 49, 103, 144-145,
147, 148, 149, 289, 342-343,
436.

Industria e rëndë, zhvillimi i
saj — 54, 55, 100, 136, 169,
190, 337.

Interesi i përgjithshëm dhe ai
vetiak — 178.

Internacionalizmi proletar —
342, 451.

Investimet, përdorimi i tyre
me efektivitet — 335-336.

J

**Jetesa në shoqërinë tonë so-
cialiste** — 336.

**Jugosllavia, revizionizmi ju-
gosllav, Kongresi i 8-të i LKJ**
— 148, 241, 259, 421;

— vija e saj, politika dema-
gogjike; tradhtia e tyre
ndaj marksizëm-leniniziz-
mit; roli sabotues në luf-
tërat nacionalçlirimtare
e revolucionare të popuj-
ve — 34-35, 36, 237, 423;

— gjendja e brendshme,
kriza, zhvillimi i kapita-
lizmit; vetadministrimi
jugosllav. Qëndrimi ndaj
pakicave kombëtare, qën-
drimi armiqësor ndaj
popullsisë shqiptare që
jeton në trojet e veta në
Jugosllavi — 57, 274, 421-
-423;

— agjenturë e imperializ-

mit; lidhjet me imperia-
lizmin amerikan — 120-
-121, 422-423;

— lidhjet me revizionistët
italianë; përkrahja për
reaksionin grek — 20, 21,
56;

— qëndrimi armiqësor ndaj
PPSh dhe RPSH — 19,
56;

— qëndrimi ndaj Kinës dhe
PKK — 18-19, 411.

K

Kapitalizmi — kriza, pashma-
ngësia e zhdukjes së tij — 150-
-151.

Këshillat popullorë — komi-
tetet ekzekutive të këshillave
popullorë të rretheve; Këshi-
lli Popullor i qytetit të Tira-
nës — 139, 426, 429.

**Këshilli i Ministrave (Qeve-
ria), Kryesia e Këshillit të**
Ministrave — 168, 276, 369,
405, 413.

Kina, PK e Kinës — vija e saj
për ndërtimin e socializmit —
219, 221-222;

— politika e jashtme opor-
tuniste; pikëpamjet na-
cional-shoviniste — 226-
-227, 251-252, 285, 287-
-290, 360-361;

— strategjia dhe taktikat;
vija e saj oportuniste
dhe pragmatiste; qëndri-

- 260-261, 300, 338-339, 342, 349-350, 397, 398-399, 437;
- përkrahja për popujt që luftojnë për çlirimin e tyre — 342-343;
 - mbrojtja e marksizëm-leninizmit, qëndrimi ndaj Stalinit — 247, 249, 338, 341-342;
 - solidariteti dhe përkrahja e partive marksiste-leniniste për PPSH — 392-393, 394, 398, 401;
 - lëvizja komuniste marksiste-leniniste në Amerikën Latine — 59-60.
- Lufta Antifashiste Nacional-çlirimtare e popullit shqiptar**
- 171, 173, 303;
 - lufta kundër ndërhyrjeve të imperialistëve anglo-amerikanë në punët e brendshme të luftës sonë. Misionet ushtarake të aleatëve. Shkatërrimi i pikëpamjeve dhe i veprimëve të tyre në dëm të luftës sonë — 174-175.
- Lufta dhe paqja — qëndrimi marksist-leninist ndaj tyre; rruga për arritjen e paqes** — 281-282;
- rreziku i luftës, shkaqet dhe shkaktarët e shpërthimit të luftërave. Pacifizmi borgjez — 144-145, 150, 281, 282.

Marksizëm-leninizmi — bu-sull dhe udhëheqje për veprim; studimi, përvetësimi dhe zbatimi i tij krijues — 35, 247, 299, 343, 344-345.

Marks, Karl — 35, 146, 151, 329, 344.

Mbrojtja e atdheut — forcimi i gatishmërisë luftarake të ushtrisë, të popullit dhe të mbarë vendit për mbrojtje; fortifikimi i vendit, punimet mbrojtëse — 13-14, 415-416, 417-419.

Metoda dhe stili në punë — 111, 166, 368-371, 405.

Ministritë

- Ministria e Punëve të Jashtme — 264-266, 369-370;
- Ministria e Mbrojtjes Popullore — 54, 415, 416;
- Komisioni i Planit të Shtetit — 405;
- Ministria e Financave — 405, 410;
- Ministria e Ndërtimit — 425;
- Ministria e Ekonomisë Komunale — 431, 432;
- Ministria e Arsimit dhe e Kulturës — 65.

Ndërtimet në RPSH — organizimi, drejtimi dhe kontrolli i punës në fushën e ndërtimeve; projektet, preventivat — 403-406, 425.

Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — 13-14, 222, 299, 392, 451.

Ndihmat ndërmjet shteteve, kuptimi marksist-leninist i tyre — 16-17, 221-222, 312, 334-335, 342-343.

Organet e drejtësisë — Gjykata e Lartë, gjykatat popullore, gjyqtarët. Prokurorët — 408-409.

Organet e Punëve të Brendshme — kuadrot, edukimi i tyre ideopolitik — 208.

Oportunizmi — 453.

Organizata-bazë e Partisë, sekretari i saj; detyrat e tyre — 187, 192, 413, 425-426.

Organizata e Kombeve të Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme e saj; pjesëmarrja dhe roli i RP të Shqipërisë në këtë organizatë — 29, 150, 200, 368-371, 436.

Partia e Punës e Shqipërisë — vija, vendimet, direktivat, ndërtimi dhe jeta e brendshme

- përvjetorët e themelimit të saj, vija e saj në ndërtimin e socializmit, vendimet, direktivat; njohja dhe zbatimi i tyre — 143, 222, 223, 314, 330, 363, 366-368, 392, 446;
- forcimi organizativ i Partisë, pranimet në Parti dhe masat ndëshkimore. Ndërrimi i dokumenteve të Partisë; tesera; uniteti në Parti — 13, 99, 128, 193, 202, 267, 315;
- puna e Partisë, metoda dhe stili në punë, qëndrimi ndaj të metave e gabimeve — 69, 70, 194, 267, 446-449;
- karakteristikat e Partisë, besnikëria e saj ndaj marksizëm-leninizmit, qëndrimi i saj internacionalist — 247-248, 249, 439;
- materialet, studimet, informacionet për organet udhëheqëse — 137, 418, 427, 429;
- edukimi në Parti, seminaret — 187, 189, 247, 447-449.

Partia e Punës e Shqipërisë
— *organet udhëheqëse qendrore dhe në rrethe*

- Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati i KQ — 54, 55, 63, 65, 71, 75, 87, 100, 111, 114, 136, 137, 143, 156, 168, 169, 187, 188, 198, 199, 263, 267, 268, 270, 276, 283, 299, 305, 314, 317, 334, 352, 363, 366, 377, 386, 417, 425, 429;
- Plenumi i 8-të i KQ (26—28 tetor 1962); Plenumi i 12-të i KQ (11—12 shkurt 1964); Plenumi i 13-të i KQ (7—9 korrik 1964) — 69, 70, 201, 202, 270;
- aparati i KQ dhe organizata-bazë e Partisë e aparatit të KQ — 133, 137, 251, 267;
- komitetet, byrotë e Partisë dhe aparatet e tyre në rrethe — 137, 156, 187, 267, 426, 427;
- komitetet e Partisë të rrethëve Dibër, Lezhë, Tropojë dhe Elbasan — 84, 168;
- Byroja e Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës — 189, 194;
- Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Korçës; Konferenca e Parti-

së e Rrethit — 86, 88, 89-97;

- Organizata dhe Komiteti i Partisë i Universitetit Shtetëror të Tiranës — 267-268;
- organizatat dhe komitetet e Partisë në ushtri — 114-115, 207, 208-209, 416-417.

Partia e Punës e Shqipërisë
— *lufta e klasave në Parti*

- lufta e saj kundër armiqve; qëndrimi ndaj oportunistëve — 174-175, 333.

Partia e Punës e Shqipërisë
— *politika e jashtme, rritja e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH* — 297-298;

- mbrojtja e marksizëm-leninizmit, e Stalinit dhe e BS të kohës së Stalinit — 308, 388-390;
- marrëdhëniet, qëndrimi dhe përkrahja për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, për partitë komuniste marksiste-leniniste, për revolucionarët dhe forcat përparimtare. Vija e PPSH për mbledhje të partive komuniste marksiste-leniniste — 67, 113, 116, 159, 164, 196, 204, 209, 212-214, 219-220, 304, 346, 347-348, 349-351, 376,

378, 379, 386, 387, 392-393, 430, 431, 439;

- lufta e saj kundër imperializmit, revizionizmit modern dhe atij sovjetik — 7, 12, 13, 14-15, 54-55, 73, 79, 122-123, 125, 135, 138-139, 218-219, 241, 242, 243, 247-248, 249, 260-261, 262, 275, 281, 282, 284, 293, 296, 297, 298, 300, 305, 306, 307, 313, 314-316, 317, 322, 363, 389-390, 396-397;
- qëndrimi i PPSH ndaj propozimit të revizionistëve sovjetikë për mbledhje të partive komuniste e punëtore; qëndrimi ndaj polemikës në lëvizjen komuniste — 13, 79, 87, 396-402;
- marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj PK të Kinës dhe RP të Kinës — 12-16, 87, 219, 221-223, 227, 251-252, 263, 285, 292, 293, 309, 310, 311-312, 313-314, 315, 322, 376-377, 378, 386, 391;
- marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj Partisë Punëtore Rumune dhe ndaj revizionistëve rumunë — 75, 78-79, 80, 81, 82, 218-219, 221, 222, 223, 227,

230, 231, 232, 237, 238-239, 248;

- qëndrimi ndaj revizionistëve francezë dhe italianë — 122-123, 352-353.

Partia e Frontit Nacionalçlirimtar Algjerian — 379.

Partia e Punës e Koresë, Partia e Punonjëseve të Vietnamit — 134, 321, 378, 379.

Partia Komuniste e Belgjikës — 120, 212, 376.

Partia Komuniste e Brazilit, e Kilit, e Perusë dhe e Venezuelës — 59-60, 113, 430.

Partia Komuniste e Cejlonit, e Indonezisë, e Iranit, e Japonisë dhe e Zelandës së Re — 107, 164, 209, 242-243, 304, 376, 431.

Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste); grupet marksiste-leniniste në Itali — 67, 73, 346-351.

Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Australisë — 204, 219-220, 376.

Partia Socialiste e Bashkuar Gjermane; Partia Socialiste e Belgjikës, socialistët belgë; Partia Socialiste e Unitetit Proletar në Itali; Partia Socialiste Franceze — 40, 54-55, 120, 121, 122, 135.

Përvoja e përparuar, përgjithësimi i saj — 198.

Planifikimi i ekonomisë po-

pullore, planet — parimet e planifikimit të ekonomisë popullore; hartimi dhe realizimi i planeve, studimet; organet e planifikimit, metoda e punës së tyre. Plani i 4-t pesëvjeçar (1966—1970) — 16, 136, 334-337, 352, 404-405.

Politika e jashtme e RP të Shqipërisë

- parimet themelore të politikës së jashtme të RPSH — 14, 57, 312, 369;
- marrëdhëniet dhe qëndrimi parimor marksist-leninist ndaj RP të Kinës — 3-4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12-15, 16-17, 18, 19, 164, 182, 196, 203, 215, 217, 219, 251-252, 271, 277, 286, 378;
- marrëdhëniet me Vietnamin dhe me Korenë; përkrahja për luftën nacionalçlirimtare të popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë — 130, 161, 179, 204, 378, 379, 388;
- marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj Rumanisë dhe Bullgarisë — 57-58, 218-219, 224, 379;
- marrëdhëniet me Algjerinë, me Ganën dhe me Kongon — 182, 379, 380-381;

— të huajt, miqtë për Shqipërinë; rritja e prestigjit të RP të Shqipërisë në botë — 211, 380, 383, 391-392, 394.

Polonia, revizionistët polakë — 74, 77, 126, 226, 241, 259-260, 288, 398.

Populli shqiptar — traditat, virtytet moralopolitike — 181, 392.

Propaganda dhe shtypi borgjezo-revizionist — 18, 19, 25, 47, 55-58, 124, 143-144, 148, 157, 245, 279-280, 294, 324, 330-331, 332, 355-356, 357.

Psikologjia mikroborgjeze, lufta kundër shfaqjeve të saj — 366, 367-368.

Puna — rëndësia dhe qëndrimi socialist ndaj saj; lidhja e punës mendore me punën fizike — 202.

R

Rendimenti i punës, ngritja e pandërprerë e tij — 337.

Revizionistët Francezë, Partia Komuniste Franceze; Kongresi i saj i 17-të — 30, 41-42, 73, 121-123, 308, 362, 394.

Revizionistët italianë, Partia Komuniste Italiane, pozita e tyre policentriste

— vija e tyre; strategjia dhe

taktikat; tradhtia dhe lufta ndaj marksizëm-leninizmit, lidhjet dhe bashkëpunimi me socialdemokracinë; diferencimi në gjirin e saj — 20-21, 34, 36-41, 42, 241, 253-257, 258-259, 260, 358;

- lidhjet me revizionistët jugosllavë, marrëdhëniet dhe kontradiktat me revizionistët sovjetikë — 20, 21, 36-37, 42, 126;
- qëndrimi i tyre ndaj Shqipërisë — 261.

Revizionizmi modern, partitë revizioniste; strategjia dhe taktikat, lufta kundër marksizëm-leninizmit, partive m-l e socializmit. Përpyekjet për të shkatërruar kampin e socializmit — 237, 244-246, 248, 257-258, 260, 273-274, 275, 297, 300, 452;

- kriza, përçarja dhe kontradiktat në gjirin e tyre, disfatat; lidhjet, kontradiktat dhe përpyekjet për t'u shkëputur nga revizionistët sovjetikë — 36-37, 76-78, 126-127, 138, 241-243, 248-249, 259-260, 275, 300, 325-327, 341-342, 395, 397, 433-434, 436;
- aleanca dhe bashkëpunimi me socialdemokracinë dhe borgjezinë — 20-21,

34-36, 73, 119-120, 121-122, 245, 246, 450-451, 452-453;

- lidhjet me revizionistët jugosllavë; qëndrimi ndaj Kinës — 18, 326-327, 421;
- lufta e tyre kundër PPSH dhe RP të Shqipërisë — 18, 275, 297;
- qëndrimi ndaj Stalinit — 341-342, 389-390.

Revolucioni dhe luftërat nacionalçlirimtare — 147, 452.

Rinia, Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë — edukimi i saj komunist, lufta kundër shfaqjeve të huaja; rinia studentore — 268, 367-368, 409-410, 442, 445, 446.

Rezervat shtetërore — 336-337, 352.

Rumania, revizionistët rumunë, Partia Punëtore Rumune — 74, 111-112, 142, 226, 252, 259;

- vija, pozita centriste e tyre; qëndrimi ndaj BS dhe polemikës në lëvizjen komuniste — 75, 77-78, 79, 221, 225-226, 227, 235-237, 241, 242, 248, 290, 321;
- qëndrimi ndaj imperia-listëve amerikanë dhe revizionistëve jugosllavë — 221-222, 236, 237;
- marrëdhëniet dhe qënd-

rimi ndaj Kinës — 102, 105, 290;
— marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj PPSH dhe RP të Shqipërisë — 75, 78, 106, 205, 231, 232, 236, 237, 290, 379, 393.

S

Socialdemokracia, socialistët — 35, 36, 119-122, 147, 257, 421.

Sociologjia, studimet sociologjike — 446-447.

Stalin, Josif Visarionoviç — 35, 59, 147, 148, 226, 227, 278, 280, 289, 290, 308, 320, 329, 332, 338, 341, 344, 355, 388-389, 434, 435.

Superfuqitë — bashkëpunimi e rivaliteti ndërmjet tyre — 29-30.

SH

Shëndetësia në RPSH — kujdesi i Partisë për shëndetin e popullit; mjekët, kuadrot dhe punonjësit e shëndetësisë, ngritja e tyre ideoprofesionale. Kujdesi për nënën e fëmijën; vdekshmëria foshnjore — 71-72, 235, 412-413.

Shkenca në RPSH — politika dhe kujdesi i Partisë për shkencën — 65;

— institucionet shkencore,

kuadrot dhe punonjësit shkencorë; organizimi dhe drejtimi i punës studimore-shkencore; studimet shkencore, lidhja e tyre me jetën e praktikën — 65-66, 159, 183-184, 265-266.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika demagogjike, e luftës, e agresionit dhe e diktatit; ndërhyrjet në Afrikë dhe në Vietnam; disfatat — 28-29, 143-144, 375, 388;

— lidhjet dhe bashkëpunimi me BS dhe me shtetet e tjera kapitaliste. Kontradiktat dhe qëndrimi ndaj Francës — 27-28 141, 149-150, 436;

— bashkëpunimi me revizionistët jugosllavë; qëndrimi ndaj Kinës — 27, 28-29, 422.

Shtypi botëror; shtypi marksist-leninist — 13, 45, 49, 62, 105, 163, 307, 357, 362, 385, 405-406.

Shtypi dhe botimet në RPSH; përmbajtja dhe forma. Gazetarët — 34, 73, 84, 98, 130, 135, 140, 186, 211, 272, 275.

T

Teatri, estrada — 137, 180.

Teoria dhe praktika, uniteti dialektik i tyre — 299-300.

Teoritë dhe pikëpamjet borgjezo-revizioniste dhe kritika ndaj tyre

— pikëpamjet e revizionistëve modernë për bashkëzistencën paqësore — 18-19;

— teoritë e revizionistëve hrushovianë për proletariatin, për bashkëzistencën paqësore, për luftën e paqen dhe për çarmatimin — 152, 293-294;

— teoria italiane për rrugën paqësore parlamentare të kalimit në socializëm dhe për kompromisin historik — 37-38, 121.

Tregtia e jashtme; eksporti, importi; stabilizimi i tregjeve të shitjes — 100, 336, 337, 352.

U

Uji i pijshëm — 82, 83.

Uniteti Parti-popull — 13, 158, 235.

Ushtria Popullore — forcimi i saj organizativ; roli udhëheqës i Partisë — 114, 206, 414-417;

— Shtabi i Përgjithshëm, Drejtoria Politike e Ushtrisë, komandimi në ushtri — 416-417, 418;

— karakteri popullor, tiparet e saj. Edukimi ideo-

politik dhe kulturor, kuadrot ushtarakë; lufta kundër koncepteve të huaja dhe veprimtarisë armiqësore në ushtri, heqja e gradave — 115, 192-193, 206-209, 416;

— xhenio, punimet xhenle-re. Forcat rezerviste dhe paraushtarake; programet e stërvitjes, përgatitja dhe stërvitja e tyre ushtarake — 114, 192-193, 364, 383, 414-416, 417-419.

Ushtritë borgjeze e revizioniste — 206-207.

V

Veteranët — 174, 234, 235.

Vështirësitë, lufta për kapërcimin e tyre — 118, 352.

Vietnami; lufta e popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë. Qëndrimi oportunist ndaj BS — 29, 145, 217, 371, 388.

Vigjilenca revolucionare — 243, 247-248, 261, 282, 333, 374.

Z

Zgjedhjet për këshillat popullorë dhe gjykatat popullorë — 117, 181.

Zonat malore — zhvillimi i tyre — 235.

TREGUESI I EMRAVE

A

- Alia, Ramiz — 32, 34, 46, 51,
52, 54, 55, 82, 83, 86, 87, 125,
135, 166, 185, 201, 212, 439.
Akiko Nose — 159.
Akostas, Raul — 59.
Aref, Abd al-Salam — 167.

B

- Baholli, Sulë — 195, 432.
Bak, Tim — 357.
Balluku, Beqir — 206, 414.
Beria, Lavrentiev — 298.
Bizhga, Abdyl — 94.
Blum, Leon — 42.
Bodnarash, Emil — 225, 226,
232.
Bordiga, Amadeo — 347.
Brezhnjev, Leonid — 324, 325,
327, 328, 329, 372.
Bushati, Seit — 68, 84.
Byrnel, Ernest — 120.

C

- Cezari, Jul — 327.

Ç

- Çan Kai Shi — 29, 328.
Çarçani, Siri — 54.
Çen Ji — 3, 6, 7, 8, 9, 11, 12,
13, 319, 360.
Çervonjenko, Stepan — 354,
373.
Çollaku, Muharrem — 234.
Çollaku, Reshit — 234.
Çu En Lai — 3, 5, 6, 7, 8, 9,
10, 11, 12, 13, 15, 16-17, 18,
19, 27, 70, 217, 222, 225, 226,
227, 293, 306, 309, 310, 312,
317, 321, 331, 355, 356, 357,
360, 362, 372, 373, 375, 376,
386, 387, 391.

D

- Dange, Shpirad — 437.
Dezh, George Georgiu — 77,
78, 205, 222, 223, 225, 230,
231, 232, 235, 236, 237, 321.
Dë Gol, Sharl — 27, 28, 49.
Dikson, Riçard — 219.
Dishnica, Esat — 175.

Dy Bua, Fransua — 380-381.
Dy Bua, Shirlei Graham —
380-381.
Dyklo, Zhak — 357.

E

Eskalante, Anibale — 44.

F

Fan Çën Cuo — 5.
For, Edgar — 27.
Fu Ca Ji — 328, 329.
Fundo, Kristaq — 159.
Fyrnberg, Fridëll — 357.

G

Gomulka, Vladislav — 77, 242,
288, 321.
Grabocka, Myftar — 91-92, 97,
432.
Gradeci, Sulo — 48.
Gripa, Zhak — 212.
Grishin, Viktor — 386.

GJ

Gjebero, Sami — 431.
Gjebero, Veiz — 431.
Gjermani, Todo — 190-191.
Gjermani, Rrapi — 205.
Gjika, Xhebro — 9.

Gjinikasi, Mihallaq — 45.
Gjinishi, Mustafa — 174, 175.

H

Hoxha, Nexhmije — 170, 177,
181, 316, 318, 440.
Hakani, Petrit — 46.
Hasani (Brataj), Selim — 9.
Haxhiu, Ethem — 234.
Hill, Eduard — 219, 220.
Ho Lun — 372.
Homeri — 99.
Ho Shi Min — 378.
Hoxha, Ilir — 23.
Hoxha, Sokol — 23.
Hrushov, Nikita — 12, 13, 14,
15, 19, 20, 21, 24, 25, 26, 28,
29, 30, 34, 36-37, 41, 42, 43,
44, 49, 55, 56, 77, 78, 79, 80,
103, 105, 107, 111, 119, 120-
-121, 123, 127, 138, 139, 141,
144, 149, 150, 151, 152, 167,
190, 200, 209, 219, 225, 226,
227, 237, 242, 245, 246, 248,
250, 253, 254, 255, 256, 257-258,
259, 262, 274, 278-279, 280,
281, 282, 284, 285, 288, 289,
290, 291, 293, 294, 296, 298,
300, 305, 306, 307, 308, 309,
312, 313, 314, 317, 319, 322,
324, 325, 326, 327, 328, 329,
330, 332, 354, 355, 359, 362,
363, 371, 374, 375, 377, 378,
386, 394, 396, 398, 433, 434,
435, 436, 451.

I

Ibarruri, Dolores (Pasionarja)
— 24.

J

Jeng Çia Tun — 215.

K

Kapo, Hysni — 9, 24, 33, 43, 54,
101, 166, 204, 212, 215, 336.
Koleka, Spiro — 303, 314, 315.
Kondi, Pirro — 86, 97, 432.
Kacori, Petraq — 90.
Kadare, Ismail — 109.
Kadar, Janosh — 321.
Kaganoviç, Lazar — 298.
Kalivaçi, Zyko — 234.
Kallanxhi, Vasilika — 96.
Kapo, Vera — 33.
Kardel, Eduard — 34, 421.
Kastro, Fidel — 19, 24, 25-26,
43-44.
Kenedi, Xhon — 246.
Kim Ir Sen — 321.
Kodheli, Riza — 108.
Konda, Spiro — 99.
Kono, Kristo — 100.
Konomi, Dhora — 92-93.
Kosigin, Aleksei — 324, 371,
372.
Kosta, Pjetër — 432.
Krerri, Mak — 159.
Kroi, Haxhi — 205.

L

Lako, Koço — 93.
Lalollari, Dituri — 95.
Lekbello, Koço — 96.
Leskoviku, Suat — 234.
Le Zuan — 134.
Li Hsien Nien — 238, 377, 378,
387, 391.
Liu Shao Çi — 293, 332.
Longo, Luixhi — 357.
Lo Shi Gao — 13, 196, 277.
Lubonja, Todi — 84.
Luçi, Mustafa — 9.
Lu Din I — 387.

LL

Lleshi, Haxhi — 174.

M

Marko, Rita — 34, 52, 54, 55,
73, 276.
Myftiu, Manush — 55, 185,
218, 219, 224, 231, 232, 236,
237, 238.
Macedo, Saturnino Paredes —
430.
Malenkov, Georgi — 298.
Male, Sterjo — 92.
Malinovski, Rodion — 328, 372.
Mao Ce Dun — 157, 252, 263,
285, 287, 288, 289, 290, 308,
328, 332, 387.

Masoz, Moris — 159.
Maurer, Ion — 78.
Meixher, Artur — 159.
Menzelxhiu, Jashar — 84.
Mikojan, Anastas — 242, 290,
372.
Moisiu, Spiro — 175.
Mole, Gi — 119, 135.
Molotov, Viaceslav — 298, 332.
Mosku, Nasi — 97.
Muhiden, Hasen — 164.

N

Nushi, Gogo — 117.
Naska, Jani — 96-97.
Neni, Pietro — 40.
Nguyen Ngoc Son — 204.
Nguyen Van Hieu — 179.
Novotni, Antonin — 77, 321.
Nuke, Misto — 95-96.

O

Ohri, Musa — 176.

P

Paçrami, Fadil — 84.
Paraf, Pier — 211.
Pardede, Peris — 304.
Parruca, Bilal — 432.
Paskali, Odhise — 172.
Pashollari, Hamide — 96.

Pavliqoti, Fatmir — 92.
Peçi, Shefqet — 171.
Peza, Myslim — 175.
Podgorni, Nikolai — 24, 25.
Polena, Jani — 96.
Prifti, Ilo — 89.

Q

Qulli, Muço — 190.

R

Radovicka, Petrit — 136.
Rankoviç, Aleksandër — 421.
Roka, Blas — 44.
Rusell, Florence — 204.

S

Salazhan, Leontin — 232, 236,
237.
Samara, Thoma — 97.
Saraçi, Rexhep — 94-95.
Spaho, Irfan — 91.
Spak, Pol-Anri — 119, 120, 375.
Stefanllari, Skënder — 96.
Sulejmani, Myzafer — 90-91.
Suslov, Mihail — 124, 135, 155.

SH

Shamblli, Peti — 432.
Sharki, Lorens — 219, 220.

Shigeaki Hirata — 159.
Shkurti, Leka — 86.
Shtylla, Medar — 175, 363.
Shy Gjien Guo — 277.

T

Toska, Haki — 54, 55, 169,
336.
Tilka, Vasil — 90.
Tito, Josip Broz — 12, 20, 21,
34, 37, 41, 42, 49, 79, 103, 119,
120, 123, 222, 226, 237, 242,
259 292, 375, 399, 411, 421,
423.
Toliati, Palmiro — 19, 20, 21,
34, 36, 37, 39, 40, 41, 42, 73,
123, 253, 254-257, 258-259,
260, 261, 353.
Topulli, Çerçiz — 190.
Terez, Moris — 34, 41-42, 73.
Trebeshina, Myzafer — 52.

TH

Themeli, Palo — 96.

U

Ulbricht, Valter — 77, 321, 357.

V

Vanderveld, Emil — 120.
Venizellos, Sofokli — 55, 56,
57, 58.
Veshi, Petraq — 95.

X

Xega, Marko — 94.

XH

Xhabia, Ramiz — 73.
Xhonson, Lindon — 141, 144,
328.

Y

Ylli, Kahreman — 185.

Z

Zagorçani, Bexhet — 93-94.

ZH

Zhang Shi Shin — 5.
Zhivkov, Todor — 321.
Zhukov, Georgi — 296.

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

- Afrikë — 18, 19, 120, 150, 319, 436.
Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë — 66.
Akademia Ushtarake e RP të Shqipërisë — 54, 115.
Amerika Latine — 43, 44, 59, 120, 150, 436.
Ansambli i këngëve e i valleve i Phenianit, Kore — 316.
Arkivi Qendror i Partisë — 5, 6, 8.
Arkivi Qendror i Shtetit — 264, 265.
Azi — 35, 120, 148, 150, 436.

B

- Balli Kombëtar (organizata ~) — 357.
Banka e Shtetit Shqiptar — 405.
Beograd — 19, 20, 36, 42, 119, 135.

D

- Berat — 9, 156, 170, 171, 302, 303, 314, 315, 318.
Besarabi — 289, 290.
Brazil — 145.
Brigada V Sulmuese e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare — 43.
Brigada XII Sulmuese e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare — 171, 174.
Britania e Madhe — 28, 141, 326.
Brozdovec (Korçë) — 229.
Bukuresht — 224, 232, 238, 355, 360.
Burrel — 267.
Dajt (mali ~) — 18, 22, 132, 154, 385, 403.
Deti i Kuq — 167.
Dibër — 168.
Divjakë (Lushnjë) — 55.
Durrës — 82, 83, 267.

Egjipt — 167.
Ekspozita Kombëtare e Arteve Figurative (Tiranë, 1964) — 427-428.
Elbasan — 83, 84, 215.
Evropë — 35, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 255, 291, 393, 398, 421, 436, 452.

F

Fabrika e Bukës, Tiranë — 403-404.

Fabrika e cigareve «Vasil Shanto», Shkodër — 193.

Fabrika e çimentos «V. I. Lenin», Vlorë — 10.

Fabrika e Tisazhit, Shkodër — 193.

Fabrika e Trikotazhit [Kombinati i trikotazhit «Drapër e çekan»], Korçë — 99.

Fabrika e Tullave, Vorë — 163.

«Flamuri i kuq» (revista ~) — 373.

Fronti Nacionalçlirimtar i Vite namit të Jugut — 388.

«Futja e klikës së Titos në KNER dhe planet revizioniste» (artikulli ~, «Zëri i popullit», 18 nëntor 1964) — 273-275.

Ganë — 380.
Gestapo (Policia Sekrete e Shtetit) — 153.
Greqi — 55.
Guançou (Kinë) — 203.

GJ

Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 28.
Gjirokastër — 54, 190.

H

«Halili dhe Hajria» (baleti ~) — 6.

Havanë — 24, 25.

Helmës (Skrapar) — 175.

Hidrocentrali i Vaut të Dejës — 337.

HSINHUA (Agjencia Kina e Re) — 210, 332.

Hungari — 226.

I

Indi — 437.

Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë — 65.

Instituti i Historisë së Partisë [Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH], Tiranë — 265-266.

Intelixhens Servisi — 174.
Internacionalja e Tretë Komuniste — 42.
Irak — 167.
Iran — 209.
Itali — 20, 39, 256, 358, 391.

J

Jaltë (Bashkimi Sovjetik) — 253.

Japoni — 29.

K

Kili — 116.

Klubi i Shkrimtarëve e i Artistëve, Tiranë — 3.

KNER (Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke) — 149, 273, 274, 275.

Kombinati i Tekstileve, Berat — 170.

Kombinati i tekstileve «Stalin», Tiranë — 3.

Komonuelthi Britanik — 29.

Konferenca e 4-t e Bashkimit të Gazetarëve të Shqipërisë (18 prill 1964) — 140.

Kongo — 150, 375.

Kongresi i Përmetit (24 maj 1944) — 170, 174-175.

Kongresi i Turit — 42.

Kooperativa Bujqësore e Bërdicës, Shkodër — 192.

Kooperativa Bujqësore e No-

voselës, Vlorë — 10.
Korçë — 7, 8, 84, 85, 86, 83, 97, 99, 100, 178, 220, 228, 229.
Kore — 29, 217, 371.
Kosovë — 57, 227, 289.
Kukës — 426-427.
Kuzbaba [Parku «Liria»], Vlorë — 50.

L

Laos — 145.

Lezhë — 54, 84.

Librazhd — 85.

Lindja e Largme — 28, 437.

M

Maliq (Korçë) — 228.

Marrëveshja amerikano-sovjetike për kufizimin e prodhimit të lëndëve fisile — 144.

«Mbi çështjet e lëvizjes punëtore ndërkombëtare e të unitetit të saj» (promemoria ~, P. Toliati) — 253-254, 261, 353.
Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë (10 nëntor—1 dhjetor 1960) — 59, 397, 398.

Mokër (Pogradec) — 233, 234, 235.

Moldavi — 289.

Moskë — 19, 24, 25, 76, 86, 119, 138, 280, 315, 321, 355, 356,

357, 360, 362, 371, 373, 376,
385, 386, 391.
Muzeu i Pavarësisë, Vlorë —
9.

N

NATO (Organizata e Traktatit
të Atlantikut Verior) — 28.
«Nëntori» (revista ~) — 109.
Ndërmarrja bujqësore «Perlat
Rexhepi», Shkodër — 190.
Ndërmarrja e Qilimave, Korçë
— 100.

O

Oder—Najse (kufijtë ~) —
288.
Olimp (Greqi) — 99.
Osum (lumi ~) — 171.

P

Pallati i Brigadave, Tiranë —
3, 10, 11, 383, 391.
Pallati i sportit «Partizani»,
Tiranë — 11, 382.
Pekin — 86, 106, 111, 217, 293,
327, 332, 356, 360, 373, 387.
Peqin — 83.
Përmet — 156, 170, 171, 172-
173, 174, 175, 176, 177.
«Përse mendohen këto male»
(poema ~, I. Kádare) — 109.

Pleshisht (Pogradec) — 234.
Pogradec — 85, 156, 215, 216,
230, 234-235, 240.
«Pravda» (gazeta ~) — 362,
436.
«Probleme të paqes e të socia-
lizmit» (revista ~) — 357.

Q

Qipro — 103.
Qyteti Stalin — 9, 170, 302.

R

Radio Varshava — 288.
Revolucioni i Madh Socialist i
Tetorit (1917) — 314, 323, 330,
332.
Romë — 67, 327, 360.

RR

«Rrethimi i bardhë» (drama
~) — 98.

S

Sarandë — 48.
Sllatinë (Pogradec) — 234.
SMT, Shkodër — 193.
Stacioni Qendror i Zooteknisë,
Shkodër — 191.
Stanleivil (Kongo) — 375.

«Studimi i evolutave dhe i
evoiventeve të kurbave të ha-
pësirës» (vepra ~, K. Fundo)
— 159.
Sukë (Përmet) — 171.

SH

Sheshi i Flamurit, Vlorë — 9.
Shkodër — 7, 8, 18, 54, 189, 190-
191, 192, 194.
Shkolla e Partisë «V.I.Lenin»,
Tiranë — 299-300, 301.
SHNUM (Shoqëri në ndihmë
të Ushtrisë e Mbrojtjes) — 415.
Shoqata e Miqësisë Belgjikë
— Shqipëri — 200.
Shoqata e Miqësisë Francë
— Shqipëri — 211.
Shqipëria e Jugut — 57, 391.
«Shqipëria socialiste në 20-vje-
torin e saj» (ekspozita ~) —
380.
Shtëpia e Kulturës, Përmet —
173.
Shtëpia Qendrore e Ushtrisë
Popullore, Tiranë — 3.
Shtoj (Shkodër) — 190.

T

Tajvan — 27, 145.
TANJUG (Agjencia Telegrafi-
ke e Jugosllavisë së Re) — 56,
119.
TASS (Agjencia Telegrafike e

Bashkimit Sovjetik) — 124.
Teatri i Operës dhe i Baletit,
Tiranë — 4, 316.
Teatri Popullor, Tiranë — 180.
Teknikumi Veterinar, Shkodër
— 191.
Tempulli i Dodonës (Greqi) —
99.
Tepelenë — 156, 177, 330, 426-
427.
Termoelektrocentrali i Fierit
— 337.
Tërbaç (Vlorë) — 33.
Tiranë — 3, 23, 43, 59, 67, 82,
83, 101, 138, 139, 154, 240,
303, 383, 403.
«To Vima» (gazeta ~) — 55,
56.
TPE (Tregu i Përbashkët Ev-
ropian) — 274.
Traktati i Varshavës — 149.
Traktati sovjetico-amerikano-
anglez për ndalimin e prova-
ve të armëve bërthamore (Mo-
skë, 1963) — 143, 144.
Transilvani — 289, 290.
Trebinjë (Pogradec) — 235.
Tropojë — 168.

U

Uji i Ftohtë, Vlorë — 9.
Universiteti Shtetëror i Tira-
nës [Universiteti i Tiranës
«Enver Hoxha»] — 65, 183,
265-266, 267-268.
Uzina e Telave të Bakrit [Uzi-
na e Telave dhe e Kablllove

Elektrikej, Shkodër — 190.
Uzina Mekanike, Korçë — 100.

V

Vatikan — 39.
Vendet Skandinave — 34.
Venezuelë — 113.
Vlorë — 9, 24, 31, 32, 33, 43,
47, 51, 52, 53, 177.

Y

«Ymanite» (gazeta ~) — 362.

Z

Zelanda e Re — 107.
«Zëri i popullit» (gazeta ~) —
84, 98, 130, 186, 272, 273, 281,
317, 352-353, 357.

ZH

«Zhenminzhibao» (gazeta ~)
— 330, 405-406.

ENVER HOXHA

DITAR

1965

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1989

ENVER HOXHA

E SHTUNE
2 JANAR 1965

U nisëm për në Vlorë për të bërë një pushim të shkurtër. Erdhën dhe fëmijët, se edhe ata janë me pushimet e shkollës.

VLORE, E DIEL
3 JANAR 1965

Kohë me shi. Bëra një shëtitje të vogël. Në mbrëmje pamë një film sipas romanit të Zhyl Vernit me titull: «Ishulli misterioz».

VLORE, E HËNË
4 JANAR 1965*

Agjencitë e lajmeve njoftuan mbrëmë se Indonezia shpalli tërheqjen e saj nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, për arsye se Malajzia u zgjodh anëtare e Këshillit të Sigurimit. Indonezia kërkon Kalimantanin, ku partizanët indonezianë veprojnë me kohë për ta çli-ruar nga kolonizatorët anglezë. Tërheqja e Indonezisë nga OKB-ja ka shqetësuar dhe do të shqetësojë shumë, në radhë të parë, amerikanët dhe sovjetikët, si dhe sa-telitët e tyre. Të parët e përdorin OKB-në si një organ të tyre dhe veprojnë në botë në mënyrë mizore, duke u mbuluar me pelerinën e saj. Ata bëjnë agresione në emrin e OKB-së, bëjnë spiunazh nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të saj. Revizionistët modernë, që bashkë-punojnë ngushtë me imperializmin amerikan, kanë filluar të bëjnë edhe ata si amerikanët, ta përdorin OKB-në si maskë dhe të bien në ujdi me ta për ta kthyer në një vegël të përbashkët, amerikanët për të vepruar, sovjetikët për të bërë demagogji. Organizatës së Kombeve të Bashkuara ka kohë që i ka rënë prestigji. Mospranimi në të i Kinës e ka thelluar krizën akoma më shumë. Askush nuk mund të pranojë që shteti më i

madh në botë të pengohet të hyjë në këtë organizatë. Kjo tregon në mënyrë flagrante se në OKB amerikanët dhe sovjetikët intrigojnë kundër popujve.

Disa vende të porsaçliruara kanë iluzione të kota, se gjoja OKB-ja shërben për mbrojtjen e tyre. Në fakt nëpërmjet saj imperialistët amerikanë përpiqen të mbrojnë interesat e tyre. Revizionistët sovjetikë, që janë kundër revolucioneve dhe lirisë së popujve, vijnë atje pas amerikanëve dhe zhvillojnë në OKB diplomacinë e fshehtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Prandaj largimi i Indonezisë do të ketë jehonë dhe tronditje në radhën e imperialistëve dhe të revizionistëve, pse kjo u prish atyre qetësinë e veprimeve në OKB. Vendet e reja në OKB po binden se liria dhe pavarësia e tyre nuk mbrohen nga OKB-ja, por nga forca e popullit të vet, nga organizimi i tij...

VLORË, E MARTË
5 JANAR 1965

Është kohë e bukur me diell. Bashkë me fëmijët vajtëm në Kuzbaba, nga ku bëmë sehir Vlorën, që dukej si në pëllëmbë të dorës. Kemi ndërtuar shumë në Vlorë, por qyteti nuk më duket i mbajtur mirë. Shokët drejtues duhet të kenë më shumë shije e dëshirë për ta zbukuruar qytetin, por edhe vetë banorët të kenë kujdes për ta mbajtur atë bukur e pastër, sepse në Vlorë kemi investuar mjaft për këtë qëllim. Duhet punuar me njerëzit për t'i edukuar edhe në këtë drejtim.

Qeveria reaksionare indiane bëri këto ditë një goditje të ashpër kundër shokëve tanë komunistë indianë, fill pas kongresit revizionist të Danges. Kjo tregon egërsinë e reaksionarëve indianë, që janë shpallur nga revizionistët sovjetikë si miqtë e tyre më të ngushtë. Goditja e rëndë që u është bërë në Indi shokëve (lajmet thonë se kanë arrestuar afër 500 veta), tregon dobësinë e madhe të reaksionit indian në fuqi, që s'i bën dot ballë krizës dhe urisë, s'i bën dot ballë lëvizjes revolucionare që ngrihet, dhe u trembet marksistë-leninistëve. Reak-

sioni indian vepron në ujdi të plotë me revizionistët sovjetikë prapa perdes.

Me t'u krijuar Partia Komuniste e Indisë (marksiste-leniniste), reaksioni indian, në bashkëpunim me sovjetikët dhe Dangen disa muaj më parë, që kur rronte akoma Nehruja, bënë në mënyrë djallëzore një veprim përgatitor, arrestuan disa revizionistë, bënë pak zhurmë dhe i lëshuan përsëri. Tash goditja që u dha është prova e sigurt për të dëmtuar dhe zhdukur Partinë Komuniste të vërtetë Indiane. Ne duhet të shkruajmë në shtyp¹, për të demaskuar me forcë komplotin revizionisto-reaksionar indian, dhe bashkë me të revizionistët sovjetikë, që fshehurazi kanë gisht në këtë vepër tradhtarë dhe që haptazi ndihmojnë me çdo mjet provokatorët e luftërave kundër Kinës dhe torturuesit e shokëve komunistë. Ne duhet të mbrojmë me zjarr të madh shokët komunistë revolucionarë indianë, pse kjo mbrojtje ka rëndësi të jashtëzakonshme, jo vetëm për në Indi, por edhe gjatë.

Reaksioni botëror, në mos sot nesër, përgatitet të godasë kudo partitë komuniste dhe punëtore marksiste-leniniste që janë duke u formuar. Duke goditur rrezikun që ngrihet dhe e kërcënon, reaksioni lehtëson edhe punën e revizionistëve. Me qëndrimin tonë ne duhet të ngjallim te shokët indianë ndjenjën e vigjilencës ndaj rrezikut që i kërcënon, pse shumë prej tyre po flenë, po i marrin këto çështje subjektivisht dhe të shkëputura nga lufta që revizionistët në aleancë me imperializmin zhvillojnë kundër marksizëm-leninizmit.

1. Më 9 janar 1965, «Zëri i popullit» botoi artikullin «Një akt i ri fashist i reaksionarëve indianë».

VLORË, E MËRKURË

6 JANAR 1965

Sot në faqet 2, 3 e 4 të gazetës «Zëri i popullit» u botua artikulli me titullin «Marksizëm-leninizmi revolucionar do të triumfojë në Evropën e mbarsur me revizionizëm»¹. Tezat e këtij artikulli i kisha shkruar më parë.

* I shkrova shokut Ramiz se, ashtu sikurse i thashë edhe në telefon, letrën që na dërgoi qeveria polake, kup-tohet në emër të anëtarëve të tjerë të Traktatit të Varshavës, ku na fton të marrim pjesë në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ, ne duhet ta pranojmë dhe jo të mos e pranojmë, siç mendojnë shokët e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Letrën duhet të mos e kthejmë, e para, për arsye se ajo nuk na drejtohet vetëm nga qeveria sovjetike, por nga të gjithë anëtarët e tjerë, me të cilët (me përjashtim të sovjetikëve) kemi marrëdhënie diplomatike, dhe, e dyta, ne duhet t'u japim një përgjigje, e cila të mbetet një dokument historik, ku t'i

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 353.

demaskojmë që të gjithë për veprime të paligjshme dhe të dënueshme.

Letra duhet të hartohet në mënyrë serioze nga Ministria e Punëve të Jashtme në emër të Qeverisë¹ dhe të lihet jashtë çdo konsideratë ideologjike, në formë polemike. Dokumenti duhet të ketë karakter shtetëror, në forma dhe me terma të fortë, të drejtpërdrejtë për sa u përket fakteve dhe argumenteve.

Ne nuk do të marrim pjesë në këtë mbledhje, në kushtet aktuale dhe në çdo rrethanë, derisa anëtarët e Traktatit të Varshavës janë këta që janë. Prandaj konkluzioni i përgjigjes sonë është që ne nuk marrim pjesë. Por në këtë letër ne duhet të radhitim një sërë faktesh, të kërkojmë një sërë konditash të drejta nga çdo anë ligjore, politike dhe morale për ne. Në rast se ata nuk i plotësojnë këto kondita, ne nuk vemi dhe ua lëmë çdo gjë në kurrizin e tyre...²

I hodha mendimet e mia në vija të përgjithshme, të paformuluara ekzaktësisht e me stil diplomatik. Prandaj i shkrova shokut Ramiz t'i shikojë me shokët, t'i diskutojë, t'i shtojë e t'i korrigjojë. Në formulim duhet të kemi parasysh dhe letrën që na dorëzuan. Gjatë kësaj

1. Mbi bazën e orientimeve që parashtron në këtë shënim shoku Enver Hoxha, është përgatitur «Letër e Qeverisë së RP të Shqipërisë drejtuar pjesëmarrësve të Mbledhjes së Traktatit të Varshavës të 19 janarit 1965», botuar në «Zërin e popullit» më 2 shkurt 1965.

2. Shih vazhdimin e këtij shënimi në librin: Enver Hoxha, «Superfuqitë», f. 136.

kohe do të mendoj edhe unë më mirë dhe, kur letra të jetë gati, do ta shoh dhe unë, mund të bëj ndonjë vërejtje. Mendoj se Ramizi do t'i ndihmojë ca ata të Ministrisë së Jashtme në këtë punë. Letra duhet të jetë gati që ta dorëzojmë para datës së mbledhjes.

VLORE, E ENJTE

7 JANAR 1965

Pasdreke na erdhi për vizitë Hysniu. Pamë një film për jetën dhe krijimtarinë e Maskanjit. Muzikë e bukur.

Ambasadori ynë në Hanoi na lajmëron se i dorëzuan kopjen e letrës që Partia e Punonjësve të Vietnamit i ka dërguar Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në lidhje me mbledhjen e marsit. Në letër pothuajse nuk kuptohet nëse do të venë apo jo, nëse e pranojnë apo jo. Në fakt, ata nuk do të venë, po letra është aq e paqartë saqë ambasadorët revizionistë u detyruan t'i pyesin vietnamezët: «Do të vini në mbledhje apo jo?». Përveç kësaj, lidhur me çështjen që vietnamezët thonë në letër «merruni vesh ju (sovjetikët) me kinezët dhe vendosni kur duhet ta bëjmë mbledhjen dhe kush duhet të marrë pjesë në mbledhje dhe ne (vietnamezët) jemi dakord», ambasadori bullgar, të cilit kjo gjë i ka bërë përshtypje, u tha vietnamezëve: «Nuk mendoni ju se kështu ofendoni partitë e tjera?». Me të vërtetë kjo është për të ardhur keq!

Qeveria polake, në emër të Traktatit të Varshavës, na ka ftuar të marrim pjesë në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të këtij Traktati, që do të bëhet më 19 janar me temën: «Armatimi i Gjermanisë Perëndimore me armë atomike». Dje i dërgova shokut Ramiz orientimet e hartimit të letërpërgjigjes, ku ne do t'u themi polakëve se refuzojmë të marrim pjesë.

Por interesant është taktika e rumunëve. Ata, nëpërmjet Bodnarashit dhe, me spunt, me anë të ambasadorit kinez, na paralajmëronin për këtë mbledhje, na sugjeronin edhe taktikën që duhet të përdorim, por që në fund të fundit konsiston në atë që ne «të marrim pjesë». Sipas tyre, mund të mos pranojmë menjëherë datën, të kërkojmë që kjo të shtyhet, të kërkojmë edhe rendin e ditës, pastaj të vemi, pse rumunët, ne dhe kinezët si vëzhgues do të mundim të luftojmë më mirë, dhe veçanërisht për të realizuar propozimin e Çu En Lait për mbledhjen e përgjithshme të kryetarëve të qeverive. Ambasadori kinez në Rumani na i komunikoi thëniet e Bodnarashit, gjoja më parë se të vinte në dijeni Pekinin.

Rumunët, me manovrat e veta, kërkojnë të futin në thes kinezët dhe me anë të tyre të na bëjnë presion edhe neve dhe, në qoftë se kinezët pranojnë të venë, të zemërohen e të ftohen me ne që nuk vemi. Por kjo neve s'na prish asnjë punë.

VLORË, E PREMTE

8 JANAR 1965

* I shkrova përsëri Ramizit lidhur me përgjigjen që do t'u dërgojmë vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës, duke i sugjeruar që të kenë parasysh në formulimin e letrës edhe këto ide:

Në kondita të këtilla që ju keni krijuar për Republikën Popullore të Shqipërisë në gjirin e Traktatit të Varshavës, Qeveria Shqiptare, me përgjegjësi të plotë, me anën e kësaj letre, shpreh mendimin e saj për rendin e ditës që ju propozoni:

Kundër armatimit të Gjermanisë Perëndimore me armë atomike. Këtë pikëpamje e kemi pasur, e kemi dhe do ta kemi kurdoherë. Dhënien e armëve bërthamore, nga ana e amerikanëve, e kemi luftuar, e luftojmë dhe do ta luftojmë kurdoherë.

Rrezikshmëria e ka burimin në politikën kapitulluese, antimarksiste dhe antisocialiste që ka mbajtur para imperializmit amerikan qeveria sovjetike, edhe kur kryesohej nga ish-kryeministri Nikita Hrushov, i cili çështjen e Traktatit famëkeq të Moskës¹ e lidhi me arma-

1. Për ndalimin e provave të armëve bërthamore në atmosferë e nën ujë.

timin atomik të Gjermanisë Perëndimore dhe me tratativa të dyshimta për sakrifikimin e Republikës Demokratike Gjermane, të të drejtave të saj, të lirisë, të pavarësisë, të sovranitetit.

Ne i kemi thënë hapur dhe botërisht qëllimet e errëta të N. Hrushovit, kur u nënshkrua Traktati i Moskës; N. Hrushovi dhe shokët e tij i fshehën qëllimet e vërteta. Këto tani po dalin sheshit, në mënyrë të rrezikshme. Pavarësisht nga Traktati i Moskës dhe nga betë e rrufetë e Nikita Hrushovit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, miqtë «e arsyeshëm dhe paqësorë» të tij, po armatosin me armë atomike Bonin. Pyesim: Pse u bë ky Traktat i Moskës? Kundër kujt u bë ky traktat?

Me një politikë të tillë kapitulluese para imperializmit amerikan, siç po vazhdon të ndjekë qeveria sovjetike, politikë të cilën e fsheh nën formulat e «bashkëzistencës paqësore», të «garës paqësore» e të tjera formula të tilla, që në praktikë janë antileniniste, nuk mund të ecet shumë larg, nuk mund të mbrohen paqja dhe jeta e njerëzimit nga katastrofa bërthamore që kërkohjnë të shpërthejnë imperializmi amerikan dhe aleatët e tij.

Ne shqiptarët dhe të gjithë popujt jemi të shqetësuar, por jo të frikësuar. Imperializmi amerikan është armiku numër një, ai përgatit luftën, ai armatos aleatët e tij për të na sulmuar. Kësaj situatë duhet t'i bëhet ballë jo duke u bërë lëshime amerikanëve, por duke i gozhduar në vend dhe duke i detyruar të zbythen. Me këtë politikë që ndiqet tani nga qeveria sovjetike dhe nga disa prej qeverive të vendeve të tjera anëtare të

Traktatit të Varshavës, po ecet në rrugë të rrezikshme, po ndihmohet shpërthimi i luftës nga ana e imperia-
lizmit amerikan.

Së bashku kemi marrë më parë vendime të drejta, por ato tani janë shkelur, janë braktisur, për të marrë vendime të gabuara.

Duhet të mbrojmë me të gjitha forcat Republikën Demokratike Gjermane. Kemi marrë vendim të nënshkruanim traktatin e paqes me të, vinin apo nuk vinin të tjerët. Qeveria sovjetike me N. Hrushovin u frikësua, kapitulloi para amerikanëve, dhe, me qëllime shumë të këqija për fatet e popullit gjerman, të popujve të vendeve tona dhe të popujve të botës, e prishi këtë vendim. Ju mbani, gjithashtu, përgjegjësi të rëndë për këtë. Po s'u mbrojt Republika Demokratike Gjermane, nuk mund të mbrohen kufijtë Oder-Najse, nuk mund të mbrohen Sudetët dhe Çekosllovakia. Këto janë të lidhura së toku dhe të shtrenjta për ne të gjithë. Ne duhet të mbrojmë vendet tona, të mbrojmë popujt tanë dhe socializmin dhe jo të kurdisim komplete kundër vendeve vëllezër, siç bënte Nikita Hrushovi dhe disa nga shokët e tij. E vërteta është e hidhur, por është e vërtetë.

Është urgjente që gabimet fatale të bëra nga qeveria sovjetike të ndreqen. Në radhë të parë:

a) Të nënshkruhet sa më parë traktati i paqes me Republikën Demokratike Gjermane.

...

c) Të denoncohet sa më parë Traktati i Moskës nga ana e qeverisë sovjetike dhe nga ato qeveri që e kanë nënshkruar këtë traktat.

Qeveria e RPSH është e bindur se çdo masë apo vendim tjetër nuk do të ketë efekt përpara kërcënimeve të SHBA-së e të aleatëve të tyre dhe nuk do të ndalojë veprimtarinë e tyre luftënxitëse.

Politika kapitulluese dhe sharlatane e N. Hrushovit ka falimentuar me turp e me dëme kolosale dhe ka krijuar rreziqe serioze. Kjo nuk mund të mos jetë e qartë për qeveritë e shteteve të tjera pjesëtare të Traktatit të Varshavës. Në qoftë se ju nuk e shikoni, mendohuni më mirë, në qoftë se bëni sikur nuk e shikoni, ju bëni një faj kolosal, në rast se ngulni këmbë në atë politikë armiqësore dhe vazhdoni ta ndiqni, ju bëni një krim kolosal dhe mbani të gjitha përgjegjësitë përpara popujve tuaj, përpara gjithë popujve të botës, përpara socializmit.

Ne ju bëjmë thirrje të rishikoni fund e krye politikën tuaj të jashtme dhe ta ktheni atë me guxim në rrugë të drejtë, sa të jetë e mundur më parë, pse jo vetëm forcat tona janë kolosale, por edhe koniunkturaturat ndërkombëtare janë të atilla, të favorshme për një kthesë të tillë. Ju bëjmë thirrje t'i studioni thellë këto koniunktura, të përfitojmë nga to, të përfitojmë nga kontradiktat e thella në gjirin e imperialistëve për t'u dhënë atyre goditje akoma më të mëdha.

P S

Qeverisë polake, së cilës i drejtohet letra, duhet t'i kërkohet që t'ia paraqesë atë mbledhjes plenare të Komitetit Politik Konsultativ, ose thjesht mbledhjes plenare të Traktatit të Varshavës dhe të lexohet në mbledhje. Në rast se kjo nuk bëhet, atëherë t'u themi se jo vetëm vazhdohet në padrejtësitë e mëparshme, por në

mënyrë të paligjshme kërkohet të fshihen mendimet e një anëtari të traktatit. Mund të shënojmë, gjithashtu, se Qeveria Shqiptare rezervon të drejtën t'i bëjë të njohura opinionit publik pikëpamjet e saj të shfaqura në këtë letër, në momentin që ajo do ta gjykojë të përshtatshëm dhe me mjetet që ajo disponon.

Në mbrëmje pamë një film italian, «Il machinista». Film i bukur shoqëror. Luante shumë bukur një djalë i vogël.

VLORE, E SHTUNE

9 JANAR 1965

U nisëm për në Treport, por qëndruam dhe vizituam Fabrikën e Sodës Kaustike — një fabrikë e madhe, kombinat. Korpusi kryesor ka dalë lart themeleve, jo ashtu siç e kishin projektuar kinezët, gjë që do të na kishte kushtuar shtrenjtë. Gëzohesh kur shikon kudo, në objektet industriale inxhinierët tanë që drejtojnë me kompetencë ndërtime. Më thanë se nuk u mungonte asgjë, hekur e çimento kishin për tre muaj rezervë.

U takova me një inxhinier që kishte mbiemrin Boçari dhe e pyeta: «Ke të bësh ti me familjen historike të Sulit?». Ai m'u përgjigj: «Një gjak jemi, sipas familjes».

I vetmi qëllim i kongresit të revizionistëve jugosllav¹ ka qenë parashtrimi për «konsum botëror» i teorive të tyre antimarksiste, kritika ndaj asaj që ata e quajnë «mbeturinë të së kaluarës», domethënë marksizmin.

1. Është fjala për Kongresin e 8-të të LKJ, që u mbajt nga 7 deri më 13 dhjetor 1964.

zëm-leninizmit, që vepron dhe kundërshton në teori dhe në jetë deformimet monstruoze revizioniste. Nga ana tjetër, lënë të kuptohet se gjoja po bëjnë njëfarë autokritike para «shokëve» të tyre, të cilëve u duhet diçka si «provë» për të thënë se titistët po ndreqin gabimet dhe me këto të legalizojnë futjen e revizionizmit jugosllav në familjen e përbashkët revizioniste.

Nga gjithë materiali i këtij kongresi antimarksist, del falsiteti i madh i teorive të tyre dhe dështimi i diskutueshëm në jetë i varianteve kapitaliste, të mbuluara dhe të maskuara me frazeologji marksiste. Në çdo fushë del dështimi i tyre i plotë. Në fakt titistët i bënë shumë reklamë këtij kongresi, përpara se ai të hapej, me shpresë që të kishte një jehonë në botë. Por pësuan fiasko. Nuk pati veçse disa kuriozitete. Titistët, sigurisht, kishin marrë masa që në kongresin e tyre të asistonin shumica dërrmuese e partive komuniste e punëtore të botës dhe të krijonin kështu përshtypjen se ata kishin mbështetjen e të gjitha partive, me përjashtim të «dogmatikëve». Ata, pra, shpresonin që rreth tyre, si epiqendra e re e «komunizmit specifik», të grumbullonin «komunizmin ndërkombëtar», të izolonin «dogmatikët» dhe, duke ftuar në kongres edhe parti socialiste, socialdemokrate e të tjera parti borgjeze, të ilustrojnë tezën e tyre se jo vetëm nuk ekziston ideja e kampit të socializmit, por socializmi ndërtohet edhe në vende kapitaliste dhe drejtohet nga «parti të klasës punëtore», siç janë partitë socialiste në vendet e Evropës Perëndimore etj.

E gjithë kjo u dështoi, pse shumë parti «komuniste» dhe «punëtore» të Evropës Lindore, që drejtohen nga

klika revizioniste, hezituan të venë në kongres për të mos u komprometuar haptas; vajtën partitë revizioniste të Evropës Perëndimore, mbajtën nga një përshëndetje dhe shkruan nga një artikull në organet e tyre pasi u kthyen nga Beogradi. Në kongresin titist u bë, pra, vëllazërimi i armëve antimarksiste, i socialdemokratëve dhe i revizionistëve modernë.

E gjithë zhurma propagandistike e kongresit titist nuk pati jehonë, jo vetëm jashtë, por as brenda në Jugosllavi. Në Jugosllavi, zbatimi i teorive antimarksiste nga regjimi kapitalist i instaluar aty jo vetëm nuk ndreq gjë, por po acaron akoma më shumë kontradiktat ekonomike kapitaliste, po acaron nacionalizmin, por varfëron popullin, po çon në ngritjen në kulm të çmimeve, po ndikon në uljen e nivelit të jetesës e po sjell shumë të këqija të tjera. Këtë regjim kapitalist titistët përpigën ta legalizojnë duke e pagëzuar me emra të përshatshëm pseudosocialistë dhe me forma gjoja të reja, të cilat, në fakt, e demaskojnë dhe e bëjnë akoma më të paqëndrueshëm. Plot kriza është pseudosocializmi, kapitalizmi i tyre në çoroditje të plotë.

Titoja në raportin e tij, që në fillim, preokupohet për dështimin e teorive revizioniste në realitetin aktual jugosllav, dhe natyrisht fajin kryesor ua hedh «remnisansave¹ të marksizëm-leninizmit», dhe kërkon që me këto të qërohen hesapet një herë e mirë. Por kot e ka Titoja. Kapitalizmi më i shturur, më anarkik që po mbretëron në Jugosllavi, jo vetëm do të shtojë rrëmujën, varfërinë, kaosin, vjedhjet dhe do të fryjë ndjenjat

1. Nga frëngjishtja — ajo që mbetet në kujtesë nga diçka.

nacionaliste e regjionaliste, do të krijojë republika të pasura dhe republika të varfra, por do të shkaktojë kundërshtime edhe më të forta në mes popujve dhe shtresave të varfra nga njëra anë dhe borgjezisë titiste, që është formuar dhe forcohet çdo ditë, nga ana tjetër.

Kjo situatë vërtetohet nga vetë Titoja në kapitullin e referatit të tij mbi vetadministrimin ose siç e quajnë ata formula «e fundit marksiste e ndërtimit të socializmit specifik jugosllav», gjoja sipas interpretimit titist të teorive të Marksit dhe të Engelsit. Vetëm se Titoja s'ka se si të mos pohojë se ky farë socializmi po «has në vështirësi dhe në pengesa». Edhe pse Titoja e pranon se ky sistem, këto vështirësi i ka krijuar nga «politika jo e drejtë e investimeve», dhe që si rrjedhim ka krijuar «pakënaqësi të thella në mes republikave, dhe pakënaqësi në punonjësit», ai nuk zgjatet mbi arsyet pse këto investime janë bërë në një mënyrë të tillë, pse këto kanë krijuar pakënaqësi, cilat janë arsyet ekonomike, politike dhe organizative që kanë drejtuar këto investime në këto rrugë, që kanë sjellë në vend të të mirave të këqijat. Natyrisht këto nuk mund të thuhet, pse pastaj del në shesh vetë natyra kapitaliste e këtyre investimeve, del në shesh varësia ekonomike jugosllave nga kapitali monopolist e skllavërues amerikan, që dominon në investimet kapitale në Jugosllavi. Këto investime nuk drejtohen nga interesat e popujve të Jugosllavisë, por nga interesat e kapitalit të huaj, i gërshetuar me interesat e klasës së re kapitaliste jugosllave. Prandaj kjo situatë fshihet me shumë fjalë dhe arsye boshe, që ekzistojnë në praktikën e punës. Ato që numërojnë ti-

tistët, s'janë kryesoret. Ato janë rrjedhimi i arsyeve kryesore që titistët i fshehin.

Titistët, që e trumbetojnë vetadministrimin si fjalën e fundit, nuk mungojnë gjoja të ankohen se «sistemi i tyre i shërbimeve shtetërore» ka një pozitë «të privilegjuar mbi punëtorët».

Kjo është aqik dhe këtu qëndron demagogjia e vetadministrimit dhe esenca e tij kapitaliste. Klasa e re e administratës po mbahet në kurriz të punëtorëve. Titoja këtë gjë kryesore e karakterizon si një «të metë të përkohshme», por kjo është esenca, kryesorja. Natyrisht një sistem i tillë kapitalist s'ka se si të mos nxitë nacionalizmin, shovinizmin, grindjet dhe kontradiktat në mes republikave dhe të mos vërë në rrezik edhe vetë sistemin federativ.

Titoja, në raportin e tij, vë në dukje këtë rrezik të madh të dezintegritimit, dhe me parulla gjoja socialiste përpiqet të flasë për integrimin socialist, me një fjalë për nënshtrimin e republikave të ndryshme nën thundrën e kapitalistëve. Por Titoja nuk mund të mos ngrinte çështjen e shovinizmit serbomad (se kjo është një plagë e shëmtuar), dhe të asimilimit të kombësive «të vogla». Shqetësimi titist për shkak të rrezikshmërisë së interesave kombëtarë (kupto: të kapitalit të madh jugosllav) është i madh.

Rezultatet ekonomike të këqija janë gjylet e rënda në këmbët e titistëve. Të duash t'i fshehësh ato, s'i fsheh dot. Çmimet ngrihen, mungesa sa të duash në tregje, kualiteti përtokë, pakënaqësia sheshit.

Por, në fund të fundit, klika titiste nuk mund të marrë asnjë masë radikale, pse ekonomia e tyre kapi-

taliste s'ka rrugëdalje tjetër, veç anarkisë, varësisë nga koniunkturat dhe ndihmat e kapitalit të huaj.

Titoja e tregoi paaftësinë e klikës për zgjidhjen e problemeve ekonomike edhe me vetë përmbajtjen dhe orientimin e gjithë kongresit. Kongresi i tyre kishte për synim të sqaronte gjoja politikisht dhe ideologjikisht organizimin dhe sukseset e vetadministrimit. Çështja tjetër ishte shpallja e vijës politike dhe e qëndrimeve ideologjike tradhtarë të titistëve për problemet botërore dhe të lëvizjes komuniste botërore.

Titoja bekoi OKB-në dhe «mendjet e shëndosha» të atyre që me politikën që ndoqën penguan konfliktet. Këtu ai e pati fjalën për Hrushovin dhe Kenedin dhe theksoi se procesi i polarizimit të forcave të paqes e të luftës, po shkon përpara. Natyrisht Kina, ne dhe «të tërbuarit» jemi forcat e luftës.

Problemin e paqes dhe të çarmatimit Titoja, sigurisht, e trajtoi sipas dëshirës së imperializmit amerikan, domethënë sipas tij duhet më parë të zhduket prapambetja e botës, jo me revolucion, por me evolucion (këtë Titoja e shpjegoi qartë), pastaj ose njëkohësisht duhet të «demokratizohen marrëdhëniet ndërkombëtare». Në ç'mënyrë, dihet: Kyçi titist i të gjitha këtyre të «mirave që do të vijnë», qëndron në «ndarjen ndërkombëtare të punës», në «ndihmat nga vendet e zhvilluara», me fjalë të tjera, në lëmoshat amerikane.

Politika e «mosangazhimit» titist, natyrisht u bë çështje e një tirade të gjatë në raport, por në realitet, kjo politikë e titistëve, ose më mirë veçanërisht influenca e tyre në këtë drejtim, ka pësuar disfatë. Në qoftë se vendet «e paangazhuara» bisedojnë me të, ose mbajnë

disa herë qëndrime të njëjta, kjo bëhet për arsye se prapa Titos ato shohin amerikanët.

Në çështjet ideologjike Titoja, për t'u dhënë zemër shokëve të tij, deklaroi se «dogmatizmi stalinist po likuidohet», megjithëse as ai nuk e beson atë që thotë.

Duke mbrojtur të gjithë renegatët e marksizmit, duke ngritur në qiell rolin e LKJ dhe programin e saj, Titoja në fjalimin e tij vë në dukje se po zhduket «kufiri dogmatik» i ndërtimit të socializmit. Për ta ilustruar këtë, u thirrën apostafat në kongres partitë socialdemokrate e socialiste nga të katër anët e botës.

Titoja e ndien rrezikun e demaskimit që i bëjmë në teorive revizioniste, prandaj sulmoi Kinën direkt dhe në indirekt e u predikoi edhe revizionistëve të tjerë një luftë të vendosur e pa asnjë kompromis kundër «dogmatikëve».

Kurse raporti i Kardelit, duke u bazuar dhe duke pasqyruar vijën e Titos, trajton dhe teorizon çështjen e vetadministrimit titist.

VLORE, E DIEL
10 JANAR 1965

Na erdhën për vizitë shokët drejtues të rrethit të Vlorës me të cilët biseduam për problemet e stinës. Ishin optimistë. Kryetari i komitetit ekzekutiv kishte shkuar në Tiranë për të biseduar për çështjen që shumë qytetarë vlonjatë janë të gatshëm të venë të vendosen e të punojnë në qendra pune, kudo që të jetë nevoja. Siç thanë ata, në rrethin e Vlorës gjendja në këtë drejtim është shumë pozitive, se kështu pengohet largimi i forcave të punës nga fshati. Duhet ta ndjekim me kujdes këtë dëshirë të qytetarëve, që nuk na paraqitet kudo.

Në mbrëmje shkuam në estradë, ku pamë disa skeçe me temë nga aktualiteti. Nuk ishin përgatitur keq. Në përgjithësi aktorët i interpretonin mirë skeçet, po akoma më shumë duhet bërë për rritjen e mjeshtërisë së aktorit, gjë në të cilën ndikon si përgatitja me kujdes e materialit ashtu edhe tema e tij. Shokët drejtues të rrethit na thanë se interesohen për këto probleme, por nuk besoj të jetë plotësisht kështu. Tash në çdo qytet ka shumë kuadro të lartë, ka shkrimtarë të talen-

tuar dhe të gjithë bashkë më shumë duhet të interesohen për zhvillimin e estradës. Edhe disa nga këngëtarët mund të këndojnë më mirë, po të bëjnë përpjekje për t'u kualifikuar, po të tregojnë kujdes më shumë për regjimin e tyre dhe të specializohen në disa lloj këngësh. Mirëpo, me sa duket nuk ka asnjë shije dhe kujdes për këtë. Ata këndojnë në çdo zhanër muzikor dhe vetvetiu të gjitha nuk mund t'i këndojnë mirë.

Raporti i Eduard Kardelit mbajtur në Kongresin e 8-të të LKJ është një raport tipik i errët revizionist, sikur të ishte shkruar apostafat nga një filozof kufomë i Internacionales së Dytë. Ky raport duhej të shërben-te gjoja për t'u sqaruar komunistëve jugosllavë dhe popujve të Jugosllavisë teorinë dhe praktikën e vetadministrimit, por në realitet ai është aq konfuz, aq i errët, aq i pakuptueshëm, saqë jo vetëm njerëzit e thjeshtë nuk shohin veçse tym, por edhe ata që kanë dijeni mbi ekonominë politike duhet të lodhen fort për të nxjerrë qëllimin dhe mënyrën e veprimit të revizionistëve titistë në vendosjen dhe në zhvillimin e kapitalizmit në Jugosllavi. Zaten, qëllimi i titistëve konsiston në forcimin e kapitalizmit në vendin e tyre, duke ua errësuar mendjen shtetasve të tyre me formulime «teorike» konfuze, gjoja origjinale, duke shpjeguar ose më mirë duke u përpjekur të shpjegojnë disa fenomene tipike kapitaliste me formulën e rrjedhimeve të vetadministrimit. Shumë disfata në ekonomi përpiqen t'i justifikojnë gjoja me arsyen e moskuptimit sa duhet të këtij sistemi origjinal dhe të ri të «ndërtimit të socializmit», ose

të moszbatimit të tij si duhet në jetë. Shumë fenomene të tjera të këqija, që janë rrjedhim logjik i sistemit anarkist kapitalist, Kardeli i lë pa përgjigje.

Në qendër të raportit Kardeli vë dënimin e drejtimit të ekonomisë së centralizuar, gjoja se kjo ka sjellë shumë të këqija, dhe, nga ana tjetër, predikon autonominë në planifikim, në investime, në shkallë republike dhe deri në ndërmarrje. Dhe këtë e «arsyeton» duke thënë se drejtimi i centralizuar e i planifikuar i ekonomisë nga shteti e shndërron njeriun në «punëtor me mëditje të aparatit shtetëror». Rreth kësaj teze, Kardeli, siç e ka zakon, thur një barrë teorish abstrakte, duke mos thënë asgjë konkrete se ç'duhet bërë.

Gjoja për të nxitur rendimentin e punës mbi bazën e vetadministrimit, kërkohet që punonjësit e çdo ndërmarrjeje të kenë mundësi «më të gjera» për të vepruar në mënyrë «të pavarur». Dhe për këtë Kardeli këshillon që të hiqet dorë edhe nga akumulimi i centralizuar dhe pjesa më e madhe e tij «të lihet», në duart e punonjësve, për ta «përdorur» ata drejtpërdrejt vetë ku ta shohin dhe kur ta shohin të nevojshme, për «zgjerimin e prodhimit».

E gjithë kjo teori ekonomike dhe shumë të tjera që përmenden në raportin antimarksist e të errët të Kardelit kanë për qëllim forcimin e bankave të kreditit, krijimin dhe mahjen me labirintin dhe manipulimin e fondeve të kapitalistëve të rinj, nxitjen e spekulimit në tregun e jashtëm dhe të brendshëm në kurriz të masave, varfërimin dhe zhdukjen ose gëlltitjen e ndërmarrjeve të vogla nga të mëdhatë, shtimin e të papunëve dhe eksportimin e krahut të punës jashtë, krijimin

e trusteve të mëdha të kapitalistëve të mëdhenj, të bashkuar apo veças, deri në rang republike, për t'u kurozuar në rang federate.

Brenda kësaj teorie ekonomike antimarksiste po zhvillohen të gjitha fenomenet e krizave kapitaliste, ngritja e çmimeve, varfërimi i masave, zhdukja e prodhimeve, akaparimi dhe spekulimi i tyre, dhe as që merret mendimi për masa efikase. Me një fjalë Kardeli, me teoritë e tij të tjerrura në formulime të errëta, ka marrë përsipër të shpjegojë vetadministrimin punëtor, për të fshehur disfatën dhe për ta bërë akoma më të zezë të ardhmen e popujve të Jugosllavisë.

Efektet e këtyre «teorive» antimarksiste, që as nuk shpjegojnë dhe as zgjidhin gjë, u dukën me të mbaruar kongresi. Filluan të ngrihen dhe vazhdojnë të ngrihen çmimet e të gjitha mallrave në treg, dhe jo pak, por me përqindje të madhe.

Atëherë çfarë zgjidhi, çfarë shpjegoi dhe çfarë ndreqi kongresi titist?

Ai vazhdon të shkallmojë Jugosllavinë. Popujt e Jugosllavisë po e shikojnë me sy dhe i provojnë në kurriz konsekuencat e tij. Prandaj kongresi ra në batak. Po ashtu në arenën ndërkombëtare s'po merren me ato që u thanë në Kongresin e 8-të titist, sepse druhen se mos komprometohen, disa si të djathtë, disa sepse nuk duan të zbulojnë fijet që i lidhin me këtë agjenturë të kapitalizmit e të revizionizmit ndërkombëtar.

VLORE, E HËNË
11 JANAR 1965

19-vjetori i festës së republikës ma mbushi zemrën me gëzim të papërshkruar. Sa vite kalojnë, aq më shumë ndiejmë madhësitinë, forcën dhe bukurinë e republikës sonë. Në jetën e popullit tonë, në përparimin e tij shohim forcën krijuese të ideve të pavdekshme marksiste-leniniste që frymëzojnë dhe udhëheqin Partinë, që mobilizojnë energjitë krijuese të masave.

Jam i lumtur sot, që edhe unë kam kontribuar në mënyrë modeste në këtë vepër të madhe dhe të pavdekshme të popullit e të Partisë.

Për rolin e Lidhjes së Komunistëve dhe gjendjen e saj në Kongresin e 8-të foli edhe shefi i policisë së fshehtë jugosllave, Aleksandër Rankoviçi.

Rankoviçi drejton «partinë», pra «partia» nën drejtimin e policisë. Ky është qëndrimi i pandryshuar i renegatëve jugosllavë. Dhe kjo del hapur nga raporti i Rankoviçit kur shpjegon gjendjen dhe pikëpamjet që zhvillohen në gjirin e LKJ. Fijet e vërteta bazë të Lidhjes i drejton UDB-ja. Të gjitha të tjerat, e kam fjalën

për normat bazë organizative, morale, politike, ato nuk ekzistojnë. LKJ është një front dhe kjo është vija e vjetër e tradhtarëve titistë drejt likuidimit të partisë dhe vendosjes së diktaturës së klikës titiste dhe të UDB-së.

Kështu pikëpamjet jokomuniste që zhvillohen në frontin e LKJ janë pasqyruar në gërryerjen dhe anarkinë që mbretëron edhe në vetadministrimin. Nën maskën e anëtarit të Lidhjes bëhen vjedhje e të gjitha të këqijat e tjera: arroganca, hatëret, mendjemadhësia, shtypja e të dobëtimit etj. Qëndrimet burokratike kanë zëvendësuar çdo gjë në Lidhje dhe s'ka se si të jetë ndryshe.

Deri aty ka ardhur puna saqë në gjirin e LKJ shprehen hapur idetë e zhdukjes edhe të centralizmit formal të demokracisë dhe kërkohet e drejta e legalizimit të pakicës.

Në LKJ kanë lindur tarafe, shoqëri të mbyllura, qarqe nacionaliste, shoviniste etj. Brenda në LKJ është e pamundur që të mos ketë elementë të mirë, por në një ilegalitet shumë të rëndë.

Të gjitha këtyre të këqijave Rankoviçi u përpoq t'u gjejë arsyetimin «teorik», se gjoja pranohen pak punëtorë.

Por fakt është se Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë s'është një parti komuniste, por një front antimarksisht nën drejtimin e UDB-së; vetë Rankoviçi thotë në raport se që nga viti 1958 deri në vitin 1963 janë përjashtuar 96 613 punëtorë nga Lidhja, që do të thotë 48 për qind të përjashtuar. Pra ajo tani është një

grupim borgjezësh, intelektualësh, kulakësh, një grupim antipunëtor.

Rankoviçi padashur zbuloi kalbësimin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

VLORE, E MARTE

12 JANAR 1965

Koha është e bukur si në pranverë. Dielli ndrin dhe nuk fryn erë. Vlora është me të vërtetë një vend i mrekullueshëm, sidomos në dimër, ku gjetkë bie borë, shi, fryn erë e bën ftohtë. Çdo gjë ndrin sot, deti, portokallet, trëndafilat. Plantacionet me portokalle janë prush të shëndetshme. Bëmë një shëtitje të gjatë me këmbë, pastaj u ulëm nën ullinjtë. Ishim bashkë me familjen e shokut Hysni. Vajtëm te shtëpia nr. 2 në verandë mbi det. Përpara në horizont Sazani dukej qartë si në pëllëmbë të dorës, si rojë besnike e Vlorës historike, e gjirit të saj, e jetës së popullit.

VLORE, E MËRKURË

13 JANAR 1965

Erdhën Hysniu, Vitoja dhe Behari. Mbaruam punë, pastaj hëngrëm drekë së toku.

Pasdreke më vizituan shokët drejtues të Vlorës dhe biseduam për probleme të kulturës; u thashë të tregojnë më shumë kujdes për qytetin e ky të mbahet më mirë.

Është e domosdoshme dhe detyrë jona marksiste-leniniste të demaskojmë edhe një herë teorinë titiste të vetadministrimit, rreth së cilës u fol përsëri me mburrje e për qëllime propagandistike në Kongresin e 8-të të LKJ.

Mbi bazën e shënimeve që kam mbajtur këto ditë, sot fillova të hartoj skemën dhe të shkruaj teza e mendime të zgjeruara për një artikull¹. Për këtë do të bisedoj edhe me shokun Ramiz.

1. «Natyra kapitaliste e vetadministrimit punëtor jugosllav në dritën e Kongresit të 8-të të LKJ». Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 1.

Diskutuam dhe përfunduam letrën që do t'u dorëzojmë vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës, në lidhje me ftesën që na është dërguar për të marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit Politik që kanë vendosur të bëjnë më 19 janar 1965.

Me këtë letër ne i vëmë revizionistët me shpatulla në mur nëpërmjet argumentesh ligjore të padiskutueshme. Sidomos akuzojmë qeverinë sovjetike për krimet që hrushovianët kanë bërë kundër nesh. Ne evitojmë në letër të akuzojmë drejtpërdrejt të tjerët, megjithëse indirekt i bëjmë përgjegjës për shumë gjëra. Rëndësi ka që dokumenti të lexohet në mbledhje, në rast të kundërt, u lëmë të kuptohet se do ta botojmë, po ta gjejmë të arsyeshme. Sigurisht kjo do t'i bëjë të mendohen mirë.

VLORE, E ENJTE

14 JANAR 1965

Vajtëm me Hysniun në Treport. Biseduam me komandantët dhe kuadrot e tjerë drejtues të repartit e të kufirit.

Reparti ishte në stërvitje. Pamë pozicionet e zjarrit. Mbrojtje e fortë.

E PREMTE

15 JANAR 1965

U kthyem në Tiranë, kaluam pushime jo të këqija. Koha është e bukur, por në Tiranë bën ftohtë.

E SHTUNË
16 JANAR 1965

Fillova përsëri punën në zyrë.

Pasi lexova raportin vjetor të Ministrisë së Mbrojtjes hodha në letër disa teza që kanë të bëjnë me organizimin e ri në pikat e hapjes, ku, bashkë me punën për të përshtatur sa më mirë edukimin dhe instruktimin profesional të efektivit, duhen bërë përpjekje që të bëhet e qartë ideja se të gjitha pikat e hapjes të lidhura organikisht me njëra-tjetrën përbëjnë një trup të vetëm, të cilat duhet të veprojnë të koordinuara edhe më mirë se më parë. Theksova se fryma e unitetit të tyre të plotë e të çeliktë tash jo vetëm duhet të ruhet në radhët e oficerëve e të ushtarëve, por edhe të forcohet më shumë.

Do të jap porosi që me këtë rast të rishikohet plani i stërvitjes dhe i edukimit të efektivit në pikat e hapjes, të rishikohet gjithashtu organizimi dhe puna e Partisë në këto pika, si edhe puna e rinisë. Do të prek me këtë rast disa probleme të tjera që kanë të bëjnë me punën e Partisë në ushtri, me kushtet e jetesës së oficerëve në pikat e hapjes etj., si dhe për t'u dërguar

një letër gjithë organizatave të Partisë për të mbajtur ngritur domosdoshmërinë e zbatimit të detyrave dhe të rregulloreve të ushtrisë.

Vajtëm uruam shokun Manush për 46-vjetorin e lindjes.

Pamë filmin «Helena e Trojës». Gjë e modernizuar. Më mirë ishin realizuar skenat e luftimeve.

Rumunët na dorëzuan një kopje të letrës që i kanë drejtuar KQ të PK të BS. Ky gjest është pozitiv. Letra ka lidhje me mbledhjen e «komisionit të partive komuniste dhe punëtore» që propozojnë sovjetikët të mbahet në mars të këtij viti për të përgatitur «mbledhjen e përgjithshme të partive komuniste e punëtore të botës». Rumunët, siç del nga letra e tyre, nuk pranojnë të venë atje, bile propozojnë të lihet fare ideja e mbledhjes në fjalë dhe «të bëhen përgatitje të shumta, shumëpalëshe dhe me durim të sheshohen disa divergjenca, me qëllim që të përgatitet terreni për një mbledhje, për të cilën të jenë dakord të gjitha partitë». Edhe kjo është pozitive nga ana e rumunëve, pavarësisht se në këtë qëndrim ata kanë arritur të nisur nga pozita më shumë subjektive e centriste. Por, sidoqoftë, kundërshtimi i rumunëve ndaj sovjetikëve ka anë pozitive. Me sa duket, ata kanë arritur t'i kuptojnë, të mos i pranojnë dhe t'i dënojnë diktatin, ndërhyrjet dhe metodat antidemokratike dhe antisocialiste të sovjetikëve.

Rumunët, në letrën e tyre, natyrisht, nuk pohojnë faktin se edhe ata kanë qenë solidarë në rrugë antimarxiste me sovjetikët kundër nesh, por vetëm sa përcaktojnë datën kur ata filluan t'u bëjnë sovjetikëve vërejtje dhe të desolidarizohen me ta — që nga marsi i 1963-shit. Këtë evolucion të rumunëve ne e kemi konstatuar, por tash ai po përcaktohet më qartë. Natyrisht që nga kjo datë e këtej rrodhën shumë ngjarje. N. Hrushovi kreu veprime e bëri presione të shëmtuara kundër rumunëve dhe shkaktoi acarimin që dihet.

Me letrën e tyre rumunët tregohen si «këshillues» të rrugës «së mirë» për të zhdukur divergjencat dhe për t'ia arritur unitetit. Por krejt e shtrembër dhe e dënueshme është ajo që, në një faqe të tërë, ata përmendin pa adresë «konsequencat dhe format e polemikës», pra na futin të tërë në një thes dhe na quajnë të gjithë fajtorë. Në këtë mënyrë ata injorojnë krejtësisht çështjet e mëdha e vendimtare që shkaktuan polemikën, — deviacionin revizionist, tradhtinë e revizionistëve modernë e, në radhë të parë, të atyre hrushovianë, politikën e tyre tradhtarë në të gjitha drejtimet.

Veprimet që KQ i PP të Rumanisë i dënon pa adresë ose me adresë, janë rezultate logjike të tradhtisë së revizionistëve në ideologji, në politikë e në organizim. Por këtë aspekt themelor rumunët e lënë në heshtje. Kjo tregon se ata qëndrojnë në mes të rrugës, janë në pozita centriste revizioniste, oportuniste. Rumunët janë subjektivistë dhe kanë arritur në gjysmë të rrugës vetëm nga fakti se N. Hrushovi u shkeli në kallon e këmbës. Nga letra e tyre del se ata kanë shikuar mjaft të këqija të hrushovianëve, por nuk i kanë parë të gjitha, nuk

kanë parë thelbin dhe kryesoren — rrezikshmërinë ndërkombëtare të revizionizmit modern.

Prandaj rumunët janë për shuarjen e polemikës dhe në vend të saj predikojnë «paqen», «mirëkuptimin», «durimin» etj. Por në qëndrimin e tyre revolucionarët nuk ekskludojnë aspak as durimin, as mirëkuptimin, as diskutimin, vetëm se këto duhen bërë në frymën marksiste-leniniste.

Në këtë letër, interesante janë qëndrimet e rumunëve kundër disa pikëpamjeve të revizionistëve, të cilat ne i kishim parashikuar dhe denoncuar me kohë, por që vetë rumunët tani i vënë në dukje dhe dëshirojnë të desolidarizohen me ta.

a) Ideja që ka mbretëruar ndër revizionistët, sipas së cilës, në rast se ne nuk marrim pjesë në mbledhje, do të «përjashtoheshim» nga lëvizja komuniste dhe kjo do të bëhej nën formulën e njohur se «e kishim vënë veten jashtë lëvizjes komuniste botërore».

b) Ideja e papohuar dhe djallëzore e revizionistëve që komisionit përgatitor të mbledhjes (ku nuk do të ishim ne, pse nuk do të venim) t'i ngarkohej detyra që, në mënyrë kolektive ose me grupe, të vinte «të bisedonte me ne». Këto «bisedime» u duhen revizionistëve për t'i shpëtuar ballafaqimit të vërtetë dhe për të treguar që «ja, bëmë shumë përpjekje, por s'na dëgjuan».

c) Rumunët (mundet dhe kinezët) lënë të kuptohet se vajtja e tyre në Moskë për festë¹ kishte për qëllim

1. Është fjala për festimet e 47-vjetorit të Revolucionit të Tetorit në nëntor 1964, kur në Moskë shkoi edhe një delegacion i PK të Kinës, i kryesuar nga Çu En Lai.

të bëheshin, përveç të tjerash, edhe përpjekje të përbashkëta që të shtyhej ose të lihej mbledhja e marsit dhe ky vendim të merrej «kolegjialisht».

c) Rumunët shënojnë se mbledhjet festive të organizuara për nder të Revolucionit të Tetorit në Moskë, në Pekin, në Berlin dhe në Bukuresht qenë «gjëra të mira, shenja afrimi» etj. Kështu me siguri kanë menduar dhe kinezët, por nuk doli gjë.

d) Rumunët vënë në dukje se «polemika është ulur, është zbutur» dhe për këtë nuk e fshehin dot gëzimin. Me këtë ata indirekt përgëzojnë kinezët e sovjetikët dhe, natyrisht, indirekt u urojnë të vazhdojnë «ta zbutin», që më në fund të arrihet në «pajtim». Zaten për gjithë revizionistët, këtu qëndron aksi i gjithë planit të tyre, këtu fle lepuri.

dh) Por argumenti «më i madh» për «të na bindur» ne se me udhëheqësit e rinj sovjetikë nuk duhet «t'i humbasim shpresat dhe duhet të kemi durim», «se ata s'mund të veprojnë shpejt dhe si duam ne» është ky «fakt» që shënohet në letër: pasi delegacioni rumun mori dijeni nga udhëheqësit sovjetikë se N. Hrushovi u hoq ngaqë kishte gabime me karakter të brendshëm dhe pasi delegacioni rumun u tha sovjetikëve se Hrushovi kishte gabuar edhe në politikën e jashtme, Brezhnjevi na paska thënë se «çështjet ndërkombëtare, që preku delegacioni rumun, janë një nga trashëgimet më të rënda të lëna nga N. Hrushovi»!

Këtë «përkëdhelje» të Brezhnjevit rumunët e quajnë «shenjë të madhe» dhe me të u drejtohen në radhë të parë kinezëve dhe pastaj edhe neve që «të kemi shpresa».

Por sa dokrra e sa gënjeshtra kemi dëgjuar ne nga sovjetikët dhe nga revizionistët modernë! Gjer në grykë jemi me to, ndaj s'na gënjejnë dot as Brezhnjevi e as rumunët. Vetëm faktet, veprat na bindin, sepse fjalët e revizionistëve i merr era dhe gjuha e tyre dri-dhet e përdridhet nga të duash e si të duash.

E DIEL
17 JANAR 1965

Sovjetikët kanë nxitur dhe organizuar në Havanë mbledhjen e disa partive revizioniste të Amerikës Latine kundër Partisë Komuniste të Kinës. Kjo mbledhje doli me një rezolutë revizioniste dhe caktoi një delegacion nën kryesinë e Rodrigues (blasrokist-eskalantist) dhe Arismendit si sekretar, për të shkuar në Moskë, natyrisht, që të legalizohet puna e bërë. Në dukje ai shkoi në Moskë «për të shprehur pikëpamjet e mbledhjes», me të cilat revizionistët sovjetikë, natyrisht, ishin plotësisht dakord. Pastaj këta kaluan në Pekin dhe kërkuan që kinezët të pushonin polemikën, të ndalonin dhënien e ndihmës forcave marksiste-leniniste që po organizohen dhe të venë në mbledhjen që duan të bëjnë revizionistët. Kinezët u dhanë një përgjigje të drejtë, të vendosur dhe i cilësuan revizionistë.

Por interesant janë dy gjëra:

1) Në mbledhjen që kanë bërë në Havanë, Kastroja ka mbajtur një fjalim, ku, në mes të tjerash, ka thënë se bën «autokritikë për ndihmën që u ka dhënë të majtëve (kupto: marksistë-leninistëve) në Amerikën Latine dhe se këtej e tutje nuk do t'i ndihmojë më».

2) Me emrin e Kastros ata kanë dashur të bëjnë presion dhe provokacion njëkohësisht mbi kinezët. Këta, dhe posaçërisht Maoja, u kanë thënë se s'janë dakord me pikëpamjet e Kastros, se do të veprojnë në të kundërtën e tij, se nuk janë dakord me deklaratën e Kastro-Hrushovit dhe do të shohin nëse Kastroja do të qëndrojë në deklaratën e tij të Havanës.

E HËNË
18 JANAR 1965

Kishim mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor. Midis të tjerave fola për të drejtat dhe detyrat e këshillit popullor të fshatit dhe për funksionimin e tij. Vura në dukje se kryetarë të këshillave popullorë duhet të zgjidhen njerëz të aftë, që të jenë në gjendje të vënë në lëvizje gjithë këshillin popullor të fshatit për të gjitha problemet që u dalin.

Nuk jam dhe nuk rashë dakord me mendimin që u shpreh për t'i bërë kryetarët e këshillit popullor të fshatit funksionarë me pagesë, të shkëputur nga punët e tjera¹.

Lidhur me raportin vjetor të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, që shqyrtuam sot me shokët, bëra edhe unë disa vërejtje për ta çuar punën më përpara.

Lexova raportin vjetor për veprimtarinë e organeve të Sigurimit të Shtetit, ku, krahas sukseseve, del

1. Shënimet e mbajtura nga ky diskutim gjenden në Arkivin Qendror të Partisë.

qartë se në to ka shumë dobësi, të meta e mungesa në punë, për ndreqjen e të cilave kam dhënë porosi të merren masat përkatëse, me qëllim që punën ta çojmë më përpara. Të kemi parasysh sidomos luftën kundër familjaritetit midis kuadrove të këtij sektori, frymës së repartit, si dhe çështjen e thellimit në veprime, për respektimin e ligjshmërisë dhe zbatimin me rreptësi të platformës, si dhe për përpjekjet që duhen bërë nga punonjësit e këtyre organeve për përgatitjen speciale të tyre politike, ideologjike, kulturore e profesionale, drejtime këto që duhen mbajtur mirë parasysh, pse puna e bërë deri tash nga ana e tyre është e pamjaftueshme.

**E MARTË
19 JANAR 1965**

Në mbledhjen e Byrosë Politike që bëmë sot hodha disa mendime për të diskutuar, nga koha në kohë, edhe probleme shoqërore. Të tilla janë, për shembull, çështje të familjes, çështje të marrëdhënieve djem-vajza, çështje të edukatës qytetare etj.

Probleme të karakterit shoqëror kemi shqyrtuar edhe herë të tjera, diskutojnë edhe shokët në rrethe, por më duket se shpeshherë këtyre u kalohet përcipitazi. Ka shokë drejtues, të cilët, kur flasin për çështje shoqërore, u kanë mbetur në majë të gjuhës formula shabllone. Kur shkon në rrethe dhe bisedon me sekretarë partie, të flasin si u realizua plani, dinë përmendsh shifra ekonomike, por për çështje shoqërore janë shterpë, nuk të shtrojnë asgjë, nuk të thonë asnjë konkluzion.

Theksova me forcë se problemet e edukimit shoqëror kanë rëndësi të madhe, prandaj propozova edhe tema konkrete për të studiuar e diskutuar si ne këtu në qendër, ashtu edhe shokët e Partisë në rrethe. Këta do t'i ndihmojmë duke u dhënë edhe teza, që të orientohen e të bëjnë studime për probleme shoqërore. Do t'i thë-

rresim edhe këtu të na raportojnë për punën që po bëjnë.

Gjithashtu mbledhja e Byrosë Politike diskutoi edhe probleme të tjera dhe vendosi për masat e mëtejshme që duhen marrë për forcimin e punës në ushtri dhe në Sigurimin e Shtetit. Në të dy këta sektorë të rëndësishëm Partia punon mirë. Gjendja moralo-politike është shumë e shëndoshë në ushtrinë tonë, megjithatë vazhdimisht e me vigjilencë duhet punuar në këtë drejtim.

Vendosëm përfundimisht për kërkesat ndaj Kinës, lidhur me pesëvjeçarin tonë të katërt. Të shohim si do të na përgjigjet.

Shqyrtuam edhe projektplanin e çështjeve që do t'u paraqiten për analizë Plenumit të Komitetit Qendror, Byrosë Politike dhe Sekretariatit gjatë vitit 1965.

E MËRKURË
20 JANAR 1965

Pata një takim me shokun Hun Tao¹, sekretar i përgjithshëm i Partisë Komuniste të Malajës². Biseduam për zemërsisht dhe ishim dakord me pikëpamjet e njëri-tjetrit.

Shoku malajzian ka disa javë te ne. Ai vizitoi shumë qytete, qendra pune dhe kooperativa, bisedoi me shokë në bazë dhe me Hysniun. Tha se ka mbetur tepër i kënaqur dhe ka mësuar shumë.

Është i dyti delegacion i Partisë Komuniste të Malajës që ka ardhur te ne. Delegacioni i parë ka qenë kryesuar nga shoku Musa, kryetar i Partisë Komuniste të Malajës, që erdhi në Kongresin e 4-t të Partisë sonë.

1. Pseudonim.

2. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 28, f. 396.

E ENJTE
21 JANAR 1965

Sot revizionistët modernë, që janë mbledhur në kryeqytetin e Polonisë në Komitetin Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, shpallën mbarimin e punimeve. Në fakt, punimet, siç duket, zgjatën vetëm një ditë, domethënë më 19, se më 20 e mbyllën pazarin. Lexoi secili me radhë raportin që kishte përgatitur në shtëpi, raporte të tëra këto as mish, as peshk, pse asgjë konkrete nuk ngrinin, nuk lëndonin kurrkënd, asnjë interes nuk preknin, pastaj lexoi edhe Greçkoja lajusin¹ e tij. Më në fund u këndua «deklarata» e përbashkët e përgatitur nga Andropovi e Grëmikoja dhe u pranua me «unanimitet». Përnjëherë, pas kësaj komedie formale, pjesëmarrësit morën trenat dhe avionët dhe u nisën për në vendet e tyre.

Komunikatën do ta botojnë sigurisht sot ose nesër dhe menjëherë pas botimit të saj do të fillojë *la guerre en dentelles*², lufta... me artikuj «bombastikë», lufta...

1. Nga frëngjishtja — fjalim pompoz dhe i mërzitshëm.

2. Frëngjisht: lufta me dantella — kështu quhej lufta që bëhej në shekullin e 18-të nga oficerë të veshur me rroba të stolisura si në dasmë.

me fraza, kurse, nga ana tjetër, vazhdon konkretisht tradhtia dhe aleanca me imperialistët, që ecën përpara për të mirën e «paqes» dhe të «bashkekzistencës»!

Shpartallimi i të ashtuquajturit unitet midis revizionistëve modernë u ka krijuar sovjetikëve kokëçarje të shumta, prandaj këta bëjnë përpjekje që të gjejnë forma dhe metoda të reja për të ushtruar të paktën njëfarë influence dhe drejtimi mbi grupimet e ndryshme revizioniste, të cilat po bëhen në mënyrë të rrezikshme «independente».

Fakt është se Moska, e demaskuar dhe plot dështime në veprimet e saj revizioniste, po e humbet autoritetin dhe revizionistët e tjerë s'po e dëgjojnë më. Ata duan më shumë të dëgjojnë zërin e rublës tingëlluese sesa profkat e Brezhnjevëve. Ata duan të veprojnë dhe veprojnë «të lirë» deri në njëfarë shkalle shqetësuese; prandaj revizionistët sovjetikë, duan s'duan, po adoptojnë këshillat që Toliati ua la revizionistëve vasijet me «testament» dhe pikërisht krijimin e grupimeve të të ashtuquajturave parti komuniste dhe punëtore sipas interesave, zonave, kontinenteve etj.

Dihet se Toliati kishte tendencë të shkëpuste krejt nga drejtimi sovjetik grupimet e vendeve kapitaliste dhe t'i lidhte këto kryesisht me Partinë Komuniste Italiane, të krijonte një bllok të vetëm «komunist» latino-amerikan, nën drejtimin e Partisë Komuniste Italiane kryesisht, si kundërpeshë e influencës sovjetike dhe si mjet për minimin e shpejtë të kampit të socializmit dhe të vetë doktrinës marksiste-leniniste.

Sigurisht, ky qëllim i Toliatit vazhdohet nga shokët e tij italianë, por revizionistët sovjetikë, të cilët veprojnë në vija të përgjithshme sipas këshillës së Toliatit, kërkojnë të mbajnë vetë drejtimin ose nëpërmjet asaj partie ose atyre njerëzve që janë besnikë të tyre e «të palëkundshëm».

Ky grupim po realizohet në Amerikën Latine nga sovjetikët dhe ndjek këto qëllime:

1) Unitet i klikave revizioniste të Amerikës Latine për mbështetje të revizionizmit modern e veçanërisht të politikës ndërkombëtare sovjetike, në afrim dhe në ujdi graduale me imperializmin amerikan.

2) Unitet lufte kundër Partisë Komuniste të Kinës, Partisë së Punës të Shqipërisë dhe partive që qëndrojnë në pozita të shëndosha.

3) Unitet lufte kundër partive të reja marksiste-leniniste dhe grupeve të majta që janë krijuar në Amerikën Latine.

Pra këtë grupim e patronon revizionizmi sovjetik dhe ky shtyn Kastron e Blas Rokën ta drejtojnë. Ky grupim, me veprimet e tij antimarksiste, regjionaliste, nacionaliste, puçiste, do të bëjë të falimentojë dhe të shpejtojë procesin e degjenerimit të klikave në fjalë dhe do të sjellë forcimin e forcave të reja revolucionare që po ngrihen. Në këtë terren sovjetikët do të ndeshen sigurisht me interesat e Partisë Komuniste Italiane dhe të Partisë Komuniste të Spanjës, të cilat do të kërkojnë dhe do të përpiqen të marrin drejtimin e këtij grupimi. Titistët kanë rolin e tyre specifik proamerikan, të përçarjes, të shpartallimit total të gjithë atyre.

Përpara kësaj situatë që po konturohet rol të rën-

dësishtëm merr lufta e marksistë-leninistëve në Amerikën Latine, krijimi i partive komuniste të reja me një vijë të qartë revolucionare, afrimi dhe lidhjet e shëndosha në mes tyre për t'i bërë ballë luftës, diversionit, grupimit revizionist dhe goditjeve të koordinuara imperialisto-revizioniste. Rol të rëndësishëm do të luajë edhe ndihma e përkrahja e organizuar ideologjike, politike, organizative që do t'u japim ne shokëve tanë që luftojnë në Amerikën Latine etj. Përpara organizimit të luftës nga ana e revizionistëve, ne duhet të organizojmë seriozisht luftën kundër tyre. Do të jetë një humbje për ne në rast se lufta jonë bëhet me hope, sporadike, e papërgatitur ose spontane sipas situatave që krijohen. Lufta jonë duhet të jetë e rregullt, jo me rënie, po me ngritje, me objektiva të caktuar për t'u arritur, një luftë me perspektivë dhe me plan pune.

Një grupim të tillë, por në forma të tjera, revizionistët sovjetikë po e realizojnë edhe në Afrikë dhe në Lindjen e Mesme. Këtu të gjitha partitë ndodhen në ilegalitet, ose janë shkrirë e shpartalluar krejt. Ky është rezultati i dëshiruar dhe i arritur i Hrushovit.

Nga këto parti ekzistojnë vetëm disa udhëheqës tradhtarë të tyre, që rrojnë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet ish-socialiste të Evropës, marrin rroga, bëjnë nga një deklaratë sa për formë kur u kërkohet nga sovjetikët dhe hiqen sikur kanë nën drejtim parti, kurse në fakt s'kanë asgjë, as edhe «privilegjin» të dinë ç'bëhet në vendet e tyre dhe çfarë intrigash bëjnë sovjetikët me klikat që sundojnë në ato vende. Këtë gjendje që kanë krijuar sovjetikët në këto parti, përpiqen jo vetëm ta mbajnë, por ta thellojnë. Në këto vende, pra,

nuk është çështja për të krijuar një grupim revizionistësh, sa për ndonjë deklaratë, se për këtë ata i kanë njerëzit në Moskë, por qëllimi i sovjetikëve është që komunistët t'i shpartallojnë, t'i nxjerrin nga ilegaliteti, t'i nënshtrojnë te klikat sunduese dhe me veprimet e tyre të mbështetin politikën zyrtare qeveritare sovjetike ndaj qeverive të këtyre vendeve.

Pra në këtë rast revizionistët sovjetikë synojnë:

1) Të likuidohen krejtësisht partitë komuniste e punëtoresh në kontinentin afrikan dhe në Lindjen e Mesme.

2) Komunistët të dalin në legalitet dhe të vihen në «rregull» me regjimin e vendit.

3) Komunistët të mbështetin politikën e qeverisë sovjetike në këto rajone.

4) Komunistët të jenë agjentë të udhëheqjes sovjetike për të luftuar marksizëm-leninizmin, krijimin e partive marksiste të reja në vendet e tyre.

5) Komunistët të luftojnë dhe të sabotojnë influencën e partive marksiste-leniniste në këto vende.

Natyrisht, në këto zona dhe në këto situata, neve na dalin detyra të mëdha për të ndihmuar shokët tanë marksistë-leninistë. Por që të ndërtojmë një metodë lufte efikase e të përshtatshme me këto situata specifike, edhe ne duhet të konsultohemi me njëri-tjetrin, të shkëmbejmë mendime, për të vazhduar me konsekuencë luftën tonë në mbrojtje të marksizëm-leninizmit.

Ne duhet të mendojmë për të gjetur taktika lufte të përshtatshme për të shkatërruar planin minues sovjetik, për të mëkëmbur, për të ndihmuar dhe për të forcuar partitë komuniste në këto rajone dhe për të

ruajtur e zhvilluar më tej marrëdhëniet tona miqësore me popujt dhe me qeveritë e këtyre vendeve. Kjo nuk është një punë e lehtë, por bëhet akoma më e rëndë në rast se ne veprojmë pa plan të koordinuar në mes nesh dhe shokëve tanë të mirë në këto vende, që rrojnë dhe luftojnë në ilegalitet të rëndë e në vështirësi të pa-numërta.

Revizionistët sovjetikë në Azi kanë tri qendra ku mbështeten dhe do të mbështeten fort: partinë e Danges, partinë e Sharkit dhe revizionistët japonezë. Këto tri qendra revizioniste kapitaliste duhet të luftohen nga komunistët e vërtetë dhe të likuidohen pa mëshirë dhe sa më parë, pse ka mundësi të mëdha.

Kurse në Evropë situata njihet, ajo është e vështirë, por inkurajuese. Lufta jonë do të krijojë këtu situata interesante e më të favorshme, pse revizionizmi në vetvete ka përçarje, gjë që krijon mundësi të mira për punën tonë.

E PREMTE

22 JANAR 1965

Kinezët botuan të plotë artikullin tonë me titullin: «Marksizëm-leninizmi revolucionar do të triumfojë në Evropën e mbarsur me revizionizëm»¹. Kjo është një shenjë e mirë.

Revizionistët botuan komunikatën e aprovuar në mbledhjen e tyre të Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës. Komunikata përfaqëson në të vërtetë vijën e tyre tradhtare, është krejtësisht bajate, pa kockë, pa personalitet. Asnjë ide, asnjë vendim konkret, asnjë qëndrim politik kundër politikës kaq kërcënuese të imperializmit amerikan dhe aleatëve të tij. Një politikë e tillë, shprehur në një komunikatë si kjo pa vlerë, ka çuditur edhe vetë imperialistët. Ata as formalisht nuk e prisnin këtë politikë të shprehur kaq përunjësisht, në një mënyrë kaq oportuniste. Pra, revizionistët po u thonë aleatëve të tyre, imperialistëve amerikanë, se nuk do t'u shkaktojnë asnjë kokëçarje dhe asnjë

1. Shih në këtë vëllim f. 9.

ndryshim nuk do t'u bëjnë qëllimeve dhe politikës së tyre «të bashkekzistencës paqësore». Mbledhja e Varshavës ishte kështu një mbledhje krejt formale, bile nga më formalet që kanë bërë revizionistët. Kuptohet pse kjo mbledhje vazhdoi vetëm një ditë dhe gati 3-4 orë «punë»: sa për të lexuar fjalimet dhe për të dalë me këtë deklaratë, që s'prek asgjë, që nuk prish asnjë plan, bile as të çdo grupi revizionist që vepron individualisht dhe bën një politikë të veçuar me imperializmin dhe me fuqitë e tjera kapitaliste. Kështu, komunikata e Varshavës u thotë amerikanëve se «ne jemi dakord për të mos bërë asgjë kundër jush, jemi dakord në qëndrimet tona, komunikata s'gënjen askënd, po ne duhet ta bëjmë për formë». Pra formalisht dhe konkretisht me këtë revizionistët i thonë botës se janë bërë shërbëtorët më vulgarë të imperializmit.

Komunikata, nga ana tjetër, vërteton pikëpamjet tona të drejta, prandaj është një sukses për ne. Letra që u drejtuam ne ishte një dritë e qartë përpara errësirës së komunikatës së tyre. Ajo i ka tronditur dhe i ka frikësuar revizionistët në strofkën e tradhtisë së tyre. Me tri-katër radhë ata na komunikuan se morën letrën tonë dhe se «varet nga Qeveria Shqiptare në merr apo nuk merr pjesë në mbledhjet e Varshavës». Kaq dhe asgjë më shumë. Kjo do të thotë që të dyja palët qëndrojnë në pozitat e tyre, ata mbi krimet, mbi tradhtinë, dhe ne në të drejtën. Revizionistët kanë frikë nga botimi i letrës sonë, pse kjo, përveç të tjerave, demaskon nulitetin e komunikatës së tyre.

Ne duhet të mendojmë ta botojmë letrën tonë dhe përgjigjen e tyre qesharake, domethënë të shoqërojmë

botimin e letrës me komunikatën e tyre. Duke i vënë krah për krah letrën tonë dhe komunikatën e tyre, njerëzit do të bëjnë krahasimin e pikëpamjeve dhe të qëndrimeve politike të të dyja palëve.

Por të lëmë një herë revizionistët të botojnë «jehonën» e tyre qesharake, pastaj të dalë botimi i letrës sonë, që do të bëjë një jehonë tronditëse për ta.

E SHTUNË
23 JANAR 1965

Organizimi i garave socialiste për realizimin e planit ka një rëndësi të veçantë. Sot e diskutuam këtë çështje në mbledhjen e Sekretariatit. U dhanë mendime se si t'i organizojmë garat këtë vit.

Në diskutimin tim unë u ndala sidomos për marrjen e zotimeve. A duhet të interesohet shteti për këto zotime? Natyrisht po, sepse zotimi është një plus mbi planin, por duhet parë nëse realizimi i zotimeve bëhet duke shfrytëzuar rezervat e brendshme apo në dëm të cilësisë. Këto ndiqen me llogari.

Bashkimet profesionale të interesohen jo vetëm për marrjen e zotimeve, por edhe për ndjekjen e propagandimit të tyre. Zotimet janë baza e propagandës për emulacionin, për nxitjen e punëtorëve, për mobilizimin e tyre në plotësimin e detyrave të planit.

Dje, më 22 janar, ambasadorit kinez iu dorëzua letra që i drejtojmë qeverisë kineze, për dërgimin e një delegacioni qeveritar. Ambasadori u shpreh se qeveria kineze e pret me gëzim vajtjen e delegacionit tonë në

Pekin. Ne duhet të përgatitim delegacionin që të jetë gati në shkurt.

Pashë filmin francez «Zherminal», sipas romanit të shkrimtarit francez, Emil Zola. Është realizuar mirë. Në fund të filmit minatori plak, përpara varrit të mbesës së tij, të vdekur në minierë, i thotë revolucionarit të ri, i cili, i frymëzuar nga idetë e Marksit dhe të Internacionales së Parë, i udhëhoqi minatorët në grevë: «Të faleminderit ty që na frymëzove me ato ide dhe na mësove si të luftojmë për të drejtat tona!»

Kjo ngjarje zhvillohet në vitin 1863, domethënë 100 e ca vjet më parë, kurse në Francë, akoma edhe sot vazhdon të sundojë kapitali dhe ëndrrat e minatorëve akoma nuk janë realizuar. Te ne, 20 vjet më parë, ato u bënë realitet në sajë të po këtyre ideve të Marksit e të Internacionales Komuniste që frymëzuan Partinë tonë të lavdishme, e cila e udhëhoqi popullin në luftë dhe në fitore.

Shqipëria, që disa e quajnë «të prapambetur», është shumë më përpara nga Franca «e përparuar», për sa i përket zhvillimit politik dhe shoqëror.

E DIEL
24 JANAR 1965

Koha është me re, por shi nuk bie. Bëra një shëtitje të gjatë për ndonjë orë, në parkun pas Universitetit e buzë liqenit. Rrugicat atje deri në njëfarë vendi janë asfaltuar. Pemët janë akoma të vogla. Si duket kanë mbjellë shumë, por pa kriter. Kriteri i vetëm, me sa duket është: mbill të mbjellim sa më shumë, të mos prishen fidanët dhe pemët të rriten e të bëjnë hije. Por qëllimi i ekzistencës dhe i zbulimit të parkut, mendoj se nuk është ky, ndryshe do të bëhej punë pa kulturë. Parku ka bukuritë e tij të veçanta, prandaj në disa qoshe duhet të mbillen disa lloj pemësh, në disa kodra të mbillen të tjera, diku duhen lule ose pemë ornamentale, disa skaje të mbeten të dëlira etj. Me një fjalë, ky park që kemi sot të lë përshtypjen e një parku primitiv, jo me shije e me kulturë. T'i këshillojmë shokët e Tiranës të kenë më shumë kujdes e të punojnë me më shumë kulturë.

E HËNË
25 JANAR 1965

Dje vdiq Uinston Çerçilli, burrë shteti shumë i shquar për kapitalizmin dhe imperializmin anglez.

Në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, Çerçilli ka qenë kryeministër i vendit të tij dhe si i tillë udhëhoqi me energji të madhe luftën e popullit anglez kundër nazizmit. Këtë ai u mundua, dhe deri diku edhe e shfrytëzoi, për të imponuar politikën e qarqeve kapitaliste e imperialiste angleze, në dëm të popujve të tjerë. Në mënyrë të veçantë, Çerçilli punoi me çdo mjet për të sabotuar luftën çlirimtare të popujve të vendeve të Evropës Lindore. Ai bëri çmos për të çarmatosur dhe për të shkatërruar ushtrinë demokratike greke deri në shuarjen e luftës çlirimtare të popullit grek. Titon dhe klikën e tij, Çerçilli i lidhi kokë e këmbë pas qerres së vet, në dëm të luftës e të fitoreve antifashiste të popujve të Jugosllavisë.

Çerçilli ishte një armik i egër i Bashkimit Sovjetik e i komunizmit. Megjithatë gjatë Luftës së Dytë Botërore iu desh të ulet në bisedime me Stalinin në tryezën e takimeve të tre aleatëve të mëdhenj në Teheran, Jaltë e Potsdam.

Stalinit, me gjithë taktin e mprehtësinë diplomatike që edhe Rusveldi e ka vlerësuar lart, i është dashur të ndeshej me Çerçillin e të luftonte me këmbëngulje kundër oreksit të tij të shfrenuar në shërbim të politikës së vjetër kapitalisto-imperialiste të borgjezisë së madhe angleze.

* Informatat e para që na vijnë për zhvillimin e mbledhjes së Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës vërtetojnë parashikimet tona. Në këtë mbledhje pati grindje, kontradikta të thella dhe mosmarrëveshje gati në të gjitha çështjet kryesore që u shtruan, ose, më mirë të themi, që duhej të shtroheshin. Komunikata që u botua, ashtu si mendonim, nuk shprehte asgjë konkrete. Por më e keqja për ata është ajo që as problemit që ishte në rendin e ditës dhe as atyre që mund t'i shtoheshin, nuk iu shkua dhe nuk mund t'u shkohej deri në fund, ashtu si duhet të bëjë një forum i tillë siç është Komiteti Politik Konsultativ i Traktatit të Varshavës. Pra, rendi i ditës vetëm sa u prek, në disa formulime të përgjithshme, që edhe për këto nuk kishte dhe nuk mund të kishte unanimitet.

Arsyeja kryesore e një mbledhjeje të tillë pa sukses është frika e përçarjes flagrante në mes revizionistëve, pse kontradiktat midis tyre janë të pakapërcyeshme. Kjo është shpata e Damokleut që u qëndron mbi krye...¹

1. Shih vazhdimin e këtyre shënimeve në librin: Enver Hoxha, «Superfuqitë», f. 149.

Ministria e Punëve të Jashtme duhet t'i ketë dorëzuar sot të ngarkuarit me punë të ambasadës polake përgjigjen e Qeverisë sonë për vendimin që mori dhe na dërgoi Komiteti Politik Konsultativ i Traktatit të Varshavës në lidhje me letrën e Qeverisë sonë. Vendimi i tyre ishte mospërfillës, i shkurtër dhe as datë, as numër nuk kishte. I porosita shokët që përgjigjja jonë drejtuar Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës të jetë po aq mospërfillëse, duke i bërë përgjegjës. Teksti të jetë më i shkurtër se vendimi i tyre.

Revizionistët vazhdojnë t'i bëjnë «bujë» komunikatës së tyre pa asnjë vlerë pas mbledhjes së Varshavës, duan ta vlerësojnë atë me zor. Nga java tjetër do të botojmë edhe ne materialin tonë.

Pashë filmin anglez «Titanik», që trajton historinë e transatlantikut që u mbyt pasi u godit nga ajsbergët në vitin 1912. Filmi është realizuar bukur dhe e paraqet mirë tragjedinë.

E PREMTE
29 JANAR 1965

Pashë filmin francez «Maria Oktobër», me subjekt nga lufta e rezistencës në Francë kundër nazizmit. Film psikologjik, i interpretuar dhe i realizuar mirë dhe me moral të shëndoshë. Mendoj se mund të shfaqet në popull, i cili me siguri do ta pëlqejë.

E SHITUNË
30 JANAR 1965

Sot u varros Uinston Çërçilli. Funeralin e tij e pamë në televizor.

Shumë dëme i ka bërë klasës punëtore ndërkombëtare dhe shumë vështirësi i ka nxjerrë socializmit veprimtaria e tij e madhe dhe e egër në krye të imperializmit anglez dhe botëror.

Bisedova me Ramizin që të japim të martën për botim dokumentet mbi mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës.

E DIEL
31 JANAR 1965

Sot Moska dhe Hanoi dhanë lajmin se Kosigini, në krye të një delegacioni sovjetik, do të vejë këto ditë në Vietnam. Gazetat e Vietnamit kanë filluar hosanatë për sovjetikët.

Sigurisht, sovjetikët kanë plane të këqija, drejtpërdrejt dhe indirekt për të fshehur veprimtarinë e tyre të ardhshme me revizionistët dhe me amerikanët.

Sot «Pravda» lajmëron bashkëpunimin në televizion të sovjetikëve me amerikanët dhe flet në mënyrë pozitive për një udhëtim të ardhshëm të udhëheqësve sovjetikë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tradhtia po vazhdon e po zgjerohet.

E HËNË
1 SHKURT 1965

Moska, sonte, në mënyrë lakonike njoftoi se Brezhnëvi dhe Podgorni, të ftuar nga Komiteti Qendror i Partisë së Punonjësve të Hungarisë, nga 29-31 janar ishin në Budapest, ku biseduan në «mënyrë të përzemërt dhe miqësore» me byronë politike të KQ të PP të Hungarisë. E çuditshme! Kjo bëhet menjëherë pas mbledhjes së Varshavës, të Komitetit Politik të Traktatit të Varshavës, ku kishin kohë të bisedonin. Ta merr mendja se revizionistët e Moskës nuk «janë thirrur» në Budapest për gjëra pa rëndësi. Diçka serioze duhet të ketë, por çfarë? Më vonë ka për t'i dalë tymi. Por mund të bëjmë disa supozime:

1) Kadari ka qenë i ngarkuar të kërkojë tërheqjen e trupave sovjetike nga Hungaria. Sovjetikët dhe pjesëtarët e tjerë të Traktatit të Varshavës ia kanë hedhur poshtë. Atëherë Byroja Politike e Partisë së Punonjësve të Hungarisë ka thirrur Brezhnëvin.

2) Kadari gjendet në pozita të vështira në udhëheqje dhe ka kërkuar ndihmë.

3) Kriza ekonomike e madhe në Hungari rrezikon të çojë në një kundërrevolucion të ri. Kërkohet ndihmë.

E DIEL
31 JANAR 1965

Sot Moska dhe Hanoi dhanë lajmin se Kosigini, në krye të një delegacioni sovjetik, do të vejë këto ditë në Vietnam. Gazetat e Vietnamit kanë filluar hosanatë për sovjetikët.

Sigurisht, sovjetikët kanë plane të këqija, drejtpërdrejt dhe indirekt për të fshehur veprimtarinë e tyre të ardhshme me revizionistët dhe me amerikanët.

Sot «Pravda» lajmëron bashkëpunimin në televizion të sovjetikëve me amerikanët dhe flet në mënyrë pozitive për një udhëtim të ardhshëm të udhëheqësve sovjetikë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tradhtia po vazhdon e po zgjerohet.

E HËNË
1 SHKURT 1965

Moska, sonte, në mënyrë lakonike njoftoi se Brezhnjevi dhe Podgorni, të ftuar nga Komiteti Qendror i Partisë së Punonjësve të Hungarisë, nga 29-31 janar ishin në Budapest, ku biseduan në «mënyrë të përzemërt dhe miqësore» me byronë politike të KQ të PP të Hungarisë. E çuditshme! Kjo bëhet menjëherë pas mbledhjes së Varshavës, të Komitetit Politik të Traktatit të Varshavës, ku kishin kohë të bisedonin. Ta merr mendja se revizionistët e Moskës nuk «janë thirrur» në Budapest për gjëra pa rëndësi. Diçka serioze duhet të ketë, por çfarë? Më vonë ka për t'i dalë tymi. Por mund të bëjmë disa supozime:

1) Kadari ka qenë i ngarkuar të kërkojë tërheqjen e trupave sovjetike nga Hungaria. Sovjetikët dhe pjesëtarët e tjerë të Traktatit të Varshavës ia kanë hedhur poshtë. Atëherë Byroja Politike e Partisë së Punonjësve të Hungarisë ka thirrur Brezhnjevin.

2) Kadari gjendet në pozita të vështira në udhëheqje dhe ka kërkuar ndihmë.

3) Kriza ekonomike e madhe në Hungari rrezikon të çojë në një kundërrivolucion të ri. Kërkohet ndihmë.

4) Mosmarrëveshjet kufitare me Rumaninë. Kërkohej ndërhyrje.

Të shikojmë çfarë do të dalë nga ky takim, por pa tjetër diçka serioze e ka nxitur atë.

Kosigini do të shkojë për së shpejti në Hanoi. Moskë e dha këtë lajm me anën e TASS-it. Hanoi në të gjitha gazetat e vendit e priti atë me artikuj të ndryshëm, plot «dashuri, besnikëri dhe mirënjohje të pafund» për sovjetikët. Natyrisht këtu futen të gjithë revizionistët sovjetikë, edhe ata që zëvendësuan Hrushovin. E kam fjalën për klikën Mikojan-Brezhnev-Kosigin. Në gazetat e tyre vietnamezët nuk mungojnë të thonë, gjithashtu, se «vajtja e këtij delegacioni (revizionistësh) do të përmirësojë marrëdhëniet dhe do të forcojë unitetin dhe miqësinë në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik dhe të gjitha vendeve të kampit të socializmit». Kështu udhëheqësit vietnamezë as më shumë, as më pak, po vihen në radhën e ndërmjetësve pajtues, për të predikuar «unitetin», vetëkuptohet pa asnjë bazë parimore.

Nga ana tjetër, ata thërresin ambasadorin tonë për t'i komunikuar këtë «lajm», duke thënë se ata i «njohin mirë sovjetikët kush janë, se janë revizionistë të këqij, se ata na kanë bërë shumë të këqija, se janë përçarës», janë ashtu, janë kështu etj.

Edhe kryeredaktorit të gazetës sonë «Bashkimi», që ishte kohët e fundit në Vietnam, një zyrtar i lartë vietnamez i kishte thënë, në mes të tjerash, se «Kina është një vend i madh dhe duhet ta dëgjojmë e ta ndjekim».

Ky mund ta kishte këtë për veten e tyre. Sidoqoftë, nuk u gabova në gjykimin e letrës që Komiteti Qendror i Partisë së Punonjësve të Vietnamit u dërgonte sovjetikëve në përgjigje për mbledhjen e marsit të ardhshëm: letër e lëkundshme; tash ajo mund të gjykohej si një mesazh, urë ndërtuese për vajtjen e delegacionit me Kosiginin në krye. Komunikata sovjetike thotë se «delegacioni është sovjetik», pra as i qeverisë, as i partisë. Një demagogji kjo fund e krye për të thënë se gjoja është një delegacion i popullit sovjetik, pa karakter qeveritar ose partie. Do të ishte më drejt ta quanin «delegacion sputnik», se ky delegacion, me këtë karakterizim që i bënë, nuk do të merrej me asgjë tjetër, veçse me çështje qiellore!

Por, sidoqoftë, sipas mendimit tim, ky delegacion revizionistësh vete për të bërë intriga të mëdha.

Revizionistët sovjetikë, mendoj unë, shkojnë në Vietnam për të arritur disa qëllime politike dhe ideologjike (që ngjarjet e ardhshme do të vërtetojnë nëse janë parashikuar drejt ose jo):

1) Të krijohet përshtypja se ideologjikisht Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe Partia e Punonjësve të Vietnamit nuk kanë kundërshtime të mëdha, mbajnë lidhje «të mira» dhe çdo gjë mund të ndreqet «me bisedime vëllazërore». Kjo, edhe në qoftë se s'është kështu, është një tym në favor të revizionistëve.

2) Të tregohet se Bashkimi Sovjetik dhe Republika Popullore e Vietnamit janë «miq shumë të ngushtë». Bashkimi Sovjetik e ka ndihmuar dhe e ndihmon «bujarisht». Kosigini mund t'u japë një kredi të mirë, «të dënojë» edhe disa gabime «politike», «ideologjike»

dhe «ushtarake» të Hrushovit, sepse kjo s'u kushton gjë. Ky gjest natyrisht bën bujë, është gjithashtu në favor të revizionizmit sovjetik.

3) Të propagandohet se sovjetikët janë qind për qind me Vietnamin dhe me luftën në Vietnamin e Jugut. Do t'u japin edhe disa armë dhe do të kritikojnë përsëri Hrushovin që nuk u kishte dhënë ndihmë ushtarake. Dhe këtu nuk humbasin gjë. Përveç propagandës, revizionistët sovjetikë mund të venë edhe me propozime për të shuar luftën dhe për të përgatitur një kompromis me amerikanët, me të cilët mund të jenë marrë vesh më parë.

4) Për të kundërbalancuar influencën politike, ideologjike dhe ekonomike të Kinës, për të neutralizuar Vietnamin, në mos mundtë ta bëjë tërësisht me vete. Gjithashtu për t'i treguar botës se në Lindjen e Largme «kam edhe unë influencë dhe se po ia prish planet Kinës».

5) Në qoftë se mundet, me anë të udhëheqjes vietnameze, të arrijë në disa pika ujdje për bisedime dhe për uljen e gjakrave me Kinën. Zaten Kina po hesht kundër revizionistëve në një mënyrë shqetësuese. Ç'kanë në kokë shokët kinezë? Koha do ta tregojë më qartë.

6) Vajtja në Vietnam është gjithashtu një taktikë e revizionistëve sovjetikë për veprime ndërkombëtare. Kosigini do të vejë edhe në Londër. «Pravda» këto ditë deklaroj se hiqet viza për turistët që duan të vizitojnë Bashkimin Sovjetik, se e shikon me simpati një vizitë të udhëheqësve sovjetikë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

do të bëhen shkëmbime televizive etj. Pra, për të mos e filluar «karrrierën diplomatike» me vajtjen në vende kapitaliste, revizionistët sovjetikë e fillojnë me Vietnamin, që do ta vazhdojnë më vonë me Indonezinë, me Indinë, në Afrikë e gjetkë.

Kinë, hap sytë, se ne nuk i mbyllim! Në politikë duhet gjallëri, shpejtësi dhe vendosmëri për të dërrmuar planet e revizionistëve. Plogështia në politikë është e njëllotjtë si të shpejtosh duke gabuar. Por të flesh s'është aspak mirë.

E MARTË
2 SHKURT 1965

Sot u botuan në shtyp dokumentet në lidhje me mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, përfshirë edhe letra e Qeverisë sonë drejtuar këtij Komiteti.

Të shohim nëse shtypi i huaj do t'i bëjë jehonë letrës sonë, që u turbullon ujërat e qeta, në të cilat po notojnë imperialistët dhe revizionistët, mbasi në këtë amulli, s'është çudi që ata po merren vesh duke bërë tratativa të fshehta për Gjermaninë dhe për probleme të tjera.

Njoftohet se pas mbledhjes së Varshavës sovjetikët kanë biseduar me Gomulkën për mbledhjen e parti-ve revizioniste të 1 marsit. Duket se ky i ka këshilluar që të hiqet dorë nga mbledhja e marsit. Mundet, nga ana tjetër, që sovjetikët të kenë shkuar në Budapest edhe për të bindur hungarezët që mbledhja të mos bëhet. Në Moskë sovjetikët janë takuar sot me Raimond Gijonë¹ po për këtë punë. Por mund të jetë dhe ver-

1. Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të PK Franceze.

sioni tjetër, që mbledhjen ta bëjnë (sido që nuk ishte nevoja të bridhnin, pse për mbajtjen e saj është dhënë pëlqimi), por të mos caktojnë ose të ndryshojnë rendin e ditës. Sidoqoftë kjo do të duket, për ne njësoj është, në të dy rastet fitojmë. Fitojmë po ta bëjnë, pse ata vetë legalizojnë me këtë rast përçarjen, fitojmë edhe po të mos e bëjnë, pse edhe kështu demaskohen dhe diskreditohen keqas.

* Politika e qeverisë kineze, më duket mua, nuk tregon dinamizmin e duhur dhe gjerësinë që kërkojnë momentet, koniunkturat, potenciali dhe rëndësia e saj në arenën ndërkombëtare. Ajo shfaqet e plogësht, deri diku hezituese, e mbyllur dhe e kufizuar në disa fusha të caktuara dhe për probleme të veçanta. Kjo politikë nuk ka atë iniciativë dhe rajonizim që duhet të ketë një fuqi e madhe socialiste në zhvillimin e ngjarjeve botërore. Më të shumtat e herës ajo u nënshtrohet ngjarjeve dhe nuk mund t'i parashikojë, t'i evitojë, të paraveprojë, t'u ndërrojë kursin ose t'u prishë planet e zhvillimit, kur këto ngjarje janë në dëm të socializmit dhe të paqes botërore. Nuk mund të themi se politika kineze nuk reagon, nuk mban qëndrim, nuk influencon në ngjarjet, në zhvillimin dhe në zgjidhjen e tyre, por kjo politikë vepron me vonesë, jo sa duhet dhe jo kur duhet.

Lufta kundër imperializmit amerikan dhe demaskimi i këtij nga ana e Kinës bëhet mirë, por me hope, dhe forca e kësaj lufte nuk ndihet kudo sa duhet. Ajo ndihet, mund të themi, në Lindjen e Largme, në Gadi-

shullin Indokinez, rreth Tajvanit dhe Indonezisë. Pesha e Kinës në këtë rajon nuk mund të injorohet as nga imperialistët amerikanë, as nga reaksionarët e tjerë...

Unë mendoj se kinezët e nënvleftësojnë, e kanë lënë pas dore luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern brenda në Evropë. Kjo ndodh për shkak të koniunkturave të ndryshme që kanë krijuar dhe vazhdojnë të krijojnë ata në dëm të socializmit, që janë me pasoja të rënda për kontinentet e tjera, ku revolucioni po zien, ku popujt po luftojnë, ku intrigat janë të mëdha dhe situatat të paqëndrueshme.

Unë vazhdoj të kem mendimin se shokët kinezë luftën brenda në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e shikojnë nga larg dhe e zhvillojnë atë nëpërmjet disa artikujve të mirë e demaskues. Por vetëm kaq nuk është dhe nuk mund të jetë e mjaftueshme. Shokët kinezë nuk i studiojnë dobësitë konkrete të kapitalizmit botëror në strofkën e tij, nuk thellohen sa duhet në koniunkturat e krijuara nga krizat e mosmarrëveshjet. Ata nuk shfrytëzojnë aktivisht të çarat e armikut, nuk janë të zhdërvjellët dhe të shpejtë në disa veprime të përshtatshme që të thellojnë krizat e kapitalizmit dhe të revizionizmit...¹

1. Shih vazhdimin në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 189.

E MËRKURË 3 SHKURT 1965

Bëmë mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë të aparatit të Komitetit Qendror për dhënie llogari e zgjedhje.

Raportin e komitetit të Partisë të aparatit e mbajti shoku Xhoxhi Robo. Në raport, midis të tjerash, u ngrit edhe çështja e vështirësisë që hasin disa organizata në përcaktimin e tematikës së mbledhjeve. Kjo ka shkakuar që disa organizata-bazë vitin e kaluar kanë bërë edhe deri 4 mbledhje më pak.

Vetëm dy organizata u kritikuan.

Raporti, përveç hyrjes dhe pjesës që fliste për situatën ndërkombëtare, përmbante dy pika: **zbatimin e vendimeve dhe çështjen e figurës morale të komunistëve.**

I. Mbi zbatimin e vendimeve: Vazhdohet të mos shikohet sa duhet ana teoriko-politike e shkencore e vendimeve sidomos ana e parë, kurse për anën praktike punohet më mirë. Për këtë të metë u kritikua edhe Fadil Paçrami.

Për verifikimin e zbatimit të vendimeve u bënë po ato kritika si dhe herë të tjera dhe me fraza të për-

gjithshme. Në raport mund të ishin sjellë disa shembuj si për rezultate pozitive edhe për të meta. U lavdëruan disa shokë, por disa që nuk e bëjnë mirë punën mund të kritikoheshin.

II. Mbi figurën morale të komunistëve të aparatit. U fol për mbeturina siç janë në një rast mendjemadhësia që duket te ndonjë shok apo shpërdorimi i funksionit që u argumentua me rastin kur njëri i kishte dhënë rekomandim për punë «të përshtatshme» një njeriu jo të mirë.

Në raport u fol edhe mbi nevojën për të bërë më shumë punë shoqërore në lagje dhe në aparat.

Mendoj se u teprua në kritikën që u bë në mbledhje, për disa gjëra të vogla në lagje ndaj disa grave, të cilat vetë nuk janë anëtare partie, por bashkëshortët i kanë komunistë dhe punonjës këtu në aparat.

Ka interesim nga shokët për edukimin e fëmijëve në familje dhe në shkollë. Shokët e organizatës karakterizohen nga sjellja e mirë me pjesëtarët e tjerë në familjen e tyre.

Diskutuan shokët:

1) **Petraq Magjistari.** Bëri autokritikë për pakujdesi që kishte treguar gjatë kolektivizimit në malësi (Shkodër, Pukë etj.). Ai tha se në drejtori nuk i studiojnë mirë vendimet, se mungon eksperiencia organizative dhe teknike për organizimin e punës në kooperative.

Gjithashtu, vuri në dukje se nuk zbatohen si duhet direktivat; foli edhe për neglizhenca nga funksionarët

e drejtuesit e ndërmarrjeve pyjore nëpër rrethe: tha se nuk punohet si duhet politikisht dhe ngriti problemin e forcimit të edukimit moral.

Theksoi pastaj se nga disa drejtori nuk po merr rrugën e duhur ndihma që i duhet dhënë bazës në mënyrë kolektive dhe shtoi se bashkëpunimi e shkëmbimi i materialeve në mes drejtorive duhet të bëhet më mirë.

2) **Tefik Çumani.** Vuri në dukje se tani në aparat shokët po i punojnë më mirë materialet, por shprehu mendimin se para se të venë në bazë ata duhet t'i punojnë përsëri. Foli edhe për nevojën e ngritjes në një nivel më të lartë të aftësisë teknike të kuadrove dhe për shfrytëzim më të mirë të eksperiencës së tyre. Shokët e aparatit nuk janë thelluar mirë në ndihmën që duhet t'i japin bazës, në mënyrë që organizata-bazë të funksionojë si duhet. Bëri kërkesë që drejtoritë, kur studiojnë dhe marrin vendime, të thërresin edhe inspektorët. (Këtë e kishte edhe si kritikë.)

3) **Hamdi Sollaku.** Në diskutimin e tij tha se nga komunistët e aparatit nuk janë bërë përpjekje të mjaftueshme individuale për të ngritur nivelin kulturor dhe për të mësuar ndonjë gjuhë të huaj që do t'i ndihmojë në shfrytëzimin e më shumë materialeve të nevojshme. Foli gjithashtu për përdorimin si duhet të materialeve dhe për të përfituar nga leksionet e seminarit. Së fundi vuri në dukje disa të meta, qofshin këto edhe të vogla, dhe tregoi rrugët se si duhet t'i zhdokim.

Ai kritikoi shokët e komitetit të Partisë të aparatit dhe sekretarët e KQ, që duhet të interesohen më mirë për organizatat-bazë të aparatit.

4) **Rita Marko.** Tha se në fillim tregohet kujdes për problemet që ngrihen, por pastaj interesimi për to bie. Shoku Rita analizoi drejt çështjen se si duhet të ndiqet zbatimi i vendimeve me afat të shkurtër dhe me perspektivë të gjatë.

Pastaj vuri në dukje se nga shokët bëhen plane, edhe të detajuara për zbatimin e vendimeve, por këto nuk shpjegohen si duhet.

Mund të ngjasë që ndonjë nga pikat e vendimit të mos jetë e realizueshme, sqaroi ai, por kjo duhet të arsyetohet dhe t'i sinjalizohet udhëheqjes, në mënyrë që kjo të marrë masa. Pa marrë aprovimin e udhëheqjes, vendimi i saj s'duhet ndërruar.

5) **Prokop Murra.** (Zakonisht shoku Prokop është objektiv në trajtimin e problemeve dhe jo ëndërrues.)

Ai theksoi se çdo komunist duhet të tregohet njeri me horizont që t'i shikojë çështjet në perspektivë dhe të mos veprojë si automat ose zbatues i ngushtë i direktivës.

Të tërë nëpunësit në Drejtorinë e Industrisë që drejton Prokopi, siç tha ai vetë, janë me arsim të lartë. (Ky është një sukses i madh dhe deri diku kjo gjendje është në shumë drejtori.)

Ai foli edhe për lidhjen e punës teknike me punën edukative të Partisë.

Theksoi gjithashtu, si të gjithë, nevojën për bashkëpunimin më të mirë midis drejtorive.

6) **Sotir Manushi** (në sektorin ideologjik). Në fillim të diskutimit foli për nënyleftësimin që i bëhet punës organizative në kryerjen e detyrave dhe mosshkuarjen deri në fund në këtë çështje. Kritikoi Fadil Paçramin

që drejton këtë sektor, duke e konkretizuar atë që tha me një citat të bukur të përshtatshëm të Leninit. Bëri edhe autokritikë. Sotiri kritikoi, gjithashtu, qëndrimet zyrtare, prepotente e megalomane të disa propagandistëve, të cilët nuk bëjnë si duhet e me durim punën bindëse e shpjeguese me njerëzit.

Ai foli edhe për krijimin dhe shfrytëzimin e formave të reja të punës në përshtatje me rrethanat e reja, me zhvillimin dhe ngritjen ideologjike e politike të njerëzve.

Format e reja, tha ai, do të na nxjerrin probleme të reja e do të na frymëzojnë për punë më të mirë.

7) **Adnan Muço** (në Drejtorinë e Bujqësisë).

8) **Ngjeli Toka** (në Drejtorinë e Organizimit).

Ngjeli është shok i mirë, që ka fituar eksperiencë, por prapë ka mbetur një natyrë e mbyllur. Edhe në diskutimin e tij spikatën këto tipare.

9) **Ligor Zuka** (në sektorin e administratës). Tha se në qëndrimin e komunistëve ndaj punës ka të meta, disa rrinë shumë në klub e në korridore, vijnë në orar, por sillen rreth e rrotull ose dalin jashtë aparatit në orarin e punës; ka edhe disa që rrinë në shtëpi pa raport mjekësor. Bëri kritika të mira për të gjithë ata shokë që i shfaqin këto të meta, sido që me emër përmendi vetëm një.

Për mbrojtjen dhe ruajtjen e pronës shoqërore vuri në dukje se ka kujdes dhe nikoqirllëk.

Duket shok i mirë, kritikon, është rigoroz. Kërkoj nga shokët që t'i heqin nga zyrat furnelat elektrike, pse kështu harxhohet energjia elektrike, gjë që është shkelje e rregullave të vendosura.

Pastaj u aprovuan sekretarët e organizatave-bazë të Partisë të sektorëve dhe në fund u zgjodh komiteti i Partisë i aparatit.

U lajmërua se Kosigini nisët nesër për në Hanoi. Ai do të bëjë një ndalesë në Pekin, ku, natyrisht, do ta presë Çu En Lai dhe së bashku do të kenë një bisedim. Të shohim, do të qëndrojë pak, sa të ndërrojë avionin, apo do të rrijë ndonjë natë. Kjo ka rëndësi të veçantë për rrjedhimin e gjërave. Rëndësi do të ketë edhe kur të kthehet nga Vietnam, do të kalojë përsëri nga Pekini, do të ndalet pak, apo do të rrijë përsëri ndonjë natë? Kjo duhet të jetë akoma më sinjifikative. Të shohim taktikat dhe manovrat e reja të revizionistëve dhe qëndrimet e shokëve kinezë.

Sot bisedova me Ramizin rreth disa tezave që kam përgatitur për një artikull demaskues kundër mbledhjes revizioniste të marsit¹, që do ta botojmë, pavarësisht nëse bëhet ose jo kjo mbledhje.

* Ambasadori ynë në Pekin na shkruan për bisedën që ka pasur me Liu Siaon dhe Y Khanin. Sipas këtyre,

1. Artikulli «Ç'fshihet prapa mbledhjes fraksioniste të 1 marsit, që po përgatitin revizionistët hrushovianë», u botua në «Zërin e popullit» më 16 shkurt 1965. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 100.

— dhe kjo është vija e udhëheqjes kineze, — klika revizioniste aktuale në fuqi në Bashkimin Sovjetik është «më e poshtër se Hrushovi, është tradhtarë, është dinake» etj.; «Hrushovi bënte bujë, kurse këta punojnë dhe veprojnë në heshtje dhe kohët e fundit kanë realizuar plot marrëveshje me amerikanët që Hrushovi nuk do të guxonte ose nuk i kishte realizuar dot»; «revizionistët aktualë sovjetikë, në sipërfaqe, hiqen sikur janë të mirë e të moderuar, por janë shumë të këqij»; «ata vënë maska që të gënjejnë si shtriga e përrallës kineze që vuri një maskë të bukur për të tërhequr djemtë e rinj, tërhoqi dy, po i treti ia grisi maskën dhe kështu doli fytyra e vërtetë e shtrigës» etj., etj.

Po, kur ambasadori ynë i pyeti: «Përse nuk i godisni edhe ju udhëheqësit aktualë sovjetikë, që t'u çirret maska?», ata i thanë: «Ne (kinezët) u përgjigjemi sovjetikëve me artikujt e partive motra, dhe kur të vijë koha, që ata (sovjetikët) të na atakojnë ne (kinezët) drejtpërdrejt, atëherë ne do t'i shpartallojmë ata përfundimisht». **Luftë, pra, «e rreptë» me fishekët e të tjerëve, dhe kinezët, duke jetuar «me miell hua», do t'i japin «grushtin përfundimtar» shtrigës pasi të tjerët t'ia kenë çjerrë maskën asaj. Me një fjalë «dhentë e dhitë e Zeres, nami i Hasan Qeres».** Kjo është me të vërtetë revoltuese, jomarksiste, jo e ndershme. Por më e poshtër akoma është arsyeja që nxorën ata për mosvazhdimin e luftës e të polemikës kundër revizionistëve sovjetikë. Shokët kinezë nuk i sulmojnë ata «për të mos dëmtuar» popujt sovjetikë, pse, sipas tyre, po t'i sulmojnë, atëherë udhëheqja sovjetike do t'u thotë popujve sovjetikë: «I shikoni kinezët, ata nuk na lënë t'i luftojmë si duhet imperialis-

tët. Ne (sovjetikët) po luftojmë imperializmin dhe ata (kinezët) na sulmojnë ne. Kështu popujt sovjetikë egërsohen dhe nuk na kuptojnë ne (kinezët). Prandaj ne presim që ata (sovjetikët) të na sulmojnë hapur dhe pastaj t'u japim grushtin përfundimtar».

Ky është arsytimi «gjenial», «marksist-leninist», i këtyre shokëve kinezë, kjo është taktika e tyre «revolucionare»!! Kjo është skandaloze. Nga njëra anë, kësaj i thonë të veprosh siç dëshirojnë revizionistët (pse ata këtë qetësi duan dhe s'ka përse të të sulmojnë hapur), dhe, nga ana tjetër, po të ndjekësh logjikën e taktikës kineze, sipas së cilës **le të egërsohen popujt sovjetikë me partitë motra që u çjerrin maskën udhëheqësve sovjetikë**, një gjë e tillë s'ka rëndësi për kinezët. Ballistët te ne për të arsyetuar mospjesëmarrjen e tyre në luftë kundër pushtuesit, thoshin: «Mishi të piqet, helli të mos digjet». Edhe kinezët kështu mendojnë: **Le t'ua çjerrin të tjerët maskën revizionistëve**, ne të marrim namin e drejtimit të kësaj pune, të mençurisë, të pjekurisë e të gjakftohtësisë, të tjerët le t'i nxjerrin për ne gështenjat nga zjarri!

Mjerisht për ta këto janë llogari të bëra pa hanxhinë.

Së pari, popujt sovjetikë nuk egërsohen kur ne demaskojmë tradhtarët revizionistë, përkundrazi, ata gëzohen, forcohen, ndihmohen dhe u shtohet dashuria e respekti për ne.

Së dyti, ne nuk i nxjerrim gështenjat nga zjarri për oportunistët, po japim kontributin tonë për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, pavarësisht se na digjen duart. Le të na digjen duart dhe trupi për një

kauzë kaq të madhe! Këtë ne e kemi për nder e si nderin më të madh.

Së treti, shokët kinezë gabojnë rëndë kur mendojnë dhe veprojnë kështu, ata asgjë nuk do të përfitojnë nga këto spekulime. Bota të vë notën dhe të peshon për çka vlen dhe për çka ke vënë në balancë. Koha dhe njerëzit do të peshojnë drejt çdo fjalë, çdo gjest, çdo vepër të çdo partie dhe të çdo populli në situata të veçanta, në veprime të veçuara dhe në veprime kolektive.

E ENJTE
4 SHKURT 1965

Sot Durrësi inauguron pallatin e ri të kulturës «Aleksandër Moisiu». Nexhmija shkoi atje që në mëngjes. Pasdreke, në orën 17³⁰ vajta edhe unë për të parë pallatin dhe për të asistuar në shfaqje. Mbas vizitës biseduam me arkitekten e veprës, shoqen Pistoli. Pallati i kulturës është ndërtuar shumë bukur, me shije artistike. Salla e shfaqjeve ishte shumë e këndshme, e ndriçuar bukur, e hijshme, me skenë të bollshme dhe me akustikë të mirë dhe e tëra të ngjall ndjenjën e intimitetit, të një salle të lehtë pranverore. Dhomat, sallo-net dhe ndarjet e tjera janë gjithashtu shumë të mira dhe mjaft të bollshme. Përgëzuar ndërtuesit, i uruam durrsakët dhe i këshilloam ta mbajnë mirë, pastër dhe ta shfrytëzojnë si duhet.

Pamë shfaqjen. Edhe kjo ishte e bukur. Aktorët profesionistë dhe diletantë interpretuan mirë. Durrësi ka mundësi ta përmirësojë e ta zhvillojë më shumë artin, dhe besoj se shokët drejtues të këtij rrethi do të punojnë për ta gjallëruar jetën artistike të qytetit.

Pallati mban emrin e artistit tonë të madh, Aleksandër Moisiut. Të bëjmë, pra, që teatri i Durrësit ta

meritojë plotësisht emrin e bashkëpatriotit tonë me famë botërore.

Sot agjencitë e lajmeve dhe gazetat e huaja filluan të komentojnë fort materialet tona për mbledhjen e fundit të Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës.

E PREMTE
5 SHKURT 1965

Kosigini, që shkoi në Hanoi, ndaloi në Pekin, thonë për 24 orë, ku e priti Çu En Lai. Sigurisht do të kenë bërë bisedime. Të shohim ç'do të dalë.

E SHTUNË
6 SHKURT 1965

Bisedova përfundimisht me Ramizin për artikullin mbi Kongresin e 8-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe i dhashë disa teza plotësuese për artikullin kundër mbledhjes së 1 marsit të revizionistëve.

E DIEL
7 SHKURT 1965

Nexhmijes ia bëmë sot, në familje, festën e ditëlindjes së saj, që e ka nesër, më 8 shkurt.

Amerikanët barbarë bombarduan sot disa vende të Vietnamit të Veriut, gjoja si raprezalje kundër një akcioni të Vietkongut, që shkaktoi djegien e disa avionëve amerikanë dhe vrasjen e 9 aviatorëve janki. Ky akt barbar amerikan po bëhet në një kohë kur Kosigini po flet në Hanoi. Kjo tregon dobësinë e madhe të amerikanëve dhe forcën e madhe të vietnamezëve. Akti heroik i vietnamezëve, që goditën aerodromin amerikan duke i shkaktuar dëme të mëdha, jo vetëm ka diskredituar amerikanët, por ka demaskuar dhe ka vënë në pozita të vështira e delikate edhe revizionistët sovjetikë, aleatë të amerikanëve.

Gazeta «Zëri i popullit» boton sot në tri faqet e saj artikullin «Natyra kapitaliste e vetadministrimit punëtor jugosllav në dritën e Kongresit të 8-të të LKJ»¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 1.

E HËNË
8 SHKURT 1965

Mora pjesë në punimet e plenumit të Komitetit të Partisë të Qytetit të Tiranës.

Shoku Rrapo Dervishi mbajti raportin e byrosë së komitetit të Partisë me temë: Të ngremë më lart rolin e organizatave-bazë të Partisë në administratë.

Raporti ishte i mirë, përfshinte shumë probleme, të cilat analizoheshin drejt, në mënyrë kritike. Raport mjaft konciz, që duhet zbërthyer nga organizatat-bazë për t'u orientuar në punë gjatë vitit.

Pas raportit filluan diskutimet.

1. — **Gafur Çuçi** (drejtor i Drejtorisë së Tregti-Financës në KQ). Foli për organizatën-bazë të kësaj drejtorie. Shtroi kryesisht këto probleme:

a) Mbi produktivitetin e punës. Vuri në dukje se në disa raste bëhet punë e përciptë, materialet udhëzuese nuk punohen kurdoherë mirë, nuk bëhen studime me nivel dhe nuk shfrytëzohet eksperiencia për të bërë një punë më të frytshme në të ardhmen.

Puna e përditshme nuk duhet të errësojë punën e thelluar dhe me perspektivë, siç ka ndodhur disa herë. Duhet nxitur tek të gjithë punonjësit studimi in-

dividual dhe krijimtaria e tyre. Të krijohet besimi në kuadrot e rinj.

b) Metoda e punës, zbërthimi i vendimeve dhe kontrolli i tyre. Shokët e qendrës t'i dëgjojnë me interes mendimet e njerëzve të bazës. Shpeshherë shkojnë shumë urdhra nga lart, pa pasur më parë si duhet opinionin e bazës për shumë probleme.

2. — **Deko Rusi** (dekan i Fakultetit Ekonomik).

a) Kualifikimi i kuadrit. Deri sivjet kanë mbaruar studimet një numër i madh studentësh (dha shifra konkrete), por përçindja e kalueshmërisë nuk është e kënaqshme, sidomos te studentët e korrespondencës dhe tek ata të Fakultetit Ekonomik. Ka dobësi në cilësinë e dhënies së lëndëve, nuk shikohet me perspektivë problemi i kualifikimit të kuadrit. Një mungesë serioze vihet re në mësimin e gjuhëve të huaja, gjë që pengon në shfrytëzimin e materialeve që ka biblioteka e universitetit.

b) Të punohet më shumë për një organizim më të mirë të punës së studimit. Të thellohet studimi i teorisë marksiste-leniniste dhe studimi për njohjen e pikëpamjeve antimarksiste, revizioniste në filozofi, në politikë dhe në ekonomi, që të mund t'i luftojmë ato më mirë.

3. — **Musa Ferra** (sekretar i komitetit të Partisë të ndërmarrjes «21 Dhjetori».)

Ngriti probleme të përgjithshme me karakter partie dhe shtetëror. Raportoi për punën në ndërmarrje dhe bëri një kritikë për organizatën-bazë të ndërmarrjes, e cila duhet të luftojë më shumë kundër burokratizmit në administratë.

Kritikoi edhe disa dikastere që kanë lidhje me organizatën e tyre të ndërtimit.

4. — **Hajredin Çeliku** (drejtor i uzinës «Enver»).

Theksoi se ndihma me ekipe nga ana e Ministrisë së Industrisë është e frytshme. Përveç ndihmës që japin, këto ekipe caktojnë edhe detyra për edukimin dhe kualifikimin e kuadrit e nga ana tjetër edhe vetë ato përfitojnë nga eksperiencia e bazës.

Baza është rritur, tha ai, mundësitë për të ecur përpara janë të mëdha, prandaj duhet që të mos i nxjerrim vështirësi ministrisë.

Bën autokritikë të shëndoshë ky shok. Është kuadër shumë i mirë dhe energjik.

Kritikoi disa drejtues në Ministrinë e Industrisë, që ngulin këmbë në mendimet e tyre të paarsyeshme. Kjo vjen nga kokëfortësia dhe mendjemadhësia e tyre.

Uzina akoma s'po mbaron. Rrinë në magazinë pa plan shpërndarjeje motorët diezel që ne kemi ndërtuar, tha ai, dhe që na i kanë kërkuar me insistim.

5. — **Nikolla Mitrushi** (kryeinxhinier i NISH Kimikes).

Bëri një diskutim të mirë për të metat që konstatohen, për punën ideologjike të pamjaftueshme, kritikoi punën e varfër që kanë bërë deri tani me punëtorët.

Foli për marrëdhëniet e ndër marrjes me Ministrinë e Industrisë, të cilat në përgjithësi kanë ecur mirë, pa shumë pengesa. Në ndërmarrjen e tyre ata vetë kanë ngritur reparte të reja, që shfrytëzojnë materialet e vendit. Por plani i ndërtimeve dhe dhënia e një numri makinerish, janë zvarritur. Bën autokritikë. Inxhinier kimist i ri, por duket shok i matur, i logjikshëm dhe

ka aftësi për të bërë një punë më frytdhënëse. Kjo është përshtypja e parë që më la nga diskutimi i tij.

6. — **Gogo Kozma** (zëvendësministër i Tregtisë).

Ndër të tjera foli për mbrojtjen e pronës socialiste, për nevojën e forcimit të punës politike me punonjësit e tregtisë etj.

7. — **Hajdar Aranitasi** (sekretar i komitetit të Partisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme).

Foli për çështje të forcimit të organizatave-bazë dhe të drejtimit të tyre nga komitetet e Partisë.

8. — **Veiz Gjebero** (ish-drejtor i kombinatit të tekstileve «Stalin», tani zëvendësministër i Industrisë së Lehtë).

Është shok i mirë. Në diskutimin e tij ngriti probleme e të tilla ka shumë atje, po të marrësh parasysh eksperiencën e madhe të shumë komunistëve që ka kombinati i tekstileve «Stalin». Nga mesi i diskutimit foli për probleme shtetërore, ndoshta, meqë ka qenë drejtor i kombinatit dhe preokupimi kryesor i tij ka qenë ana shtetërore, ku ai ka treguar zotësi në drejtimin organizativ dhe teknik. Tash në ministri ai është zgjedhur edhe sekretar i organizatës së Partisë, dhe do të fitojë eksperiencë edhe si i tillë.

Unë kam besim te ky kuadër, pse është i ri, energjik e me perspektivë. Ai është edhe kandidat i Komitetit Qendror të Partisë.

9. — **Ajet Simixhiu** (drejtor i ATSH-së).

Foli për gjallërimin e frymës luftarake në organizatë dhe vuri në dukje se shumë herë ka paralelizëm të punës së Partisë dhe të pushtetit.

Tregoi rastin e një mbledhjeje të organizatës-bazë

të Ministrisë së Drejtësisë, ku u mbajt një raport informativ, të cilit i mungonte studimi i punës në frymë partie. Në këtë raport, tha ai, kishte vetëkënaqësi, ngriheshin probleme administrative, që mund të ishin edhe qesharake, si për shembull, pse nuk erdhi me kohë shoferi ose pse nuk u ndanë gazetatat në rregull etj. Me një fjalë ai i bëri një kritikë të drejtë organizatës-bazë të Ministrisë së Drejtësisë.

Ministri i Drejtësisë, shoku Bilbil Klosi, sipas shokut Ajet, diskutoi mirë e në mënyrë kritike.

10. — **Jovan Bardhi**. Foli për realizimin e disa vendimeve që ishin marrë më parë.

Pastaj foli unë¹. Vlerësova punën e mirë që ka bërë organizata e Partisë e qytetit të Tiranës dhe u ndala në dy momente të rëndësishme të veprimtarisë së organizatave-bazë të Partisë, siç janë përcaktimi i rendit të ditës së mbledhjeve të organizatave-bazë si dhe edukimi ideopolitik e profesional i komunistëve.

Kur dolëm nga mbledhja e plenumit, në orën 20⁰⁰ pamë se vendi që mbuluar me një cipë të hollë bore. Bën shumë ftohtë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 52.

E MARTË
9 SHKURT 1965

Kudo, në Veri e në Jug, ka rënë borë e madhe dhe shumë rrugë janë zënë, është prerë komunikacioni dhe në disa fabrika e miniera nuk po punohet. Bora vazhdon të bjerë, por deri tani dëme s'kemi as në njerëz, as në bagëti. Për bujqësinë, veçanërisht për të lashtat, kjo borë është e mirë, kurse bagëtinë e kemi ca shtrënguar me ushqime.

Në Tiranë bën ftohtë, fryn erë dhe bie shi. Në Dajt bie borë¹.

1. Po në këtë datë, autori ka hedhur në Ditar shënimin: «Provokacionet amerikane kundër Republikës Demokratike të Vietnamit», botuar në librin e tij «Superfuqitë», f. 152.

E MËRKURË
10 SHKURT 1965

Në bazë të planit që kemi aprovuar, sot zhvilluam mbledhjen e Byrosë Politike. Në rendin e ditës kishim edhe shqyrtimin e raportit «Mbi punën e bërë nga byrotë e komiteteve të Partisë të disa rretheve të Veriut për çështjen e kolektivizimit», por këtë pikë nuk e realizuam, se shumë sekretarë të parë të këtyre rretheve nuk mundën të vinin, për arsye se rrugët e Veriut janë zënë nga bora.

Midis një numri problemesh shqyrtuam edhe raportin për planin dhe buxhetin e shtetit për vitin 1964 dhe detyrat e planit e të buxhetit për vitin 1965, që do t'i paraqitet Plenumit të ardhshëm të Komitetit Qendror.

Duke diskutuar për këto probleme bëra një vërejtje që duket sikur del jashtë rendit të ditës, por na preokupon: Po vë re se probleme shqyrtojmë, por projektvendime nuk po na paraqiten. Theksova se ne kemi kritikuar drejt marrjen e vendimeve të shumta, por jo të kalojmë në anën tjetër, duke mos nxjerrë vendime.

Vendimet që marrim nxitin interesin e gjithë Partisë për problemet që shqyrton udhëheqja. Ato i vënë shokët në pozita pune për të ndjekur zbatimin e dety-

rave në kohë e në perspektivë. Prandaj, kur shqyrtojmë një problem, bashkë me raportin, të na paraqitet edhe një projektvendim.

Diskutuam edhe për disa çështje të rritjes së mëtejshme të rolit të bashkimeve profesionale. Folën edhe shokët e tjerë të Byrosë Politike, por unë u ndala sidomos te gjyqet shoqërore. Mundet që njëri të bëjë një gabim moral, i cili nuk është mirë të popullarizohet në masë. Mirëpo ky gabim i duhet vënë në dukje medoemos personit. Prandaj, do të veprojmë sipas rastit konkret. Njërit do t'i thuhet veç, tjetri mund të diskutohet në një rreth të ngushtë njerëzish, siç është gjyqi shoqëror.

Gjyqi shoqëror ndihmon në edukimin e njerëzve. Ka çështje që mund të ezaurohen shpejt, pa pritur mbledhjen e organizatës profesionale. Po edhe sikur të ndodhë që kjo mbledhje të jetë në plan ato ditë, jo çdo gjë shtrohet në kolektiv, se këtu janë shumë njerëz. Në kolektiv shtrohen çështje në kuadrin e edukimit të përgjithshëm të punëtorëve. Në gjyqin shoqëror shqyrtohet një çështje shumë serioze, që ndihmon të gabuarin, ndihmon edhe punën, ndihmon edhe udhëheqjen të nxjerrë konkluzione për punën e saj me njerëzit.

Vajtëm në mbledhjen solemne kushtuar 20-vjetorit të themelimit të Bashkimeve Profesionale, në sallën e Teatrit të Operës e të Baletit. Gogoja mbajti fjalimin e rastit.

Shoku Haxhi Lleshi i dorëzoi shokut Gogo dekoratën e lartë të «Heroit të Punës Socialiste», me të cilën Presidiumi i Kuvendit Popullor dekoron organizatën e Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë. Në sallë kishte entuziazëm të madh.

Pas konferencës pamë koncertin. Ishte ordiner.

Kinezët na njoftuan për bisedimet shumë të ftohta që patën me Kosiginin. Qëndrimet e shokëve kinezë, ashtu siç na i njoftuan, ishin të mira. Kosigini u propozoi atyre që të bëjnë njëfarë bisedimi me amerikanët, po kinezët ia refuzuan dhe i bënë të ditur kushtet e tyre të forta: largimin e amerikanëve nga Vietnam i Jugut dhe nga gjithë Azia Juglindore etj.

Kosigini u propozoi gjithashtu që Bashkimi Sovjetik, Kina, Koreja dhe Vietnam të bënin një deklaratë kundër imperializmit amerikan. Kinezët as që iu përgjigjën fare këtij propozimi. (Siç duket ata e kanë lexuar mirë mendimin tonë se nuk mund të luftohet imperia-lizmi amerikan në aleancë me revizionistët modernë.)

Kosigini u kërkoi më së fundi të merrnin pjesë në mbledhjen e 1 marsit, po kinezët, natyrisht, ia refuzuan, ia hodhën poshtë edhe këtë kërkesë. Në rregull!

E ENJTE
11 SHKURT 1965

Kosigini, në kthim nga Vietnami, pasi qëndroi 24 orë në Pekin, ku e priti edhe Mao Ce Duni, u nis për në Kore. Të shohim ç'kanë biseduar përsëri dhe ç'do të bëjë në Kore. Por e marrim me mend, edhe atje do të grumbullojë një kaçup me erë.

E PREMTE
12 SHKURT 1965

Pas një jave zhvillohet mbledhja e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë¹.

Shënime për fjalën që do të mbaj në këtë Plenum:

— T'i vihet rëndësi e madhe e të mos nënvleftësohet aspak shfrytëzimi i fushave të vjetra naftëmbajtëse krahas këmbënguljes për zbulimin dhe zgjerimin e vendburimeve në shtresa gëlqerore të reja.

— Fuqia punëtore në sharra (veç Pukës) dhe në Kombinatin e Drurit në Elbasan është deficitare dhe ky faktor është një nga shkaqet e mosrealizimit të planit.

— Pjesëmarrja masive, e kualifikuar dhe e kujdeshme e punonjësve të thjeshtë administrativë dhe teknikë të kooperativave, të kuadrove të Partisë e të Ministrisë së Bujqësisë në punët bujqësore.

— Problemit të mirëmbajtjes së kullotave, shokët që përgjigjen për këtë sektor dhe Ministria e Bujqësisë, nuk po i gjejnë zgjidhjen që lyp koha.

1. Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH «Mbi përfundimet e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1964 dhe detyrat e planit dhe të buxhetit për vitin 1965», që u zhvillua më 18-19 shkurt 1965.

1 — Ndërtimi, përfundimi në kohë dhe vënia në shfrytëzim sa më parë e veprave industriale ka rëndësi të madhe dhe vendimtare për ekonominë.

— Do të jetë më mirë të forcojmë punën për ndërtimin dhe për montimin e veprave industriale që duhet të futen në prodhim këtë vit dhe në fillim të vitit tjetër, qoftë edhe duke ngadalësuar sadopak ato të viteve të ardhshme.

— Komitetet ekzekutive dhe ato të Partisë me sa duket, nuk kanë masën e duhur në planifikimin e eksportit dhe nuk e lidhin këtë si duhet me shtimin e sasisë e përmirësimin e cilësisë së mallrave dhe me kohën e përshatshme të livrimit të tyre. Duhet të mendojmë mënyrat e lidhjes së tyre sa më të ngushtë dhe të shtojmë interesimin për këtë çështje kaq të rëndësishme.

— Duhani është një nga prodhimet më me vlerë për eksportin tonë, për të cilin duhet të merren masat e nevojshme: të bëhet kujdes në manipulimin e tij në të gjithë procesin dhe të vendosen rregulla, përgjegjësi, mundet edhe stimuj të rinj, por të parashikohen edhe sanksione për ata që nuk kryejnë detyrat.

— Problemi i pambukut është po ashtu preokupant. Çfarë duhet të bëjmë ne që të heqim dorë nga importimi i pambukut të kualitetit të mirë dhe ta zëvendësojmë me të vendit?

— Kursimi i lëndëve deficitare, i lëndëve djegëse, i energjisë elektrike, i të gjitha materialeve të importit. Ky problem duhet të jetë çdo ditë në qendër të vëmendjes së punonjësve dhe të drejtuesve. Për këtë nuk mjafton vetëm puna politike edukative, por të caktohen norma rigoroze, të cilat të kontrollohen vazhdimisht dhe

mbi këto masa teknike të ndërtohet edhe puna politike, ekonomike dhe edukative e punonjësve.

— Probleme të rëndësishme janë, gjithashtu, ngritja tekniko-profesionale e punonjësve të ekonomisë, arti i drejtimit të ndërmarrjeve industriale, të kooperativave bujqësore, të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe të të gjitha ndërmarrjeve të tjera ekonomike.

— Shfrytëzimi i kapaciteteve maksimale të makinerive në të gjithë sektorët është problem i dorës së parë për ekonominë.

— Të përputhim kurdoherë dëshirat me mundësitë. Të mbështetemi në mundësitë e brendshme, të përpiqemi t'i shtojmë këto dhe kryesisht mbi bazën e tyre të hartojmë planet ose të kërkojmë shtesa planesh, ose përmirësime, por jo jashtë mundësive tona. Duhet gjetur mënyra që kuadrot drejtues dhe planifikues të ministrive e të ndërmarrjeve të njihen me realitetin objektiv, me mundësitë tona që të mos bëjnë, ose të kërkojnë të bëjnë kështjella mbi rërë.

— Si duhet të jetë interesimi i bazës për ndërmarrjet nacionale.

— Puna e dobët e Partisë në Pukë, në Shkodër dhe në disa rrethe të tjera të Veriut në lidhje me kolektivizimin e fshatrave malore. Konkluzionet politike që duhet të nxjerrim nga këto raste.

Sovjetikët u propozuan vietnamezëve t'i ndihmojnë në luftë kundër amerikanëve si dhe të nënshkruanin një dokument të përbashkët me vendet «socialiste» gjoja

kundër amerikanëve. Kosigini u tha se «e kanë korrigjuar vijën ekonomike dhe, në politikën e jashtme, amerikanët i luftojnë në rrugën diplomatike» nëpërmjet një politike «elastike». Ai u tha edhe se do të forcojnë marrëdhëniet me Francën. Foli kundër nesh, shqiptarëve, që s'vajtëm në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, i cili u mbledh në kryeqytetin polak, dhe u vuri vietnamezëve në dukje se pse s'na kritikojnë ne.

Për mbledhjen e 1 marsit u tha se do ta bëjnë «për shkëmbim mendimesh në mes partive». Ai kërkoi që të mos i kritikojnë dhe iu largua çështjeve si ajo e Jugosllavisë, e Indisë, e Indonezisë etj. Vietnamezët i kritikuan për mbledhjen, për qëndrimin ndaj Jugosllavisë, për ndihmën Indisë etj., u thanë të përmirësojnë marrëdhëniet me Kinën e me Shqipërinë dhe pastaj «le të bëjnë politikë elastike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në bazë të një vije të përbashkët». Sovjetikët u «justifikuan» se u japin armë indianëve, që këtyre të mos ua japin amerikanët, u thanë se «Shqipëria përzihet në punët e brendshme të Bashkimit Sovjetik», kurse ata «s'përzihen në punët e brendshme të Shqipërisë». U fallën vietnamezëve 6 anije peshkimi, do të ndërtojnë në Hanoi një shtëpi pionieri dhe për vietnamezët e Jugut do të japin ilaçe dhe aparatura ndërlidhjeje, do t'u japin edhe disa armatime, por se çfarë armatimesh nuk na thanë, do t'i ndihmojnë edhe ekonomikisht, po me çfarë, edhe për këtë vietnamezët s'thanë gjë.

Vietnamezët konsiderojnë se këto bisedime «shkuan mirë, hapur, dhe do të ecin hap pas hapi përpara». Ata

thonë se udhëheqja sovjetike «e ka vështirë të ndryshojë, se ka bashkëpunuar me Hrushovin» etj. Ho Shi Mini ka mbetur sigurisht i kënaqur nga këto bisedime.

Rishikua me Ramizin artikullin që do të botojmë kundër mbledhjes së 1 marsit të revizionistëve.

E SHTUNË
13 SHKURT 1965*

Sipas njoftimeve zyrtare që japin shokët kinezë në lidhje me bisedimet në mes Maos dhe Kosiginit, kur ky i fundit u kthye nga Hanoi, konstatojmë me kënaqësi të thellë se Maoja i ka qëndruar fort dhe drejt këtij revizionisti të poshtër...¹

1. Shih vazhdimin e këtyre shënimeve në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 199.

E DIEL
14 SHKURT 1965

U njoftua se Kosigini u largua nga Pheniani me një komunikatë plot demagogji. Mundet që koreanët të mos kenë lëshuar në parime, po pritja që i bënë delegacionit sovjetik dhe artikujt që kanë shkruar, u shërbejnë sovjetikëve për të gënjyer e për të bërë demagogji, se gjoja me koreanët mund të merren ose janë marrë vesh.

E HËNË
15 SHKURT 1965

Bie shi. Në male bie borë e madhe.

Bëmë mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor.

I dhashë dorën e fundit artikullit demaskues për mbledhjen fraksioniste të 1 marsit që po përgatitin revizionistët hrushovianë. Ai do të botohet nesër në «Zërin e popullit» me titullin «Ç'fshihet prapa mbledhjes fraksioniste të 1 marsit që po përgatitin revizionistët hrushovianë»¹.

1. Shih në këtë vëllim, f. 82.

E MARTË
16 SHKURT 1965

Shiu që ka filluar prej ditësh vazhdon të bjerë pareshtur.

* Sonte në mbrëmje ambasadori ynë në OKB, shoku Halim Budo, do të marrë fjalën dhe do të kërkojë që Asambleja të vazhdojë punën në bazë të procedurës së Kartës, të cilën amerikanët dhe sovjetikët e kanë shkëlur. Sigurisht mocioni ynë do të jetë tronditës për ta, do t'u bjerë papritur dhe momentin ne e kemi gjetur të përshtatshëm, kur banditët në OKB kanë rënë dakord, kusarçe në kulisa, që ta shtyjnë mbledhjen për në vjeshtë. Me siguri do t'ua prishim planet. Ata do të shkelin Kartën për të dalë nga dara që do t'u vëmë në grykë, por ne do ta bëjmë drejt, burrërisht punën tonë. Do t'i demaskojmë keqas dhe Shqipëria do të mbahet në gojë për të mirë.

E MËRKURË
17 SHKURT 1965

Edhe në Tiranë filloi të bjerë borë dhe po mban.

Vajtëm me Nexhmijen uruam shokun Rita, që mbushi 45 vjeç.

* Bujë e madhe u bë sot në tërë botën për mocionin e paraqitur nga delegacioni ynë në Asamblesë e Përgjithshme të OKB-së¹. Gjithë agjencitë e lajmeve po flasin

1. Përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ata të Bashkimit Sovjetik përpiqeshin që punimet e sesionit të 19-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të zhvilloheshin në kushte jonormale dhe të mos shqyrtohej asnjë problem që kërkonte votim. Këto përpjekje dështuan në sajë të luftës së delegacionit tonë, i cili kërkoi të shqyrtohej me përparësi, mbi çdo çështje tjetër, dhe të merrej menjëherë vendim, me votim me apel nominal, mocioni i tij që «Asambleja e Përgjithshme të fillojë menjëherë punën e saj normale në përputhje me Kartën dhe me rregulloren e brendshme, të procedojë menjëherë në zgjedhjet e byrosë dhe në aprovimin e rendit të ditës, për të filluar pa vonesë shqyrtimin e çështjeve të ndryshme».

për veprimin e Shqipërisë, të cilin e quajnë «bombë, që po trondit OKB-në» etj. Halimi, pasi mbaroi, është duartrokitur mirë. Kryetari i Asamblesë, i hutuar i kërkoi me lutje tri herë Halimit që të tërhiqte kërkesën. Natyrisht, ai s'u lëkund. Hutim i madh! Shumë janë të detyruar të flasin mirë për Shqipërinë... Kryetari i Asamblesë mbylli seancën dhe e shtyu atë për nesërmbrëma, për të gjetur mënyrën e thyerjes së darës sonë, e cila, sido që të bëjnë, u qëndron në kokë si shpata e Damokleut.

E ENJTE
18 SHKURT 1965

Sot Tirana u gdhi e mbuluar me borë.

U hap Plenumi i 14-të i Komitetit Qendror, që shqyrtoi raportin e Byrosë Politike «Mbi përfundimet e plotësimit të planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1964 dhe detyrat e planit e të buxhetit për vitin 1965». Mbas raportit filluan diskutimet.

Në OKB dhe në botë vazhdon jehona e madhe e qëndrimit tonë. Halimi u thirr përsëri nga kryetari i Asamblesë, i cili edhe një herë iu lut, po ai qëndroi si mali i Tomorit, i palëkundshëm. Të shohim ç'do të bëhet sonte në mbledhje.

E PREMTE
19 SHKURT 1965

Në Plenumin e Komitetit Qendror diskutimet vazhduan deri pasdreke dhe ishin shumë të mira. Në fund foli unë, për gati dy orë¹. Mbledhja u mbyll në mbrëmje, në orën 20⁰⁰. U prekën mjaft probleme të rëndësishme për planin e vitit 1965. Plenumi shtroi detyra të mëdha, nga plotësimi i të cilave varet realizimi i planit të këtij viti. Që t'ia dalim mbanë, kërkohet mobilizim, këmbëngulje dhe organizim i mirë në punë.

Sot korrëm në OKB një fitore të madhe politike. I detyruam Shtetet e Bashkuara të Amerikës t'i hapin dritën jeshile votimit nominal që propozonim ne dhe që ato e ndalonin. U demaskuan nga ana jonë, në sy të të gjithë botës, shantazhi dhe blofi amerikan, u demaskuan kompromisi dhe ujdite e ndyra sovjetiko-amerikane dhe u vërtetua uniteti politik amerikan-sovjetik, që votuan tok kundër nesh. Po bëhet bujë në botë për luftën tonë kundër «superkolosëve».

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 119.

E SHTUNË
20 SHKURT 1965

Borë dhe borë e madhe ka rënë kudo në Shqipëri; rrugët janë zënë. Dëme në njerëz nuk ka, por kjo kohë e keqe na nxjerr probleme. Qytetet janë ca shtrënguar për lëndë druri dhe këtë e kemi problem. Kjo çështje mund të zgjidhet përfundimisht duke e zëvendësuar lëndën e drurit me qymyr, se ky nuk na mungon, por na mungojnë stufat prej gize. Prodhimi i tyre në vend është i paktë, sepse nuk kemi lëndë të parë. Megjithëse stufa të gatshme sjellim, prapë këto janë të pamjaftueshme.

Nga dëbora dhe nga mungesa e ushqimit bagëtia na u dëmtua ca. Më e theksuar kjo ka qenë sidomos në zonat fushore, ku bagëtitë kullosin jashtë dhe dimri i madh i zuri në befasi, kurse malësitë janë në rregull, pse ishin përgatitur më mirë. Megjithatë, për bujqësinë ky mot është i mirë, vetëm të mos fryjë Juga, se mund të na shkrijë bora shpejt, gjë që do të na shkaktonte përmbytje.

Mbrëmë pashë filmin «300 spartanët», një episod nga beteja e zhvilluar kundër persëve në Termopile, e

udhëhequr nga mbreti i Spartës, Leonidha. Mirë paraqiten, sidomos, karakteri i Leonidhës, kostumet, mënyra e luftimeve dhe peizazhi.

* Me mocionin tonë, që u aprovua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, i cili kërkonte që kjo Asamble të fillonte menjëherë punën e saj normale në përputhje me Kartën dhe me rregulloren e saj të brendshme, gjë që pengohej nga përfaqësuesit e SHBA-së e të BS, ne fituam një betejë të rëndësishme politike me rëndësi ndërkombëtare, kundër grupimit më të fuqishëm aktual në botë, grupimit më reaksionar që ka parë historia, siç është ai midis imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik.

Lufta që ne bëmë përpara gjithë botës, në gjirin e OKB-së, kundër këtyre armiqve të egër, ishte një luftë e vështirë, plot kurthe dhe dredhi nga ana e reaksionit botëror.

Ne pritëm momentin më të përshtatshëm që të goditnim, pse kjo kishte rëndësi vendimtare, pse forca e armiqve është e atillë që mund të gjenin një mijë e një dredhi procedurale, që të shpartallonin planin tonë. Gjatë më shumë se dy muajve ne pritëm për të vepruar, të ndodhur përballë vendimeve të turpshme të amerikanëve dhe të sovjetikëve, kur një palë tregonte forcën, tjetra demagogjinë dhe kur të dyja ishin dakord dhe kishin ndarë rolet për t'ia arritur të njëjtit qëllim: të pengonin OKB-në të punonte, ta drejtonin vetëm ata atë, të shtypnin vullnetin e vendeve të tjera anëtare, të zhvillonin një diplomaci të fshehtë dhe diplomacia ame-

rikano-sovjetike të bëhej, të zbatohet, të koordinohet në kurriz të botës, jashtë OKB-së. Të gjitha këto ne i vërenim me kujdes dhe udhëzonim Halimin që të duronte, të jepte herë pas here nga një spunt të vogël të hostenit, herë nga një fjalë, herë nga një halë, për t'u dhënë të kuptonin armiqve që ne po bëjmë nga një goditje, por pa zarar dhe me qëndrimin tonë të qetë u linim të mendonin se mund të vepronin lirisht, sido që frikën na e kishin.

Amerikanët dhe sovjetikët e ujdisë fjalën në mes tyre, ranë plotësisht dakord, komploti u organizua dhe u poq, konspiratorët u përgatitën në errësirë, u rregullua skenari, njerëzit që do të vepronin, ata që do të flisnin, si do të flisnin, si do të votonin dhe dolën në Asamble me «buqetën me lule» për të marrë pëlqimin e «zonjës Asamble».

Ne i dhamë, 24 orë më parë, Halimit udhëzime të sulmonte e të hapte zjarr dhe, me t'i rënë ziles kryetari i sesionit të Asamblesë, ganezi Sakej, shqiponja u vërsul në tribunën e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara e para dhe hodhi, si me thënë, bombën.

Kampi i komplotistëve u gjend në befasi, në panik të madh, miqtë dhe sidomos përfaqësuesit e vendeve arabe dhe të vendeve afrikane duartrokitnin në mënyrë frenetike Halimin. Dhe lufta jonë vazhdoi e pandërprerë deri në fitore. Bravo shoku Halim!

Ai luftoi burrërisht, me vendosmëri, me zgjuarsiri, me urtësi. Shtetet e Bashkuara të Amerikës u përulën përpara vullnetit tonë, ato pranuan votimin dhe i gjithë plani i qelbur u demaskua. Sovjetikët votuan tok me

amerikanët, ata u gjendën në një krevat të ngalatur fort me njëri-tjetrin.

Emri i Shqipërisë u dëgjua në të katër anët e botës për të mirë, shembull luftëtari të patrembur kundër errësirës, për dritën, për paqen, për socializmin. Popujt e vegjël e marrin Shqipërinë si shembull, popujt e robëruar që luftojnë, inkurajohen. Ta mbajmë lart flamurin e Shqipërisë dhe të Partisë sonë.

E HËNË
22 SHKURT 1965

Sot është një kohë e bukur me diell. Po të na mbajë, do të jetë shumë mirë për bujqësinë. Për ushqimin e bagëtisë jemi ca të sëkëlldisur, veçanërisht se kemi mungesë qumështi për shqerrat.

**Mbi rritjen e prodhimit bujqësor në zonat
kodrinore-malore**

Shënime

Në bazë të studimeve, në zonat kodrinore-malore jetojnë 70 për qind e popullsisë fshatare, me 54 për qind të tokës nën kulturë. Këtu prodhohet 56 për qind e prodhimit të përgjithshëm bujqësor, 57 për qind e sasisë së drithërave të bukës, 50 për qind e prodhimeve të frutikulturës, 51 për qind e mishit, dhe 55 për qind e qumështit.

Nga këto shifra, mund të nxjerrim një konkluzion të përgjithshëm, që në tokat fushore duhet ngritur prodhimi i drithërave të bukës, i mishit dhe i qumështit.

tit, pra në zonat fushore duhet intensifikuar bujqësia.

Në zonat kodrinore-malore deri më 1963 ujitja e tokave arriti në 35,2 për qind dhe rendimenti i drithërave në 10,3 për qind për hektar. Kjo mund të konsiderohet jo keq. Bagëtia e imët nga viti 1960 deri më 1963 ka pasur një rënie të vogël, që, deri diku, mund të jetë shkaktuar edhe nga kthimi i disa kullotave në toka buke. Prandaj duhet ta kemi parasysh këtë gjë. Megjithatë është e domosdoshme të shtojmë ujitjen, të rritim rendimentin dhe të mos nënvleftësojmë blegtorinë dhe frutikulturën e ovikulturën.

Në zonat kodrinore-malore ka shumë forca pune, pra ka mundësi të intensifikohet dhe këtu bujqësia në drejtimin e hapjes së tokave të reja; të ngritjes së rendimentit të kulturave bujqësore e të rritjes së krejt prodhimeve bujqësore; të shtimit të blegtorisë; të shtimit të tokave nën ujë; të zgjerimit të frutikulturës etj. Kjo mundësi bëhet dhe duhet të bëhet shumë më e madhe, duke shtuar ca mekanizimin dhe kafshët e punës, siç janë qetë, që i kemi deficitare.

Sipas statistikës prej vitit 1960 deri më 1963 për 13 rrethe krejtësisht kodrinore-malore, rendimenti mesatar i misrit është 13 për qind më i lartë sesa mesatarja e gjithë fshatarësisë, ndërsa rendimenti i grurit 21 për qind dhe si drithëra buke mesatarisht 3 për qind më i lartë. Por po ta shohim problemin duke mbajtur parasysh raportin popullsi-sasi prodhimi sipas sipërfaqes së tokës së mbjellë me drithëra, duket qartë se këto zona nuk arrijnë ta prodhojnë bukën vetë dhe furnizohen nga shteti.

Duke krahasuar prodhimin bujqësor të zonave ko-

drinore-malore me atë të zonave fushore del se diferen-
cat janë mjaft të ndjeshme dhe pasqyrojnë nivelin e
jetesës në zona të ndryshme të republikës.

Zonat kodrinore i sigurojnë të ardhurat e tyre 47
për qind nga bimët e arave, 16 për qind nga frutikul-
tura, 37 për qind nga blegtoria. Zonat fushore 57 për
qind të të ardhurave i marrin nga bimët e arave, 10 për
qind nga frutikultura, 33 për qind nga blegtoria. Pran-
daj duhet të luftohet për ngritjen e rendimentit të bi-
mëve të arave në të dyja zonat dhe veçanërisht në zonat
fushore ku konditat janë më të mira. Për sa i përket
blegtorisë, në zonat kodrinore-malore, duhet të zhvillo-
het kooperimi i blegtorisë, rritja e sasisë së saj si dhe
e prodhimit blegtoral. Në zonat fushore, të ardhurat
nga blegtoria janë shumë të pakta, prandaj atje duhet
t'i shtojnë sidomos lopët e racës. Po të shohim si punojnë
dhe sa punojnë njerëzit në të dyja zonat, ne kon-
statojmë shifra të hidhura. Njerëzit e zonave fushore
punojnë më shumë (si ditë-punë) se ata të zonave ko-
drinore-malore dhe përqindjet e atyre që realizojnë më
pak se 100 ditë-punë janë të larta.

Prandaj Partisë i dalin detyra të mëdha për edu-
kimin me ndjenjën e dashurisë për punën, për të luftuar
në mentalitetin e fshatarësisë të kënaqurit me pak, për
të luftuar dembellëkun, patriarkalizmin, parazitizmin
dhe paditurinë në zonat kodrinore-malore. Të forcojmë
dashurinë për punën e kolektivizuar, të disiplinuar.

Interesimi i organeve të bujqësisë ka qenë më i
madh për zonat fushore dhe fare pak për kooperativat
e thella malore. Kjo duhet të ndreqet sa më parë.

Rrethet krejtësisht malore kanë një pakësim të
pendëve të qeve në masën 50 për qind në raport me to-
kën dhe me paraluftën. Kjo është jashtëzakonisht se-
rioze. Kjo do të thotë që toka nuk punohet e gjitha, pu-
nohet cekët dhe rendimentet nuk ngrihen, sepse afati i
mbjelljeve zgjatet shumë.

Me sa duket kooperativistët e zonave kodrinore-ma-
lore nuk i bëjnë drithit shërbimet e duhura, bëjnë pak
ditë-punë, nuk vlerësojnë plehun organik etj.

Bagëtia në zonat kodrinore-malore duhet të zhvi-
llohet më mirë. Lopët japin pak prodhim, 323 kilogramë
qumësht në vit, që është nën mesataren për republikë
dhe shumica mbahen për vica. Bagëtia e imët mund të
shtojë prodhimet në rast se sigurojmë ushqim të boll-
shëm, stalla dhe u bëjmë mirë shërbimet e tjera. Pra
edhe në këto drejtime duhet të marrim shumë masa.

Frutikultura në zonat kodrinore-malore zë pjesën
më të madhe të aktivitetit. Në vitin 1963 në këto zona
69 për qind të prodhimit e morën nga frutikultura, 72
për qind e pemëve dhanë prodhim, po kështu edhe 81
për qind e ullinjve, por rendimentet ishin shumë të ulët-
ta, gjë që erdhi nga mungesa e shërbimeve. Prandaj
edhe këtu duhen marrë shumë masa të forta dhe të kri-
johet një edukatë e re.

Rol të madh në ngritjen e rendimentit të drithë-
rave dhe veçanërisht të misrit në zonat kodrinore-ma-
lore luan uji. Në qoftë se sigurojmë ujitjen, këto zona
me siguri prodhojnë bukën. Prandaj duhet të studiojmë
mundësitë materiale dhe financiare për ndërmarrjen
e këtij aksioni të madh jetik.

Të caktohen rregulla për plehrat organike që do të përdorin kooperativat bujqësore, duke mbajtur parasysh edhe nevojat që kanë oborret e kooperativistëve. Të shikohen mënyrat e shtimit dhe të mirëmbajtjes së plehut të kafshëve.

E MARTË
23 SHKURT 1965

Vazhdon të jetë kohë e bukur me diell.

Qetësi e madhe për sa i përket luftës kundër revizionistëve. Vetëm ne po flasim. Revizionistët janë mbledhur si gërthëla, nuk flasin, nuk pipëtojnë, ata punojnë në heshtje. Taktikë e tyre e re. Kina, Koreja etj. kanë pushuar. Vallë do të flasin këto për mbledhjen e 1 marsit? Mendoj se do të jetë skandaloze në qoftë se jo, por nuk e besoj që të heshtin.

Revizionistët sovjetikë kanë hartuar një taktikë të re, atë të shuarjes, gati krejt, të polemikës nga ana e tyre. Nuk i përgjigjen fare polemikës sonë. bëjnë sikur e injorojnë, duke pranuar edhe rriskun e demaskimit të tyre.

Kërkojnë të japin përshtypjen se janë për unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe se ne jemi gjoja të vetmit për vazhdimin e polemikës, pra për përçarjen. Hiqen sikur duan të mos japin asnjë shkas për

ndezjen e polemikës. Ata e panë se vija e tyre tradhtare provokuese dhe ofenduese dha rezultate shumë të këqija për ta, prandaj, me këtë taktikë të heshtjes, përpiqen të na imponojnë heshtjen.

Ata heshtin sidomos ndaj Kinës, taktikat e së cilës, dhe kryesisht parullën oportuniste kineze «po të na sulmojnë, ne do t'i sulmojmë», i kanë studiuar mirë. Në fakt, që prej rënies së Hrushovit, sovjetikët nuk i ngasin kinezët, por edhe këta nuk i ngasin. Që nga rënia e tij kinezët nuk kanë shkruar veçse një artikull. Në mbledhjet ndërkombëtare, kinezët diku kanë bërë nga një kritikë indirekte, sovjetikët dhe të tjerët bëjnë veshin e shurdhër dhe nuk e ngrenë sfidën.

Pasi trumbetuan, pra, me të madhe se «ne jemi për shuarjen e polemikës, për unitetin» etj., tani revizionistët sovjetikë heshtin. Kritikoji po deshe, demaskoju, ata nuk përgjigjen.

Nga ana tjetër, si kundërpeshë demagogjike, ata përdorin vajtjen e Kosiginit në Vietnam, në Kinë, në Kore dhe trumbetojnë me tamtame «unitetin në luftën kundër provokacioneve amerikane». Në këtë drejtim, në sipërfaqe dhe për arsye demagogjike, për të gënjer dhe për të fshehur veprimet e tyre nën rrogos, ata kanë lëvizur nga taktika e Hrushovit, flasin më shumë në gazeta jo vetëm kundër «të tërbuarve», por edhe kundër imperializmit amerikan dhe disa herë edhe kundër administratës së Xhonsnit. Natyrisht, këto i dozojnë me kujdes, pse janë larg të presin urat, të cilat, përkundrazi, i forcojnë pa bërë bujë.

Kjo taktikë e re e revizionistëve u pëlqen edhe imperialistëve amerikanë, të cilët nuk zemërohen dhe as

egërsohen nga klithmat e revizionistëve sovjetikë. Kjo asgjë nuk u prish amerikanëve, pse lidhjet dhe puna e tyre vazhdojnë edhe më mirë se në kohën e Hrushovit, për arsye se kjo taktikë revizioniste gënjen më shumë, kurse ajo e Hrushovit acaronte.

Titistët, nga ana e tyre, heshtin, kanë mbledhur këmbët, po i adaptohen taktikës së re amerikano-sovjetike, punojnë nën rrogos dhe kontribuojnë në krijimin e njëfarë qetësie, për të cilën kanë nevojë planet e tyre tradhtare dhe agresive.

Pra, në arenën ndërkombëtare revizionistët modernë sovjetikë:

- 1) Hiqen kundër imperializmit amerikan dhe flasin më shumë.
- 2) Trumbetojnë se u arrit «uniteti», se ky po forcohet.
- 3) Konsolidojnë pa bujë lidhjet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- 4) Përpiqen të forcojnë sundimin mbi revizionistët e tjerë.
- 5) Me anë kredish dhe me demagogji fillojnë të lëvizin në vendet e posaçliruara.

Brenda në Bashkimin Sovjetik, për të dhënë përshtypjen se diçka ka ndryshuar, bëjnë disa korrigjime flagrante të aventurierit Hrushov, por kurdoherë në kuadrin e vijës së kongreseve të 20-të e të 22-të, sjellin ata njerëz revizionistë që Hrushovi i kishte skartuar. Këtë e bëjnë për t'u hedhur të tjerëve hi syve.

Ata ecin me prurë në çdo drejtim, me demagogjinë më të hollë, për të mëkëmbur situatën e tronditur, për të fituar kohën e humbur, për t'u konsoliduar

dhe më pas për të na goditur ne më fort me forca të përtëritura.

Kush nuk e ka parasysh këtë taktikë të revizionistëve, ai do të gabojë. Kush u beson qoftë një fije demagogjisë dhe hilesë së tyre, ai do ta pësojë keq. Kush ka shpresa nga këta armiq, ai do të dëmtohet rëndë dhe do të ketë deziluzione të tmerrshme.

Partia jonë nuk do të gënjehet kurrë, nuk do të ngopet kurrë me lugë të zbrazët dhe nuk do ta pushojë kurrë luftën kundër këtyre tradhtarëve. Ajo do t'u çjerrë çdo maskë që ata do të tentojnë të vënë në fytyrë.

E MËRKURË
24 SHKURT 1965

Koça u prish, por shi nuk bie. Në krahina të tjera të vendit, diku bie shi, diku bie borë. Vetëm të mos fryjë Juga, se na shkrin borën dhe na nxjerr telashe.

Ambasadori sovjetik në Paris u takua me Dë Golin. Asgjë nuk do të nxjerrin, gjithçka është *ballons d'essai*¹. Kinezët nuk na kanë shfaqur akoma mendimin e tyre për këto tratativa që po bëjnë borgjezia dhe revizionistët.

1. Frëngjisht — sprovë sondazhi.

E ENJTE
25 SHKURT 1965

Delegacionet revizioniste filluan të venë në Moskë për të marrë pjesë në mbledhjen e marsit, e cila tash është e sigurt se do të mbahet.

E PREMTE
26 SHKURT 1965

Shi dhe dëborë e madhe po bie në të gjithë vendin. Na lajmërojnë se kemi ca dëme në bagëti. Këto do të na dalin të dobëta nga dimri, përveç humbjeve në krerë. Në njerëz deri tash s'kemi asnjë dëm.

Sonte më lajmëruan se na ka ndodhur një katastrofë në zonën e Martaneshit; na u vranë në borë 11 veta të ekspeditës gjeologjike të Batrës. Kjo ekspeditë, e përbërë prej 20 vetash, u nis në dy drejtime për të kërkuar një punëtor të humbur. Njërin pjesë e mbuloi një ortek i madh bore prej 50 metrash trashësi, që u shkëput nga mali. U dërguan ndihma, por shokët nuk u shpëtuan dot. Duhet të presim të shkrijë bora. U ndihmuan urgjentisht familjet e tyre.

Në fund të muajit shkurt po duket buqeta e pleksur me një numër të madh manovrash mashtrimi dhe demagogjie për çështjen vietnameze.

Lufta heroike e partizanëve të Vietnamit të Jugut

Jo vetëm u ka ulur prestigjin përtokë imperialistëve amerikanë, por i ka futur në një qorrrokak të tmerrshëm nga ana ushtarake. Lufta kolonialiste u ka shkaktuar atyre humbje dhe disfata të mëdha politiko-ushtarake, ua ka dobësuar jashtëzakonisht pozitat brenda në Vietnam, por edhe jashtë Vietnamit. Një gjendje e tillë i demaskon botërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës i dobëson ato edhe në rajonet e tjera të botës, ku ato po veprojnë me zjarr e me hekur, por edhe atje ku ato veprojnë me shantazhe e presione me anë të dollarit. Lufta heroike e vietnamezëve i ka dërrmuar plotësisht nga çdo pikëpamje, kukullat vietnameze të amerikanëve dhe e tregon në të tërë lakuriqësinë e saj se lufta në Vietnam mbahet gjallë vetëm nga amerikanët; pa këta, kukullat vietnameze nuk mund të qëndrojnë asnjë ditë.

Tani në Vietnam vihet çështja që Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose të qërohen sa më parë dhe të ikin me turp të madh prej andej, ose të vazhdojnë luftën koloniale pa perspektivë. Imperialistët amerikanë përpiqen dhe do të përpiqen deri në fund të shpëtojnë ndërin dhe të fillojnë negociatat nga pozitat e forcës, ose, pas ndonjë «aksioni të bujshëm», të mund të tregohen gjoja zemërmëdhenj dhe të fillojnë bisedimet.

Mirëpo për bisedime kinezët dhe Vietnami i Veriut kanë vënë konditë të drejtë, të fortë. Më parë se të bisedohet duhet që amerikanët të largohen nga Vietnami i Jugut dhe nga e gjithë Indokina. Natyrisht, ne kemi bindjen se partizanët vietnamezë në asnjë mënyrë nuk do të hedhin armët dhe nuk do të pranojnë asnjë kompromis që të dëmtojë luftën e tyre çlirimtare.

Pra, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë vënë

në mes dy zjarreve të mëdha që po i përvëlojnë; po rrezikohet jo vetëm prestigji i tyre, por u prishen të gjitha planet agresive në Azi, të gjitha bazat strategjike të luftës së tyre kundër Kinës, Vietnamit, Koresë, Indonezisë. Rrezikohet baza e tyre në Tajvan, dobësohen pozitat e tyre në Japoni, pse do të ketë reperkusione, kurse mbështetja e tyre tek India është e dobët, e lëkundshme dhe akoma e pakonsoliduar për ta pasur një bastion të sigurt kundër Kinës.

Tani del qartë se një nga qëllimet kryesore të vajtjes së Kosiginit në Vietnamin e Veriut ka qenë t'i futë vietnamezët në thes për të kurdisur me amerikanët (në mos e kishin gjetur fjalën më parë me ta) një rrugëdalje, një rrugë shpëtimi për imperializmin amerikan. Kosigini sigurisht do të luftonte që vietnamezët e Jugut të ngadalësonin luftën, që vietnamezët e Veriut ta pranonin këtë tezë kapitulluese dhe si konsekuencë të pranonin *les bons offices*¹ të sovjetikëve pranë amerikanëve për bisedime paqësore në Gjenevë ose ndonjë mbledhje të re ndërkombëtare për Vietnamin. *Les bons offices* të sovjetikëve as nuk do të preknin çështjen e «largimit të forcave amerikane nga Vietnami», pale nga e tërë Indokina që jo e jo. Në këtë mënyrë revizionistët sovjetikë merrnin flamurin e «lavdisë» se gjoja me anë bisedimesh dhe me «furnizim armësh dhe ndihmash Vietnamit të Veriut», furnizim vetëm në kartë, arritën «paqësimin në Vietnam», «shuarjen e një vatre lufte» etj., etj. profka. Por si duket ky plan i revizionistëve sovjetikë dështoi, pse partizanët vietnamezë bënë një *salut* të

1. Frëngjisht — ndërmjetësim.

mirë e me sukses kundër amerikanëve. Kina nuk e pranoi këtë plan falimentues, nuk e pranoi as RD e Vietnamit.

Kosigini ka më tepër se dy javë që është larguar nga RD e Vietnamit, dhe vetëm sot vendosi t'u flasë për këtë udhëtim popujve sovjetikë nga televizioni. Sigurisht, duhej të rregullonte frazat dhe të gjente disa arsye për të trajtuar çështjen e Vietnamit. Gjatë këtyre dy javëve diplomacia sovjetike bëri një hap gjoja të bujshëm, ajo përputhi mendimet e saj mbi Vietnamin me ato të Dë Golit dhe që të dy u deklaruan dakord «se çështja e Vietnamit duhet të zgjidhet me bisedime dhe jo me armë». Teza golistë është që për këtë të mblidhen të pesë, në mbledhje ndërkombëtare (dhe jo në Gjenevë). Për këtë zgjidhje duhet të jenë dakord edhe sovjetikët, dhe këta, për t'u gjetur një rrugëdalje konditave kino-vietnameze, e braktisën idenë e vazhdimit të konferencës së Gjenevës dhe, që të forcojnë këtë ide të re, nuk e «vunë fare në dijeni» qeverinë angleze, që është bashkëkryetare me Bashkimin Sovjetik për konferencën e Gjenevës. Qeveria angleze hiqet si e pizmosur nga ky veprim i shkëputur sovjetik.

Sovjetikët, nga ana e tyre, duan, së pari, të tregojnë, se kjo iniciativë e tyre është një iniciativë krejt e re, dhe së dyti, ata mendojnë t'u bëjnë njëfarë shantazhi amerikanëve, duke u thënë se gjoja qëndrimet tuaja na shtynë ne sovjetikët të lidhemi me Dë Golin.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga ana e tyre, bëjnë sikur e kanë veshin e shurdhër, sikur s'dinë gjë dhe se ata pranojnë të bëjnë bisedime, por duhet më

parë RD e Vietnamit të bëjë deklarata se «do të ndalojë agresionin kundër Vietnamit të Jugut».

Siç po shihet, diplomacia sovjetike e ka humbur krejt toruan, ajo përpiket të rrojë me ekspedientë e me kompromise, me hile e me dallavere. Bashkimi Sovjetik është vënë, nga udhëheqja e tij tradhtare, në mes të zjarreve dhe po korr disfata pas disfatash.

Çështja e Vietnamit, që Kosigini mendoi se do t'ia forconte pak pozitë udhëheqjes revizioniste sovjetike, do t'ia çjerrë akoma më shumë maskën. Duhet të luftojmë çdo orë për këtë disfatë të revizionistëve.

E SHTUNË
27 SHKURT 1965

Lexova tekstin e fjalimit të Kosiginit, mbajtur dje në televizionin sovjetik dhe transmetuar nga agjencia TASS, lidhur me vizitën e tij në vendet socialiste të Azisë: në RD të Vietnamit dhe në RDP të Koresë. Ky fjalim vërteton mendimet që unë kisha formuar lidhur me qëllimet e vërteta të kësaj vizite. Kështu Kosigini eviton të mbrojë hapur luftën e popullit të Vietnamit të Jugut dhe nga ana tjetër nuk do që të komprometohet e të ndeshet me amerikanët. Për asgjë nuk flet kundër, asnjë fjalë nuk thotë për forcat amerikane që duhet të largohen nga Vietnam i Jugut. Pra për Kosiginin është i shtrenjtë prestigji i imperialistëve amerikanë. Në të kundërt, ai flet për Korenë e Jugut, nga ku duhet gjithashtu të ikin forcat amerikane. Këtë ai e bën sepse këtu është pa zarar, pse s'ka luftë dhe acarim si në Vietnam.

I dërgova Ramizit disa ide lidhur me këtë çështje, si dhe kopjen e fjalimit të Kosiginit, ku anës fletëve shënova teza e mendime për t'i përdorur në një artikull që mendoj të shkruajmë për demaskimin e politikës

sabotuese të revizionistëve sovjetikë ndaj luftërave çlirimtare të popujve¹.

Artikullin duhet ta botojmë shpejt që të mos i ikë aktualiteti, sepse do të dalin gjëra të tjera.

— Disfata ushtarake dhe rënia e prestigjit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës vijnë nga lufta heroike e Vietnamit të Jugut.

— Provokacionet amerikane kundër Vietnamit të Veriut janë një përpjekje kundërveprimi ndaj fitoreve të vietnamezëve të Jugut.

— Prandaj, kur «mbrohet» Vietnam i Veriut dhe nuk mbrohet me konsekuencë lufta e Vietnamit të Jugut, kjo do të thotë të mos mbrosh as Vietnamin e Veriut, ose të bësh demagogji. Kësaj i thonë t'i vësh pak melhem plagës së madhe të hapur që të mos demaskohesh sheshit.

— E gjithë «mbrojtja» që Kosigini i bën qoftë Vietnamit të Veriut, qoftë gjithë Indokinës, konsiston në fraza, në konstatime, në thirrje e lutje.

— Politika e revizionistëve sovjetikë gjendet në batak dhe borgjezia e quan fjalimin e Kosiginit të moderuar, se s'ka si ta quajë revizionist, oportunist dhe në bisht të situatës. Politika e jashtme sovjetike tjerr leshin që i servir borgjezia imperialiste e Uashingtonit, e Parisit, e Londrës.

— Lufta nacionalçlirimtare e popujve është strumbullari kryesor, faktori vendimtar i situatave të krijua-

1. «Trojka hrushoviane, Brezhnjev-Kosigin-Mikojan, në rrugën e mohimit dhe të sabotimit të luftërave çlirimtare të popujve» («Zëri i popullit», 3 mars 1965). Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 149.

ra; e vetmja politikë e drejtë qëndron në atë që të ndihmohet me të gjitha mjetet kjo luftë që imperialistët kërkojnë të shtypin.

— Por, meqë nuk e shtypin dot dhe krijohen situata të rënda në çdo drejtim, imperialistët sajojnë gjithfarë manovrash, gjithfarë intrigash, gjithfarë propozimesh. Revizionistët sovjetikë përpiqen të kapen pas tyre, t'i trajtojnë sipas formulimeve të njohura, për të mos bërë gjë, veçse t'i bien legenit për të gënjer dhe për të ndihmuar agresorët.

— Kur partizanët vietnamezë po shkojnë nga fitorja në fitore, revizionistët sovjetikë, përpiqen në fakt, me qëndrimet e tyre oportuniste ndaj amerikanëve, ta dobësojnë këtë luftë dhe këtë avantazh.

— Të tentosh të zbatosh «bashkekzistencën paqësore me amerikanët» në kurriz të popullit të Vietnamit të Jugut ose të popujve të Laosit, të Kongos, siç bëjnë revizionistët sovjetikë, kjo është tradhti ndaj këtyre popujve që luftojnë. Frazat dhe demagogjia s'pinë ujë për shumë kohë. Lufta çlirimtare i demaskon këto.

— E vetmja rrugë e zgjidhjes së problemit vietnamez dhe laosian është tërheqja imediate e forcave amerikane nga këto vende, ose lufta deri në fund për t'i hedhur në det. Kjo duhet të jetë zgjidhja e vetme e drejtë për popujt që luftojnë për liri.

— Jashtë amerikanët nga vendet sovraane! Le t'i zgjidhin vetë popujt çështjet e brendshme të tyre!

— Pse Bashkimi Sovjetik nuk guxon të mbajë hapur këtë qëndrim? Në qoftë se revizionistët sovjetikë e quajnë këtë qëndrim të gabuar, pse nuk e thonë hapur? Nuk mjafton për Bashkimin Sovjetik të thotë vetëm

fjalë, por duhet të vërë të gjithë peshën e tij të madhe në balancë, që të vendoset drejtësia.

— Është aktualisht në gjendje Bashkimi Sovjetik ta bëjë këtë gjë? Tani jo, pse e kanë zënë në grykë revizionistët, agjentët ideologjikë të borgjezisë imperialiste.

— Po të mos ishte kështu, Bashkimi Sovjetik do të bënte që imperializmit amerikan me kohë t'i dridhe-shin këmbët. Është për këtë që imperialisto-revizionistët e duartrokitën vdekjen e Stalinit të madh dhe shpifën kundër tij. Por marksizëm-leninizmi, që mbronte Stalini, rron e do të triumfojë.

*** Agjencia kineze e lajmeve njofton se në shtypin kinez do të botohen artikujt dhe fjalimet e Hrushovit (vëll. 3) të cilat i cilëson si plehra. Mirëpo botimi i tyre në shtypin kinez nuk është fare pa rrezik, sepse në ato plehra ka dhe demagogji, e cila mund të gënjejë njerëz. Në rast se nuk i demaskon (dhe jo vetëm me 9 artikuj) dhe nuk i komenton ato, një gjë e tillë mund të të dëmtojë. Kinezët në disa gjëra janë të çuditshëm.**

Shokët kinezë japin shenjat e zakonshme sikur do të shkruajnë kundër mbledhjes së 1 marsit. Kjo do të jetë shumë mirë. Pritet një gjë e tillë, sepse kanë kaluar 4 muaj dhe gjer tani kanë shkruar vetëm një artikull.

Bisedova me Ramizin për artikullin ku demaskojmë fjalimin e Kosiginin mbi udhëtimin e tij në Azinë Juglindore.

Kinezët na njoftuan se sovjetikët u kërkuan pikëpamjet e tyre për çështjen e Vietnamit, pasi kishin bërë përçapjet me francezët dhe me anglezët dhe i kishin shpallur me bujë propozimet e tyre. Kinezët natyrisht, nuk ishin të kënaqur, por, ajo që ka rëndësi, ata nuk ishin dakord me propozimet sovjetike. Kinezët nuk lëvizin nga pikëpamjet e tyre dhe nga kushti, sipas të cilit s'ka bisedime dhe mbledhje ndërkombëtare pa u tërhequr amerikanët nga Vietnamit. E dyta, pasi të tërhiqen nga Vietnamit i Jugut, duhet të thirren në mbledhje edhe partizanët e Vietnamit të Jugut. Ne jemi dakord me këtë qëndrim, se është i drejtë.

Lëvizje e madhe diplomatike në këtë fund muaji për çështjen e Vietnamit. Imperialistët amerikanë thonë se «mund të bisedohet për çështjen e Vietnamit, por me konditë që Vietnamit i Veriut t'i japë fund agresionit». Francezët me sovjetikët thonë «të mblidhemi në Gjenevë, por Shtetet e Bashkuara duhet të pushojnë bombardimet në Vietnamit e Veriut». Kina dhe Vietnamit thonë se «bisedojmë, por më parë amerikanët duhet të tërhiqen nga Vietnamit i Jugut dhe nga e gjithë Indokina».

Pozita e kinezëve dhe e vietnamezëve është e drejtë dhe e fortë. Tash të shohim si do të zhvillohen punët, se mos bëhet ndonjë kompromis.

Revizionistët do të bëjnë mbledhjen e 1 marsit. Delegacionet e partive revizioniste po venë në Moskë si kusarët, në majë të gishtërinjve, pa bujë, pa pritje e pa propagandë në shtyp. Edhe në bisedimet duhet të mbajnë maskën e konspiratorëve e të komplotistëve.

E HËNË
1 MARS 1965

Tradhtarët revizionistë, të kryesuar nga ata sovjetikë, hapën sot mbledhjen famëkeqe të komisionit përgatitor, së cilës i kanë ndërruar tabelën duke e pagëzuar me emrin «mbledhje konsultative». Natyrisht atje marrin pjesë gjithë revizionistët, me përjashtim të rumunëve, të cilët refuzuan të venë. Kjo është pozitive nga ana e Rumanisë.

Kinezët, në gazetën e tyre «Zhenminzhibao», vazhdojnë t'i ngacmojnë sovjetikët. Siç duket po përgatitin terrenin për një artikull për demaskimin e mbledhjes. Kjo është një shenjë e mirë, pse kanë kaq kohë që po heshtin!

1. Po në këtë datë, autori ka hedhur në Ditar shënimin: «Revizionistët modernë po bëjnë demagogji me «frontin e përbashkët antiimperialist», botuar në librin: «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 205.

E MARTË
2 MARS 1965

Sot fryn erë e madhe nga jugu. Bora po shkrihet dhe ujërat janë duke u ngritur, sidomos në Shkodër dhe në Lezhë; në Bahçallëk uji ka dalë gjysmë metri mbi rrugë, aq sa veturat nuk kalojnë dot. Do të ishte mirë të mbetej me kaq.

Pashë përfundimisht artikullin «Trojka hrushoviane, Brezhnjev-Kosigin-Mikojan, në rrugën e mohimit dhe të sabotimit të luftërave çlirimtare të popujve». Nesër ai do të botohet në gazetën «Zëri i popullit».¹

Agjencitë e lajmeve njoftojnë se mbrëmë agresorët amerikanë bombarduan përsëri objektiva në Vietnamin e Veriut. Emocion, zemërim dhe urrejtje në gjithë botën sot kundër akteve barbare amerikane. Revizionistët sovjetikë shumë të hutuar ndodhen në rrugëkryq, s'dinë ç'të bëjnë, ata po demaskohen keqas për qëndrimet e tyre proamerikane.

1. Shih në këtë vëllim, f. 134.

E MËRKURË
3 MARS 1965

Sot në mëngjes u mbledhëm në Presidiumin e Kuvendit Popullor, ku u bë ceremonia e dekorimit me titullin «Hero i Punës Socialiste» të shokut tonë të dashur, Hysni Kapos, që mbushi 50 vjet. Foli shoku Haxhi Lleshi, i cili vuri mirë në dukje meritat e mëdha të shokut Hysni, si në kohën e luftës, ashtu edhe në këtë të pasluftës. Pastaj shoku Hysni mbajti edhe ai një fjalim plot ndjenja dhe emocione. Dekorim shumë i merituar.

Revizionistët modernë vazhdojnë mbledhjen e tyre përçarëse në fshehtësi të madhe. U detyruan të lëshojnë një deklaratë kundër bombardimeve amerikane në Vietnamin e Veriut.

E ENJTE
4 MARS 1965

Të gjithë shokët së bashku vajtëm uruam shokun Hysni me rastin e 50-vjetorit të lindjes dhe i dorëzuam mesazhin e urimit në emër të Komitetit Qendror.

Në mbrëmje, në Shtëpinë e Partisë, dhamë një darkë për nder të shokut Hysni. Darka ishte shumë e ngrohtë dhe e gëzuar. Në fjalën time vura në dukje meritat e shquara të Hysniut si komunist dhe si udhëheqës, trimërinë, pjekurinë, dashurinë e ngrohtë dhe të sinqertë të tij me shokët, thjeshtësinë, punën e palodhur dhe besnikërinë e madhe ndaj Partisë.

Artikulli ynë i djeshëm për trojkën hrushoviane i vuri udhëheqësit sovjetikë në vështirësi të jashtëzakonshme dhe demaskoi manovrat e tyre. Ne demaskonim, përveç të tjerave, faktin e bujshëm skandaloz që Kosigini nga Vietnami nuk deklaroi kërkesën e arsyeshme dhe kyç të problemit vietnamez: tërheqjen e trupave amerikane nga Vietnami i Jugut. Në qoftë se nuk bëhej kjo kërkesë, atëherë çdo gjë ishte bluf dhe demagogji. Sovjetikët, natyrisht, nuk e bënë këtë, pse nuk ua lejonte as zemra, as vija e tyre revizioniste, por ndoqën

rrugën e natyrshme të tyre të blifit dhe të demagogjisë. . . Por, pasi doli artikulli ynë, përpara demaskimit tonë, revizionistët modernë u detyruan të veprojnë. Në mëngjes ata morën përmbajtjen e artikullit tonë, i cili që në orët e para pati një jehonë të madhe ndërkombëtare dhe, në mbrëmje, të mbledhur për «konsultime», lëshuan një komunikatë të përbashkët ku «dënojnë bombardimet amerikane në Vietnamin e Veriut dhe kërkojnë tërheqjen e trupave amerikane nga Vietnam i Jugut». Pra, sovjetikët e ndërmorën këtë hap të hidhur për t'i shpëtuar demaskimit; këtë akt formal e bënë gjoja nga ana e «partive». Dhe në fakt, ky akt formal nuk e preku asnjë grimë qëndrimin kapitullues të revizionistëve sovjetikë, pse nga ana qeveritare ata mbajnë fort pozitat e tyre, për mostërheqjen e trupave amerikane nga Vietnam i Jugut. . .

Fakt është se qëndrimet tona po bëjnë një efekt të madh dhe bota po i studion me vëmendje dhe i komenton gjerësisht. Qëndrimet tona politike dhe ideologjike lënë gjurmë të thella, orientojnë drejt revolucionarët dhe u prishin planet e demaskojnë armiqtë, të cilët s'kanë tjetër ç'të thonë, veçse u kanë mbirë në gojë fjalët se ne «jemi satelitë të Kinës», «jemi zëdhënësit e Kinës», se ne «marrim urdhra nga Pekini». Por këtyre profkave kanë filluar edhe ata vetë të mos u besojnë, pale të dinë ata që ne jo vetëm nuk marrim urdhra dhe direktiva nga Pekini për qëndrimet tona, por as edhe koordinimin më të vogël nuk kemi me kinezët për këto punë. Shpifjet e armiqve neve s'na prishin punë, ne jemi internacionalistë, ne bëjmë punën tonë të drejtë, revolucionare, për socializmin, për komunizmin, për revolu-

cionin botëror. Vetëm kjo ka rëndësi, dhe rëndësi vendimtare, dhe kjo bëhet me konsekuencë kur udhëhiqesh nga teoria jonë e pavdekshme, marksizëm-leninizmi.

Është e qartë se demonstrata e sotme antiamerikane në Moskë ishte violente nga të dyja palët, si nga ana e demonstruesve, ashtu edhe nga ana e policisë sovjetike. Kjo demonstratë nuk ishte si ato parakalimet «paqësore» që organizojnë revizionistët sovjetikë sa për të kaluar radhën. Si nga njëri krah ashtu edhe nga tjetri u tregua vendosmëri. Nga demonstruesit u tregua heroizëm, guxim, shpirt revolucionar, nga ana e policisë revizioniste u tregua dobësi, frikë, frymë antirevolucionare dhe u përdor shtypja e kërbaci. Njëra anë shprehte urrejtjen kundër imperializmit amerikan, ana tjetër mbronte ambasadën amerikane në Moskë, dhe jo vetëm pse e donin rregullat diplomatike, por se politikisht ata duhej t'i mbronin, pse kështu mbronin vijën e tyre kapitulluese dhe i qëndronin besnikë parimeve të bashkëzistencës me armiqtë e klasës.

Në demonstratë shumica, sipas agjencive të huaja, ishin studentë të huaj, kinezë, vietnamezë etj., por atje kishte dhe studentë sovjetikë, në mos edhe popull, gjë që nuk mund kurrësi të ekskludohet në këto raste. Këtë gjë e vërteton edhe vetë agjencia TASS, e cila thotë se demonstruesit shkuan edhe përpara ambasadës së Republikës Demokratike të Vietnamit ku foli, përveç të tjerëve, dhe përfaqësuesi i studentëve sovjetikë. Pra demonstrata kishte karakter solidariteti ndërkombëtar,

anti-amerikan. Është vështirë të mendosh se revizionistët sovjetikë nuk kanë pasur dijeni për këtë demonstratë, por, me sa duket, u iku nga kontrolli. Me siguri ata nuk kanë dashur ta sabotonin, as ta copëtonin nëpër rrugë, gjë për të cilën kanë në dispozicion mjete të çfarëdo-llojshme, pse po ta bënë këtë, atëherë do të demaskoheshin akoma më tepër. Edhe ambasada amerikane, sipas agjencive të lajmeve, ishte në dijeni që më parë dhe kërkoi mbrojtje nga Ministria e Punëve të Jashtme e Bashkimit Sovjetik dhe kjo i mori masat dhe ndërtoi katër barrikada prej hekuri, policësh, ushtarësh dhe kavalerie, përpara dhe përreth kështjellës kapitaliste të Xhonsonit në Moskë.

Kështu që qeveria revizioniste sovjetike, në pamundësi të ndalonte demonstratën, mori masa ta shtyp-te, në rast se ajo nuk do të mundte ta kthente në një demonstratë gandiste¹.

Pra demonstrata, me të mbërritur para ambasadës, u shndërrua në një demonstratë me tërë kuptimin e fjalës revolucionare, anti-amerikane dhe antirevizioniste. Kavaleria, policia dhe ushtria sulmuan me kërbac dhe gjakosën demonstruesit, të cilët u përleshën me ushtarët e Kerenskëve dhe Roziankovëve të rinj, kapërcyen të katër barrikadat dhe e bënë helaq fasadën e ambasadës së Xhonsonit dhe njëkohësisht fytyrat e Sbirëve², të Brezhnjevëve dhe të Kosiginëve.

Revizionistët e treguan hapur fytyrën e vërtetë të tyre në Moskë në popull, kundër Vietnamit, kundër

1. Nga frëngjishtja — çunakësh qesharakë.

2. Nga frëngjishtja — të policëve.

Kinës, kundër revolucionit, ata treguan fytyrën e tyre brutale të kundërrevolucionarëve, të borgjezisë së egër, aleate të borgjezisë imperialiste.

Kjo ishte një fitore e madhe, pse ndodhi në Moskë dhe do të ketë jehonë në botë, por veçanërisht në Bashkimin Sovjetik. Kjo ka shumë rëndësi pse është një sinjal i parë, që i thotë popujve sovjetikë: hapni sytë e shikoni se ç'po bëhet në botë, shihni si ju gënjen udhëheqja, shihni si i mbron kjo amerikanët dhe gjakos popullin. Kjo demonstratë u thotë po ashtu sovjetikëve: ja ç'do të thotë «bashkekzistenca paqësore» e udhëheqësve tuaj revizionistë, ja se si i mbrojnë me demagogji udhëheqësit tuaj tradhtarë popujt dhe luftën nacionalçlirimtare të tyre, ndërsa në realitet ata i godasin, i gjakosin përpara ambasadorit amerikan, Kohler, i cili bën sehir dhe fërkon duart nga dritarja e ambasadës së tij, kur gjaku derdhet në rrugë, dhe më vonë me cinizëm prej padroni prepotent, i dërgon lakeut të tij Gromiko urime «për guximin dhe heroizmin e milicëve sovjetikë që mbrojtën ambasadën amerikane», duke kërkuar që herët e tjera të mbrohet më mirë, domethënë të skuqet me më shumë gjak bulevardit të Moskës. Gromiko, me përulje, i përgjigjet: «Si urdhëron, herë tjetër do ta bëjmë më mirë».

Të gjitha këto tani i mendojnë më mirë popujt sovjetikë dhe prandaj unë besoj se kjo demonstratë e vogël, por e përgjakshme, do të ketë jehonën e saj të madhe. Popujt sovjetikë do të marrin më shumë kurajë dhe, në mos sot, nesër do të dinë të shfryjnë zemërimin.

Kjo perspektivë është e tmerrshme për revizionistët

hrushovianë, ata janë në rrugëkryq përpara disfatës, e cila nuk është përveçse çështje kohe dhe koha punon për revolucionin.

Këtë veprim të guximshëm të demonstruesve të Moskës duhet ta shfrytëzojë mirë propaganda jonë.

E PREMTE
5 MARS 1965

Bisedova me Ramizin për një artikull lidhur me demonstratat e djeshme antiamerikane në Moskë.

Agjencia TASS njoftoi se revizionistët e mbaruan mbledhjen e famshme që filluan më 1 mars. Flitet se kanë pasur mosmarrëveshje në lidhje me taktikën që duhet të ndjekin në luftën kundër partive tona. Përçarësit tradhtarë revizionistë, për të fshehur gjurmët, do të shpallin më 10 mars «rezultatet» me një komunikatë, gjë që tregon dobësinë dhe blofin e tyre. Ata as që guxuan të nxjerrin rezolutë, por komunikatë. Sidoqoftë ne e dimë se ç'do të gjijnë dhe përgjigjen ua kemi gati.

**E SHTUNË
6 MARS 1965**

Disa mendime për edukimin ideopolitik në shkollat tona, që do të shqyrtohet në mbledhjen e Byrosë Politike më 9 mars:

Si duhet të zhvillohen në shkolla mësimet e historisë, të gjeografisë dhe në përgjithësi të lëndëve shoqërore.

Edukimi i mësuesve, në radhë të parë, ngritja e nivelit të tyre të përgjithshëm ideologjik e profesional. Programi dhe koha.

Literatura e koordinuar me shkencat shoqërore.

Raportet e lëndëve deri në klasën e 8-të.

Edukata moralo-proletare.

Programet dhe tekstet e shkollave. Programet mund të jenë deri diku mirë, sido që edhe në to vazhdimisht duhet të bëhen korrigjime dhe përmirësime, por do parë

nëse tekstet u përgjigjen si duhet programeve dhe sidomos qëllimit, edukimit të vërtetë. Unë mendoj se këtu ne kemi shumë e shumë për të bërë.

Programet dhe tekstet e shkollave pedagogjike. Seminare perfeksionimi me mësuesit për përvetësimin sa më mirë të shkencave shoqërore.

Që nxënësit të kuptojnë mirë konceptet shkencore materialiste dhe të arrijnë në konkluzione ideoshkencore, këto duhet të zhvillohen gjatë shpjegimit të mësimëve të historisë, të gjeografisë dhe të lëndëve të tjera dhe jo të serviren si formula abstrakte, filozofike, të errëta e të rënda.

Në raportin që do t'i paraqitet Byrosë Politike përmendet fjala «idetë e kohës». Kjo formulë ose duhet ilustruar, ose duhej të ishte ilustruar që gjatë viteve të kaluara, nëpërmjet lëndëve të shkencave të natyrës dhe atyre shoqërore.

Në përgjithësi unë mendoj se zhvillimi i dijeve dhe edukimi ideopolitik sidomos në shkollat e mesme, nuk duhet të udhëhiqen nga idetë «e shkollave» të ndryshme, por nga koncepti i zhvillimit materialist të botës, të shkencës, të ideve, të shoqërisë. Kjo të bëhet e harmonizuar, e dozuar, që t'i shërbejë nxënësit në jetë.

Zhvillimi i luftës anticoloniale dhe historia e popujve që çlirohen dhe dalin si shtete më vete në arenën ndërkombëtare, është një çështje me rëndësi të madhe

për zhvillimin e njerëzimit. Ky problem nuk figuron në tekstet tona shkollore, ose figuron zbehtë vetëm ana politike, që dhe kjo është disi skematike e propagandistike. Kurse figurojnë mirë pushtimet imperialiste, ndryshimet e formave të shtypjes e të shfrytëzimit, luftërat koloniale etj.

Për t'i shërbyer edukimit të vazhdueshëm të mësuesit, duhet menduar për hartimin e teksteve të veçanta, të ilustruara me shembuj konkretë, se si duhet zhvilluar ora e mësimit jo nga ana metodike, por sidomos nga përmbajtja. Këto tekste speciale, as mund të quhen të përhershme, por herë pas here duhet të ribotohen me korrigjime, ose të botohen tekste të reja më të perfeksionuara.

Duhet të punohen e të përgatiten monografi e antologji të veçanta për zgjerimin e dijeve të mësuesve. Në këto të fundit të përfshihen edhe njohuri nga letërsia e përbotshme e lidhur me tekstin e lëndës dhe tekstet të tregojnë jo vetëm idetë progresive, por edhe ato regresive që t'i lejojnë mësuesit të bëjë krahasimin, të kuptojë rrugën e zhvillimit materialist të historisë, të shkencave dhe të ideve.

Duhet rishikuar dhe përpunuar mirë kurset ideopolitike që bëhen me mësuesit, pse dyshoj që ato bëhen krejtësisht të shkëputura nga profesioni i tyre, bëhen në forma të përgjithshme propagandistike, kështu që mësuesi ose i di ato që i thuhet, ose i neglizhon fare, se i bëhen të mërziqshme.

Mund të bëhet fjalë për lëndë të veçanta si «Njohuri fillestare të marksizëm-leninizmit», «Edukata morale», por jo «Edukata politike».

Mendoj se «informacioni politik» është një problem që i takon më shumë organizatës së rinisë, Komitetit Qendror të Rinisë dhe jo shkollës, pra jo Ministrisë së Arsimit. Në këtë çështje, mendoj unë, nuk mund të caktohet një metodikë, siç caktohet për dhënie e mësimeve dhe as të bëhet ky informacion politik në orën e mësimit. Nga ana tjetër, informacioni politik në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojë mësimin e lëndës që shpjegon bazat e marksizëm-leninizmit. Kësaj të fundit duhet t'i kushtohet orë e veçantë mësimi në programin e shkollës, kurse informacioni politik të zhvillohet në mbledhjet e rinisë, në mbledhje të improvizuara qoftë edhe ditore, por jashtë mësimit dhe nën drejtimin e organizatës së rinisë.

Mësimi i historisë së popullit tonë jo vetëm të jetë baza, por duhet të pasqyrojë, në mënyrë marksiste-leniniste gjithë zhvillimin e shoqërisë sonë si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen. Për trajtimin e fakteve historike duhet të përdoret sa më drejt një metodë nga më të përshtatshmet, që të përputhet plotësisht me metodën tonë dialektike materialiste. Sigurisht shkencëtarëve tanë nuk u lejohet as të bien në pozita dëshpërimi dhe as të japin fakte të paqena, të panjohura, ose akoma të paplota të historisë së lashtë të popullit tonë. Por mbi ato materiale që kemi, dhe kemi mjaft, ne duhet të ndërtojmë programe të qarta mësi-

more. Për sa i përket historisë së popullit tonë, të paktën gjatë këtyre 100 vjetëve, ne çdo gjë e kemi të qartë, e kemi në dorë, e kemi brumin të mirë, të faktuar, të dokumentuar dhe këtë brumë po e gatujmë vetë ditë-ditës. Këtu, për këtë periudhë, ka rëndësi shfrytëzimi i mirë i materialeve, formulimi dhe paraqitja e tyre si dhe metoda e punës së mësuesve për t'u ushqyer këta vetë dhe pastaj edhe nxënësit.

Kur kam pasur rastin të bisedoj me shokët drejtues të rinisë, i kam porositur se duhet të organizojnë me plan konferenca të ndryshme për rininë, tema të ndryshme për historinë e vendit tonë dhe të vendeve të huaja, për jetën e popujve të ndryshëm, tema me karakter shoqëror dhe shkencor. Mundësisht këto të shoqërohen edhe me filma, ose me fotografi e diapozitivë. Por këto konferenca të mos bëhen shkel e shko, as të kenë ujë brenda, fjalë boshe, karakter propagandistik, por të bëhen për t'i dhënë rinisë njohuri politike, ideologjike si dhe informacion shkencor. Këto njohuri mund të lidhen me disa momente kyç të programit mësimor dhe ta plotësojnë këtë, në mënyrë më të zgjeruar, më të specializuar.

Do të dalë nevoja që në të ardhmen krahas «shtëpive të pionierëve» të ngremë edhe «shtëpitë e rinisë». Këto do të ndihmojnë shumë në edukimin e rinisë jashtë shkollës, do ta mënjanojnë atë nga veprimi i ndikimeve të huaja. Duhet ta fillojmë këtë punë këtu në Tiranë, ku kemi më shumë se në çdo rreth tjetër të rinj e të reja.

Rëndësia e punës fizike, e shërbimit paraushtarak dhe e zgjedhjes së profesionit nga të rinjtë (puna politike në këtë drejtim).

Orientimi për pjesëmarrjen në diskutime të të rinjve dhe të rejave ka rëndësi të madhe për zhvillimin e tyre mendor të gjithanshëm, për shkëmbimin e eksperiencës, për plotësimin, nxitjen dhe shtimin e njohurive, si dhe për veprimtarinë e tyre krijuese. Rregullat shabllone, të thata, formalizmi që vërehet zakonisht në mbledhje, toni zyrtar solemn, pret iniciativën e të rinjve, krijon mosbesim ndaj vetes, frikë për t'u shprehur lirishit ashtu si ndiejnë dhe si mendojnë.

Duhet ndryshuar kjo metodë pune, pse jo vetëm nuk jep frytet që kërkojmë ne, por favorizon mospërgatitjen, indiferentizmin e ndonjërit prej referuesve kryesorë, i cili e di që nuk do të ketë diskutime, nuk do të ketë mendime të kundërta dhe nuk do të ketë kokëçarje. Ai flet ose e mban referatin, se duhet ta mbajë dhe e bën atë sa për formë e shkel e shko.

Sot edhe ne, kurse kinezët dje, demaskuam në shtyp goditjen e egër që policia sovjetike bëri kundër demonstruesve në Moskë, por me një ndryshim që ka rëndësi të madhe. Artikulli ynë, duke nxjerrë konkluzionet nga demonstrata dhe nga raprezaljet, pa theksuar se kush përbënte shumicën në demonstratë, vë në dukje se policia sovjetike sulmoi demonstruesit. Në fakt, në të merrnin pjesë edhe sovjetikë dhe, si konsekuencë e drejtpërdrejtë, ne tregojmë se demonstrata jo vetëm s'ishte

krejt e të huajve, por revizionistët për të mbrojtur ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, goditën edhe njerëzit e tyre. Kinezët, përkundrazi, theksonin më shumë anën tjetër, sikur demonstrata përbëhej nga studentë të huaj që udhëhiqeshin prej kinezëve. Sidoqoftë demaskimi ynë bëri bujë.

Studentët kinezë në Pekin demonstruan sot përpara ambasadës sovjetike, ata hodhën parulla kundër imperializmit amerikan dhe dhanë peticione proteste solidariteti me shokët e tyre të plagosur në Moskë. Këta të fundit, thotë HSINHUA-ja, u vizituan nga ambasadori kinez në Moskë, i cili i paraqiti Ministrisë së Punëve të Jashtme të Bashkimit Sovjetik një notë proteste, me kërkesën që të pohojë gabimin e qeverisë sovjetike për raprezaljet ndaj studentëve dhe t'u kërkojë ndjesë studentëve kinezë të plagosur në demonstratë.

Po ndizet. Ky është një proces i rregullt. Nota kineze është bërë me zgjuarsi, pse ajo e vë Ministrinë sovjetike të Punëve të Jashtme në pozita shumë delikate. Në rast se sovjetikët nuk u kërkojnë ndjesë studentëve, atëherë do të demaskohen keq, mbasi ambasadës amerikane ata i kërkuan ndjesë, bile i premtuan se do ta mbrojnë më mirë. Kjo do të thotë që do t'i skuqin më mirë bulevardet e Moskës me gjakun e demonstruesve. Nga ana tjetër, sovjetikët, po të pranojnë t'u kërkojnë ndjesë, e humbën prestigjin dhe u treguan neutralë të palavdishëm në këtë konflikt të popujve kundër imperializmit agresor. Asnjëri, pra, s'mund të gënjejhet se

revizionistët sovjetikë s'janë solidarë me imperialistët amerikanë kundër popujve. Çdo gjë tjetër është bluf, gënjeshtër, demagogji. Ata janë tradhtarë nga më të këqijtë. Prandaj luftë deri në shkatërrimin e plotë të tyre!

E HËNË
8 MARS 1965

Problemi i Vietnamit po na shqetëson çdo ditë. Imperialistët amerikanë vazhdojnë provokacionet dhe shantazhet kundër tij. Ata zbarkuan 3 mijë e ca mërinsa gjoja për të mbrojtur qendrën e raketave në Danang. Por ky zbarkim ka për qëllim të përforcojë njësitë e veta agresive kundër partizanëve dhe Republikës Demokratike të Vietnamit. Reagimi i sovjetikëve është zero. Ata me siguri, në mos hapur, në mënyrë *tacite*¹, janë dakord ose nuk u intereson të bëjnë zhurmë, pse prishin punë dhe planet e tyre.

Studentët kinezë u kanë dërguar sot një letër autoriteteve sovjetike, ku i demaskojnë në lidhje me shtypjen e demonstratës së studentëve në Moskë.

Amerikanët përsëri provokuan sot Republikën Demokratike të Vietnamit, duke bombarduar një fshat.

1. Frëngjisht — të heshtur.

E MARTË
9 MARS 1965

Sot u bë mbledhja e Byrosë Politike, ku diskutuam dhe morëm vendime për probleme me rëndësi. Shqyrtuam veçanërisht problemin e edukimit ideopolitik të rinisë në shkollat e mesme e të larta.

Në diskutimin tim¹ fola kryesisht për dy çështje: për nevojën e përpunimit në mënyrë të vazhdueshme të teksteve shkollore, me qëllim që këto të përmirësohen e t'i shërbejnë plotësisht edukimit ideopolitik të rinisë, si dhe për përgatitjen ideologjike, tekniko-profesionale e zhvillimin kulturor të mësuesve.

Revizionistët modernë, nëpërmjet të ngarkuarit me punë të Cekoslovakisë, na dhanë sot komunikatën e mbledhies së tyre famëkeqe, që mbajtën nga 1-5 mars në Moskë. Ne nuk e morëm atë në dorëzim dhe ua kthyem pa e lexuar.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 165.

E MËRKURË
10 MARS 1965

Sot revizionistët e botuan të famshmen komunikatë të mbledhjes së tyre përçarëse të 1 marsit. Kjo i përngjet «lëngut të gështenjës». Në thelb të taktikës së tyre të re që është: paqe, të pushohet polemika ose kjo të bëhet me dorashka të pambukta, s'bëhet fjalë dhe nuk insistohet për mbledhjen e madhe, por, thonë ata, «duhet të punohet dhe të merret pëlqimi i 81 partive». Me një fjalë, mbledhja varet nga ne dhe jo më nga ata.

E ENJTE
11 MARS 1965

Koha po mban mirë. Kjo na i lehtëson punët në bujqësi. Sivjet dimri na e dëmtoi blegtorinë. Sipas të dhënave paraprake, numri i humbjeve në bagëtitë e imëta nga ngordhjet dhe dështimet është i madh.

Zonat fushore ku ra borë nuk u gjendën të përgatitura mirë me ushqimet e bagëtisë. Kështu që këto do të na dalin mjaft dobët nga dimri dhe, si rezultat, nuk do të realizojmë dot as qumështin, as mishin, as gjalpin.

Lexova komunikatën e lëshuar dje nga partitë revizioniste mbi mbledhjen përçarëse të 1 marsit që bënë në Moskë. Me këtë komunikatë revizionistët, të cilëve u kanë rënë pendët, tregojnë edhe një herë më mirë frikën që kanë nga zjarri demaskues i polemikës sonë të drejtë dhe të vazhdueshme. Sa larg janë pretendimet «kërcënimit», «vendosmëria» dhe fjalët bombastike të Hrushovit që do të na «përpinte të gjallë». Ata me arrogancë deklaruan se jo vetëm do ta bënin mbledhjen pa ne, por do të na demaskonin, do të na përjash-

tonin nga lëvizja komuniste ndërkombëtare, do të har-tonin platformën e re të komunizmit, pse rrethanat gjoja kishin evoluar, se ata do të përgatitnin dhe do të thërrisnin po këtë vit, edhe pa ne, mbledhjen e përgjithshme dhe do të vendosnin «gjëra të mëdha». Të gjitha këto mburrje dhe demagogji ranë në batak. Ata pësuan përsëri një disfatë të madhe, pas asaj të largimit të Hrushovit, pse mbledhja që ata kurdisën me zor dhe e bënë për të mos u turpëruar fare, vërtetoi vetëm disfatën e tyre dhe fitoren tonë.

Në fakt mbledhja e tradhtarëve vërtetoi atë që mezi e realizuan radhën e parë. Rumania nuk u vajti, kjo ishte një humbje e madhe për ta. Revizionistët anglezë, deri në ditët e fundit, deklaruan zyrtarisht se nuk do të merrnin pjesë, dhe kjo jo pse ata s'janë revizionistë. Ata më në fund bënë si bënë, vajtën dhe këtu ka luajtur rubla dhe shantazhi. Sidoqoftë këtu u demaskuan edhe sovjetikët, edhe revizionistët anglezë.

Kubanët neve na thanë se nuk do të shkonin në asnjë mënyrë në mbledhje, jo pse janë me ne, por se duan të mbajnë një pozitë centriste si rumunët. Fjalët «e vendosura» të Guevarës se nuk do të gaboheshin të shkonin, i mori era. Sovjetikët fituan në dukje, po vajtja e kubanëve nuk u solli ndonjë fitim as sovjetikëve, as marksizëm-leninizmit (pse ata s'janë marksistë të vendosur dhe konsekuentë). Ata ndihmuan në drejtim që të dilte kjo komunikatë që doli. Polakët, të shtyrë nga antisovjetizmi i tyre, dhe duke kërkuar që të luajnë një rol të rëndësishëm në revizionizmin modern, kërkuan që komunikata dhe diskutimet, natyrisht, jo vetëm të mos kishin tonin bombastik të Hrushovit, jo vetëm të mos

pipëtinte shenjë polemike në to, por ato të ishin tipike kishtarë, priftërore, jezuite. «Kardinal» Gomulka la gjurmë të thella në punime.

Revizionistët italianë po ata, i kanë treguar dhe i ndjekin qëndrimet e tyre. Ata edhe janë, edhe s'janë me atë komunikatë që doli. Për këta revizionistë as do të ketë ndonjë ndryshim, ata vetëm bëjnë kujdes që të mos u imponohet njeri, çdo përqendrim ta shpartallojnë, të vazhdojnë të marrin nga çdo anë dhe të bëjnë pallavra parlamentare e çdo veprimtari minuese kundër marksizëm-leninizmit, që t'u sjellë të ardhura. Të tjerët, pas karvanit.

Me një fjalë, në këtë mbledhje përçarëse revizioniste nuk dominonte gjë tjetër veçse hija jonë, shpata e Damokleut, marksizëm-leninizmi, me dialektikën e tij materialiste të pamëshirshme. Prandaj mbledhja mund të themi se ishte një mbledhje konspirative, një mbledhje që doli me atë komunikatë, e cila pasqyron bren-dinë e ndërgegjegjes së tyre katran të zezë.

Fakt është se në këtë mbledhje revizionistët nuk bënë, të paktën publikisht, ndonjë përpjekje, siç e kanë zakon, për të mashtruar opinionin publik me anë të ndonjë «tërheqjeje» demagogjike. Kjo për ne është mirë. Megjithëkëtë ata mbeten plotësisht revizionistë.

Por disfata e tyre duket kudo në komunikatën e botuar.

Sa shumë ata kanë folur, i kanë rënë gjoksit, janë betuar për kongreset famëkeqe të 20-të, të 21-të, të 22-të! Në këtë komunikatë s'u dëgjua zëri i tyre. Kjo është me kuptim të thellë. Mundet dhe vetë revizionistët sovjetikë s'kanë guxuar të propozojnë që këtyre

kongreseve t'u dilte qoftë edhe pak maja e veshëve.

«Bashkekzistenca paqësore», që është tradhtia e tyre më e madhe dhe jorgani që ata mendojnë se u mbulon aleancat e kurdisura me imperializmin dhe me borgjezinë reaksionare, përmendet një herë dhe kjo krahas frazës demagogjike «lufta kundër imperializmit» etj., etj.

Sa për mbledhjen e përgjithshme, ajo u çua në kalendat greke. Topat e hrushovianëve qenë mbushur me leckë. Ata nuk mund dhe s'janë në gjendje ta bëjnë mbledhjen, shkoi koha e diktatit të tyre. . .

Revizionistët modernë duan ta shuajnë, duan ta evitojnë luftën tonë, prandaj gjëja kryesore për ta është shuarja e polemikës. Tani në komunikatën e tyre e kërkojnë përsëri, bile luten që, në fund të fundit, të bëhet një «diskutim» por me dorashka, me diplomaci, «pa sharje». Për ta «sharjet» janë tezat dhe parimet marksiste që na udhëheqin në këtë luftë kundër revizionistëve. Këta s'mund t'u qëndrojnë dot këtyre përpara, ata duan të bëhet një luftë me pambuk, luftë me dantella, me «buzëqeshje», me një fjalë një «polemikë speciale» demokratike-revizioniste me të gjitha tiparet e diplomacisë borgjeze të xhentëlmenëve, që të qesh në sy dhe të fut thikën nga pas.

Të tillë luftë dëshirojnë këta zotërinj, por në këtë lloj lufte nuk do të na tërheqin ne. Një nga qëllimet e komunikatës së tyre, dua të them tonit dhe përmbajtjes, përveç frikës dhe disfatës, është përpjekja që edhe këto t'i shfrytëzojnë për të zbutur polemikën me ne.

Revizionistët modernë po shkojnë nga disfata në

disfatë. Të mos i lëmë të marrin frymë, t'i godasim, t'i demaskojmë pa pushim.

Jemi duke përgatitur përgjigjen e kësaj komunikate¹. Të shohim si do të jetë përgjigjja e Kinës. Dyshoj se mos ketë ndonjë moment të dobët. Do të jetë mirë që ata të qëndrojnë në atë që kanë thënë se «po e bëtë këtë mbledhje ju (sovjetikët) do të futeni në varr». Për sa u përket koreanëve, indonezianëve, vietnamezëve, të shohim ç'do të bëjnë, se deri tani heshtin, heshtin.

Lufta nacionalçlirimtare në Vietnamin e Jugut ka marrë hov të madh. Gati tri të katërtat e territorit janë çliruar dhe administrohen nga fronti nacionalçlirimtar. Kukullat e Sajgonit dhe agresorët amerikanë mbajnë vetëm qytetet e mëdha, rrugët kryesore dhe aerodromet. Edhe në këto baza ku janë struktur, ata gjejnë vështirësi të mëdha politike, pse qeveritë kukulla që po ndërrohen gati çdo muaj dhe çdo javë, tregojnë se atje pushtimi është bërë me të vërtetë i padurueshëm. Rivaliteti në mes kukullave të Sajgonit po thellohet çdo ditë dhe po kthehet, si të thuash, kundër amerikanëve.

Në këto situata, çdo qeveri kukull që vjen në Vietnam nuk konsiderohet si një udhëheqje reaksionare qoftë edhe me njëfarë personaliteti, por është vetëm një lodër në duar të pushtuesve, prandaj ato s'kanë asnjë vlerë dhe janë bërë të padurueshme, mund të themi fare të pavlefshme edhe për vetë amerikanët. Këta,

1. Më 18 mars 1965, «Zëri i popullit» botoi artikullin «Mbledhja përçarëse, revizioniste e 1 Marsit — një komplot i madh kundër marksizëm-leninizmit dhe komunizmit ndërkombëtar».

natyrisht, për sy e faqe, i mbajnë si paravan, se për sundim a për drejtim s'u kanë lënë asgjë në dorë. Imperializmi amerikan qeveritë kukulla të Sajgonit i mban edhe për manovrime diplomatike, pse në brendi ato nuk përbëhen veçse nga mercenarë, të cilët paguhen kur i shërbejnë padronit, ose në të kundërtën vriten si Ngo Din Diemi, apo dërgohen diplomatë shëtitës si Kani.

Por çështja qëndron në manovrimin jashtë. Imperialistët amerikanë edhe më parë, por edhe tash, hedhin gurin dhe fshehin dorën. Ata janë dhe luftojnë në Vietnam gjoja të ftuar nga qeveria e Sajgonit, që përfaqëson «demokracinë», «botën e lirë». Amerikanët pretendojnë se në Vietnamin e Jugut ekziston një qeveri «legale», «e zgjedhur nga populli», e cila lufton «rebelët» komunistë të ardhur gjoja nga Vietnami i Veriut. Këtë tezë false imperialistët amerikanë e kanë përdorur vazhdimisht, por, sidomos tani që po humbasin e përdorin edhe më shumë.

Tash, përveç të tjerave, amerikanët thonë se janë të gatshëm të hyjnë «në bisedime për paqe në Vietnam, por Republika Demokratike e Vietnamit duhet të deklarojë se heq dorë nga ndihma që i jep Vietkongut dhe këta të tërhiqen në Veri, andej nga kanë ardhur». Natyrisht, kjo hidhet poshtë me vendosmëri dhe me përbuzje nga Republika Demokratike e Vietnamit dhe nga Kina, që deklarojnë se duhet të largohen trupat amerikane dhe kukullat e tyre të Sajgonit nga Vietnami dhe të zbatohen marrëveshjet e Gjenevës.

Revizionistët sovjetikë janë kundër kësaj teze të drejtë. Ata janë për ta shuar luftën në Vietnam, janë për pajtim me kukullat e Sajgonit dhe për bisedime në

këto kushte me amerikanët. Kjo do të thotë se sovjetikët janë me amerikanët.

Zaten, në qoftë se mbahet mend, hrushovianët kanë qenë kundër luftës nacionalçlirimtare në Vietnamin e Jugut. Ata bënë shumë presione mbi shokët vietnamezë, për ta shuar luftën e tyre në Jug.

Por lufta mori zjarr, u zgjerua dhe u korrën fitore. Të gjitha këto peripeci Hrushovi i ka biseduar me siguri me amerikanët, ai ua ka parashtruar këtyre të gjitha nuancat, të gjitha tendencat, deri edhe te vendimet që janë marrë nga Veriu për të ndihmuar Jugun. Këto amerikanët i dinë, por i shfrytëzojnë dhe do t'i shfrytëzojnë edhe më shumë nesër, ata i kanë zënë në kllapa sovjetikët dhe nuk i lëshojnë, u bëjnë shantazh dhe në të ardhmen do t'u bëjnë edhe më shumë.

«Libri i bardhë» amerikan për luftën e Vietnamit, përveç shpifjeve të kurdisura, sigurisht duhet të ketë edhe një sërë të dhënash nga burime hrushoviane, të cilat i kanë përdorur amerikanët për të forcuar shantazhin. Në fakt, revizionistët sovjetikë nuk e bënë çështje dhe ta demaskonin me forcë këtë të ashtuquajtur libër të bardhë. Në politikën ndaj Vietnamit revizionistët sovjetikë janë për bisedime, por pa vënë asnjë kusht, ashtu siç thotë Titoja, Niksoni, Dë Goli, U Tani e të tjerë dhe në kundërshtim me kinezët dhe me vietnamezët. Zaten ne u informuam se Rapacki¹ i tha ambasadorit të Republikës Demokratike të Vietnamit në Varshavë se «Ju duhet të pushoni luftën dhe të hyni në bisedime me amerikanët». Me një fjalë haptazi u tha vietnamezëve: «Kapitulloni».

1. Në atë kohë ministër i Jashtëm i Polonisë.

Në këto kushte a nuk është pjekur vallë situata që partizanët e Vietnamit të Jugut të formojnë qeverinë e tyre demokratike provizore të frontit nacionalçlirimtar pa e nxjerrë partinë në legalitet¹?

Kur «qeveria e Sajgonit» është diskredituar kaq shumë dhe gati është e paqenë, kur imperializmi amerikan po pëson kaq disfata ushtarake dhe politike, kur pjesa më e madhe e territorit është çliruar dhe drejtohet nga pushteti popullor, krijimi i një «qeverie demokratike provizore» të Vietnamit të Jugut, mendoj se do të bjerë si një bombë e madhe, do ta forcojë luftën dhe besimin e popullit që lufton. Kjo do t'u heqë edhe armën demagogjike amerikanëve, se partizanët «janë rebelë të ardhur nga Veriu» që «drejtohen nga Republika Demokratike e Vietnamit» e të tjera.

Unë mendoj se populli në luftë do ta presë këtë me entuziazëm dhe do ta konsiderojë si një fitore, kurse qeverisë kukull të Sajgonit do t'i bjerë prestigji më keq sesa i ka rënë. Në arenën ndërkombëtare kjo do të bëjë efekt të madh dhe në çfarëdo bisedimesh që do të bëhen, qeveria demokratike e Vietnamit të Jugut nuk mund të mos përfillet, pa të asgjë nuk mund të bëhet, asgjë nuk mund të vendoset. Formimi i një qeverie demokratike i jep një personalitet të madh luftës, me këtë qeveri ne mund të mbajmë lidhje të drejtpërdrejta, mund të ndihmohet Jugu më mirë politikisht, ekonomikisht, ushtarakisht dhe diplomatikisht. Një qeveri de-

1. Këtë mendim shoku Enver Hoxha ia parashtroi edhe ambasadorit kinez në Tiranë më 16 mars 1965. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 180.

mokratike provizore do të prishë planet e revizionistëve modernë sovjetikë dhe të gjithë të tjerëve, do t'u vërë fre tendencave oportuniste dhe çështja e aleancave brenda në Vietnamin e Jugut mund të ketë një sukses më të madh anti amerikan, pse ata që do të lënë «vaporin e mbytur», mund të bisedojnë dhe të ujdisen më lehtë me një qeveri demokratike të formuar. Por këto mund të jenë akoma të papërshtatshme. Shokët e Vietnamit i dinë dhe i gjejnë më mirë situatat brenda. Unë i gjej me kaq sa di, me kaq sa jam i informuar. Por mendoj se nga kjo rrugë do të kalohet patjetër dhe më parë se të zhvillohen proceset e tjera të pasçlirimit.

E SHTUNË
13 MARS 1965

Sovjetikët, me anën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, iu përgjigjën notës kineze që protestonte për dhunën që u përdor kundër studentëve në demonstratën e Moskës. Përgjigjja është brutale, proimperialiste. Kjo është një gjë e mirë, se i demaskon revizionistët modernë dhe, nga ana tjetër, në vazhdim të luftës kundër këtyre kinezët forcohen¹.

1. Po në këtë datë, autori ka shkruar shënimin: «Frenime që i bëhen Kinës ndaj veprimeve të hrushovianëve», që është botuar në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 211.

E DIEL
14 MARS 1965

Nga Nju-Jorku morëm lajmin se dje në Florida të Shteteve të Bashkuara të Amerikës vdiq Fan S. Noli. Po marrim masat e nevojshme, me këtë rast, për të nderuar kujtimin e këtij patrioti demokrat, publicist dhe poet i shquar i vendit tonë.

E HËNË
15 MARS 1965

Siç na njoftojnë Fan S. Noli vdiq nga një operacion që bëri këto javët e fundit, të cilin, për shkak të moshës, nuk e përballoi dot. Një hemorragji cerebrale i shkaktoi vdekjen e shpejtë.

Noli është një nga figurat e shquara politiko-letrare të fillimit të këtij shekulli. Po të bëjmë bilancin e jetës së tij, ai ishte pozitiv, e ka dashur popullin, ashtu siç mendonte, dhe ka luftuar për çlirimin e tij dhe për parësinë e atdheut. Këtej rrjedhin influenza dhe emri i mirë që ka ai në popull.

Fan Noli ishte antifeudal, antizogist dhe një nga udhëheqësit kryesorë të Revolucionit Demokratiko-Borgjez të vitit 1924. Ky revolucion lidhet ngushtë me emrin e tij, sepse ai formoi qeverinë demokratike dhe e drejtoi atë si kryeministër, derisa kundërvolucionin feudal, i udhëhequr nga Zogu, me ndihmën e mercenarëve të huaj, serbë e rusë të bardhë vrangelistë, e përmbysi qeverinë. Atëherë Fan Noli u arratis jashtë, në emigracion, ku shkroi vjersha të bukura me frymë të thellë revolucionare, antifeudale dhe antizogiste.

Për një kohë të gjatë në periudha të ndryshme ai

drejtoi shoqërinë «Vatra» në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe, në përgjithësi, mund të thuhet se kur ishte nën drejtimin e tij, «Vatra» i shpëtoi llumit ku ra më vonë.

Noli në këto periudha ka mbajtur një qëndrim pasiv, nuk reagoi kundër reaksionarëve të «Vatrës», të cilët, nën prestigjin e tij të madh, fshihnin veprimtarinë e tyre reaksionare. Por vetë Noli, personalisht, nuk foli asnjëherë kundër nesh, bile disa herë foli mirë dhe veçanërisht duke bërë dedikasën e botimit të ri të «Historisë së Skënderbeut». Me zemër Noli qëndronte me ne dhe, në dhjetor të vitit që kaloi, pra pak kohë para se të vdiste, duke i dhënë të fala për mua, ai i qe shprehur kështu shokut Behar Shtylla: «Unë jam si ai i krishteri që u bë mysliman, po kur kalonte përpara kishës thoshte: o zonja shën Mëri, mos më shiko nga emri, po zemrën e kam me ty». Po me këtë rast, kur ishin duke ngrënë së bashku me shokun Behar, Noli i hapi zemrën, i shprehu dashurinë dhe falënderimet për ne, për «djemtë» që punojnë mirë e që e nderojnë Shqipërinë, dhe i tha: «Do të vij në Shqipëri dhe atje do të rri gjatë». Kur u ndanë (se shkonte në Florida, ku edhe vdiq), i emocionuar i tha: «Kur të vesh në Shqipëri, u thuaj shokëve nga ana jote çdo gjë të mirë dhe të gjitha ato që do t'u thuash janë edhe ndjenjat e mia».

Sot Fan Noli gëzon një popullaritet të madh e të merituar në vendin tonë si letrar, si përkthyes dhe kritik muzike. Ai është një lëvruer i shquar i gjuhës shqipe. Veprat e tij origjinale, si dhe përkthimet, veçanërisht nga Shekspiri, nga Omar Khajami e Blasko Ibanjezi, janë të pavdekshme. Por sidomos elegjitë dhe poezitë e

tij me ndjenja antizogiste, antifeudale janë xhevahire të bukura, që e kanë frymëzuar e do ta frymëzojnë rininë tonë, sidomos krijuesit tanë. Ai respektohet në mënyrë realiste edhe si politikan, si një demokrat revolucionar në ideologji dhe në politikë.

Partia e ka vlerësuar drejt figurën e Nolit. Aq sa ka merituar, e ka pasë për detyrë patriotike t'ia vërë në dukje realisht edhe meritat e tij të mëdha në letërsi, në histori e në art, po kështu si meritat dhe dobësitë e tij në politikë.

Mendoj të bëjmë çmos që trupin e tij ta sjellim në Shqipëri, se ky bir i shquar i popullit shqiptar, patriot e revolucionar, e meriton të prehet në atdheun e tij, të cilin e ka dashur dhe ka luftuar tërë jetën për të.

Çu En Lai, në një banket për delegacionet shqiptare që ndodhen në Kinë, i tha ambasadorit tonë se nga fundi i marsit do të nisët për një udhëtim zyrtar miqësor për në Rumani dhe në Shqipëri. Ai i tha se «në Rumani, e cila nuk mori pjesë në mbledhjen e revizionistëve në Moskë, po kthej vizitën dhe në Shqipëri po vij për të dytën herë. Kam borxh edhe në vendet e tjera socialiste të Evropës, por atje nuk do të shkoj». Do të na lajmërojnë më vonë datën ekzakte. Kjo është një gjë shumë e mirë për ne dhe për politikën tonë të përgjithshme ndërkombëtare.

Nga shokët kinezë, sipas mendimit tim, po shfrytëzohet mirë momenti që Rumania u desolidarizua me mbledhjen e Moskës. Pavarësisht nga qëndrimet e përgjithshme politiko-ideologjike të rumunëve, mosvajtja

e tyre në Moskë është pozitive, prandaj duhet shfrytëzuar vajtja e Çu En Lait në Rumani dhe te ne.

Kjo do të ketë rrjedhime, do të jetë humbje për revizionistët dhe për titistët, kurse për ne fitim.

Natyrisht, me këtë rumunët duan të arrijnë dy objektiva: t'u qëndrojnë si karshillëk revizionistëve e të tregojnë njëkohësisht se kanë një vijë «të qendrës» dhe të konkretizojnë edhe ndonjë ndihmë. Sidoqoftë avantazhet peshojnë nga ne, por me kusht që kinezët të mos entuziazmohen përnjëherë, të vazhdojnë të ecin me kujdes, as me lëshime ideologjike rumunëve, por as edhe me ngurrime. Rumunët, sipas lajmeve që kemi, në kufi janë përpjekur edhe me armë me sovjetikët, domethënë marrëdhëniet sovjeto-rumune janë mjaft të nderura. Pa dyshim mosvajtja e rumunëve në mbledhjen e 1 marsit në Moskë duhet të ketë bërë që acarimet e mëdha që kanë pasur me gjithë revizionistët e Evropës, tash të jenë përforcuar edhe më shumë akoma. Prandaj hapi i kinezëve është me vend.

E MËRKURË
17 MARS 1965

Pashë përfundimisht artikullin me titull: «Mbledhja përçarëse, revizioniste e 1 marsit — një komplot i madh kundër marksizëm-leninizmit dhe komunizmit ndërkom-bëtar»¹. Nesër do të botohet në «Zërin e popullit».

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 192.

E ENJTE
18 MARS 1965

Agjencia rumune e lajmeve njofton se George Georgiu Dezhi është sëmurë.

Sot në mbrëmje ambasadori ynë në Bukuresht, tok me ambasadorët e tjerë të vendeve «socialiste», ishte thirrur në Komitetin Qendror të Partisë Punëtore Rumune. Aty u kishin komunikuar se George Georgiu Dezhi është sëmurë rëndë nga mushkëritë dhe mëlçia e zezë dhe se do të bëjnë ç'është e mundur ta shpëtojnë.

Si duket gjendja është serioze. Me vdekjen e Dezhit Rumania do të dëmtohet shumë. Kohët e fundit Dezhi ka qenë pozitiv, qëndrimi i tij ndaj sovjetikëve ka qenë i drejtë dhe i guximshëm. Do t'i bëj një telegram urimi për shërim të shpejtë.

E PREMTE
19 MARS 1965

George Georgiu Dezhi, thonë, vdiq nga kanceri në mushkëri dhe në mëlçi. Sëmundja nuk ishte diktuar dhe iu shfaq në mënyrë galopante. Kjo është një humbje e madhe për Rumaninë. E njihja mirë Dezhin edhe personalisht, kisha marrëdhënie të mira miqësore me të. Ishte ca i rëndë në paraqitje. Më vonë ai bëri gabime të rënda në vijë duke u solidarizuar me revizionistët sovjetikë e me të tjerët dhe na sulmoi. Por fakt është që, duke u nisur nga pozita nacionale, ai filloi të kuptojë rrezikshmërinë e Hrushovit dhe të shkëputet prej revizionistëve sovjetikë. Atëherë filloi të kuptojë, deri në njëfarë shkalle, edhe gabimet që kishte bërë ndaj nesh. Fakt është se Dezhi nuk vdiq revizionist, por centrist.

Dezhi vdiq, po të shohim se kush do ta zëvendësojë; kjo ka rëndësi. Sovjetikët dhe jugosllavët do të intrigojnë shumë për të sjellë njerëzit e tyre në krye.

Ne do të dërgojmë një delegacion në varrimin e Dezhit, pse qëndrimi i tij ndaj nesh, kohët e fundit u përmirësua.

E SHTUNË
20 MARS 1965

U takova sot dhe bisedova gjatë me sekretarin e KQ të Partisë Komuniste të Kolumbisë (marksiste-leniniste) shokun Pedro Vaskues¹. Dukej shok i mirë dhe i vendosur.

Shkuam në ambasadën rumune dhe ngushëlluam ambasadorin për vdekjen e G. G. Dezhit.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 235.

E DIEL
21 MARS 1965

Sot prita në shtëpi ambasadorin kinez, i cili më komunikoi se Çu En Lai do të vijë për vizitë zyrtare në Shqipëri më 27 mars dhe do të qëndrojë tri ditë. Ai do të vejë më parë në Rumani për të marrë pjesë në varrimin e Dezhit dhe prej andej do të vijë te ne. Iu luta t'i transmetojë udhëheqjes së tij falënderimet tona.

E HËNË
22 MARS 1965

Para disa ditësh kërkova të më përgatitnin disa informacione për gjendjen aktuale në rrethet Krujë dhe Lezhë, për të marrë pjesë në aktivet e Partisë që do të zhvillohen atje më 26 dhe 29 mars. Meqenëse këtu do të vijë delegacioni kinez unë nuk mund të shkoj për të marrë pjesë në këto aktive, prandaj lajmërova shokun Haki të caktojë shokë të tjerë.

Kinezët transmetuan sonte një artikull për mbledhjen përçarëse revizioniste të Moskës, të 1 marsit. Artikulli është i mirë. Më mirë vonë se kurrë!

Në Rumani u zgjodh sekretar i parë i Komitetit Qendror të Partisë Nikolae Çausheku, kurse Kivu Stoika u caktua kryetar i Këshillit të Shtetit. Thonë se Çausheku ka qenë kurdoherë afër Dezhit. Të shohim qëndrimet e tij konkrete në jetë.

E MARTE
23 MARS 1965

Barbarët amerikanë përdorën gazrat helmuese kundër partizanëve vietnamezë. Me të gjitha forcat të mbrojmë luftën e shokëve tanë vietnamezë dhe të demaskojmë veprimet kriminale amerikane!

E ENJTE
25 MARS 1965

Shokët Rita dhe Pilo u kthyen nga Rumania, ku shkuan për varrimin e Dezhit. Pritja që shokëve tanë iu bë nga rumunët qe e ngrohtë.

Lufta në Vietnamin e Jugut, sipas mendimit tim, ka hyrë në një fazë të re. Imperialistët amerikanë gjenden në pozita shumë të vështira, ushtarake dhe politike. Ata duan të dalin nga kjo gjendje, por duke u përpjekur të shpëtojnë edhe prestigjin, edhe pozitën e tyre politike e ushtarake në Vietnam dhe në Indokinë. Këto janë dy gjëra që natyrisht nuk mund të pajtohen dhe nuk mund të shkojnë së toku, prandaj amerikanët do të pësojnë disfatë.

Në Vietnamin e Jugut amerikanët po pësojnë humbje. Kukullat e tyre vendase u diskredituan totalisht, kështu që imperialistët amerikanë s'gënjejnë më njeri se gjoja mbrojnë popullin e Vietnamit, mbrojnë qeverinë e Sajgonit, që nuk ekziston. Ushtria e kukullave është pa shpirt, ajo është e detyruar të struket në qytete, nëpër rrugë dhe të bëjë puçe për klikat dhe për ameri-

kanët. Vietkongu i ka mbyllur amerikanët dhe kukullat në qytete dhe në aerodrome, bile edhe këtu po i godet. Pra ata rrezikohen të hidhen në det, të kapitulojnë. Këtë gjë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si fuqi e madhe agresive, s'mund ta pranojnë kollaj. Prandaj ato përpiqen të gjejnë rrugëdalje. Për këtë heqin forca nga baza të tjera dhe i sjellin në Vietnam për të përforcuar pikat e mbështetjes, qytetet, aerodromet, portet. Të ashtuquajturën ushtri të vullnetarëve, kukulla koreanojugorë, përpiqen ta angazhojnë më shumë në luftime kundër partizanëve. Por ushtrinë e Sajgonit e pret shpartallimi total. Gjatë kësaj kohe imperializmi amerikan vazhdon bombardimet në Vietnamin e Veriut, me qëllime të shumta: t'u japë kurajë kukullave, të frikësojë partizanët, të bëjë shantazh e të frikësojë Vietnamin e Veriut dhe Kinën, t'i bëjë t'i përunjen diktatit të tij, të vërë në lëvizje miqtë e vet, sovjetikët, anglezët, titistët, që të punojnë për kapitullimin e luftës së Vietkongut dhe të Vietnamit të Veriut. Pra imperializmi amerikan, nga një anë, sjell trupa amerikane në Jug për të forcuar bazat, hedh gazra helmuese në popull, bombardon Vietnamin e Veriut, nga ana tjetër, punon që të shtyjë sovjetikët dhe titistët që të manovrojnë për kapitullim pa kushte të vietnamezëve dhe të shuajnë luftën në favorin e amerikanëve.

Amerikanët janë për bisedime nga pozita force, janë që të pushojë lufta dhe të çarmatosen partizanët.

Pasi të bëhen këto, duan të krijojnë një qeveri të re «demokratike» kukull, ekonomikisht ta kenë Vietnamin në zap, të riorganizojnë dhe të armatosin ushtrinë reaksionare kukull për ta bërë mbështetje të tyre dhe

vetë të qëndrojnë në porte dhe në aerodrome, t'i kenë këto baza të tyre. Kështu të qeverisë në Sajgon jo qeveria kukull, por ambasada amerikane. Nga këto pozita ata duan të gllabërojnë Vietnamin e Veriut, ta thyejnë atë, ta shkëputin nga Kina. Këtë e pohoi tani edhe një senator amerikan i cili deklaroi se «neve na duhet në Azi një Vietnam titist».

Sovjetikët dhe titistët punojnë intensivisht që të realizohet plani amerikan. Demagogjia e revizionistëve sovjetikë fsheh veprimet e tyre sekrete dhe të koordinuara me amerikanët, me anglezët, me titistët. Sovjetikët kanë për qëllim të bëjnë që Vietnamin e Veriut të kapitulojë, të vejë në bisedime pa kushte, ta shkëputin atë nga Kina, të shkaktojnë çarje, të futen në Vietnamin e Veriut, gjoja me vullnetarë, gjoja me «këshilltarë» ushtarakë, për t'u mësuar armatimet e vjetra dhe simbolike që do t'u japin, dhe kështu nën maskën e ndihmës të pushtojnë Vietnamin, të shuajnë luftën në Jug, të hyjnë në ujdi me amerikanët dhe në favor të amerikanëve. Titistët, nga ana tjetër, përpiqen të ndihmojnë amerikanët në planin e tyre, duke punuar në drejtim të forcave të djathta, në vendet e çliruara ose të porsaçliruara, për të krijuar opinion të favorshëm për planin amerikan, për të zbukuruar dhe për të fshehur agresivitetin e amerikanëve dhe për të nxitur e për të shtuar armiqësinë kundër Kinës.

Kjo është një politikë e orkestruar edhe me zhurma bombash, të cilat vazhdojnë dhe do të vazhdojnë të hidhen në Vietnamin e Veriut. Por e gjithë kjo do të jetë një fiasko e madhe për amerikanët, për sovjetikët e për titistët. Kjo nuk frikëson, nuk gënjen, as vietnamezët

e Jugut, as RD të Vietnamit, as Kinën, as ne, as gjithë marksistë-leninistët dhe popujt që luftojnë. Fitorja është jona. Amerikanët janë zënë si me thënë për gryke në Vietnam. Ata atje do të goditen edhe më keq, do të demaskohen dhe do të thyhen tok me sovjetikët, me tivistët etj. Këta aleatë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e shohin që tani pisk punën, pse janë në pamundësi ta mbrojnë hapur. Në vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës lufta koloniale s'ka simpati. Sa më tepër amerikanët të futen në luftë në Vietnam, aq më keq është për ta. Po ta zgjerojnë atë, atëherë u erdhi fundi, disfata e sigurt. Prandaj me të gjitha forcat të ndihmojmë dhe të jemi në një vijë lufte me Vietnamin!

E PREMTE
26 MARS 1965

Kinezët botuan tekstin e artikullit tonë kundër mbledhjes përcarëse revizioniste të Moskës. Shumë mirë!

E SHTUNË
27 MARS 1965

Sot në mëngjes Çu En Lai mbërriti në Shqipëri. Iu bë pritje shumë e ngrohtë. Populli kishte dalë në rrugë, entuziazmi ishte i madh. Çuja ishte shumë i gëzuar, na bëri vizitat protokollare dhe pasdreke filluam bisedimet zyrtare. Fola unë i pari dhe trajtova gjatë problemet ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ekonomike në mes të dy vendeve tona¹. Çu En Lai dëgjoi me shumë vëmendje dhe mori shumë shënime. Ia dhamë edhe të plotë diskutimin tim. Nesër do të flasë ai.

Pas pune, në mbrëmje, hëngrëm darkë së toku. Çdo gjë shkoi shumë mirë, me dashuri e ngrohtësi.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 254.

E DIEL
28 MARS 1965

Tërë ditën sot foli Çu En Lai. Ai na bëri një ekspozitë të gjatë të problemeve ndërkombëtare dhe si i shikojnë ato shokët kinezë. Duket që janë të një mendimi me ne për problemet e situatat që diskutuam. Indirekt ai bëri dhe autokritikë. Kjo është një fitore për ne. Nesër ai do të flasë për marrëdhëniet ekonomike.

Në mbrëmje ne dhamë darkën tonë zyrtare. Kaloi shumë mirë, në një atmosferë të ngrohtë e të gëzuar.

E HËNË
29 MARS 1965

Vazhdojnë bisedimet. Në mëngjes foli Çuja për marrëdhëniet ekonomike midis vendeve tona. Ekspozeja e tij ishte pozitive dhe puqej plotësisht me parimet e ndihmës internacionaliste që shtrova unë për ndihmat që duhet të na japin kinezët. Natyrisht, ai nuk foli konkretisht për objektet, po ato që tha janë pozitive dhe shpresoj se çdo gjë do të konkludohet mirë. Pas tij foli edhe unë dhe u duk qartë se ne ishim dakord në çështjet që u shtruan. Pra, si konkluzion, ardhja e Çusë ishte një fitore për ne, çdo gjë u sqarua në mënyrën më të plotë.

Pasdreke miting i madh në sheshin «Skënderbej». Populli e duartrokiti shumë herë e nxehëtishtë fjalimin e Çusë.

Në mbrëmje, pritje nga ana e shokëve kinezë. Çu En Lai foli shumë ngrohtë për Partinë tonë. Fola edhe unë. Çdo gjë kaloi në mënyrë shumë miqësore. Kjo vizitë e kaliti më tej miqësinë midis dy popujve tanë.

E MARTË
30 MARS 1965

Sot e përcollëm Çu En Lain. Gjatë rrugës dhe në aerodrom kishte popull. Çuja u tregua shumë entuziast. Çdo gjë i bëri përshtypje të madhe.

Kjo vizitë është një sukses i madh për Partinë dhe për popullin tonë.

Çu En Lai u nis për në Algjer, Kajro, Karaçi dhe Rangun.

[MARS 1965]¹

Mendime për studentët

Për sa i përket orientimit për profesionin që vajza do të zgjedhë në universitet, ajo është e influencuar nga ambienti familjar më shumë se djali.

Ka prej tyre që mendojnë të fillojnë punën për disa arsye: martohen në moshë të re, të ardhurat e burrit nuk janë të mjaftueshme në familje dhe dëshirojnë të kenë më shumë liri financiare etj.

Te ndonjë vajzë mund të ekzistojë edhe mendirai që të marrë një profesion për të gjetur një burrë të mirë, por mundet gjithashtu të ekzistojë, në radhë të parë, mendimi që duhet të ketë një profesion.

Te vajzat martesë mund të pengojë për të vazhduar shkollën e lartë, po ashtu edhe shtatzënësia. Prandaj zakonisht ato mund të priren në zgjedhjen e fakulteteve më të shkurtra, që duan më pak vite për t'u kryer, që ato të krijojnë familje, domethënë të mos zgjedhin të

1. Këto shënime nuk kanë datë. Mendohet të jenë mbajtur në mars 1965, pas mbledhjes së Byrosë Politike të 9 marsit 1965, ku autori ka reflektuar në vazhdim të diskutimit të tij «Shkolla jonë është politike dhe ideologjike».

atilla profesione që nuk u japin mundësinë të jenë më të shumtën e kohës në shtëpi.

Konditat e jetës do t'i orientojnë vajzat më vonë që të ndjekin universitetin, të zgjedhin ato degë që do t'i harmonizojnë më mirë me jetën familjare, si, për shembull, letrat, nëpunësia, arsimit dhe deri diku mjekësia.

Kur mbaron shkollën e mesme dhe hyn në universitet, studenti dhe studentja kanë një nocion tjetër për independencën. Në fillim, këtë nocion, veçanërisht vajzat, e kanë të zhvilluar, por më pas shikohet që ndryshimi është i vogël, sepse fillon e njëjta praktikë si në shkollën e mesme. Janë po e njëjta disiplinë në punë, po të njëjtat kërkesa për mësim, po të njëjtat kërkesa familjare dhe po ai ambient familjar. Sidomos vajza gjendet përsëri po në ato rrethana të kufizuara shokësh dhe shoqesh, si në shkollën e mesme, nuk e ka marrë akoma atë sigurinë e nevojshme, që ta ndiejë veten të lirë nga paragjykimet që e frenojnë këtë liri dhe në përgjithësi zhvillimin e saj dhe këto kurdoherë duhen kuptuar lidhur me rritjen e personalitetit të saj dhe jo në kuadrin e ngushtë të «liberalizmit», thjesht në marrëdhëniet e dashurisë, në mes burrit dhe gruas.

Zakonisht thonë se gruaja «ka fjalë shumë», por kur është çështja të flasë në një mbledhje studentësh, ajo nuk ka shumë fjalë, përkundrazi është ca e drojtur, që të afirmojë me forcë mendimin e saj. Por në mësim, në përgjithësi vajza është më e aplikuar, mëson mirë, i ndjek më mirë kurset, por më të shumtat e herës ajo kufizohet në atë kornizë që mëson ose që ka mësuar.

Me gjithë këto nuk mund të dilet në konkluzione

të gabuara, se për disa profesione intelekti i djemve është më i zhvilluar se ai i vajzave, ose në këtë profesion janë më të përshtatshëm burrat sesa gratë, si për shembull për shkencat janë më të prirë djemtë dhe në letra e në arte gratë, ose doktoresha gjinekologe ose pediatre janë më shumë gra se burra, ose gratë «s'bëhen dot kirurge pse e kanë më të zhvilluar sensibilitetin» etj. Këto prirje duhet t'i kërkojmë më shumë jo në natyrën biologjike të gruas, por në gjendjen sociale të saj, në mbeturinat e së kaluarës, që rëndojnë akoma mbi të dhe në shumë kondita aktuale shoqërore që vazhdojnë të influencojnë rëndë mbi gruan.

Do të jetë interesante të bisedohet me disa studentë dhe studente për të parë si mendojnë dhe si i ndiejnë ata këto çështje.

E ENJTE
1 PRILL 1965

Koha është e mirë, por e ftohtë. Sa mirë do të jetë sikur të ftohtit të mos vazhdojë gjatë se na dëmton, si domos pëmët.

të gabuara, se për disa profesione intelekti i djemve është më i zhvilluar se ai i vajzave, ose në këtë profesion janë më të përshtatshëm burrat sesa gratë, si për shembull për shkencat janë më të prirë djemtë dhe në letra e në arte gratë, ose doktoresha gjinekologe ose pediatre janë më shumë gra se burra, ose gratë «s'bëhen dot kirurge pse e kanë më të zhvilluar sensibilitetin» etj. Këto prirje duhet t'i kërkojmë më shumë jo në natyrën biologjike të gruas, por në gjendjen sociale të saj, në mbeturinat e së kaluarës, që rëndojnë akoma mbi të dhe në shumë kondita aktuale shoqërore që vazhdojnë të influencojnë rëndë mbi gruan.

Do të jetë interesante të bisedohet me disa studentë dhe studente për të parë si mendojnë dhe si i ndiejnë ata këto çështje.

E ENJTE
1 PRILL 1965

Koha është e mirë, por e ftohtë. Sa mirë do të jetë sikur të ftohtit të mos vazhdojë gjatë se na dëmton. si-
domos pemët.

ELBASAN, E PREMTE
2 PRILL 1965

Sot erdha për një vizitë në rrethin e Elbasanit. Vizitova kantierin e ndërtimit të uzinës së metalurgjisë së zezë. Punët atje shkojnë mirë, punëtorët kanë marrë zotime që këtë objekt ta mbarojnë sivjet dhe besoj se do ta mbajnë fjalën. Janë entuziastë dhe kanë marrë masa. Materialet nuk mungojnë. Kulmi i punës do të jetë në gusht dhe atëherë atje do të nevojitet maksimumi i specialistëve, kështu që do të detyrohemi të dërgojmë atje specialistë edhe nga rrethet e tjera. Në qoftë se organizata e Partisë në ndërmarrje do të fillojë të punojë që tash, për këtë pikësynim, me forcë dhe me kurajë, ka mundësi që shumicën e kuadrove specialistë, ta përgatitë nga radhët e rinisë së zjarrtë punëtore të kantierit. Këtë këshillë ua theksova fort shokëve drejtues të kantierit, punëtorëve e specialistëve.

Në përgatitjen e kuadrit të ri, në caktimin e njerëzve në detyra me përgjegjësi, duhet të ecim me rrugë revolucionare. Tjetër rrugë të sigurt të shpejtë nuk ka.

ELBASAN, E SHTUNE
3 PRILL 1965

Vizitova Rafinerinë e Naftës në Cërrik. Bisedova me kuadrot drejtues të saj, me inxhinierët, me teknikët dhe me punëtorët. Ika me përshtypje të mirë për një-rëzit dhe për punën. Ajo është një ndërmarrje solide, e sigurt dhe e stabilizuar. Çdo gjë atje është në rregull, pastërti, jo rrëmuje, jo punë të lënë përgjysmë. Natyrisht, kanë edhe të meta, që do t'i zhdukin me punë, edhe nevoja, të cilat do të marrim masa t'ua plotësojmë.

Mora pjesë në konferencën e 11-të vjetore të rinisë së Elbasanit. Sekretari i parë i rinisë i rrethit mbajti raportin. Pastaj filluan diskutimet. Shumë optimizëm, gjallëri, kurajë dhe pjekuri ka në rininë tonë.

Në mbrëmje vajta në shfaqjen e përbashkët të estradave të Korçës, Elbasanit, Pogradecit e Lushnjës. Kishte mjaft përparime, sido që akoma kemi shumë për të bërë në këtë drejtim.

ELBASAN, E DIEL

4 PRILL 1965

Vazhdojnë diskutimet e zjarra e të pjekura në konferencën e rinisë së Elbasanit.

Sefedin Kongoli (shëf i planit në ndërmarrjen e shfrytëzimit të pyjeve). Mbahti raportin e komisionit të revizionimit. Është shok i ri, po duket energjik. Foli sidomos për realizimin e kuotave, veçse ka çrregullime në mbajtjen e tesarave dhe të dokumenteve.

1. **Jani Xharda** (teknik i mesëm, elektrikist në TEC, anëtar i plenumit). Flet për jetën në organizatat e kooperativave. Kërkon që arsimtarët të japin më shumë kontribut për të ndihmuar rininë. Shtroi problemin e ngritjes tekniko-profesionale të të rinjve dhe të përveçësimit të profesioneve prej tyre.

2. **Luan Shqera** (veteriner, anëtar i byrosë së rrethit). Flet se rinia duhet të njohë mirë bujqësinë, të mësojë shkencën e teknikën dhe të jetë e zonja në praktikë. Kurset në këto drejtime ndiqen me kujdes.

Ka të rinj që nuk e kuptojnë drejt rëndësinë e kurseve. Por organizata e rinisë punon dhe influencon në këtë drejtim. (Është mirë që në komitetin e rinisë të kemi kuadro të lartë, e sidomos në bujqësi, sepse këta

mund t'i tërheqin dhe t'i edukojnë më mirë të rinjtë nëpërmjet punës).

3. **Tele Selimi** (nxënëse e shkollës pedagogjike). Bëri një diskutim të bukur, të shkruar mirë, me ndjenja dhe me ide të drejta e të zjarrta. Vajzë e zgjuar. Në diskutimin e saj tregoi se, veç mësimëve, punojnë për t'i zbatuar ato në jetë.

4. **Qemal Çela** (organizata e rinisë e metalurgjisë). Tregon për punën heroike të rinisë punëtore në metalurgji. Ka ngurrim në kantiere të merren të rinj në punë. Ky qëndrim është i dëmshëm. (Diskutim i mirë, plot entuziazëm dhe kritik, ashtu siç duhet.)

5. **Suzana Tollumi** (organizata e rinisë Vidhas. Është arsimtare, ka mbaruar pedagogjikën). Tregon punën serioze të rinisë së fshatit të saj. Flet për edukimin patriotik të rinisë dhe për aktivitetin e mirë të kësaj organizate. Ç'mrekulli kur shikon një vajzë të fshatit tonë të bëhet mësuese dhe të punojë e të flasë me kaq kulturë.

6. **Xhavit Blogu** (organizata e rinisë Gostimë. Është përgjegjës i shtëpisë së kulturës, ka mbaruar shkollën artistike).

Flet për jetën në familje dhe kulturën. Diskuton lirisht, pa letër, me shënime. Tregon për zotime konkrete që ka marrë rinia.

7. **Sefedin Allkja** (organizata e rinisë e ndërmarrjes ushqimore. Punëtor novator).

Tregon përparimet dhe flet me rezultate konkrete. Tregon shembuj të mirë dhe konkludon duke thënë: «Këta janë njerëz të thjeshtë të rinisë, njerëz të kohëve tona». Diskuton shumë mirë për letërsinë e re dhe bën

vërejtje kritike e të drejta. Në cilësinë e prodhimeve janë nga të parët në republikë.

8. **Petrit Kurti** (organizata e rinisë Pajovë). Shënimet i ka në letra të vogla si fletë cigareje, por flet mirë, drejt, qartë, thjesht. Foli shumë drejt për njësitë e kontrollit në brigadë.

9. **Liri Gjoshi** (organizata e rinisë Seferaj. Është anëtare partie). Bëri një diskutim të guximshëm dhe të drejtë, kritik. Solli si shembull historinë e saj që u rezistoi prindërve dhe u martua me atë që dëshoi.

10. **Kujtim Ballhysa** (organizata e rinisë e parkut të automjeteve). Në esencë tha se që të kryhen punët mirë, duhet të forcohet bindja për çdo gjë.

11. **Hysen Malej** (organizata e NISH Kimikes).

Foli për edukimin e rinisë në qendrën e punës.

12. **Violeta Binjaku** (organizata e rinisë Shpat-Gjinar).

Mësuese e re. Tregon jetën e saj dhe arritjen e qëllimeve dhe të dëshirave të saj. Flet për luftën kundër zakoneve prapanike; për t'i bindur të rinjtë për dëmin e tyre, kanë bërë jo vetëm konferenca, por edhe punë konkrete, duke organizuar aktivitete të ndryshme.

Kanë bërë përpjekje për përmirësimin e mënyrës së jetesës në shtëpi, në veshje, në ushqim (flet me zjarr dhe me logjikë të fortë).

13. **Fisnik Hoxholli** (organizata e rinisë e NBSH-së së Elbasanit). Flet për lëvizjen e brigadave socialiste.

14. **Fatmir Biçaku** (organizata e rinisë e Kombinatit të Drurit).

Pranon kritikën që u bënë në raport (flet për luftën në Vietnam).

15. **Irma Saraçi** (organizata e rinisë e gjimnazit «Qemal Stafa». Vajzë e dalluar e shkollës, e zgjuar dhe dinamike).

Tregon se si organizohet ndihma për nxënësit e dobët. Flet gjithashtu për punën praktike në shkollë. Shprehu solidarizimin e saj me luftën e popullit të Vietnamit.

16. **Gani Luli** (organizata e rinisë Shtërmën). Diskutoi shumë mirë, foli për zhvillimin e fshatit dhe për përmirësimin e mënyrës së jetesës. Tregoi se shtëpitë i kanë mobiluar, se e kanë rregulluar shumë mirë ekonominë në familje. Flet për artin (kanë marrë çmimin e parë në republikë për shfaqjet).

Është krenar për aktivitetin e kooperativës së tij. Flet për luftën kundër zakoneve të këqija.

17. **Afërdita Nikolla**. Raport i komisionit të mandateve. Sekretare e rinisë, merret me të rejtat. Është ndihmësmjete. Vajzë e zgjuar.

18. **Sotiraq Gjordeni** (organizata e rinisë e ushtrisë).

Flet për organizatën e rinisë në ushtri. Diskutim i bukur, i hartuar plot vendosmëri e poezi. Bilbil nga goja, si i thonë fjalës. Njeh vështirësitë në punën edukative veçanërisht për shkak të «heterogjenitetit» në ushtri. Theksoi se duhet të njihen të gjitha zakonet prapanike të krahinave të ndryshme.

19. **Sokrat Popa** (organizata e rinisë e rezervave të punës).

Nga radhët e tyre kanë dalë shumë kadro që punojnë në ndërmarrje të ndryshme. Flet për lidhjet e mësimin me punën, me jetën. Tregon raste të ndryshme kur

të rinjtë e shkollës janë bërë shembull me veprimet e guximshme për ruajtjen e makinerive. Rekomandon që brezi i ri të punojë kudo dhe kritikon ata që tërhiqen përpara presioneve të vështira. Tregon se si me punën e tij (që e konkretizoi edhe përpara nxënësve), një punëtor me dy këmbë të prera u bë shembull për të tjerët; kjo bëri një efekt të madh dhe edukoi pa masë.

Diskutimet e të rinjve u mbyllën.

Në pushim bëra shumë fotografi me delegatët. Pas-taj e mora fjalën unë¹. Fola gjatë për rolin dhe detyrat e rinisë. (Fjalën time shoku Haxhi Kroj e mori me stenogram.) Mbeta shumë i kënaqur nga mbledhja, nga diskutimet e guximshme dhe plot brumë, me detyra, preokupacione dhe optimizëm.

Kemi një rini të mrekullueshme.

Pas fjalës që mbajta, unë u largova, kurse konferenca vazhdoi seancën për të bërë zgjedhjet.

Përshtypjet e mia nga kjo konferencë janë të mira. Raporti i mbajtur ishte plot me detyra, sikur po i drejtohej një aktivisti partie. Shpesh shokët e Partisë që drejtojnë rininë, nuk bëjnë kujdes, prandaj konstatojmë që shumë herë edhe raportet që mbahen i humbasin karakteristikat e rinisë. Kurse e kundërta ngjet me anëtarët e rinisë, me ata që dalin dhe diskutojnë në tribunë. Ata, duke qenë të pjekur, të thellë në mendime, ruajnë freskinë e rinisë në diskutime, në brendinë e problemeve, por edhe në paraqitjen.

Më bënë përshtypje shumë të mirë të rinjtë që diskutuan, bile më tëpër ata të fshatit, të cilët flisnin

thjesht, por fjalët e tyre ishin po aq të rrjedhshme, po aq të lidhura mirë, nga ana e formës stilistike e gramatikore, sa edhe ato të diskutantëve nga qyteti i Elbasanit. Dukej që ishin të rinj e të reja që kishin mbaruar shkollat, pa përjashtim. Por edhe mendimet dhe problemet që shtronin, ishin shumë të thella. Vajzat nuk mbeteshin aspak pas djemve, bile, disa herë paraqiteshin më lart.

Fakt është se nga të gjitha diskutimet del me shkëlqim serioziteti i punës së rinisë dhe lidhjet e ngushta të saj me Partinë. Të rinjtë e njohin vijën e Partisë për mrekulli. Në punën e tyre, në çdo hap ata kanë parasysh porosinë e Partisë dhe udhëhiqen prej tyre.

Duket kujdesi i madh i rinisë për edukimin moral-politik të saj, kujdesi që të rinjtë tanë i vënë ruajtjes së pastërtisë së ndërgjegjes dhe të moralit komunist. Të gatshëm për punë, entuziastë — ata mund të kryejnë çdo detyrë që u ngarkohet.

Të shtohet kujdesi i Partisë për të rinjtë, të shtohet përkrahja, pse rinia është në gjendje të çajë male, të nxjerrë vepra të mëdha të përjetshme.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 296.

ELBASAN, E HËNË
5 PRILL 1965

Në mbledhjen e organizuar në sallën e shtëpisë së kulturës zhvillova një bisedë me kuadrot kryesorë të Partisë të rrethit të Elbasanit. I informova gjerësisht për gjendjen në çdo drejtim brenda vendit, si dhe për situatën ndërkombëtare, duke theksuar detyrat që na dalin përpara të gjithëve¹. Më dëgjuan me vëmendje të madhe.

Pasdite vizitova Peqinin, ku bëra një bisedë me shokët drejtues të lokalitetit. Më raportuan për gjendjen, për rezultatet që kanë arritur në sektorë të ndryshëm, sidomos në fushatën e mbjelljeve të pranverës, dhe për problemet që u dalin. Bënë disa kërkesa, të cilat do t'ua plotësojmë.

Në mbrëmje u ktheva në Tiranë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 324.

E MARTË
6 PRILL 1965

Në sektorin e tregtisë po bëhen të dukshme disa të meta, të cilat duhen eliminuar sa më parë. Ka punonjës të tregtisë që nuk e dëgjojnë sa duhet dhe si duhet zërin e masave, kritikën, ankesat dhe kërkesat që bëjnë këto. Ky qëndrim mospërfillës, disa herë arrogant i tyre duhet luftuar dhe zhdukur medoemos. Në disa elementë të tregtisë është krijuar një mentalitet antisocialist, sipas të cilit klienti është i detyruar ta blejë mallin që do, sido që të jetë ky dhe kur t'i bëhet mirë shitësit. Sjelljen e kulturuar, modestinë, fjalët e ëmbla bindëse, disa nga punonjësit e tregtisë i quajnë servilizëm ndaj blerësit dhe s'e kanë për gjë të përgjigjen në mënyrë prepotente, të pakulturuar, si «po të duash merre mallin, po të duash lëre» etj.

Këtyre sjelljeve të padenja e të dënueshme nga shoqëria jonë u duhet prerë rruga sa më parë.

Disa punonjësve të pandërgjegjshëm të tregtisë u intereson vetëm të marrin në rregull rrogën e tyre, kurse mallin e shtetit ata e konsiderojnë si të huaj dhe shërbimin ndaj popullit si një punë angari, të cilën mezi presin sa ta mbarojnë, bile kur u paraqitet mun-

dësia gjejnë një mijë arsye që ta lënë punën e të mbyllin dyqanin para orarit. Janë pikërisht këta që neglizhojnë mbledhjet me popullin dhe nuk marrin masa të shpejta për të ndrequr të metat.

Me ta duhet punuar seriozisht, duhen këshilluar të ndreqen sa më parë, dhe në qoftë se nuk korrigjohen, të flaken nga tregtia dhe nga kontaktet e përditshme me popullin. Në tregti duhet të punojnë njerëz të ndershëm, shërbëtorë të vërtetë të popullit, që të jenë kurdoherë, në çdo rast, të gatshëm për të plotësuar me mirësjellje çdo kërkesë të popullit.

Edhe në furnizimin e dyqaneve ka të meta. Ka mungesë mallrash e artikujsh të ndryshëm, jo pse nuk kemi, por sepse ka burokratizëm dhe nuk bëhen përpjekjet e duhura për të përmirësuar gjendjen.

Në mjaft lokale publike nuk mbahet pastërti, gjellët nuk gatuhet mirë dhe përgjegjësit e këtyre lokaleve as që bëhen merak për klientët, për shijet dhe kërkesat e tyre.

Disa punonjës të tregtisë me veprimet e tyre burokratike kanë shkaktuar anomali në blerjen e bukës në dyqane, aq sa krijojnë përshtypjen tek të tjerët që në disa vende buka po ndahet në formë racioni. Kjo është e palejueshme. Rregullimi i shitjes së bukës nuk do të thotë racionim i saj. Racionimi është tjetër dhe të tillë ne s'kemi.

Në të gjitha njësitë tregtare duhet medoemos të respektohet tetorëshi, të gjitha veprimet të bëhen jashtë orarit të punës, në mënyrë që të mos ndodhë si në shumë raste kur dyqanet rrinë mbyllur disa orë me radhë brenda orarit të punës, sidomos nëpër fshatra.

Edukimi i shitësve të bëhet jo vetëm nëpërmjet leksioneve, por mundësisht me hapjen e kurseve disamujore. Kjo gjë të shikohet edhe për kamerierët e lokaleve. Paketimi dhe ambalazhimi i mallrave është me rëndësi për tregtinë, sepse flet për shërbim të kulturuar dhe mënjanon në njëfarë shkalle suficitet e deficitet.

Të shkohet gjithashtu edhe drejt një ambalazhimi standard, nga depot qendrore për dyqanet malli të paketohet në thasë e qeska prej letre ose celofani.

E MËRKURË
7 PRILL 1965

Mbi punën e Institutit të Kërkimeve dhe të Studimeve Gjeologjike e Minerale¹

Më parë ky institut punonte si laborator i Ministrisë së Minerave. Por edhe tani që u kthye në institut ai ka mbetur në rrugë dhe nuk po i zhvillon punimet si i tillë.

Laboratori i mëparshëm nga gjithçka që ishte më parë, bëhet tash mjeti i institutit, domethënë mjeti për vërtetimin e studimeve që duhet të bëjë instituti dhe jo më instituti të funksionojë si laborator i thjeshtë.

Pra jemi larg që instituti të ketë marrë karakterin e vërtetë të detyrave të tij të rëndësishme. Kjo ngjet se as ministria nuk e ka kuptuar këtë gjë si duhet dhe nuk e vë në vijë, por as edhe kuadrot që punojnë në të.

Atje punojnë 53 kuadro të lartë dhe 62 me arsim

1. Mbi bazën e këtyre shënimeve shoku Enver Hoxha ka mbajtur diskutimin në mbledhjen e Sekretariatit të KQ më 10 prill 1965. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 362.

të mesëm. Me se merren pra këta kuadro? Me punë praktike laboratorike, apo me studime, të cilat i vërtetojnë me punët laboratorike?

Siç del, kuadrot e lartë të institutit, merren më shumë me analiza laboratorike dhe jo me studime e me punë laboratorike. Këta nuk kanë plan studimesh, ose kanë diçka të vogël dhe këtë diçka nuk e bëjnë siç duhet dhe me kujdes. Kuadrot e lartë që punojnë në institut duhen konsideruar një forcë e madhe, kurse ata 3/4 e kohës e harxhojnë me analiza që janë detyrë e laborantëve, të cilët në qoftë se nuk i kanë të mjaftueshëm t'i shtojnë dhe në qoftë se nuk i kanë të përgatitur, t'i përgatitin.

Është e papranueshme që në një institut siç është ky, për punën që bën dhe për kushtet tona, kur nevojat për kuadër të lartë janë të mëdha, të ketë aq kuadro të lartë sa ka edhe të mesëm.

S'ka asnjë dyshim se ka kuadro të lartë që bëjnë punën e laborantit. Ministria e lejon këtë gjë të palejueshme qoftë ekonomikisht, qoftë nga pikëpamja shkencore, po edhe nga fakti se analizat janë trefishuar.

Laboratorit mund t'i caktohet për të bërë një pjesë të analizave, por pjesa tjetër duhet t'u kushtohet nevojave të studimeve që bën instituti, të cilat duhet të jenë të domosdoshme për ekonominë.

Në rast se nuk ecet në këtë rrugë, atëherë një pjesë e kuadrove të lartë duhet të shkojë në terren dhe të zëvendësohen me laborantë. Mirëpo ne nuk e ngritëm institutin që të ecim në këtë rrugë.

Kuadrin laborant duhet ta specializojmë dhe të evitojmë numrin e madh të kuadrit të panevojshëm administrativ.

Jam dakord që ndërmarrjet ta organizojnë punën në mënyrë që shumë analiza t'i bëjnë vetë dhe unë kam parë se në çdo ndërmarrje, sipas rëndësisë, ka nga një laborator dhe laborante, prandaj nuk e kuptoj dhe s'duhet lejuar që institutit t'i shtohen edhe analizat që nuk i përkasin këtij, por ndërmarrjeve.

Pra, ministria e shikon këtë problem thjesht si një praktikë të përditshme.

Nuk mund të kuptohet dhe as të pranohet që këshilli shkencor i një instituti studimesh të mblidhet rralë. A është ky një institut shkencor dhe studimor?

Kjo është një e dhënë kapitale, që vërteton atë që thashë më lart, se ky institut është akoma larg të punojë si i tillë dhe pra duhet sa më parë të marrim masa urgjente për ta ndryshuar gjendjen.

Nuk mund t'u lejohet kuadrove të lartë të këtij instituti të mos studiojnë, të mos kryejnë studime shkencore, që u janë vënë përpara, të mos kenë plan pune, të mos bëjnë shtruarje të temave dhe diskutime shkencore, të mos vërtetohen këto me eksperimentime laboratorike. Kjo gjendje vërteton atë që thashë më sipër, se kuadrot e lartë këtu e kalojnë më të shumtën e kohës së tyre me punë praktike, të cilën mund dhe duhet t'ua bëjnë ndihmësit e tyre, sepse me këtë metodë pune, as kuadrot e lartë nuk rriten, po as ndihmësit, pra laborantët nuk përgatiten, pse nuk u jepet punë dhe nuk u lihet iniciativë krijuese.

Kuadrot e lartë të institutit, duhet të jenë dhe të bëhen njerëz të pasionuar për studime, për zgjerimin e njohurive të tyre shkencore, të jenë njerëz metodikë siç e lypin shkencat ekzakto, të jenë studiues. Në qoftë

se ka javashllëk dhe përtaci, siç po vërtetohet në punën e këtij instituti, atëherë duhet të merren masa që dembelët të shkojnë në bazë, në «luftë», në praktikë, që të shërohen.

Unë e kuptoj që mund të ketë javashllëk në një studim të thellë, serioz të gjerë, të komplikuar, të vështirë, por ky javashllëk nuk ka karakterin e përtacisë dhe nuk ka të bëjë me të.

Aparatet unikale të laboratorit, jo vetëm që duhet të mbahen mirë, por duhet të shfrytëzohen, pse ndryshe s'ka kuptim që i kemi sjellë.

Këto kabinete moderne duhet të shihen nga afër, të ngarkohen me punë e me detyra. Në qoftë se ministria s'i plotëson dot këto me punët e saj, të shikohet mundësia për të plotësuar edhe një pjesë të nevojave të të tjerëve.

Më duket se në institut puna e organizatës së Partisë nuk mund dhe nuk duhet të jetë një punë e thjeshtë, e kufizuar vetëm në edukimin moralo-politik, por një nga detyrat kryesore të saj duhet të jetë orientimi i drejtë në thelbin shkencor të punës së institutit, në caktimin, studimin, diskutimin, përfundimin me sukses të temave shkencore. Dhe këtu nuk e kam çështjen të një punë formale, si për shembull me kontrollu caktimin e datave, të afateve, ose ditët e mbledhjeve.

Prandaj, duhet të merren menjëherë masat që të përmirësohet puna në këtë institut, që ky të veprojë si i tillë dhe jo më si një laborator i thjeshtë për punët praktike të përditshme të ministrisë dhe të ndërmarrjeve të saj.

E ENJTE
8 PRILL 1965

Filloi të bjerë shi. Është pikë e flori. Dëshirë kemi që të vazhdojë se tani bën shumë mirë për bujqësinë.

E PREMTE
9 PRILL 1965

Në mbledhjen e Byrosë Politike diskutuam shumë probleme, midis tyre edhe relacionin mbi masat për një rritje më të shpejtë të prodhimit bujqësor e blegtoral në zonat kodrinore e malore. Duke folur, veçanërisht për këtë problem, dhashë disa mendime¹. Shokët e Byrosë bënë vërejtje të vlefshme rreth studimit që na ishte paraqitur për këtë çështje, e cila do t'i shërbejë përmirësimit të mëtejshëm të studimeve për zhvillimin e bujqësisë e të blegtorisë në zonat kodrinore e malore.

Natyrisht, në bujqësi do të investojmë, por ama çështja nuk zgjidhet vetëm me investime. Prandaj, përveç plotësimit të kërkesave që dalin për këtë problem, nevojitet edhe një punë e madhe edukative nga organizata e Partisë, nga organet e pushtetit dhe nga organizatat e masave për mobilizimin e njerëzve nëpër kooperativat bujqësore dhe për kryerjen e detyrave me nivel të lartë teknik, dhe këtu, pikërisht këtu, duhet të rrahë çekani e jo të shtohet një kuadër në

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 352.

organikën e komitetit ekzekutiv. Udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në rreth duhet ta balancojë punën e saj si për qytetin edhe për fshatin, ku ka rezerva të mëdha që gjenden në vetë punën e njerëzve dhe në metodën e drejtimit. Vetëm kështu fshati ynë do të ecë përpara e bashkë me të gjithë vendi.

Po kështu, ndër të tjera, diskutuam edhe për disa ndryshime në nomenklaturën e kuadrit. U dhanë mendime të ndryshme. Në diskutimin tim vura theksin te çështja që të kuptohen mirë cilat janë kompetencat e Partisë dhe cilat janë ato të pushtetit për kuadrin. Në këtë drejtim të evitojmë burokratizmin, që pengon në ngritjen e kuadrit. Politikën e kuadrit duhet ta bëjë kurdoherë Partia.

Bëjmë mirë që kur aprovojmë kuadro shohim, në radhë të parë, anën politike të familjes së tij dhe të vetë kuadrit, qëndrimin e tij, nëse është i përshtatshëm politikisht për vendin e propozuar. Po mund të ndodhë që politikisht kuadri është në rregull, atëherë shikohet si punon, a është i aftë. Të dyja këto anë nuk ndahen.

Kuadrin ta ndjekim në punë dhe, kur krijohet një post i ri, të mendojmë se cili mund të ngrihet. Të gjitha këto i studiojnë përkatësisht forumet dhe zyrat e kuadrit të tyre, sipas nomenklaturës që kanë.

Mbi organikë nuk lejohet asnjë kuadër!

E SHTUNË
10 PRILL 1965

Sot, në mbledhjen e Sekretariatit diskutuam për hartimin e librave të veçantë mbi jetën dhe veprimtarinë e organizatës-bazë të Partisë. Për këtë çështje na ishte dhënë edhe një relacion.

Të gjithë shokët u shfaqën dakord që çdo organizatë, përveç librit-protokoll, të ketë edhe një libër tjetër, që të përmbajë historikun e saj. Siç ka ose duhet të ketë historik fshati, qendra e punës ose institucioni, pse të mos ketë edhe organizata-bazë e Partisë? Në këtë historik të shkruhet për të që kur është krijuar, rruga që ka kaluar, komunistët që kanë qenë në efektivin e saj, ndryshimet që pëson organizata, problemet që e preokupojnë, vendimet që merr, si zbatohen, rezultatet që arrihen, komunistët që lavdërohen ose kritikohen dhe përse etj.

Në fund të çdo viti, sekretari i organizatës-bazë harton faqet që i shtohen historikut. Kështu do të pasqyrohet jeta e çdo organizate partie.

Mbledhja e sotme e Sekretariatit diskutoi edhe mbi punën e organizatës së Partisë të Institutit të Studimeve dhe të Kërkimeve Gjeologjike e Minerale për të cilën fola edhe unë.

E HËNË
12 PRILL 1965

Bëmë mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor, ku aprovuam disa propozime për dekorime, ndarje administrative, dhënie shtetësie dhe falje dënimesh.

**E MARTË
13 PRILL 1965**

Nga Sofja na vijnë lajme se atje është zbuluar një grup i organizuar kundër udhëheqjes revizioniste. Kanë filluar arrestimet dhe flitet se janë futur në burg disa gjeneralë. Ndonjë zëvendësministër dhe sekretar partie ka vrarë veten dhe disa janë arrestuar. Flitet gjithashtu se është arrestuar Raiko Damianovi, bile edhe Anton Jugovi.

Revizionistët i kanë keq punët. Ky është fillimi. Klikat revizioniste s'i do njeri. Këta mbahen me zor prej sovjetikëve.

**E MËRKURË
14 PRILL 1965**

Sot kam ngelur vetëm në zyrë mbasi shokët sekretarë të Komitetit Qendror Hakiu, Rita dhe Ramizi janë me grip, kurse Hysniu ka shkuar në terren.

E ENJTE
15 PRILL 1965

Vazhdon të bjerë shi, ndërsa në Dajt ka rënë borë. Kjo gjendje na dëmton në bujqësi, mbasi pengon punimet dhe mbjelljet.

E SHTUNË
17 PRILL 1965

Disa mendime për një takim tjetër të shokëve tanë me Gripën

Udhëheqja jonë mori dijeni për bisedën tuaj me shokun Pirro Bita dhe ju falënderon për mënyrën e hapët me të cilën ju shprehët mendimin tuaj për disa probleme.

Natyrisht, ne gëzohemi që pikëpamjet e partisë suaj dhe të Partisë sonë janë të njëjta dhe në unitet marksist-leninist për vijën e përgjithshme, gjë që është kryesorja. Çdo gjë tjetër është e dorës së dytë dhe ndreqet në funksion të së parës. Disa gjëra të praktikës korrente, edhe sikur të mos puqen plotësisht, ndreqen me bisedime dhe me sqarime shoqërore në interesin e për-bashkët.

Meqë ju, në bisedën tuaj të hapët, i bëtë disa pyetje shokut Pirro Bita dhe sidomos për sa i përket formës që ju dëshironi t'i parashtroni disa mendime tuajat shokëve kinezë, na lejoni t'ju themi mendimin tonë, duke ju kërkuar që më parë ndjesë, sepse natyrisht ju vendosni vetë.

Ne do të mendonim se nuk do të ishte e nevojshme që çështjet që ju keni, meqë më të shumtat nuk janë çështje parimore, por kanë të bëjnë me veprime praktike ose supozime, t'i bëni me letër, qoftë në emrin tuaj ose të Byrosë Politike. Këto çështje mund t'i bisedoni e t'i zgjidhni shoqërisht edhe me gojë me shokët kinezë, sidomos kur ju keni në plan të shkoni në verë në Pekin. Sipas mendimit tonë, kjo do të jetë rruga më e përshtatshme. Ne mendojmë se me një reflektim më të thellë, më me gjakftohtësi, shumë gjëra dhe supozime mund të eliminohen për interesin e përgjithshëm. . .

Gjithashtu t'i sugjerohet Gripës se interesi i përgjithshëm i lëvizjes komuniste, dhe veçanërisht në Francë, e do që Partia Komuniste e Belgjikës të mos i acarojë punët me grupin e Marsejës dhe me federatën që ata kanë krijuar, pse ne kemi përshtypjen se ata të Marsejës, pavarësisht se mund të kenë edhe gabime, kanë grumbulluar një forcë militante për të cilën ju nuk duhet të jeni të ngurtë dhe të lini tek ata përshtypjen se ndërhyjnë në punët e tyre dhe kërkonin të bëjnë si doni ju. Partia jonë ka një eksperiencë të mirë në çështjen e punës së grupeve para dhe pas formimit të Partisë, për sqarimin dhe inkuadrimin e plotë të anëtarëve të grupeve të ndryshme në vijën e drejtë të Partisë.

Neve, marksistë-leninistëve, na duhet të kemi shumë takt, sidomos aktualisht në Francë, ku rrymat anti-marksiste veprojnë fuqimisht ndaj grupeve të reja marksiste-leniniste. Duhet të kemi parasysh, gjithashtu, se shokët kinezë kanë lidhje të mira me shokët e Marsejës dhe ne mendojmë se kjo është një garanci e madhe që edhe sikur të bëhen gabime nga ky grup, shokët kinezë

do të dinë të influencojnë në ta me takt për të mirë. Natyrisht edhe ne nuk do ta kursejmë ndihmën tonë në këtë rrugë. Këtë e themi pse edhe ndaj nesh shokët e Marsejës paraqiten ca të ftohtë, por me ju më shumë, bile ka një dozë mërie dhe zemërimi nga ana e tyre ndaj jush. Ne përpiqemi dhe do të përpiqemi që ta zhdukim këtë ftohtësi. Ne do të dëshironim që dhe ju të kontribuonit në këtë drejtim. Ju mund t'i gjykoni më mirë format dhe mënyrat e marrjes kontakt me shokët e Marsejës, por ne mendojmë se ju, duke qenë një parti më e vjetër dhe më me eksperiencë, mund të shkoni tek ata. Kjo do të jetë një inkurajim për ta. Interesi i përbashkët e do që të punojmë në një front dhe në rrugën marksiste-leniniste.

U botua komunikata sovjeto-vietnameze. Për vietnamezët nënshkroi Le Zuani. Ky, si duket, kishte shkuar «ilegalisht» në Moskë dhe na doli legalisht me një komunikatë që lustron sovjetikët revizionistë.

Kam frikë se vietnamezët, me këto lëkundje që kanë, do ta pësojnë një mëngjes.

I dhashë dorën e fundit artikullit me titull «Grupi tradhtar i revizionistëve sovjetikë përkrah imperialistët amerikanë në agresionin kundër Vietnamit»¹.

1. Artikulli është botuar në gazetën «Zëri i popullit» më 20 prill 1965. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 371.

E DIEL
18 PRILL 1965

Ne kemi nevojë edhe për kadro të mesëm, edhe për kadro të lartë, kemi nevojë që kadrot tanë të kenë arsim të përgjithshëm, por të kenë edhe arsim profesional¹, kemi nevojë që kadrot të mësojnë në shkolla, por të mësojnë edhe jashtë shkollës. E gjithë kjo gamë e madhe kuadrosh, në rritje të vazhdueshme, në tërë kompleksitetin e vet, duhet të edukohet e të aftësohet në përshtatje me nevojat e vendit. Ky orientim nuk mund të jetë i pandryshueshëm, por duhet rishikuar periodikisht në të gjitha drejtimet. Vetëm arsimi i detyruar 8-vjeçar nuk ka nevojë të rishikohet. Të gjitha të tjerat po.

Politika jonë e drejtë e rritjes dhe e edukimit të kuadrove për t'i shërbyer zhvillimit dhe dinamizmit të jetës së vendit, nuk mund ta durojë spontaneitetin ose zgjidhjet me anë formulash stereotipe.

Në çdo periudhë të caktuar duhet të bëhet një

1. Këto shënime janë mbajtur nga autori në kuadrin e diskutimeve që janë zhvilluar gjatë asaj kohe për probleme të shkollës.

analizë shkencore e gjendjes, duke pasur kurdoherë parasysh «lëndën e parë», si me thënë, njerëzit që kemi edukuar dhe ata që na vijnë për të edukuar. Pasi ta kemi mirë të qartë gjendjen e kontingjenteve, duhet të dimë mirë e saktë nevojën e çdo sektori të jetës për kadro të ndryshëm, të çdo kategorie, të dimë dhe të caktojmë drejt përpjesëtimet nga një periudhë në një periudhë tjetër, pa harruar asgjë, pa neglizhuar asgjë.

Në bazë të këtyre të dhënave ne do të ndërtojmë drejt edhe kërkesat tona për sa i përket numrit të shkollave, llojit të tyre, do të caktojmë, përmirësojmë, plotësojmë, thjeshtojmë apo forcojmë programet në këtë ose në atë lëndë.

Kjo do të bëhet në bazë të kontingjenteve dhe do t'u jepet prioriteti atyre sektorëve, të cilët për nga zhvillimi janë më të rëndësishëm, duke pasur parasysh nevojat dhe për arsye të mungesës së kuadrit.

Zhvillimi në rrugë të drejtë i arsimit dhe i kulturës ka ngjallur dëshirën e zjarrtë të njerëzit tanë që ata të mbarojnë shkollat e mesme dhe universitetin. Kjo është një gjë shumë e mirë. Vendi ynë ka pasur, ka dhe do të ketë nevojë shumë kohë për një gjë të tillë. Por ne do të gabojmë në rast se nuk e rishikojmë këtë orientim, pse me zhvillimin e vendit kemi nevojë edhe për kadro të lartë, por kemi nevoja shumë të mëdha për kadro të mesëm dhe me arsim profesional. S'ka dyshim se një ushtri e madhe ka nevojë për gjeneralë, por gjeneralë pa ushtarë nuk ka. Po ashtu edhe inxhinierë pa mekanikë, tornitorë, makinistë, gjeometra etj. nuk mund të ketë. Që këto proporcione të ecin të harmonizuara, natyrisht, përveç shumë masave të tjera organizative,

materiale, duhet që edhe frymëzimi dhe propaganda për arsim e kulturë të bëhen në rrugë të drejtë, të jenë të dozuar e të harmonizuar.

Ashtu siç është vepruar drejt për t'i bërë të ndër-gjegjshëm njerëzit për domosdoshmërinë e arsimit 8-vjeçar, duhet jo vetëm të futim në shpirtin dhe në mendjen e rinisë dëshirën për të ndjekur shkollën e mesme dhe universitetin, por dhe ta organizojmë shkollën në mënyrë të atillë, që një pjesë e madhe e saj të hidhet në zanate, në teknikë, në politeknikë. Zbatimi i këtij orientimi të drejtë, natyrisht, kërkon një organizim të gjerë shkollash, kursesh, ku të rinjtë e të rejat do të fitojnë një kulturë të mirë që u hap dyert e jetës. Ata duhet ta kuptojnë se pa punën e tyre nuk ndërtohet socializmi, dhe se dyert e shkollave për zhvillimin e mëtejshëm të tyre janë kurdoherë të hapura. Ka rëndësi të madhe ideologjike që të rinjtë e të rejat kurrë të mos priren nga karrierizmi, por nga patriotizmi dhe nga nevoja për perfeksionimin në zanatin e tyre, që sjell rritjen e rendimentit në punë dhe si pasojë ngritjen e mirëqenies së përgjithshme e personale.

Kërkesat që kemi për kuadro të mesëm të specializuar duhet, pra, t'i rishikojmë në mënyrë revolucionare. Drejtuesit e çdo sektori të gjykojnë drejt për këtë çështje, të jenë të ndërgjegjshëm se në mënyrë revolucionare duhet të shikojnë edhe edukimin, edhe shtimin, edhe dhënien e besimit dhe të përgjegjësisë kuadrit të ri. Natyrisht duhen krijuar edhe kushtet për këtë, duhen siguruar fonde, organika etj., ndryshe këto mbeten vetëm fjalë dhe dëshira të mira, por pa fryt.

Sot, bashkë me Nexhmijen erdhëm për një shëtitje në plazhin e Durrësit. Në shtëpinë tonë të pushimit po bëjnë riparime. Çdo vit i njëjti avaz. Thonë që duan të evitojnë lagështirën nga uji që del në bodrum, ku është kuzhina e ambientet e shërbimeve.

E HËNË
19 PRILL 1965

Vazhdon të bjerë shi dhe të ftohtit po ashpërsohet. Temperatura është ulur. Në Korçë ka rënë borë.

E MARTË
20 PRILL 1965

Vizitova shokët Haki dhe Rita. Janë më mirë. Po ashtu më mirë është edhe Ramizi, i cili ka filluar të dalë, por akoma jo në zyrë.

Gazeta «Zëri i popullit» boton sot artikullin me titull: «Grupi tradhtar i revizionistëve sovjetikë përkrah imperialistët amerikanë në agresionin kundër Vietnamit»¹.

1. Shih në këtë vëllim, f. 223.

E MËRKURË
21 PRILL 1965

Vazhdon të bjerë një shi monoton, i mërzitshëm e i dëmshëm.

E ENJTE
22 PRILL 1965

Thirra Abdyl Këllezin¹, të cilin e kritikova ashpër dhe i dhashë urdhër të marrë masa imediate për përmirësimin e shitjes së bukës në popull. Ekziston një burokratizëm i madh për këtë çështje; synohet që çdo gjë të jetë e rehatshme për fabrikën dhe për shitësin, pa se nuk i shërbehet me kohë dhe mirë popullit, burokratët s'e bëjnë qejfin qeder.

Duhet t'u thyejmë brinjët burokratizmit dhe burokratëve!

Sot në mëngjes në Dajt ra borë, ndërsa në Tiranë vazhdon të bjerë shi.

Disa gjeneralë sovjetikë kanë filluar të flasin nga një çikë për Stalinin me rastin e Ditës së Fitores mbi Fashizmin, të thonë se Stalini s'i ka pasë të gjitha të gabuara, se nuk është e vërtetë që Stalini nuk dëgjonte

1. Në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave.

këshillat e bashkëpunëtorëve të tij, se, në rast se janë bërë gabime, nuk është vetëm Stalini përgjegjës etj., etj. Të gjitha këto i bëjnë me zë të ulët dhe kanë vetëm një qëllim: të gënjejnë, të ulin zemërimin që po shtohet, por nga kjo një ditë do ta pësojnë keq revizionistët tradhtarë. Ne do të shfrytëzojmë çdo rast që kjo çështje të shkojë më tej, domethënë deri në rehabilitimin e plotë të Stalinit, gjë që do të thotë vdekje për revizionistët hrushovianë.

E PREMTE
23 PRILL 1965

Sot u nisën për në Kinë, nga Italia, shoku Spiro Koleka dhe anëtarët e tjerë të delegacionit qeveritar për çështjet ekonomike.

U nis gjithashtu për në Kinë, për të marrë pjesë në festimet e 1 Majit dhe më vonë në 45-vjetorin e Partisë Komuniste të Indonezisë, shoku Gogo Nushi.

Nga sa kam lexuar e parë këto kohët e fundit rreth mendimeve dhe qëndrimit të Gripës si për sa i përket forcimit të Partisë Komuniste të Belgjikës, qëndrimit ndaj grupeve e partive të tjera marksiste-leniniste e vetë lëvizjes marksiste-leniniste në përgjithësi, kam arritur në mendimin se atij i është rritur ca mendja dhe kjo e bën të gabojë. Në qoftë se ai nuk i ndreq këto pikëpamje, mund të prishë punë.

Gripa ka pretendimin të «marrë përsipër» organizimin dhe drejtimin e gjithë lëvizjes marksiste-leniniste. Natyrisht kjo nuk mund të mos shkaktojë konflikte,

zemërime dhe mosmarrëveshje në mes tij e grupeve të ndryshme.

Kjo nuk mund të mos sjellë keqkuptime gjithashtu edhe me ne dhe parti të tjera marksiste-leniniste, keqkuptime këto që Gripa na i shfaqti në bisedën që pati me shokun Pirro Bita në Romë. Dhe pikërisht këto gjëra jo të mira vijnë, pse Gripa i ka vetëngarkuar vetes të drejtën që të drejtojë dhe të përpiqet të bëhet epiqendra e lëvizjes marksiste-leniniste në botë, derisa ndërhyen edhe në format më të thjeshta organizative të grupeve të ndryshme.

Qoftë Partia Komuniste e Kinës, qoftë Partia jonë, jemi, luftojmë e ndihmojmë me të gjitha forcat që në vendet kapitaliste, dhe në ato të Evropës Perëndimore veçanërisht, lëvizja revolucionare marksiste-leniniste antirevizioniste të ngrihet, të rritet e të forcohet deri në krijimin e partive të reja. Natyrisht, kjo nuk varet vetëm nga dëshira dhe nga ndihma jonë, por varet, në rradhë të parë, nga marksistë-leninistët e vërtetë të çdo vendi. Ndihma jonë është e dorës së dytë. Këtë Gripa nuk e kupton sa duhet drejt, ose tregohet entuziast dhe i rrëmbyer më shumë sesa duhet.

Kur themi se lëvizja revolucionare marksiste-leniniste varet nga marksistë-leninistët e vërtetë të çdo vendi, duhet të kuptojmë mirë situatën e atij vendi dhe të marksistëve që dalin nga kjo krizë e madhe që shkaktoi revizionizmi modern në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Këta marksistë antirevizionistë, dhe sidomos të vendeve kapitaliste, nuk mendojnë të gjithë njësoj për problemet e politikës, të ideologjisë, të organizimit, të luftës. Këtë Gripa nuk e kupton sa duhet

ose e kupton, por shpejtohet në vendime dhe kjo do të shkaktojë vendime të njëanshme dhe të papjekura. Pse?

Mënyrat e mendimit dhe të veprimit, metodat e punës së partisë dhe të luftës së këtyre shokëve, janë akoma të ngjashme me ato të partive ku ata kanë bërë pjesë, ku janë edukuar, ku kanë milituar ose ku janë influencuar, prandaj ne duhet të kuptojmë mirë se është e zorshme për ta që të shkunden menjëherë prej tyre. Këtë gjë do ta bëjë lufta e tyre e drejtë revolucionare, ku edhe do të provohen këta shokë. Këtë provë të domosdoshme Gripa në teori e kupton, por në praktikë jo, dhe bën gabime në vlerësimet e qëndrimit të njërit apo tjetrit grup, të njërit apo tjetrit person.

Këta shokë marksistë-leninistë të grupeve të ndryshme dhe të vendeve të ndryshme paraqiten antirevizionistë, revolucionarë, në përgjithësi duan të luftojnë dhe luftojnë kush më mirë, kush më keq, por gjatë këtyre përpjekjeve dialektike për formim, për afirmim, ka dhe kundërshtime midis grupeve, ka grindje, ka mëri, ka mosmarrëveshje të bazuara e të pabazuara, me *parti pris* e pa *parti pris*, me baza ideologjike ose jo, me baza shpifjesh ose jo, me megalomani dhe mbeturina të theksuara mikroborgjeze ose jo, me punë provokuese ose jo, me infiltrimet revizioniste dhe agjenturore kapitaliste ose jo. Në një gjendje të tillë grupesh të shumta, të paafirmuara, të paregjura, të arrish, siç bën Gripa, që të thuash se ky grup është i mirë, ky grup është provokator, ky njeri është i mirë, ky është i keq, te ky grup duhet të mbështetemi dhe te ky jo, këtë grup ta njohim dhe këtë tjetrin jo, kjo është një aventurë e papjekur, e shpejtuar, joserioze.

Lufta e grupeve si aspekt i luftës së madhe për problemet bazë të marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen e vijës së përgjithshme, duke u mbështetur në luftën e masave dhe duke pasur për objektiv krijimin e partisë marksiste-leniniste, jo vetëm që është e paevitueshme në këto situata në vendet kapitaliste, por është dhe e domosdoshme, pse vetëm kështu sqarohen situatat, pozitat e grupeve dhe të personave ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj revizionizmit, ndaj kapitalizmit. Natyrisht, lufta e grupeve, në rast se kthehet në një luftë shkatërrimtare dhe të paprincipitë në mes tyre, duke harruar armikun dhe qëllimet e mëdha, atëherë kjo s'ka më karakterin që theksova, por degjeneron në një punë armiqësore, antimarksiste.

Të ndërhysh që ta zbutësh këtë situatë nga jash-të është gabim; të kërkosh të influencosh arbitrarisht që një grup të pranojë pikëpamjet e një grupi tjetër, edhe kjo është e gabuar dhe pa asnjë rezultat të mirë; të mendosh se duhet të ndalohen grindjet, duke përdorur autoritetin, kjo nuk ecën dhe nuk sjell asgjë të mirë. Këto mosmarrëveshje dhe polemika, dashkemi ose nuk dashkemi ne, do të vazhdojnë për shumë kohë. Por, gjatë kësaj kohe lufte dhe përpjekjesh, do të afirmohen më të mirët, më të guximshmit, më revolucionarët. Disa, që tash paraqiten të mirë, do të thyhen, disa të tjerë do të kaliten, të tjerë të panjohur do të dalin dhe do të forcojnë radhët e të mirëve. Ky është një proces dialektik, revolucionar, që ne, edhe po të duam, nuk e ndalojmë dot dhe, po të përpiqemi ta ndalojmë, gabojmë, po edhe po të mos e ndihmojmë drejt, atëherë nuk veprojmë si marksistë. Gripa në këtë çështje gjith-

ashtu gabon dhe mund të prishë punë, në qoftë se nuk ndreqet.

Gripa del në konkluzione të gabuara:

Sikur ai e njeh mirë situatën në të gjitha këto grupe dhe është në gjendje dhe përpiqet të na diktojë se ky grup është i mirë, ky jo, ky njeri është i mirë, ky jo. Ai vete deri atje sa merr guximin absurd t'i diktojë Partisë Komuniste të Kinës se këtij ose atij grupi duhet t'i jepet kjo ose ajo ndihmë financiare. Me një fjalë, Gripa i ka vënë vetes jo vetëm rolin e drejtuesit «të pagabueshëm ideologjik», por edhe rolin e «ministrit të financave të lëvizjes komuniste ndërkombëtare», natyrisht me të hollat e të tjerëve. Kjo është absurde dhe mendjemadhësi e patolerueshme.

Ne duhet t'i ndihmojmë grupet revolucionare dhe elementët revolucionarë me sugjerimet tona, kur të na i kërkojnë, por duke i këshilluar njëkohësisht që të mendojnë dhe të vendosin vetë. Ne duhet t'i ndihmojmë ata, por pa nxjerrë asnjë detyrim për ta nga kjo ndihmë. Çdo ndihmë, e çfarëdo natyre qoftë kjo, duhet të shtohet dhe të forcohet për ato grupe ose për ato parti që ecin në rrugë të drejtë, që afirmohen, që luftojnë. Çdo lëvizje, çdo grup revolucionar, çdo parti marksiste-leniniste e re duhet të krijojë personalitetin e vet me luftë të drejtë, me bazat e shëndosha në masat, me vijën e vet të drejtë marksiste-leniniste.

Gripa, sipas mendimit tim, është një shok tepër ekspansiv dhe tregohet «kompetent» për lëvizjet e mëdha politiko-ekonomike, ideologjike, ushtarake të botës perëndimore, karakteristikë kjo e një pjese të komunistëve të vendeve kapitaliste. Që të kesh njohuri të gjera

është mirë, por kjo nuk duhet të të largojë nga puna dhe nga organizimi i luftës konkrete, i edukimit konkret të partisë, i forcimit të saj nga ana organizative, përkundrazi.

Çështja e grupeve është një çështje serioze. Për mënyrën se si vepron Gripa, për shpejtësinë dhe ndërhyrjen e tij në punët e tyre, derisa arrin të krijojë acarime me to, i duhen bërë vërejtje shoqërore.

Unë besoj se, kur të kem rastin të piqem me të dhe t'ia shtroj këto vërejtje shoqërisht, ai do të më kuptojë dhe do të bjerë dakord, pse qëllimi ynë është i njëjtë, të ndihmojmë shokët revolucionarë në rrugën e drejtë dhe me metoda të drejta marksiste-leniniste.

Për mendimin tim, Gripa është në gabim dhe ky gabim bëhet akoma më i madh dhe i rrezikshëm, në rast se me këto pikëpamje jo të drejta ai frymëzon edhe ato grupe tek të cilat ka vetë besim. Ky është një influencim i dëmshëm, me konsekuenca të këqija. Prandaj Gripa medoemos duhet të rishikojë qëndrimet e tij.

Nga biseda që bëri me shokun Pirro kam përshtypjen se Gripa ose i shtrembëron pikëpamjet e shokëve kinezë, ose i interpreton sipas «qejit» të tij, domethënë i gjykon me gjaknxehtësi dhe sipas disa konkluzioneve që vetë ka arritur më parë, konkluzione që i pëlqejnë, që i quan «të drejta dhe të pagabueshme».

Gripa jo vetëm duhet të ndreqë këto mendime, por duhet të jetë shumë më i matur në këto çështje, sidomos t'i kushtojë shumë rëndësi punës në Partinë Komuniste të Belgjikës, e cila është akoma e re, e pafornuar mirë, e pakalitur si duhet. Kjo nuk do të thotë

se Partia Komuniste e Belgjikës nuk duhet të ndihmojë grupet revolucionare. Jo, por t'i ndihmojë ato në rrugën që duhet dhe t'i frymëzojë drejt, pse këto grupe, nga nevojat që kanë, të trokasin në derë. Por unë mendoj se, tok me këtë ndihmë, ndihma më e madhe që mund t'u japë Partia Komuniste e Belgjikës këtyre është shembulli i qëndrimit të saj, i luftës së saj, i forcimit të organizimit, i lidhjeve me masat, i zgjerimit dhe i edukimit marksist-leninist të kuadrit të Partisë Komuniste të Belgjikës dhe i futjes së saj në aksione konkrete. Kjo është ndihma kryesore më e madhe, të tjerat pa këto janë «fjalë të mëdha».

Nga bisedimet me shokun Pirro, unë nxjerr edhe konkluzionin se te Gripa ka një «sensibilitet» të sëmurë prej mikroborgjezi intelektual. Mendime dhe vërejtje të drejta që shokët kinezë i kanë thënë për grupet e ndryshme dhe për njerëzit, ai i ka marrë sikur këta shokë ia bëjnë indirekt atij dhe këndej del me supozime pa baza. Por edhe në disa raste, në qoftë se mund të arrihet në një konkluzion ku arrin Gripa, kjo duhet ta bëjë atë të reflektojë dhe ta shikojë punën më thellë. Për shembull, Gripa arrin në konkluzionin ose në supozimin që meqë kinezët thanë këtë ose atë për filan grup, atëherë «mos vallë shokët kinezë nuk janë të kënaqur me rezultatet e punës së Partisë Komuniste të Belgjikës?».

Unë mendoj se shokët kinezë s'kanë pse arrijnë në këtë konkluzion, qoftë edhe sikur të jenë ose të mos jenë të kënaqur nga puna e Partisë Komuniste të Belgjikës. Por mendime ata mund të kenë, siç kemi edhe ne. Gripa duhet ta gjykojë vetë punën e tij dhe të marrë

masa për forcimin e punës. Partia Komuniste e Belgjikës ka rezultate, por ajo ka akoma shumë për të bërë. Këtë e njih edhe Gropa vetë. Atëherë pse duhet të dalë me supozime se shokët kinezë mos e kanë këtu ose atje hallin?

Ne mendojmë se kur duhen kritikuar shokët kinezë, kjo duhet bërë, por në këtë çështje ata e kanë drejt dhe gabime të dorës së dytë mund të bëjnë jo vetëm ata, por mund të bëjmë edhe ne.

E DIEL
25 PRILL 1965

Vietnamezët e Veriut na kërkuar zyrtarisht ndihma në dok për ushtrinë e tyre dhe bitum. Ne do t'ua japim menjëherë, aq sa kërkojnë, bile do të përgatitim edhe më shumë.

Është detyra jonë internacionaliste të heqim nga vetja dhe t'u japim ndihma shokëve që luftojnë.

E HËNE
26 PRILL 1965

Koha filloi të kthejë, por prapë po na i pengon shumë mbjelljet, sidomos të panxharit, të pambukut dhe të duhanit. Ka shumë baltë dhe traktorët akoma nuk mund të futen në fusha.

«Ndhimat» e bujshme revizioniste për Vietnamin kanë një qëllim të mbrapshtë, të rrezikshëm e të dëmshëm për luftën heroike të popullit të Vietnamit të Jugut dhe për rezistencën e popullit të Vietnamit të Veriut.

Fushatën për këtë lloj «ndihme» e udhëheqin revizionistët sovjetikë dhe e shoqërojnë edhe revizionistët e tjerë.

Me sloganin e tyre të fundit për «dërgimin e vullnetarëve», tradhtarët hrushovianë ndjekin disa qëllime: brenda dhe jashtë vendit të tyre të japin përshtypjen se revizionistët janë «solidarë» me luftën antiimperialiste të popullit vietnamez; se janë «aq vendosmërisht» kundër imperializmit amerikan, sa «nuk kanë frikë» nga komplikacionet dhe nga lufta; se janë gati të «saktifikojnë» edhe gjakun dhe jetën e njerëzve të tyre, mjafton

që «kauza» e vietnamezëve të fitojë etj. E gjithë kjo zhurmë propagandistike bëhet vetëm e vetëm që hrushovianët të gënjejnë dhe të fshehin realitetin — faktin që ata janë kundër luftërave çlirimtare dhe në aleancë të fshehtë me imperializmin amerikan.

Por revizionistët sovjetikë dhe të tjerë nuk janë vetëm me fjalë për dërgimin e «vullnetarëve në Republikën Demokratike të Vietnamit». Në këtë çështje objektivi i tyre është tepër djallëzor e tepër i rrezikshëm. Ata duan të dërgojnë njerëz në Vietnam, bile po t'i lejojnë, sa më shumë aq më mirë, jo se iu dogj barku për të përkrahur luftën e popullit vietnamez, por për ta mbytur këtë luftë nga brenda. Revizionistët sovjetikë, nëpërmjet «vullnetarëve» duan të futin agjenturën e tyre të armatosur, politike dhe ideologjike, brenda në Vietnam dhe të marrin supremacinë legale, të thyejnë vullnetin e Partisë së Punonjësve të Vietnamit, dhe të hyjnë në pazarllëqe e në bisedime me amerikanët. Ky është qëllimi, kjo është gracka; shokë vietnamezë, ruhuni nga «kali i Trojës»!

Në qoftë se qeveria e Republikës Demokratike të Vietnamit bie në këtë grackë dhe fut «vullnetarët», revizionistë sovjetikë e të tjerë, në tokën e vet, ajo bën një gabim fatal e të pandreqshëm.

Në qoftë se vietnamezët lejojnë «vullnetarët» sovjetikë, atëherë porta hapet edhe për «legjionet» e revizionistëve të tjerë. Si pasojë, Vietnamit kthehet vetvetiu në një fushë veprimtarie legale agjenturash revizioniste në interes të amerikanëve, në interes të imperializmit. Këtyre u leverdis shumë që të hyjë kjo kolonë e pestë në Vietnam, qoftë edhe me raketa «tokë-ajër». Agjen-

tura revizioniste i sjell më shumë dobi strategjisë së amerikanëve sesa e dëmton me raketat në duart e «vullnetarëve» sovjetikë dhe të «miqve» të tyre vietnamezë.

Prandaj, unë mendoj se shokët vietnamezë do të bëjnë gabim të rëndë në rast se lejojnë të futen «vullnetarë» revizionistë nën çdo formë.

Kjo për «vullnetarët».

Po «ndihmat materiale» të revizionistëve sovjetikë dhe të revizionistëve të tjerë a duhet t'i kërkojnë dhe t'i pranojnë vietnamezët?

Unë mendoj se edhe këto nuk duhet të pranohen pa kondita dhe nuk duhet që këto ndihma të shërbejnë si shkallë që revizionistët të futin hundët brenda dhe t'i përdorin për demagogji, për të mbuluar politikën e tyre me dy faqe e armiqësore.

Ndihmat e revizionistëve sovjetikë të çdo natyre qofshin, janë të rrezikshme dhe me qëllime sabotimi, janë zinxhirë të rinj skllavërimi për popullin vietnamez.

Para së gjithash unë mendoj se vietnamezët jo vetëm nuk duhet t'i reklamojnë këto ndihma pa i marrë akoma, siç bënë me komunikatën që lëshuan, por edhe kur t'i marrin, reklama duhet të mos ekzistojë, pse «ndihmat» janë insinjifiante¹ përpara sakrificave që bëjnë vetë vietnamezët në luftën kundër amerikanëve.

Fundi i fundit, vietnamezët edhe mund t'i pranojnë këto ndihma, por duhet të kuptojnë se ato, materialisht, nuk u kushtojnë asgjë sovjetikëve, ndërsa mora-

1. Nga frëngjishtja — të papërfillshme.

lisht dhe politikisht u sjellin shumë fitime. Vietnamezët, para së gjithash, duhet t'u kërkojnë sovjetikëve që e vetmja ndihmë e tyre të jetë **bllokimi total, i hapët dhe i gjithanshëm i imperializmit amerikan**, pra Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera gjoja socialiste t'i sulmojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në të gjitha fushat.

Këtë sovjetikët nuk do ta bëjnë.

Ç'kuptim ka, për shembull, «fushata» e revizionistëve italianë «për të mbledhur ndihma» që të blejnë një spital për Vietnamin?! E tëra kjo është demagogji. Këtë punë po bëjnë e do të bëjnë edhe revizionistët e tjerë. Dhe për këto «ndihma bujare e internacionaliste» Republika Demokratike e Vietnamit do të lëshojë certifikata, do të botojë artikuj lavdërimi dhe solidariteti për tradhtarët e marksizëm-leninizmit e të popujve. Këta, nga ana e tyre, do t'i përdorin këto certifikata e këta artikuj vietnamezë si kapitale politike për të gënjyer komunistët, opinionin e tyre dhe atë ndërkombëtar. Po si mund të lejohet të spekulojnë e të zbukurohen tradhtarët me luftën heroike të popullit të Vietnamit, me sakrificat e tij të mëdha? Jo, kjo është tragjike, nuk duhet lejuar, shokë vietnamezë!

Ju nuk jeni keq për një spital fushor, që do t'ju dërgojnë revizionistët italianë. Pse nuk ju ndihmoi me kohë Hrushovi që sot të ishit të armatosur? Tash a e keni filluar ju luftën? Tash a e kanë filluar luftën vëllezërit tuaj në Jug? Kush ju ka ndihmuar deri tani me armë? Prandaj mos bini në grackën revizioniste!

Për sa u përket «ndihmave» të partive «komuniste» ku sundojnë revizionistët (e kam fjalën për vendet e ashtuquajtura socialiste), këto janë krejt formale. Këta

revizionistë edhe ato ndihma të pakta materiale që po japin ose që premtojnë, i japin vetëm nga halli, për të genë brenda, pse ata jo vetëm që nuk kanë asnjë bindje në fitoren e popullit vietnamez, por nuk kanë as qejfin dhe as qëllimin më të vogël për të ndihmuar luftën e këtij populli. Ata, bile, kanë frikë të madhe dhe ruhen se mos «ndihmat» e tyre për Vietnamin i marrin vesh amerikanët e të tjerë dhe u prishin punë në pazarllëqet që ata kanë bërë dhe po bëjnë me ta, në lidhje me kreditë që marrin nga imperialistët, në bazë të marrëveshjeve politike që kanë përfunduar. Kjo është aq e vërtetë, sa që «komunistët» e vendeve «socialiste» pengojnë me forcë edhe më të vogël demonstratë solidariteti të punonjësve të vendeve të tyre me luftën e popullit vietnamez. Po si mund të pranohet që, nga njëra anë, ta quash vendin tënd «socialist» dhe partinë tënde «marksiste», e, nga ana tjetër, të mos çosh peshë popullin politikisht kundër agresorëve imperialistë që sulmojnë, vrasin e djegin një popull vëlla të një vendi socialist?!

Ç'vlera ka «ndihma» materiale e atyre partive që quhen «marksiste», siç janë partitë revizioniste të vendeve kapitaliste, kur këto parti nuk shpërthejnë në një fushatë politike, të shoqëruar me greva dhe demonstrata të fuqishme dhe të vazhdueshme, për t'i shtrënguar qeveritë e tyre borgjeze të detyrojnë imperialistët amerikanë të ndalojnë agresionin në Vietnam! Qeveria e Moros është e gatshme të financojë, dhe mundet që i financon tërthorazi Longot dhe Pajetat për t'u dërguar vietnamezëve ndonjë spital fushor e disa ilaçe, por ama... si shpërblim, revizionistët italianë duhet të rrinë urtë e të mos i nxjerrin qeverisë borgjeze kokëçarjel!

Dhe në fakt, borgjezisë kapitaliste prej revizionistëve nuk i krijohet asnjë kokëçarje, jo vetëm në politikën e brendshme, por as në të jashtmen. Qeveria laburiste, qeveria e Moros, qeveria e Spakut etj. mbrojnë hapur dhe tregohen solidare me agresorët amerikanë në Vietnam, pa gjetur asnjë kundërshtim serioz, asnjë telash e presion nga ana e revizionistëve.

Por pikërisht kundërshtimin e plotë të politikës imperialiste duhet t'u kërkojnë vietnamezët këtyre pseudomarksistëve dhe jo ilaçe me llafe.

E MARTË
27 PRILL 1965

Shënime për një bisedë me shokët e Partisë Komuniste të Kinës¹

Mendoj t'u themi:

Ka ardhur te ne shoku Valera, i cili është zgjedhur në udhëheqjen kryesore të Partisë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste), që u formua këta muajt e fundit. Ai, në bisedim me ne, shfaqti dëshirën dhe na u lut t'i organizonim një takim me ju, pse, siç tha ai, dëshiron t'ju parashtrojë problemet e tyre. Prandaj unë e kërkova këtë takim me ju për t'ju komunikuar kërkesën e shokut Valera.

Te ne, me rastin e festës së 1 Majit, kanë ardhur mjaft delegacione të grupeve të ndryshme marksiste-leniniste. Disa i kemi ftuar ne, disa kanë kërkuar vetë të vijnë. Me të gjitha këto grupe ne kemi marrëdhënie të mira dhe, me sa mundemi, përpiqemi t'i ndihmojmë. Ne ju kemi vënë herë pas here në korent për gjendjen

1. Në këto shënime u mbështet shoku Hysni Kapo për bisedën e tij me ambasadorin kinez në Tiranë më 29 prill 1965.

e tyre dhe, kur këta të largohen nga vendi ynë pas festës, do të takohemi e të bisedojmë përsëri.

Ne mendojmë se bashkëpunimi dhe ndihma e Partisë Komuniste të Kinës dhe e Partisë sonë me këto grupe marksiste-leniniste është në një vijë të vetme dhe udhëhiqet nga të njëjtat parime dhe nga të njëjtat taktika të drejta. Siç e dini, qëllimi i partive tona është zgjerimi i lëvizjes revolucionare marksiste-leniniste në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern në vendet e ndryshme të Evropës Perëndimore, të Amerikës Latine, të Australisë dhe gjetkë. Ky është një qëllim i madh i partive tona. Vija e drejtë marksiste-leniniste dhe ndihma morale, politike dhe ideologjike është ajo ndihmë që ne u japim forcave marksiste-leniniste në botë.

Kjo lëvizje tash është zgjeruar. Janë krijuar dhe afirmuar disa parti të reja marksiste-leniniste, siç janë ajo e Belgjikës, e Australisë, e Brazilit etj. Në shumë vende janë krijuar grupe marksiste-leniniste dhe në partitë e vjetra me udhëheqje revizioniste baza e këtyre partive lëkundet dhe bën njëfarë rezistence, e cila sigurisht me kohë do të shtohet. Këtë ne e konsiderojmë një shenjë të mirë, një proces dialektik revolucionar që do të zhvillohet, do të rritet dhe do të transformohet nga sasia në cilësi.

Partitë tona do të ndihmojnë vazhdimisht që ky proces revolucionar të zhvillohet në rrugë të drejtë, por ne mendojmë se kjo nuk varet vetëm nga dy partitë tona. Shumë faktorë do të lozin një rol vendimtar dhe posaçërisht faktori revolucionar brendapërbrenda çdo

vendi ku veprojnë këto parti të reja dhe këto grupe revolucionare marksiste-leniniste.

T'i shpejtojnë partitë tona këto procese, siç mendojnë disa shokë në vendet perëndimore, është gabim, kjo s'është marksiste-leniniste; të ndërhyjnë partitë tona me autoritetin e tyre në punët e brendshme të këtyre partive të reja dhe grupeve marksiste-leniniste, siç kërkojnë disa shokë nga vendet perëndimore, as kjo nuk mund të bëhet, se s'është e drejtë dhe as marksiste-leniniste; të përkrahet më shumë ose më pak njëri ose tjetri grup, të quhet njëri grup parti dhe të tjerët të shtyhen tej, duke u bazuar në një njohje të përciptë ose në mendime të njëanshme, të diktuara disa herë nga simpati për një grup ose për një tjetër, me një fjalë partitë tona të angazhohen në luftën dhe në mosmarrëveshjet që kanë midis tyre grupet e ndryshme në një vend ose në një tjetër, siç pretendojnë disa shokë në vendet perëndimore, ky do të ishte një gabim i palejueshëm dhe i rëndë që partitë tona nuk e kanë bërë dhe nuk do ta bëjnë, pse si Partia Komuniste e Kinës, edhe Partia jonë kanë një eksperiencë të madhe nga puna e grupeve dhe lufta e tyre.

Shumë grupe marksiste-leniniste janë krijuar dhe do të krijohen në të ardhmen. Këto, në përgjithësi, paraqiten me orientim kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit modern, paraqiten solidare me Partinë Komuniste të Kinës dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë. Në këtë rast ne i kemi ndihmuar dhe do t'i ndihmojmë të gjitha me vijën tonë dhe me ndonjë mendim, kur të na e kërkojnë vetë.

Ne mendojmë se puna revolucionare e vërtetë du-

het të bëhet me djersën, me gjakun dhe me sakrificat e vetë militantëve të çdo partie apo grupi marksist-leninist. Vetëm kësaj i thonë punë revolucionare. Në këtë rrugë kanë ecur të dyja partitë tona, asnjëri s'i ka ndihmuar ato, ne kemi vuajtur, kemi sakrifikuar, kemi luftuar dhe kemi fituar në kushte tepër të rënda.

Disa shokë në vendet perëndimore, ndoshta jo me qëllim të keq, por të entuziazmuar, disa herë edhe me ndërhyrje shumë të gabuara, përcipen të shpejtojnë në mënyrë artificiale procesin e formimit të partive, bile edhe të bashkimit të grupeve marksiste-leniniste.

Bashkimi i grupeve dhe formimi i partive të reja marksiste-leniniste është qëllimi ynë i madh dhe ne ndihmojmë dhe do të ndihmojmë, por pa ndërhyrë në punët e tyre dhe sidomos në asnjë mënyrë duke u diktuuar atyre bashkimin ose formimin e partive të reja. Ky proces duhet të përgatitet nga vetë militantët komunistë të çdo grupi në çdo vend, sipas situatave objektive të lëvizjes revolucionare në këtë ose në atë vend dhe në bazë të tyre dhe jo pse na e do zemra. Çdo formë tjetër, jashtë këtij procesi revolucionar dialektik, marksist-leninist, do të jetë formale, pa baza, jo me jetë të gjatë. Në këtë rast, atë proces të domosdoshëm, që duhet të bëhet para bashkimit dhe formimit të partisë, ne në mënyrë artificiale e pengojmë dhe e transportojmë të bëhet dhe do të bëhet brenda në partinë e re të krijuar, ku mund të ngjasin dhe do të ngjasin edhe grindje, fraksione e përçarje. Prandaj, të shpejtohet procesi i formimit të partive të reja jo në rrugë të drejtë, siç mund të mendojnë disa shokë në Perëndim, kjo nuk është e drejtë, për mendimin tonë.

Ne po ndihmojmë dhe do të ndihmojmë që grupet e ndryshme të arrijnë në një unitet mendimi dhe veprimi marksist-leninist, por nuk duhet të kemi frikë dhe të alarmohemi pse ata diskutojnë, grinden, disa herë parimisht, disa herë mbi baza joparimore. Ky është ai proces që bëjnë fjalë më lart dhe që është i pashmangshëm. Lufta e tyre revolucionare do t'i sheshojë këto kontradikta. Ne nuk mund të mos kemi parasysh prejardhjen e shokëve të grupeve të ndryshme nga origjina, nga partitë prej të cilave kanë trashëguar mënyrën e mendimit, të diskutimit, të organizimit, të principeve sidomos. Ne nuk mund të mos kemi gjithashtu parasysh ambientin ku rrojnë, ku mendojnë dhe ku luftojnë; nuk mund të mos kemi parasysh luftën e hapët dhe të fshehtë që u bëjnë atyre borgjezia dhe revizionistët modernë me propagandën kolosale dhe me aparatet e tyre shtypëse. Duke i pasur kurdoherë parasysh këto situata, një proces i tillë jo vetëm që s'duhet të na alarmojë, por, edhe po të duam ta ndalojmë (dhe do të bënim gabim), ne nuk mund ta ndalojmë. Askush nuk mund ta ndalojë këtë proces.

Partitë tona e kanë për detyrë që me mendime, me qëndrime të matura, prudente e të panxituara të ndihmojnë që ky proces të ecë në rrugën e drejtë. Çështja, mendojmë ne, nuk vihet, siç e vënë disa shokë në vendet perëndimore, se «revolucioni dhe krizat» këto vende duhet t'i gjejnë me parti të formuara. Ne mendojmë se duhet të formohen parti të vërteta revolucionare, jo parti formale. Që procesi të realizohet, duhet të ndjekë rrugën revolucionare. Këtë e vërteton shembulli i Partisë sonë, që u formua në momentin e krizës më të madhe

të pushtimit fashist të vendit, dhe ajo e tregoi veten e saj të denjë për kauzën e madhe të popullit tonë, për kauzën e socializmit.

Shokëve të këtyre grupeve dhe partive të reja, me të cilat kemi lidhje, piqemi, bisedojmë dhe bashkëpunojmë, kurdoherë ua vëmë në dukje këto parime bashkëpunimi dhe ndihme për njëri-tjetrin. Ne kurdoherë u theksojmë atyre se ata vetë janë përgjegjës për punën e tyre, se ata vetë mund dhe do ta zgjidhin më drejt çdo gjë, në vendin e tyre, në grupin ose në partinë e tyre. Lufta e tyre revolucionare marksiste-leniniste është primare, ndihma dhe mendimet tona janë sekondare.

E MËRKURË
28 PRILL 1965

20-vjetori i fitores mbi fashizmin

Shënime¹

1. — **Esenca e artit ushtarak** stalinian, në mbrojtje dhe në sulm.

2. — **Drejtësia e këtij arti**, e vërtetuar në betejat kryesore në Luftën e Dytë Botërore dhe që sollën fitoren.

3. — Kritikën që i bënë këtij arti ushtarak revizionistët hrushovianë.

4. — **Me çfarë e zëvendësuan** ata këtë art stalinian dhe ç'dobësim konkret solli kjo në ushtrinë sovjetike.

1. Këto shënime janë përdorur për artikullin «Fitorja e popujve mbi fashizmin, roli vendimtar i Bashkimit Sovjetik dhe meritat e mëdha historike të J. V. Stalinit», botuar në gazetën «Zëri i popullit» më 9 maj 1965.

Mareshalë dhe gjeneralë sovjetikë filluan të flasin për meritat e Stalinit

Kjo filloi me rastin e 20-vjetorit të fitores mbi Gjermaninë hitleriane. Ky është një fillim me «shumë kujdes dhe druajtje», por prapëseprapë është një fillim. E vërteta nuk mund të durojë tërë kohën e lidhur me zinxhirët revizionistë. Do të vijë koha, që figura e madhe e Josif Stalinit dhe vepra e tij e pavdekshme të shkëlqejnë si ngahera dhe të udhëheqin e të frymëzojnë vazhdimisht komunistët e popujt e botës në rrugën e revolucionit.

Lufta heroike e Partisë së Punës të Shqipërisë për mbrojtjen e mësuesit të madh të proletariatit do të kurorëzohet patjetër me sukses. Stalini duhet të rehabilitohet plotësisht. Të gjitha barrikatadat revizionisto-imperialiste do të shemben. Ne kemi besim të plotë se mashtrimi kolosal i Hrushovit ndaj Stalinit do të dërrmohet.

Shpifjet dhe sulmet e egra të Hrushovit kundër Stalinit dhe veprës së tij ishin shpifje dhe sulme kundër Bashkimit Sovjetik, kundër socializmit e komunizmit në Bashkimin Sovjetik e në botë, kundër diktaturës së proletariatit dhe partisë komuniste. Ato kishin për qëllim diskreditimin e çdo fitoreje të arritur nga Bashkimi Sovjetik dhe kampi i socializmit në luftën kundër fashizmit hitlerian, borgjezisë kapitaliste dhe imperializmit. Hrushovi dhe shokët e tij morën përsipër të realizojnë atë që nuk mundën të realizonin dot bjellogardistët, trockistët dhe fashistët gjermanë, që i hapnin rrugën

shndërrimit të Bashkimit Sovjetik në një vend kapitalist.

Me Stalinin ishte lidhur edhe fitorja historike mbi fashizmin gjerman. Prandaj këto lidhje duheshin këputur, dhe, që të këputeshin, duhej shpifur me të gjitha forcat kundër Stalinit edhe në çështjen e drejtimit nga ana e tij të luftës kundër fashizmit, për të errësuar e për të fshirë meritat e tij të mëdha si farkëtues i fitores në Luftën e Madhe Patriotike të BS. Dhe çfarë nuk u tha dhe nuk u kurdis prej revizionistëve në këtë drejtim!

Stalini u akuzua se «e la vendin të papërgatitur përpara agresionit hitlerian», se «nuk e njilhte fare situatën në frontet», se «nuk kishte haber nga operacionet dhe strategjia ushtarake», se «ishte një pijanec», se «nervozizmi dhe histeria e tij i kanë shkaktuar Ushtrisë së Kuqe dëme serioze», se «nuk kishte shkuar në asnjë front» dhe se «e drejtonte luftën me një hartë shkollore» etj., etj. Dhe në konkluzion na doli se gjoja luftën e drejtoi «Komiteti Qendror». Po kush ishte ky Komitet Qendror? Ai u akuzua dhe u dënua i tëri «antiparti» nga hrushovianët. Na doli më në fund se «figura e madhe udhëheqëse» e luftës kundër nazizmit na ishte njëfarë gjeneralmajor i quajtur Nikita Hrushov! Mareshalet heronj të Bashkimit Sovjetik që udhëhoqën me guxim e zotësi të rrallë frontet nën komandën e Stalinit; u diskredituan, u errësuan, u nxorën në pension dhe na dolën mbi ujë karrieristë të tillë si Greçkot, Çuikovët, Jeremenkot e Bagramianët.

E gjithë kjo fushatë e planifikuar denigruese kishte për qëllim diskreditimin e ushtrisë sovjetike, degjene-

rimin dhe demoralizimin e saj, revizionimin e artit ushtarak stalinian. Masat hrushoviane mbi reformat në ushtri dhe çmobilizimin kishin për qëllim dobësimin e ushtrisë sovjetike, uljen e vigjilencës përpara imperia- lizmit amerikan që kërcënonte me luftë.

Natyrisht, gjithë kjo fushatë e tërbuar shpifjesh monstroze dhe kjo veprimtari minuese nuk mund të mos sillte me vete reagimin e njerëzve objektivë të ushtrisë, e në radhë të parë të kuadrove të saj të vjetër që dolën nga revolucioni e që u rritën bashkë me Ushtrinë e Kuqe, që u kalitën nga partia e Stalini, që bënë luftën kundër fashizmit dhe dolën fitimtarë në të. Ata ishin në gjendje më mirë se kushdo tjetër të gjykonin si duhet, të dallonin të vërtetën nga gënjeshtra e shpifja revizioniste.

Por rryma e luftës shpifarake revizioniste hrushoviane, siç duket, i mbyti ata dhe karrieristët u vunë në vendet ushtarake kyç për të komanduar, për të shtypur, për të shpifur e për të propaganduar. Blofi revizionist i organizuar për diskreditimin e Stalinit si udhëheqës i shquar dhe strateg i madh ushtarak ishte bazuar në disa ndodhi të qena e të paqena, të kurdisura e sporadike, pa asnjë rëndësi, në kuadrin e epokës së lavdishme të luftës antifashiste. Hrushovianët i grumbulluan të gjitha këto, i klasifikuan, i përpunuan nga të gjitha anët dhe një ditë i ngritën në teori për të diskredituar Luftën e Madhe Patriotike dhe strategjinë staliniane.

Hrushovianët trockistë, duke ndjekur metodën e trockistëve, nga thashethemet, nga anekdotat, nga pakënaqësitë e të pakënaqurve, të karrieristëve, të frika-

manëve, kurdisën një gjiriz të tërë dhe kur morën fuqinë në dorë e lëshuan këtë mbi Stalinin dhe ushtrinë sovjetike. Ato që Stalini, si marksist i madh, kishte kritikuar me kohë, hrushovianët i bënë si të tyret dhe mbi këto qepën një pëlhurë me shpifje dhe gënjeshtër. Të gjithë karrieristët, të pakënaqurit, të frikshmit dolën mbi ujë. Ata luftonin gjoja kultin e Stalinin dhe ngrinin e propagandonin veten e tyre, disfatat e tyre i nxirnin si fitore, frikën e tyre e kthyen në heroizëm. Ata nxorën libra e memorie ku shanin Stalinin që gjoja qenkësh inkompetent në çështjet ushtarake dhe i pengonte këta «heronj» të zbatonin idetë e tyre «gjeniale». Ata shanin Stalinin se nuk merrte parasysh «propozimet» që bënin, të cilat, sipas tyre, «po të ishin marrë parasysh, Gjermania hitleriane do të ishte shembur më parë». Kjo literaturë false, antihistorike, antimarksiiste, mbuloi Bashkimin Sovjetik për të krijuar kaos dhe në këtë kaos të vazhdohej puna për të minuar mbrojtjen e Bashkimit Sovjetik e veçanërisht për të demoralizuar e degjeneruar ushtrinë sovjetike.

Një situatë e tillë jo vetëm që pati konsekuenca të hidhura brenda, por në arenën ndërkombëtare bëri që ushtrisë sovjetike t'i ulej prestigji, të errësoheshin fitoret e saj të shkëlqyera, sakrificat e saj të mëdha. Ishte e natyrshme që imperialistët të ngrinin në qiell kontributin e tyre në fitoren dhe të arrinin të reklamonin se ishin ata vendimtarët e fitores mbi Gjermaninë, ishin ata që vendosën fatet e luftës. Natyrisht, në këto situata të krijuara nga agjentët e tyre hrushovianë, imperialistët amerikanë dhe anglezë notonin në një gjendje aq të favorshme, saqë edhe ata vetë nuk e parashikonin.

Vetë imperialistët as që e prisnin që hrushovianët të arrinin deri atje, saqë të thoshin se sovjetikët «i udhëhiqte në luftë një kriminel, një idiot, një injorant, një pijanec», sikurse e kualifikuan hrushovianët Stalinin.

Është e natyrshme që njerëzit e thjeshtë të bënin pyetjet: «Si mund të arrinte Bashkimi Sovjetik këto mrekulli, si mund të arrinte fitoren mbi një armik të fortë, pa udhëheqës të fortë ose me një presidium «antiparti», me një sekretar të përgjithshëm idiot në krye të tij dhe të ushtrisë?», «Si mund të udhëhiqej një ushtri e lavdishme, siç ishte ushtria sovjetike, pa komandant suprem ose me një komandant suprem «injorant?»».

E tillë ishte gjendja. Imperialistët, të udhëhequr nga një objektivitet borgjez, nuk arritën deri në këtë gradë saqë të mohonin meritat e Stalinin në luftë, sikurse bëjnë këta tradhtarë të ndyrë antisovjetikë, hrushovianët.

Për udhëheqjen e re revizioniste sovjetike, vazhduese e tradhtisë, si në çdo sektor, ashtu edhe në atë ushtarak, u krijua një situatë e rëndë. Me rënien e Hrushovit, në ushtri filloi patjetër të lëvizet dhe antistalinianët të hutohen, të tremben. Për Stalinin filluan të flasin publikisht disa gjeneralë, por kurdoherë të rezervuar, sepse sigurisht kështu është dhënë «direktiva» nga KQ. KQ revizionist i BS ndodhet ngushtë, është detyruar të lëshojë perin për të ulur valën që ngrihet, veçanërisht në ushtri, për të gënjer, për t'u dhënë njëfarë satisfaksioni të pakënaqurve. Prandaj ai i ka këshilluar gjeneralët të jenë të matur. Por më kot, po iku filli i çorapes një ditë, ai do të shkojë deri në fund.

Shumë interesante janë deklaratat publike të gjenrallejtënant V. Pozdnjakut, historian sovjetik, të bëra në konferencën e shtypit që u mbajt në Moskë më 20 prill 1965. Ai tha se «Stalini mori pjesë aktive në përpunimin e të gjitha planeve të operacioneve të mëdha gjatë kohës së luftës», se «ai nuk ishte një njeri që vinte thjesht firmën mbi një plan pa e njohur nga afër». «Nuk është e vërtetë se Stalini nuk pyeste dhe nuk peshonte mendimin e komandantëve. Këtë gjë e them me kompetencë, tha ai, **pse kam marrë mendimin e të gjithë komandantëve të frontit**».

Vetëm nga këto deklaratat ne mund të nxjerrim disa konkluzione me shumë rëndësi, por që nuk i pëlqejnë aspak udhëheqjes së tashme revizioniste sovjetike:

— Del se Stalini s'ishte një injorant, njeri që nuk kishte haber nga lufta dhe që ishte i shkëputur nga fronti, por një strateg i madh që ka marrë pjesë në përpunimin e të gjitha planeve të operacioneve të mëdha, që ndiqte e njihte me hollësi gjendjen në front, bile edhe lëvizjen e çdo divizioni.

— Del se Stalini nuk ishte ai që praktikonte «kultin e personit», që nuk pyeste njeri dhe vendoste në mënyrë arbitrare, përkundrazi, ai këshillohej dhe vendoste në mënyrë kolegjiale duke çmuar e duke respektuar mendimet e të tjerëve. Natyrisht, Stalini dhe bashkëpunëtorët e tij kryesorë, nuk mund të vendosnin kurdoherë ashtu sikurse thoshte njëri ose tjetri gjeneral e mareshal nga ky ose ai front dhe që nuk mund të shihnte dot madhësinë dhe tërësinë e operacioneve. Po të mos kishte vepruar kështu, atëherë me të vërtetë Stalini

do të kishte bërë gabime të mëdha dhe do të ishin vënë në rrezik ushtria dhe fitorja. Trillime absurde si skena e famshme e telefonit të Hrushovit dhe Malinovskit, të cilët i paskan kërkuar ndihmë Stalinit dhe ai nuk ua paska dhënë, u ngritën nga tradhtari Hrushov në teori për të treguar se gjoja Stalini ishte një nulitet ushtarak, kurse Hrushovi dhe Malinovski — gjeni ushtarakë!

Edhe ndonjë mareshal i Bashkimit Sovjetik, që ka treguar heroizma në luftë, s'mungon të dalë me ndër-gjegje të rënduar dhe të shqetësuar për të dënuar e pushkatuar të vërtetën dhe për të ndihmuar gënjeshtren dhe shpifjen. Ky mareshal nuk shikon se duke vepruar kështu i shërben një tradhtie të madhe që ka marrë përsipër dobësimin e Bashkimit Sovjetik përpara imperializmit amerikan, shkatërrimin e tij, minimin e të gjitha fitoreve të tij historike.

Kritikuesit «heroikë» të Stalinit, që e akuzojnë atë se nënvleftësoi rrezikun e luftës dhe e la të papërgatitur Bashkimin Sovjetik përpara agresionit fashist, le të na thonë se cilat janë «hapat dhe masat e tyre serioze» që përgatitën Bashkimin Sovjetik kundër imperializmit amerikan? Cilat janë «fitoret e shkëlqyera» të politikës tradhtarë e kapitulluese hrushoviane? Mos vallë mendoni ju se popujt sovjetikë, marksistë-leninistët e vërtetë, oficerët dhe ushtarët patriotë sovjetikë nuk i shohin e nuk i kuptojnë gënjeshtren, tradhtinë dhe disfatën tuaj? Jo! Gaboheni!

Vetëm të verbrit nuk mund të shohin se ju u puthët me imperializmin amerikan, se ju jeni vënë në shërbim të tij, se keni tradhtuar çështjen e Bashkimit Sovjetik e të socializmit, keni ulur prestigjin dhe keni

diskredituar autoritetin e tij, keni humbur miqtë e tij të vërtetë dhe jeni bashkuar me disa klika tradhtarësh e reaksionarësh që urrehen nga komunistët dhe popujt e tyre. Popujt sovjetikë do t'ju dënojnë pa mëshirë. Dita e gjyqit të madh të revolucionit nuk do të jetë e largët. Këtë e kërkon drejtësia marksiste-leniniste, e kërkon nderi, e tashmja dhe e ardhmja e Bashkimit Sovjetik, e socializmit dhe e komunizmit, këtë e kërkon fitorja mbi imperializmin, fitorja e revolucionit botëror.

* Imperialistët amerikanë zbankuan trupa në Santo-Domingo, ku po zhvillohen luftime midis veglave të amerikanëve që janë në fuqi dhe revolucionarëve që përkrahin ish-presidentin Bosh. Vazhdon politika e kanonierave. Agresorët amerikanë janë bërë të paturpshëm, ata shkuan të mbytin në gjak popullin revolucionar të Santo-Domingos, që me dhjetëra vjet vuajtje të zezat e ullirit nga klika e diktatorit Truhiljo, vegël e amerikanëve.

Moska është «për të shpëtuar jetën e nënshtetasve amerikanë dhe të huaj». I tërë ky është bluf. Sovjetikët revizionistë sigurisht dhe si zakonisht «do ta ngrenë çështjen» në Këshillin e Sigurimit, do të mbajnë një, dy fjalime bombastike, mbledhja do të vazhdojë litar dhe, gjatë kësaj kohe, amerikanët do të bëjnë punën e tyre në këtë ishull e do të merren vesh me sovjetikët në kulisa. Diplomaci e fshehtë. Do t'i demaskojmë, do të bëjmë deklaratë dhe do të mbrojmë popullin dominikan.

E ENJTE
29 PRILL 1965

Natën në Tiranë ra shumë shi, kurse në Dajt borë. Në vende të tjera po ashtu. Ky keqësim i kohës është bërë shqetësues.

E PREMTE
30 PRILL 1965

Sot, në selinë e Komitetit Qendror të Partisë, prita delegacionin e Shoqatës së Punonjësve për Çlirimin e Vietnamit të Jugut, i cili ka ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në festimet e 1 Majit. Patëm një bisedë shumë të përzemërt¹.

Prita, gjithashtu, përfaqësuesit e federatës së rretheve marksiste-leniniste të Francës.

Po sot prita edhe përfaqësuesit e KQ të Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) të Spanjës dhe përfaqësuesit e lëvizjes marksiste-leniniste italiane².

Miqtë dhe shokët marksistë-leninistë kanë ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në festimet e 1 Majit.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 473.

2. Po aty, f. 483, 497, 510.

E SHTUNË
1 MAJ 1965

Populli manifestoi për festën e bukur të 1 Majit me gëzim të madh dhe me entuziazëm. Organizimi ishte i mirë. Parullat, pankartat e pllakatet, gjithashtu, ishin zgjedhur me kujdes e të larmishme. Populli ishte i veshur shumë mirë. Dielli shkëlqente.

Në tribunën qendrore ftuam edhe shokët vietnamezë.

E PREMTE
30 PRILL 1965

Sot, në selinë e Komitetit Qendror të Partisë, prita delegacionin e Shoqatës së Punonjësve për Çlirimin e Vietnamit të Jugut, i cili ka ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në festimet e 1 Majit. Patëm një bisedë shumë të përzemërt¹.

Prita, gjithashtu, përfaqësuesit e federatës së rretheve marksiste-leniniste të Francës.

Po sot prita edhe përfaqësuesit e KQ të Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) të Spanjës dhe përfaqësuesit e lëvizjes marksiste-leniniste italiane².

Miqtë dhe shokët marksistë-leninistë kanë ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në festimet e 1 Majit.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 473.

2. Po aty, f. 483, 497, 510.

E SHTUNË
1 MAJ 1965

Populli manifestoi për festën e bukur të 1 Majit me gëzim të madh dhe me entuziazëm. Organizimi ishte i mirë. Parullat, pankartat e pllakatet, gjithashtu, ishin zgjedhur me kujdes e të larmishme. Populli ishte i veshur shumë mirë. Dielli shkëlqente.

Në tribunën qendrore ftuam edhe shokët vietnamezë.

E HËNË
3 MAJ 1965

Likuidatorët italianë

Shënime¹

Revizionistët italianë me në krye grupin e Amendolës, në shtypin e partisë së tyre, po shtrojnë zyrtarisht likuidimin e Partisë Komuniste Italiane, bashkimin dhe shkrirjen e saj me partitë socialiste dhe socialdemokrate.

Këtë rrugë e hapën tradhtarët hrushovianë me «teoritë» e tyre për «bashkekzistencën paqësore», për «marrjen e pushtetit në rrugë paqësore parlamentare», për «botën pa armë, pa luftëra», për «partinë e të gjithë popullit» etj. Revizionistët italianë ecin përpara në realizimin konkret të këtij programi.

Tezat e likuidatorëve italianë mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Këto shënime janë përdorur nga autori për artikullin «Revizionistët modernë — likuidatorët më të mëdhenj në historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare» («Zëri i popullit», datë 25-26 maj 1965). Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 396.

Revolucioni, socializmi në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë u bënë në kushte të ndryshme nga ato aktuale, të periudhës së «bashkekzistencës paqësore». Në vendet e tjera socialiste, revolucioni dhe socializmi, për likuidatorët italianë, u importuan nga jashtë, prandaj s'ka as ndonjë vlerë që të merret si eksperiencë. Si konkluzion ata thonë se duhet të ndërtohet një vijë e re, «vija italiane e socializmit», vijë e cila përshtatet më shumë me politikën e «bashkekzistencës paqësore», natyrisht nënkuptohet edhe në ideologji. Këtu fle lepuri dhe e thonë hapur: «rruga e komunistëve» nuk dha rezultate në Evropën Perëndimore, në vendet «e përparuar», «rruga e socialdemokracisë» po ashtu. Internacionalja e Tretë dhe Lenini, pale Stalini, kanë gabuar në drejtimin e thellimit të përçarjes me socialtradhtarët.

Tani, sipas likuidatorëve italianë, ka ardhur koha që kjo të riparohet, duke e zhdukur këtë çarje, këtë hendek. Dhe si? Duke u bashkuar, duke u shkrirë në një parti të vetme të klasës punëtore dhe ta merr mendja, bashkim nga koka dhe duke i bërë koncesione njëri-tjetrit. Cilat janë koncesionet? Natyrisht në parimet kryesore, pra jo revolucion, por evolucion, jo diktaturë të proletariatit, por mbështetje në «parimet e kushtetutës demokratiko-borgjeze liberale italiane», jo parti marksiste-leniniste, por njëfarë partie të gjerë masash, për votim, për reforma strukturore me anë parlamentesh.

Me një fjalë «partia e të gjithë popullit» e Hrushovit.

Hrushovianët shkuan duke e likuiduar çdo gjë që ishte ndërtuar (duke e «argumentuar» se gjoja sociali-

zmi mbaroi së ndërtuari në Bashkimin Sovjetik dhe këtu tani ndërtohet komunizmi). Kurse likuidatorët italianë shkojnë nga parimi që çka u ndërtua në Bashkimin Sovjetik jo vetëm që ishte gabim, një anomali e kultit të personit, por do të jetë gjithashtu «gabim» të merret për bazë kjo eksperiencë e gabuar nga vendet «e përparuara evropiane», siç është Italia.

Prandaj, thonë likuidatorët italianë, derisa është «pranuar» që në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera socialiste është ecur «në rrugë të gabuar, në rru-gën e terrorit, të vrasjes, të mungesës së demokracisë së vërtetë, të përçarjes së klasës punëtore», atëherë ne duhet të ndjekim një «rrugë tjetër, të drejtë, të vërtetë, marksiste-leniniste» dhe kjo është «rruga italiane për në socializëm». Kjo përbën «një eksperiencë të re, të kohëve të reja», me një «Lenin të ri që quhet Toliat»! Çdo gjë pra ka ndryshuar, thonë likuidatorët italianë, e vjetra duhet flakur se është vjetruar dhe duhet zëvendësuar me diçka të re. «Eureka»!

Mirëpo kjo i demaskon plotësisht tradhtarët. Të gjithë revizionistët janë të alarmuar nga «guximi» revizionist i grupit të Amendolës, i cili vrapon përpara dhe i heq petët byrekut. Të alarmuar janë Longot, të alarmuar janë sovjetikët dhe të gjithë marrin pjesë në këtë diskutim. Por i vijnë rrotull «vazos» që po thyhet.

Amendola gërthet «unë jam në rregull, nuk them ndonjë gjë më tepër se ju, kjo është një vijë e për-bashkët, këtu ecim të gjithë». Me një fjalë, Suslovëve dhe Hrushovëve Amendola u thotë: Ju na e dhatë çelësin e portës dhe unë e hapa derën e nevojtores. Kurse Longove u jep shkrimet e tyre të mëparshme dhe

aktuale e u thotë: «Ç'grini kot, ja ç'keni shkruar, ja ç'keni thënë, ju dhe Toliati, tani hajdeni t'i zbatojmë».

Hrushovët, Suslovët, Longot e të tjerë vetëm këtë diferencë kanë me Amendolën dhe e këshillojnë «mishi të piqet, helli të mos digjet». Me një fjalë, të luftohet marksizëm-leninizmi, të shkatërrohet socializmi, të rivendoset pushteti borgjez kapitalist dhe ata të vazhdojnë të vetëquhen komunistë, marksistë-leninistë, bile ata mbeten të parët, të vërtetët, që bënë revolucionin!

Këta «marksistë-leninistë të vërtetë», i thonë social-demokratët Amendolës, me të cilët ne po bashkohemi, nuk e ndërrojnë tabelën e dyqanit të tyre, në këtë dyqan të tyre ne do të bëhemi ortakë, do të bashkojmë plaçkat për t'i shitur, por duke ruajtur edhe ne tabelën jashtë. Tabela jashtë dyqanit s'ka rëndësi, s'prish punë, rëndësi kanë plaçkat e dyqanit që i bashkojmë, prandaj mos u shpejto të prishësh dhe tabelën, ose maskën, e cila na duhet për të mbyllur vazon që qelbet.

Duhet demaskuar fort këta shërbëtorë të kapitalizmit dhe të imperializmit amerikan.

E MARTË
4 MAJ 1965

E kritikova rreptë Fadil Paçramin që as e kishte vënë fare ujin në zjarr për artikullin që do të botohet me rastin e 20-vjetorit të fitores mbi fashizmin, duke e fjetur mendjen se atë do ta shkruanin të tjerë. Fadili tregohet përtac. Ia ka marrë mendjen «drama» dhe e harron detyrën si drejtor në Drejtorinë e Propagandës në aparatit e Komitetit Qendror.

Qëndrime të tilla dëmtojnë punën.

E MËRKURË
5 MAJ 1965

Dita e Dëshmorëve, dita më e shenjtë për ne. Mendoj kohët e vështira nga kaluam, luftën heroike që bëmë, shokët e lavdishëm që na u vranë për atdheun, për Partinë, për socializmin. Sot, që populli rron dhe punon i lumtur, shkon e nderon kujtimin e bijve dhe bijave të tij të pavdekshëm në varrezat e tyre, në varrezat e dëshmorëve.

Me dhjetëra mijë njerëz shkojnë sot atje, për të nderuar kujtimin e tyre. Nga dritarja e zyrës i shoh vargje-vargje banorët e kryeqytetit që mbajnë në duar kurora e lule të freskëta. Me mijëra nxënës e nxënëse shkollash. Sa mirë, sa mirë! Të mos e harrojnë ata sakrificën supreme që bënë prindërit dhe të afërmit e tyre, por të frymëzohen gjithë jetën nga lufta e dëshmorëve të kombit!

Dola edhe vetë, mblodha trëndafila të kuq, u futa në mes të turmës dhe shkova nderova kujtimin e shokëve të mi të dashur. U vura lule trimave, që i kam kurdoherë pranë, në zemrën dhe në mendjen time. Lavdi e përjetshme dëshmorëve dhe mëmës Parti që i rriti dhe i bëri të pavdekshëm!

E ENJTE
6 MAJ 1965

E ktheva për ripunim pjesën e fundit të artikullit për 20-vjetorin e fitores mbi fashizmin¹. Dhashë vërejtjet konkrete si duhet ta ripunojnë atë.

1. Shih në këtë vëllim, f. 254.

E PREMTE
7 MAJ 1965

Mbledhja e Sekretariatit sot diskutoi shumë probleme, por kryesisht u ndal në zbatimin e detyrave për forcimin e mëtejshëm të përbërjes së Partisë dhe në punën e organizatave-bazë për drejtimin e çështjeve ekonomike.

Duke pasur parasysh faktin që Partia tani është rritur, kam mendimin se duhet të kemi një orientim më shkencor për rritjen e mëtejshme të radhëve të saj. Ky them se mund të jetë edhe objekt i një studimi të veçantë. Duke diskutuar¹ në mbledhje shtjellova idenë time për përgatitjen e këtij studimi për të dalë me propozime në Kongresin e ardhshëm të Partisë.

Për problemin e dytë diskutimin tim² e përqendrova në faktin që organizatat-bazë të Partisë duhet të udhëhiqen nga njerëz të gjallë, energjikë, punëtorë të palodhur, iniciatorë e me nivel të lartë ideologjik, politik e profesional, që të jenë në gjendje t'i zgjidhin drejt problemet e mëdha që shtrohen përpara Partisë në të

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 525.

2. Po aty, f. 531.

gjitha fushat e jetës. Theksova rëndësinë dhe rolin e veçantë që ka sekretari i parë i komitetit të Partisë së një rrethi në kuptimin, zërthimin dhe zbatimin e direktivave të Komitetit Qendror, si dhe për punën individuale që duhet të bëjë ai për ngritjen dhe formimin e tij të vazhdueshëm. Në punën me njerëzit t'i kushtohet rëndësi përgatitjes serioze e me përgjegjësi për çka do të flitet dhe të gjenden forma e mënyra pune sa më të përshtatshme për zbatimin mirë e me sukses të direktivave të Partisë.

E SHTUNE

8 MAJ 1965

Bëmë mbledhjen e Byrosë Politike ku diskutuam për planet, programet dhe afatet e shkollës së mesme të arsimit të përgjithshëm.

Mbas shumë debatesh, në fund vendosëm që afati i shkollës së mesme të përgjithshme të jetë 12 vjet, gjë që diktohet nga një numër i madh faktorësh e që në diskutimin tim i analizova gjerësisht¹.

Një nga temat që diskutuam sot në Byronë Politike ishte shkëmbimi i monedhës. Kërkuam se ç'masa janë marrë për këtë problem të madh, për qarkullimin e monedhës, për kohën e ndërrimit të saj, për detyrat që kanë bankat dhe arkat e kursimit, të cilat do të japin paratë e reja dhe do të mbledhin të vjetrat.

U bënë diskutime. Unë fola në mënyrë të veçantë për mirëmbajtjen e monedhës. Shoh se për këtë çështje punonjësit e financës nuk po bëjnë ndonjë propagandë. Është dhënë direktiva që çdo njeri t'i mbajë mirë mo-

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 539.

nedhat, t'i palosë e t'i ruajë ato. Po ç'bëhet për këtë? Asnjë propagandë! Asnjë kërkesë për të rritur kujdesin, për ta mbajtur monedhën në kuletë, që asaj t'i zgjatet sa më shumë jeta.

Kur mbaruam mbledhjen e Byrosë Politike, shkuam në sallën e madhe për të parë maketin e përgatitur për Monumentin e Pavarësisë që do të ngrihet në qytetin e Vlorës.

Ideja e monumentit na pëlqeu, por duhet filluar menjëherë. Prandaj grupi i skulptorëve dhe i arkitektëve t'i futet sa më parë kësaj pune dhe ta përfundojë në kohë Monumentin e Pavarësisë.

Në mbrëmjen solemne kushtuar përvjetorit të Ditës së Fitores mbi Fashizmin, që u mbajt në Moskë, foli Brezhnjevi. I detyruar nga situatat e vështira të brendshme, ai zuri në gojë edhe Stalinin. Brezhnjevi kërkoi ta kalonte këtë gjë shpejt, por salla (6 mijë veta dhe të zgjedhur me qiri) reagoi dhe për 15 sekonda rresht duartrokiti për Stalinin. Salla duartrokiti gjithashtu Zhukovin, i cili u përmend në raport dhe ishte ftuar në tribunë.

Natyrisht kjo gjë është një goditje për revizionistët dhe një plus për marksistë-leninistët. Revizionistët s'kanë ç'bëjnë, janë keq, ata e kanë lakun në grykë, dhe ky do t'u shtrëngohet çdo ditë e më shumë.

E HËNË
10 MAJ 1965

Prita zonjën Aua Diallo Keiten nga Mali¹. Është kushërirë e parë e Modibo Keites². Dukej grua e zgjuar dhe shprehu shumë simpati për vendin tonë. Besoj se do të bëjë punë të mirë për propagandimin e Shqipërisë në Mali³.

Punova për artikullin që do të botojmë së shpejti kundër likuidatorit Amendola dhe revizionistëve të tjerë.

1. Në atë kohë deputete, anëtare e byrosë politike kombëtare të Bashkimit Kombëtar të Bashkimit Sudanez RDA dhe përgjegjëse e seksionit për gruan pranë kësaj byroje.

2. Në atë kohë, president i Malit.

3. Shih: Enver Hoxha, Veptra, vëll. 29, f. 546.

E MARTË
11 MAJ 1965

Në tërë Shqipërinë ka rënë shi. Në Korçë edhe në qytet ka rënë borë. Vetëm në Tiranë sot koha është pa shi.

E MËRKURË
12 MAJ 1965

Sot kishim mbledhjen e organizatës-bazë. Filluam në orën 17.

Spiroja na lajmëroi nga Pekini për përfundimin e bisedimeve me Çu En Lain. Nuk na i plotësuan kërkesat. Problem i madh për ne është sidomos hidrocentrali dhe metalurgjia.

E ENJTE
13 MAJ 1965

Kohë e vrenjtur, po bie shi. Na hëngri ky shi që nuk po duket të pushojë. Tash ai po bie sa s'duhet, gjë që më vonë mund të shkaktojë thatësi të.

E PREMTE
1A MAJ 1965

Mbi zgjerimin e shkollës së mesme

Diskutua me Ramizin dhe me Manushin rreth zbatimit të vendimit të fundit, që shkolla të jetë 12-vjeçare dhe jo më 11-vjeçare, siç ishte deri tani, për perspektivën e zgjerimit të mëtejshëm të shkollës së mesme, si dhe për disa çështje të tjera të shkollës.

Duke marrë parasysh të gjitha llojet e shkollave në vendin tonë socialist, në parim orientimi është ky: arsimit do të shkojë duke u zgjeruar dhe duke u ngritur kurdoherë në një nivel më të lartë. Nuk mund të bëhet fjalë as për ngushtimin e shkollave, as për «superprodhim» të njerëzve me shkollë dhe as për papunësi të këtyre. Sigurisht çdo gjë do të planifikohet që t'u përgjigjet shkollës së zhvillimit të vendit, shtimit të popullsisë, nevojave të ekonomisë, të arsimit dhe të kulturës, të ushtrisë dhe të administratës shtetërore etj.

Në parim e gjithë rinia duhet të pajiset me arsim. Arsimit 8-vjeçar, natyrisht, është i detyruar. Kurse 4 vjetët e tjerë të shkollës së mesme, qoftë kjo e përgjithshme apo profesionale nuk janë të detyruar. Por duhet

të kuptohet se të gjithë të rinjtë, që dëshirojnë të ndjekin shkollat e mesme të çdo natyre, i kanë të hapura dyert, bile ne duhet të punojmë për t'i nxitur ata që të vazhdojnë patjetër shkollën e mesme. Kështu që nuk bëhet fjalë për ngushtim, apo mbyllje të shkollave të mesme të çdo kategorie, po për shtim të numrit të shkollave.

Kufizime do të ketë vetëm vajtja në shkollën e lartë dhe kjo do të bëhet duke pasur parasysh nevojat e sektorëve dhe përpjesëtimet e kuadrove të lartë e të mesëm. Kështu, jo të gjithë ata që mbarojnë shkollat e mesme, do të kenë mundësinë të ndjekin universitetin. Këtu do të bëhet seleksionimi si në numër ashtu dhe në cilësi, kurdoherë lidhur me nevojat e planifikuara të sektorëve të ekonomisë dhe të kulturës.

Në shkollat e larta në fillim na mungonin nxënës; erdhi një kohë kur me ato kapacitete materiale e financiare që kishte universiteti, s'mund të mbanim më shumë studentë, megjithëse ritmi i nxjerrjes së kuadrove të lartë ishte prapë mesatar. U detyruam t'i shtojmë këto mjete e ritme dhe pranuar më shumë studentë. Tani këto mjete janë përsëri të pamjaftueshme për numrin e të rinjve që kërkojnë të ndjekin shkollat e larta. Pra, del nevoja që ritmet e përgatitjes së kuadrove të lartë të shtohen. Ky është një problem shumë i rëndësishëm që do ta studiojmë më vete.

Për vitin shkollor 1964-1965 pati një numër nxënësish, të cilëve nuk iu dha e drejta e studimit për në universitet; në vitet e ardhshme do të ketë edhe të tjerë, që nuk do të plotësojnë kushtet. Ky është një proces normal që nuk duhet të na alarmojë. Këta do të jenë

kuadro të mesëm, me kulturë të përgjithshme, që ne duhet t'i orientojmë për të punuar menjëherë në prodhim, ose pasi të jenë përgatitur në disa kurse speciale të shkurtra. Gjatë viteve të shkollës së mesme ata, përveç kulturës së përgjithshme që kanë fituar, kanë bërë edhe punë në uzina, kooperativa, ndërmarrje bujqësore etj., kështu që kanë marrë disa njohuri fillestare edhe për praktikën e punës në to. Këto njohuri mund t'ua përforcojmë me disa kurse speciale, sipas profileve dhe ata me punë dhe në punë do të kualifikohen si kadro të mesëm.

Shtrohet çështja: çfarë shkollash të mesme duhet të kemi? Unë mendoj se duhet të kemi, në radhë të parë, gjimnaze, por na nevojiten edhe politeknikume e shkolla të tjera të profilizuara. Sigurisht, nxënësit në këto shkolla do të dërgohen në bazë të një planifikimi, sipas nevojave të sektorëve të ndryshëm për punëtorë të kualifikuar me arsim të përgjithshëm, politeknik ose teknik special, për punëtorë dhe specialistë të mesëm, si dhe për kontingjente të mjaftueshme për shkolla të larta.

Pra, këtë drejtim kryesor është e domosdoshme që, para Kongresit të ardhshëm të Partisë, ta studiojmë. Ta kemi të qartë se lloji i shkollave të mesme dhe nevojat për kadro janë të lidhura dhe në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të vendit.

Ne kemi edhe shkollat e rezervave të punës, si edhe nxënësit në ekonomi. Këto kanë qenë të nevojshme; deri në njëfarë shkalle dhe për një periudhë ato mund të jenë akoma të nevojshme. Por ne duhet t'i shohim më nga afër këto shkolla, sepse më parë, kur kishim

shumë nevojë për punëtorë disi të kualifikuar, në to pranonim të rinj që kishin mbaruar filloren ose shtatë-vjeçaren. Tani, aq më tepër për të ardhmen, problemi shtrohet ndryshe. Çdo vit do të kemi një numër të madh të rinjsh e të rejash që mbarojnë shkollën e mesme dhe që duan punë. Ata duhet të hyjnë punëtorë, më parë nga ata që kanë mbaruar 8-vjeçaren.

Prandaj si punëtorë do të pranojmë ata që kanë një arsim më të lartë, kurse të tjerët me fillore ose me 8-vjeçare t'i shtyjmë të vazhdojnë shkollat e mesme të çdo natyre. Shkollat e rezervave të punës javash-javash duhet të ndërrojnë profilet dhe brendinë, pse këto nuk do të përgatitin nxënës 14-16-vjeçarë, por 18-19-vjeçarë dhe që kanë mbaruar shkolla të ndryshme të mesme.

Vetë shkollat e mesme të profileve të ndryshme duhet të shikohen me njëfarë orientimi për specializim, sigurisht, në bazë të nevojave. Kjo më shumë për politeknikumet dhe teknikumet e veçanta, por edhe për gjimnazet, sido që në këto nuk mund të bëjmë ndryshime të shpeshta në orientime e në programe.

Një nga parimet bazë që zbaton Partia jonë, është sigurimi i arsimit dhe i punës për çdo njeri në vendin tonë. Puna do të krijojë të mirat dhe bollëkun. Një punë e kualifikuar do ta sjellë më shpejt këtë mirëqenie dhe puna e kualifikuar do të bëhet nga njerëz të mësuar në shkollë e në punë. Pra, ky orientim duhet të na udhëheqë në zhvillimin e mëtejshëm të shkollës sonë.

(Shoku Manush me shokun Ramiz ishin dakord me këtë orientim.)

Tani te ne fillon një proces i ri i natyrshëm, shtimi

i numrit të të rinjve e të rejave që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe teknik dhe sidomos futja e një pjese prej tyre drejtpërdrejt në prodhim. Deri sot, ata që mbaronin shkollën e mesme, në përgjithësi thitheshin nga universiteti ose i kalonin administratës shtetërore, pse si njerëz me kulturë ishin më të preferuarit, për arsye të nivelit të ulët arsimor të njerëzve në ato momente. Tani gjendja ka filluar të ndryshojë. Një pjesë e njerëzve të administratës kanë mbaruar shkollën e lartë, një pjesë janë me arsim të mesëm, të tjerë që s'e kanë të plotë arsimin e mesëm, kanë fituar stazh dhe eksperiencë në punë. Këta të fundit nuk mund t'i heqim për t'i zëvendësuar me ata që kanë marrë arsim të mesëm, por atyre do t'u vëmë si detyrë ta plotësojnë, pa shkëputje nga puna, arsimin e mesëm, bile edhe arsimin e lartë, në qoftë se e lyp vendi i punës. Kështu që ne çdo vit do të kemi kontingjente të rinjsh dhe të rejash që mbarojnë shkollën e mesme e që duhet të futen direkt në prodhim, si punëtorë. Në këtë proces të ri, natyrisht, neve na duhet të bëjmë një punë edukative intensive:

Së pari, për të luftuar sidomos pikëpamjet që ekzistojnë në këtë drejtim dhe që i ushqenin edhe situatat e nevojat e viteve të mëparshme. Në ato kohë, të mbaroje shkollën e mesme ishte një privilegj, kurse sot mbarimi i shkollës së mesme, duke pasur parasysh nevojat e vendit, është një sukses, por jo më një privilegj, pse janë të shumtë ata që mbarojnë dhe do të mbarojnë shkollën e mesme.

Së dyti, të luftohet pikëpamja se po mbarove shkollën e mesme, shteti duhet të të japë medoemos të

drejtën për të vazhduar universitetin. Për të hyrë në universitet duhen plotësuar kushtet për cilësinë që kërkohet. Këto kushte do të maten me notat që merren ose me konkurs. Kjo formë zgjedhjeje të studiohet.

Së treti, të luftohet pikëpamja se, meqë dikush ka mbaruar shkollën e mesme dhe, për një arsye ose për një tjetër, nuk e vazhdoi universitetin, shteti duhet t'i sigurojë medoemos një vend të rehatshëm qoftë në prodhim ose në administratë. Në rast se ka nevojë për kuadro me arsim të mesëm dhe numri i konkurrentëve është i madh, edhe në këto vende duhet të vendoset kriteri për t'u marrë në punë më të aftët.

Pra, si konkluzion i këtij procesi që ka filluar e do të zhvillohet dhe i mentaliteteve që janë krijuar, duhet të punohet intensivisht, që ky proces të kuptohet drejt nga rinia, të ekzistojë një kuptim i drejtë i punës, për punën fizike, për vendin e rëndësishëm që zë punëtori në shoqëri. Në këto kushte të zhvillimit të vrullshëm të socializmit në vendin tonë, të jesh punëtor nuk do të thotë më të jesh pa kulturë, të futesh sa të marrësh një rrogë dhe të prodhosh sa të prodhosh për shoqërinë. Jo. Për shoqërinë punëtori dhe çdo punonjës duhet të zotërojnë mirë zanatin, të ngrenë rendimentin në punë, të prodhojnë sa më shumë, dhe, që ta bëjnë këtë, ata duhet të jenë njerëz të mësuar. Në qoftë se më parë janë bërë lëshime në këtë drejtim (dhe këto bëheshin nga halli), tani teknika dhe metodat moderne të prodhimit, automatizimi i proceseve të punës etj., si dhe detyrat e mëdha që shtrohen në fushat e industrisë, bujqësisë, ushtrisë, administratës etj., nuk lejojnë të ecet më si përpara. Në qoftë se do të ecim në këtë

rrugë të drejtë (dhe kështu do të ecim), ne do të prodhojmë më shumë e më mirë dhe do të ngremë kurdoherë nivelin e jetesës së popullit, qoftë nga ana ekonomike, qoftë nga ana e ngritjes së nivelit arsimor e kulturor të njerëzve. Në qoftë se shtohet automatizimi dhe rriten rendimentet, nuk ka pse të kemi frikë nga papunësia, papunësi nuk do të ketë, përkundrazi, në këtë proces do të na duhet të punojmë për të shembur edhe disa barrikada të tjera, si për shembull, hezitimin e atyre djemve dhe të vajzave të qytetit që mbarojnë shkollën e mesme, për të dalë jashtë qytetit të tyre e për të punuar atje ku ka nevojë atdheu, qoftë në qytete të tjera ose në fshat. Ky është një problem me rëndësi shoqërore, zgjidhja drejt e të cilit godet edhe kuptimin patriarkal të mënyrës së jetesës. Procesi e do që këto vështirësi të kapërcehen. Natyrisht, duhet të punojmë në këto drejtime.

E HËNË
17 MAJ 1965

Sot, në selinë e KQ të Partisë, prita delegacionet kinezë që ndodhen në vendin tonë e që morën pjesë në festimet e 1 Majit¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 29, f. 563.

E MARTE
18 MAJ 1965

Në mbledhjen e Presidiumit diskutuam për disa probleme që lidhen me punën e gjykatave.

Theksova idenë se nga shqyrtimi i këtyre problemeve në Presidium, Gjykata e Lartë duhet të nxjerrë disa mësimë për punën e saj dhe të organeve të drejtësisë në rrethe.

Agjencitë e lajmeve thonë se amerikanët me notë zyrtare u kanë propozuar vietnamezëve «të pushojnë ndihmën për Vietkongun dhe ata do të ndërpresin bombardimet». Qeveria e RD të Vietnamit ka deklaruar se do ta demaskojë këtë manovër të imperialistëve amerikanë. Në fakt duhet ta hedhin poshtë. Të shohim.

Koha filloi të na mbajë, prandaj po mbillet kudo në masë, sidomos duhan, pambuk dhe misër. Jemi ca më vonës, se na pengoi koha e keqe.

Agjencitë e lajmeve njoftojnë se imperialistët amerikanë rifilluan bombardimet mbi RD të Vietnamit. Dështoi pra manovra amerikano-revizioniste.

Nisem për Korçë për të marrë pjesë në festën e Kolonjës.

Bisedë me shokët drejtues të rrethit të Korçës dhe me sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Kolonjës. Ka ardhur për festë edhe shoku Peti Shamblli.

Sot, në mëngjes, u nisa për në fshatin Vodicë të Ersekës, për të marrë pjesë në festimin e 22-vjetorit të krijimit të batalionit partizan «Hakmarrja».

U ndala në fillim në qendrën e rrethit (në Ersekë), ku vendosa një kurorë me lule të freskëta në varrezat e dëshmorëve. Pastaj vizitova muzeun lokal. I përgëzova shokët e rrethit për ngritjen e këtij muzeu dhe u sugjerova që atë ta pasurojnë edhe më shumë, sidomos me materiale e dokumente nga jeta dhe nga veprimtaria e dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare e të luftëtarëve të tjerë të rrethit.

Vajtëm në Vodicë. Ky është fshati i Josif Pashkos. Kishte ardhur shumë popull. Entuziazëm i madh. U takova me prindër dëshmorësh, me ish-partizanë të batalionit «Hakmarrja» etj. Të gjithëve u ndritnin sytë nga gëzimi, pleqve e të rinjve.

Në mitingun e organizuar me këtë rast fola¹ për

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 1.

traditat patriotike të krahinës së Kolonjës, për sukseset që kemi arritur nën udhëheqjen e Partisë sonë të lavdishme, për zhvillimin e bujqësisë dhe detyrat që u dalin edhe kolonjarëve në këtë drejtim etj. Fola gjithashtu për respektin që gëzon sot Shqipëria në arenën ndërkombëtare si rezultat i luftës së saj të vendosur kundër armiqve imperialistë dhe revizionistëve modernë, për suksesin që arriti delegacioni ynë në sesionin e OKB-së duke shpartalluar intrigat djallëzore të delegatëve të SHBA-së, BS e të satelitëve të tyre, për gjendjen në kampin revizionist e në atë imperialist, për pozitat e vështira në të cilat gjenden imperialistët amerikanë në Vietnam etj. Fola edhe për veprën marksiste-leniniste të Stalinit, për rritjen dhe forcimin e lëvizjes marksiste-leniniste ndërkombëtare, si pasojë e së cilës revizionistëve po u ngushtohet laku në fytyrë.

Pas mitingut u ktheva në Korçë.

KORÇE, E HËNE

24 MAJ 1965

Vizitova disa qendra pune e prodhimi.

Vajta në kombinatin e trikotazheve «Drapër e çekan»; vizitova filaturën, fabrikën e re. Shumë e mirë, por duhen bërë përpjekje për të përvetësuar akoma më tepër disa procese pune. Gjatë vizitës u takova dhe bisedova me mjaft punonjës.

Shumicën e punëtorëve në këtë ndërmarrje industriale e përbëjnë shoqet.

Vizitova Fabrikën e Miellit dhe atë të Këpucëve. Më pëlqyen shumë. Këtë të fundit e kisha parë edhe herë tjetër, por tani gjithçka atje kishte ndryshuar dhe ishte bërë më e mirë. Bisedova me punëtorët, të cilët më njohën me punën e me përpjekjet që bëjnë për të rritur prodhimin dhe cilësinë e tij e njëkohësisht për t'u arsimuar.

Vajta në kooperativën e zmadhuar bujqësore të Drenovës, ku u takova e bisedova me kuadrot drejtues të saj e me kooperativistë.

KORÇE, E MARTE

25 MAJ 1965

Sot pata një takim me kuadrot kryesorë të rrethit të Korçës. Në bisedën që zhvillova me ta, në shtëpinë e kulturës, fola¹ kryesisht për kuptimin e drejtë të punës dhe të arsimit, si faktorë vendimtarë për ndërtimin e socializmit me ritme të shpejta; për problemet e bujqësisë; për punën që bëhet në sektorin e ushtrisë, sidomos për përgatitjen e kuadrove të rinj ushtarakë e për disa probleme të tjera. Në fund, pasi i njoha pjesëmarrësit në këtë takim, në vija të përgjithshme, me zhvillimin e situatës ndërkombëtare, i porosita të punojnë me të gjitha forcat që ta mbyllin me sukses planin pesëvjeçar e të përgatiten për planin e ri.

Shëtitje me shokët në kodrat e qytetit.

Sot në gazetën «Zëri i popullit» filloi botimi i artikullit me titullin «Revizionistët modernë — likuidatorët

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 34.

më të mëdhenj në historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare»¹. Pjesa e dytë e artikullit vazhdon në numrin e nesërm të «Zërit të popullit».

SHIFAT E SHIFIT
SHIFAT E SHIFIT

U nisa për në Pogradec. Para largimit u ndala dhe i bëra një vizitë Mihalit [Dhima] të usta Lekos.

SHIFAT E SHIFIT
SHIFAT E SHIFIT

KORÇË — POGRADEC
E MËRKURË, 26 MAJ 1965

U nisa për në Pogradec. Para largimit u ndala dhe i bëra një vizitë Mihalit [Dhima] të usta Lekos.

Vajta pashë banesat që po ndërtohen në Pogradec. M'u dukën të mira.

Bisedë pune me shokët drejtues të Pogradecit. Buzë liqenit po bëhet një park i bukur.

1. Shih në këtë vëllim, f. 266.

E ENJTE
27 MAJ 1965

edh U nisa për Tiranë. Gjatë rrugës u ndala dhe vizi-
tova teknikumin e minierave e të gjeologjisë në Përre-
njas. Bisedë me mësuesit dhe me nxënësit. Kanë arritur
rezultate të kënaqshme.

E DIEL
30 MAJ 1965

Me çështjen e Vietnamit revizionistët sovjetikë për-
piqen, siç thonë francezët, të *redorer leur blason... rouil-
lé!*, pra të fshehin të palarat dhe të dalin mbi ujë.

Çështjen vietnameze ata kërkojnë ta përdorin si
një gur shahu për demagogjinë e tyre rreth «unitetit»
dhe «luftës kundër imperializmit amerikan».

Nëpërmjet këtij gjoja uniteti revizionistët sovjetikë
synojnë të shuajnë polemikën e drejtë marksiste-lenin-
niste që po zhvillohet dhe të fitojnë qetësinë e humbur.
Këtë «qetësi» ata e kërkojnë për të vazhduar në he-
shtje tradhtinë e tyre kundër marksizëm-leninizmit dhe
zhvillimin më tej të aleancës dhe të kompromisit me
imperializmin amerikan dhe borgjezinë kapitaliste. Me
fjalë të tjera, revizionistët sovjetikë jo vetëm nuk kanë
asnjë qëllim dhe asnjë dëshirë që ta kundërshtojnë
efektivisht agresionin amerikan kundër Vietnamit, por

1. Të zbukurojnë emblemën e tyre... të ndryshkur. Këtu
në kuptimin: të rifitojnë prestigjin e humbur.

përpiqen ta përdorin këtë agresion si një *planche de salut*¹ për demagogjinë e tyre.

Qëllimi i sovjetikëve është të bisedojnë me amerikanët për një kompromis me ta. Ky kompromis duhet të konsistojë vetëm në «pushimin e bombardimeve amerikane mbi Vietnamin e Veriut», domethënë sovjetikët të arrijnë gjoja të ndalojnë bombardimet në Republikën Demokratike të Vietnamit dhe ta trumbetojnë këtë si një «sukses të madh» nga ana e tyre. Pikërisht një «sukses» të tillë kërkojnë tradhtarët hrushovianë dhe as që çajnë kokën për fatin e Vietnamit të Jugut. Zaten amerikanët filluan dhe vazhdojnë bombardimin e Republikës Demokratike të Vietnamit si një shantazh për bisedime pa kushte, ose «bisedime paqësore», siç i quajnë revizionistët sovjetikë.

Këtu është një ujdj e heshtur, si me thënë, në mes amerikanëve dhe sovjetikëve. Që të dyja palët kanë pasur interes që të bombardojnë Vietnamin e Veriut, që të dyja palët përpiqen ta gjuhëzojnë Republikën Demokratike të Vietnamit të kapitullojë, duke spekuluar me bombat që ha në kurriz. Me fjalë të tjera, amerikanët duan të gjejnë një rrugëdalje për të qëndruar në Vietnamin e Jugut dhe këtë kërkojnë ta arrijnë gjoja «duke sakrifikuar bombardimet në veri të paralelit 17». Nga ana e tyre, me «ndalimin e këtyre bombardimeve» sovjetikët llogaritin amerikanët dhe veten, në mos duke arritur «unitetin» dhe «pushimin e polemikës», të paktën të bien në «ujdi» vetëm me Republikën Demokra-

1. Frëngjisht — tra shpëtimi. Të kapesh pas diçkaje që të shpëtosh nga mbytja.

tike të Vietnamit, pa sa për në Jug, «shohim e bëjmë më vonë».

Për t'ia arritur këtij qëllimi, sovjetikët synojnë në shumë drejtime:

Së pari, të bindin Republikën Demokratike të Vietnamit që të hyjë në bisedime me amerikanët, pse «po digjet e po bëhet hi kot», se nuk duhet të sakrifikojë më. Pra, me këtë revizionistët sovjetikë u thonë vietnamezëve: «Shkëputuni nga Kina, mbështetuni te ne dhe ne do t'ju shpëtojmë. Po të vini me ne, Amerika jo vetëm do t'ju pushojë bombardimet, por ajo do të zgjedhë rrugën «e arsyes» dhe çdo gjë do ta zgjidhim në rrugën paqësore».

Së dyti, këto ide dhe këto veprime revizionistët sovjetikë i mbështetin në fushën ideologjike me parullën e «unitetit për mbrojtjen» e Vietnamit. Edhe kjo manovër ka për qëllim të përforcojë të parën dhe t'u thotë vietnamezëve: «E shikoni, Kina nuk e do unitetin me ne për t'ju shpëtuar ju».

Së treti, këtë qëllim djallëzor revizionistët sovjetikë e shoqërojnë politikisht me gjoja ashpërsimin «me fjalë» të politikës së tyre kundër imperializmit amerikan, për t'i dhënë të kuptojë opinionit ndërkombëtar dhe veçanërisht vietnamezëve se «ja, shikoni, ne po ndryshojmë, jemi antiimperialistë dhe anti amerikanë të tërbuar»; «shihni, pra, duan të thonë sovjetikët, kinezët gabojnë, na shajnë kot, bëjnë shpifje» etj.

Në këtë fushatë mashtruese, revizionistët sovjetikë kanë filluar të dërgojnë në Vietnam edhe disa armë. Ata mund të dërgojnë dhe po të jenë të zgjuar duhet të dërgojnë më shumë për të mbështetur demagogjinë

e tyre. Ç'u kushton?! Ata me këtë u thonë vietnamezëve: «Ja, ne ju japim edhe armë...».

Këtë taktikë po ndjekin të gjithë revizionistët dhe kësaj taktike po i bëjnë reklamë ngado...

E HËNË
7 QERSHOR 1965

Mbledhja e Presidiūmit të Kuvendit Popullor sot shqyrtoi disa çështje, midis të cilave edhe gjendjen organizative të këshillave popullorë në rrethin e Elbasanit. Duke diskutuar¹ për këtë problem, theksova punën dhe kujdesin e shokëve drejtues të rrethit me anëtarët e këshillave popullorë të të gjitha instancave, gjë që lidhet me kuptimin drejt prej tyre të karakterit të pushtetit tonë popullor, sepse të drejtën e qeverisjes së vendit të ne nuk e kanë nëpunësit e administratës.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 69.

Partitë revizioniste të vendeve kapitaliste të Evropës u mbledhën në Bruksel dhe botuan një komunikatë. Duhet të demaskojmë qëllimet e tyre. PK e Holandës nuk ka nënshkruar.

Pika orientuese për diskutimin që do të bëj në mbledhjen e Sekretariatit, e cila do të zhvillohet në datën 14 të këtij muaji.

Kuadri bujqësor i rrethit të Gramshit.

— Në këtë rreth janë me shkollë fillore 71 llogaritarë, 117 brigadierë arash, 47 brigadierë blegtorie etj.

— Në kooperativa ka disa agronomë dhe asnjë zooteknik ose veteriner.

— Nuk dërgojnë nxënës me bursat që akordon shteti.

— 60 për qind e kuadrove drejtues nuk kanë asnjë shkollë ose kurs profesional dhe 84 për qind e magazinierëve janë me arsim fillor.

— Shkollat e ulëta bujqësore nuk funksionojnë. Po ashtu dhe kurset.

— Edukimi kulturor i kuadrit thonë se bëhet mirë (?!).

— Janë dërguar një numër i mirë kuadros në kurse për kooperativa, por gati gjysma janë larguar ose kanë ndërruar profilin.

— Gjatë dy vjetëve, as Partia, as pushteti në rreth

nuk e kanë marrë në shqyrtim çështjen e kuadrit në kooperativa.

— Perspektiva e së ardhmes.

— Propozimet që bëjnë shokët e këtij rrethi janë të diskutueshme.

Kuadri bujqësor i rrethit të Librazhdit.

— Ky rreth paraqitet disi më mirë në kuadro me kurse profesionale, 1-vjeçare dhe 6-mujore.

— Sot nga ky rreth vazhdojnë studimet në Institutin e Lartë Bujqësor 5 veta, ndërsa 42 veta ndjekin shkollën e mesme profesionale (30 agronomë, 7 zooveterinerë dhe 5 ekonomistë kontabël).

— Në kursin 2-vjeçar mësojnë 5 veta. Preokupohen më mirë.

— Përgatitja e kurseve gjatë këtij viti shkollor është e mirë, por të bëhet seriozisht.

Kuadri bujqësor i rrethit të Skraparit.

— Shumë i ulët, vetëm një ose dy me teknikum bujqësor.

— Për këtë vit kanë dërguar një numër të mirë nxënësish në shkollë, por duhet të kujdesen që këta, kur të mbarojnë, të kthehen përsëri në rrethin e tyre dhe të mos largohen e të hallakaten.

— Kurse **Tepelena**, me gjithë të metat, ka punuar më mirë.

Çështja e Partisë Komuniste të Holandës paraqitet interesante. Në dokumentet e ditëve të fundit të aprovuara nga KQ i Partisë Komuniste të Holandës po duket një çarje me revizionistët modernë, me revizionistët

sovjetikë, në radhë të parë, dhe me partitë revizioniste të vendeve kapitaliste të Evropës.

Në këto dokumente holandezët kanë vendosur se duhet demaskuar dhe dënuar Hrushovi dhe revizionizmi i tij në radhë të parë, pastaj të shihet edhe çështja e gjykimit të «dogmatizmit». Holandezët morën pjesë në mbledhjen e revizionistëve evropianë të vendeve kapitaliste, që u bë disa ditë më parë në Bruksel, por ata nuk nënshkruan dokumentet zyrtare që nxori kjo mbledhje. Ky është një kundërshtim i hapët dhe serioz nga ana e Partisë Komuniste të Holandës.

Nga ana tjetër, ne dimë që Pol dë Groti mbajti jo vetëm një qëndrim të rezervuar në Mbledhjen e Moskës më 1960, e jo vetëm që nuk na sulmoi ne, siç bënë të tjerët, por mbrojti edhe Stalinin në mënyrë të atillë që na la përshtypjen se Partia Komuniste e Holandës u rreshtua nga ana e partive tona.

Ne mbajtëm lidhje të rregullta me Partinë Komuniste të Holandës për një kohë dhe ajo, me sa më kujtohet mua, nuk na sulmoi. Më vonë kjo parti tha edhe diçka kundër nesh për të qenë në radhë. Ne nuk u përgjigjëm.

Sipas lajmeve të fundit që na vijjnë nga shokët e grupeve komuniste holandeze, mësojmë se Pol dë Groti i ka të prishura punët me sovjetikët, të cilët janë përpjekur ta zëvendësojnë me njerëzit e tyre, se Pol dë Groti ka kundërshtuar jugosllavët, është kundër tyre dhe s'ka pranuar që titistët të rifuten në parti, me gjithë presionet e mëdha sovjetike etj. Me një fjalë, s'ka tym pa zjarr. Pol dë Groti, për një kohë, duhet të ketë qenë

i detyruar «të ndjekë me zor» vijën e përgjithshme hrushoviane.

Fakt është tash se duken dhe shfaqen haptazi kontradiktat. Sa të thella janë këto? Në ç'baza janë këto kontradikta? Kjo është për t'u sqaruar.

Për interesin e marksizëm-leninizmit ne duhet jo vetëm të sqarohemi, por të ndihmojmë në sqarimin e mëtejshëm të shokëve holandezë. Ata derisa u vunë në opozicion të hapët me revizionistët evropianë, diçka kanë pozitive, dhe këtë anë pozitive të tyre ta zgjerojmë dhe ta forcojmë.

E ENJTE

10 QERSHOR 1965

Pas njoftimit që bëri Uashingtoni se ushtarët amerikanë «do të marrin pjesë drejtpërsëdrejti në luftimet» në Vietnam, Vietkongu shpalli se do t'u bëjë thirrje RD të Vietnamit dhe miqve të tjerë të dërgojnë vullnetarë në Vietnam.

Mbledhje regjionale deri sot janë bërë nga partitë revizioniste të Vendeve Skandinave, të Amerikës Latine (mbledhja e Havanës) dhe nga ato të vendeve kapitaliste të Evropës (mbledhja e Brukselit). Këto mbledhje maskohen me Deklaratën e Moskës, e cila gjoja i lejon dhe i rekomandon këto lloj mbledhjesh, si edhe me problemet gjoja specifike të këtyre rajoneve të ndryshme. Në fakt, këto mbledhje janë konsekuenca logjike të përçarjes së lëvizjes komuniste ndërkombëtare nga ana e revizionizmit modern dhe të ecjes drejt përçarjes dhe specifimit të vetë revizionizmit modern në shumë qendra ose në policentrizëm, duke u përpekur që në këto «qendra të ndryshme» të arrihet në dominimin e një partie, e cila të influencojë dhe të

orientojë me vijën e saj revizioniste në shpartallimin e plotë të partive që bëjnë pjesë në këtë apo atë grupim.

Kështu ne mund të konstatojmë se në mbledhjet e partive revizioniste të Vendeve Skandinave të shquhet Partia Komuniste e Suedisë, e cila, duke u paraqitur disi «e rezervuar» dhe «independente në mendime», në thelb ka një orientim oportunist. Kurse në partitë revizioniste të Amerikës Latine, ne shohim që «partia e Kastros» të dominojë dhe të kërkojë të orientojë e të drejtojë partitë e tjera revizioniste të Amerikës Latine, të cilat e pranojnë deri diku këtë «leadership» më shumë për t'u maskuar dhe për të lustruar kështu kapitullimin flagrant të tyre. Kurse në mbledhjen regjionale të partive revizioniste të Evropës kapitaliste, këtu punët janë më të komplikuar, për arsyt e qenies së «dy Kamberëve në një derë», e dy partive të mëdha, asaj franceze dhe asaj italiane, të cilat, që të dyja, kërkojnë të dominojnë dhe nga pozitat e thella revizioniste të tyre ndeshen hapur me njëra-tjetrën.

Ç'fshihet prapa rezolutave të tyre? Vetëm një unitet formal mbi disa probleme ndërkombëtare dhe për të cilat mbahet një qëndrim revizionist-oportunist i theksuar. Kurse në realitet ato s'kanë asnjë unitet, përveç atij të luftës kundër partive tona marksiste. Këto parti revizioniste janë në pozita shumë të vështira përpara opinionit botëror, i cili sheh se qëndrimi i vërtetë i këtyre partive është proimperialist. Prandaj ato bëjnë të tilla mbledhje, për të afirmuar gjoja një qëndrim «revolucionar» ndaj problemeve botërore dhe për të

dhënë përshtypjen edhe të njëfarë uniteti, por edhe të njëfarë pavarësie nga «shkopi i dirigjentit».

Nga ana tjetër, udhëheqësit revizionistë të këtyre partive janë në gjendje të vështirë me vetë bazën e çdonjërës parti, e cila po pëson gradualisht katastrofën ku po e çojnë tradhtarët, dhe këta të fundit përpiqen jo vetëm t'i japin bazës një «orientim revolucionar», por që të gënjejnë më mirë, t'i japin përshtypjen se «ky orientim i vendosur revolucionar» është kolektiv, është «unitet mendimi dhe veprimi revolucionar» i shumë partive të një rajoni të caktuar me «specifika të njëjta» etj.

Në kulisa «dirigjenti», revizionizmi sovjetik, punon dhe influencon deri diku në vija të përgjithshme, por është e qartë se e ka humbur forcën dhe monopolin absolut të drejtimit. Revizionizmi sovjetik përpiqet të japë përshtypjen se nuk përzihet më si më parë, por kundër «fatkeqësisë» që i ngjau, ai detyrohet të buzëqeshë. Çështjet e përgjithshme dhe trajtimi i tyre prej këtyre grupimeve koordinohen me «këngën» e revizionistëve sovjetikë. Kjo është diçka dhe revizionistët sovjetikë janë të detyruar nga halli të pranojnë edhe kaq dhe të vazhdojnë të gënjejnë e të japin përshtypjen e «njëfarë uniteti» në mes tyre. Por ata s'kanë se si të mos shohin se në të tilla grupime partish revizioniste, divergjencat do të thellohen sa më shumë që të kalojë koha dhe do të zhvillohet rivaliteti në mes tyre. Revizionistët sovjetikë do të gjenden në rolin e «valltarit mbi litar», që s'do të dijë ç'anë të mbajë. Në këtë rrugë nuk ka si të mos thellohen edhe kontradiktat, rivalitetet me revizionistët sovjetikë dhe lëshimet

nga ana e këtyre. Të gjithë revizionistët janë pa parime, aleancat midis tyre nuk janë parimore, ato s'do të kenë kurrë baza të tilla, ato janë e do të jenë të lëkundshme, efemere, diskredituese për të gjithë. Të gjithë do të komprometohen dhe do të përlyhen nga vetë veprimet e tyre, të secilit veç e veç dhe të tjetrit; për një moment e për oportunitet do ta mbështetin njëri-tjetrin, por në një moment të mëvonshëm do të veprojnë në unitet flagrant me kapitalistët.

Pra, mbledhjet regjionale bëhen pa pëlqimin e plotë të revizionistëve sovjetikë. Në pamundësi që t'i kenë në zep të gjithë revizionistët, ata përpiqen të ruajnë lidhjet rublare me cilindo dhe shpresojnë që, duke i futur nën drejtimin e disa «lidërsipëve» «të karfosur mirë pas qerres sovjetike», të mundin të influencojnë plotësisht me dirigjentë «të ndërmjetëm». Por sovjetikët janë edhe në një hall tjetër të madh. Ata pësuan një disfatë të madhe në lidhje me thirrjen e mbledhjes së përgjithshme të partive komuniste të botës. Ata bënë mbledhjen shtatanike të marsit, e cila i dobësoi dhe i diskreditoi më shumë. Atëherë para opinionit botëror u vu çështja: Ku është forca e sovjetikëve? Ku është forca e gjoja shumicës? Kjo duket aq, ata s'e kanë as forcën, as drejtësinë, të cilat janë nga ana jonë, pse këndeje është marksizëm-leninizmi, kurse andej tradhtia dhe revizionizmi.

Përpara kësaj disfate sovjetikët janë të detyruar të pranojnë këtë ekspedient të mbledhjeve regjionale, duke shpresuar dhe duke bërë tentativa të panumërta, të organizojnë edhe një mbledhje me Kinën, me Korenë dhe me Vietnamin, gjoja për çështjen e vetme «ak-

tuale, imediate», të «mbrojtjes» së Vietnamit. Mirëpo edhe kjo tentativë djallëzore nuk u eci. Kjo mbledhje u refuzua dhe ata u detyruan sigurisht «të mblidhnin këmbët».

Sovjetikët kanë pasur dhe kanë shpresa te udhëheqësit vietnamezë e koreanë, dhe këtyre shumë u buzëqeshin, i lëmojnë, u bëjnë qejfin.

Çështja vietnameze është bërë për të gjithë revizionistët modernë *dada*-ja e shpëlarë e pushimit të polemikës dhe e përpjekjeve të pafrytshme të «afërimit revizionist me ne». Por manovra e tyre nuk u shkon. Ata, megjithatë, nën rrogosin e kësaj zhurme gjoja ant imperialiste dhe anti amerikane, po lidhin dhe po forcojnë marrëveshjet e fshehta me amerikanët, po kurdisin plane të reja, po ndërmarrin hapa që shpien në likuidimin e partive të tyre, po lidhin kontrata të majme me kapitalistët e ndryshëm, po lidhin aleanca me socialdemokratët, po marrin pjesë hapur në organizime të ndryshme kapitaliste me karakter ndërkombëtar.

Çështja e Vietnamit pra, është një perde për ta. Si konkluzion, edhe vendimet bajate që marrin partitë revizioniste në mbledhjet e tyre regjionale për Vietnamin etj., janë false, gënjeshtër, hipokrizi dhe u shërbejnë qëllimeve të tyre tradhtarë.

E SHITUNË
12 QERSHOR 1965*

Pozitat e imperializmit amerikan po dobësohen. Amerikanët po pësojnë disfata politiko-ushtarake kudo dhe, në radhë të parë, në Vietnamin e Jugut.

Bombardimet që ata bënë në RD të Vietnamit nuk u dhanë asnjë avantazh politik dhe ushtarak. Përkundrazi, ata pësuan fiasko. Shantazhi nuk u piu ujë. Ata s'mundën ta gjunjëzonin Vietnamin dhe as të ndihmonin sovjetikët në presionin e vazhdueshëm që këta revizionistë të çonin vietnamezët në bisedime me amerikanët. Në të kundërtën, bombardimet kanë demaskuar amerikanët, kanë rritur urrejtjen e vietnamezëve, i kanë kalitur këta dhe i kanë bërë të forcojnë mbrojtjen, rezistencën, përgatitjen dhe luftën. Përveç kësaj, këto bombardime të egra dhe të pafrytshme kanë lëkundur aleatët e Shteteve të Bashkuara, të cilët kanë filluar të flasin, të kritikojnë, të qortojnë, të këshillojnë. Brenda në Shtetet e Bashkuara të Amerikës politika e Xhonsonit ka krijuar pakënaqësi në opinion dhe disfatat e tij kanë shkaktuar dhe shkaktjnë komente të gjalla të hidhura për politikën agresive të presidentit amerikan. Popujt, natyrisht, kanë shtuar urrejtjen ku-

ndër imperializmit amerikan dhe, të gjithë ata që besonin në «forcën e tij të madhe», kanë humbur shpresat. Ndërhyrja brutale e amerikanëve në Santo-Domingo, manovrat e tyre të ndyra kanë shtuar dyshimin dhe urrejtjen e popujve dhe veçanërisht të popujve të Amerikës së Jugut. Të gjitha këto veprime barbare kanë qenë një kompleks, si një xhumbë në grykën e amerikanëve, që po i mbyt dhe po u zë frymën...¹

1. Këto shënime janë botuar të plota në librin: Enver Hoxha, «Superfuqitë», f. 160.

Sot kishim mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror. Një nga problemet që diskutuam ishte gjen-dja e kuadrit drejtues e specialist në kooperativat bujqësore të disa rretheve, si Gramsh, Librazhd, Tepelenë, Skrapar. Problemi i përgatitjes së kuadrit për bujqësinë është po aq i rëndësishëm sikurse edhe për industrinë, por në praktikë kujdesi dhe interesimi për kuadrin që do të punojë në bujqësi nuk është aq i madh sa në industri.

Në diskutimin tim¹ vura në dukje se si mund të zgjidhet drejt ky problem për çdo kooperativë, dhe se e gjithë kjo ka të bëjë me kuptimin dhe zbrëthimin drejt e gjer në fund të direktivës së Komitetit Qendror për këtë problem.

Fola, gjithashtu, edhe për punën e sektorit komunal². Të kënaqet syri kur shikon rrugët e pastra të Ersekës, ku isha muajin e kaluar, kurse s'ndodh kështu në Lushnjë. Përveç kësaj, edhe shokët e komunales nuk duhet të përqendrohen vetëm në ndërtimin e shtëpive të reja të banimit, por edhe në mirëmbajtjen e atyre ekzistuese dhe të ambienteve.

1. Shih Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 30, f. 76.

2. Po aty, f. 88.

Mbledhja e Byrosë Politike midis shumë çështjeve që diskutoi, mori në shqyrtim edhe punën e Partisë për edukimin e kooperativistëve me qëndrimin socialist ndaj punës dhe pronës së përbashkët në kooperativat bujqësore të rretheve Kukës e Dibër.

Ky është një problem mjaft i rëndësishëm, sepse ka të bëjë drejtpërdrejt me rritjen e prodhimit, prandaj nuk duhet nënvleftësuar e nuk duhet lënë pas dore. Përmirësimi i gjendjes në këtë drejtim është i domosdoshëm jo vetëm për këto dy rrethe, por edhe për rrethet e tjera. Duhet punuar akoma më shumë se deri tani, për t'i bërë njerëzit të ndërgjegjshëm, që ta kuptojnë të gjithë se çdo gjë arrihet vetëm me punë. Mundësitë për këtë janë. Njerëzit i kemi të mrekullueshëm, lypset ta përmirësojmë më tej punën me ta. Këtë çështje e trajtova në diskutimin tim¹.

Shqyrtuam gjithashtu edhe problemin e zhvillimit të mëtejshëm të shkencave shoqërore. Në fjalën time për këtë problem u ndala kryesisht në hartimin e Historisë së Partisë dhe në krijimin e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste².

1. Shih: Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 30, f. 95.

2. Po aty, f. 110.

E ENJTE
17 QERSHOR 1965

Sot u zhvillova shokëve disa ide për hartimin e një artikulli redaksional për konferencën e Algjerit¹ dhe si mbështetje për punën e ambasadorëve tanë që janë akredituar në disa vende afrikane.

1. Shih: Enver Hoxha, «Superfuqitë», f. 166.

E PREMTE
18 QERSHOR 1965

Ka rënë shi i mirë gati në gjithë republikën. Shi e bereqet.

E SHTUNË
19 QERSHOR 1965

Në Algjeri u bë një puç ushtarak. Koloneli Bumedien rrëzoi presidentin Ben Bela¹. Të shohim orientimet e tij.

1. Refleksionet lidhur me këtë ngjarje janë botuar në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Lindjen e Mesme», f. 23.

E MARTË
22 QERSHOR 1965

Mbledhja e Kuvendit Popullor që ka filluar qysh dje, vazhdon edhe sot. Pas diskutimeve rreth raportit¹ të mbajtur nga shoku Behar [Shtylla], shoku Bilbil Kłosi foli për Kodin e Familjes. Pastaj mbledhja kaloi në diskutime rreth kësaj çështjeje, si dhe për probleme të tjera.

1. «Mbi gjendjen ndërkombëtare dhe mbi politikën e jashtme të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë».

E MËRKURË
23 QERSHOR 1965

Edhe sot ishim në mbledhjen e Kuvendit Popullor. U aprovuan projektligje të ndryshme. Propozime për emërimet e ministri të reja.

Mbledhja e Kuvendit Popullor u dha fund punimeve.

E SHTUNË
26 QERSHOR 1965

U nisëm për në Durrës familjarisht. Fillojmë punimet e verës. Bën një vapë aq e fortë sa mezi durohet.

Konferenca e 2-të Afro-Aziateke u shty për më 5 nëntor. E sabotuan.

DURRËS, E DIEL
27 QERSHOR 1965

Vapa vazhdon të jetë e madhe ditën dhe natën. E pamundur të flemë. Në Tiranë është një vapë më e tmerrshme akoma.

Në të gjithë faqen e katërt të gazetës «Zëri i popullit» botohet sot artikulli «Të demaskohet gjer në fund qëndrimi me dy faqe i revizionistëve hrushovianë ndaj luftës së popullit vietnamez»¹. Në të ne godasim përpjekjet e përbashkëta të imperialistëve amerikanë e revizionistëve sovjetikë për t'i imponuar kapitullimin popullit vietnamez.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 131.

DURRËS, E MERKURE
30 QERSHOR 1965

Vapa filloi të bjerë ca. Nexhmija shkoi në Tiranë se nesër ka një mbledhje.

E HËNË
5 KORRIK 1965

Ka disa ditë që vazhdon të fryjë erë e fortë dhe përplasia e valëve të detit shkakton zhurmë të madhe.

Në mbrëmje bashkë me Nexhmijen u kthëm në Tiranë.

E MARTË
6 KORRIK 1965

Në Tiranë koha filloi të freskohet mirë. Diku duhet të ketë rënë shi, por jo te ne. Thatësira na e dëmton shumë bujqësinë.

E MËRKURË
7 KORRIK 1965

I dërguari i Uilsonit¹, deputeti Harold Deivis, u nis për bisedime në Hanoi. Të shohim ç'po kurdisin revizionistët sovjetikë e të tjerë.

1. Harold Uilson, në atë kohë kryeministër i Anglisë.

E PREMTE
9 KORRIK 1965

Ambasadori i SHBA-së në Vietnamin e Jugut, gjenerali Maksuell Teilor, dha papritur dorëheqjen. Në vend të tij, presidenti amerikan caktoi diplomatën e vjetër Kabot Lloxh. Me siguri ky ndryshim, në krye të ambasadës amerikane në Sajgon, është i lidhur me manovrat që po bëjnë imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë për të imponuar «paqen» në Vietnam.

E SHTUNË
10 KORRIK 1965

Sot inaugurojmë Hidrocentralin e Bisticës, që do t'i vëmë emrin e Stalinit. Në inaugurim do të flasë shoku Spiro Koleka.

E HËNË
12 KORRIK 1965

Bisedova me shokët dhe i porosita të marrin masa rigoroze për të vënë plotësisht në shfrytëzim sistemin e ujitjes që nuk është i vogël, por që disa herë është lënë në mëshirën e fatit. Një gjë e tillë nuk duhet lejuar.

Qendra
14 KORRIK 1965

E MËRKURË
14 KORRIK 1965

U konsultuam me Ramizin për fjalimin që ai do të mbajë në Kongresin e 9-të të Partisë Punëtore Rumune.

Vazhdon thatësira që po na dëmton shumë në bujqësi.

Qendra
15 KORRIK 1965

E ENJTE
15 KORRIK 1965

Ambasadori shëtitës dhe «i posaçëm» i presidentit amerikan Xhonson, Averel Harriman, është i kënaqur nga bisedimet që pati sot me Kosiginin e që zgjatën afro dy orë¹. Sigurisht ata po përgatitin një komplot të ri kundër Vietnamit.

1. Averel Harrimani mbërriti në Moskë më 12 korrik 1965 dhe u largua më 21 korrik 1965.

**E MËRKURË
28 KORRIK 1965**

Shoku Ramiz u kthye nga Rumania dhe më raportoi për zhvillimin e Kongresit të 9-të të Partisë Punëtore Rumune.

**E DIEL
1 GUSHT 1965**

Nisem me djemtë për në Pogradec.

POGRADEC, E HËNË

2 GUSHT 1965

Pogradeci çdo vit po zbukurohet. Sivjet janë bërë ndryshime të mëdha. Është spastruar gati gjithë plazhi nga shtëpitë e vjetra, është sistemuar gjithë parku, janë bërë parapete anës liqenit dhe gjatë bregut të liqenit është asfaltuar rruga. Në bllokun tonë janë ndërtuar dy shtëpi të reja të mira, komode dhe gjithë kjo punë është kryer pastër, bukur dhe lirë brenda 9 muajve.

POGRADEC, E ENJTE

5 GUSHT 1965

Pasi lexova dy artikuj që duhet të botohen këto ditë në shtypin tonë, i shkrova shokut Ramiz se artikulli për Harrimanin mund të botohet, nuk është realizuar keq¹.

Për sa i përket artikullit tjetër për titistët, mendoj gjithashtu se mund të plotësohet edhe me bisedimet e Titos me Shastrin², duke vënë në dukje mirë se, pasi Titoja koordinoi veprimet me sovjetikët, Harrimani shkoi në Beograd, kur ishte edhe Shastri atje, për të kontrolluar këto bisedime dhe për t'i «supervizuar» definitivisht.

Fryma e të gjithë artikullit duhet të tregojë **shqetësimin e madh të imperialistëve amerikanë dhe të revizionistëve sovjetikë** përpara disfatave të tyre të mëdha politike, ideologjike dhe ushtarake. Prandaj për këtë në ndonjë paragraf të ngjeshur të vihen në dukje

1. «Një Kemp Dejvid i dytë — diplomacisë së fshehtë tradhtarë revizioniste t'i çirret maska». («Zëri i popullit», 7 gusht 1965.)

2. Në atë kohë kryeministër i Indisë.

të gjitha këto lëvizje diplomatike dhe fjalime të shumta që nga Xhonsoni, Tito, Shastri, Kosigini e të tjerë, të cilët prapa frazave e demagogjisë fshehin disfatat, frikën, nervozizmin e tyre.

Artikulli të përpunohet duke marrë shkas nga kriza ekonomike jugosllave (ashtu siç është trajtuar, natyrisht duke e balancuar, pse qëllimi s'është të demaskohet kriza ekonomike jugosllave, por politika e reaktionit botëror), dhe mund të ndahet në dy kapituj kryesorë: kapitulli i parë, për problemin që është trajtuar, domethënë mballosja dhe tentativat për ta mbajtur në këmbë regjimin e falimentuar revizionist jugosllav, që të vazhdojë t'u shërbejë amerikanëve etj., dhe kapitulli i dytë, si konsekuencë e të parit, të tregojë detyrat e ngarkuara Tito-Shastrit nga imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë.

Ky çift (Tito-Shastri) me veprimet e tij synon:

a) Luftën kundër Kinës.

b) Mbështetjen e manovrës diplomatike të gjerë dhe të fshehtë të imperialistëve dhe të revizionistëve modernë për kapitullimin e Vietnamit.

c) Përpjekje nga të dy për të dhënë përshtypjen se njëri nga Evropa dhe tjetri nga Azia gjoja udhëheqin vendet «e paangazhuara» dhe u diktojnë e u sugjerojnë politikën ose frymën e kësaj politike të gjitha këtyre vendeve «të ndërmjetme».

ç) Përpjekje që, nën bajrakun e tyre, të konsolidojnë radhët e këtyre vendeve «të paangazhuara», që janë shthurur dhe s'i dëgjojnë më, ose disa i ndjekin për oportunitete koniunkturale.

Tito-Shastri me veprimtarinë e tyre përpiqen:

1) Me subvencionet e majme që marrin nga imperialistët amerikanë, nga revizionistët sovjetikë dhe nga të gjitha forcat e tjera reaksionare të jenë shembull për të gjithë kandidatët që duan të shiten te dollari dhe te rubla. Ata, pra, përpiqen të propagandojnë «bujarinë e padronëve të tyre të pasur», për të gënjyer dhe për të korrptuar njerëz, si merhumin Ben Bela, për të cilin derdhën lot ata dhe padronët e tyre.

2) Të tmerruar nga revolucioni i popujve dhe nga lufta nacionalçlirimtare, agjentët e imperialistëve amerikanë dhe të revizionistëve sovjetikë, Tito-Shastri, duke koordinuar plotësisht qëllimet dhe veprimet, përpiqen të forcojnë dhe të krijojnë kudo klika antipopullore, për të farkëtuar zinxhirë të rinj robërie për popujt, duke shfrytëzuar vështirësitë e tyre, duke nxitur armiqësitë, duke komplotuar dhe ngritur në sistem korrupsionin dhe subversionin.

Tito-Shastri punojnë aktivisht, kudo ku sovjetikët dhe amerikanët duan të fshehin dorën dhe veçanërisht në Afrikë.

3) Plani i tyre: të luftojnë dhe të izolojnë influencën dhe dashurinë që kanë popujt e botës dhe veçanërisht vendet e Afrikës dhe të Azisë për Kinën dhe për vendet e tjera socialiste si Shqipëria, që gëzon simpati të madhe në të gjitha këto vende për politikën e saj të drejtë parimore dhe për trimërinë e saj në luftë kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, për mbrojtjen e lirisë, të pavarësisë, të sovranitetit të saj socialist etj.

Në këto drejtime të demaskohet roli i Titos dhe i

Shastrit dhe të dalë nga kjo arsyeja e vërtetë që i detyron amerikanët dhe sovjetikët t'i ndihmojnë kaq «bujarisht».

Me një fjalë i vëmë në dy këmbë qëllimet përse financohet nga amerikano-sovjetikët çifti Tito-Shastri.

Titulli dhe nëntitujt të ndihmojnë për të vënë në dukje qëllimin e artikullit¹.

POGRADEC, E SHTUNË

7 GUSHT 1965

Sot vajta në festën e Devollit. Popull i madh ishte mbledhur në pyllin e Dëmbrevës, në Poloskë, për të festuar përvjetorin e formimit të batalionit partizan «Fuat Babani». Shumë entuziazëm për Partinë. Populli i Devollit është patriot dhe punëtor. Kooperativistët ishin veshur shumë mirë, nuk kishin asnjë ndryshim nga qytetarët në këtë drejtim.

Fola¹ para popullit shtruar, më se 2 orë. Theksova sidomos rëndësinë e bujqësisë si një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë sonë, forcimin e kooperativave dhe të demokracisë në to. Pastaj bëra një analizë të shkurtër të gjendjes ndërkombëtare.

Edhe fushat e Devollit po vuajnë sivjet nga thatësira.

Nga çdo kooperativë kishte grupe folklorike të mira. Kënduam dhe kërcyem bashkë me popullin. Ishte një kënaqësi e madhe për të gjithë. Në kthim u ndala ca në Korçë dhe në mbrëmje u ktheva në Pogradec.

1. Ky artikull nuk është botuar.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 151.

POGRADEC, E DIEL
15 GUSHT 1965

Filloi të bjerë ca shi në Pogradec. Sido që me vonesë dhe i paktë, por i freskon bimët.

Vajta në koncertin që dha kori i pleqve të Korçës në shtëpinë e pushimit. Më pëlqejnë shumë këngët e vjetra korçare, që këndohen nga ky grup koral, pse janë melodioze dhe sidomos më kujtojnë kohën e rinisë sime, kur i kam kënduar bashkë me shokë ato këngë. Bisedova me koristët pleq, të cilët m'u ankuan për drejtuesit e kulturës në rreth, që nuk i kanë propozuar për t'i dekoruar asnjëherë për veprimtarinë e tyre të frytshme e të gjatë. Kanë të drejtë, prandaj duhet ta korrigjojmë këtë të metë.

Kisha Adilin bashkë me vajzat e tij për drekë.

POGRADEC, E HËNË
16 GUSHT 1965

Bisedova me Behar Shtyllën dhe Halim Budon për zhvillimin e punimeve të sesionit të sivjetëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. I mbajta për drekë.

POGRADEC, E MARTE
17 GUSHT 1965

Gati në të gjithë Shqipërinë ka rënë shi në mënyrë të kënaqshme. Në Korçë ka rënë pak, kurse në Sarandë e në Gjirokastrë aspak.

Pas thatësirës së madhe që bëri, ky shi na duhej e na ndihmon.

POGRADEC, E ENJTE
19 GUSHT 1965

Prita sot dhe mbajta për drekë delegacionin e PK të Indonezisë, të kryesuar nga sekretari i KQ Anvar Kadir¹. Biseda shkoi mirë, por s'thanë asnjë fjalë kundër revizionistëve hrushovianë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 182.

Me gjithë sukseset e mëdha që kemi arritur në të gjitha fushat, me gjithë masat e ndryshme dhe të shumanshme që kemi marrë për përmirësimin e punës si në drejtimin e aparateve të Partisë, ashtu edhe në atë të pushtetit, përsëri makina, si me thënë, rënkon; diçka pengon që të ecet më me vrull, më me dinamizëm, më revolucionarisht. Mendoj se burokratizmi është ai që na pengon seriozisht, se ka filluar të na bëhet një sëmundje shumë e rrezikshme. A e kemi parë dhe a kemi bërë përpjekje për ta luftuar këtë sëmundje? Po, por jo sa duhet dhe si duhet. Veçanërisht në organet shtetërore burokratizmi, për shkak të presionit mikroborgjez, paraqitet më i rëndë, më kërcënues në mendime, në veprime dhe në organizim. Në organet e administratës shtetërore mendoj se janë krijuar hallka e «rripa» të padurueshëm, të dëmshëm, që ndrydhnin e fishkin iniciativën në punë dhe si në një magnet, rreth mendimit e veprimit burokratik ngjiten lloj-lloj pikëpamjesh e veprimesh të huaja dhe të dënueshme.

Kemi marrë masa shumë herë për t'i luftuar këto shfaqje dhe nuk mund të themi se s'kemi pasur rezul-

tate, por prapë jam i shqetësuar, se e shoh që rezultatet nuk janë aq sa duhet efektive, rrënjësore. Jam me pushime, por kjo gjendje më shqetëson, njëkohësisht edhe më ndihmon të reflektoj më thellë.

Përpjekje dhe luftë bëhen, Partia lufton heroikisht, por, për të luftuar burokratizmin, ndoshta ne nuk kemi zgjedhur rrugën më të mirë, nuk kemi kapur hallkën kryesore, kemi bërë veprime vetëm nga lart, ia kemi diktuar bazës, po nuk jemi mbështetur si duhet te kjo. Mendoj se bazës duhet t'i japim sinjalin për një aksion të madh masiv, me rëndësi të madhe shtetërore, ekonomike e politike dhe ajo ta zgjidhë këtë aksion nën udhëheqjen e Partisë, por pa «rripat» burokratikë dhe ferrat që të lidhin këmbët.

Kam menduar që ky aksion i madh duhet të jetë planifikimi i pesëvjeçarit të katërt. Partia, masat, kanë përvojë kolosale, këtë ta lëmë të zhvillohet me vrull. Kam bindjen se, pa u lidhur këmbët, duart dhe trurin Partisë dhe masave me «shifrat» tona, me «konkluzionet shkencore» të Komisionit të Planit, ato do të japin rezultate të mrekullueshme si politikisht, si ideologjikisht, si organizativisht, ashtu edhe ekonomikisht. Forca e Partisë dhe e masave është kolosale, «makina» e mrekullueshme duhet vënë në lëvizje.

Për këtë kam menduar dhe po reflektoj që ne, kur të kthehemi nga pushimi, t'u drejtohem Partisë dhe popullit me një thirrje të hapët dhe t'i udhëzojmë që vetë ata ta bëjnë projektplanin e ri pesëvjeçar, vetë ata të planifikojnë.

Kam bindjen e plotë se ky do të jetë një mësim i madh kolosal për ne, që do të na hapë sytë për mun-

dësitë reale të ekonomisë sonë, për rezervat e brendshme që fshihen, si fshihen, kush i fsheh, cili ka mundësi t'i zbulojë, t'i luftojë e t'i demaskojë ata që i fshehin.

Ky do të jetë një mësim i madh politik, ideologjik, organizativ, sidomos për drejtuesit e çdo shkalle, që kanë marrë nga një afsh burokratizmi, mendjemadhësie e hiqen sikur çdo gjë e dinë, çdo gjë e kanë parashikuar dhe që mendojnë se çdo gjë nuk realizohet si duhet jo për fajet dhe gabimet e tyre, por të masës, të punonjësve. Kjo do të na japë metodën dhe stilin më të mirë të punës për të kapur hallkat e tjera të zinxhirit, për t'i vajisur si duhet dhe për t'u hequr ndryshkun.

Ky mendim ma bën Pogradecin më të bukur, pse kurdoherë çdo gjë të duket e bukur kur e vë kokën mbi zemrën e Partisë dhe të popullit. Mbështetja në masat për çdo gjë dhe në çdo kohë të jep kurdoherë zgjidhje të drejtë dhe me plot sukses.

POGRADEC, E SHTUNE

21 GUSHT 1963

Kishim për drekë ambasadorin kinez me të shoqen, që po pushojnë këtu.

Kishim për darkë sekretarin e parë të Korçës, Petro Doden, dhe kryetarin e komitetit ekzekutiv Myftar Grabockën.

POGRADEC, E DIEL
22 GUSHT 1965

Vajta me djemtë në Korçë dhe pamë ndeshjen e futbollit midis Partizanit e Dinamos.

Nexhmija me Pranverën qëndruan në Pogradec. Koha është e vrenjtur, sido që në Korçë nuk ka rënë shi si gjetiu.

POGRADEC, E HËNË
23 GUSHT 1965

Koha u kthjellua. Liqeni është shumë i qetë. Fëmijëve u janë ngritur kuçot¹ për të shkuar në Tiranë, por unë me Nexhmijen do të rrimë edhe disa ditë.

1. U është ngritur mendja.

POGRADEC, E PREMTE
27 GUSHT 1965

Mbaruam pushimet dhe sot pasdreke nisemi për në Tiranë. Kohë vjeshte me shi. Në këtë stinë në Pogradec koha ka qenë e paqëndrueshme.

E ENJTE
2 SHTATOR 1965

Mora pjesë në pritjen e dhënë në hotel «Dajti» nga ambasadori i RD të Vietnamit me rastin e 20-vjetorit të shpalljes së Republikës Demokratike të Vietnamit.

E PREMTE
3 SHTATOR 1965*

Shtesë për fjalimin e delegacionit tonë në OKB

Lexova fjalimin që kryetari i delegacionit tonë do të mbajë në sesionin e këtij viti në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Porosita t'i shtohet këtij fjalimi pjesa që vijon:

Në kohën e sotme nuk mund të pranohet koncepti se një shtet i vogël duhet t'i nënshtrohet një shteti të madh, se një shtet i vogël, që të mund të fitojë të drejtën të rrojë në këtë botë, duhet të ndjekë verbërisht dhe me imponim politikën e një shteti të madh, se një shtet i dobët ekonomikisht duhet t'i nënshtrohet një shteti të fuqishëm ekonomikisht. Liria, pavarësia, sovraniteti, vetëvendosja, vetëqeverimi, vendimet politike të çdo populli, të çdo shteti të pavarur janë të papajtueshme me ndërhyrjen e hapët ose të maskuar, në çfarëdo forme qoftë dhe në çdo rrethanë. Mirëpo shtetet e mëdha kapitaliste dhe udhëheqës të degjeneruar shovinistë s'kanë hequr dorë nga kjo politikë e shtypjes, e shantazhit politiko-ekonomik, e ndërhyrjes brutale, e

makinacioneve të hapëta e të fshehta kundër popujve dhe shteteve sovrane. Ata vazhdojnë dhe luftojnë t'ia zgjatin jetën kësaj politike të ndyrë dhe bëjnë çmos ta kalojnë lehtë si një politikë «demokratike», e mbulojnë me parulla pseudopaqësore, pseudohumanitare, e mbështjellin me mantelin e pseudobashkekzistencës paqësore. Kjo politikë fsheh në vetvete agresionin, shantazhet, presionet politike dhe ekonomike, fsheh ndërhyrjet e armatosura, përgatit luftën dhe rrezikon paqen. ...!

I. Kjo shtesë është botuar e plotë në librin: Enver Hoxha, «Superfuqitë», f. 168.

E DIEL
5 SHTATOR 1965

Djemtë, që kishin shkuar qysh dje në Shkodër, sot u kthyen. Më thanë se kishin vizituar gati gjithë fabrikat e këtij qyteti. Ishin shumë entuziastë nga zhvillimi e përparimi që ka bërë Shkodra.

S'ka lumturi më të madhe sesa kur sheh atdheun tënd të lulëzojë, të përparojë.

E MARTE
14 SHTATOR 1965

Me shokët sekretarë të KQ diskutuam sot mjaft probleme. Një nga këto probleme, për të cilat edhe unë shfaqja disa mendime, ishte ajo e trajtimit dhe e sjelljeve të njerëzve tanë me specialistët e huaj. Sjellja jonë e mirë me ta nuk do të thotë se ne respektojmë ideologjinë e tyre, sepse ideologjikisht ne jemi në luftë dhe se ideologjia jonë marksiste-leniniste është shumë më e fuqishme, por me sjelljet tona të mira, ne tregojmë edukatën tonë, kulturën tonë. Kjo ka rëndësi të madhe.

Me specialistët e një vendi kapitalist, që kanë ardhur për të ndihmuar në një nga veprat e pesëvjeçarit tonë, ne duhet të jemi korrektë, të sjellshëm, të tregojmë karakterin e lartë të popullit tonë. Në punë le të na njohin më mirë se si jemi ne shqiptarët. Ata janë njerëz të borgjezisë reaksionare dhe vijnë në vendin tonë të angazhuar me kontratë, prandaj kuadrot tanë do të bashkëpunojnë me ta. Detyra jonë është që, gjatë kohës të qëndrimit të tyre në Shqipëri, të përfitojmë sa më shumë prej tyre, natyrisht nga pikëpamja

teknike. Sa më mirë të sillen shokët tanë me ta, aq më shumë do të mund të përfitojnë prej tyre.

Në këto marrëdhënie me ta në asnjë mënyrë nuk duhet të ulet vigjilenca, përkundrazi kjo duhet të jetë e gjallë, revolucionare dhe jo administrative. Edhe pse janë nga një vend borgjez, midis tyre ka dhe njerëz përparimtarë, njerëz që kanë simpati për ne dhe mund të na ndihmojnë kur ndonjë prej tyre nuk do ta bëjë mirë punën ose do të ketë qëllime të këqija, do të jetë i dispozuar të sabotojë. Prandaj vigjilenca të ngrihet.

Me sjelljet tona të mira, me vëmendjen tonë për të përfituar prej tyre teknikisht, t'u japim të kuptojnë specialistëve të huaj se ne, një vend socialist, qëndrojmë shumë më lart politikisht dhe ideologjikisht.

E MËRKURË
15 SHTATOR 1965

Në qytetin e Tiranës Partia ka shumë probleme, një nga të cilat është edhe ai i forcimit të punës me rininë dhe me inteligjencien. Për këtë çështje diskutuam edhe sot në Byronë Politike.

Raportoi shoku Rrapo Dervishi, të cilit iu bënë edhe pyetje. Doli që në kryeqytet tregohet kujdes i veçantë për rininë dhe inteligjencien, për edukimin dhe aktivizimin e tyre. Megjithatë mbetet shumë për të bërë.

Kërkesat e Byrosë Politike janë për një punë cilësisht të thelluar. Në diskutimin tim fola për punën e Partisë me shkrimtarët dhe artistët. Thëksova që këta kanë bërë mjaft përparime. Veprat e tyre janë me përmbajtje të pastër, përshkohen nga vija e drejtë e Partisë. Ata punojnë me vullnet, me pasion, me gjithë shpirt. Bëjnë përpjekje për më shumë kulturë, për krijime me nivel të lartë ideor e artistik.

Drejtuesit e Partisë duhet të qëndrojnë më afër shkrimtarëve dhe artistëve, të trajtohen ata ngrohtë e të inkurajohen. T'i ndihmojmë e t'i aktivizojmë në problemet që na preokupojnë. Ata mund të bëjnë shumë për edukimin e masave. Në kontakt me popullin do të përfitojnë edhe për vete, do të frymëzohen e mësojnë nga populli.

E ENJTE
16 SHTATOR 1965

Mbledhja e Byrosë Politike që ka filluar qysh dje, vazhdon edhe sot. Diskutuam për probleme të shumta e të ndryshme si «Mbi disa çështje të punës ideopolitike»¹ (raport i Komitetit të Partisë të Qytetit të Tiranës); mbi zbatimin e vendimit të Plenumit të Komitetit Qendror të nëntorit 1958 për përmirësimin racor dhe shtimin e prodhimit të mishit²; diskutuam për letrën që do t'i dërgohet bazës për mënyrën e hartimit të planit të katërt pesëvjeçar³ e për çështje të tjera.

Shqyrtuam edhe relacionin mbi disa dallime në trajtimin e kuadrove të arsimit e të shkencës në krahasim me ata të sektorëve të tjerë të pushtetit e të ekonomisë. Diskutova edhe për këtë çështje. Ky problem është shumë i madh dhe mund ta marrim në analizë edhe frontalisht, edhe të shkëputur. Por po ta marrim të shkëputur, siç na ishte paraqitur materiali, mund të bëjmë gabime, kurse po ta marrim frontalisht,

gabimet mund të jenë më të pakta. Prandaj gjatë diskutimit tim u shpreha dakord që këtë problem ta marrim frontalisht, kurse zbatimin ta bëjmë me periudha dhe të përgatitemi në mënyrë të shkallëzuar.

Me këtë rast shfaq mendimin se ne nuk duhet të rregullojmë vetëm raportin e pagave midis atyre që merren me punë mendore dhe punonjësve të prodhimit. Mendoj të shohim edhe përpjesëtimet midis qytetit dhe fshatit. Në qoftë se ne do të marrim masa që t'u presim rrugën teprimeve, favorizimeve etj., në të njëjtën kohë duhet të shikojmë edhe ndryshimet që ekzistojnë në nivelin e jetesës midis qytetarëve dhe fshatarësisë. Në asnjë mënyrë të mos lejojmë që të na krijohet kasta dhe shtresa të privilegjuara në qytete, si në raportin midis punëtorëve dhe inteligjencias, ashtu edhe midis qytetit e fshatit. Raportet duhet të shkojnë duke u harmonizuar. Kanë rëndësi të madhe në psikologjinë e njerëzve favorët që gëzon punonjësi në qytet, siç janë uji brenda në banesat, drita elektrike, shfaqjet kulturore, artistike, sportive etj.

Një situatë të tillë ne duhet t'i përgjigjemi duke nxitur shtimin dhe zhvillimin e madh të prodhimit në bujqësi. Të mos harrojmë se fshatarësia përbën shumicën dërrmuese të popullsisë.

Problemi i pagave është mjaft i ndërlikuar. Prandaj masat që do të marrim, duhet t'i peshojmë mirë. Diferencimi në paga përfshin një gamë të gjerë problemesh. Në radhë të parë duhet parë me kujdes nivelin e jetesës së njerëzve. Fondet që do të krijohen nga ulja e pagave të larta t'i përdorim për shtimin e prodhimit dhe jo për rritjen e rrogave të tjera, se

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 212.

2. Po aty, f. 225.

3. Po aty, f. 233.

po të bëjmë këtë të fundit do të futemi në një ingranazh të rrezikshëm. Gjendjen do ta përmirësojmë duke shtuar prodhimet, duke rritur fuqinë blerëse.

Korrigjime në paga do të bëjmë atje ku duhet. Në qoftë se rrogat e minatorëve, për shembull, janë në rregull, le të qëndrojnë aq sa janë, por në qoftë se duhen bërë disa ndryshime, do t'i bëjmë. Ose, në qoftë se një punonjës i thjeshtë në ndërmarrje merr 900 lekë, gati aq sa merr edhe një punonjës me përgjegjësi në rreth, natyrisht kjo nuk shkon. Prandaj korrigjimet do të bëhen të studiuara dhe me shkallëzime.

Njëkohësisht, duke parë në tërësi rrogat, të shohim edhe shpërblimet e pushimet suplementare, se më duket që në këtë drejtim ka vend për korrigjime. Byroja Politike ka vendosur që punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që kanë një punë shumë të lodhshme e të rëndë nervore, të kenë një trajtim më të mirë, një pushim më të madh. Mirëpo ky pushim tani është shtrirë tek të gjithë punonjësit e kësaj ministrie, pavarësisht nëse lodhen ose nuk lodhen të gjithë njëllë. Ky, më duket, është një privilegj që u bëhet atyre. Kështu nuk duhet ecur.

Natyra e punës së këtyre punonjësve nuk është njësoj për të gjithë. Për shembull, ata të hetuesisë, që marrin në pyetje armiqtë e klasës, të cilët bëjnë njëqind dredhira, lodhen më shumë. Pikërisht punonjësit e kësaj kategorie është e arsyeshme të kenë një pushim suplementar dhe jo si gjithë të tjerët. Prandaj në qoftë se jemi të bindur që t'u japim disa kategorie të punonjësve një pushim më të gjatë se të tjerët, duhet të caktohen edhe disa kritere, me qëllim që

pushimin suplementar ta marrin ata që e meritojnë. Kështu të veprohet për kategoritë e ndryshme të punonjësve.

Pra, ka ardhur koha t'i përcaktojmë drejt dhe t'i shikojmë mirë këto çështje. Natyrisht, ky studim nuk përgatitet dot as për një muaj, as për dy. Prandaj propozova që shokëve, të cilët do të punojnë për këtë studim, t'u japim 5-6 muaj kohë. Të mos nxitohemi, pse nxitimet dhe masat jo të matura janë të rrezikshme. Këto çështje t'i shohim si mjeku të sëmurin. Fakti është që të gjitha masat që ka marrë Partia, njerëzit tanë kurdoherë i kanë pritur shumë mirë, me një patriotizëm të madh. Kuadrot tanë dhe populli janë të vendosur në rrugën e Partisë, por duhet të jetë e qartë se do të ketë një numër njerëzish që do t'u cenohet interesi, prandaj të punojmë që ta kuptojnë të gjithë politikisht këtë çështje.

E SHTUNË
18 SHTATOR 1965

Shënime për shokun Hysni Kapo

Në lidhje me problemet e kooperativave bujqësore që bisedova me ty më duket se është e domosdoshme të studiojmë edhe çështjet e mëposhtme që janë të lidhura ngushtë dhe influencojnë te njëra-tjetra.

I. Çështja e planifikimit të kulturave bujqësore në kooperativat. Megjithëse kemi thënë që disa gjëra të rëndësishme të kulturave do t'ua planifikojmë nga lart, për arsyet që dimë dhe komitetet ekzekutive do t'ua sugjerojnë kooperativave, në realitet ua sugjerojmë të gjitha, ose ua planifikojmë të gjitha dhe kooperativat me disa «diskutime», i aprovojnë. Pra, në një mënyrë ose në një tjetër, si shtet ne kemi marrë përsipër çdo gjë edhe në këtë drejtim.

Tash, në rast se dëshirojmë që kjo metodë e re e planifikimit të arrihet dhe të zbatohet drejt, duhet të vëmë në lëvizje vetë kooperativën, sepse kështu do të ngjallet iniciativa e masave, do të rritet shumë interesimi i tyre për prodhimin, do të zhvillohet drejt ndjenja e pronës së përbashkët socialiste, e mbrojtjes,

e rritjes dhe e ndarjes së drejtë të saj sipas parimeve socialiste. Njëkohësisht, kështu do të lehtësohen kuadrot e pushtetit dhe të Partisë në rreth për disa probleme që u përkasin t'i kryejnë dhe do të kenë kohë të ndihmojnë më shumë e më drejt kuadrot e kooperativave se si ta kryejnë detyrën që u përket.

Sepse, kështu si është tani, të gjithë kanë përgjegjësi dhe asnjeri s'ka sa duhet edhe për atë që i përket në të vërtetë.

Pra, si konkluzion, në bazë të parimit të drejtë të planifikimit, duhet të rishikojmë praktikën dhe eksperiencën dhe të përcaktojmë më drejt cilat janë detyrat në planifikim të njerëzve të pushtetit dhe ato të njerëzve të kooperativave.

II. Duhet të rishikojmë më thellë, në praktikën e kooperativave, se si udhëhiqet nga instancat e zgjedhura, ose të emëruara, ky problem bazë i planifikimit, i zhvillimit të prodhimit, i ndarjes, i përgjegjësisë dhe i kontrollit të punës. Në parim, ne jemi në rregull, por në praktikë bëhen lëshime, gabime e mungesa që duhet t'i ndreqim.

Asambleja, në parim, është drejt, ajo mund që edhe mblidhet në rregull, por në praktikë, më të shumtat e kohës, është formale ose mblidhet sa për të qenë brenda parimit. Të tjerë vendosin e drejtojnë edhe për ato që i përkasin asamblesë. Këtë situatë duhet ta vëmë drejt, jo në teori, se në teori ajo është drejt, por në praktikë. Mendoj se propaganda për këtë çështje është një gjë, kurse organizimi i mirë i të gjithë ingranazhit në kooperativë është një gjë tjetër. Që të mund të zbatohet

drejt parimi, duhet organizuar më mirë praktika e punës. Këtu çalojmë. Dhe këtu e kam çështjen.

Ne kemi organizmat e punës dhe të drejtimin në kooperativa. Por në praktikë, këta organizma, a e kryejnë dot detyrën që u kemi ngarkuar dhe që do t'u ngarkojmë? Këtë çështje duhet ta analizojmë në bazë të praktikës dhe të të metave që na vërtetohen.

Për drejtimin operativ të punëve ne mund të bëjmë edhe korrigjime, por në përgjithësi mund që të mos kemi shumë gjëra për të korrigjuar. Kur bëhet planifikimi (ashtu sikurse bëhet edhe sot), kur vendoset një orientim, ne mbështetemi praktikisht te kryesia dhe konkretisht te kryetari. Këta marrin mendimin e njërit ose të tjetrit, pavarësisht në e pranojnë ose jo mendimin e tyre, por preokupohen, në radhë të parë, që të jenë në akord me njerëzit e komitetit, me planifikimin e komitetit dhe pastaj çështja formalisht shtrohet edhe në asamble. Në asamble, direkt ose indirekt, ai vete me autoritetin e Partisë dhe të pushtetit, kështu që në vija të përgjithshme puna ka marrë fund. Nga një situatë e tillë mund të rrjedhin shumë gjëra jo të mira, që krijojnë pakënaqësi të rrezikshme, që gabimet, arbitraritetet, arrogancat e një kryetari kooperative ose komiteti ekzekutiv t'i vishen indirekt Partisë ose pushtetit dhe vijës në përgjithësi.

Prandaj, ne duhet të organizojmë punën në mënyrë të atillë që kryetari të jetë efektivisht përgjegjës përpara asamblesë, e cila ta kritikojë ose edhe ta pushojë në rast se ai bën gabime etj. Asambleja të jetë e qartë, si në teori dhe në praktikë, se as Partia dhe as pushteti nuk janë të lidhur me gabimet ose fajet e

kryetarit dhe të kryesisë së kooperativës. Kështu, kryetari dhe kryesia vihen direkt përpara përgjegjësisë së kooperativistëve për detyrat e tyre dhe për pasojat që do të rrjedhin nga puna e tyre e mirë ose e keqe, pse janë kooperativistët që i kanë zgjedhur dhe i kanë zgjedhur që të administrojnë pasurinë e përbashkët socialiste me përgjegjësi të plotë morale e materiale, në bazë të ligjeve të shtetit socialist, të normave politiko-ideologjike të Partisë, në bazë të rregullave që ata i kanë formuluar, vendosur e pranuar vetë.

Përpara këtyre situatave të drejta kryetari dhe kryesia të kenë më shumë përgjegjësi ndaj familjes së madhe socialiste të kooperativës. Ata janë të detyruar (dhe ne si Parti dhe si pushtet do t'i mësojmë, do t'i ndihmojmë me të gjitha format dhe mjetet) të mbështeten fuqimisht dhe në mënyrë të organizuar në ndihmën e masës, jo vetëm në kohën kur mblidhet asambleja. Asambleja duhet të diskutojë dhe të vendosë për diçka që është studiuar, rrahur e peshuar nga të katër anët, jo vetëm nga kryetari ose kryesia, por nga një numër i mirë specialistësh (jo vetëm në kuptimin e specialistëve si agronom, veteriner, financier që po e po), dhe kooperativistësh të dalluar.

Një punë e tillë ka rëndësi kolosale, mendoj unë, për të përgatitur disa vendime kyç të përditshme të kooperativës.

Se si do të bëhet një punë e tillë, duhet gjetur forma. Për shembull mund të krijohet:

1. Këshilli i planifikimit të prodhimeve pranë kryesisë dhe pa diskutimin në këtë këshill, asnjë gjë s'mund

të paraqitet në asamble për diskutim dhe aprovim.

2. **Këshilli për planifikimin dhe zhvillimin e blegtorisë.**

3. **Një këshill për planifikimin e përditshëm të plehrave, të ujitjes, të farërave.**

4. **Një këshill financiar** që të studiojë, të vendosë për gjithë anën financiare të kooperativës, që nga ndarja e deri tek investimet.

Në këtë ingranazh do të marrin pjesë një numër i mirë kooperativistësh, ndihmës efektivë të çmueshëm të kryesisë që direkt ose indirekt janë përgjegjës përpara asamblesë, që moralisht e materialisht janë të interesuar që të pyeten dhe ta ndiejnë veten se marrin me të vërtetë pjesë në administrimin e pasurisë kolektive. Kështu, kryetari dhe kryesia do të rrethohen nga ndihmës, kurse tendencave të akraballëkut, arrogancës, mashtrimit moral ose material do t'u vihet fre, sepse janë nën kontrollin e masës. Nga ana tjetër, ne do të zhvillojmë dhe do të edukojmë në masë kooperativistët se si drejtohet një ekonomi e madhe socialiste bujqësore, si planifikohet, si zbatohet në jetë ky planifikim. Ata do të shohin më qartë vijën e drejtë të Partisë dhe të pushtetit, ndihmën e tyre kolosale materiale dhe moralo-edukative dhe do të dinë më mirë e më drejt ta çmojnë, ta përdorin e ta shfrytëzojnë këtë ndihmë.

Këta njerëz, në asnjë mënyrë nuk duhet të paguhen, sepse kjo është një detyrë shoqërore e domosdoshme dhe e lidhur ngushtë me interesin e përgjithshëm të jetës në kooperativë.

E gjithë kjo çështje jo vetëm është e drejtë, në parim dhe në praktikë, por bëhet e domosdoshme, si

për planifikimin e ri, që do punë dhe pjesëmarrje të gjallë, ashtu edhe për çështjen që kemi në studim, për uljen e ditëve fikse të kryetarit etj. Ulja e ditëve fikse, që është e drejtë, dhe ne duhet ta bëjmë ashtu siç kemi udhëzuar, nuk është një veprim i thjeshtë aritmetik. Kalojmë nga një situatë e favorizuar, në një situatë më pak të favorizuar, por të drejtë.

Prandaj, nuk mund të themi se nuk do të ketë konsekuenca në mentalitetin e kryetarit, pra mund të ketë konsekuenca që shprehen në rënien e punës së drejtimt, e shkaktuar kjo nga gjendja e krijuar nga zbritja e të ardhurave dhe nga koha që kryetari, tash pas këtij vendimi, do ta përdorë për të krijuar një «ditë-punë efektive». Dhe për këtë ai do të luftojë t'i shtojë, kështu që mund të na ndodhë fenomeni që kryetari të mos i kushtojë sa duhet dhe si duhet kohë drejtimt të punëve në kooperativë. Prandaj, duke e parashikuar edhe këtë eventualitet, ne duhet ta mbështetim kryetarin, jo materialisht siç e kishim, por me ndihmën e njerëzve. (Ndihma e këtyre njerëzve që edhe nuk paguhen, por e bëjnë këtë si detyrë shoqërore do të shërbejë veç të tjerash edhe si shembull për kryetarin, i cili do të shohë se ka njerëz që ndihmojnë pa u paguar, kurse kryetari që paguhet, duhet të kryejë detyrën.) Natyrisht kjo praktikë të eksperimentohet dhe të ndiqet në proces.

Ky problem bëhet i mprehtë edhe për arsyen e zgjerimit të kooperativave. Ne caktoam kush formon kryesinë, por krahas me zgjerimin e ekonomisë, nuk morëm masa paralele për fuqizimin e këtij drejtimi.

Mua më duket se një nga format është kjo që propozoj më lart.

Përveç çështjes së «ditëve fikse» të kryetarit ose të të tjerëve, mendoj se duhet të shikohen edhe pagat e specialistëve të lartë ose të mesëm që paguhen nga shteti me rroga fikse dhe këtë për t'i lidhur ata ngushtë me interesat e kooperativës dhe të prodhimit.

Unë propozoj që të gjithë këta financiarisht të shkëputen nga shteti ku të ruajnë vetëm sigurimet shoqërore dhe pensionet. Pagat e tyre të paguhen nga kooperativa (pa bërë asnjë ndryshim në rrogë, ose të ndryshojnë kur të bëhet ndryshimi që projektojmë për të gjithë). Në gjendjen e tanishme financiare kooperativat nuk mund t'ua paguajnë rrogën këtyre, po shteti atë fond pagash që ka caktuar për ta, t'ua kalojë kooperativave. Në ç'mënyrë?

1. Pa asnjë detyrim për kooperativat, vetëm është forma që mund të ndikojë në atë që specialisti moralisht dhe ekonomikisht e ndien veten të lidhur me kooperativën, sepse ajo ia jep rrogën. Kjo mund të duket si formale, po ka efekt psikologjik

2. Që të mos jetë formale dhe efekti psikologjik të jetë i plotë, atëherë shteti këtë fond pagash ia jep si kredi kooperativës me afate shumë të gjata dhe kjo, jo vetëm do të ketë efekt psikologjik por edhe vetë kooperativa, në këtë formë, do t'i kërkojë atij detyrë dhe punë më të kualifikuar e më me përgjegjësi, sepse e paguan me kredinë që i ka dhënë shteti. Kjo rrogë e dhënë në këto forma mund dhe duhet të lidhet nga ana tjetër me prodhimin e kooperativës. Si?

Mundet e tëra (si edhe kooperativistët e tjerë), natyrisht me disa forma të ndryshme.

Mundet një pjesë e rrogës të jetë fikse, tjetra e lidhur me prodhimin në norma të caktuara.

Mundet e tëra të jetë fikse, siç është sot, por të paguhet nga kooperativa, siç thamë më lart. (Kjo do të japë minimalen e efektit që kërkojmë të arrihet.)

Prandaj, mendoj t'i studiojmë më thellë këto çështje para se të vendosim definitivisht.

Mundet që disa gjëra nuk i kam sa duhet të qarta në bazë të praktikës së punës dhe pra të gaboj ose çel ndonjë derë të hapur, por në përgjithësi ku më shumë, ku më pak, ku në një formë, ku në një tjetër këto gjëra na vërtetohen. Rëndësi ka, sidomos në bujqësi, që herë pas here të bëjmë përgjithësimin e eksperiencës dhe korrigjimet e nevojshme atje ku duhen, për të ruajtur parimet që i kemi drejt dhe për të hapur perspektiva të reja zhvillimi, duke u bazuar kurdoherë fort në parimet.

Prandaj, shoku Hysni, i studio këto propozime dhe, ti që merresh direkt me këtë problem, ke eksperiencë dhe të dhëna të shumta e, sigurisht, do ta zhvillosh më gjerë e ta pasurosh atë, duke e korrigjuar atje ku mund të mos jetë aq ekzakt. Pasi ta kesh bërë, kur të vijë koha, mund të bisedojmë për të dalë me një gjë të plotë përpara Byrosë Politike dhe Qeverisë.

Rishikimi i ligjeve dhe i urdhëresave për kooperativat bujqësore

Ky rishikim të bëhet me kujdes, duke ruajtur çdo parim bazë në interesin e madh të forcimit të marrëdhënieve socialiste në fshat, në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë së përbashkët socialiste, në interesin e të gjithë republikës.

Jemi në fazën kur prona socialiste në fshat nuk ësh-të akoma pronë shoqërore e të gjithë popullit, siç janë fermat shtetërore, por pronë shoqërore e një grupi kooperativistësh të bashkuar vullnetarisht në kooperativat bujqësore.

Prandaj, ndryshe qëndron parimi i punës, i organizimit, i drejtimit, i planifikimit, i prodhimit, i pagave etj. në ferma (të gjitha këto të formuluara në ligje dhe në urdhëresa shtetërore) me ato të kooperativave bujqësore (pavarësisht se në disa raste, mund të kenë njëfarë ngjashmërie). Këtu nuk futet eksperiencia agroteknike, eksperiencia e mirë organizative, e përparuar në ferma, që jo vetëm duhet të merret nga kooperati-

vat, por, sidomos, të bëhen të gjitha përpjekjet që kjo eksperiencë e përparuar t'u përpunohet e t'u jepet kooperativave dhe këto ta adaptojnë.

Në këtë vështrim, në ligjet dhe në urdhëresat që kemi lëshuar për kooperativat bujqësore, duhet të dallojmë:

a) **Ligjet bazë që konsakrojnë parimet vendimtare për të qenë kooperativë dhe për të funksionuar si kooperativë bujqësore.** Këto janë definitive dhe s'mund të lëvizin, derisa të vijë koha që kooperativat bujqësore të bëhen pronë e të gjithë popullit.

b) **Një sërë ligjesh ose urdhëresash të rëndësishme, që përcaktojnë marrëdhëniet e shtetit me kooperativat bujqësore,** detyrime nga ana e kooperativave dhe detyrime nga shteti për disa çështje kryesore, siç janë detyrimi që toka të punohet, ose e drejta e ndërhyrjes së shtetit në planifikimin e disa zërave kryesorë, çështja e SMT-ve, detyrimet financiare në lidhje me kreditë e investimet nga shteti në bujqësi (për tokat e reja, për ujitjet që merren përsipër nga shteti, për farërat e zgjedhura etj.). Mund të shtohen edhe tregues të tjerë, por kurdoherë në atë mënyrë që këto të ekzistojnë me doemos në mes shtetit dhe një organizate shoqërore ekonomike. Këto ligje dhe urdhëresa bazë janë të domosdoshme sepse përcaktojnë në mënyrë të rregullt e parimore marrëdhëniet shtet-kooperativë bujqësore, përcaktojnë detyrimet e detyrat e të dyja palëve.

c) **Midis shtetit dhe kooperativave ka kontrata dhe marrëveshje të përhershme dhe të përkohshme,** të bazuara në ligj, i cili sipas klauzolave, të pranojë që ato mund të prishen kur shkelen detyrimet nga një

palë dhe në këtë rast paguhen sanksionet, ose të vazhdohen, ose, sipas konditave, të përmirësohen.

Në këtë punë ne duhet të bëjmë dallimet dhe t'i përcaktojmë mirë ligjet, urdhëresat, kontratat, rregulloret në mes kooperativave dhe shtetit, në mes enteve shtetërore dhe kooperativave brendapërbrenda ndërmarrjeve shtetërore që punojnë në kooperativa.

c) Ligjet dhe rregullat e veçanta që u përkasin vetëm për kooperativave bujqësore, duhet të udhëhiqen nga ligjet bazë të ekonomisë socialiste dhe t'u përshtaten formave të planifikimit, metodave të reja agroteknike, organizimit më të mirë të punës së prodhimit, financimit dhe investimeve etj., etj.

Këto çështje, mendoj unë, nuk duhet të kenë formën e ligjeve dhe të urdhëresave shtetërore, por të jenë ligje dhe urdhëresa të grupit shoqëror ekonomik, siç janë kooperativat bujqësore, të atilla që rregullojnë jetën dhe prodhimin brendapërbrenda kooperativës etj. Këto duhet të diskutohen dhe të pranohen nga vetë masa e kooperativistëve.

Këto nuk mund dhe nuk duhet të jenë në kundërshtim me ligjet bazë të shtetit dhe me rregulloret e kontratat e përbashkëta, por të harmonizohen me to, me interesin e përgjithshëm të socializmit. Në këtë mënyrë ruhen parimet jo formalisht, dhe nuk mbytet iniciativa me rregulla administrative të vendosura nga lart.

Ligjet dhe rregulloret e brendshme të kooperativave bujqësore, në përgjithësi dhe sidomos kryesoret, duhet të jenë të njëjta për të gjithë sistemin tonë

kooperativist, por kjo nuk duhet të ekskludojë ndonjë ndryshim, për shkak të situatave ekonomike, të konfiguracionit të tokës, ose të kushteve të ndryshme të punës. Këto mundet dhe duhet të pësojnë ndryshime, e kam fjalën, sigurisht, për ndryshime pozitive, të domosdoshme, sepse ato mund të kenë qenë të përshtatshme për një kohë, por me shtimin e prodhimit, me përmirësimin e metodave të punës, me zgjerimin e sipërfaqeve etj., kërkojnë që të ndryshohen e të përmirësohen.

Në praktikë mund dhe i kemi bërë këto, por kjo nuk përjashton të kemi ndonjë gabim. Eksperienca mund të na diktojë të bëjmë disa korrigjime për përmirësimin e tyre. Klasifikimi i tyre, siç propozoj më lart, mendoj se nuk është formal. Mua më preokupon çështja që ka raste kur funksionarë të pushtetit dhe të Partisë mendojnë dhe, sidomos veprojnë në praktikë, sikur kooperativa bujqësore është njëlloj si ferma shtetërore, sikur çdo gjë në të është e rregulluar dhe e drejtuar me ligje dhe me urdhëresa të ardhura nga lart dhe kooperativa vetëm sa i zbaton. **Respektimi i të drejtave të kooperativës bujqësore ka rëndësi të madhe parimore dhe psikologjike**, pse kemi të bëjmë me pronën e grupit dhe në qoftë se kuptohet dhe zbatohet drejt influencën drejtpërdrejt në forcimin e kooperativave, kurse në të kundërtën influencën për keq.

Planifikimi i detyrimeve në natyrë dhe i tepriçave që duhet t'i shesin shtetit kooperativat bujqësore.

Për këtë fola pak, në parim, në mbledhjen e fundit të Byrosë Politike, por ky është një problem me rëndësi, për të cilin ne duhet të reflektojmë dhe të mos

e marrim si një problem të thjeshtë aritmetik, domethënë planifiko kaq, prodho kaq, i jep detyrime shtetit kaq, i shit kaq teprica dhe tjetrën ti kooperativë mba-je për vete dhe shpërndaje. Ky është një problem i rëndësishëm parimor dhe ekonomik nga i cili varet prodhimi për ushqimin e të gjithë popullit.

Po të shqyrtojmë ligjet dhe urdhëresat në fuqi që rregullojnë këto probleme, mund të arrijmë në përfundim se duhen bërë korrigjime.

Për shumë prodhime, i kemi hequr detyrimet dhe i kemi lënë vetëm për disa kryesoret, siç është buka etj. Ky veprim ka qenë i mirë dhe i drejtë. Rrethanat e lypnin një gjë të tillë dhe do të bënim gabim po t'i hiqnim të tëra detyrimet. Mendoj se ato detyrime që kanë ngelur, duhet të vazhdojmë t'i mbajmë. Çmimet e këtyre gjithashtu i kemi caktuar. Ashtu siç i kemi, mund të jenë ca të ulëta, po fshatarësia e sheh që shteti investon shuma kolosale në bujqësi, u jep kredi të mëdha kooperativave bujqësore etj. Natyrisht me kohë Partia do të bëjë korrigjimet e duhura.

Niveli i jetesës së fshatarësisë na ka preokupuar, po kemi qenë dhe jemi larg një studimi, siç kemi bërë dhe po bëjmë për punonjësit e qytetit. Prandaj ta bëjmë këtë studim dhe, me shtimin e prodhimit, të marrim masa më të mira për furnizimin e popullsisë si në qytet edhe në fshat.

Të gjitha këto masa, mendoj unë, duhet të lidhen ngushtë me prodhimin bujqësor, me planifikimin e ri, me hapjen e perspektivave të reja në rrugën socialiste të zhvillimit të prodhimit bujqësor, me rritjen e interesimit konkret të masave kooperativiste për prodhi-

min, me shfrytëzimin e forcave maksimale në rrugë të drejtë për sigurimin e furnizimit të qytetit dhe të fshatit.

Ndryshimet e para, të drejta, që ne duhet t'u bëjmë kooperativistëve në ndarjen e prodhimeve ushqimore nga kooperativa, duhet të balancohen me shtimin gradual të prodhimit, të kompensohen me shtimin e prodhimit në ferma, ku duhet të jemi shumë rigorozë dhe ku na paraqiten mjaft të meta, neglizhenca dhe shpërdorime.

Vetëm duke mbajtur parasysh dhe duke zbatuar drejt këto orientime, jo vetëm do t'i zhdukim të metat, po do t'i hapim perspektiva të mëdha bujqësisë kooperativiste. Kështu kooperativat do të prodhojnë më shumë dhe më mirë për vete dhe për punonjësit e qytetit, do të lidhen akoma më fort me pronën socialiste, do të kuptojnë dhe do të zbatojnë më mirë ligjet e zhvillimit socialist të ekonomisë dhe do të zhduken më shpejt mbeturinat e pronës private, të prodhimit të vogël etj.

Roli dhe detyrat e kooperativave të konsumit

Kooperativat e konsumit janë organizata shoqërore tregtare të destinuara për tregtinë me fshatin. Këtë nuk duhet ta harrojmë asnjëherë, jo vetëm teorikisht, por sidomos në praktikë. Kuptimi dhe funksionimi i tyre i mirë ose i keq, influencon për mirë ose për keq në zhvillimin e prodhimit bujqësor dhe në mirëqenien e fshatit.

Kujdesi i vetëm i kooperativave të konsumit është të tregtojnë në fshat dhe të kenë iniciativa krijuese për t'i ardhur në ndihmë fshatit dhe për t'u shitur enteve tregtare shtetërore prodhimet e fshatit.

Furnizimet e fshatit me prodhime industriale nga entet e tjera shtetërore dhe nga importi duhet t'i planifikohen fshatit në bazë të nevojave të tij në përgjithësi dhe të sasisë e të nevojave që lypin shkëmbimet me prodhimet bujqësore, duke pasur parasysh rëndësinë e tyre të përditshme për ushqimin e popullsisë së qytetit. Ndarja e mallrave në fshat nga ana e kryesisë së kooperativave të konsumit duhet të bëhet me kri-

tere të shëndosha dhe jo kudo njëlloj, si atje ku fuqia blerëse është e madhe, ashtu edhe atje ku është e vogël. Tregtimi nuk mund dhe nuk duhet të pranojë «mykjen në vend» dhe rehati e zgjidhje burokratike.

Pa hyrë në hollësi, jam i sigurt se në punën e kooperativave të konsumit ka pluhur, që duhet shkundur e spastruar, të meta e shtrembërime, si në organizim, si në marrëdhëniet me entet shtetërore, ashtu edhe në marrëdhëniet me fshatarët.

Për sa i përket organizimit të tyre, mendoj se duhet parë çështja e dyqaneve në fshat. Këto janë mjetet kryesore të kooperativave të konsumit në kontakt me fshatin. **Pra, këto dyqane duhet të jenë shitëse dhe blerëse** (me pakicë ose me shumicë, me individët ose me kooperativat, me kontratë ose pa kontratë). Në atë masë që u përgjigjen fshatarët me prodhime bujqësore, në atë masë duhet edhe dyqanet t'u përgjigjen atyre me mallra e me të holla.

Nga ky parim dhe nga ky organizim nuk duhet të largohemi. E them këtë se, në qoftë se nuk gabohem, ka raste që dyqani i kooperativës së shitblerjes, vetëm shet ato mallra që i dërgon qendra e rrethit, që edhe kësaj ia ka dërguar ndërmarrja shtetërore, e cila ka marrë përsipër ta furnizojë sipas planifikimit kryesor. Në këtë mënyrë shitësi i dyqanit të kooperativës së shitblerjes që ka interes të mos e prishë me qendrën, i erdhi apo nuk i erdhi me kohë kontingjenti, i erdhi ose jo kontingjenti që u përgjigjet nevojave të fshatit dhe fuqisë blerëse të kooperativave bujqësore, që ai mbulon, as shqetësohet për këtë, por e mbyll dyqanin dhe e hap kur të dojë. Ka edhe ndonjë

të pandërgjegjshëm që me shumë marifete mendon si të vjedhë dhe kur vjen fshatari të blejë, i përgjigjet «s'kam nga ky e nga ai mall, s'ka ardhur akoma kontingjenti» etj., etj.

Dyqani diku blen me para në dorë edhe ngandonjë vezë nga fshatari, por në praktikë dyqani vetëm shet, ato që i dërgojnë dhe sa i dërgojnë nga qendra.

Bashkimet e kooperativave të konsumit në rrethe, lidhin kontratat me kooperativat bujqësore disa herë duke u nisur nga mendimi për një punë «të rehatshme» për vete, por me rreziqe për ekonominë. U thuhet: «Ju kooperativa bujqësore do të më sillni në depo këto prodhime dhe unë do t'ju jap lekët, por edhe disa materiale kryesore». Në teori kjo është «e bukur», por në praktikë ndodh që as kooperativa e shitblerjes, as bashkimi i konsumit nuk i respektojnë kontratat e firmuara. Në të holla kooperativa e konsumit është e gatshme t'ua paguajë prodhimet dhe ua paguan më shpejt, se vete në bankë dhe merr paratë nga shteti, të cilit i ka dorëzuar mallin, po për materialet e planifikuara si shkëmbim për prodhimet bujqësore, problemi paraqitet ndryshe. Ato shkelen vazhdimisht dhe është krijuar mendimi i gabuar (e janë marrë edhe masa ligjore) që kooperativa bujqësore, tepricat (që nuk janë detyrime) duhet t'i mbledhë dhe t'ia çojë kooperativës së konsumit, kur t'i dojë kjo. Kurse për nevojat e kooperativës bujqësore mbyllin një sy duke thënë se çimento do të dërgojnë kur të prodhohet, se me lëndën e drurit janë deficit këtë ose atë tremujor etj.

Një situatë e tillë s'është në rregull, një «rehati e burokraci e tillë» duhet zhdukur. Përveç kësaj, në

qoftë se do të vazhdohet kështu, atëherë në fshat do të dilet me dy organizma paralelë të të njëjtit karakter, me të njëjtat funksione, por me aparat të dyfishtë e të kushtueshëm. Pra, nga njëra anë është ndërmarrja e grumbullimit dhe nga ana tjetër kooperativa e konsumit, që bëjnë të njëjtën punë për grumbullimin e detyrimeve që teorikisht quhen teprica; (sepse nuk respektohen kontratat dhe, në fund të fundit, u jepen fshatarëve para në dorë, gjë që e bëjnë edhe ndërmarrjet shtetërore të grumbullimit).

Por, nuk është absolutisht në interesin e ekonomisë sonë ekzistenca e dy organizmave paralelë. Pra ndaj ose ta vëmë në rrugë të drejtë këtë çështje, ose të mbajmë vetëm njërin organizëm dhe materialet e planifikuara në kontratë t'u kalojnë dyqaneve të konsumit.

Megjithëqë parimet përgjithësisht i kemi drejt për këtë problem, mendoj se janë krijuar forma pune, organizime burokratike, që shtrembërojnë ndonjë nga këto parime. Rehatia administrativo-burokratike dëmton rëndë marrëdhëniet me fshatin, politikisht dhe ekonomikisht.

Të shohim dyqanet e shitblerjes në fshat. Në qoftë se nuk gabohem, këto nuk janë ngritur me plan, por tre këtu, pesë atje, asnjë në një vend tjetër, kurse për dyqanet në qytete është menduar më në rregull, bile preokupimi për to ka qenë deri atje sa që po të ishte e mundur t'u çohet njerëzve dyqani deri te dera e shtëpisë. Kurse për fshatarin, megjithëse themi që nuk duhet të zbrësë në qytet se humbet kohë dhe kur ai zbrët në qytet, e kritikojmë, e qortojmë,

prapëseprapë, dyqanet e kooperativave nuk i kemi ngritur të studiuara. Kështu, shumë herë, fshatarit i duhen të paktën dy orë të vejë e të vijë në dyqan për të blerë ca metra basme. Për këtë lodhje dhe humbje kohe të fshatarit pak preokupohemi, kurse preokupohemi shumë dhe alarmohemi kur disa qytetarë qahen se duhet të ecin një çerek ore për të vajtur në dyqan. Zakonisht qytetarët ankohen se «lodhen tetë orë në punë dhe s'kanë kohë të harxhojnë në dyqane». Po kooperativisti nuk lodhet, nuk panon dhe nuk ia ka edhe atij qejfi të pushojë pas punës? Ç'mendime të shtrembra!

Më kanë thënë se dyqanet e konsumit janë ngritur me disa «kritere» që secili të mbulojë dy, tri ose pesë kooperativa bujqësore. Ky mund të jetë deri diku një realitet i zbehtë, **po këto dyqane nuk janë hapur me kritere të shëndosha, prandaj duhet të rishikohen në bazë të popullsisë, në bazë të distancave, në bazë të ekonomive, në bazë të fuqisë blerëse.** Këtej del edhe madhësia e dyqanit, numri i kuadrove dhe planifikimi i mallrave.

Dyqani i kooperativës së shitblerjes, thuhet se është nën kontrollin dhe drejtimin e fshatarëve. Kjo ka mbetur thujse një parullë, ashtu sikurse kanë mbetur parulla këshillat e dyqaneve. Si janë nën kontrollin e fshatarëve dyqanet, kur disa shitës bëjnë si të duan? Shpeshherë fshatarin s'e pyet njeri, s'e dëgjon njeri dhe kur kërkon atë që i duhet, i thuhet: «S'kam». Kur çon mallin ta shesë, ka raste që i kthehet mbrapsht, se shitësi s'do që të ketë kokëçarje. I prishet malli fshatarit, s'mërzitet shitësi. Në goftë se vidhet dyqani

i kooperativës, atëherë edhe fshatarit mund të thotë: «Pse të interesohem, kur shitësi për mua nuk interesohet, le ta zbulojë vjedhjen policia».

Kjo është një situatë e patolerueshme dhe këtë e ka krijuar burokratizmi, administrata, urdhëresat e panumërta që, edhe sikur të jenë të drejta, dashur pa dashur po shtrembërohen.

Pra, duhet ta ndryshojmë rrënjësisht këtë situatë dhe jo me fjalë. Kjo situatë do të ndryshojë dhe duhet ta ndryshojmë, duke goditur me forcë «ujin e fjetur» plot mikrobe dhe kjo nuk mund të bëhet me një ose dy urdhëresa, prandaj Partia dhe fshatarësia, me rrugë revolucionare, duke vënë në vend parimet dhe gjithë ç'rrijdhin prej tyre, ta vënë në vend këtë situatë.

Të studiohen faktet, humbjet, shpërdorimet, prishjet dhe të nxirren konkluzione të drejta e të thella për t'i bërë rentabël kooperativat e konsumit, për t'i bërë sa më popullore e jo burokratike, të lidhura me masën dhe nën drejtimin e kontrollin e fshatarit, korrekte me të dhe me shtetin, të jenë dyqane me të vërtetë për fshatin, të lidhura me të gjitha prodhimet, me kontratat etj., etj.

Shteti me kooperativat e konsumit duhet të ketë marrëdhënie të drejta, të shëndosha dhe të jetë shembull ndaj tyre për disiplinën e planifikimit, për respektimin e kontratave.

Kooperativat e konsumit, as në teori dhe as në praktikë, në asnjë mënyrë nuk duhet të konsiderohen si organe shtetërore, t'u imponohen atyre urdhra jashtë ligjeve që përcaktojnë detyrimet reciproke, jashtë kontratave, urdhëresave etj. Duhet të gjenden mënyrat

dhe format që kuadrot e kooperativave të konsumit të mos e ndiejnë veten përgjegjës vetëm përpara shtetit, po edhe përpara kooperativistëve, përpara kooperativës dhe përpara Partisë, e cila duhet të interesohet shumë për kuadrin e këtyre organizmave në të gjitha drejtimet.

Kreditë dhe konditat bankare që u jep shteti kooperativave të konsumit nuk duhet të bëjnë të mendohet që këto kooperativa janë njëloj si ndërmarrjet shtetërore dhe të shkelen kontratat me to. As kooperativat të mos shkelen detyrimet ndaj shtetit, por as shteti të mos lejojë që ndërmarrja shtetërore t'i shkelë detyrimet e saj.

Të zgjerojmë aktivitetet e kooperativave të konsumit, flas kurdoherë në ndihmë të fshatit. Tani kooperativat e konsumit me prodhimet e fshatit bëjnë reçel, bëjnë turshi etj., për hesap të tregtisë shtetërore. Kjo është e mirë të vazhdohet, por kooperativa e konsumit duhet të mendojë, që jashtë këtyre detyrimeve, me prodhime që teprojnë, të prodhojë edhe për fshatin, sidomos për ato fshatra për të cilat përpunon lëndën e parë. Këtë aktivitet mund ta bëjë kooperativa e konsumit, por, mendoj se këtë mund ta zhvillojë edhe kooperativa bujqësore për përpunimin e disa prodhimeve ushqimore.

Në kooperativat bujqësore kemi krijuar një artizanat të vogël, si skuadrat e muratorëve etj. Pra, kemi eksperiencë dhe jo të keqe. Po, për përpunimin e prodhimeve ushqimore mendohet se ato duhet t'i bëjë shteti, duke grumbulluar lëndën e parë. Kështu jemi të ndërgjegjshëm që shumë prodhime na venë dëm, që ka pro-

dhime, të cilat shpërdorohen dhe iniciativa që mbyten.

Atëherë ç'duhet të bëjmë?

Baxhot në bazë të kontratave që kanë për qumështin, bëjnë djathë dhe vetëm ato, kur duan ato, sa duan ato. Këto duhet të vazhdojnë, po në mënyrë të leverdishme. Këto baxho duhet t'i kemi dhe t'i modernizojmë për të prodhuar djathë të mirë për qytetin dhe për eksport. Po monopolin e bërjes së djathit nuk mund ta kenë vetëm kooperativat e shitblerjes, të cilat duhet ta bëjnë gjithnjë e më mirë, por ne duhet të inkurajojmë e të ndihmojmë edhe kooperativat bujqësore që të bëjnë vetë djathë, duke krijuar për këtë çështje punishte të tyre. S'ka fshatar që të mos dijë të bëjë djathë. Atëherë, përveç asaj që kontraktin me baxhot (siç është rasti i qumështit), të inkurajojmë në kooperativat bujqësore bërjen e djathit. Ashtu siç bëhen në fshat shtëpi, stalla, le të bëhet edhe djathë, turshi, reçel, salcë etj. Dhe këto prodhime le t'u ndahen fshatarëve, t'i nxjerrin po të duan në dyqanin e kooperativës, ose po të kenë shumë, mund t'ia shesin shtetit (në rrugë të drejtë si teprica dhe jo si detyrime).

Ç'arrihet me këtë punë? Kooperativat bujqësore bëhen ekonomi komplekse, krijohen punishte fillestare, të cilat për nevojat e përditshme ushqimore të fshatarit do të zgjerohen. Duke punuar me teprica, me lëndë të para të oborreve, prodhimet e tyre do të jenë më të lira, kështu do të plotësohen shumë nevoja të kooperativistëve, do të lehtësohen barra dhe shpenzimet e mëdha shtetërore, nuk do të dynden kooperativistët në qytete për të blerë gjizë, djathë, reçel e shumë e shumë prodhime të tjera ushqimore.

Prandaj, duhet t'u futemi thellë këtyre punëve, asgjë s'na pengon, na pengojnë vetëm praktikat e shtrembërimet burokratike.

Edhe ky problem është i lidhur ngushtë me të gjitha problemet e bujqësisë dhe të fshatit. Asnjëra të mos merret e shkëputur, veças, vetëm për t'u studiuar, por është një qëllim kompleks.

Këto mendime që hodha këtu mund të rregullohen sipas të dhënave më ekzakta dhe të konkluzioneve të eksperiencës praktike. Prandaj shokët le t'u futen thellë gjërave, t'i analizojnë objektivisht, shkencërisht dhe të na dalin me propozime që të ndreqim punët, që këto të ecin më mirë. Suksese kemi pasur, por ky fakt nuk duhet të na pengojë të shohim të metat në punë e t'i korrigjojmë¹.

1. Në bazë të këtyre porosive të shokut Enver Hoxha kooperativat e konsumit, aktiviteti i të cilave në qytetet e mëdha i kishte kaluar me kohë ndërmarrjeve shtetërore të tregtisë, u larguan gradualisht edhe nga qytetet e vogla. Ato u shndërruan kudo vetëm në kooperativa shitblerjeje, për t'i shërbyer më mirë funksionit të dyfishtë — furnizimit të fshatit me prodhime industriale dhe grumbullimit të tepricave të prodhimeve bujqësore e blegtorale nga kooperativat bujqësore e fshatarësia. Brenda dy vjetëve, vetëm dyqane në fshat u hapën 1 217.

E PREMTE
24 SHTATOR 1965

Sot mora përgjigjen e një letre anonime, që e kishim dërguar në Durrës për t'u verifikuar nga ana e Komitetit të Partisë.

Na thonë se në këtë letër asgjë nuk është e vërtetë. Por në fakt vjedhjet vazhdojnë. Ky s'është verifikim serioz partie. Për mua përgjigjja nuk është bindëse. Në këto «jo të vërteta» duhet të ketë edhe të vërteta.

E HËNË
27 SHTATOR 1965

Pashë disa variante dekoratash të reja; një pjesë edhe mund të shkojnë, pasi t'u bëhen ca përmirësime. Të tjerat mendoj se janë pa shije, të mbushura me figura ushtarësh, policësh, pushkësh. Të mos ekzagjeronen. Në asnjë mënyrë të mos lejohet të vihet fytyra ime në dekorata.

E MARTË
28 SHTATOR 1965

Kemi protestuar nëpërmjet dy notave zyrtare pranë qeverisë çekosllovake për sabotimin e madh që na kanë bërë në turbinat e Hidrocentralit të Shkopetit. Deri tani asnjë përgjigje nuk kanë dhënë. Duhet të kemi kujdes se mos na janë sabotuar edhe turbinat e Hidrocentralit të Bistricës.

Duhet të dërgojmë ekspertë për të konstatuar shkallën e sabotimit të Hidrocentralit tonë të Shkopetit nga çekoslllovakët.

E MËRKURË
29 SHTATOR 1965

Asistova në koncertin që dha sot pasdite, në sallën e Teatrit të Operës dhe të Baletit, ansambli i këngëve dhe i valleve «Fronti» i Republikës Popullore të Kinës.

E ENJTE
30 SHTATOR 1965

Asistova në koktejin e dhënë nga ambasada kineze në selinë e saj, me rastin e 16-vjetorit të shpalljes së Republikës Popullore të Kinës. Pas përshëndetjes së ambasadorit Shy Gjien Guo, mbajta një fjalim.

E HËNË
4 TETOR 1965

Sot erdhi në vendin tonë një delegacion i PK të Zelandës së Re, me në krye sekretarin e përgjithshëm të kësaj partie.

Vajta e prita në aeroport.

E MARTË
5 TETOR 1965

Ç'po ngjet në Indonezi, s'po marrim vesh asgjë. Agjencitë e lajmeve dhe radiot e huaja përhapin konfuzion rreth ngjarjeve që ndodhën më 30 shtator. Asgjë të sigurt nuk dimë. As Pekini nuk di gjë, ose nuk na thotë neve.

E MËRKURË
6 TETOR 1965

Filluam bisedimet me delegacionin e PK të Zelandës së Re. Fola unë¹.

Në mbrëmje shkuam në koncert. E pëlqyen shumë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 239.

E ENJTE
7 TETOR 1965

Vazhdojnë bisedimet me delegacionin e PK të Zelandës së Re.

Shtruam drekë për nder të delegacionit, nga ana e Byrosë Politike.

Shumë pak lajme të sigurta kemi nga Indonezia. Edhe kinezët që kemi pyetur, gjithashtu na thonë se janë pa lajme. Nga agjencitë e huaja të lajmeve, të cilat, natyrisht, i marrim me rezerva, mund të bëjmë disa supozime, të nxjerrim disa konkluzione, por koha do t'i vërtetojë nëse janë ose jo të drejta.

Për «grushtin e 30 shtatorit» flitet se e ka organizuar zbulimi amerikan. Ka mundësi, pavarësisht se në fakt u vranë një numër gjeneralësh, kreu i reaksionit ushtarak, u plagos edhe Nasutioni, njeriu më me rëndësi i amerikanëve. Kjo sikur thuhet që të mos ngjallet dyshim se amerikanët kanë gisht në përpjekjet për të vendosur në Indonezi një diktaturë ushtarake të tyren, por për këtë s'ka asnjë dyshim. Reaksioni ushtarak në Indonezi është përpjekur gjatë gjithë kohës që të marrë

fuqinë në dorë. Momentet ndërkombëtare e kombëtare aktuale, atij dhe imperialistëve amerikanë e revizionistëve sovjetikë, ua diktonin më tepër se kurrë ta bënin tani një puç të tillë. Thuhet se reaksioni ushtarak indonezian kishte vendosur të vepronte më 5 tetor, ditën e festës dhe kishte sjellë forca të shumta në Xhakarta gjoja për paradë.

Thuhet gjithashtu se Partia Komuniste e Indonezisë e «përshëndeti këtë puç» të U Tungut të 30 shtatorit, si një gjest «patriotik dhe revolucionar», më vonë (5 tetor), e cilësoi si «grindje në mes ushtarakëve» dhe se ajo «s'kishte marrë pjesë». Kjo mund të jetë e vërtetë, mundet që ky puç të jetë organizuar nga Sukarno, pa dijeninë e Partisë Komuniste të Indonezisë, duke kërkuar në mënyrë puçiste të likuidonte kundërshtarët e tij, më të rrezikshëm aktualisht. Në qoftë se Partia Komuniste e Indonezisë ka qenë në dijeni të këtij «puçi», pa marrë pjesë në të, ajo është treguar naive që s'ka marrë masa për të përballuar çdo të papritur. Në fakt ndodhi e papritura: reaksioni ushtarak, me gjithë humbjet, kundërveproi me shpejtësi dhe mori pushtetin në dorë, futi në ilegalitet partinë dhe filloi terrorin.

Partia Komuniste e Indonezisë, mendoj unë, është treguar shumë naive, e lëkundur për veprim dhe ka pasur besim të tepruar, pra të dëmshëm, te Sukarnoja dhe te NASAKOM-i¹. Sukarnon, një udhëheqës borgjez, partia e ngrinte në qiell, pse dhe Sukarnoja, për interesat e tij imediatë dhe të largët, u hidhte «lule»

1. Bashkim i nacionalistëve, i partive fetare dhe i komunistëve.

komunistëve dhe veçanërisht Aiditit. Partia kishte një vijë të drejtë për NASAKOM-in, por udhëheqja e kishite të tepruar besimin në të dhe kishte arritur në mendimin që mund të merrte edhe pushtetin në rrugë paqësore. Kjo, mendoj unë, e kishte vënë ca në gjumë partinë, udhëheqja ishte optimiste më tepër se ç'duhej, mund të them dhe se e kishte mbuluar një vetëkënaqësi e dëmshme dhe një mbivlerësim i forcave të saj e nënvleftësim i forcave të kundërshtarit. Kundër revizionistëve sovjetikë nuk flisnin hapur, me gjithë të këqijat e mëdha që ata u bënin. Pse? Mendoj se Partia Komuniste e Indonezisë nuk e shikonte drejt rrezikun e revizionizmit sovjetik, «marrja e pushtetit në rrugën paqësore» e zbuste luftën e saj kundër revizionistëve sovjetikë dhe ajo kishte arritur deri atje sa të hidhte edhe parulla si «indonezianizimi i marksizëm-leninizmit». Këtë parullë përpiqeshin ta shpjegonin, por në fakt, sido që mund të përpiqesh ta interpretosh, kjo parullë, ashtu si shtrohej prej tyre, ishte centriste, ishte parullë «specifike» për të arsyetuar pozitat e tyre, jo shumë të qarta.

Por, përveç të gjitha këtyre, Partia Komuniste e Indonezisë neve na kishte thënë se ishte në dijeni të komplotit që po organizonte reaksioni ushtarak, ishte e përgatitur për këtë, bile aq «e përgatitur» sa i kishte propozuar Sukarnos t'i «linin ushtarakët të vepronin, le ta mbanin dhe fuqinë ndonja 10 ditë, të diskreditoheshin dhe pastaj t'i likuidonin». Autentike! E habitshme! Atëherë ne nuk mund të jemi shumë të bindur se Partia Komuniste e Indonezisë nuk dinte gjë etj.

Është fakt se kundërgrushti reaksionar e gjeti Partinë Komuniste të Indonezisë jo të përgatitur. Mund të mos jetë kështu dhe urojmë që të mos jetë kështu, pse ne nuk dimë ç'bën partia, si vepron ajo. A e mori veten? A godet? A lufton? Të gjitha këto janë të panjohura për ne. Por në këto situata, si u zhvilluan ngjarjet, unë mendoj se Partisë Komuniste të Indonezisë do t'i duhet të kalojë nga një situatë paqësore, në një situatë lufte dhe kjo kohë do të jetë e gjatë ose e shkurter në vartësi nga përgatitja e saj për këto eventualitete. Partisë Komuniste të Indonezisë do t'i duhet të luftojë. Duhet të fillojë revolucionin i vërtetë dhe ky duhet të shkojë deri në fund. NASAKOM-i mbaroi, Sukarnoja gjithashtu. Revolucion nën udhëheqjen e partisë — kjo është kryesorja, vendimtarja. Sukarnoja dhe pjesëtarët e NASAKOM-it, në qoftë se «do të mbajnë» anën e popullit, duhet të vihen nën drejtimin e revolucionit, në një formë të re dhe me një vijë të re revolucionare. Ndryshe humbi revolucionin dhe Partia Komuniste e Indonezisë. Në qoftë se kjo do të vazhdojë të ketë shpresë te Sukarnoja, te NASAKOM-i, si më parë, ajo do të ecë drejt likuidimit si parti marksiste-leniniste.

Sigurisht, lufta dhe revolucionin do të kenë shumë zigzage, të përpjeta dhe të tatëpjeta, por këto do të kapërcehen me sukses në rast se partia dhe udhëheqja e saj qëndrojnë në pozita të forta marksiste-leniniste, revolucionare deri në fund. Në qoftë se Partia Komuniste e Indonezisë u bën lëshime Sukarnos dhe revizionistëve sovjetikë, në qoftë se ajo ka frikë nga revolucionin dhe

nga lufta dhe hyn në bisedime e në kompromise, atëherë ka nënshkruar dënimin e saj e të popullit të vet. Ne urojmë që të mos ngjasë kështu, që Partia Komuniste e Indonezisë të luftojë me heroizëm deri në fitore. Ne do të jemi me të në këtë rrugë të drejtë të luftës dhe të revolucionit. Koha do të na tregojë se ç'po bëhet atje dhe si vepron Partia Komuniste e Indonezisë në këto momente historike.

E DIEL
10 TETOR 1965

Sot në mbledhjen e Byrosë Politike aprovaam raportin që do të mbahet në Plenumin e KQ për letërsinë dhe artet. Propozova që raportin ta mbajë shoku Ramiz, dhe kështu u vendos.

Në rend të ditës kishim edhe disa probleme të tjera, rreth të cilave diskutuam. Edhe unë, si shokët, ngrita disa çështje, ndër të cilat:

1. — Ndërmarrjet nacionale vërtet varen nga qendra, por themeli i tyre është në rreth, ato atje rrojnë, atje prodhojnë. Prandaj kontrolli dhe ndihma e rrethit janë të domosdoshme.

2. — Komitetet ekzekutive të rretheve të kontrollojnë veçanërisht në disa drejtime të realizimit të planit e të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të tilla siç janë fuqia punëtore, lënda e parë etj.

3. — Të forcohet kontrolli sidomos për mbrojtjen e pronës socialiste. Ka vjedhje e dëmtime. Ne duhet të dimë: kush janë ata që vjedhin dhe ku bëhen vjedhjet, se kjo ka rëndësi për të nxjerrë konkluzione për punën e Partisë e të levave të saj.

E HËNË
11 TETOR 1965

Po përgatitem për mbledhjen e afërme të Byrosë Politike. Duke pasur parasysh materialin që më është dhënë, mendoj të përqendrohem në disa çështje kryesore:

— Duhet forcuar seksionet e planit pranë komiteve ekzekutive, duke marrë punonjës edhe nga ndërmarrjet nacionale, natyrisht pa i lënë këto pa gjë. Seksionet e planit të mos jenë kudo njëjloj.

Plani i ndërmarrjes nuk duhet të bëhet pa pasur dijeni seksioni i planit në komitetin ekzekutiv.

Komiteti ekzekutiv i rrethit (seksioni i planit) duhet t'ia dërgojë vërejtjet për planin jo ministrisë përkatëse, por Komisionit të Planit të Shtetit.

Komiteti ekzekutiv (seksioni i planit) duhet të kontrollojë veçanërisht disa drejtime të realizimit të planit.

Ndërmarrja nacionale duhet të ketë lidhje të dyfishta, edhe me ministrinë nga e cila varet, edhe me organet drejtuese të pushtetit në rreth.

Komiteti ekzekutiv duhet të vihet përpara përgjegjësisë dhe të detyrohet të plotësojë të gjitha nevojat

e ndërmarrjeve nacionale, që i takon të plotësojë, si për fuqi punëtore, për lëndë të parë etj.

Duhet të gjejmë mënyra pune të efektshme që në mes ndërmarrjeve nacionale dhe komiteteve ekzekutive të rretheve të mos mund të krijohen kompromise dhe familjaritete në planifikim dhe në realizim.

— Qëndrime arbitrare të kundërligjshme dhe jopolitike ndaj disa kooperativistëve (siç është, për shembull, heqja e kopshteve personale disa familjeve). Kontrollon një numër familjesh për të gjetur një vjedhës misri (!). Ofezë e madhe!!

— Çrregullime në sektorin e tregtisë, burokratizëm, por sidomos mungesë kontrolli dhe familjaritet i sëmurë në mes drejtuesve të tregtisë dhe të kooperativës së konsumit.

— Kërkesat e fshatarëve. Si shpjegohen dhe si plotësohen këto kërkesa (për vaj, makarona etj.).

— Kuptim i njëanshëm i punës politike me masat: vetëm sqarim politik.

— Raportin për gjendjen politike në rreth e bën kryetari i degës së punëve të brendshme, në vend që ta bëjë sekretari i parë. Ç'del nga kjo metodë pune?!

— Format e punës politike. Flitet shumë për gjetje formash të reja, por qëndrohet në të vjetrat, masive, të përgjithshme, diku gati të detyrueshme, kurse duhet të bëhen tërheqëse.

— Nga organet e kontrollit e të revizionit, të cilave po u bëhen aq elozhe, nuk duhet të nënvleftësohen krimet që ngjasin kundër pasurisë socialiste. (Ç'na ngjau në sharrat e Pukës.)

Një konkluzion absurd: sa më i madh të jetë rrethi,

aq më të mëdha do të jenë vjedhjet. Kësaj i thonë të përlligjshëm vjedhjet.

Prandaj me njerëzit, në radhë të parë, duhet bërë punë e dëndur ideopolitike, edukative bindëse e jo të kalohet menjëherë në masa administrative, ndryshe edhe ligjet e shtetit nuk zbatohen si duhet.

Në Peqin, në kooperativën e konsumit caktohet për të punuar një njeri që ka qenë i dënuar pesë herë për vjedhje (!!).

Përsëritësit të dënohen rëndë dhe të mos u falet dënimi, por ta kryejnë atë deri në fund.

— Raporti trajton gjendjen e normave, ka karakter informativ. Ç'mësime duhen nxjerrë dhe rrugët që duhet të ndiqen për pesëvjeçarin e ardhshëm.

Forcimi i mëtejshëm i regjimit të kursimit.

a) Përmasat e mëdha që do të marrin kërkimet gjeologjike, prodhimi, ndërtimet, shërbimet etj.

b) Në strukturën e prodhimit peshën më të madhe do ta ketë industria e rëndë, nxjerrëse e përpunuese.

Pakësimi i importit.

Rezervat duhet të kërkohen në shumë drejtime, por veçanërisht:

a) Në përdorimin racional të lëndëve të para të materialeve kryesore, ndihmëse dhe të lëndëve djegëse.

b) Në pakësimin e humbjeve joteknologjike të firove natyrale.

Firot natyrale — firot legale.

Që nga ndërmarrjet prodhuese deri te përdoruesi.

Nga përdoruesi deri në konsumin përfundimtar.

Me vendim janë caktuar shifrat maksimale për firot

dhe këto janë legalizuar e mbahen parasysh në planifikim, sidomos në planin e shpërndarjes.

Në plan veprohet në mënyrë empirike, caktohet një shifër mesatare, që prodhuesit të kenë kontingjentin e mjaftueshëm për të përbulluar firot që mund të lindin.

Në planet e shpërndarjes pasqyrohen të gjitha firot, që nga prodhuesit deri te përdoruesit. Për lëndë të tilla, si hekur-nikel, krom, qymyr etj. akoma nuk është përcaktuar kujt i takon firoja, prodhimit apo transportit. Këtu, pra, s'janë bërë përpjekje.

Firot e grupit të dytë (nga përdoruesi deri te konsumi përfundimtar) përfshihen në normat e furnizimit të ndërmarrjes. Por nga përcaktimi i drejtë i firove natyrale varet edhe vlera e materialeve të nevojshme për prodhim.

Pra, puna duhet të bëhet jo vetëm në studimin dhe vendosjen e normave teknike të bazuara, por edhe në llogaritjen e saktë të firove natyrale. Këtu ka lidhje të ngushtë.

Statistika nuk ndjek në mënyrë të posaçme realizimin e firove natyrale dhe këto nxirren në mënyrë të tërthortë, me anën e gjendjes kontabël.

Pra, firot përdoren për të balancuar gjendjen, për ta përputhur me inventarin fizik.

Del kështu që u kemi lënë dorë të lirë punonjësve të tregtisë të manipulojnë me shifrat, gjë që rëndon ekonominë.

Me firot natyrale shpjegohet edhe një pjesë e deficiteve dhe e suficiteve në sektorin e tregtisë, në kooperativat e konsumit në grumbullim etj., prandaj në

goftë se nuk do të marrim masa, ky bëhet një problem shoqëror.

Firot në bujqësi. Aprovimi ligjor i tyre.

Firot në grumbullim. «Zbritja e lëndëve të huaja», kompensim edhe firot legale, të realizuara në fakt, dhe deficitet e krijuara. Kështu këto rezultojnë me teprica.

Koha kur janë përcaktuar firot. Aprovuar më 1961, studimi filloi më 1958. Tani kushtet në sektorin e tregtisë kanë ndryshuar, baza tregtare është forcuar, përveç të tjerave, edhe me pajisje moderne si frigoriferë etj., prandaj problemi i firove duhet të studiohet dhe këto të mos ekzistojnë më.

[12] TETOR 1965¹

Lexova projektletërën e Komitetit Qendror që mendohet t'i dërgohet bazës për hartimin e planit të katërt pesëvjeçar.

Ideja ime bazë për këtë letër ka qenë mobilizimi total i njerëzve **për të planifikuar drejt, realisht planin pesëvjeçar, duke shfrytëzuar të gjitha rezervat e brendshme, materiale dhe njerëzore.**

Kjo letër, sipas mendimit tim, duhet të ishte shumë konkrete për çdo sektor, në bazë të eksperiencës së planifikimit dhe të realizimit, pa konsiderata të gjata moralo-politike ose ideologjike, të cilat i kemi thënë, do t'i themi në kongres e gjetkë.

Çështja, për mendimin tim, ishte që përpunimin e shifrave orientuese nga baza, kjo letër ta ndihmonte konkretisht, me të mirat dhe me gabimet e vërtetuara. Kjo do të bënte që baza dhe, kur themi baza, jo vetëm drejtoritë e ndërmarrjeve me këshillat teknikë, ose drejtuesit e fermave e të kooperativave, por tok me ta edhe njerëzit më të mirë të sektorëve të prodhimit, të

1. Nga përmbajtja e tyre del se shënimet janë mbajtur para mbledhjes së Byrosë Politike të Komitetit Qendror, që u zhvillua më 15 tetor 1965.

planifikojnë, por jo me forma burokratike, rutine, ose me mendimin për të qenë brenda, ose për të ulur planin, në krahasim me shifrat orientuese që janë dhënë, dhe të bëjnë kërkesa të fryra, të ekzagjeruara, të parealizueshme. Një ndihmë e tillë e frymëzuar e revolucionare, ndaj bazës, do të na plotësonte si duhet detyrën e madhe të planifikimit, do të na hapte perspektiva të sigurta. Plani që do të marrim për të studiuar pas kësaj do të ishte më real, më i bazuar.

Eksperienca na ka treguar se në bazë të planit pesëvjeçar, pasi kemi vendosur planet vjetore, kemi dhënë, më vonë, udhëzime për studime më të thelluara, për shtesa plani, për ulje kostoje, për shfrytëzim rezervash të brendshme, për kursim etj. dhe masat punonjëse u janë përgjigjur këtyre kërkesave pozitivisht, duke arritur rezultate të shkëlqyera, që janë shprehur në miliarda lekë. Këto na janë dukur si të falura, po në fakt kanë qenë rezerva të brendshme, të mundshme, të planifikueshme që më parë, para se të vendosej plani. Fakti që këto nuk u planifikuan si duhet që më parë, tregon se masat punonjëse nuk u mobilizuan gjallërisht në kohën e planifikimit.

Një fjalë e urtë thotë: «Më mirë vonë se kurrë!» Kjo është një gjë, po më e mira është «më mirë shpejt se vonë», që ky mobilizim të bëhet më parë, që kur hidhen bazat e planit. Por edhe më vonë, përsëri e përsëri duhet mobilizim për të shfrytëzuar akoma më shumë rezervat. Një mobilizim i tillë do të shkundë «zyrtarët» dhe do të luftojë frymën burokratike e rutinën në planifikim, rutinën e shifrave të renditura. Drejtuesit do të jenë nën presionin e masës, e cila krijon e

lufton me vështirësitë dhe është armike e burokratizmit, e idesë që çon në zgjidhje «për të qenë brenda» dhe «për të mos i prishur qetësinë qendrës planifikuese».

Kjo letër duhet të nxitë pikërisht frymën e shëndoshë dhe revolucionare në planifikim dhe t'u tërheqë vërejtjen veçanërisht shokëve të udhëheqjes në bazë që, jo vetëm të thyejnë hallkat e punës burokratike që kanë krijuar, por të arrihet që këto hallka, në asnjë mënyrë, të mos karfosin mendimet, sugjerimet, iniciativat revolucionare të masave punonjëse.

Ç'mund të vëmë akoma në këtë letër? Sipas mendimit tim, për të ndihmuar bazën në planifikimin drejt të bujqësisë e, për analogji, afërsisht me karakteristikat e veçanta të tyre edhe për sektorët e tjerë:

Çdo rreth në veçanti duhet të planifikojë rendimentet e kulturave të ndryshme bujqësore duke pasur parasysh këta faktorë:

a) Për planifikim për tokat nuk duhet të marrim si kriter klasifikimin që kemi vendosur, po një kriter të ri, revolucionar (meqenëse do të mobilizojmë totalisht forcat), duke pasur parasysh dy ose tri lloje tokash.

b) Për çdo lloj toke të merret për bazë rendimenti më i lartë i kooperativës që, në krahasim me kooperativat e tjera, ka realizuar rendimentin më të lartë, pavarësisht se edhe këtu ka rezerva. Pra, do të caktohet një kooperativë që do të merret si bazë për rendimentet, të cilat do të shërbejnë edhe si kriter për të dyja kategoritë e tokave.

Në funksion me planifikimin e këtyre rendimenteve duhet të përcaktohen:

a) Kriteri i rendimentit më të lartë si republikë për tokat nën ujë.

b) Kriteri i rendimentit më të lartë si republikë për tokat ku është bërë punimi i thellë, qilizmë dhe i atyre tokave që planifikohen të bëhen.

c) Kriteri i rendimentit më të lartë që është marrë duke pasur parasysh sasinë e plehut organik ose kimik të hedhur.

ç) Kriteri i rendimentit më të lartë i arritur në funksion të punimeve me traktorë (për të cilat duhet të përcaktohet përfundimisht thellësia e punimeve).

d) Kriteri i rendimenteve më të larta si republikë në funksion të llojit të farërave (problem që duhet të kontrollohet rigorozisht).

dh) Kriteri i rendimenteve më të larta si republikë sipas prashitjeve (të cilat duhet të caktohen të detyrueshme për çdo kulturë).

Llogaritja e fuqisë punëtore në çdo kooperativë t'i nënshtrohet një kontrolli vjetor dhe të mbahet në evidencë dinamizmi i saj.

Për caktimin e ditëve kalendarike të punës duhet të përcaktohen disa kategori të ndryshme, jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas moshës (kjo për orientim planifikimi, pse s'mund të ketë kufi stabël). Për çdo kategori në kooperativë duhen të merren për bazë arritjet maksimale, që janë vërtetuar në punë, kurse për gjithë rrethin, të merret për kriter kuota maksimale e asaj kooperative të dalluar, llogaritur në kriteret që thamë më lart (po edhe këtu do të ketë mjaft rezerva,

sepse kjo varet nga shumë faktorë: fizikë, shpirtërorë, moralë dhe politikë).

Planifikimi i blegtorisë duhet të llogaritet për hektar, siç e kemi pasur, duke pasur parasysh edhe këtu kriteret që propozoj për rendimentet e prodhimeve bujqësore. Kjo të llogaritet si për shtimin e bagëtisë ashtu dhe për prodhimet e tyre, duke mbajtur parasysh edhe shtimin e prodhimeve bujqësore, pasurimin e tokave, spastrimin dhe zgjerimin e kullotave, me një fjalë, bazën ushqimore të bagëtisë që duhet të krijohet me punë shkencore revolucionare.

Kështu mund të veprojmë, deri diku, edhe me frutikulturën në specifikën e saj.

Për analogji, në sektorët e tjerë të ekonomisë, sipas specifikës së çdo sektori, duhet të përcaktojmë për bazën disa orientime të reja revolucionare për planifikim, të mbështetura kurdoherë jo në dëshirat, po në rezultatet konkrete dhe reale të arritura.

Kështu do të kemi në plan shifra më të mëdha, mundësisht të realizueshme, se bazohen në realizimet më të mira, po që, natyrisht, nuk mund të arrihen në rast se masat nuk mobilizohen në bazë të kriterëve mbi të cilat është mbështetur ky planifikim. Në këtë çështje do të luajë rol vendimtar patriotizmi, puna politike, ideologjike dhe organizimi i çeliktë e i disiplinuar i një pune shkencore. Sigurisht, suksesin në këtë nuk mund ta sigurojë një punë organizative burokratike, as një punë politike ideologjike e mefshtë, rutinë.

Po, është e vërtetë dhe do të jetë fakt se një planifikimi të tillë të studiuar, të vendosur, të pranuar e të shpjeguar dhe që vazhdimisht duhet të shpjegohet, do

t'i vënë gjoksin masat dhe Partia e do të kenë sukses në detyrën e tyre të madhe.

Jam i mendimit, dhe këtë do t'ia propozoj Byrosë Politike, që kjo projektletër, të kthehet në thirrje që t'i drejtohet gjithë popullit.

E ENJTE
14 TETOR 1965

Delegacioni i PK të Zelandës së Re bëri disa vizita në vendin tonë. Ai vizitoi dhe Shkollën e Lartë të Partisë «V. I. Lenin». Në sallën e shkollës u bë një takim me studentët. Mora pjesë edhe unë dhe fola; foli edhe kryetari i delegacionit.

Dje pasdite nënshkruam deklaratën e përbashkët midis Partisë sonë dhe Partisë Komuniste të Zelandës së Re.

Përcollëm në aeroport delegacionin e PK të Zelandës së Re, që iku shumë i kënaqur.

E PREMTE
15 TETOR 1965

Në mbledhjen e Byrosë Politike, që u zhvillua sot, duke diskutuar rreth një relacioni që na ishte paraqitur për edukimin politik të masave në rrethet Gjirokastër e Krujë fola¹ për rëndësinë që ka puna politike dhe si duhet kuptuar, për luftën kundër shfaqjeve të huaja dhe për informimin që na bëjnë shokët e bazës. E dimë, ka edhe të meta e dobësi, prandaj të mos na thuhet vetëm fjalë të mira, sepse gabimet e ndonjë shoku, aty ku ndodhin e mërzhitin popullin.

Diskutova gjithashtu për ngritjen e nivelit të punës së organeve të Partisë e të pushtetit në rreth² në ndihmë të mobilizimit dhe diskutimit të masave punonjëse për problemet e planifikimit ekonomik. Ndihma dhe kontrolli i këtyre organizmave të vijë duke u rritur.

Fola dhe për udhëzimet dhe grafikët e projektplanit të katërt pesëvjeçar³, aprovuam projektletren që

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 290.

2. Po aty, f. 296.

3. Po aty, f. 300.

do t'i dërgohet bazës për hartimin e planit. Propozova që kjo projektletër të bëhet thirrje dhe të botohet në shtyp. Shokët u shprehën dakord.

Në mbledhjen e Byrosë u ndalëm edhe në kriminalitetin e zhvilluar gjatë viteve 1963-1964 dhe në luftën që duhet bërë kundër tij, për të cilat diskutova¹ edhe unë.

1. Shënimet e mbajtura nga ky diskutim gjenden në AQP.

E SHTUNË

16 TETOR 1965

Prita vizita në shtëpi për datëlindjen time. Më erdhën shumë shokë, miq, njerëz të thjeshtë të popullit për të më uruar. Bisedova me ta me kënaqësi të veçantë.

* Gazeta «Zëri i popullit» botoi sot artikullin «Bashkëpunimi me imperializmin amerikan për sundimin e botës — vija e përgjithshme e udhëheqjes revizioniste sovjetike»¹. Në këtë artikull trajtojmë kryesisht disa çështje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e fshehtë e të hapët sovjeto-amerikan, një vit pas rënies së kryerevizionistit Hrushov.

— Pas ardhjes në pushtet, udhëheqja e re sovjetike ka zbatuar më me ngulm politikën hrushoviane të afrimit dhe të bashkëpunimit me imperializmin amerikan, duke vendosur vazhdimisht fusha të reja bashkëpunimi me të.

— Sot mund të thuhet dhe të përcaktohet me sak-

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 309.

tësi se vija e përgjithshme e revizionistëve hrushovianë është bashkëpunimi sovjeta-amerikan për sundimin e dy fuqive në botë. Përpjekjet e përbashkëta imperialisto-revizioniste për sundim nga të dyja fuqitë e mëdha kanë marrë tani një karakter më se konkret. Në një front të përbashkët ndodhen ato tani kundër lëvizjeve revolucionare në rajone të ndryshme të botës, së bashku luftojnë dhe minojnë socializmin, bashkërisht ndihmojnë reaksionarët e vendeve të ndryshme, së bashku mundohen të krijojnë, nën flamurin e OKB-së, xhandarmërinë ndërkombëtare etj.

— Ashtu si imperialistët, edhe revizionistët hrushovianë flasin sot për zona influence, për interesa të përbashkët në rajone të ndryshme të botës, për përgjegjësi të përbashkëta për «ruajtjen e paqes», për përgjegjësi të veçanta të dy fuqive të mëdha, për misione të veçanta të tyre etj., etj. Të dyja palët bëjnë përpjekje të mëdha për të bindur ose për të detyruar të tjerët të pranojnë konceptin dhe praktikën se «të gjitha problemet e sotme ndërkombëtare duhet dhe mund të zgjidhen vetëm në kuadrin e bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve sovjeta-amerikane».

— Afrimi me imperializmin amerikan, i filluar nga Hrushovi, u vazhdua nga udhëheqësit e rinj sovjetikë me vendosjen e një bashkëpunimi të plotë në të gjitha fushat. Për hir të këtij bashkëpunimi, udhëheqja e sotme sovjetike hyri në pazarllëqe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për cenimin e të drejtave dhe të së ardhmes të RD Gjermane, saboton luftën e lavdishme çlirimtare të popullit vietnamez etj.

— Sot nuk ka çështje të rëndësishme ndërkombë-

tare për të cilat, pavarësisht nga qëndrimet demagogjike që mund të mbahen për oportunitete të ndryshme politike, të mos ekzistojë një marrëveshje paraprake sovjeta-amerikane, të mos jenë biseduar dhe të mos jenë koordinuar midis tyre taktikat që do të ndiqen. OKB-ja është një shembull fare i qartë. Në OKB, si në një teatër, aktorët imperialistë e revizionistë luajnë rolet e mësuara përmendsh që më parë. Gjatë lojës, ata herë zemërohen e herë bëhen të butë, bërtasin e buzëqeshin, por, si në çdo farsë, fundi mbaron paqësisht dhe ata i shtrëngojnë dorën njëri-tjetrit.

— Ekzistenca e një komploti të madh imperialisto-revizionist kundër socializmit, sigurisë ndërkombëtare dhe paqes është një fakt që duket sheshit dhe që nuk mund të mbulohet me asnjë demagogji.

E HËNË
18 TETOR 1965

Sot u bë ceremonia e dekorimit të shokut tonë të dashur Ramiz, me rastin e 40-vjetorit të lindjes së tij. Presidiumi i Kuvendit Popullor e dekoroi atë me dekoratën e Urdhrit të Lirisë të klasit të parë. Ramizi ishte i emocionuar, na falënderoi ngrohtë ne shokët e tij e në radhë të parë Partinë tonë të shtrenjtë, bij të së cilës jemi të gjithë. «Gjithë jetën, — tha ai, — do të jem ushtar besnik i Partisë për çështjen e popullit e të atdheut».

Në selinë e KQ të Partisë prita miq kinezë që ndodhen në vendin tonë, një grup shkencëtarësh të Akademisë së Shkencave të RP të Kinës si dhe drejtuesit e artistët e ansambilit të këngëve e të valleve popullore «Fronti»¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 343.

E MARTE
19 TETOR 1965

Bujqësia na ka preokupuar e do të na preokupojë kurdoherë. Sot në Sekretariat dëgjuam sekretarë të Partisë të disa rretheve. Duket kujdesi i Partisë, i pushtetit dhe i të gjithëve. Por ka edhe probleme që duhen zgjidhur më mirë, për të cilat edhe unë dhashë disa mendime:

T'i jepet më shumë rëndësi rolit dhe punës së brigadave në kooperativat bujqësore. Ato që merren me kultivimin e pambukut, të synojnë për t'i bërë shërbimet e nevojshme agroteknike dhe të marrin cilësi të parë, me qëllim që të evitojmë importin e tij.

Bëra një vërejtje për Ministrinë e Bujqësisë, që duhet të kujdeset më shumë për çështjen e farës. Ka pak përpjekje për zgjedhjen dhe sigurimin e saj, qoftë edhe nga jashtë, por jo farë të degjeneruar. T'i referohemi edhe eksperiencës sonë, të bëhen edhe eksperimente, por studimet të mos zvarriten.

Shoku Hysni me të drejtë ngriti çështjen që për duhanin vjeshtak nuk tregohet kujdes. I këtij mendimi jam edhe unë.

Nuk më vjen mirë që dëgjoj se ky duhan «nuk pihet», «nuk kemi ku ta thajmë», «nuk ka nikotinë». Me këto koncepte në kokë disa edhe kanë groposur fshehurazi sasi të konsiderueshme të duhanit vjeshtak. Unë nuk jam dakord me këto mendime e veprime. Ne duhet t'i mësojmë njerëzit që ta pinë duhanin e vjeshtës. Aq më mirë që ky ka më pak nikotinë. Për tharjen e tij ka forma e mënyra të ndryshme.

Në Sekretariat diskutuam edhe për punën ideologjike me punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Na ishte paraqitur një raport shumë i përgjithshëm, që mund të lexohet njëlloj, si tani, edhe pas dy ose pesë vjetësh, sepse është mbushur me fraza që nuk të japin gjë. I kritikova që të mos na bëhen më raporte të tilla. Pastaj shtrova disa probleme e detyra, që organizatat e Partisë në Organet e Punëve të Brendshme t'i kenë më mirë parasysht.

Në këtë mbledhje dëgjuam edhe dy raporte nga komitetet e Partisë të rretheve Tiranë e Fier, se si punohet për forcimin e rolit të organizatave-bazë të Partisë dhe për edukimin e punonjësve të shëndetësisë. U dhanë mendime për ta ngritur më lart punën ideopolitike dhe profesionale në shëndetësi, por u nënvizua fort edhe një çështje: të ketë një proporcion më të drejtë në shpërndarjen e mjekëve në qytet e në fshat. Të shikohet drejt kjo çështje, se në fshat banon

shumica e popullsisë. Por fshatit ia kemi ngrënë bukën, i kemi dërguar pak mjekë. E porositëm shokun Ciril¹ që të merret seriozisht me këtë problem.

1. Ciril Pistoli, në atë kohë ministër i Shëndetësisë.

E HËNË
25 TETOR 1965

U mbledh Plenumi i 15-të i Komitetit Qendror të Partisë. Raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe të arteve për edukimin komunist të masave» e mbajti shoku Ramiz Alia. Problemet zërtheheshin shumë mirë.

Raportin e kisha parë që përpara dhe herë pas here kishim biseduar me Ramizin, kishim rrahur e shoshitur probleme të veçanta që gjatë përgatitjes së tij.

Mbas raportit filluan diskutimet. Diskutime shumë të mira, mobilizuese të shokëve. Në Plenum kishin ardhur të ftuar edhe shkrimtarë e artistë.

E MARTË
26 TETOR 1965

Sot Plenumi i 15-të i Komitetit Qendror u dha fund me sukses punimeve. Në mbyllje fola edhe unë¹ për rëndësinë dhe rolin e madh të letërsisë e të arteve në jetën e shoqërisë sonë, për perspektivën e zhvillimit të tyre në rrugën e realizmit socialist, për pasqyrimin në to të jetës dhe të luftës së pashembullt të popullit shqiptar dhe të Partisë së Punës në ndërtimin e Shqipërisë socialiste.

Që të arrijnë kuota sa më të larta, shkrimtarët dhe artistët tanë duhet të pajisen me kulturë të gjerë, të studiojnë teorinë marksiste-leniniste, të lidhen me jetën e popullit, të njohin folklorin, të kenë kuptim dhe qëndrim të drejtë ndaj kulturës botërore etj., probleme për të cilat fola gjerësisht në fjalën time të mbylljes.

Punë të mbarë dhe suksese shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë së re!

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 363.

Plenumi aprovoi një rezolutë në të cilën shprehet solidariteti i plotë i komunistëve dhe i popullit shqiptar me Partinë Komuniste të Indonezisë.

E ENJTE
28 TETOR 1965

Shkëmbyem mendime me Ramizin për tre artikuj të ndryshëm në mbrojtje të PK të Indonezisë¹. I dhashë me këtë rast një numër tezash e mendimesh që kisha formuluar për këta artikuj.

1. Këta tre artikuj janë botuar në gazetën «Zëri i popullit» në datat 30 tetor 1965, 4 nëntor 1965 dhe 23 nëntor 1965.

[TETOR 1965]¹

Mbi disa probleme të metodës së punës

— Në kushtet e tanishme, përmirësimi i mëtejshëm i metodës së punës përbën një nga problemet kryesore dhe më të rëndësishme për të ngritur lart të gjithë punën organizative të Partisë, të levave të saj dhe të pushtetit në përshtatje me detyrat që kemi. Pra, ky është problem i madh i përgjithshëm.

— Përmirësimi i metodës së punës së Partisë jo vetëm do të forcojë rolin udhëheqës të saj në tërë jetën e vendit, por do të influencojë dhe do të ndihmojë direkt edhe në përmirësimin e metodës së punës në të gjitha fushat e sektorët e tjerë, në mënyrë që secili të ndodhet në vendin e tij dhe të kryejë sa më mirë detyrat e tij.

— Ky problem është ngritur dhe në të kaluarën dhe ne kemi arritur mjaft suksese, gjë që duket qartë në forcimin e pandërprerë të Partisë dhe në faktin se forumet e kuadrot tanë tani punojnë shumë më mirë

1. Këto shënime janë pa datë. Nga përmbajtja e tyre dhe nga të dhënat që përdor autori, mendohet se janë të muajit tetor 1965.

se në të kaluarën, duke përballuar me nder detyra shumë më të mëdha e të vështira. Lidhjet me masat janë forcuar, format e punës janë shtuar dhe janë bërë më të harmonishme dhe efikase.

Kjo tregon vitalitetin e Partisë sonë, karakterin e saj krijues leninist.

Partia funksionon si një mekanizëm unik, ku në të njëjtën kohë hallkat e ndryshme të saj vetëveprojnë me iniciativë, duke vënë në jetë me besnikëri vijën e përgjithshme të saj.

— Por, siç dihet, e mira s'ka kufi. Për më tepër duhet theksuar se në metodën e punës së Partisë, krahas sukseseve, ne kemi dhe mjaft të meta e dobësi, natyrisht jo me karakter vije, por dhe jo pa rëndësi e të vogla. Prandaj kësaj çështjeje duhet t'i kushtojmë rëndësi të madhe dhe të përpiqemi seriozisht për të likuiduar këto të meta e dobësi, me qëllim që ta çojmë punën dhe më përpara, ta forcojmë edhe më shumë Partinë tonë.

Cilat janë disa të meta dhe si duhen luftuar:

1. — Në punën e Partisë vihet re shpesh një lloj dublimi, zëvendësimi e spostimi i organeve shtetërore etj. Organet e Partisë marrin mbi vete shumë nga problemet korente që u përkasin të tjerëve. Kjo manifestohet në disa drejtime:

— Në shqyrtimin e problemeve mjaft shokë gjykojnë mbi gjendjen e punëve në sektorë të ndryshëm pothuaj vetëm nga shifrat për realizimin e planeve etj., dhe nuk u japin rëndësi atyre që fshihen prapa shifrave: njerëzve, punës politike me ta, punës së Partisë për mobilizimin e tyre, gjendjes moralo-politike të masave. Kjo vihet re në bisedat tona me kuadrot e Partisë të

rretheve. Kjo duket dhe në faktin se nuk janë të rralla rastet kur në byro, në plenumë e në aktive partie analizohen çështjet teknikiisht, ashtu siç mund t'i shqyrtojnë organet përkatëse shtetërore.

— Në marrjen e vendimeve: kur merren vendime në mbledhje të byrove, të plenumëve ose në aktive të Partisë nuk vihen në plan të parë detyrat organizativo-politike të organizatave të Partisë e të komunistëve, por masat tekniko-operative që duhet t'i marrin organet përkatëse ose specialistët. Ç'mund të thuash, për shembull, për planin e masave që aprovoi aktivi i Partisë i rrethit të Pogradecit për frutikulturën më 30 shtator, kur në 30 e ca pika flitet për pompat, teneqet 10 litërshë, gërshërët, kosoret, sharrat etj., etj. po ku s'flitet asgjë për rolin dhe detyrat e Partisë.

— Ndjekjen e problemeve Partia ka për detyrë ta bëjë një për një, pasi ajo drejton tërë jetën e vendit. Por këtë ajo e bën duke vënë në lëvizje të gjitha levat e saj, duke vënë çdo njeri në krye të detyrës së tij. A ndiqen dot të tëra problemet duke bërë, për shembull, siç bën sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Burrelit, i cili vihet vetë në krye të shtabit të mbjelljeve, nuk vë në lëvizje komitetin ekzekutiv, por kryetarin e tij e cakton si përgjegjës të ekipeve për zonën e Klosit? Kështu përgjegjësit kryesorë të kësaj pune caktohen në rol të dorës së dytë.

— Ky dublim dhe spostim shfaqet më shumë në ndjekjen e problemeve ekonomike, siç shihet dhe nga shembujt që përmenda më lart. Në rrethe gjen sekretarë partie që kalojnë orë e ditë të tëra duke u marrë me zgjidhjen e çështjeve korente për probleme ekono-

mike, japin urdhra për mobilizimin e traktorëve, buldozerëve, makinave, duke matur vetë sipërfaqet e duhanit apo distancat e pambukut, duke mbledhur drejtorë ndërmarrjesh etj. Po përse janë organet ekonomike, specialistët, drejtorët e kryetarët e kooperativave? Është absurde të mendosh se një kuadër partie mund t'i njohë e t'i zgjidhë çështjet tekniko-ekonomike më mirë se specialistët përkatës. Kush përveç Partisë do t'i vërë ata në krye të detyrave të tyre, dhe kush do të bëjë organizimin e mobilizimin e ndërgjegjshëm të masave për problemet ekonomike?

— Por kjo shihet dhe lidhur me problemet e tjera, si të arsimit, të kulturës etj. Këto janë çështje të sektorit ideologjik, por që kanë si anën e tyre tekniko-organizative, me të cilën merren organet e kuadrot përkatës, ashtu dhe anën e përmbytjes, të mobilizimit të ndërgjegjshëm dhe të ngritjes ideologjike të atyre që merren direkt me këtë punë. Këtë të fundit duhet ta bëjë Partia, mirëpo shpeshherë kjo gjë nënvleftësohet dhe ajo merret me atë që u takon të tjerëve. Kështu, për shembull, nuk është aspak normale që byroja e Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit e shikon problemin e arsimit nga pikëpamja e aspekteve e masave tekniko-pedagogjike dhe jo nga pikëpamja e rolit të Partisë, të organizatave të saj dhe të komunistëve për ta shpënë punën përpara; ose që aktivi i Partisë i rrethit të Tiranës e shikon punën me librin vetëm nga ajo se ç'thonë e ç'bëjnë arsimtarët e përgjegjësit e vatrave të kulturës dhe aspak nga pikëpamja se si ka punuar dhe si duhet të punojë Partia që nga byroja e rrethit e deri te komunistët e thjeshtë.

— Në këtë çështje ka të meta jo vetëm në bazë, por edhe në qendër. Cili është roli i Komitetit Qendror dhe i aparatit të tij kundrejt organeve qendrore të shtetit etj.? Natyrisht jo të kërkojë nga rrethet të dhëna për fushatat e ndryshme, bile dhe më të hollësishme nga ç'marrin Kryeministria ose Ministria e Bujqësisë, ose që të mbledhë disa sekretarë dhe drejtorë ndërmarrjesh bujqësore për përcaktimin e blloqeve të ullinjve në ferma, siç ka bërë drejtorja e bujqësisë. Por që të nxjerrin konkluzione politike mbi mobilizimin e Partisë e të masave për zgjidhjen e detyrave ekonomike, duke e njohur gjendjen realisht në bazë dhe nga të dhënat e dikastereve e konkluzionet e komiteteve të Partisë në rrethe, anëtarët e KQ e ministrat, kur venë me shërbim në rrethe, nuk shkojnë edhe në organizata-bazë të Partisë.

— Përse ngjasin këto gjëra? Arsyet janë të shumta (këto varen dhe nga pjekuria e aftësia e kuadrove), por kryesoret janë:

— **E para**, në praktikë nuk mbahet mirë parasysh gjithnjë roli i Partisë si Parti në fuqi, si forca drejtuese, mobilizuese dhe edukuese e vendit, roli i levave të saj dhe si duhet t'i drejtojë Partia ato.

Sekretarët e parë shpesh monopolizojnë punën duke mbajtur vetë shumë lidhje: me pushtetin, ushtrinë, degën e punëve të brendshme, prokurorinë, gjykatën etj. Pse ta bëjnë vetëm ata këtë?

Partia s'drejton vetëm nëpërmjet aparatit e funksionarëve (që janë të paktë), por nëpërmjet gjithë organeve-bazë dhe çdo komunisti. Aparati i Komitetit Qendror si dhe ai i Komiteteve të Partisë në rrethe,

pavarësisht nga sektorët e ndryshëm, është aparat i specializuar partie që ka funksione partie. Kjo duhet kuptuar mirë.

— Detyrat kryesore të aparatit të Partisë janë puna me kuadrin dhe kontrolli i zbatimit të vendimeve.

Si duhen kuptuar këto.

Rëndësia e aktivitetit.

Mbështetja te masat.

— **E dyta**, organet shtetërore dhe të ekonomisë bëjnë presion të madh mbi organet dhe aparatet e Partisë, me anë shkresash «për njoftim», projektvendimesh e rregulloresh «për konsultim e kompetencë» etj., me qëllim që të shkarkojnë përgjegjësinë e tyre.

Duke parë se një praktikë e tillë tani është bërë pengesë dhe e dëmshme, është e nevojshme të rishikohen disa vendime të Qeverisë e të Komitetit Qendror dhe disa udhëzime që përcaktojnë lidhjet midis Partisë e organeve shtetërore. Kjo do të bëjë që organet e aparatet e Partisë të heqin dorë nga një lloj tutele e tepruar mbi organet shtetërore dhe ekonomike.

— **E treta**, organet dhe aparatet e Partisë detyrohen të merren me probleme korentë të ekonomisë, sepse disa dikastere dhe organe të pushtetit e të ekonomisë nuk kryejnë si duhet detyrat e tyre karshi vartësve: ndërmarrjet u ngrenë probleme, ata s'përgjigjen ose s'bëjnë gjë, atëherë përplasen te Partia. (Shembull, problemi i tërheqjes së qymyrit në Memaliaj dhe i birrës së Korçës në dimër.)

Duhet parë se mos dikasteret kanë akoma të përgendruara në duart e tyre më shumë gjëra sesa duhet,

gjë që mund t'i pengojë në zgjidhjen e problemeve kryesore.

— **Konkluzion për pikën 1 mbi dublimet, spostimet etj.**

Është e nevojshme të ngremë mirë rolin e organizatave të Partisë në administratat qendrore dhe të rretheve. Nga ana tjetër, Qeveria duhet të ushtrojë më shumë kontroll mbi veprimtarinë e dikastereve, veçanërisht në ndihmë të rretheve e të ndërmarrjeve nacionale. Duhet të merremi më mirë me punën e këshillave popullorë dhe të komiteteve ekzekutive të tyre.

2. — Në metodën e drejtimit të Partisë duhet të udhëhiqemi nga rregulli: më pak shkresa e udhëzime të përsëritura, më shumë punë konkrete dhe të gjallë. Me gjithë përmirësimet, ka akoma shumë shkresa, raporte, relacione, informacione etj. Jo vetëm, po këto shkruhen dhe të gjata! Të tilla i paraqiten dhe Byrosë Politike e Sekretariatit.

— Raportet e shkresat e nevojshme nga poshtë të vlerësohen, të studiohen dhe nga to të nxirren konkluzionet, të bëhen vërejtje (disa drejtori s'i lexojnë fare).

— Shkresat e tepërta të burokratizojnë, pengojnë mendimin dhe veprimin krijues.

— Mos vallë ka shumë shkresa, sepse ka shumë njerëz që i prodhojnë?

— Shkresat e tepërta vijnë edhe ngaqë për çështje të planit e të buxhetit, për bilancet etj., gjërat nuk parashikohen mirë me kohë, prandaj bëhen ndryshime, shtesa, pakësime.

— Prandaj: të pakësohen shkresat e panevojshme deri në minimum, të studiohet mirë si nga dikasteret,

komitetet ekzekutive dhe aparatet e Partisë praktika e deritanishme lidhur me këtë gjë, të vihen njerëzit para përgjegjësishë për sektorët që drejtojnë që të parashikojnë e të llogaritin çdo gjë mirë e në kohë.

3. — **Organizatat-bazë ankohen për rrethin, dhe komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive për qendrën se akoma u venë shumë vendime. Kjo ka të bëjë pak a shumë me atë që trajtuam dhe më lart, ndonëse vendimet kanë tjetër rëndësi.**

Rëndësia dhe vlera e madhe e vendimeve, ligjeve dhe e urdhëresave tona.

E vërteta është se vendimet që u dërgohen komiteteve të Partisë për shqyrtim në forumet e tyre, në krahasim me dy vjet më parë, janë pakësuar trefish. Kjo, sepse komitetet e Partisë janë rritur (janë pjekur më shumë).

Por kritika është e drejtë si për qendrën ashtu edhe për rrethet sepse, megjithatë, ka akoma shumë vendime.

— Një nga shkaqet që merren shumë vendime, pa dyshim qëndron dhe te praktika jo e rregullt e mbledhjeve tona: ose bëhen shumë mbledhje, ose (dhe kjo është më tipike) mbledhjet rëndohen me shumë çështje e probleme. Kuptohet që nuk është e rregullt të rëndohen mbledhjet e byrove me shumë pika në rendet e ditës dhe me 100-120 faqe materiale (veç atyre për pranime e masa). Këto pastaj lindin disa dhjetëra faqe vendime, masa e udhëzime. Merrni me mend, për shembull, se ç'ka dalë nga shqyrtimi i 138 problemeve në mbledhjet e byrosë, të plenumeve dhe të aktiveve të rrethit të Vlorës.

— Rruga kryesore për të pakësuar vendimet e pa-nevojshme është zbatimi i vendimeve. Kur ato nuk zbatohen mirë, rilindin vendime analoge, përsëritje, të pjesshme ose të plota të tyre. Por zbatimi varet nga organizimi dhe mobilizimi i mirë i kuadrove, i punonjësve, i mjeteve dhe formave që kanë të bëjnë me këtë apo me atë vendim. Nuk është normale, për shembull, që lidhur me blegtorinë KQ ka marrë që nga viti 1960 shtatë vendime, kurse Qeveria e rrethet kanë marrë akoma më shumë dhe, prapëseprapë, rezultatet në këtë sektor nuk janë akoma të mira. Ka vështirësi, por ka dhe burokratizëm e pakujdesi për këtë sektor.

Për këtë duhet luftuar dhe kundër asaj që disa herë vendimet dërgohen në bazë me vonesë të madhe, gjë që vjen dhe ngaqë aparatet e Partisë e dikasteret kur përgatitin raportet e projektvendimet përkatëse, nuk përcaktojnë dhe nuk marrin që në atë kohë masat për vënien e tyre në jetë.

Vendimet janë ligj dhe aparatet nuk kanë të drejtë as t'i vonojnë, as t'i mbajnë për vete. Kudo duhet krijuar situatë mobilizuese.

— Duhet pasur parasysh dhe një gjë, se vendimet e shumta, as ndiqen e as kontrollohen dot. Shembullin për këtë na e jep Ministria e Minerave dhe e Gjeologjisë, e cila nga 60 vendime që u ka dërguar ndërmarrjeve, ka planifikuar të kontrollojë brenda 1 viti vetëm 4.

Prandaj mendoj se është e nevojshme të studiohet gjithë praktika jonë lidhur me vendimet. Arsyeja — tani kemi një legjislacion të plotë, vendime të kongreseve, të plenumëve, të Byrosë Politike e të Sekretariatit

të KQ të Partisë, niveli i kuadrove është rritur etj.

Kjo të bëhet: duke organizuar më mirë punën, duke bërë analiza të thella, duke forcuar rregullin e disiplinën.

Është e domosdoshme që kur shqyrtohet një problem t'u referohemi detyrimisht të gjitha vendimeve e dispozitave që kemi.

T'i japim rëndësi të madhe punës së Partisë dhe të organeve të shtetit për njohjen e vendimeve, të ligjeve e të urdhëresave të ndryshme, jo vetëm nga kuadrot, por edhe nga masat punonjëse.

4. — Të përmirësojmë kontrollin e ndihmën në drejtim të bazës.

Përmirësime janë bërë, por jo në raport me numrin e kontrolleve e të kontrollorëve.

— Bëhen kontrole të shumta e të shpejta pa lënë gjurmë.

— Duhet vendosur një raport më i drejtë në ndihmën e kontrollin nëpër rrethet e ndryshme (se venë më shumë në kryesoret) dhe gjatë muajve të vitit (se venë më shumë në verë).

— Cilat janë efektet e kontrolleve dhe të ndihmës së përciptë? Në Korçë, megjithëse kanë vajtur kaq njerëz dhe ekipe, akoma s'janë zgjidhur as çështja e ngordhjeve të bagëtisë në NBSH, as problemi i energjisë elektrike. Apo mos janë ndihmë 79 detyrat e përgjithshme që i la ndërmarrjes gjeologjike të Kukësit një ekip i ministrisë?

— Ndhima e kontrolli në rrethet e në bazë duhet të jenë të kualifikuar, se kërkesat janë rritur e njerëzit

janë ngritur dhe t'u shkohet çështjeve deri në fund. Pra, më pak e më saktë.

— Me punën e kontrollit e të ndihmës duhet të merren kuadrot kryesorë dhe ata të mos venë vetëm kur jepen konkluzionet, siç ndodh disa herë.

— Kontrolli e ndihma është baraz punë e gjallë me njerëzit dhe jo futja në shkresa.

Të mos bihet në subjektivizëm në gjykimin e çështjeve dhe nxjerrjen e konkluzioneve, po të nisemi nga njohja objektive, reale e gjendjes.

— T'i kushtohet rëndësi aktivizimit të aktivitetit dhe masave për kontroll nga poshtë. Të vlerësohen vërejtjet, mendimet e propozimet e tyre.

— Njerëzit që dërgohen për kontroll e ndihmë në bazë të dëgjohen me vëmendje nga përgjegjësit, se ndodh që i nisin me shumë porosi dhe, kur kthehen, s'gjejnë kohë për t'i dëgjuar. Kjo i dekurajon kuadrot etj.

— Të ruhet konspiracioni: konkluzionet mbi çështje të veçanta ose mendimet personale në kundërshtim me vendimet, të mos bëhen muhabet pazari.

— Kuadrot, në radhë të parë, të respektojnë normat e caktuara nga Partia, ligjet dhe rregullat shtetërore.

— Ndjenja e përgjegjësisë së lartë në punë e në marrëdhëniet me njerëzit.

5. — Të shikohet çështja e organikave: Me gjithë shkurtime të vitit 1958, ato janë shtuar me mbi 3 000 veta (vetëm në dikasteret qendrore plus 480 veta). Për shembull, Ministria e Bujqësisë që kishte 118 veta, tani është dyfishuar, pra ka 237 veta, veç 90 vetave në historikanikë.

Kjo të shihet në dy drejtime: Të shkurtohen njerëzit e tepërt nëpër aparate, të thjeshtësohen këto në ndërtimin e tyre, pse ka disa paralelizma; për shembull, revizorë në ministri, revizorë në drejtori, ose mekanikë, ekonomistë etj. në degë të ndryshme të të njëjtës ministri.

Ndërtimi më i mirë i organikave të shpjerë në shfrytëzimin më të mirë të specialistëve, që aparati të bëhet më i manovrueshëm dhe që baza të forcohet me kuadro.

Kryeministria të bëjë një koordinim më të mirë të ndihmës në bazë, për problemet kryesore dhe sipas një tematike të caktuar për rrethe të caktuara.

— Bazë e metodës së punës së Partisë të jetë metoda e bindjes së masave dhe jo zgjidhja e çështjeve në mënyrë administrative. Ja një shembull i keq dhe që s'duhet të përsëritet më: në një material që ka shqyrtuar byroja e Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit për luftën kundër zakoneve prapanike dhe veshjen e kulturuar, paraqitur nga sekretari i parë dhe shefi i kabinetit thuhet: «Duhet të merren masa nga ana e Frontit që të bëhet regjistrimi i shallvareve dhe të detyrohen fshatarët t'i presin ato në prezencë të shoqëve të ekipit». . .!! Byroja e ka aprovuar këtë material dhe aparati i KQ të Partisë nuk e ka studiuar këtë protokoll. Pse kështu zgjidhet ky problem?

— Të futim kudo frymën revolucionare të Partisë, të luftojmë burokratizmin, të rritim iniciativën e përgjegjësinë e kuadrove, të luftojmë kudo për rregull e disiplinë të fortë e të ndërgjegjshme, të edukojmë kuadrot në luftën për zbatimin e vijës së Partisë.

[TETOR 1965]¹

Përmirësimi i mëtejshëm i metodës së punës në Parti, i stilit në punë — problem kryesor.

- 1) Forcon rolin udhëheqës të Partisë.
- 2) Forcon ndihmën direkte bazës.
- 3) Bëhet shembull në përmirësimin e metodës e të stilit në punë në të gjitha fushat.

Ka suksese, por ka edhe të meta të cilat duhet t'i ndreqim me kurajë.

Dublimi, zëvendësimi dhe spostimi, në kuptim dhe në praktikë, i organeve shtetërore nga ato të Partisë.

— Shqyrtimi i problemeve për gjendjen e sektoreve mbi bazën e shifrave.

— Nuk u jepet rëndësia e duhur njerëzve, punës me ta.

— Analizohen vetëm teknikisht problemet në byrotë e komiteteve të Partisë.

— Në vendimet e byrove, në radhë të parë, dhe

1. Këto shënime mund të jenë mbajtur në tetor 1965, sepse në këtë periudhë autori ka shkruar, nga koha në kohë, për luftën kundër burokratizmit. Materialet që akumulonte e përpunonte, çuan në diskutimin e tij në Byronë Politike më 24 dhjetor 1965 e deri në Letrën e Hapur.

kryesisht në masat tekniko-operative dhe ato organizativo-politike gati të zbehta.

— Ndjekja e problemeve dhe zbatimi i vendimeve nuk bëhen kurdoherë drejt dhe në kompleksin Parti-pushtet-organizatat e masave, por të veçuara etj.

Dublimi shfaqet në ndjekjen e problemeve ekonomike. Sektorët merren me zgjidhjen e çështjeve korrente për probleme ekonomike deri te matja e sipërfaqes së duhanit. Atëherë përse i kemi specialistët, njerëzit e pushtetit, komunistët që punojnë në prodhim? Kemi apo s'kemi besim tek ata? Do t'i ndihmojmë, apo do t'ua marrim detyrat dhe do të hiqemi sikur i zgjidhim vetë?

Kjo e metë vërehet edhe për probleme të tjera, në arsim-kulturë (shkollat — ana teknike e tyre).

Këto të meta shfaqen në rrethe dhe në qendër. Kjo është bërë edhe çështje në Byronë Politike e në Sekretariat për punën e drejtorëve të drejtorive në KQ, si t'i paraqitin më mirë kërkesat e tyre ndaj bazës dhe si të bëhen shembull të një stili më të mirë në punë.

Pse ngjasin këto?

Vendimet e drejta dhe vendimet e panevojshme.

Pse ka përsëritje vendimesh? Pse nuk përcaktohen mirë masat, pse nuk përmirësohen masat organizativo-politike, pse nuk ndiqen dhe pse kontrollohen dobët.

Të shkurtohen organikat, aparatet të thjeshtësohen, të zhduken ku duhet paralelizmat.

Shfrytëzimi më i mirë i specialistëve.

Bazë e metodës së punës së Partisë është metoda e bindjes së masave dhe jo zgjidhja e çështjeve në mënyrë administrative.

Pranimet në Parti, — të kihet kurdoherë parasysh, që Partia është pararoja e klasës punëtore:

— Se lufta e klasave zhvillohet në forma të ndryshme, kundër mbeturinave të klasave të mundura.

— Se lufta kundër ideologjisë borgjeze dhe mbeturinave të saj në ndërgjegjen e njerëzve vazhdon.

— Se lufta kundër burokratizmit dhe atyre që e krijojnë vazhdon.

Pranimi në Parti nga radhët e punëtorëve të pararojës dhe jo nga zyrtarët.

Pranimi në Parti nga radhët e kooperativistëve punëtorë më të mirë dhe jo nga zyrtarët.

(Këto si orientim i përgjithshëm.)

Ç'ndodh kur një organizatë nuk bën pranime?

a) Uji fle dhe në ujin që fle bëjnë follenë mikrobe të dëmshme: rehatllëku, familjariteti, akraballëku.

Atje bëhen përpjekje të ruhet qetësia e ujit të fjetur.

b) Zhduket fryma revolucionare. S'ka kritikë, autokritikë, iniciativë.

Liberalizmi dhe sektarizmi në zhvillimin e jetës së brendshme të Partisë dhe pasqyrimi në punë.

a) As në jetën e Partisë, as në luftën e përditshme, nuk duhen lejuar diskutime të gjata, të kota, boshe që e kthejnë Partinë në klube muhabetesh të rrezikshme.

b) As nuk duhet që, duke zbatuar sa thashë më lart, organizata e Partisë dhe diskutimet e nevojshme, frytdhënëse, edukative të ndrydhen, të kthehen në një burokratizëm të thatë, pa

shpirt, të shkëputura nga problemet dhe nga zgjidhja e tyre dhe të pranohen vendimet dhe zgjidhjet «e drejta», kur këto s'janë të drejta.

Shkresa — në 17 dikastere e drejtori qendrore gjatë 9 muajve kanë hyrë 128 000 dhe kanë dalë 79 000, gjithsej pra 207 000 shkresa. Dallohet Ministria e Bujqësisë, Ministria e Industrisë, Banka e Shtetit që kanë nga 20-30 mijë.

Mos vallë ka shumë njerëz që i kanë qejf këto shkresa?

Shkresat vijnë se shumë gjëra nuk parashikohen drejt, nuk kontrollohen, bëhen lëshime etj., etj.

Dikasteret duhet të shikojnë punën e tyre në këto drejtime: në monopolizimin e punës, në prerjen e iniciativës bazës, në moszgjidhjen shpejt të kërkesave, në luftimin e burokratizmit.

Qeveria të kontrollojë dhe të udhëzojë më mirë nga afër dikasteret për metodën e tyre të punës, për lidhjet e tyre me ndërmarrjet, luftën kundër letrave dhe të vajturave e të ardhurave pa hesap e pa llogari.

Duhen luftuar drejtimi dhe praktikat burokratike deri në kuadrot e bazës. Natyrisht, kuadrot e qendrës duhet të japin shembullin e tyre, një shembull të gjallë, revolucionar.

Kur themi drejtim burokratik nuk e kam fjalën vetëm në letrat dhe në shkresat e shumta, të cilat, natyrisht, duhet të reduktohen në minimum, por edhe në veprimet që praktikohen në bazë për zgjidhjen e problemeve, të cilat duhet të bëhen jo vetëm nga «kapaciteti i njërit» por nga përpjekjet e të gjithëve.

Udhëheqja ideologjike dhe politike e Partisë — detyrë jashtëzakonisht e rëndësishme, që s'duhet harruar kurrë, që s'duhet nënvlerësuar. Ekonomia shkon më përpara, por edukimi ideologjik dhe politik ecin më ngadalë, gjejnë shumë pengesa në rrugë nga mbeturinat borgjeze, mikroborgjeze dhe nga rrethimi kapitalist.

Më bëjnë përshtypje jo të mirë disa gjëra që shumë herë i dëgjoj. Ka drejtues të fermave ose kryetarë të kooperativave bujqësore, ose drejtorë të ndërmarrjeve, që shprehen: «Unë kam kaq hektarë tokë, kaq kokë bagëti, kaq të ardhura nga ndërmarrja ime» etj.

Ç'rreziqe fshehin këto shprehje?

— Ato krijojnë idenë e pronës private.

— Shprehin nënvleftësim të kolektivit dhe mbulojnë përpjekjet e heroizmat e tij.

— Japin idenë e mendjemadhësisë, të prepotencës, se pa «diturinë dhe zotësinë» e drejtuesit asgjë s'bëhet.

Mjaft drejtues ndoshta edhe pa dashje i ushqejnë këto tendenca të dëmshme.

Çdo gjë e krijojnë, e ndërtojnë masat e popullit të udhëhequra nga Partia. Individët, kuadrot luajnë rolin e tyre, sjellin kontributin e tyre në punën e përgjithshme. Kontributi i tyre mund të jetë i madh, frytdhënës, kjo s'ka dyshim, por këto s'mund të zëvendësojnë, as të errësojnë forcën e madhe krijuese të masave të popullit dhe të Partisë në tërësi. Prandaj në këtë drejtim, edhe në kuptimin e drejtë të kësaj çështjeje të madhe, për të sotmen dhe për të ardhmen, duhet të zhvillojmë një punë të pareshtur ideologjike dhe politike për edukimin e njerëzve.

Të mendojmë thellë dhe të nxjerrim mësim nga zhvillimi i revizionizmit në Jugosllavi, në Bashkimin Sovjetik, në vendet e tjera të demokracisë popullore të Evropës dhe në shumë parti komuniste e punëtoresh të vendeve kapitaliste.

— Revizionizmin e kanë përqaftuar udhëheqësit e këtyre vendeve dhe të këtyre partive.

— Këta përfaqësojnë elementët, mbeturinat dhe ideologjinë e ish-klasave shfrytëzuese. Prandaj ata janë kundër diktaturës së proletarietit, kundër partisë së klasës punëtoresh, kundër ideologjisë marksiste-leniniste.

— Ata luftojnë për rehabilitimin e ish-klasave shtypëse dhe të ideologjisë së tyre, luftojnë për krijimin dhe për fuqizimin e një klase të re shtypëse.

— Nga e krijojnë këtë klasë? Nga burokratë, nga teknikistë të sëmurë dhe nga megalomanë, që kanë humbur çdo ndjenjë të klasës dhe shpirtit revolucionar; nga spekulatorë e nga shumë të tjerë të kësaj kategorie; nga drejtuesit kryesorë të bujqësisë, të fermave e të kolkozeve, të sovkozeve, të drejtorive të SMT-ve, etj.; nga radhët e njerëzve të privilegjuar të fushës së krijimtarisë, shkrimtarë, artistë e shkencëtarë.

— Vetadministrimi titist, ku drejtuesit e prodhimit dhe njerëzit me poste kryesore në pushtet marrin rroga të majme. Në këtë rrugë ecet me të shpejtë edhe në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera revizioniste.

Duke e studiuar këtë proces, ne duhet të zhvillojmë një punë të madhe politike, ideologjike dhe organizative, për të demaskuar këtë proces revizionist dhe t'u vëmë barrierë të pakapërcyeshme këtyre të këqijave,

në kuadrot tanë, në Partinë tonë, në popullin tonë.

Kapërcimi i vështirësive dhe i pengesave — si duhet të kuptohet dhe si duhet të realizohet.

Revizionistët sovjetikë mbrojnë teorinë: «Partia e gjithë popullit». Kjo do të thotë parti e një klase të privilegjuar që po krijohet në BS dhe që merr në brenë dinë e saj teorike dhe në format e saj organizative tiparet e një partie borgjezo-socialdemokrate, që ka marrë përsipër restaurimin e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik.

Fryma revolucionare. Mbështetja në masat dhe lidhjet me to. (Në tërë gamën e saj, luftë privilegjeve, mendjemadhësisë, përçmimit, prepotencës burokrate dhe hierarkike.)

Disiplinë, në të gjitha drejtimet. Gatishmëri për zbatimin e vendimeve. Shfaqjet e huaja: përvetësimet, dembellëku, shkeljet morale. Ndjenja e unitetit në familje, uniteti shoqëror etj.

Mobilizimi i Partisë për çështjet ekonomike, puna edukative-politike, zbrëthimi i rëndësisë dhe i kuptimit politik të planeve dhe veprave, luftimi i të metave subjektive dhe objektive, rritja e ndërgjegjes socialiste, mobilizimi shpirtëror i njerëzve.

Karakter i universal dhe unik i drejtimit të Partisë: teorik, politik, organizativ, teknik, ekonomik.

Kuptimi i gjerë i punës drejtuese të Partisë: jo vetëm udhëheqja por e gjithë Partia në të gjitha hallkat, për drejtimin masiv të popullit të organizuar.

Kuptimi i drejtë i drejtimit kolegjial.

Kuptimi i drejtë i kompetencave dhe i përgjegjësisive.

Kuptimet jo të drejta, që çojnë në rrugë të gabuara.

Dualiteti Parti-pushtet.

Punë politike-ideologjike nga një anë dhe drejtim efektiv, tekniko-organizativ nga ana tjetër.

Organe të specializuara dhe organe të përbashkëta në drejtim, por kurrë nuk duhet të dilet në idenë e gabuar të dualitetit në drejtim.

Çdo njeri duhet të punojë me frymë partie dhe të zbatojë me përpikëri vijën e Partisë. Askush të mos harrojë se ka përgjegjësi të dyfishtë, përpara Partisë dhe, njëkohësisht, përpara pushtetit dhe ligjeve të tij të vendosura nga Partia, në frymën dhe në rrugën revolucionare të saj.

Pikëpamjet subjektive në çështjen e drejtimit teoriko-politik dhe teknik të zbatuesit.

Pikëpamjet e gabuara në ndarjen e përgjegjësisive Parti-pushtet:

— Pse njerëzit që drejtojnë në aparatet e Partisë nuk bëjnë si duhet detyrën e tyre.

— Pse këta dhe aparatet shumë herë monopolizojnë punët e pushtetit dhe e spostojnë këtë në kryerjen e detyrave të tyre.

— Pse komitetet ekzekutive dhe njerëzit e Partisë që punojnë në to neglizhojnë kombinimin e punës së Partisë me atë tekniko-organizative.

Rreziqet që mund të rezultojnë nga kuptimet jo të drejta, jo të kristalizuara në të gjithë dhe jo të zbatueshme si duhet.

Kuptimi i drejtë i rolit drejtues dhe edukues i

organizatës-bazë nga vetë komunistët dhe nga komitetet e Partisë.

a) Këtej rrjedh dhe çështja e caktimit të drejtë të tematikës për mbledhjet e organizatave-bazë dhe për mbledhjet e komiteteve të Partisë.

b) Këtej rrjedh, gjithashtu, çështja e tematikës së komiteteve ekzekutive dhe koordinimi i këtyre tematikave me ato të komiteteve të Partisë.

Përgjegjësia kolektive në komitetet dhe organizatat e Partisë dhe në organet e pushtetit dhe përgjegjësia individuale përpara Partisë, pushtetit, ligjeve të shtetit.

Roli i Partisë në fuqi.

Sekretarët shpeshherë monopolizojnë punën.

Partia të drejtojë dhe të vërë si duhet në lëvizje jo vetëm aparatet e saj, por, sidomos, bazën dhe levat e veta.

Cilat janë detyrat e aparatit të Partisë? Puna me kuadrin dhe kontrolli e ndihma në zbatimin e vendimeve, mobilizimi politik i të gjithëve dhe puna ideologjike.

Partia kurrë s'duhet të harrojë mbështetjen te masat e organizuara që zgjidhin çdo gjë; këtu hyjnë kuadrot specialistë dhe gjithë punëtorët.

Presion të madh bëjnë organet e pushtetit mbi ato të Partisë për zgjidhjen e problemeve. Pse? Sepse kërkojnë ndërhyrjen e Partisë drejt mobilizimit, evitojnë ndërhyrjet e tyre direkte në organet më të larta të pushtetit, i shmangen përgjegjësisë, dëshirojnë të ndajnë përgjegjësinë për atë që është e tyre.

Të hiqet tutela e organeve të Partisë ndaj atyre të pushtetit dhe kjo çështje të vendoset drejt.

Sapo lexova një raport që kanë bërë dy inspektorë të Komitetit Qendror për punën e Partisë në Kombinatit e Naftës.

Një raport jo i mirë, mbushur me gjëra që s'na duhen, kurse ato që na duhen paraqiten keq, se mbyten me ujë.

Raporte të tilla nuk janë për ne. Ata që i shkruajnë këto raporte duhet të vrasin mendjen se çfarë na duhen neve dhe jo të na futin në lloj-lloj gjërash. Frazat e përgjithshme s'të japin gjë.

Në raport ka disa probleme që i përkasin bazës, por për zgjidhjen e tyre duhet të merren masa jo vetëm atje, por të ndihmojnë edhe të dërguarit tanë, sesa të na raportojnë neve në detaje.

E PREMTE
5 NËNTOR 1965

Na erdhi sot një përgjigje e Komitetit të Partisë të Lushnjës, për një letër anonime që duhej të verifikohesh.

Duke lexuar këtë përgjigje shikoj që shokët e Komitetit të Partisë të këtij rrethi, në vend që të kërkojnë ku janë gabimet dhe t'i ndreqin, përpiqen të gjejnë autorin e letrës.

Me kërkue autorin e një letre të parrezikshme do të thotë t'u futësh frikën kooperativistëve, që këta të mos kritikojnë.

Këto veprime të ndalohen menjëherë!

E HËNË
8 NËNTOR 1965

**Masat që mund të marrim
për përmirësimin e punës në ushtri**

1 — **Rishqyrtimi me sy kritik i eksperiencës së ushtrisë sovjetike**, që është marrë prej kohësh në ushtrinë tonë, qoftë organizimi, qofshin rregulloret e ndryshme dhe puna ideopolitike. Të mbahet parasysh zhvillimi i ushtrisë sonë, eksperiencia që ajo ka fituar, eksperiencia e Luftës Nacionalçlirimtare, ngritja e kuadrit, të mbahen gjithashtu parasysh situatat aktuale të brendshme e të jashtme.

2 — **Puna ideopolitike në ushtri të rishqyrtohet dhe të mos bëhet punë rutinë**, ose punë politike, ideologjike në vetvete, por të jetë punë e gjallë, me synim e objektiv të caktuar ushtarak, e lidhur, në radhë të parë, me punën e shumanshme të ushtrisë, me jetën e saj të brendshme, në të gjitha shfaqjet dhe drejtimet. Natyrisht, kjo punë duhet të harmonizohet me gjendjen e brendshme të vendit dhe të mos qëndrojë e shkëputur dhe e vetmuar nga rruga e zhvillimit të jetës sonë.

3 — **Planëzimi i punës ideopolitike për tërë vitin**

mund të çojë në një punë disi monotone, të renditur, të argumentuar një herë e përgjithmonë dhe që nuk përputhet me ngjarjet që mund të lindin herë pas here dhe të cilat duhet vënë më shumë theksi, por që nuk mund t'i parashikojë programi i paravendosur. Kjo mund të çojë në atë që shumë kuadro ta kenë të vështirë për t'iu përgjigjur situatave dhe dalin me zor nga programi, u duhen përgatitje të veçanta dhe meqenëse nuk e kanë si duhet këtë praktikë i trajtojnë evenimentet përciptas.

Prandaj planëzimi i punës ideopolitike për të gjithë vitin duhet t'i parashikojë edhe këto eventualitete të mundshme e të domosdoshme. Kjo është e domosdoshme edhe për të luftuar «fjetjen e mendjes» prej kuadrove. Leksionet janë përgatitur dy-tre vjet më parë; këtej rrjedh edhe mungesa e përpjekjeve, e punës krijuese, e ngritjes profesionale, si pasojë, ka rutinë, ka moskoordinim të leksionit me aktualitetin. Puna ideopolitike duhet të bëhet e gjallë, e lidhur me jetën, e lidhur me shembuj të rinj e të freskët të praktikës së përditshme, të jetë një punë revolucionare. Ndryshe ajo nuk vlen, e ndryshk makinën, në vend që ta vajisë.

Pra, si konkluzion, mendoj se në formulimin dhe planëzimin e punës ideopolitike në ushtri, duhen bërë shumë ndryshime të arsyeshme e të domosdoshme, që kjo të jetë e gjallë, luftarake, revolucionare, e lidhur me jetën, me nevojat e ushtrisë sonë dhe jo një punë në hava.

4 — Problemi ekonomik i ushtrisë duhet të shikohet gjithashtu me kujdes, me gjithë rishikimet e herë-pashershme që kemi bërë. Unë mendoj se duhet të ri-

shikohen me kujdes normat në çdo gjë. Kjo çështje të shikohet në dy aspekte: në aspektin ekonomik dhe politik. Them ekonomik sepse duhet të bëjmë kursime, dhe politik sepse në rast se duhet të mësojmë dikë të rrojë, të punojë dhe të luftojë në kushte të vështira, kjo në radhë të parë duhet të jetë ushtria. Në rast se i jepen ushtrisë norma të larta në çdo gjë, atëherë e kanaqepsim atë, e mësojmë me rehati, me bollëk dhe momentet e vështira nuk e gjejnë të përgatitur sa duhet.

Pjesëmarrja e ushtrisë në prodhimin e bukës vetë, në punë në ndihmë të bujqësisë etj., duhet të planëzohet me kujdes edhe në kushtet aktuale të shpërndarjes së efektivave në pikat e hapjes, gjë që nuk duhet të nxirret si pengesë për këtë punë të rëndësishme. Shpërndarja të konsiderohet, dhe në fakt është, një lehtësi e madhe për kuptimin më shpejt nga ana e ushtarit të mësimit teknik që i jepet, sepse efektivit është më i vogël dhe shpjegimet jepen e kuptohen më mirë.

Prandaj mendoj se mund dhe duhet të shkurtohen normat e orëve të mësimeve teknike, për të krijuar kohë që një herë në vit të punohet në grupe të mëdha, dhe kjo mund të quhet «koha e fushimit aktiv në punë».

5 — Drejtimi i Partisë në ushtri të rishikohet në bazë të eksperiencës së madhe të Partisë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, si në sektorin ushtarak, ashtu edhe në atë civil. Besoj se në këtë drejtim mund të bëjmë ndryshime që të japin rezultate të shkëlqyera. Mendoj se është e nevojshme të studiojmë çështjen e krijimit të komiteteve të Partisë në ushtri, të rikthehemi në krijimin e komisarit politik, në suprimimin e disa formave pune e drejtimi të marra nga eksperiencia e Ush-

trisë Sovjetike të kohës së Stalinit. Por studimi duhet të kryhet duke u mbështetur në gjendjen reale dhe në kushtet e ushtrisë sonë sot në vendin tonë. Të evitohet çdo kopjim shabllon nga të tjerët.

Natyrisht, studimi dhe vendosja e një forme të re të drejtimit të Partisë në ushtri nuk është e thjeshtë dhe nuk do të thotë se me krijimin e komiteteve dhe të komisarëve politikë çdo gjë mbaron. Jo. Rëndësi ka, në radhë të parë, funksionimi i tyre, kompetencat dhe zbatimi i tyre në çdo kohë e në çdo situatë; rëndësi kanë, gjithashtu, lidhjet e tyre me repartet, me komandën, me Komitetin Qendror, lidhjet objektive me trupën, puna e tyre e partishme, zbatimi i centralizmit demokratik, i kritikës dhe i autokritikës nga poshtë-lart e anasjelltas etj. Duke e shikuar çështjen në këta përbërës dalim te problemi tjetër, ai i gradave në ushtri, që mendoj se kërkon një rishikim të thellë lidhur ngushtë edhe me eksperiencën tonë, me kushtet tona, me kërkesat tona të veçanta specifike dhe me traditat e vendit e të popullit tonë. Pra, nuk është një operacion i thjeshtë, megjithatë i mundshëm e i domosdoshëm për forcimin e ushtrisë, për ngritjen e përgjegjësisë së kadrove, për forcimin e lidhjeve të tyre me bazën e ushtrisë. Nga ana tjetër, ushtria do të jetë plotësisht nën drejtimin dhe kontrollin e Partisë.

6 — Mendoj se duhet të rishikohen rrënjësisht planet dhe programet e stërvitjes së ushtrisë; ka ardhur koha që ato të thjeshtohen në bazë të nevojave reale dhe të kushteve konkrete të vendit tonë si dhe të luftës që armiku mund të na detyrojë të përballojmë. Po të mos mbahen parasysh këto kushte reale, stërvitja e

ushtrisë mund të ngarkohet së tepërmi me gjëra që nuk i shërbejnë, përkundrazi i humbasin kohën e vlefshme për të mësuar e për të ditur ato që i duhen me të vërtetë dhe medoemos.

Kuadrot tanë ushtarake që kanë marrë mësim në akademitë e larta ushtarake sovjetike, ta përdorin eksperiencën që kanë fituar, por kjo të mos i pengojë për të hartuar programe dhe plane mësimi e pune të përshtatshme për kushtet tona, për konfiguracionin e vendit tonë, për luftën që mund të zhvillohet konkretisht te ne, duke mbajtur parasysh armët që disponojmë dhe armët që mund të përdorë armiku kundër nesh, armët që armikut ia lejon pozita, taktika dhe strategjia e vendit tonë etj.

Eksperiencia e luftës sonë partizane jo vetëm duhet të njihet nga çdo oficer e ushtar, por kjo të përshkojë të gjitha veprimet, mësimet e stërvitjen në luftën frontale, pozicionale me reparte të mëdha. Kjo eksperiencë nuk duhet mësuar si diçka e veçuar, ose e nevojshme vetëm atëherë kur mund të jemi të detyruar që reparti ynë të veprojë si repart partizan. Jo, kjo do të ishte një e metë, një boshllëk dhe duke menduar se ushtrinë e kemi mësuar me artin modern ushtarak, kjo nuk do të ishte e plotë në qoftë se nuk e kemi kombinuar atë me eksperiencën e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit tonë.

Pra, duhet ta kombinojmë drejt artin modern të luftës, me artin e Luftës sonë Nacionalçlirimtare, me kushtet që mund të na imponojë armiku, **por, sidomos me kushtet që ne duhet t'ia imponojmë armikut.** Në qoftë se ne do t'i imponojmë armikut kushtet tona, ato, natyrisht, do të jenë të disfavorshme për të dhe ky

duhet të jetë një nga qëllimet tona kryesore. Vetëm kështu ne ia prishim planet armikut, e detyrojmë të ndërrojë metodat e taktikën e tij, dhe të përdorë metoda që ai e ka të vështirë t'i zbatojë me shpejtësi e në një vend ku çdo gur e çdo gardh është për të armik.

Këtu do të qëndrojë zotësia e kuadrove, që të arrijnë ta stërvitin ushtrinë tonë në mënyrë origjinale, efikase, për të qenë në gjendje me taktikën dhe me strategjinë tonë të thyejmë superioritetin e armikut në armë e në mjete moderne. Kuadrot tanë duhet ta njohin strategjinë dhe taktikën e armikut dhe si i zbaton ai ato, të dinë si lufton armiku, por ata duhet të kenë dhe të vënë në jetë mënyrën tonë të luftimit, që është superiore ndaj asaj të armikut; nga ana tjetër, të përpiqemi që armiku të mos njohë mënyrën e luftimit tonë, të mos e parashikojë dot këtë, por të pësojë më parë disfatën. Edhe pasi ai të ketë pësuar disfata e të ketë nxjerrë mësim, ne t'i vëmë përpara taktika të reja të panjohura prej tij. Kuadrot tanë ushtarakë duhet të dinë se kjo pasuri taktikash luftimi e ka burimin te vetë lufta e popullit tonë, te eksperiencia e tij e madhe gjatë luftërave të ndryshme dhe, sidomos, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

7 — **Nga kjo rrjedh se duhet të rishikojmë edukimin teknik të kuadrove oficerë në kurse, në shkollë e në akademi.** Unë jam i atij mendimi që të thjeshtësohen lëndët, t'u vihet rëndësi lëndëve më të domosdoshme, më të nevojshme, pra të vihen proporcione të reja, të drejta; të fitohet kohë, sepse koha e humbur për një oficer duhet të konsiderohet si kohë e humbur për stërvitjen konkrete të ushtrisë dhe një shpenzim

i tepërt në kuadro e në materiale financiare për shtetin. Në këtë drejtim dhe me këtë frymë duhet të shikojmë edhe stërvitjen e rezervistëve, të paraushtarakëve etj.

8 — **Si duhet t'i bëjmë të gjitha këto gjëra?** Të gjitha këto janë të lidhura njëra me tjetrën, janë një kompleks i tërë. Më parë se të vendosim, duhet t'i studiojmë të gjitha këto çështje dhe të tjera që mund të ketë derisa t'u vemi problemeve në taban. Për disa probleme të studiohen disa variante dhe çdo variant të arsyetohet, duke mbajtur parasysh shumë rrethana: ekonomike, politike, ideologjike, morale, psikologjike etj., duke ruajtur kurdoherë qëllimin kryesor, **forcimin e fuqisë mbrojtëse të atdheut, kalitjen e ushtrisë, kalitjen e kuadrit oficer.** Asnjëherë të mos harrohet se ushtria dhe kuadrot e saj duhet të mësohen me vështirësi edhe në kohë paqeje, që në kohë lufte e rreziku ta bëjnë më lehtë punën e tyre të rëndë e vendimtare për fatet e atdheut.

Pasi t'i kemi studiuar të gjitha këto, ne duhet të vendosim për to në Byronë Politike dhe mund t'i çojmë edhe në Komitetin Qendror për diskutim e aprovim. Mund të vendosim që Komiteti Qendror t'i drejtohet ushtrisë dhe kuadrove të saj me një letër të brendshme të gjatë, e cila të punohet në të gjithë ushtrinë (ushtarë e oficerë, komunistë dhe të paorganizuar në Parti), ku të shpjegohet, të arsyetohet nga të gjitha anët çdo çështje dhe çdo problem.

Kjo do të jetë rruga më e mirë, mendoj unë, sesa t'i shtrojmë problemet një nga një. Nuk e shoh të udhës se del mirë në rast se i shtrojmë çështjet një e nga një,

si për shembull: të diskutohet një herë t'i ulim rrogat e oficerëve apo jo, t'i heqim gradat apo jo, të ulim normat e ushqimeve dhe të rrobave apo jo, të heqim kategorizimet, vjetërsinë apo jo. Po të diskutohen e të zgjidhen problemet veç e veç nuk do të kuptohen mirë, do të ketë njerëz që nuk do t'i presin mirë. Por, kur këto çështje i inkuadrojmë, ashtu siç janë në realitet, të pleksura me të gjitha çështjet e tjera të ushtrisë, çdo gjë do të kuptohet drejt, do të aprovohet. Unë kam bindjen se nga të gjithë, oficerë e ushtarë, do të shikohet problemi në gjithë kuadrin e tij të madh, dhe kjo mënyrë nuk lë rast të futen gjërat në shtigje të vogla e pa dalje, siç janë tendencat egoiste, mikroborgjeze të interesit personal. Çdo ushtarak do të shohë orientimin e madh e të drejtë të Partisë, kujdesin e saj për jetën e tij familjare, që nuk duhet të jetë më e favorizuar nga pjesa tjetër që nuk punon në ushtri; ai do të kuptojë rolin e tij të madh në shoqërinë tonë dhe besimin që ka tek ai Partia, si dhe kujdesin e veçantë që Partia bën për të kalitur njerëz të zotë, oficerë e ushtarë të gatshëm për kohë të këqija, të vështira, njerëz të sakrificës, që populli ynë të jetë gjithnjë i lirë, i pavarur e të ndërtojë me sukses socializmin, i mbrojtur nga çdo tentativë e armikut.

Këto shënime që shprehin disa mendime të miat, po ua dërgoj shokëve të ushtrisë si dhe shokut Rita¹ që t'i studiojnë dhe të mendojnë se në ç'drejtime dhe

1. Në atë kohë sekretar i KQ të PPSH.

si të veprojmë për të filluar rishikimin e problemeve në ushtri, për forcimin e punës së saj. Pasi t'i studiojnë ata, do të diskutojmë së bashku për të përcaktuar një projektplan pune, që do t'ia paraqesim Këshillit të Mbrojtjes dhe pasi t'i studiojmë përfundimisht do t'ia paraqesim Byrosë Politike për diskutim dhe aprovim.

E MARTË
9 NËNTOR 1965

Sipas lajmeve nga Xhakarta dhe atyre që japin agjencitë perëndimore të shtypit, situata në Indonezi duket shumë e vështirë dhe veçanërisht për Partinë Komuniste të Indonezisë. Atje mbretëron terrori i bardhë, reaksioni ushtarak ka marrë fuqinë në Xhakarta dhe po e zgjeron atë në të gjithë Indonezinë. Tani është fakt i kryer se Partia Komuniste e Indonezisë është futur në ilegalitet të rëndë, komunistët ndiqen e persekutohen, vriten nga reaksioni i egër. Udhëheqja e Partisë Komuniste të Indonezisë, me Aiditin në krye, nuk dihet ku është.

Gjithnjë sipas lajmeve të reaksionit indonezian, Aiditi dhe shokët e tjerë po ndiqen, bëhen përpjekje të zbulohen dhe të arrestohen. Shpresojmë se reaksioni s'do t'ia arrijë kurrë qëllimit, se përndryshe do të jetë një humbje e madhe për Partinë Komuniste të Indonezisë, e cila në këtë rast mbetet pa kokë dhe rrezikohet të likuidohet.

NASAKOM-i tash ka marrë fund, dhe duhet të ketë marrë fund definitivisht për Partinë Komuniste të Indonezisë. Ai vërtetoi se nuk ishte ashtu siç e trumbe-

tonin shokët indonezianë dhe s'mund të ishte ashtu, derisa borgjezia, qoftë dhe ajo liberale, bënte pjesë në të dhe sidomos kishte pushtetin efektiv në dorë. NASA-KOM-i ishte, në fakt, një vegël politike e borgjezisë liberale që kishte fuqinë dhe e ndante këtë me borgjezinë reaksionare dhe me ushtrinë, kurse komunistët bënë pjesë dhe duhej të bënin pjesë, sipas mendimit tim, por s'kishin asgjë në dorë. Dy-tre ministra pa portofol, ose gjoja këshilltarë të Sukarnos ishin thjesht sfumatura të borgjezisë dhe lëshime pa rëndësi të reaksionit; fundi i fundit, Partia Komuniste e Indonezisë duhej të përfitonte nga kjo gjendje, por ta trumbetonin NASAKOM-in dhe Sukarnon në atë mënyrë siç bënin ata dhe sidomos të kishin aq besim dhe aq shpresa siç kishin ata se do ta merrnin fuqinë në rrugë paqësore, nëpërmjet NASA-KOM-it dhe bug Karnos (Sukarno), ky ishte iluzion prej kalamani.

Në fakt Sukarnojo jo vetëm nuk doli gjë, por ai tash po kthen rrugën nga e djathta dhe mbështet reaksionin ushtarak kundër Partisë Komuniste të Indonezisë dhe interesave të popullit.

Sukarnojo është një aventurier borgjez, që mbron interesat e klasës së tij. Ai çdo ditë do të shkojë më tej dhe të gjithë «autoritetin e tij» do ta vërë në balancën e borgjezisë reaksionare, të veshur natyrisht me formula e slogane «demokratike», «socialiste», «popullore» e çfarë të duash.

Tani për ta është më shumë se kurrë koha e formulave «të majta» për të maskuar ecjen nga e djathta.

Pra, sipas mendimit tim, Partia Komuniste e Indonezisë duhet të zhdukë sa më parë të gjitha iluzionet

që kishte për NASAKOM-in dhe për bug Karnon. Në qoftë se ajo vazhdon t'i ketë ato, qoftë të sajuara, gjoja për taktikë, atëherë ka rrezik të madh të shpartallohet. Taktikë dhe elasticitet mund të duhet dhe do të duhet, por jo më me mendimet e vjetra, jo më me shpresa të marrjes së pushtetit me rrugën paqësore nëpërmjet NASAKOM-it, por nëpërmjet rrugës së luftës civile, nëpërmjet revolucionit të udhëhequr nga Partia Komuniste e Indonezisë, dhe vetëm nga ajo. Fronti i ri, lufta e vërtetë revolucionare e udhëhequr nga partia, duhet të vendosë, të imponojë taktikat dhe strategjinë e saj dhe jo më NASAKOM-i dhe bug Karnoja.

Grushti që po ha Partia Komuniste e Indonezisë aktualisht duhet ta bëjë këtë të ndërgjegjshme një herë e përgjithmonë se rruga paqësore, për marrjen e pushtetit, jo vetëm ka vdekur, por as ka lindur ndonjëherë, që të mund të vdiste. Kjo teori është pjellë e revizionizmit modern për të shpëtuar rendin kapitalist, për të degjeneruar teorinë e revolucioneve me dhunë, për të degjeneruar partitë marksiste-leniniste dhe për t'i likuiduar krejtësisht, siç bëhen tentativat sot në Indonezi. Në qoftë se Partia Komuniste e Indonezisë nuk e ka kuptuar mirë tani këtë, ajo do të pësojë humbje të rënda.

Tani ajo po pëson humbje të mëdha dhe do të pësojë akoma më të mëdha, pse këto janë konsekuencat e kuptimit jo si duhet nga ana e saj e ligjeve marksiste-leniniste dhe të revolucionit.

Entuziazmi i tyre i pabazuar e joreal, ndihmon tani patjetër në hutimin e komunistëve indonezianë. Një

pjesë dërrmuese e tyre, akoma nuk e kuptojnë si ngjau ky rrebesh, disa do të jenë të deziluzionuar, disa të dëshpëruar, disa të frikësuar, disa të lëkundur. Mjaft nga këta s'vlejnë më për revolucion. Ata do të dezer-tojnë nga radhët e partisë, do të dorëzohen, do të mohojnë partinë.

Sigurisht, Partia Komuniste e Indonezisë s'ka pse të shpartallohet dhe të shuhet pse u lëkundën këta. Ajo duhet të bëhet më e fortë, po të mbeten më të fortët; ajo duhet të bëhet më revolucionare, po të mbeten më revolucionarët; ajo duhet të bëhet luftarake, po të mbeten luftëtarët e qartë dhe të vendosur. Dhe këta do të jenë shumë e do ta çojnë revolucionin përpara.

Kuptohet, Partia Komuniste e Indonezisë kalon tani momente shumë të rënda, dhe në këto momente të rënda ne jemi me të gjitha forcat me të. Ne e kuptojmë se nuk është aq lehtë për Partinë Komuniste të Indonezisë, sado e madhe që të ishte, sado e parapërgatitur që të ishte për ngjarjet e papritura, të kalojë me lehtësi nga gjendja legale në ilegalitet dhe të organizojë kundërofensivën. Do t'i duhet asaj një kohë e mirë, plot me sakrificat të mëdha, por sakrificat do ta kalitin.

Revizionistët modernë, dhe në radhë të parë ata sovjetikë, do të punojnë intensivisht me agjentët e tyre pseudomarksistë, që ta likuidojnë sa më parë dhe krejtësisht Partinë Komuniste të Indonezisë, të eliminojnë udhëheqësit e vërtetë dhe të vendosur marksistë-leninistë të saj dhe të krijojnë një «parti të re» me revizionistë në krye, pra të krijojnë një parti «socialdemokrate», e cila të ketë njëkohësisht baba dhe nënë revii-

zionizmin modern dhe kapitalizmin indonezian. Kjo do të jetë një parti konform dëshirës së përbashkët të kapitalizmit botëror dhe të agjunkturës së tij, revizionizmit modern, e krijuar në kondita «speciale». Revizionistët sovjetikë do të bëjnë publikisht demagogji gjoja për «mbrojtjen» e Partisë Komuniste të Indonezisë; nga ana tjetër, do të lëshojnë agjentët e tyre të shpartallojnë partinë nga brenda, të zbulojnë planet dhe vendet ku fshihen dhe ku luftojnë udhëheqësit marksistë-leninistë të saj dhe këta t'ua dorëzojnë reaksionit, për t'i shpartalluar dhe për t'i zhdukur fizikisht.

Pra, me një taktikë të tillë të koordinuar, reaksioni dhe revizionistët modernë do të përpiqen të arrijnë të likuidojnë partinë e parë të vërtetë dhe të krijojnë partinë e gënjeshtërt të re revizioniste. Nuk do t'u mungojnë as format dhe as njerëzit që do të tradhtojnë dhe do të paguhen për tradhtinë e tyre. Do të dalin dhe atje Sejfulla Malëshovë, Tuk Jakovë, Bedri Spahi dhe Liri Belishovë e të tjerë.

Këtë gjë duhet ta kuptojnë shpejt shokët indonezianë, se rreziqe të mëdha i kërcënojnë. Në rast se nuk janë vigjilentë ndaj revizionistëve sovjetikë, në rast se nuk i luftojnë hapur dhe fort, bile po aq sa reaksionin, të cilin, është e qartë, e luftojnë hapur, ata të bëjnë gjëmën e madhe.

Unë vazhdoj të kem besim të madh te shokët e Partisë Komuniste të Indonezisë. Ata duhet t'i përballojnë me sukses këto vështirësi të mëdha që u kanë dalë përpara. Rruga nga ku ata do të duhet të kalojnë, do të jetë e vështirë, shumë e vështirë, por duhet të

kalohet, të kapërcehet patjetër. S'ka kala që nuk mund të marrin komunistët. Dhe Partia Komuniste e Indonezisë duhet t'i fitojë kalatë, një nga një, me luftë dhe me flamurin e marksizëm-leninizmit të shpalosur plotësisht.

E MËRKURË
10 NËNTOR 1965

Shkrova një letër¹ për shokun Rita për probleme që dalin aktualisht përpara kooperativave bujqësore dhe për detyrat e rolin udhëheqës të Partisë, si në gjithë jetën e vendit, edhe në këtë situatë të re.

[NËNTOR 1965]

Më dërguan për ta parë artikullin me titull «Përse shqetësohet udhëheqja revizioniste e PK Italiane», që është përgatitur për botim në «Zërin e popullit». Pasi e lexova, e ktheva, me vërejtjen se do të jetë më mirë të mos e botojmë, pse nuk është i plotë, por një polemikë shumë simpliste. Duhet studiuar thellë tezat e tyre dhe të dalim me një kritikë serioze.

1. Shih: Enver Hoxha, «Letra të zgjedhura», vëll. 2, f. 141.

E PREMTE
3 DHJETOR 1965

Në mbledhjen që zhvilluam sot, me sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve, fola¹ për luftën që duhet të bëjë Partia kundër rutinës e metodave burokratike, për një stil e metodë pune revolucionare.

Drejtimesit e Partisë në rrethe duhet të kenë më shumë iniciativë e të mos e presin çdo zgjidhje nga qendra, t'i drejtohen Komitetit Qendror për probleme të rëndësishme, por jo për cikërrima.

Detyra të mëdha kanë organet e Partisë edhe për kooperativat bujqësore që janë baza e socializmit në fshat. Partia lufton për ngritjen e nivelit të kooperativave dhe të kooperativistëve, në përshtatje me gjithë sektorët e tjerë të jetës, por pa lejuar kurrë privatizmin.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 458.

E SHTUNË
4 DHJETOR 1965

Zgjerimi i perspektivës së hapjes së tokave të reja

Brezit tonë i bie barra dhe na vihet detyrë të hapim perspektiva të reja dhe të realizojmë detyra më të mëdha nga ato që Partia dhe populli kanë bërë deri tash.

Shembulli i të parëve tanë, që në kushte të vështira, kanë hapur në male toka buke për të prodhuar drithë dhe për të rritur bagëti, duhet të na frymëzojë për veprime të mëtejshme, natyrisht, duke kapërcyer e lënë pas mendimet e tyre të ngushta, arkaikë që ishin për atë kohë të mira e reale, kurse sot nuk janë aktuale.

Në male, mund të prodhohet dhe mund të rritet bagëti. Në lartësi mund të mos prodhohet misër ose grurë, por mund të prodhohen patate, thekër dhe kultura të tjera. Atje, përveç deleve dhe dhive, mund të mbahen edhe lopë, derra, pula etj.

Pra, aksioni i hapjes së tokave në male për kultivimin e patates duhet të zgjerohet dhe të zhvillohet në kompleks, jo vetëm për pataten. Në këtë rrugë, për disa pesëvjeçarë mund t'i japim atdheut edhe një herë më

shumë tokë prodhuese, mbi sipërfaqen e tokës që kemi aktualisht për misrin ose për grurin.

Prandaj, studimin që sapo kemi filluar për të gjetur toka për pataten, na bie detyrë ta bëjmë të thellë e të shumanshëm. Të thuhet me saktësi sa kullota verore kemi në gjithë Shqipërinë, sa vende nga ato që janë rezervuar për pyje duhen liruuar që të destinohen për tokë prodhuese, cila është më shumë rentabël. Nga këto, duhet përcaktuar se sa do të destinohen për dritëra, sa për pataten, sa për kullotat verore. Pasi të përcaktohen drejt këto, atëherë të hartohet plani i vënies së tyre nën kulturë. Por plani duhet të parashikojë çdo gjë: fondet në të holla (investimet), mekanizimin, fuqinë punëtore, kafshët e punës, banesat që nevojiten, rrugët që do të hapen etj.

Një studim dhe një punë e tillë do të bëjnë të ndërronin shumë koncepte për shfrytëzimin intensiv të tokës në fushë e në mal, për rritjen e kulturave bujqësore dhe intensivikimin e bujqësisë, për zhvillimin e blegtorisë, për rritjen e lopës në fushë dhe në mal, për shtimin e bagëtisë së imët në zona fushore e malore, për përcaktimin më të saktë se ku është më e përshtatshme të mbahet delja dhe dhia, për rritjen e derrit në zona fushore e malore etj. Si rezultat shtimi i prodhimit do të kërkojë zgjidhje të reja edhe për përpunimin e tij. Rritja e prodhimit të qumështit do të shtojë sasinë dhe llojet e djathit, të gjalpit, ashtu si rritja e prodhimit të drithërave do të shtojë llojet e ndryshme të bukës.

Përpara nesh vihen detyra kolosale për përparimin e zonave fushore, për ngritjen në një nivel të lartë të

zonave kodrinore e malore, për vënien në shfrytëzim të gjerë të rrafshinave të larta.

Në kemi forca, Partia jonë do ta kryejë këtë aksion historik me sukses, unë jam i bindur plotësisht për këtë. Partia dhe populli do ta përqafojnë me entuziazëm dhe me bindje propozimin tim, dhe unë dëshiroj që sa më parë ta shoh kryerjen me sukses të këtij aksioni të madh të Partisë dhe të popullit.

Bisedova me Hysniun dhe shkëmbyem mendime për hapjen e tokave në rrafshnaltë. Perspektiva e tyre është e madhe.

Ripunova artikullin «5 vjet pas Mbledhjes së Moskës të vitit 1960»¹.

1. Është fjala për artikullin «Revizionistët hrushovianë përpara vështirësish, dështimesh dhe kontradiktash serioze». Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 465.

E PREMTE
10 DHJETOR 1965

Në dy faqet e saj të brendshme dhe pjesërisht në të katërtën, gazeta «Zëri i popullit» boton sot artikullin «Revizionistët hrushovianë përpara vështirësish, dështimesh dhe kontradiktash serioze».

E HËNË
13 DHJETOR 1965

Sot u takova dhe pata një bisedë me një delegacion të PK të Brazilit që ndodhet në vendin tonë¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 503.

Po hedh disa shënime për spastrimin e letrave nga aparatet e Komitetit Qendror në drejtim:

- a) të kërkesave e raporteve,
- b) të dërgimit të informacioneve nga poshtë,
- c) të kërkimit të informacioneve nga lart,
- ç) e të tjera.

Nga të gjitha këto të ngelin sa më pak dhe më të nevojshmet, të cilat të përfaqësojnë raportimin e gjendjes së një situatë kyç. Këto duhet të jenë

- a) për disa probleme të caktuara,
- b) për disa probleme që kërkon Byroja Politike dhe Sekretariati për mbledhje (studim dhe vendim).

Çdo gjë tjetër do të zëvendësohet me punën e gjallë:

- a) të sekretarëve të KQ,
- b) të inspektorëve dhe të instruktorëve,
- c) me telefon,
- ç) me thirrjen e sekretarit të rrethit (për problemet e nevojshme, por jo edhe për një gjë të vogël).

Sekretarëve të komiteteve të Partisë të rretheve u lihet kompetenca që me iniciativën e tyre, t'u drejtohen zyrtarisht forumeve të larta, ose sekretarëve të Komite-

tit Qendror me letra të veçanta, kur ata e gjejnë të nevojshme.

Të deleguarit në aktive ose plenumet s'është e thënë të kontrollojnë medoemos raportet. Ata duhet të jenë në dijeni të problemit që do shtrohet, të mendojnë vetë për problemin, dhe në aktiv të flasin, të ndihmojnë etj.

Inspektorët dhe instruktorët po ashtu të mos veprojnë si supervizorë.

Inspektorët dhe instruktorët të shkuden nga cikërrimat, të ndjekin dhe të ndihmojnë vetëm për problemin dhe të sjellin në udhëheqje problemet kryesore që shtron baza. Le t'i këshillojnë shokët e bazës, por jo edhe për çështjet që ata i dinë mirë.

E gjithë kjo punë të bëhet me qëllim që të çlirojnë kuadro nga burokratizmi, por jo nga detyrat; t'i ndihmojnë ata të shohin drurët dhe jo fletët; ta ndiejnë veten përgjegjës dhe të vënë përpara përgjegjësisë të tjerët. Kështu do të zgjerohet iniciativa në punë, në mendime, do të hiqet «tutela burokratike», do të kuptohet thellë centralizmi i vërtetë demokratik që s'ka të bëjë fare me «centralizmin burokratik».

Kjo do të krijojë një stil dhe një metodë të re pune që nuk mund ta kodifikojmë dhe ta futim në «formulime të reja». Format do të gjallërohen, do të zhvillohen, nuk do të jenë stereotipe.

Por do të jenë dhe do të mbeten të njëjta orientimi bazë i punës, direktivat dhe qëllimet që kërkohen të arrihen, ruajtja e parimeve bazë, në çdo drejtim.

Kjo duhet të kuptohet si forcim i punës së Partisë, si një disiplinë e vërtetë e punës së saj, dhe jo si shtu-

rje; kjo duhet të kuptohet si një kërkesë e vërtetë llogarë nga poshtë-lart dhe anasjelltas; të kuptohet si forcim dhe jo si dobësim i disiplinës; si forcim dhe jo si dobësim i centralizmit demokratik.

Nga rishikimi me kujdes dhe rrënjësisht i këtij problemi do të dalin më qartë problemet:

a) përdorimi i kuadrove të aparateve të Komitetit Qendror,

b) bashkëpunimi i drejtorive të Komitetit Qendror,

c) disponibiliteti dhe përdorimi më i mirë i kohës së punës,

ç) e shumë gjëra të tjera.

Është e domosdoshme ta bëjmë këtë gjë sa më parë. Të gjitha drejtoritë kanë shkresa burokratike në punë, por për natyrën e punës jam i sigurt, që në Drejtorinë e Organizimit dhe të Administratës ka më shumë. Atje janë grumbulluar raporte, statistika, informacione e çfarë nuk ka, e çfarë nuk vijnë atje!

Këtë spastrim duhet ta bëjmë sa më parë, sepse nën shembullin e qendrës ecin edhe rrethet, organet e Qeverisë, ministritë dhe të gjitha aparatet.

E MËRKURË

15 DHJETOR 1965

Traktati Japono-Kore e Jugut¹ është pjellë e imperializmit amerikan.

Qëllimi i këtij traktati është i shumanshëm: Qëllimi bazë është angazhimi i japonezëve në aleancë me amerikanët për të përgatitur luftën kundër Kinës dhe Koresë së Veriut.

Qëllimi i afërt është të forcojnë Korenë e Jugut, si një plasdarm të tyre për një agresion të ri, të frikësojnë Korenë e Veriut dhe, si rrjedhim, ta izolojnë atë nga Kina e ta neutralizojnë rolin revolucionar që ajo duhet të lozë në Lindjen e Largme.

Pra, amerikanët, me aleancat e tyre (siç është edhe ky traktat i fundit), mendojnë se e kanë rrethuar Kinën me zjarr dhe është gjoja në dorën e tyre ta ndezin fitilin kur të duan dhe ku të duan...

Amerikanët dhe sovjetikët prej kohësh po përgatitin agresionin kundër Kinës e vendeve të tjera të ra-

1. Traktati reaksionar, luftënxitës e militarist Japono-Kore e Jugut, që u nënshkrua më 22 qershor 1965, u ratifikua nga dhoma e ulët e parlamentit japonez dhe nga klika kukull e Seulit më 12 nëntor të vitit 1965.

jonit. Vietnami sot, dhe nesër Koreja janë dhe mund të jenë preludi. . .

Koreja luan dhe mund të luajë një rol të madh në Azi. Sa rëndësi do të kishte uniteti ideologjik marksist-leninist i këtyre vendeve, sa disfatë e madhe do të qe kjo për revizionistët sovjetikë!

E ENJTE
16 DHJETOR 1965

Po hedh, gjithashtu, disa shënime për spastrimin e burokratizmit nga aparatet shtetërore.

Bisedova dhe i këshillova shokët e Qeverisë që t'i futen me seriozitetin më të madh këtij problemi shumë të rëndësishëm dhe të mobilizojnë të gjitha forcat e mira për realizimin e tij. Ta shikojnë problemin seriozisht dhe të propozojnë masat më rigorozë, për ta çrrënjosur nga rrënjët burokratizmin. Mendoj se në organet shtetërore veprimet burokratike janë më të mëdha, sepse edhe vetë sektori është më i madh, i shumanshëm dhe në shumë drejtime.

Burokratizëm ka në vetë organizimin, në raportet, në kompetencat, në kërkesat, në ligjet, në rregulloret, në dipendencat, në interdipendencat etj., etj.

Prandaj i këshillova shokët e Qeverisë që të reflektojnë thellë dhe të kapin kyçet në çdo drejtim, në zbatimin e politikës së Partisë, për luftën kundër burokratizmit dhe këto orientime të zbatohen në kompleksitet.

Shokët duhet të kuptojnë thellë qëllimin e madh të Partisë, të luftojnë skematizmin, të kuptojnë se me-

toda dhe stili i punës së tyre duhet të ndryshojë, të bëhet më revolucionare, të luftojnë konservatorizmin dhe mendimin që nuk i lë të largohen nga rutina, e cila i kishte vënë edhe në gjumë.

Kushdo duhet të kuptojë se burokratizmi është një pjellë e njerëzve, e organizmave, e një mënyre të menduari, të vepruari jo revolucionar, që, po nuk u freskua, po nuk u spastrua e po nuk iu vu fre, bëhet sëmundje e rrezikshme, shumë e rrezikshme, sepse krijon përshtypjen sikur çdo gjë është normale, bile krijon edhe arsyetime të atilla sikur suksesi «i detyrohet» pikërisht kësaj pune burokratike dhe rutine.

I këshillova shokët e Qeverisë që spastrimi të fillojë më parë nga aparatet qendrore, të spastrohen kartërat, raportet, statistikat e kota, por jo ato të nevojshme. Këtej do të dalin përgjegjësitë e vërteta për çdo ministri, do të hiqet tutela e tepruar, dhe secili do të jetë i ndërgjegjshëm për detyrat që i takojnë dhe do të rritet iniciativa. Njerëzit do të çlirohen nga vogëlsitë, dollapët nga arkivat e panevojshme. Do të dalin më në pah kompetencat dhe do të duken më qartë organizmat e krijuar me vend e pa vend, si dhe madhësitë e tyre.

Të rishqyrtohen ligjet si dhe rregulloret e udhëzimet rreth këtyre ligjeve. Të konkretizohen, të spastrohen, të thjeshtësohen, me qëllim që të ruhet ligjshmëria, të forcohet e të spastrohet nga burokratizmi, nga pengesat, nga ngatërresat që këto artificialisht kanë krijuar, që nga mentaliteti i sëmurë në kokën e njerëzve, deri në zbatimin e tyre praktik.

Ka shumë shokë që e kuptojnë këtë direktivë të

drejtë të Partisë, këtë nevojë të madhe, këtë rigjallërim, por jo të gjithë do të punojnë mirë për zbatimin e saj, sepse rutina pengon vendosjen e një mentaliteti dhe metode të re pune, prandaj organizatat e Partisë duhet ta ndjekin këtë punë me seriozitetin më të madh.

E PREMTE
17 DHJETOR 1965

Revizionistët sovjetikë dëshirojnë dhe luftojnë me të gjitha forcat që, duke sakrifikuar popullin e Vietnamit, të shpëtojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga gjendja e vështirë, t'i ndihmojnë ato, në një mënyrë ose në një tjetër, dhe të aktivizojnë më lehtë tratativat, aleancat dhe bashkëpunimin me ta. Nga ana tjetër, duke shpresuar në ndonjë rezultat në këtë vijë tradhtare dhe kapitulluese, revizionistët sovjetikë shpresojnë dhe llogaritin të shpëtojnë dhe vetë nga demaskimi dhe nga disfata e tyre politike e ideologjike.

Ata kanë punuar deri tani sidomos duke bërë presione të tmerrshme ndaj Vietnamit të Veriut dhe veçanërisht ndaj udhëheqësve të tij, që këta të kapitullonin dhe të hynin në bisedime me amerikanët. Me këtë manovër ata shpresonin të izolonin Vietnamin, për të vepruar atje mbasandaj më lirisht dhe të bashkëpunonin më ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të përgatitur aventurën e madhe.

Siç po duket, tash për tash ata po dështojnë, pse jo vetëm partizanët e Jugut nuk pranojnë bisedime, por as edhe Vietnamit të Veriut. Siç duket, dobësitë dhe lë-

kundjet janë kapërcyer dhe çdo gjë është vendosur dhe janë marrë masa për luftë, deri në hedhjen në det të amerikanëve.

Këta dhe miqtë e tyre, duke parë se të gjitha përçapjet diplomatike, të hapëta dhe të fshehta, të shoqëruara me luftë barbare në Jug dhe me shantazhin e bombardimeve në Veri, po dështojnë, kanë vendosur, siç duket, ta zgjerojnë luftën në Vietnam dhe në Laos.

Këtë e paralajmëron udhëtimi i Maknamarës në Vietnam, ai paralajmëron bombardimet e Hanoit, Hajfongut, që janë lënë pa bombarduar, gjoja si fletë fiku për të mbuluar përçapjet e fshehta diplomatike me revizionistët sovjetikë.

Bombardimi i Hanoit, që me siguri do të vijë edhe ai, do të thotë dhënie fund e manovrave tradhtare dhe kapitulluese të revizionistëve sovjetikë për bisedime.

Mbledhja e këtyre ditëve të fundit në Paris e këshillit të NATO-s tregoi qartë qëllimet dhe preokupacionet e mëdha të amerikanëve. Din Rasku dhe Maknamara u qanë atje që aleatët e tyre nuk i ndihmojnë sa duhet dhe si duhet në Vietnam (kërkojnë pra t'i angazhojnë si në luftën e Koresë), dhe se armatimi i Kinës po bëhet i rrezikshëm dhe preokupant për ta.

Nga ana tjetër, po në këtë mbledhje të NATO-s u thanë fjalë të mira për Bashkimin Sovjetik, u rekomandua që të zhvillohen punët në rrugën e forcimit të miqësisë me të, nuk u vendos gjë për «dhënien» e armëve atomike Gjermanisë së Bonit (e cila në fakt i ka), pse gjoja Bashkimi Sovjetik është i alarmuar etj., etj.

Të gjitha këto ndjekin qëllime të shumta dhe të koordinuara në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës

dhe revizionistëve sovjetikë. Kur imperialistët amerikanë përgatitin «ngjitjen e shkallëve» në Vietnam dhe përpiqen të futin gjithë partnerët e tyre në valle, revizionistët sovjetikë bëjnë të njëjtën gjë me aleatët e tyre, revizionistët e tjerë.

Revizionistët sovjetikë dhe aleatët e tjerë të tyre revizionistë, duke parë dështimin e presioneve të tyre ndaj Vietnamit, tani kanë koordinuar luftën kundër Kinës. Taktika e gjoja pushimit të polemikës mori fund. Të gjithë kanë filluar një avaz, «Kina do luftë», «Kina është ajo që pengon të arrihet paqja» etj. Kjo propagandë do të shkojë duke u rritur. Me këtë taktikë revizionistët sovjetikë përgatitin truallin e gënjeshtres për popujt e tyre.

Pra, ata punojnë që Bashkimi Sovjetik të mos ndërhyjë, ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës t'i kenë duart plotësisht të lira për të vepruar.

Por, natyrisht, kjo është katastrofa për revizionistët sovjetikë dhe për imperializmin amerikan.

Për revizionistët sovjetikë vijnë ditë të zeza. Ata janë futur në kontradikta të pafundme. Koha dhe tradhtia e tyre do t'i thellojnë aq shumë këto kontradikta të brendshme e të jashtme, saqë ata një ditë do të shkatërrohen. Ngjarjet që do të rrokullisen, do ta krijojnë medoemos këtë situatë, në mos sot, nesër.

T'i demaskojmë dhe t'i luftojmë pa mëshirë këta tradhtarë!

E HËNË

20 DHJETOR 1965

Janë një varg problemesh, që, të gjitha së bashku, i shërbejnë realizimit të planeve në kooperativat e ndërmarrjet bujqësore, si edhe në fshatrat e pakolektivizuara.

1. — Problemi i edukimit politikokulturor.
2. — Problemi ideologjik.
3. — Problemi agroteknik.
4. — Problemi organizativ.
5. — Problemi financiar dhe tregtar.

Mund të ketë edhe probleme të tjera kryesore përveç këtyre.

Secili nga këto probleme ka nënndarjen e vet kryesore dhe të dorës së dytë e të tretë.

Secili prej tyre është njëkohësisht problem partie dhe problem shtetëror, domethënë se kurdoherë për kryerjen e tyre në mënyrë të koordinuar duhet të punojnë edhe Partia, edhe pushteti.

Një ndarje të tillë përgjegjësish dhe detyrash duhet ta bëjmë, që t'i japim fund marrjes së kompetencave të njëri-tjetrit dhe që t'i shmangemi ortakllëkut në marrjen e përgjegjësive.

Përcaktimi i detyrave kryesore për anën e Partisë dhe për anën e pushtetit është i domosdoshëm, pse mbi bazën e këtij përcaktimi do të ndërtohen edhe puna e ndihma e organizuar që duhet t'u jepet kooperativave dhe ndërmarrjeve bujqësore.

T'i japim fund vajtjes në kooperativa pa pikësyzime të përcaktuara që më parë dhe pa përgatitjen e duhur për qëllimin për të cilin shkojmë; t'i japim fund vajtjes për të zgjidhur «çdo problem që të na dalë përpara», ose për «të gjitha gjërat nga një çikë dhe kalimthi», pa shëruar plagën, pa marrë masat e nevojshme, pa dhënë ndihmën e kualifikuar.

Ai që vete në kooperativë, me detyrë shtetërore, natyrisht është edhe punonjës politik e duhet të shikojë edhe anën ideologjike të çështjes. Duke ditur se për punën që vete të kryejë është punuar qysh më parë politikisht, ideologjikisht etj. nga Partia, ai duhet t'i kushtohet zgjidhjes konkrete të problemit, qoftë kjo organizative, agroteknike apo financiare. Kjo duhet të jetë puna e tij, në radhë të parë, dhe në qoftë se shihet që terreni nuk është përgatitur mirë nga organet e Partisë, të japë alarmin ose nëpërmjet punës së tij konkrete ta sqarojë problemin edhe nga anët e tjera, sepse punët s'janë të ndara me mur. Por në asnjë mënyrë nuk duhet të kryhen shkel e shko. Nga secili kërkohet të bëjë mirë, në radhë të parë, detyrën që i përket.

Gjithashtu, punëtori i Partisë nuk mund ta kryejë mirë detyrën e tij pa njohur gjendjen e përgjithshme dhe të shumanshme të kooperativës. Në qoftë se nuk punon kështu, atëherë ai bën një punë pa baza, në

hava, burokratike, të shkëputur nga jeta, nga lufta e përditshme.

Të dyja palët e kanë për detyrë të shkundin njëra-tjetrën, të ndihmojnë njëra-tjetrën, të bashkërendojnë punën në atë mënyrë që jo «njëri t'i bjerë gozhdës e tjetri potkoit», apo njëri të shtrojë një problem aktual që e dikton nevoja, kurse tjetri t'i bjerë legenit për një problem që i ka kaluar koha. Puna e Partisë dhe e pushtetit në kooperativa duhet të ketë si qëllim aktivizimin e masave, zhvillimin e iniciativës së tyre, prandaj çdo ndihmë e drejtuesve të rrethit të jetë e një niveli të kualifikuar dhe jo një përsëritje e mërzitshme e atyre gjërave që baza i di mirë dhe i ka dëgjuar shumë herë.

Ka rëndësi që organet dhe forumet drejtuese të rrethit të bëjnë përgjithësimin e përvojës së përparuar të bazës dhe të luftojnë për ta përhapur këtë në mënyrë sa më të kualifikuar.

Rëndësi ka, gjithashtu, kontrolli dhe ndihma e kualifikuar për zbatimin e vendimeve.

Puna thjesht organizative e Partisë duhet të lidhet dhe të zhvillohet në funksion të këtyre problemeve, ndryshe s'ka as efekt, as kuptim dhe shndërrohet në punë të mbyllur në vetvete e burokratike, ose kuptohet si një punë me «karakter special», që në fakt nuk është aspak special, pse organizata-bazë e Partisë, që zbaton normat dhe rregulloret e brendshme të saj, që zbaton të drejtat dhe detyrat e statutit e të normave të vendosura, di t'i drejtojë si duhet punët e shumanshme të kooperativës.

Shokët drejtues në rrethe duhet ta kenë të qartë

që baza (masat dhe organizatat e tyre) të bindet për domosdoshmërinë e zbatimit të planit, për drejtësinë e ligjeve, të vendimeve, të urdhëresave e të çdo rregulloreje, sipas së cilës do të punojë. Për të gjitha këto drejtuesit dhe organizatat-bazë të Partisë kanë për detyrë të sqarojnë me hollësi çdo gjë, duke përdorur format, mjetet dhe mënyrat më të përshtatshme (por të studiuara dhe jo shkel e shko).

Sqarimi ideopolitik i problemeve është njëra anë e punës. Ana tjetër, e lidhur me të, është edukimi i njerëzve për mënyrën se si t'i kryejnë më mirë detyrat, për të cilat janë sqaruar politikisht dhe ideologjikisht.

Së fundi, për të siguruar suksesin, kanë rëndësi organizimi i punës, masat organizative, teknike, agroteknike, financiare. Pra, drejtuesve në rreth u bie një barrë e rëndë që të reflektojnë thellë për këto probleme kyç. Ata duhet të thellohen si e kanë kryer punën deri tash në këto drejtime, të bëjnë një analizë kritike, të spastrojnë sa më parë terrenin nga elementët burokratë, nga rutina, nga një punë e pakualifikuar e pa përgjegjësi dhe të vendosin një metodë e një stil të ri pune, që të përputhen me direktivat e reja që përmbajnë Thirrja dhe vendimi i Komitetit Qendror, që po marrim.

Midis problemeve që shqyrtuam sot në mbledhjen e Presidiumit ishte edhe propozimi i Komitetit të Kulturës Fizike dhe Sporteve për emërtimin e majës së Korabit «Maja 11 Janari» ose «Maja e Republikës». U tha-

shë shokëve që të kenë kujdes se mos na bëhen propozime që «të ndërrohet» edhe emri i vetë malit Korab.

Sot pasdite, në selinë e Komitetit Qendror të Partisë, prita delegacionin e shëndetësisë të RP të Kinës, që kryesohet nga ministri i Shëndetësisë Cian Sin Çun¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 522.

E MARTË
21 DHJETOR 1965

Në mbledhjen e sotme të Byrosë Politike u diskutua dhe u aprovua ndarja e Ministrisë së Tregtisë dhe krijimi i Ministrisë së Tregtisë së Jashtme dhe asaj të Tregtisë së Brendshme. Për këtë çështje shfaqta disa mendime¹.

Këtë ndarje dhe krijimin e këtyre ministrive i bëjmë për të përmirësuar punën dhe për të pakësuar burokratizmin. Në mbledhje fola në vija të përgjithshme për shfaqjet e burokratizmit nëpër ministri, por tërhoqa vëmendjen se lufta kundër burokratizmit duhet të jetë më e rreptë, që në bazë e deri në udhëheqje. Ne, që jemi në udhëheqje, duhet të japim shembullin tonë në këtë drejtim. T'i ndihmojmë të gjithë që të ushtrojnë kompetencat, të drejtat dhe detyrat që u ka caktuar Partia, duke forcuar kështu centralizmin demokratik.

Mendimi im, që e shpreha edhe në diskutimin në këtë mbledhje, është që konkluzionet e rëndësishme për problemin e luftës kundër burokratizmit, t'i shtrojmë

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 530.

në një Plenum të Komitetit Qendror. Shokët u shprehën dakord.

Lexova materiale nga veprat e Leninit për luftën kundër burokratizmit. I lexova me shumë vëmendje, me mjaft interes dhe me laps në dorë. Bëra në to nënvizime.

E MËRKURË
22 DHJETOR 1965

Gazeta «Zëri i popullit» boton sot artikullin me titull «Komploti i ri i imperialistëve amerikanë, i imperialistëve japonezë dhe i revizionistëve sovjetikë nuk do ta mposhtë kurrë popullin korean»¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 535.

E ENJTE
23 DHJETOR 1965

Sot fola në telefon me shokun Hysni për ndihmën që mendoj se duhet t'u japim rretheve në dritën e vendimit të Komitetit Qendror që do të marrim.

Këtë ndihmë dhe orientim baza e do dhe ka nevojë, sepse pas vendimit që do të pritet pa dyshim me entuziazëm dhe do të ketë efekte të mira, ka mundësi që shokët e bazës të mos e gjejnë shpejt rrugën për t'iu futur një pune të shëndoshë në praktikë dhe ka rrezik sidomos që, duke e zvarritur punën për të gjetur rrugën më të mirë, rutina dhe metodat e vjetra të punës shumëvjeçare t'i pengojnë e të qëndrojnë pak a shumë atje ku ishin.

Për këto hodha disa ide në një kartë¹ që ia nisa Hysniut, ku i them ta mendojë një herë vetë këtë punë, pasi ai e njih mirë praktikën e punës në bujqësi. Këto çështje duken zhvilluar sidomos në drejtimin e punës Parti-pushtet dhe të përgjegjësive e të kompetencave, që po të përcaktohen mirë në rreth edhe kooperativa do t'i ketë të qarta.

1. Letra gjendet në Arkivin Qendror të Partisë.

Çështja tjetër me rëndësi të madhe është që Partia dhe pushteti, për detyrat e tyre të punojnë në mënyrë të kualifikuar.

Pasi të mendojë edhe Hysniu për këto gjëra, do të bisedoj përsëri me të se në ç'forma do t'ua shtrojmë shokëve të bazës.

E PREMTE
24 DHJETOR 1965

Në mbledhjen e sotme të Byrosë Politike aprovuam vendimin «Për luftën kundër burokratizmit, për një metodë dhe stil revolucionar në punë», që ka rëndësi historike, siç e shpreha edhe në diskutimin tim¹. Po ç'duhet bërë pas kësaj? Në radhë të parë të kuptohet thellë ky vendim dhe të vihet në jetë. Spastrimi i parë s'do të jetë veçse një operacion i fillimit, kurse lufta kundër burokratizmit duhet të jetë e vazhdueshme. Asaj duhet t'u kundërvihen fryma revolucionare, puna e gjallë e njerëzve, dinamizmi dhe fryma luftarake e organizmave, metoda dhe stili revolucionar në punë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 546.

E MARTË
28 DHJETOR 1965

Mbledhja e Kuvendit Popullor që filloi dje pasdite u dha fund punimeve.

Në këtë mbledhje u aprovuan një numër projektligjesh, si ai për disa ndryshime në Kodin e Punës, për krijimin e dy ministrive etj.

Anët e dukshme negative të partive të reja dhe të grupeve marksiste-leniniste që krijohen rishtas, janë ato të rritjes. Në ato vende ku ato krijohen në ilegalitet, puna e tyre është më serioze, më koherente, më e lidhur, kurse atje ku ato krijohen në legalitet, «lirisht», pse hëpërhë nuk pengohen nga pushtetet borgjeze, në anën e jashtme duken më aktive, por në punën, në përbërjen dhe në organizimin e tyre ka më shumë dobësi dhe infiltracion të elementëve karrieristë dhe diversionistë. Në përgjithësi të parat kanë një vijë lufte pak a shumë të drejtë kundër imperializmit dhe borgjezisë, kundër revizionizmit modern, me atë hrushovian në krye.

Në vendet ku veprimtaria e tyre është «e lirë»,

lufta kryesore që bëjnë ato është propaganda me anën e shtypit, dhe natyrisht e dobët edhe nga përmbajtja, edhe nga masiviteti, sepse është akoma fillimi. Nëpërmjet kësaj propagande dhe kontakteve individuale, ato përpiqen të shtojnë radhët e tyre me elementë të rinj, të krijojnë celula dhe komitete. Këtu ka për ta rreziqe të mëdha për shumë arsye. Arsyja kryesore është se prova e shkallës së vendosmërisë së atyre që duan të futen në Parti, e besnikërisë ndaj marksizëm-leninizmit, e shpirtit të tyre revolucionar, nuk është dhe nuk mund të jetë si duhet, pse aktiviteti i tyre është akoma i kufizuar dhe legal. Brenda këtyre rrethanave është zor të dallosh kokrrën nga kashta, të vendosurit nga të vakëtit, të fortët nga të lëkundurit, është zor të dallosh shpejt elementët llafazanë nga ata seriozë, diversionistët dhe demagogët. E tillë është natyra e punës, pastaj dhe njerëzit e dalluar që i udhëheqin këto parti janë të rinj në punën revolucionare, pse gati tërë veprimtaria e tyre, edhe kur ata bënin pjesë në partitë revizioniste, por të ashtuquajtura komuniste, ka qenë kufizuar në një punë rutinë, legale dhe burokratike. Kështu që as nga jeta militante e dikurshme ata nuk kanë përfituar shumë, as edhe nga situata aktuale «e qetë dhe legale» nuk përfitojnë aq shpejt dhe mirë, si e sa duhet.

Ndryshe qëndron dhe zhvillohet lufta nga ato parti të reja dhe grupe marksiste-leniniste që veprojnë në ilegalitet. Lufta në ilegalitet dhe përballë rreziqeve të përditshme i bën ato më koherente, i kalit më shpejt, u mpreh vigjilencën, i bën më krijuese në lidhje me format dhe me metodat e luftës, i bën të njohin më

mirë njerëzit, t'i provojnë ata në aksione të rrezikshme, i bën të njohin më mirë fytyrën dhe metodat e punës e të luftës së armikut.

Edhe në këto ekziston rreziku i infiltrimit të elementëve armiq, por këta armiq të maskuar, në përgjithësi, s'mund ta kenë jetën të gjatë, siç mund ta kenë në ato parti dhe grupe të reja të vendeve ku mund të punojnë «legalisht». Në këto të fundit të lëkundurit, të frikshmit, mund të maskohen gjatë dhe të pengojnë, kurse në partitë ilegale jo, jetën e kanë të shkurtër, pse jeta është plot luftëra dhe të rrezikshme bile.

Në vendet ku punohet «legalisht», si shokët e udhëheqjes, edhe ata të bazës jo vetëm që nuk kanë eksperiencë sa duhet, por qëllon që në disa ka një bagazh të madh mbeturinash mikroborgjeze, që në një luftë të tillë të kufizuar dhe «legale» shfaqen, trashen dhe pengojnë, frenojnë dhe rrezikojnë. Kjo bën që në një vend të krijohen shumë grupe marksiste-leniniste me gjoja një «strategji të përbashkët», por në luftë me njëri-tjetrin. Secili pretendon se e ka drejt dhe akuzon tjetrin për gabim, secili përpiqet të marrë vetë flamurin e krijimit të «partisë».

Kështu që ne po asistojmë në fazën e pashmangshme e të paevitueshme të luftës midis «grupeve», në këto rrethana të vështira për lëvizjen komuniste botërore. Shumë nga këta njerëz që militojnë në këto grupe vuajnë nga mendjemadhësia, duan medoemos të drejtojnë pse «dolën të parët», duan të bëjnë ligjin, monopolizojnë punën, dhe s'kanë besim sa duhet tek të tjerët, nuk kanë të qartë ç'do të thotë parti, centralizëm demokratik, disiplinë partie, sakrificë. Të gjitha këto sje-

llin shumë vështirësi në konsolidimin e punës, sjellin përçarje, hatëre, shfaqin mbeturina me frymë borgjeze, kritika merr forma të acaruara dhe aspak marksiste, autokritika pothuajse nuk ekziston, «asnjeri nuk gabon, janë të tjerët që gabojnë».

Në një situatë të tillë ndihma jonë internacionaliste bëhet e vështirë. Ne e kuptojmë drejt e dialektikisht luftën parimore të këtyre grupeve të ndryshme marksiste-leniniste, luftë parimore që do të çojë në formimin e partive të shëndosha revolucionare. Ne u japim ndihmë e përkrahje të gjithëve që të gjejnë rrugën e vërtetë të luftës dhe të formimit të partisë. Të gjithë kanë besim në Partinë tonë, por sipas tendencave të gabuara të tyre e të grindjeve të brendshme, ata kanë edhe tendencën të klasifikohen pro njëres dhe pro tjetres parti marksiste-leniniste. Kjo është një tendencë e dëmshme dhe e rrezikshme e këtyre grupeve, për të cilët ka e duhet të ketë vetëm një klasifikim, marksist-leninist. Kjo karakteristikë është më shumë e theksuar në vendet kapitaliste të Evropës. Një gjë e tillë është e kuptueshme për arsyt që thashë më lart.

Në këto vende marksistë-leninistët bëjnë një luftë demaskuese kundër revizionizmit modern në përgjithësi dhe në veçanti kundër revizionistëve të vendeve të tyre. Për kjo luftë është akoma e dobët, jo efektive sa duhet dhe jo tepër e drejtë dhe bindëse, por disa herë shumë sektare kundër elementëve të bazës së partisë revizioniste, për t'i bindur, për t'i aktivizuar këta elementë të bazës në luftën kundër udhëheqjes revizioniste, për t'i bërë ata që të tërhiqen me bujë dhe me shumicë nga partia revizioniste, kur ta përgatitin terrenin dhe në

momentin më adapt që të bëjë efekt të madh. Ata shpesh tregohen shumë sektarë kundër këtyre elementëve të bazës dhe harrojnë se një vit ose dy vjet më parë, edhe vetë ishin në pozitë të këtyre. Ata e kuptuan më shpejt tradhtinë e revizionistëve, por nuk duhet në asnjë mënyrë të përbuzin ata që e kuptojnë me vonesë, por më në fund e kuptojnë. Më mirë vonë se kurrë!

Këto parti dhe grupe marksiste-leniniste nuk e kanë kuptuar të gjitha sa duhet nevojën urgjente të luftës kundër kapitalizmit, jo vetëm me propagandë, por konkretisht në jetë, duke bërë një punë të gjallë me masat, me proletariatin, me fshatarësinë. Kjo është kryesorja. Vetëm kështu do të kaliten militantët, do të kaliten grupi dhe partia, vetëm kështu do të mbarojë ajo luftë e shterpët dhe e dëmshme në mes grupeve dhe personave, që po bëhet dhe zhvillohet tash.

Qëllimi i luftës është i madh. Në qoftë se ky qëllim kuptohet drejt dhe në rrugën marksiste-leniniste, atëherë çdo gjë do të shkojë drejt. Unë kam bindjen e plotë se kjo është kuptuar dhe do të kuptohet edhe më mirë, dhe vështirësitë e rritjes do të kapërcehen me sukses nga partitë e reja dhe nga grupet marksiste-leniniste.

E MËRKURË
29 DHJETOR 1965

Mora pjesë në festimin e 40-vjetorit të krijimit të gjimnazit «Qemal Stafa». Salla e madhe e shkollës ishte mbushur plot me ish-nxënës të saj, mësues, profesorë, të rinj e të reja.

Ndjeva një emocion të madh kur hyra në atë shkollë që mban emrin e shokut tim të luftës, militantit komunist, Qemal Stafa.

I falënderova mësuesit dhe nxënësit e kësaj shkolle për ftesën që më bënë dhe u urova festën e shkollës e njëkohësisht festën tradicionale të Vitit të Ri që po vjen. Pastaj fola për disa probleme të revolucionarizimit të metodave të mësimdhënies dhe të marrëdhënieve mësues-nxënës¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 555.

Në lidhje me punimin e vendimit të fundit të Byrosë Politike mbi luftën kundër burokratizmit, i porosit shokët t'i këshillojnë kuadrot e ministrive dhe ata të bazës, që, për vënien në jetë me sukses të këtij vendimi, të gjejnë metodën më të mirë dhe më të përshtatshme, pse ka rrezik që përpara një morie gjërash të vogla e të mëdha, të orientohen me zor dhe të mos kapen nga hallka kyç, ku është pleksur kjo sëmundje. Përkërisht nga kjo hallkë duhen kapur për ta filluar punën e për t'i dalë mbanë. Ndryshe, mund të dalin gjëra të shkëputura, të pakoordinuara, të studiuara me ngut, të nxitura vetëm nga dëshira. Kështu shokët mund të mos peshojnë mirë se çfarë duhet hequr, çfarë jo dhe sa e kur duhet shkurtuar.

U thashë shokëve se një nga çështjet kyç është ajo e kompetencave. Këndej duhet nisur puna për t'i rishqyrtuar problemet me imtësi dhe për të vendosur drejt; vetëm kështu do të vendosen marrëdhënie reciproke të drejta dhe do t'i dalin secilit të drejtat dhe detyrat.

Çdo ministri për këtë gjë duhet të punojë në këto drejtime:

1. — Të ushtrojë kompetencat që ajo ka e ato që duhet të marrë dhe të rregullojë drejt marrëdhëniet me dikasteret e tjera. Këto sipas ligjit, dhe të përcaktojnë në mes tyre detyrat, të drejtat dhe kompetencat reciproke. Kjo ka rëndësi të dorës së parë.

2. — Çdo ministri të ketë të qarta dhe të përcaktuara mirë marrëdhëniet, kompetencat dhe detyrat në vartësi me marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me ministritë dhe me institucionet e tjera. Këtu ka një mori gjërash të paqarta, të koklavitura, të thurura me një burokratizëm të neveritshëm. Pa bërë këtë operacion për sqarimin e gjendjes, pa përcaktuar mirë cilat janë kompetencat e njërit e të tjetrit, kryerja e detyrave shtetërore nuk mund të ecë mbarë dhe burokratizmi nuk mund të zhduket.

Ky është operacioni i parë, i domosdoshëm, urgjent dhe i kryer pas një studimi të imët nga vetë dikasteret, pas diskutimit me ato dikastere me të cilat kanë lidhje dhe, më së fundi, duhen sqaruar e vendosur drejt këto lidhje; pastaj t'i paraqiten Qeverisë që t'i sanksionojë përfundimisht.

Pasi të sqarohen këto, çdo ministri duhet të studiojë problemin brendapërbrenda ministrisë si dhe për të gjitha organizmat e saj vartës e për njerëzit që punojnë atje. Kjo punë e madhe, sipas mendimit tim, duhet të zhvillohet njëkohësisht në dy drejtime: nga lart dhe nga poshtë.

a) Nga lart, ministria të rishikojë me imtësi cilat do të jenë kompetencat e saj, në të gjitha hallkat e or-

ganizmat që e përbëjnë atë, dhe cilat do t'ia lërë bazës; pra, cilat do të jenë detyrat e saj dhe cilat të bazës. Përveç kësaj, ministria e ka për detyrë të studiojë dhe të ketë mendimin e vet se cilat kompetenca, detyra dhe të drejta do të kenë organizmat e ndryshëm që varen prej saj.

b) Nga ana tjetër, çdo organizëm që varet nga ministria, duhet t'i ketë plotësisht të qarta lidhjet me ministrinë, kompetencat që ka; të kërkojë llogari në rast se i merren ato dhe të propozojë ushtrim kompetencash të reja të diktuara nga situatat dhe eksperiencat; të sqarojë marrëdhëniet dhe lidhjet me ndërmarrjet simotra brenda dikasterit ose jashtë tij. Këtë punë pasi ta mbarojnë organizmat në fjalë t'ia çojnë ministrisë që të sanksionohen përfundimisht.

Në ministri, një shtab i kualifikuar dhe i caktuar posaçërisht për këtë detyrë, të ballafaqojë mendimin e formuluar nga ajo vetë me atë që i vjen nga baza. Çështjet për të cilat nuk përputhen mendimet të bëhen objekt diskutimi në mes bazës dhe qendrës dhe të arrihet në një mendim përfundimtar të njëjtë e të drejtë.

Kur të ketë mbaruar gjithë ky operacion, atëherë gjithçka bëhet e qartë, secili i ka të qarta kompetencat, detyrat, të drejtat. Nga këto situata, likuidimi i shkresave bëhet efektiv dhe konkret, spastrohen ligjet, urdhëresat, rregulloret e panevojshme, bëhen ligje dhe rregullore më të thjeshta, më efektive dhe jo të ndërlikuara.

Nga një spastrim i tillë bëhet më i qartë edhe lloji i organikave që kërkohen, bëhet i domosdoshëm shkurtimi i tyre, pse sqarohen funksionet dhe detyrat e se-

cilit. Atëherë forcohet aparati me njerëz të përshtatshëm dhe me aq sa duhet, pa lënë asnjë më tepër; kjo bëhet në bazë të funksionit, të zotësisë së kuadrit dhe jo në bazë të punës burokratike që na kishte mbuluar. Vetëm kështu do të dimë mirë ç'duhet të heqim dhe ç'duhet të lëmë.

Nëpërmjet një pune të tillë, krijohen mundësitë për t'i studiuar edhe më mirë kapacitetet e kuadrove dhe jo vetëm të atyre që do të qëndrojnë në dikastere, por edhe të atyre që do të largohen. Kështu, organet e kuadrit, duke i njohur më mirë karakteristikat e kuadrove që do të hiqen, i futen punës menjëherë për t'i rekomanduar këta në mënyrë të drejtë në prodhim, ose në sektorë të tjerë të përshtatshëm, me qëllim që të forcohet puna.

Mendoj se një metodë e tillë pune për spastrimin e burokratizmit nga aparatet tona, do të shmangë veprimet e pastuduara mirë.

Mund të propozohet edhe ndonjë metodë shumë më e mirë se kjo që rekomandoj unë, baza ka eksperiencë të madhe, ajo është ndeshur me shumë vështirësi që i njeh më mirë, që e gjen edhe më drejt zgjidhjen për likuidimin e shpejtë dhe radikal të tyre.

Prandaj u rekomandova shokëve që të përkrahin mendimet dhe propozimet pozitive të bazës.

Mbi organizimin e drejtimit në kooperativa

Metoda e planifikimit që po vendosim në bujqësi po ngjall entuziazëm të madh në kooperativistët dhe në kuadrot, sepse spastron një sërë veprimesh burokratike të diktuara nga lart dhe gjallëron pjesëmarrjen e masave në drejtimin e punëve në kooperativë. Kjo situatë na detyron për të vendosur metoda pune e kontrolli më të përparuara, më masive që sigurojnë zbatimin e këtij planifikimi. Mendoj se në kooperativë, nën drejtimin e asamblesë, duhet të organizohet një punë drejtuese e organizuese e atillë që t'i përgjigjet plotësisht vijës dhe qëllimit të Partisë në forcimin e socializmit në fshat.

Pra, në radhë të parë, sikurse kam thënë, në bazë të eksperiencës, të studiohet në vend dhe të vendoset se sa këshilla duhet të krijohen rreth kryesisë së kooperativës, sa komisione ekspertësh, si duhet të organizohet kontrolli financiar, deri te kontrolli i brigadierëve e i normistëve që janë vende kyç. Të gjitha këto, natyrisht, kanë karakter masiv, shoqëror, por edhe me përgjegjësi, prandaj të kryhet me kujdes e jo shkel

e shko. Në të tillë organizma ndihme e kontrolli, në rast se kemi inkuadruar një pjesë të madhe të asamblesë, mendoj se e kemi zgjidhur drejt punën, drejtimin efektiv të asamblesë, e cila mbledhet një ose dy herë në vit. Por në këto mbledhje, çdo pjesëtar nuk ka kohë të diskutojë shumë, gjatë e për të gjitha problemet, kurse me mënyrën që propozoj, pjesëtarët e asamblesë, në shumicë, do të marrin pjesë në drejtimin e kontrollin e punëve të kooperativës për të gjithë vitin.

Edhe mbledhja e përfaqësuesve mund të bëhet dy herë në vit dhe përpara se të mbledhet asambleja, për të shoshitur punët në mënyrë të tillë që në mbledhjet e asamblesë të diskutohet e të vendoset vetëm për çështjet kryesore. Në këtë mënyrë, qoftë asambleja, qofshin organet e saj do të kenë punuar, drejtuar, kontrolluar e vendosur përfundimisht për problemin.

Natyrisht, Partisë i duhet të bëjë një punë të madhe në këtë drejtim, të zgjedhë në këta organizma njerëzit e përshtatshëm, por jo të njëjtët, cilido të vihet në vendin e tij. Organet e Partisë të punojnë që të futin në punë sa më shumë njerëz, duke mos nënvleftësuar qoftë edhe mendimin ose ndihmën, sado të vogël, edhe të një kooperativisti të thjeshtë. Një detyrë kryesore e Partisë është t'i edukojë të gjithë këta njerëz, t'i bëjë të zotë e të ndërgjegjshëm për drejtim dhe për punë.

E dyta, mendoj, se duhet të rishikojmë legjislativonin dhe rregulloret e brendshme që rregullojnë punën dhe jetën në kooperativa, duke i thjeshtuar e duke i bërë të përshtatshme me gjendjen e kooperativave tona, me nivelin e tyre, me natyrën e tyre. Në këtë drejtim ne kemi kopjuar disa gjëra nga sovjetikët, të cilat

edhe në rast se shumë herë nuk kanë qenë të gabuara, s'kanë qenë të përshtatshme për ne, ose kanë qenë të parakohshme. Ne kemi vendosur të tilla sisteme pune e kontrolli rigoroz në kooperativa, sikur këto të ishin ndërmarrje nga më modernet dhe me precizion të përsosur.

Këto gjëra ne i kemi vendosur dhe vazhdojmë t'i mbajmë si tabu, kur edhe kuadri ynë në kooperativa, jo vetëm që është i paktë, por akoma i ulët nga ana teknike e profesionale. Nga kjo ndodh që në më të shumtat e rasteve rregullat e vendosura të mos zbatohen, të bëhen formale, dhe nën maskën e tyre bëhen abuzime, vërtetohen veprime burokratike. Kështu kontrolli dhe iniciativa e masave frenohen, po të marrim parasysh edhe arsyen se ato nuk janë në gjendje t'i kuptojnë dhe pra edhe t'i zbatojnë si duhet, prandaj nuk duhet të kënaqemi vetëm me faktin që kemi një legjislacion «të përsosur».

Të mos kujtojmë se në krahasim me stadin e ekzistencës së pronës private, kemi arritur sot në një stad socialist të përsosur në fshat dhe të kërkojmë që edhe miligramin e gjësë ta matim me peshoren e floririt. Në një perfeksionim të tillë do të arrijmë më vonë. Partia do të punojë dhe koha do të vijë t'i edukojmë kuadrot që të ngrihen në një nivel të tillë, por sot akoma edhe në sektorin e industrisë, ku kemi fabrika moderne dhe ku çdo gjë matet në mënyrë më të përsosur dhe me mjete të perfeksionuara, prapëseprapë edhe atje kemi të meta serioze, lëre pastaj në kooperativat bujqësore. Prandaj, duke kërkuar të vëmë vetulla, të kemi kujdes të mos nxjerrim sytë.

E treta, mendoj, se duke u mbështetur në çështjen e dytë, të rishikojmë të gjitha librat, defterët, tabelat statistikore etj., që kemi vendosur në kooperativat bujqësore, në rrethe dhe deri në ministri, në këto aspekte:

a) në thjeshtësimin sa të jetë e mundur më shumë të tyre;

b) në rregulloren e kooperativave të jenë zërat e domosdoshëm, që t'i kuptojnë jo vetëm kryetari dhe tekniku i kooperativës, por gjithë masa e, në radhë të parë, anëtarët e këshillave, të komisioneve, brigadierët etj.

Në tërësi ato duhet të jenë të atilla që të japin në çdo moment pasqyrën e plotë, të qartë të gjendjes ekonomiko-shoqërore të kooperativës dhe andej të nxirren pastaj lehtësisht konkluzione e të merren masat e nevojshme dhe cilitdo t'i hapen perspektiva pune e studimi;

c) të dhënat që do të marrë rrethi nga kooperativat bujqësore të jenë të atilla që të ndikojnë për të zhdukur pikëpamjen se rrethi vendos për çdo gjë në kooperativë, se ai dikton e administron çdo gjë tek ajo. Kooperativa administron vetë. Rrethi ndihmon, drejton, kontrollon dhe administron vetëm në një rast marrëdhëniet shtet-kooperativë, në bazë të akordeve ligjore dhe kontraktuale. Por që rrethi ta bëjë mirë këtë, duhet të ketë edhe të dhëna nga kooperativat. Prandaj, të dhënat që duhet t'i japë kooperativa rrethit, të jenë aq sa i duhen rrethit për funksionet, për rolin dhe për detyrat që ka ndaj kooperativës. Kërkesat e shumta, përgatitja e të cilave e rëndon kooperativën dhe që

rrethi nuk i përdor, nuk duhet as të kërkohen nga rrethi dhe as të jepen nga kooperativat.

Kështu edhe rrethi nuk duhet t'i dërgojë ministrisë përveçse ato të dhëna që kësaj i duhen, jo për të shtuar burokracinë, po për të bërë studime të atilla që të ndihmojnë efektivisht dhe në mënyrë të lartë shkencore rrethet dhe tërë kuadrot e bujqësisë, në të gjithë shkallëzimin e tyre.

Të tria këto instanca të mendojnë më me iniciativë për çka u nevojitet për vete. Kjo ndjenjë përgjegjësie do t'u shërbejë atyre për të vendosur qoftë për vete, qoftë edhe për çfarë i duhet instancës më të lartë për punën e saj, me qëllim që puna e kësaj t'i përgjigjet dhe t'i shërbejë edhe instancës më të ulët.

Në qoftë se instanca më e lartë vendos vetë se çfarë duhet e çfarë nuk duhet, pa u këshilluar me instancën e ulët, nuk është e drejtë. Kështu nuk duhet të veprohet. Pikërisht një praktikë e tillë e ka çuar Ministrinë e Bujqësisë të marrë çdo muaj nga të gjitha rrethet deri 500 statistika. Përse i duhen asaj gjithë këto? A i ka studiuar të gjitha? Pra ky fakt tregon se ka praktika burokratike. Këtë e themi sepse nga kjo ministri asnjëherë nuk kanë ardhur në udhëheqjen e Partisë propozime me rëndësi që të revolucionojnë punën. Ja një shëmbull i tillë i qartë që tregon si të mbyt burokratizmi, si ky paralizon kuadrot e bazës dhe kuadrot e qendrës i bën të hiqen sikur bëjnë një punë shkencore, por në fakt nuk e bëjnë një gjë të tillë, përkundrazi praktikojnë një punë shumë të thjeshtë, kurse baza ka ecur shumë më përpara.

Për këtë arsye unë dhashë udhëzime të merren ma-

sa radikale dhe të digjet me hekur të nxehtë një praktikë e tillë e dëmshme, mund të themi sabotuese, qoftë edhe pa dashje. Këto udhëzime dhe të tjera ua rekomandova shokëve që tash, me rastin e punimit të thirrjes së Komitetit Qendror dhe të Këshillit të Ministrave, punët për planifikim t'i kenë parasysh dhe të bëjnë studime në bazë, të konsultohen me bazën, të marrin mendimet, sugjerimet e bazës dhe të na i sjellin t'i studiojmë me imtësi e të dalim me konkluzione. Këto konkluzione, mendoj unë mund t'ia paraqesim Komitetit Qendror t'i studiojë, t'i vendosë për të dalë me një vendim të plotë, të shumanshëm, të arsyetuar për çdo gjë, vendim që t'ia shtrojmë Partisë dhe kooperativistëve për ta zbatuar në jetë.

Kjo, mendoj unë, do të jetë një ndihmë e madhe që na jep baza dhe që ne e përpunojmë dhe ia kthejmë bazës si direktivë për të ecur përpara, për ta zhvilluar më shumë bujqësinë tonë socialiste.

[DHJETOR 1965]¹

Demokracia popullore nuk mund të bëjë pa administratën, por diktatura e proletariatit, klasa punëtore në fuqi, duhet të japë orientimet e saj për organizimin e prodhimit. Eksperienca, disiplina e hekurt dhe ndërgjegjja e klasës punëtore të bëjnë që funksionarët e administratës t'i zbatojnë detyrat që klasa u ka caktuar, dhe për shpërblim të marrin një pagë gati të njëjtë me atë të punëtorit. Proletariati nuk duhet të lejojë që aparatit e nevojshëm administrativ ta mbulojë burokracia dhe të shndërrohet ai në një çiban të rrezikshëm, që i zë frymën diktaturës së proletariatit. Të luftojmë tendencat burokratike, të forcojmë centralizimin e nevojshëm, sipas kuptimit marksist-leninist, centralizmin demokratik të masave, të ndërtuar, të frymëzuar nga direktivat, nga qëllimet, nga aspiratat e klasës punëtore, nga aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse.

1. Këtyre shënimeve u mungon data. Mendohet se janë mbajtur në dhjetor të vitit 1965, sepse në këtë muaj këto ide janë përdorur më të zgjeruara në diskutime të zhvilluara prej autorit.

Prandaj kurdoherë dhe vazhdimisht të bëjmë kujdesin më të madh që të mos rrëshqasim, as në prehrin e burokratizmit borgjez, mikroborgjez, dhe as në atë anarkosindikalist.

E PREMTE
31 DHJETOR 1965

Për studimet që po bëjmë lidhur me pagat në kooperativat bujqësore, i rekomandova Hysniut të ketë parasysh edhe këto:

1. Për të forcuar drejtimin e punës së kryetarëve të kooperativave dhe për të rritur plotësisht interesimin e tyre për mbarëvajtjen e kooperativës, përveç kujdesit të veçantë që duhet treguar për ngritjen politike dhe profesionale, të shihet, gjithashtu, që interesi i tyre ekonomik të lidhet ngushtë dhe drejt me interesin e kooperativës. Pra paga e tyre të jetë jo më me ditë fikse, por me të ardhurat e përgjithshme të kooperativës, me realizimin e plotë të planit në të gjitha drejtimet, si dhe me tejkalimin e përgjithshëm të tij.

Për t'i caktuar këto përqindje, që do të përbëjnë të ardhurat e kryetarit, duhet, gjithashtu, të kemi parasysh disa kritere të tjera. Si total të ardhurat e kryetarit të mos tejkalojnë shumë të ardhurat e kooperativistit më të mirë në mënyrë që disniveli ekonomik në mes mesatares së të ardhurave të kooperativistëve dhe të kryetarit, të mos jetë i madh.

Duhet të kemi gjithashtu parasysh, mendoj unë,

që për pagat e kryetarëve të kooperativave të zonave të pasura fushore, të kemi një konfrontim me pagat e drejtorëve të ndërmarrjeve shtetërore, sepse, pak a shumë, kapaciteti i tyre dhe vështirësia në punë e në drejtim, janë të barabarta. Për brigadierët mund të përshtatim deri-diku format e ndërmarrjeve në industri, duke marrë parasysh kurdoherë gjerësinë e brigadës dhe punën e detyrat e brigadierit.

Pra, mund të kemi brigadierë vetëm si të tillë, si dhe brigadierë që të marrin pjesë në punë në arë. Në rastin e parë, të ardhurat e brigadierit mund të ndërtohen në bazë të sistemit që do të përdoret për pagën e kryetarit të kooperativës, duke mbajtur parasysh këtu të ardhurat e përgjithshme të brigadës, të destinuara për ndarje në ditë-punë.

Në rastin e dytë, dhe në mënyrë proporcionale me punën drejtuese, mund të mbahet për bazë kriteri i mëparshëm. Për sa i përket pjesës së punës konkrete, punës direkte në prodhim, të paguhet ashtu si edhe kooperativistët e tjerë.

Për teknikët të mbahen parasysh edhe variantet që kam dhënë më parë dhe, për sa u përket disa kategorive, si rojtarë depush etj., mund të jenë me rrogë fikse ose me ditë-punë.

Propozimet që bënin kooperativat e Picarit dhe të Mashkullorës dhe që i botoi edhe gazeta, i studiova me kujdes dhe nuk janë të vlefshme. Duhet studiuar me kujdes propozimet e kryetarit të kooperativës së Konispolit, shokut Gaqo Lula, pse ka mendime të mira dhe të drejta, që na ndihmojnë dhe mund të na vlejné për studimet që po bëjmë.

Imperialistët amerikanë, në bashkëpunim të ngushtë me revizionistët hrushovianë dhe revizionistët e tjerë, gjatë gjithë kësaj jave po zhvillojnë një veprimtari të gjerë diplomatike në të pesë kontinentet për çështjen e Vietnamit.

Kjo veprimtari bëhet për qëllime nga më të ndryshmet, por kurrsesi për largimin e agresorëve nga Vietnamit.

Objektivi i amerikanëve është t'ia nënshtrojnë Vietnamin diktatit të tyre, të shuajnë luftën e drejtë të popullit vietnamez, që u shkakton humbje kolosale në njerëz, në materiale, në politikë, që demaskon demagogjinë e tyre dhe pengon zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të mira midis imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë për sundimin e botës. Lufta e drejtë e popullit vietnamez i pengon ata edhe për izolimin dhe rrethimin nga ana e tyre të Kinës.

E gjithë kjo ofensivë demagogjike për «paqe në Vietnam» është pra një flluskë sapuni, një përpjekje për të hedhur hi syve, për të justifikuar veprimet e mëvonshme ushtarake në një shkallë më të gjerë, më barbare, por pa asnjë sukses në fitore. Ajo e tëra është e koordinuar në mënyrë të fshehtë me revizionistët sovjetikë.

«Ofensiva e parë paqësore» e amerikanëve u ngrit mbi bazën e terrorit të shkaktuar nga bombardimi ajror i Vietnamit të Veriut. Atëherë Kosigini shkoi në Vietnam të gjunjëzonte vietnamezët nën shantazhin terrorist amerikan.

Mirëpo kjo përpjekje për gjunjëzim nuk pati sukses. Vietnamezët nuk u trembën dhe si amerikanët, ashtu

edhe sovjetikët, hëngrën e po hanë grushte të tmerrshme në fushat e betejës, në politikë dhe në ideologji.

Të ndodhur përballë këtij dështimi, sigurisht, revizionistët sovjetikë duhet të jenë marrë vesh me aleatët e tyre amerikanë që të vënë në veprim një variant të ri në ofensivën demagogjike për të gënjyer vietnamezët që të dorëzohen në bazë të kushteve të tyre (amerikano-sovjetike). Për këtë duhet që në fillim amerikanët të ndërpresin bombardimet ajrore mbi Vietnamin e Veriut.

Urdia në fakt është arritur dhe ka një javë që amerikanët i kanë ndërprerë bombardimet dhe u thonë sovjetikëve: «Tash veproni se jua plotësua dëshirën».

Kështu po niset pra misioni i dytë sovjetik, me në krye njëfarë Shelepini, këtë herë «me degën e ullirit amerikan», mbi «ndalimin e bombardimeve». Ky ndalim i bombardimeve do të përdoret prej sovjetikëve për të «bombarduar» kokat e vietnamezëve duke e paraqitur çështjen si një «sukses të madh të politikës sovjetike», si rezultat i presioneve «të tmerrshme të sovjetikëve mbi amerikanët» e të tjera profka.

Prandaj, të nisur nga kjo, sovjetikët do t'u bëjnë presione vietnamezëve që «përpara kësaj disfate që pësuan amerikanët, duke u detyruar të pushojnë bombardimet, le të vemi në mbledhjen e Gjenezës dhe atje t'ia vëmë SHBA-së dy këmbët në një këpucë dhe t'i detyrojmë të kapitullojnë» etj., etj. Sovjetikët s'do të mungojnë t'u thonë vietnamezëve se atje, në mbledhje, «shumica është me ne», — Polonia, India etj. Diplomatatë amerikanë që po shëtitin e piqen me Gomul-

kën, me Titon, me Shastrin, me Dë Golin, me Podgorin e të tjerë kanë nga ana e tyre planin e një manovre në Gjenevë.

Ç'plan kanë konkretisht, hëpërhë nuk e dimë, por takimet e diplomatëve amerikanë me pjesëmarrësit e konferencës së Gjenevës lënë të kuptohet qartë se po punohet për të thurur një kurth të madh.

Por shpejt do të shohim si do të zhvillohet kjo manovër tradhtare.

E rëndësishme është që Vietnami i Veriut të mos lëkundet nga pozitat e luftës së drejtë dhe çdo gjë do të kurorëzohet me fitore.

Mbaroi ky vit, me luftë e me përpjekje, me suksese dhe me të meta, por mund të them se Partia jonë u kalit shumë, u bë më e fortë, u lidh akoma më shumë me masat dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare iu shtua prestigji, plotësisht në mënyrë të merituar për vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste. Kjo ka qenë arsyeja e fitoreve të Partisë dhe të republikës sonë, si brenda dhe jashtë.

Rroftë në shekuj Partia jonë e fuqishme!

TREGUESIT

TREGUESI I LËNDËS

A

Aftësia prodhuese, shfrytëzimi i saj — 102, 103.

Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë — 480.

Ambasadat e Bashkimit Sovjetik dhe të ShBA në shtete të ndryshme — 127, 145, 146, 147, 156, 329.

Ambasadat e RP të Kinës në shtete të ndryshme — 13, 60, 156, 180, 349.

Ambasadat e RP të Shqipërisë në shtete të ndryshme — 12, 70, 82, 83, 174, 177, 318.

Ambasadat e shteteve të ndryshme në RP të Shqipërisë — 60, 65, 179, 180, 349, 353.

Aparatet shtetërore, administratat shtetërore, organet shtetërore dhe ato ekonomike — 213-214, 346, 413, 431, 445, 446, 479, 493-494, 526.

Arsimi në RPSH — politika e Partisë për zhvillimin e arsimit. Zhvillimi, masivizimi, re-

volucionarizimi i shkollës — 224, 225-226, 281-284;

— sistemi arsimor; arsimi 8-vjeçar, i mesëm dhe i lartë; kriteret e pranimit të nxënësve në shkollat e larta — 151, 224, 225-226, 275, 281-284, 285-286;

— boshti ideologjik në shkollë; edukimi ideopolitik; programet, tekstat, lëndët, metodat e mësimdhënies — 150-155, 159;

— studentët, mësuesit — 150, 151, 152, 154, 159, 192-194.

Arti Ushtarak i Luftës Popullore — 453-454.

B

Bashkimet Profesionale të Shqipërisë — 60, 98-99.

Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë — 153, 154;

— kujdesi i Partisë për rininë; cilësitë e rinisë, e-

dukimi arsimor i saj — 196, 202-203, 285-287;

— organizatat e rinisë në shkollë, edukimi i rinisë shkollore — 153, 154-155, 226, 282;

— Konferenca e 11-të vjetore e rinisë së Elbasanit — 197, 198-203.

Bashkimi Sovjetik (1917—1953); kontributi i Stalinit në Luftën e Madhe Patriotike të Bashkimit Sovjetik — 63-64, 254-256, 260-261.

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik

— gjendja e brendshme, kontradiktat; sulmi i revizionistëve sovjetikë mbi Stalinin, socializmin dhe marksizëm-leninizmin — 125, 145-148, 155-156, 231-232, 255-262, 276, 444;

— marrëdhëniet me Kinën, RD të Vietnamit dhe Korenë; qëndrimi ndaj çështjes vietnameze — 68, 70, 71-72, 73, 82, 88, 99, 100, 103-105, 106, 107, 124, 131-133, 134, 135-137, 139, 143-144, 158, 166-167, 170, 185, 242-245, 299-302, 496-497, 498, 530-532;

— taktikat në qëndrimin ndaj lëvizjes komuniste ndërkombëtare; roli sabotues ndaj luftërave na-

cionalçlirimtare dhe partive të vërteta marksiste-leniniste — 7-8, 55, 99, 123-126, 135-137, 146-147, 156-157, 461-462;

— marrëdhëniet me partitë dhe me vendet revizioniste, përpjekjet për të ruajtur hegjemoninë mbi to — 39, 40, 44, 52, 53, 54-55, 56, 69-70, 74-75, 311-313, 468-469;

— politika e jashtme; qëndrimi ndaj ShBA, lidhjet dhe përkrahja për to — 5, 6, 14-16, 17, 68, 72-73, 90, 99, 104, 124-125, 127, 131-133, 134, 135, 136, 137, 141, 143-144, 145-147, 156-157, 166-167, 185, 262, 299-301, 333, 337-338, 339-340, 415-417, 496-497, 530-532;

— qëndrimi armiqësor ndaj RP të Shqipërisë — 104;

— qëndrimi ndaj çështjes gjermane — 14-16;

— disfatat e revizionistëve sovjetikë — 162, 163-164, 498.

Blegtoria, zhvillimi i saj; kullotat, baza ushqimore e blegtorisë — 101, 118, 484.

Borgjezia e re në vendet revizioniste — 22, 23, 443.

Britania e Madhe, imperializmi anglez — 63-64, 132, 328.

Bujqësia, zhvillimi i saj — 419, 484-485;

— duhani, pambuku, farërat — 102, 419-420;

— punët e stinës në bujqësi; ujitja, sistemi i ujitjes; hapja e tokave të reja — 290, 331, 483-485;

— kuadrot, punonjësit, brigadat; studimet në bujqësi — 120, 419, 484.

Burokratizmi, lufta kundër shfaqjeve të tij — 206, 231, 346-347, 348, 380-381, 382-383, 407-408, 432-433, 441, 493-495, 504-505, 509, 516-519, 522, 524-525, 526-527.

D

Dallimet thelbësore në socializëm, ngushtimi gradual i tyre — 360-363.

Dekorimet, dekoratat — 99, 142, 388.

Dëshmorët — 271.

Diktatura e proletariatit, demokracia socialiste, centralizmi demokratik — 526.

Disiplina tekniko-shkencore dhe ajo e punës — 102-103, 206.

E

Edukimi komunist, edukimi ideopolitik; puna e diferencu-

ar me njerëzit — 98, 102-103, 402, 442, 444.

Ekonomia komunale, shërbimet komunale — 316, 476.

Ekonomia popullore — zhvillimi dhe shfrytëzimi i rezervave të brendshme — 103, 347-348.

Emulacioni socialist, zotimet — 60.

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 3, 4, 7, 12, 18, 19, 26, 30, 33, 34, 36, 37, 39, 61, 62, 65, 66, 90, 110, 114, 178, 179, 180, 188, 190, 196, 197, 202, 204, 219, 227, 229, 271, 291, 292-293, 294, 295, 297, 298, 323, 325, 326, 335, 341, 342, 343, 349, 350, 351, 352, 353, 356, 388, 390, 391, 392, 394, 412, 415, 472, 477, 478, 505, 515.

F

Franca — 132, 139.

Fshatarësia kooperativiste, politika e Partisë ndaj saj — 120, 317, 376-377, 381-383, 385, 402, 480.

Fshati socialist, përmirësimi i vazhdueshëm i gjendjes ekonomike e social-kulturore — 378-386.

Fuqia punëtore, politika e Partisë me të; lëvizja e fuqisë pu-

nëtoje — 26, 101, 284, 285, 286-287.

G

Gruaja dhe vajza shqiptare, emancipimi i tyre — 192-194.

H

Historia e Shqipërisë — 153-154.

Hungaria, Partia e Punonjësve të Hungarisë — 69-70.

I

India, reaksioni indian; politika e jashtme, gjendja e brendshme — 7-8, 73, 131, 337-340, 531.

Indonezia; gjendja e brendshme, politika e jashtme — 5, 6, 73, 76, 393, 395-399, 458-459.

J

Jetesa në shoqërinë tonë socialiste — 287, 361-362, 376.

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav; L K e Jugosllavisë, kongresi i 8-të i saj; degjenerimi i partisë në Jugosllavi — 19-25, 27-29, 30-32, 34;

— degjenerimi në kapitalizëm dhe pasojat e tij; vetadministrimi jugosllav, çështja nacionale — 21-24, 27-29, 34;

— politika e jashtme; lidhjet me imperializmin dhe me borgjezinë, marrëdhëniet me partitë revizioniste dhe socialdemokrate — 20-21, 24-25, 29, 125, 337-340;

— qëndrimi ndaj marksizëm-leninizmit, socializmit dhe partive të vërteta komuniste; qëndrimi ndaj Vietnamit — 19-20, 21, 22, 25, 53, 185.

K

Kapitalizmi — 76, 258-259, 354-355.

Këshillat popullorë, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë; seksionet e planit — 46, 102, 364, 400, 401-402, 445, 446;

— këshillat popullorë në rrethin e Elbasanit — 303.

Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave — 10, 18, 65, 431, 432, 434, 437, 441, 479, 493, 494, 525.

Kina, PK e Kinës — 251;

— qëndrimi oportunist ndaj Bashkimit Sovjetik, kontraktat dhe marrëdhëniet me të — 72, 82, 83-84, 85, 88, 99, 106, 124, 137, 138, 140, 155, 156, 158, 170;

— qëndrimi ndaj revizionizmit modern dhe ndaj mbledhjes së 1 marsit — 44, 45, 75-76, 99, 123, 137, 140, 165, 174-175, 180, 181, 187;

— politika e jashtme; qëndrimi ndaj borgjezisë dhe imperializmit amerikan — 75-76, 99, 156;

— marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj PPSH dhe RP të Shqipërisë — 13, 60-61, 99, 127, 138, 174, 180, 188, 189, 190, 191, 279, 390, 391, 418, 471, 503;

— qëndrimi ndaj lëvizjes marksiste-leniniste; qëndrimi ndaj Vietnamit — 130, 138, 139, 166, 222-223, 234, 249-250.

Klasa punëtore në Shqipëri — 286-287, 526.

Kompetencat, përgjegjësitë — 504, 516-519, 523-525.

Komunisti — detyrat e tij; përsosja e figurës së komunistit — 78, 445.

Kooperativat bujqësore; politika e Partisë për forcimin e tyre dhe për konsolidimin e rendit kooperativist — 372-

377, 479-480, 482, 499-502; — organizimi dhe drejtimi i punës në kooperativa; organet drejtuese, asambleja; kuadrot, specialistët — 316, 365-371, 520-525, 528-529;

— marrëdhëniet me shtetin; shpërblimi i punës — 368-371, 373-374, 375-376, 378, 379, 380-381, 383-386, 523-524, 528-529; — ekonomitë ndihmëse — 384-386.

Kuadrot, specialistët; politika e Partisë me kuadrin — 214, 224-226, 305-306, 357-358, 360-361, 436, 441, 442;

— përgatitja e kuadrit, edukimi dhe aftësimi i tyre; kuadrot e Partisë, kuadri i lartë e i mesëm — 196, 225-226, 282-283, 285, 286, 519.

Kuba, revizionistët kubanë, Partia Komuniste e Kubës — 44-45, 162, 310.

Kuptimi politik i problemeve — 363, 451.

Kuvendi Popullor, Presidiumi i Kuvendit Popullor — 46, 99, 142, 217, 289, 303, 321, 322, 418, 502, 510.

L

- Lenin, Vladimir Iliç* — 81, 267, 480, 505.
- Letërsia dhe artet në RPSH. Shkrimtarët, artistët; estrada* — 26-27, 197, 359, 423.
- Lëvizja komuniste punëtore e marksiste-leniniste ndërkom-bëtare* — 264;
- zgjerimi e forcimi i saj, diferencimi në lëvizjen komuniste. Faktorët objektivë dhe subjektivë, procesi dialektik i lindjes dhe i forcimit të grupeve e partive marksiste-leniniste në luftë me revizionizmin dhe reaksionin — 7-8, 53-54, 55-56, 221-223, 233-237, 249-253, 510-514;
- marrëdhëniet ndërmjet partive e grupeve marksiste-leniniste — 55-56, 221-223, 234, 237-240, 248-250, 251, 252, 253;
- lëvizja komuniste në Afrikë e në Lindjen e Mesme; lëvizja marksiste-leniniste në Evropë e në Amerikën Latine — 53-55, 222-223, 478, 513-514.
- Ligjet, përsosja e tyre* — 372-376, 521-522.
- Liria, pavarësia dhe sovraniteti kombëtar* — 6, 354-355.

- Lufta Antifashiste Nacional-çlirimtare e popullit shqiptar* — përvoja, mësimet e saj — 453.
- Lufta dhe paqja; pacifizmi borgjezo-revizionist, rreziku i luftës; armatimi bërthamor* — 14-17, 24.
- Lufta e Dytë Botërore (1939-1945)* — 63-64.

M

- Marksizëm-leninizmi* — busull dhe udhëheqje për veprim — 30, 61, 137, 145, 163, 357.
- Marks, Karl* — 22, 61.
- Masat dhe individi, roli i tyre* — 347-348, 442-444.
- Metoda dhe stili në punë; ka-pja pas hallkës kryesore* — 347-348, 426, 493-495, 516-519.
- Ministritë; detyrat, kompeten-cat, metoda dhe stili i punës së tyre* — 431-432, 434, 436-437, 441, 516-519;
- Ministria e Punëve të Brendshme — 362, 420;
- Ministria e Punëve të Jashtme — 9, 10, 11;
- Ministria e Mbrojtjes Popullore — 38, 46;
- Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 208, 209, 210, 211, 434, 441;

N

- Nafta* — shfrytëzimi i vendburimeve ekzistuese dhe zbulimi i vendburimeve të reja — 101.
- Ndërmarrjet socialiste* — ndërmarrjet bujqësore; ndërmarrjet nacionale — 372-373, 377, 400, 401-402.
- Ndërtimi i socializmit në Shqipëri* — tipare, karakteristikë — 286-287, 357, 358.
- Ndihmat, kreditë ndërmjet shteteve, kuptimi marksist-leninist i tyre* — 243-247.

O

- Organet e Punëve të Brendshme* — Forcat e Kufirit. Arma e Sigurimit të Shtetit — 36, 46-47, 49.
- Organikat* — shkurtimi i tyre — 436-437.
- Organizata-bazë e Partisë* — 213-214, 215, 273-274, 445-446;

- organizatat-bazë të Partisë në ndërmarrjet ekonomike, në institutet shkencore, në kooperativat bujqësore dhe në administratat — 196, 211, 432, 501, 502, 521.

- Organizata e Kombeve të Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme e saj; manipulimi nga superfuqitë; roli i RP të Shqipërisë në këtë organizatë* — 5-6, 109, 110-111, 112, 113, 115-117, 343, 354-355, 417.
- Organizatat e masave, detyrat e tyre* — 213-214.

P

- Paga, shpërblimi i punës; politika e Partisë në fushën e pagave* — 361-363, 370-371, 526.
- Paraja, qarkullimi i mone-dhës; mirëmbajtja e saj* — 275-276.
- Partia e Punës e Shqipërisë* — vija, vendimet, direktivat, ndërtimi dhe jeta e brendshme — vendimet, direktivat; përmbajtja, njohja dhe zbatimi i tyre — 77-78, 97-98, 316, 428, 433-435, 439, 494-495, 501-502, 507, 509, 516, 525;
- roli udhëheqës i Partisë

- 347, 348, 426-427, 428-435, 440, 442, 444-446;
- aktivet, plenumet, mbledhjet në Parti — 433, 489;
- përbërja e Partisë; shtimi i radhëve të saj; pranimet në Parti, kriteret e pranimeve — 273, 440;
- kritika dhe autokritika, disiplina, centralizmi demokratik — 77-78, 488-490;
- puna e Partisë; metoda dhe stili në punë, kapja pas hallkës kryesore; ndihma dhe kontrolli për bazën — 48-49, 274, 347-348, 426-436, 437, 438, 439, 482, 488-490, 499-502, 507;
- kompetencat, përgjegjësitë; lidhja e organeve të Partisë me ato të pushtetit, lufta kundër dublimit dhe spostimit të organeve të pushtetit — 214, 427-435, 438-439, 445-446, 479, 499-502, 507-508;
- puna e Partisë me njerëzit; letrat e popullit, puna me letrat — 274, 387, 448;
- karakteristikat e Partisë; përvoja e saj; forcimi i Partisë — 222, 251, 252-253, 427;

- materialet, raportet, informacionet për organet udhëheqëse — 420, 432-433, 447, 488, 489;
- lufta kundër shfaqjeve të burokratizmit, liberalizmit e sektarizmit — 346, 439, 440-441, 488-490;
- masat e marra nga PPSH për t'i prerë rrugën revizionizmit dhe për të çuar përpara revolucionin dhe socializmin — 442-446.

Partia e Punës e Shqipërisë — organet udhëheqëse qendrore e në rrethe

- Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati i KQ — 48-49, 60, 97-98, 150, 151, 213, 215, 216, 273, 275, 305, 316, 317, 357, 359, 360, 362, 375, 400, 401, 406, 413-414, 419, 420, 430, 431, 432, 434, 439, 455-456, 457, 473-474, 475-476, 482, 504, 509, 525;
- Plenumi i 14-të i KQ (18—19 shkurt 1965) — 101, 112, 113;
- Plenumi i 15-të i KQ (25—26 tetor 1965) — 422, 423-424;
- aparati i KQ; organizatat-bazë, Komiteti i Partisë i aparatit të KQ — 77-82, 279, 430-431, 437, 439, 447, 488, 489, 490;

- komitetet dhe aparatet e Partisë në rrethe, sekretari i parë — 48-49, 102, 214, 274, 428-429, 430-431, 433, 434, 438-439, 445, 446, 482, 488-489, 499-502;
- organizatat e Partisë të rretheve Pogradec e Përmet — 428, 473;
- Organizata e Partisë, aktiviteti, plenumi i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës — 91-95, 359, 420, 429, 475;
- Byroja e Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit — 429, 437;
- komitetet e Partisë të rretheve Durrës, Shkodër, Pukë e Burrel — 103, 387, 428;
- komitetet e Partisë të rretheve Vlorë, Fier e Lushnjë — 420, 433, 448;
- aktivet e Partisë të rretheve Krujë e Lezhë — 181.

Partia e Punës e Shqipërisë — politika e jashtme

- mbrojtja e marksizëm-leninizmit dhe e Stalinit — 232, 255;
- marrëdhëniet dhe përkrahja për lëvizjen komuniste e marksiste-leniniste, për partitë dhe

- grupet marksiste-leniniste — 8, 50, 54, 55-56, 179, 221-223, 234, 237, 238, 239, 248-253, 264, 307, 308, 332, 334, 345, 392, 394, 395, 412, 424, 425, 461, 462, 477, 478, 487, 513, 514;
- demaskimi i revizionizmit modern, atij sovjetik dhe jugosllav; qëndrimi ndaj mbledhjes së 1 marsit — 8, 34, 43, 55, 56, 82, 84-85, 89, 108, 123, 126, 134-135, 138, 143-144, 155-156, 164-165, 277, 337-340, 481.

Partia e Punonjësve të Vietnamit — 12.

Partia Komuniste e Belgjikës

- 221-222, 223, 233, 238-240.

Partia Komuniste e Brazilit

- 487.

Partia Komuniste e Francës

- 310.

Partia Komuniste e Holandës

- 304, 306-308.

Partia Komuniste e Indisë (marksiste-leniniste)

- 7-8.

Partia Komuniste e Indonezisë

- 233, 345, 396-399, 458-463.

Partia Komuniste e Italisë; revizionistët italianë

- 52-53, 163, 245, 246-247, 266-269, 310, 465-469.

Partia Komuniste e Japonisë

- 477.

Partia Komuniste e Kolumbisë (marksiste-leniniste) — 179.
Partia Komuniste e Malajës — 50.

Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste) — 53, 248.
Partia Komuniste e Suedisë — 310.

Partia Komuniste e Zelandës së Re — 392, 394, 395, 412.
Planifikimi — metodologjia e planifikimit; plani i 4-t pesëvjeçar — 49, 347, 403-405, 406-411, 413-414;

— argumentimi i planeve me aftësi prodhuese, me burime materiale, financiare dhe njerëzore — 406-411, 484;

— pjesëmarrja e masave, lufta kundër të metave në planifikim; ndihma dhe kontrolli — 347-348, 364-365, 367-369, 401-402, 404-405, 406-408, 410-411, 525;

— planifikimi në bujqësi, në blegtori dhe në kooperativa bujqësore — 364-369, 408-410, 520.

Politika e jashtme e RPSH

— parime të politikës së jashtme; rritja e prestigjit të RPSH në botë — 73, 117, 144-145, 241, 339;
— demaskimi i imperializ-

mit, borgjezisë dhe reaksionit; qëndrimi ndaj superfuqive — 14-17, 182, 324, 337-340;

— qëndrimi ndaj çështjes vietnameze dhe asaj gjermane; përkrahja për luftën e drejtë të popullit vietnamez, marrëdhëniet me RD të Vietnamit — 16, 70, 135, 138, 143, 168-169, 182, 186, 241, 353;

— marrëdhëniet me Rumaninë, Çekoslovakinë, Japoninë etj. — 178, 179, 183, 277, 389, 470;

— marrëdhëniet me Kinën — 60-61, 174, 188, 189, 190, 191, 233, 279, 288, 390, 391, 418, 471, 503.

Polonia, revizionistët polakë — 9, 13, 17, 162-163, 167.

Prona socialiste, qëndrimi socialist ndaj saj; edukimi me dashurinë për pronën socialiste — 400, 402-403, 480;

— prona e grupit, politika e Partisë për forcimin e saj; oborri kooperativist — 372-377, 480.

Pushteti popullor — kompetencat, përgjegjësitë, detyrat, metoda dhe stili në punë — 499-500, 501, 502, 507-508.

R

Regjimi i kursimit; kursimi i lëndëve të para dhe i materialeve të tjera — 102-103, 403-405.

Revizionistët modernë — vija, kontradiktat, disfatat e tyre; tendencat për shkëputje nga Bashkimi Sovjetik — 5, 20-21, 51-53, 57-58, 64, 149, 160, 161-164, 218, 246-247, 309-313;

— qëndrimi ndaj PPSH, PKK dhe çështjes vietnameze; qëndrimi ndaj partive të vërteta komuniste e marksiste-leniniste — 41-43, 44-45, 142, 144, 159, 160, 161-162, 164, 242, 243-247, 313, 461-462, 498;

— partitë revizioniste të Evropës, të Amerikës Latine, të Afrikës, të Azisë e të Lindjes së Mesme — 7, 8, 44-45, 53, 54-55, 56, 162, 304, 309, 310;
— mbledhja e 1 marsit e revizionistëve modernë — 74-75, 128, 139, 140, 142, 149, 159, 160, 161-165, 312.

Revolucioni proletar, revolucion i me dhunë; luftërat nacionalçlirimtare të popujve — 135-136, 398, 460.

Rumania, revizionistët rumunë; Partia Punëtore Rumune

— 13, 39-43, 162, 181, 332, 334;

— qëndrimi ndaj Bashkimit Sovjetik; qëndrimi ndaj RP të Shqipërisë — 13, 39, 40, 42, 140, 174-175, 177, 178.

S

Specialistët e huaj në Shqipëri — 357-358.

Stalin, Josif Visarionoviç — 63, 64, 137, 231-232, 255-261, 267, 276, 293, 307, 330, 452.
Superfuqitë — 416-417, 491-492.

Shih edhe: Shtetet e Bashkuara të Amerikës... Bashkimi Sovjetik...

SH

Shëndetësia në RPSH — 420-421.

Shkenca në RPSH, institucionet shkencore dhe punonjësit shkencorë — 48-49, 153, 208-211, 317.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës; gjendja e brendshme, politika e jashtme; disfatat e tyre — 5, 6, 14, 15, 17, 131, 262, 314-315, 333, 337-338, 339-340, 491-492, 497-498;

— lufta e tyre agresive në Vietnam, «zgjidhja» e çështjes vietnameze, disfatat në Vietnam — 90, 130-131, 132-133, 135, 139, 141, 158, 165-166, 167, 168, 182, 183-186, 289, 290, 300, 314, 329, 497-498, 530-532.
Shtypi, agjencitë e lajmeve dhe propaganda borgjezo-revizioniste — 87, 144, 393.

T

Teoritë e pikëpamjet revizioniste dhe kritika ndaj tyre

- të revizionistëve sovjetikë për «partinë e të gjithë popullit» dhe për «bashkëkzistencën paqësore» — 164, 266, 267-268, 444;
 - të revizionistëve italianë për «kompromisin historik» dhe për «rrugën italiane për në socializëm» — 266-269;
 - të revizionistëve jugosllavë për luftën, paqen e çarmatimin; teoria e «vendeve të paangazhuara» — 24-25;
 - teoritë mbi rrugën paqësore për në socializëm — 397-399, 460.
- Traktati i Varshavës, qëndrimi i RPSH ndaj tij* — 9-11, 13,

14, 15-18, 35, 51-52, 57-59, 64, 65, 67, 74.

Tregtia e brendshme, furnizimi i popullit; punonjësit e tregtisë; lufta kundër të metave dhe gabimeve në tregti; kultura tregtare — 205-207, 231, 402, 405;

— rrjeti tregtar në fshat; kooperativat e konsumit dhe të shitblerjes, lidhja e tyre me tregtinë shtetërore — 378-386, 402;

— tregu privat, kufizimi i tij — 480.

Tregtia e jashtme — importi, eksporti — 102, 403-404.

U

Ushtria Popullore — roli udhëheqës dhe puna e Partisë në ushtri; forcimi, organizimi, puna ideopolitike, kuadrot në ushtri — 38-39, 49, 449-457, 473-474.

V

Vendet revizioniste — 245-246, 443, 444.

Vështirësitë, lufta për kapërcimin e tyre — 96, 114, 129, 161, 195, 220, 242, 280, 327, 332.

Vietnami — lufta e popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë — 90, 129-130, 141, 183-186;

- çështja vietnameze; ndërhyrjet e fuqive të huaja në «zgjidhjen» e çështjes vietnameze; rrugët për zgjidhjen e saj — 132, 134, 135, 136, 139, 165-169, 242-247, 299-302, 312-313, 314;
- politika e jashtme; qën-

drimi ndaj ShBA dhe BS — 12, 68, 70, 71, 104-105, 223, 289;

— marrëdhëniet me RP të Shqipërisë — 12, 70-71, 241.

Z

Zonat kodrinore e malore — zhvillimi i mëtejshëm ekonomik-shoqëror i tyre — 118-122, 213-214, 483-485.

TREGUESI I EMRAVE

A

Alia, Ramiz — 9, 10, 11, 13, 14,
34, 67, 82, 89, 105, 134, 138,
149, 219, 229, 281, 284, 332,
334, 337, 400, 418, 422, 425.

Aidit, Dipa Nasuntora — 397,
458.

Alikata, Mario — 467.

Allkja, Sefedin — 199-200.

Amendola, Xhorxhio — 266,
268, 269, 277.

Andropov, Juri — 51.

Aranitasi, Hajdar — 94.

Arismend, Rodnei — 44.

B

Ballhysa, Kujtim — 200.

Bardhi, Jovan — 95.

Ben Bela, Ahmed — 320, 339.

Biçaku, Fatmir — 200.

Binjaku, Violeta — 200.

Bitu, Pirro — 221, 234, 238,
239.

Blogu, Xhavit — 199.

Boçari, Pandeli — 19.

Bodnarash, Emil — 13.

Bosh, Juan — 262.

Brezhnjev, Leonid — 42, 43,
69, 70, 276.

Budo, Halim — 109, 111, 112,
116, 343.

Bumedien, Huari — 320.

C

Cian Sin Çun — 503.

Ç

Çarçani, Adil — 342.

Çeliku, Hajredin — 93.

Çaushesku, Nikolae — 181.

Çela, Qemal — 199.

Çërçill, Uinston — 63, 64, 67.

Çuçi, Gafur — 91-92.

Çu En Lai — 13, 41, 82, 88,
174, 175, 180, 188, 189, 190,
191, 279.

Çumani, Tefik — 79.

D

Damianov, Raiko — 218.
 Dange, Shpirad — 7, 8, 56.
 Deivis, Harold — 328.
 Dervishi, Rrapo — 91, 359.
 Dezh, George Georgiu — 177,
 178, 179, 180, 181, 183.
 Dë Gol, Sharl — 127, 132, 167,
 532.
 Dë Grot, Pol — 307-308.
 Dode, Petro — 349.

DH

Dhima, Leko — 297.
 Dhima, Mihal — 297.

F

Ferra, Musa — 92-93.

G

Gijo, Raimond — 74.
 Gomulka, Vladislav — 74, 163,
 531-532.
 Grabocka, Myftar — 349.
 Greçko, Andrei — 51.
 Gripa, Zhak — 221, 222, 233-
 -235, 236-238, 239-240.
 Gromiko, Andrei — 51, 147.
 Guevara, Ernesto Çe — 162.

GJ

Gjebero, Veiz — 94.
 Gjordeni, Sotiraq — 201.
 Gjoshi, Liri — 200.

H

Hoxha, Nexhmije — 86, 90,
 110, 227, 325, 326, 350, 351.
 Harriman, Averel — 333, 337.
 Ho Shi Min — 105.
 Hoxha, Pranvera — 350.
 Hoxholli, Fisnik — 200.
 Hrushov, Nikita — 14-15, 16,
 17, 24, 40, 42, 45, 54, 70, 72,
 124, 125, 137, 161, 162, 167,
 178, 245, 255, 256, 259, 261,
 267, 307, 415, 416.
 Hun Tao (pseudonim) — 50.

I

Ibanjez, Blasko — 173.
 Ingrao, Pietro — 467-468, 469.

J

Jugov, Anton — 218.

K

Kapo, Hysni — 12, 33, 34, 36,
 50, 142, 143, 219, 248, 364,
 371, 419, 479, 485, 507, 508,
 528.

Koleka, Spiro — 233, 279, 330.

Kadar, Janosh — 69.

Kadir, Anvar — 345.

Kapo, Vito — 34.

Kardel, Eduard — 25, 27, 28,
 29.

Kastro, Fidel — 44, 45, 53.

Keite, Aua Diallo — 277.

Keite, Modibo — 277.

Kenedi, Xhon — 24.

Këllezi, Abdyl — 231.

Khajam, Omar — 173.

Klosi, Bilbil — 95, 321.

Kohler, Foynd — 147.

Kongoli, Sefedin — 198.

Kosigin, Aleksei — 68, 70, 71-
 -72, 82, 88, 90, 99, 100, 104,
 106, 107, 124, 131, 132, 133,
 134, 135, 138, 143, 333, 338,
 530.

Kozma, Gogo — 94.

Kroi, Haxhi — 202.

Kurti, Petrit — 200.

L

Leonidha I — 115.

Le Zuan — 223.

Lin Haj Jun — 471.

Liu Siao — 82.

Longo, Luixhi — 467, 468, 469.

Lula, Gaço — 529.

Luli, Gani — 201.

LL

Lleshi, Haxhi — 99, 142.

Lloxh, Kabot — 329.

M

Marko, Rita — 80, 110, 183,
 219, 229, 456, 464.

Murra, Prokop — 80.

Myftiu, Manush — 39, 281,
 284.

Magjistari, Petraq — 78-79.

Maknamara, Robert — 497.

Malej, Hysen — 200.

Malinovski, Rodion — 261.

Manushi, Sotir — 80-81.

Mao Ce Dun — 45, 100, 106.

Maskanji, Pietro — 12.

Mikojan, Anastas — 70.

Mitrushi, Nikolla — 93-94.

Moisiu, Aleksandër — 86-87.

Moro, Aldo — 246, 247.

Muço, Adnan — 81.

Musa, Ahmed — 50.

N

Nushi, Gogo — 98, 99, 233

Nasution, Abdul — 395.

Nehru, Xhavarharlal — 8.

Ngo Din Diem — 166.

Nikolla, Afërdita — 201.

Nikson, Riçard — 167.

Noli, Fan — 171, 172-174.

P

- Peristeri, Pilo — 183.
 Paçrami, Fadil — 77, 80-81,
 270.
 Pashko, Josif — 292.
 Pistoli, Ciril — 421.
 Pistoli, Valentina — 86.
 Podgorni, Nikolai — 69, 532.
 Popa, Sokrat — 201-202.
 Pozdnjak, V. — 260.

R

- Rankoviç, Aleksandër — 30,
 31, 32.
 Rapacki, Adam — 167.
 Rask, Din — 497.
 Roazio, Antonio — 467.
 Robo, Xhorxhi — 77.
 Rodrigues, Karlos Rafael —
 44.
 Roka, Blas — 53.
 Rusi, Deko — 92.
 Rusvelt, Franklin — 64.

S

- Sakej, Aleks Kejson — 116.
 Sallaku, Hamdi — 79.
 Saraçi, Irma — 201.
 Sekia, Pietro — 466, 467, 468.
 Selimi, Tele — 199-200.
 Simixhiu, Ajet — 94-95.
 Skoçimaro, Mario — 466.
 Spak, Pol-Henri — 247.

- Stafa, Qemal — 515.
 Stoika, Kivu — 181.
 Sukarno, Ahmed — 396-397,
 398, 459, 460.

SH

- Shamblli, Peti — 291, 479.
 Sharki, Lorens — 56.
 Shastri, Lal Bahadur — 337,
 338-340, 532.
 Shekspir, Uiliam — 173.
 Shelepin, Aleksandër — 531.
 Shqera, Luan — 198-199.
 Shtylla, Behar — 34, 173, 321,
 343.
 Shy Gjen Guo — 391.

T

- Toska, Haki — 181, 219, 229.
 Teilor, Maksuell — 329.
 Tito, Josip Broz — 21, 22, 23,
 24, 25, 63, 167, 337, 338-340,
 532.
 Tojoto, Sajaka — 470.
 Toka, Ngjeli — 81.
 Toliati, Palmiro — 52-53.
 Tollumi, Suzana — 199.
 Truhiljo, Molina — 262.

U

- Uilson, Harold — 328.
 U Tan — 167.
 U Tung — 396.

V

- Valera, Julian — 248.
 Vaskues, Pedro — 179.
 Vern, Zhyl — 4.
 Vidali, Vitorio — 465, 467, 468.

XH

- Xharda, Jani — 198.
 Xhonson, Lindon — 124, 146,
 314, 333, 338.

Y

- Y Khan — 82.

Z

- Zola, Emil — 61.
 Zogu, Ahmet — 172.
 Zuka, Ligor — 81.

ZH

- Zhukov, Georgi — 276.

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

Afrikë — 73, 339.
Akademia e Shkencave e RP të Kinës — 418.
Algjer — 191.
Algjeri — 320.
Amerika e Jugut — 315.
Ansambli i këngëve dhe i valleve «Fronti» i RP të Kinës — 390, 418.
Azi — 99, 131, 134, 138, 339.

B

Bahçallëk (Shkodër) — 141.
«Bashkimi» (gazeta ~) — 70.
Batalioni partizan «Fuat Babani» — 341.
Batalioni partizan «Hakmarrja» — 292.
Beograd — 337.
Beteja e Termopileve (480 para erës së re) — 114-115.
Bruksel — 304, 307.
Budapest — 69, 74.

Bukuresht — 177.
Bullgari — 218.

Ç

Çekosllovakia — 16, 389.

D

Dajt (mali ~) — 96, 220, 231, 263.
Danang (Vietnami i Jugut) — 158.
Devoll (Korçë) — 341.
Dibër — 317.
Durrës — 86-87, 323, 387.

E

Ekspedita Gjeologjike e Batrës, Mat — 129.
Ekspozita «Kamboxhia sot» — 472.
Elbasan — 196, 197, 203, 204.
Ersekë — 292, 316.
Evropë — 63, 76.

F

Fabrika e Këpucëve [Fabrika e Lëkurëve dhe e Këpucëve], Korçë — 294.
 Fabrika e Miellit [Fabrika e Blojës], Korçë — 294.
 Fabrika e Sodës Kaustike [Uzina e Sodës dhe PVC], Vlorë — 19.
 Florida (ShBA) — 171.

G

Gramsh — 305-306, 316.

GJ

Gjermania Lindore (RD Gjermane) — 15, 16.
 Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 14-15, 497.
 Gjumnazi «Qemal Stafa» [Shkolla e mesme e përgjithshme «Qemal Stafa»], Tiranë — 515.
 Gjirokastër — 344, 413.

H

Hajfong (Vietnam) — 497.
 Hanoi — 70, 88, 90, 104, 106, 328, 497.
 Havanë — 44, 45.
 «Helena e Trojës» (filmi ~) — 39.

Hidrocentrali i Bisticës [Hidrocentrali «J. V. Stalin»] — 330, 389.

Hidrocentrali i Shkopetit [Hidrocentrali «Frederik Engels»] — 389.

«Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» (teksti ~) — 317.

«Historia e Skënderbeut» (vepra ~, F. Noli) — 173.

I

«Il macchinista» (filmi ~) — 18.

Indokinë — 75-76, 131, 135, 183.

Instituti i Kërkimeve dhe i Studimeve Gjeologjike dhe Minerale, Tiranë — 208-211, 216.

Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH, Tiranë — 317.

Internacionalja e Parë — 61.
 Internacionalja e Tretë Komuniste — 287.

«Ishulli misterioz» (filmi ~) — 4.

Itali — 233.

J

Japoni — 131, 470, 491.

K

Kajro — 191.

Kalimantan (Indonezi) — 5.
 Karaçi — 191.

Klos (Mat) — 428.

Kolonjë — 291, 292-293.

Kombinati i Drurit, Elbasan — 101.

Kombinati i trikotazheve «Drapër e çekan», Korçë — 294.

Komiteti i Kulturës Fizike dhe Sporteve, Tiranë — 502.

Konferenca e 2-të Afro-Aziate — 318, 323.

Konferenca e Gjenevës — 131, 132, 166, 531-532.

Konferenca e Jaltës (shkurt 1945) — 63.

Konferenca e Potsdamit (korrik-gusht 1945) — 63.

Konferenca e Teheranit (nëntor-dhjetor 1943) — 63.

Kongo — 136.

Kooperativa Bujqësore e Bashkuar e Drenovës, Korçë — 294.

Kooperativa Bujqësore e Mashkullorës [Kooperativa bujqësore e bashkuar «35 dëshmorët e Cepos»], Gjirokastër — 529.

Kooperativa Bujqësore e Përcarit [Kooperativa bujqësore e bashkuar «Partizani»], Gjirokastër — 529.

Korab (mali ~) — 502-503.
 Korçë — 197, 228, 278, 291, 293, 295, 344, 350, 431, 435.
 Koreja e Jugut — 134.
 Kore (RDP e Koresë) — 99, 107, 123, 124, 492, 497.
 Kori i pleqve të Korçës — 342.
 Krujë — 181, 413.
 Kufijtë Oder-Najse — 16.
 Kukës — 317.
 Kuzbaba [Parku «Liria»], Vlorë — 7.

L

Laos — 136, 497.

Lezhë — 141, 181.

Librazhd — 306, 316.

Lindja e Largme — 75, 491-492.

Liqeni i Ohrit — 297, 351.

Londër — 72.

Lushnjë — 197, 316.

M

Malajzi — 5.

Mali (Republika e Malit) — 277.

«Maria Oktobër» (filmi ~) — 66.

Martanesh (Mat) — 129.

Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë (10 nëntor—1 dhjetor 1960) — 307.

Memaliaj (Tepelenë) — 431.
Monumenti i Pavarësisë, Vlorë — 276.
Moskë — 44, 128, 139, 145, 146, 147, 148, 149, 155, 156, 158, 159, 161, 170, 174, 175, 223, 260, 276.

N

NASAKOM — 396, 398, 458-459, 460.
NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior) — 497.
Ndërmarrja e Përpunimit të Drurit e Fushë-Arrëzit, Pukë — 101, 403.
Ndërmarrja Gjeologjike e Kukësit — 435.

NJ

Nju-Jork (ShBA) — 171.

P

Pallati i kulturës «Aleksandër Moisiu», Durrës — 86-87.
Paris — 497.
Parku i Madh i Tiranës — 62.
Pekin — 44, 82, 88, 100, 156, 222, 279.
Peqin (Elbasan) — 204, 403.
Phenian — 107.

Plazhi i Durrësit — 227.
Pogradec — 197, 297, 335, 336, 341, 342, 348, 350, 352.
Poloskë (Korçë) — 341.
«Pravda» (gazeta ~) — 68, 72.

R

Rafineria e Naftës [Uzina e Përpunimit të Naftës], Cërrik — 197.
Rangun — 191.
«Revizionistët modernë — likuidatorët më të mëdhenj në historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare (artikulli ~, «Zëri i popullit», 25 dhe 26 maj 1965) — 295-296.
Revolucioni Demokratiko-Borgjez i Qershorit (1924) — 172.
Romë — 234.

S

Santo-Domingo — 262, 315.
Sarandë — 344.
Sazan (ishulli ~) — 33.
Skrapar — 306, 316.
Sofje — 218.

SH

Shkodër — 141, 356.
Shkolla e lartë e Partisë «V. I. Lenin», Tiranë — 412.

Shoqata e Punonjësve për Çlirimin e Vietnamit të Jugut — 264.

Shoqëria «Vatra» — 173.
Shqipëria e Jugut — 96.
Shqipëria e Veriut — 96, 97.

T

Tajvan — 76, 131.
TASS (Agjencia Telegrafike e Bashkimit Sovjetik) — 70, 134, 145, 149.
Teatri i Operës dhe i Baletit, Tiranë — 98, 390.
Teknikumi i Minierave dhe i Gjeologjisë [Shkolla e mesme e Minierave dhe e Gjeologjisë], Përrenjas — 298.
Tepelenë — 306, 316.
Tiranë — 37, 96, 110, 112, 154, 204, 231, 263, 278, 298, 324, 325, 326, 327, 352, 359, 475, 476.
«Titanik» (filmi ~) — 65.
Traktati i Moskës për ndalimin e provave të armëve bërthamore në atmosferë e nën ujë (1963) — 14-15, 16.
Traktati Japonio-Kore e Jugut (22 qershor 1965) — 491.
Treport (Vlorë) — 19, 36.
«300 spartanët» (filmi ~) — 114.

U

UDB (Drejtoria e Sigurimit Shtetëror, Jugosllavi) — 30, 31.
«Unita» (gazeta ~) — 465, 469.
Uzina e Metalurgjisë së Zezë [Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë»], Elbasan — 196.

V

Vlorë — 3, 7, 26, 33, 34.
Vodicë (Kolonjë) — 292.

XH

Xhakartë — 396, 458.

Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~) — 9, 90, 108, 141, 176, 229, 295-296, 324, 415, 506.

ZH

«Zhenminzhibao» (gazeta ~) — 140.
«Zherminal» (filmi ~) — 61.